

# ENVER HOXHA

VEPRA

43



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

43

MARS 1970 – QERSHOR 1970

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1984



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 43-TË

Vëllimi i 43-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban materiale të periudhës mars-qershor 1970, shumë prej të cilave botohen për herë të parë.

Në to trajtohen probleme të rëndësishme të jetës së Partisë, të zhvillimit të revolucionit e të ndërtimit të socializmit dhe të situatës ndërkombëtare. Ideja qendrore që del prej tyre është se realizimi i detyrave në të gjitha frontet kërkon forcimin e pandërprerë të rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe të Partisë së saj në tërë jetën e vendit. Faktorë të rëndësishëm për këtë janë gjallërimi i mëtejshëm i jetës së brendshme dhe rritja e frymës luftarake të organizatave-bazë të Partisë, frytshmëria e të cilëve matet me rezultatet konkrete në çdo sektor, veçanërisht në frontin e prodhimit.

Organizatave të Partisë, theksohet në vëllim, duhet të gjejnë forma sa më të drejta pune, të cilat t'u përshtaten kohës, problemeve, situatës politike, ngritjes ideologjike të njerëzve; të punojnë që t'i bëjnë këta të ndërgjegjshëm për shtimin e prodhimit industrial nëpërmjet forcimit të disiplinës proletare, shfrytëzimit në maksimum të kohës së punës e të kapaciteteve prodhuese etj.

Orientime të vlefshme gjejnë punonjësit e fshatit

në diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë të datës 20 mars 1970, si dhe në diskutimin në Byronë Politike «Propaganda e Partisë i bën të ndërgjegjshëm, i nxit dhe i mobilizon njerëzit». Në to e në shkrime të tjera jepen mendime konstruktive që bujqësia të sigurojë rendimente të larta në të gjitha prodhimet, që të ecet drejt specializimit të saj. Gjithashtu argumentohet nevoja e zhvillimit dhe e përmirësimit racor të bagëtive, sidomos e mbarështimit të lopës, si në zonat fushore, ashtu dhe në ato kodrinore e malore. Ideja e rëndësishme se «Që të marrim prodhime të bollshme duhet të dimë dhe që të dimë duhet të mësojmë», e cila përshkon fjalën në takimin me një grup kuadrosh në Luzin e Vogël, është një nxitje për punëtorët e kooperativistët që të njohin shkencën e teknikën, ligjet e natyrës dhe anët biologjike të bimëve e të kafshëve. Duke ngritur pareshur nivelin e tyre kulturor, ata, thekson shoku Enver Hoxha, do të jenë në gjendje ta thonë më shumë e më mirë fjalën e tyre për planifikimin e për drejtimin e ekonomisë.

Arritja e rezultateve të larta në prodhimin industrial e bujqësor, siç theksohet në vëllim, kërkon t'i lihet fushë e gjerë iniciativës krijuese të masave, në luftë kundër barrikadave të kota të burokratizmit e shfaqjeve të rutinës. Njëkohësisht vihet në dukje roli që u takon të luajnë kuadrove. Analiza në diskutimin «Për disa çështje të raportit midis kuadrove me arsim të lartë dhe klasës punëtore» nxjerr detyrën: kuadrot të dinë të drejtojnë, të ndihmojnë, të kontrollojnë për mbarëvajtjen e prodhimit; ata të edukojnë klasën

punëtore, por edhe të edukohen e të kaliten prej saj.

Forcimi i rolit udhëheqës të klasës punëtore e të Partisë së saj është i domosdoshëm për të zgjidhur edhe detyrat e mëdha të zhvillimit të revolucionit tonë socialist, kur rëndësi vendimtare merr lufta për çrrënjosjen e mbeturinave të së kaluarës dhe për edukimin komunist të punonjësve. Edhe në dokumentet e kësaj periudhe shoku Enver Hoxha porosit organizatat-bazë të Partisë të mos e flenë mendjen, duke pandehur se me marrjen e një vargu masash u zhdukën paragjykimet dhe zakonet prapanike. Trajtimi i çështjeve të luftës ideologjike, nënvizon midis të tjerash, kërkon punë të dendur ideopolitike, e cila të zhvillohet vazhdimisht e me durim, në frymë shoqërore e pa teprime, por edhe pa bërë lëshime. Qëllimi i Partisë është që, duke flakur në zjarrin e revolucionit gjithçka regressive, të çlirohen shpirtërisht njerëzit, të mendojnë politikisht dhe të përkrahin e të bëjnë të vetën të renë përparimtare.

Kujdes i veçantë i kushtohet edukimit të brezit të ri e veçanërisht të studentëve. Në fjalën e mbajtur në takim me një grup aktivistësh, mësuesish e kuadrosh të rinisë, vihet në dukje se ky edukim realizohet me forcat e përbashkëta të shkollës, të mësuesve e të pedagogëve, të organizatave të rinisë, të institucioneve të shumta edukuese e kulturore, si dhe të mbarë shoqërisë.

Duke trajtuar gjerësisht probleme të fushave të ndryshme, zgjidhjen e të cilave nuk e koncepton të shkëputur nga puna e gjithanshme e organizatave-bazë të Partisë, autori, nëpërmjet shkrimeve, u rikujton ko-

munistëve të jenë kurdoherë në ballë, të zhvillojnë kritikën dhe autokritikën, të forcojnë frymën e partishe dhe kolegjalitetin. Një shembull të madh jep në këtë drejtim shoku Enver Hoxha sidomos gjatë vizitave në disa rrethe të Veriut. I ulur gju më gju me kuadrot e bazës, me punëtorë të veprave industriale e me malësorë të bjeshkëve të largëta, udhëheqësi i Partisë vlerëson traditat dhe përparimet e tyre, shkëmben mendime të vlefshme me ta, shpreh dashurinë dhe besimin e thellë te populli. Nga këto fjalime e biseda që përfshihen në vëllim, dalin mësimet të çmuara, si: vazhdimi i politikës së drejtë të Partisë për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e shoqëror të zonave malore, futja në çdo familje me një ritëm më të shpejtë e frymës proletare socialiste, skalitja e virtyeteve të larta të popullit, intensifikimi i përgatitjeve për mbrojtjen e atdheut etj.

Midis dokumenteve që botohen, janë edhe Tezat për Shkollën e Lirë Ushtarake, në të cilat zbërthehen mësimet e Leninit për armatosjen dhe për përgatitjen e të gjithë popullit për mbrojtje. Në këto Teza dhe në disa materiale të tjera të rëndësishme, që u vihen në dorë organizatave-bazë të Partisë, komandave, efektivave të ushtrisë, jepen mësimet të vyera për edukimin e vazhdueshëm të kuadrove e të mbarë popullit.

Në artikujt dhe në materiale të tjera, ku trajtohen probleme të zhvillimit botëror dhe të luftës kundër revizionizmit modern, ndërsa shtrohen si domosdoshmëri mprehja e vigjilencës dhe përgatitja ushtarake e njerëzve tanë, demaskohen e kundërshtohen me forcë vija agresive dhe ekspansioniste e imperialistëve

amerikanë dhe e krerëve të Kremlinit, aleanca e përbindshme sovjeto-amerikane, si rreziku më i madh për sigurimin ndërkombëtar. Autori i vëllimit ndalet veçanërisht dhe dënon vendimin dhëlpacak të social-imperialistëve sovjetikë për krijimin e «reparteve speciale ushtarake të përbashkëta», të përbëra nga kontingjente të ushtrive të vendeve pjesëmarrëse në Traktatin e Varshavës, për gjoja mbrojtjen kolektive të çështjes së socializmit. Analiza e qartë e fakteve nxjerr në shesh se qëllimi i grupimeve të tilla, si nga ana e revizionistëve sovjetikë, ashtu dhe e imperialistëve amerikanë dhe e partnerëve të tyre, është shuarja e flakëve të luftës për liri që zhvillojnë popujt paqdashës.

Duke ndjekur situatat konkrete ndërkombëtare, shoku Enver Hoxha thekson detyrën që njerëzit tanë të jetojnë me ngjarjet që zhvillohen në botë. Edhe një herë në këto dokumente shprehen politika e drejtë dhe parimore e Partisë dhe e shtetit, vullneti i mirë i tyre dhe i popullit tonë që në marrëdhëniet me shtetet fqinjë, e në një kuadër më të gjerë me vendet evropiane, të zotërojnë respekti reciprok dhe mirëkuptimi i vërtetë, pa ndryshuar bazat dhe parimet e politikës sonë.

Njohja me problemet e me mësimet që pasqyrohen në këtë vëllim të ri të Veprave të shokut Enver Hoxha, do t'u pasurojë përvojën njerëzve tanë, të cilët, të edukuar me teorinë dhe me praktikën revolucionare të Partisë, punojnë që të shënojnë arritje të reja, më të mëdha, në rrugën e socializmit.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



5 mars 1970<sup>1</sup>

Lenini thotë:

*«Do ta heqim përgjithnjë ushtrinë e përherëshme. Le të shkrihet ushtria me popullin e armatosur, le t'i japin ushtarët popullit njohuritë e tyre ushtarake, le të zhduket kazerma e të zëvendësohet me shkollën e lirë ushtarake. Asnjë forcë në botë nuk do të guxojë ta prekë Rusinë e lirë, në qoftë se mburojë e kësaj lirie do të bëhet populli i armatosur që ka*

---

1 Këto teza qysh atëherë iu dhanë për zbatim ish-ministrit të Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku. Ky, si armik i kamufluar që ishte, duke parë se ato pengonin realizimin e synimeve të padronëve të tij, i mbylli në kasafortë, nën pretekstin se «janë tepër sekret». Në fakt qëllimi i tij ishte të sabotonte vijën ushtarake të Partisë për zbatimin e mësimit leninist lidhur me armatosjen dhe përgatitjen ushtarake të popullit ushtar.

Pas zbulimit dhe demaskimit të veprimtarisë komplotiste e puçiste të armiqve B. Balluku, P. Dume e H. Çako, më 22 nëntor 1974, shoku Enver Hoxha dha porosi për shumëzimin e këtyre tezave, të cilat u botuan menjëherë për përdorim të brendshëm në Parti dhe në ushtri.

*zhdukur kastën ushtarake, që i ka bërë të gjithë ushtarët qytetarë dhe të gjithë qytetarët ushtarë, të aftë t'i përdorin armët»<sup>1</sup>.*

Më poshtë, po në këtë shkrim, Lenini thotë:

*«Le të ëndërrojë borgjezia hipokrite apo sentimentale për çarmatimin. Përderisa në botë ka të shtypur e të shfrytëzuar, ne duhet të kërkojmë jo çarmatimin, por armatimin e përgjithshëm të popullit. Vetëm ai do ta sigurojë plotësisht lirinë»<sup>2</sup>.*

Këto mësimë të Leninit duhet të na udhëheqin vazhdimisht në punën tonë me ushtrinë. T'i kemi parasysh këto parime të mëdha për të armatosur gjithë popullin, për të arritur në atë që thotë Lenini: «Çdo ushtar të jetë një qytetar dhe çdo qytetar një ushtar».

Gjendjen tonë ushtarake, format e edukimit të trupave dhe të kuadrove, kohën e shërbimit aktual të ushtrisë sonë, kohë që është gjykuar e mjaftueshme për stërvitjen e saj, pikëpamjen për të pasur ushtri të inkuadruar në reparte dhe në kazerma, qoftë edhe me efektiv të reduktuar, ne duhet t'i analizojmë dhe t'i konfrontojmë me parimet leniniste që përmenda më lart. Nga këto analiza duhet të nxjerrim konkluzione në përshtatje me ndërtimin e socializmit në vendin

1 V. I. Lenin, Veprat, vëll. 10, f. 48.

2 Po aty.



tonë, me gjendjen moralo-politike të popullit, me gjendjen ekonomike, me rrethanat politike të brendshme e të jashtme, me karakterin e relievit të republikës sonë që duhet të mbrojmë, me karakterin e luftës moderne që do të na bëjë armiku dhe me shumë faktorë të tjerë politiko-organizativë që rrjedhin nga gjithë këta faktorë, që ne duhet t'i konfrontojmë me parimet leniniste.

Po t'i studiojmë të gjitha rrethanat që përmenda më lart dhe duke ndjekur parimet leniniste, neve na vihet për detyrë e parë, kapitale, urgjente, të armatosim gjithë popullin, domethënë çdo qytetar të jetë njëkohësisht edhe ushtar. Të gjitha kushtet për t'ia arritur kësaj gjëje, në përgjithësi, janë krijuar nga diktatura e proletariatit.

Ne kemi bërë hapa në këtë drejtim, por janë hapa të parë, të pamjaftueshëm: ne kemi shpërndarë armë në popull, i kemi afruar depot e armëve te populli, e kemi të organizuar popullin në njësitë e ndryshme, kemi për të, për rezervistët dhe për paraushtarakët një plan stërvitjesh, kemi futur stërvitjen ushtarake në shkolla. Të gjithë këta hapa që kemi marrë janë në rrugën e drejtë leniniste, në rrugën e armatosjes së të gjithë popullit. Vetëm se këto masa ne duhet t'i harmonizojmë më mirë, t'i thellojmë, t'i zhvillojmë dhe t'i bëjmë plotësisht efektive, domethënë, të gjithë qytetarët dhe qytetarët të jenë edhe ushtarë të mirë, jo me kuptimin «ushtar i mirë pse u futa në kazermë».

E gjithë masa e madhe e popullit duhet të jetë plotësisht e përgatitur nga ana ushtarake, të jetë e armatosur me dituri ushtarake dhe me armë ushtarake.

Kjo përbën forcën vendimtare të Ushtrisë Popullore plotësisht, gjerësisht dhe thellësisht të përgatitur në mënyrë shumë serioze, pa qenë e nevojshme të jetojë në kazermë, pa shpenzime të mëdha, e inkuadruar në formacionet e caktuara të ushtrisë dhe përnjëherë e gatshme e me një shpejtësi të rrufeshme të zërë pozitave dhe të hapë zjarr në kohë krize, në kohën e mobilizimit të përgjithshëm dhe në kohë lufte.

Neve na vihet detyra operative që të mendojmë të gjithë për kohën e rrezikut, të cilin duhet ta përballojmë me forcat tona, në kushte shumë të vështira rrethimi dhe sulmi të shumanshëm. Prandaj duhet të jemi fort mirë të organizuar, shumë të shpejtë në çdo veprim, të patrembur dhe shumë të përgatitur për luftë. Gjithë këtë gjendje e krijon vetëm armatosja e popullit në kuptimin leninist që shtjellova më lart. Repartet e Ushtrisë Popullore, që do të plotësohen me ushtarë dhe me kuadro në kohë lufte, të mos jenë të plotësuara vetëm si numër, por me ushtarë dhe me kuadro plotësisht të përgatitur për luftë dhe për fitore. Këto reparte luftojnë në gjirin e një populli të tërë, ku i madh e i vogël është stërvitur me kohë për të qenë një ushtar i zoti dhe trim.

Po kush do ta mësojë gjithë këtë popull që të bëhet ushtar i tillë, siç thashë më lart? Ne na mundon e vjetra, na mendojnë pikëpamjet formaliste apo «klasike» për ushtrinë, eksperiencia e marrë nga ushtria sovjetike që nuk i ka pasë ndjekur si duhet edhe më parë parimet leniniste për ushtrinë, mundet që këtë e kanë penguar rrethanat dhe kushtet e një shteti të madh, por fakt është që aktualisht ushtria sovjetike,

kuadri i saj drejtues, kanë marrë trajta antimarksiste, puçiste, fashiste, agresive, pushtuese.

Ushtria jonë në vijën e saj politike, ushtarake, organizative, me gjithë ndikimin e ushtrisë sovjetike, ndoqi vazhdimisht rrugën leniniste. Prandaj ushtria dhe kuadrot tanë u shpëtuan nga çdo rrezik, në radhë të parë, nga qartësia politike e vijës së Partisë, e cila në kohën e duhur bëri disa korrigjime dhe kthesa në mënyrë fare të natyrshme dhe në rrugë të drejtë. Kjo ngjau pse kuadrot e ushtrisë sonë janë edukuar nga Partia me frymën e një partishmërie të lartë dhe po në një shkallë të lartë ata kanë edukimin tekniko-ushtarak.

Mirëpo çfarë gjë e vjetër na mundon ne? Lenini thotë: «Le të zhduket kazerma dhe të zëvendësohet me shkollën e lirë ushtarake». Në ç'rrethana e ka thënë Lenini këtë mendim të madh? Në qoftë se nuk gabohem, ai e shkroi me rastin e revoltës së komandës së anijes së luftës «Oçakov» në Sevastopol dhe me rastin e peticioneve të shumta të ushtarëve të reparteve të ndryshme të Petërburgut, ku bëheshin mizori të mëdha kundër ushtarëve. Kjo që shkroi<sup>1</sup> Lenini ndodhte më 1905. Por lufta e Leninit nuk drejtohej vetëm kundër kazermave cariste, ajo ishte perspektiva e ndritur e ushtrisë popullore që ai çelte.

Të gjithë, kur e studiojmë Leninin për këtë çështje, themi: «Kjo është e drejtë», por shumëkush tho-

---

<sup>1</sup> Është fjala për artikullin «Ushtria dhe revolucioni», shkruar në nëntor 1905. Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 10, f. 45-48.

të: «Po si do të bëhet ushtria pa kazerma?». Këtë përgjigje, e theksova më lart, e ka dhënë prapë Lenini.

Por Lenini kurdoherë nuk këshillon nxitimin dhe ecjen kuturu, por këshillon të reflektohet, të përgatiten kushtet dhe, kur të pihen këto, të veprohet. Dhe Partia jonë kështu ka vepruar kurdoherë. Të ngrihemi nesër në mëngjes dhe të marrim një vendim për të prishur kazermat, këtë s'na e lejon as Lenini, as leninizmi. Partia jonë nuk bie në të tilla gabime trashanike e të rrezikshme.

Disa mund ta kuptojnë thjesht aktin e prishjes së kazermave. Të mendosh kështu, do të thotë të mos thellohesh në kuptimin e madh politiko-ideologjik të problemit, do të thotë të mendosh vetëm anën organizative.

Po kemi hyrë ne në rrugën leniniste të prishjes së kazermave dhe të luftimit të frymës së kastës së oficerëve, siç thotë Lenini në citatin që përmenda që në fillim? Sigurisht kemi hyrë dhe thellë bile, nga ana politiko-ideologjike leniniste e problemit. Ana organizative është problem tjetër, i cili vendoset kur janë arritur kushtet, kur ekzistenca e kazermave është bërë pengesë dhe e panevojshme. Aktualisht kjo kohë nuk ka ardhur dhe ne do të bëjmë gabim dhe dëm, në rast se i futemi një aventure të tillë, pa krijuar kushtet.

Kazermat duhet t'i zëvendësosh, thotë Lenini, me Shkollën e Lirë Ushtarake. Pra, një nga detyrat kryesore që na vihet përpara është të forcojmë këtë Shkollë të Lirë Ushtarake, për të cilën fola më lart. Ç'duhet të kuptojmë ne me armatosjen e gjithë popullit, si

duhet të rforcojmë dhe të harmonizojmë më mirë masat që kemi marrë në këtë drejtim, të cilat unë i quaj të gjitha në kompleks, Shkolla e Lirë Ushtarake, që na këshillon Lenini? Kush do ta mësojë gjithë këtë popull të armatosur, në këto shkolla të lira ushtarake?

Edhe në këtë çështje na mendojnë disa pikëpamje të vjetra. A mendojmë ne plotësisht siç na mëson Lenini? Ç'na thotë Lenini? «Le t'i japin ushtarët popullit njohuritë e tyre ushtarake». Ne as nuk mendojmë drejt ta shfrytëzojmë kapacitetin e ushtarit dhe as e shfrytëzojmë në fakt. Që kur u krijua Ushtria jonë Popullore e deri tash, me dhjetëra e me dhjetëra mijë njerëz të mrekullueshëm kanë bërë shërbimin ushtarak... Leninizmi të gjithë këta i konsideron kuadro që duhet t'i mësojnë popullit artin ushtarak, kurse ne jo. Ata kanë titullin dhe detyrën e rezervistit dhe jo të kuadrit. Kuadër për ne në ushtri është ai që mbaron akademinë. As Lenini, as Partia jonë leniniste nuk janë kundër shkollave ushtarake, kundër perfeksionimit, sepse edhe shkolla, edhe perfeksionimi do të duhet të vazhdojnë kurdoherë.

Shokët e këtyre ushtarëve mësojnë jo tre vjet, por një vit o një vit e gjysmë zanat dhe i ngremë në kategori, kurse ushtarët që mbarojnë ushtrinë, i harrojmë, i lëmë ushtarë. Pra, duhet të kthehet rrota, ushtarët duhet të jenë mësuesit e kualifikuar në lëndë ushtarake për popullin e gjerë të armatosur. Do të duhet kualifikimi i mëtejshëm për ta? Ta organizojmë! Por, po të rrimë të presim sa të dalin kuadrot nga shkollat dhe nga akademia, nuk do ta plotësojmë de-

tyrën leniniste për ushtrinë e gjerë popullore. Për të bërë Luftën Nacionalçlirimtare kuadrot tanë nuk kishte dalë nga akademitë ushtarake, megjithatë nuk luftuan keq. Njerëzit e sotëm dhe njohuritë e tyre ushtarake as mund të krahasohen me ato tonat të fillimit të luftës. Duke luftuar, mësuam si të luftohej dhe si duhej luftuar më mirë. Kurse të rinjtë e sotëm që bëjnë ushtrinë, këtë e kanë shkollë që neve na kishte munguar.

Si jemi futur ne në rrugën e prishjes së kazerma-ve? Nga fakti se ushtria jonë ishte një ushtri revolucionare, e dalë në luftë dhe që luftoi heroikisht nën udhëheqjen e Partisë Komuniste. Ajo ishte me karakter krejt popullor, e përbërë nga punëtorë dhe fshatarë revolucionarë. Kuadrot e saj ishin po të tillë, të sprovuar në luftëra, të thjeshtë dhe besnikë deri në vdekje të kauzës së popullit dhe të socializmit. Kjo ushtri popullore që mundi okupatorët, shpartalloi përfundimisht klasat shfrytëzuese feudo-borgjeze dhe vendosi pushtetin e popullit, diktaturën e proletariatit, s'mund të pranonte kurrsesi as artin ushtarak borgjez, as ligjet e tij. Në radhë të parë, ushtria jonë ishte një ushtri politike e jo apolitike dhe politika e saj ishte politika e Partisë. Kjo politikë proletare e Partisë edukonte ushtrinë si një armë të rëndësishme të diktaturës së proletariatit për të shtypur çdo rezistencë të klasave armike të mundura, për të mbrojtur fitoret e revolucionit, për të mbrojtur lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut të fituar me gjak e me sakrificë, për t'i mbrojtur këta nga çdo rrezik eventual që mund t'i turrej popullit që ndërtonte socializmin, qof-

të nga brenda, qoftë nga jashtë. Pra Ushtria jonë Popullore ishte ushtri e klasës punëtore dhe e fshatarësisë punonjëse, ajo ishte me tendenca klasore dhe frymëzohej nga ideologjia e klasës.

Brendia, pra, e gjithë edukimit të saj politik, ideologjik, ushtarak ishte dhe mbetet ideologjia marksiste-leniniste dhe në kundërshtim flagrant me edukimin dhe artin borgjez ushtarak. Kjo është kryesorja dhe kjo rrugë ishte në luftë të hapët me shpirtin, me edukimin, me frymën dhe me qëllimet politiko-ushtarake të ushtrive borgjeze të kazermave, të kastave të oficerëve, të mishit për top, të shpirtit mercenar imperialist, shtypës të popujve dhe të revolucionarëve. Pra, Partia që në fillim iu fut punës, si në çdo sektor tjetër ku ndërtohej socializmi, edhe në ushtri dhe po shkallmonte që nga themelet rrugën e vjetër të ushtrive të kazermave e të ligjeve të tyre shtypëse, për të ndërtuar një Ushtri të re Popullore.

Organizimi i ushtrisë nga një ushtri me karakter partizan, por që gjatë luftës mori format organizative të një ushtrie të madhe dhe të rregullt, pas Çlirimit e këndej kaloi në shumë faza organizimi të një ushtrie moderne, që i lypnin ndryshimet e mëdha shoqërore, politike, ekonomike dhe shtetërore që erdhën si rezultat i fitores së luftës e të revolucionit. Këto transformime organizative iu përshtatën kohës, realitetit konkret të gjendjes e të momenteve, kushteve materiale dhe armatimeve që dispononim, iu përshtatën nivelit të masës së ushtarëve dhe të kuadrove.

Disa forma organizative në pamje mund të kishin ngjashmëri me forma organizative të ushtrive borgje-

ze, deri edhe te grumbullimi në kazerma. Kjo nuk e ndryshon karakterin kryekëput antagonist të ushtrisë sonë me ushtritë borgjeze edhe në lëmin organizativ. Edhe Ushtria jonë Popullore nuk mund të quhet ushtri, pa qenë e organizuar në reparte të vogla e të mëdha, pa pasur komandantët, komisarët e shtabet e saj, pa pasur të gjitha llojet e armëve që i lyphen një ushtrie moderne, pa pasur prapavijat e saj të organizuara etj., etj. Të gjitha këto ajo duhet t'i ketë, bile shumë më mirë të organizuara sesa një ushtri borgjeze mirë e organizuar. Këtë përsosmëri dhe forcë në organizim nuk e krijojnë as karakteri i përhershëm (permanent, siç thotë Lenini), as kasta e oficerëve, as jeta e egër e kazermës e ushtrisë borgjeze, por e krijon ndërgjegjja e lartë e detyrës së ushtarit dhe e kuadrit, e krijon pikëpamja politiko-ideologjike e tyre, e krijon qëllimi i lartë i ndërtimit të socializmit dhe i mbrojtjes së fitoreve të popullit. Pra, edhe format organizative, të ngjashme në dukje në mes dy ushtrive kundërshtarë, tonës dhe asaj borgjeze, kanë ndryshim të madh, të para dhe të analizuara këto në prizmin politiko-ideologjik marksist-leninist.

Të marrim çështjen e kazermave. Në dukje kjo ngjet njësoj si në ushtrinë tonë, ashtu edhe në ushtrinë borgjeze. Edhe te ne, edhe tek ata, ushtria rri në kazerma. Kjo kështu është, te ne edhe për një kohë do të ekzistojnë kazermat për ushtrinë: se sa do të vazhdojë, këtë do ta përcaktojnë faktorët dhe përgatitja graduale e kushteve. Dhe nuk jemi jashtë orientimit leninist për këtë çështje, ne ecim të matur në rrugën e Leninit. Por ushtria borgjeze, nga vetë karakteri



i saj antipopullor, nuk mund të dalë kurrë nga kazerma dhe nga shpirti i kazermës, ndryshe ajo shkoqet, dobësohet më keq se ç'është e dobët, bëhet inekzistente.

Ushtria jonë Popullore nuk është e tëra në kazerma, atje rron dhe mëson një pjesë e vogël e saj. Kjo kazermë ruan emrin kazermë, por ajo është një shkollë dhe një shkollë me përpjesëtime shumë të vogla, në qoftë se e krahasojmë me shkollat për rininë dhe me numrin e të gjithë atyre që duhet të jenë qytetarë ushtarë.

Po pse kemi arritur ne në një formë organizimi të tillë të përshtatshme dhe të drejtë të ushtrisë sonë për këto momente? Sepse mbajtja e një ushtrie të madhe i kushton shumë ekonomisë së atdheut. Kjo është një arsye e madhe, por nuk është e vetmja arsye e madhe. Arsyëja e dytë e madhe kryesore është se Partia dhe socializmi, në terren dhe në ushtri, kanë krijuar një gjendje të atillë të lartë moralo-politike dhe një forcë organizimi dhe edukimi që ne të fillojmë të dalim nga kazermat dhe për këtë qëllim kemi gjetur format dhe mënyrat, të cilat duhet t'i thellojmë akoma dhe t'i perfeksionojmë për të edukuar, për të stërvitur dhe për të organizuar në mënyrë të lartë e të përsosur jashtë kazermave, pa pasur nevojë të vijë në kazerma pjesa më e madhe e ushtrisë sonë, domethënë gjithë populli, të cilin duhet ta bëjmë ushtar të mirë.

Prandaj ne kemi një pjesë të ushtrisë që stërvitet dhe duhet të vazhdojë të stërvitet në kazermë, që ka atë karakter që shpjegova më lart, karakterin e një shkolle, por ne kemi shkollë edhe pjesën dërrmuese

të ushtrisë që është jashtë kazermave, që duhet ta përgatitim po me aq kujdes, bile edhe më mirë (edhe më shpejt se ç'bëjmë tani), në Shkollën e Lirë Ushtarake, që na mëson Lenini.

Është, pra, e kuptueshme që ne duhet t'i vihemi një pune shumë të madhe, të thellë e të studiuar mirë: organizimit të kësaj shkolle leniniste, e cila duhet të synojë jo vetëm t'u mësojë njerëzve thjesht se si qëllohet me pushkë, por çdo gjë që duhet të dinë ushtari, komandanti, komisari, të inkuadruar në reparte të rregullta, të cilët të zbatojnë detyrat në çdo moment me tempin dhe me normat ushtarake.

Ushtria që ne tash e quajmë rezervë, duhet kthyer në ushtri aktive, pjesëtarët e së cilës njëkohësisht punojnë si qytetarë, dhe janë të gatshëm e të përgatitur edhe si ushtarë.

Por një organizim i tillë i përsosur do të thithë edhe kontingjentet e atyre vërsave që vijnë të bëjnë shërbimin në ushtri, siç vijnë sot. Sot të gjithë ata që bëjnë paraushtarë, vijnë dhe bëjnë ushtrinë në kazerma. Po ta rregullojmë dhe ta organizojmë si duhet, ashtu siç bëhet për shkollarë që ndjekin universitetin dhe njëkohësisht bëjnë edhe stërvitjen ushtarake dhe në mbarim, pas një kursi të shkurtër, dalin oficerë të rezervës, ashtu duhet vepruar edhe me paraushtarët pa ndërprerje. Këta mund të vazhdojnë shërbimin ushtarak jashtë kazermës në Shkollën e Lirë Ushtarake. Kjo Shkollë e Lirë Ushtarake s'do të thotë të jetë shkollë diletante, por me tërë kuptimin e fjalës ushtarake, me disiplinë proletare, me ndërgjegje të lartë politiko-ideologjike, e organizuar në njësitë ush-

tarake në mënyrë të atillë që t'i përgjigjet organizimit të ushtrisë dhe ku të mësohen të gjitha armët dhe praktikat që i janë të domosdoshme repartit. Repartet të organizohen në një mënyrë të atillë që t'i kryejnë të gjitha programet e caktuara për ushtrinë dhe në çfarëdo kohe të bëhen lidhja, koordinimi, krijimi e përqendrimi në një kohë rekord, në reparte të mëdha gati për luftë.

I gjithë ky problem është çështje studimi më të thellë dhe organizimi.

Por edhe kur ne ta kemi çdo gjë të përsosur në rrugën që na tregon Lenini, përsëri do të ruajmë një pjesë të kazermave për armë speciale, edukimi i trupave të të cilave s'mund të bëhet pa qenë të grumbulluar në mënyrë të vazhdueshme, pse edhe natyra e punës dhe e detyrës së tyre kanë këtë karakter.

Të gjitha këto bëjnë pjesë në procesin e vazhdueshëm të modernizimit dhe të kalitjes së vazhdueshme të Ushtrisë sonë Popullore. Në këtë proces sa të rëndësishëm, aq edhe delikat, asgjë nuk duhet bërë pa studiuar, e shpejtuar, asgjë nuk duhet neglizhuar dhe nuk duhet lënë në harresë ose të ecë në mënyrë rutinë dhe burokratike. Duhet me pasë kurdoherë parasysh që ushtria në çdo moment të jetë në gatishmëri të plotë dhe jo përherë në «riorganizim», as në çrregullim. Çdo përmirësim cilësor duhet t'i mbajë parasysh këto gjëra të domosdoshme. Këtu hyn çështja e përgatitjes së hollësishme, e krijimit të situatave të përshtatshme, e marrjes së masave paraprake dhe po ta lypë nevoja për ndonjë riorganizim të pjesshëm ose

gradual, ai të bëhet i rrufeshëm, që të mos vuajë për asnjë çast gatishmëria e plotë e ushtrisë.

Duhet kuptuar thellë politikisht dhe ideologjikisht ky zhvillim cilësor i ushtrisë, perspektiva e këtij zhvillimi, që të mund të përcaktohen përafërsisht, në mënyrë të drejtë dhe pa u gabuar, edhe etapat e këtij zhvillimi dhe në çdo etapë të përcaktohet në cilat pjesë të saj duhen zbatuar këto ose ato veprime, nga duhet filluar ndryshimi i pjesshëm, për të mos u prishur gatishmëria, për të arritur në zhvillimin e plotë cilësor që kërkojnë orientimi dhe etapa e caktuar.

Rruga që ka ndjekur Partia për organizimin dhe për edukimin e Ushtrisë Popullore është një shembull i qartë i përdorimit dhe i zbatimit në mënyrë të drejtë e të balancuar të këtyre parimeve leniniste që numërova më lart.

Të marrim efektin e punës ideopolitike që ka bërë Partia në ushtri që nga krijimi i saj. Kjo ka qenë detyra numër një, detyrë *sine qua non* për mbarëvajtjen e çdo gjëje në ushtri. Kjo punë vajti kreshendo, duke u përmirësuar dhe kështu duhet të vazhdojë edhe pas-këtaj. Asaj i detyrohen gjithë këto ndryshime cilësore të ushtrisë. Neve na kujtohet sa thyerje disiplinore bëheshin nga ana e ushtarëve dhe e kuadrove; ne nuk kishim grada në ushtri, i vumë pse e gjykuam se në ato momente ishin të nevojshme, por ato, megjithëse kuadrot tanë ishin të sprovuar në luftë, djem të shtresave të varfra, krijuan në ta ndjenjën e epërsisë, krijuan njëfarë distance të rrezikshme në mes kuadrove dhe trupës, ndër disa u zhvillua tok me gradën edhe ndjenja e arrogancës ndaj vartësve dhe ushtarëve.

Neve na kujtohen dënimet që jepeshin në kazerma, kishte atje edhe burgje për ushtarët. Kishte edhe raste që oficeri ngrinte dorën kundër ushtarit ose e përdorte ushtarin t'i pastronte çizmet etj. Ç'ishin të gjitha këto? Mbeturina të ushtrisë borgjeze, mbeturina mikroborgjeze që shfaqeshin në njerëzit dhe këto shumë herë arsyetoheshin si pa të keq edhe politikisht, se gjoja pa to nuk mund të kishte ushtri të rregullt, nuk mund të kishte komandë, nuk mund të kishte disiplinë ushtarake. Mirëpo puna këmbëngulëse e Partisë i edukoi njerëzit, i sqaroi, u luftoi atyre «shpirtin e vjetër të kazermës së ushtrisë borgjeze», i afroi dhe i lidhi ngushtë ushtarët me kuadrot, këtyre u hoqi gradat, veprim ky me shumë rëndësi që ushtria jonë, kuadrot dhe populli e brohoritën. Disa, megjithëse e pranuan, në fillim nuk ishin shumë të bindur në veten e tyre, nuk mund të arrinin të kuptonin oficer pa grada. Por jeta, puna dhe sidomos politika e drejtë e Partisë i bindi. Me gjithë këto përparime, janë zhdukur vallë të gjitha mbeturinat mikroborgjeze në ushtri? Jo! Kjo kërkon një luftë të vazhdueshme e të gjatë.

Po kështu do të ketë shokë që nuk do të realizojnë menjëherë idenë e madhe të Leninit, kur thotë «Të prishim kazermat». Ata, menjëherë, pa u thelluar, do të thonë: «A mund të ketë ushtri pa kazerma?», ashtu siç nuk kuptuan se mund të kishte oficerë pa grada.

Ose mund të ketë oficerë që, pa u thelluar, mund të thonë: «Si mundet që stërvitjen që bëjmë në një kohë shumë më të shkurtër ta bëjmë në Shkollën e Lirë Ushtarake?».

Por të gjitha këto shpjegohen, sqarohen. Dhe kur çdo gjë është e qartë politikisht e ideologjikisht, kur studiohet imtësisht ana teknike dhe organizative e problemit dhe kur ky problem studiohet në mënyrë të koordinuar me të gjitha problemet e tjera të brendshme të sektorit dhe me problemet shtetërore në kuadrin e gjithë politikës së brendshme e të jashtme të shtetit tonë dhe të koniunkturave ndërkombëtare, të gjitha problemet zgjidhen drejt në interes të socializmit, në rrugën marksiste-leniniste të Partisë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Për Ushtrinë Popullore (Përmbledhje veprash)», vëll. II, f. 9. Tiranë, 1984*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Për Ushtrinë Popullore (Përmbledhje veprash)», vëll. II, f. 9. Tiranë, 1984*

## NJË HAP TJETËR I REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NË RRUGËN E AVENTURAVE USHTARAKE

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

6 mars 1970

Ka mjaft kohë që në faqet e shtypit të huaj janë dukur lajme që bënin të ditur se krerët revizionistë sovjetikë dhe partnerët e tyre të Traktatit të Varshavës kanë marrë vendimin për krijimin e «reparteve speciale ushtarake të përbashkëta», të përbëra nga kontingjente të veçuara nga ushtritë kombëtare të vendeve pjesëmarrëse dhe të vëna nën një komandë unike. Këto të dhëna nxirren edhe nga artikulli i gjeneralarmate Shtemenko, shef i shtabit të komandës së Traktatit të Varshavës, botuar më 24 janar në gazetën «Krasnaja zvezda», dhe nga ai i mareshalit Greçko, ministër i Mbrojtjes i Bashkimit Sovjetik, botuar në revistën sovjetike «Komunist» të muajit shkurt.

Bëhet pyetja: Cili është karakteri i këtyre legjioneve të reja revizioniste dhe cilës çështje do t'i shërbejnë ato? Përrallat që përhapin mareshalët moskovitë se gjoja kanë për qëllim «mbrojtjen kolektive të çështjes së socializmit» nuk bindin njeri. Përgjigjja du-

het kërkuar në gjendjen ushtarako-politike të kampit revizionist dhe në vetë vijën agresive e ekspansioniste të revizionistëve sovjetikë, në garën për bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në kontradiktat me to.

Prej kohësh, dhe kjo tanimë nuk është sekret për asnjë, në kampin e Traktatit të Varshavës nuk ekziston kurrfarë uniteti midis partnerëve, si për qëllimet e përgjithshme politike, ashtu edhe për strategjinë ushtarake të këtij blloku. Mosmarrëveshje të mëdha ekzistojnë, sidomos, në lidhje me koordinimin e veprimtarive konkrete të ushtrive kombëtare me njëra-tjetrën dhe në raport me atë sovjetike, për mënyrat e funksionimit, për të drejtat dhe detyrat e komandës së Traktatit në kohë paqeje e lufte etj.

Në mënyrë të veçantë kontradiktat thellohen dhe palët ndahen kur vjen çështja e përcaktimit të drejtmeve të politikës ushtarake të Traktatit të Varshavës lidhur me situatat dhe me koniunkturat konkrete ndërkombëtare që krijohen në botë, për të cilat jo të gjithë janë të interesuar në të njëjtën masë. Ashtu siç veprojnë edhe imperialistët amerikanë me aleatët e tyre të Evropës, por sidomos me ata të Azisë, sundimtarët e Moskës kërkojnë nënshtrimin e plotë dhe vënien në dispozicionin e tyre të ushtrive të vendeve të Traktatit të Varshavës, kthimin e këtyre në mercenare, në «legjione të huaja» dhe në vegla të bindura për zbatimin e planeve të tyre të ardhshme agresive. Kjo nuk mund të mos shkaktojë shqetësime serioze te satelitët e Kremlinit.

Tani, me dashjen ose pa dashjen e tyre, përpara



vendeve satelite të Traktatit të Varshavës në mënyrë drakoniane shtrohet problemi i caktimit të kufijve gjeografiko-ushtarakë të Traktatit; do të mbeten këto në Evropë, apo do të shtrihen në Lindje, kundër kujt duhet drejtuar tehu, nga kush do të mbrohen etj. Në pikën më kritike ka arritur çështja nëse do të ekzistojë ose jo sovraniteti i plotë i shtetit të pavarur mbi ushtrinë e vet kombëtare, apo ai do të sakrifikohet në altarin e interesave egoistë e imperialistë të krerëve revizionistë sovjetikë, do të ekzistojë apo jo e drejta sovrane e secilit shtet për të vendosur vetë dhe në mënyrë të pavarur për fatet e paqes e të luftës, apo ajo do të humbasë dhe do të shkojë në favor të një organizmi superkombëtar, sustat dhe levat e manovrimit të të cilit do të ndodhen në Moskë.

Probleme jo të vogla kanë lindur në lidhje me çështjen e shpenzimeve ushtarake, të armatimeve, për atë se kush duhet t'i paguajë paratë për intensifikimin e veprimtarisë ushtarake të Traktatit të Varshavës që dalin jashtë kuadrit të nevojave të secilit vend dhe janë mbi mundësitë reale të tij. Por mbi të gjitha, për tërë vendet e vogla të Traktatit të Varshavës, të sunduara nga revizionistët sovjetikë, qëndron frika e lidhjes automatike me aventurat ushtarake të krerëve të Kremlinit, gjë që do të kishte pasoja katastrofike për ta. Ngurrimet që u vunë re në prag të agresionit kundër Çekoslovakisë midis atyre vendeve që u bashkuan me revizionistët sovjetikë, janë një shembull i qartë.

Fakt është se në vendet revizioniste rezistencat nacionaliste të klikave në fuqi ndaj hegjemonisë dhe politikës së presioneve të Moskës nuk vijnë aspak duke

u pakësuar. Bile ato, edhe si rezultat i politikës së përçarjes e dezintegrimit nga brenda që SHBA dhe fuqitë e tjera perëndimore ndjekin ndaj Evropës Lindore revizioniste, shtohen edhe më tepër. Flirtet që mjaft vende të Traktatit të Varshavës po bëjnë kohët e fundit me Gjermaninë Perëndimore, me Francën etj., sigurisht nuk janë në dobi të sundimit absolut të Moskës mbi to.

Megjithëse revizionistët sovjetikë kanë bërë dhe po bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme për ta paraqitur çështjen sikur në agresionin kundër Çekosllovakisë të gjitha ushtritë e Traktatit të Varshavës ishin me ta, realiteti është krejt ndryshe. Është e vërtetë, për shembull, që ushtria çekosllovake nuk zbrazti asnjë fishek për të mbrojtur atdheun e saj, por është po aq e vërtetë se ajo nuk e fshehu armiqësinë për pushtuesit e rinj. Gjithashtu, ajo nuk i dëgjoi thirrjet e agjentëve të klikës së Brezhnjev-Kosiginit për të marshuar së bashku me tanket sovjetike kundër popullit të saj. U vërtetua, kështu, se jo vetëm në potencë, por edhe efektivisht ushtria çekosllovake nuk ishte, në momentin më kritik për revizionistët sovjetikë, një vegël e bindur dhe e nënshtruar e tyre. Për çfarë më tepër mund të shpresojnë ata në të ardhmen?

Eksperienca e pushtimit të Çekosllovakisë ishte shumë e hidhur për revizionistët sovjetikë. Ata vendosën kontrollin ushtarak mbi Çekosllovakinë edhe me ndihmën e satelitëve. Por të tjerët shkuan të pabindur dhe me gjysmë zemre. E gjithë balta që ngriti ky agresion barbar, ra mbi revizionistët sovjetikë. Ata mbetën të turpëruar e të damkosur në sytë e botës. Ush-

tritë e katër vendeve të tjera që, së bashku me atë sovjetike, morën pjesë në agresionin kundër Çekoslovakisë, më parë u larguan sesa hynë atje. S'ka asnjë dyshim se revizionistët sovjetikë, për qëllime politike, propagandistike etj., nuk do të donin të mbeteshin vetëm «për të ndihmuar» popullin çekoslovak.

Tani jo vetëm në planin politik e ekonomik, por edhe në atë ushtarak revizionistët sovjetikë kërkojnë një bindje dhe nënshtrim të plotë nga ana e satelitëve. Duke vendosur një integrim të plotë të ushtrive dhe të politikës ushtarake, ata duan të nënshtrojnë e të integrojnë tërësisht edhe partitë revizioniste e shtetet anëtare të Traktatit të Varshavës. Për arritjen e këtij objektivi revizionistët sovjetikë ka kohë që punojnë me një zell të jashtëzakonshëm. Në forma të tjera politike, e sidomos ekonomike, ata janë munduar t'i vënë partnerët nën kontrollin e hekurt të tyre, po për shkak të kontradiktave dhe të rezistencave të ndryshme, kësaj nuk ia arritën dot. Midis revizionistëve as ka pasur, as do të ketë kurrë unitet. Sa më shumë shtohen presionet hegjemoniste të Moskës, sa më të mëdha bëhen pangopësia dhe përpjekjet për të gllabëruar krejtësisht vendet që i janë nënshtruar asaj, aq më shumë shtohen edhe tendencat centrifugale në anën tjetër, aq më shumë rriten përpjekjet e hapëta e të fshehta të vendeve satelite për ta lehtësuar veten nga zgjedha e rëndë e revizionistëve sovjetikë, aq më të mëdha e më të rafinuara bëhen manovrat, në mos për t'i anuluar përfundimisht, të paktën për t'i shtyrë e për t'i zvarritur sa më gjatë kërkesat e sundimtarëve të Kremlinit.

Në këtë situatë të paqëndrueshme dhe të kalbur që mbretëron në kampin revizionist të Traktatit të Varshavës, për t'i nënshtruar partnerët e tjerë, revizionistët sovjetikë kërkojnë metoda të tjera, më efikase dhe definitive. Ata mendojnë se objektivin do ta arrijnë më shpejt dhe qëllimet e tyre do të plotësohen më mirë duke filluar me organizimin e njësive e të «reparteve speciale ushtarake të përbashkëta», si hap i parë drejt integritit të plotë të ushtrive kombëtare, dhe kthimin e tyre në një armatë të zakonshme sovjetike nën drejtimin dhe urdhrat e mareshalëve të Bashkimit Sovjetik.

Jo vetëm nga eksperiencia e aventurës çekoslovakë, por edhe nga mjaft shfaqje të tjera rezulton se ushtritë e Traktatit të Varshavës për revizionistët sovjetikë nuk janë plotësisht të sigurta. Ato nuk u binden mekanikisht urdhrave të udhëheqjes së Moskës. Shqetësimet dhe frika për pasojat katastrofike që do lën haptazi në vendet revizioniste të lidhura pas qerres së Bashkimit Sovjetik në kohën e provokacioneve antikineze të klikës sunduese sovjetike në Usuri, e vërtetojnë edhe më mirë këtë situatë.

Me krijimin e trupave të posaçme revizionistët sovjetikë kërkojnë t'i bëjnë partnerët e tjerë të Traktatit të Varshavës më të disiplinuar dhe më të manipulueshëm, që të mos u ndodhin gjëra të tilla «të papëlqyeshme» në të ardhmen.

Por është e kuptueshme se me kaq revizionistët sovjetikë nuk mund të kënaqen. Shpresat që ata mbështetin në legjionet e huaja, shkojnë shumë më larg. Në radhë të parë këto forca të reja speciale të shkom-

bëtarizuara do të përbëjnë një mjet goditës të egër dhe të pamëshirshëm për të ndërhyrë brutalisht dhe me dhunë në vendet e Traktatit të Varshavës, për të shtypur çdo orvatje revolte kundër klikave sunduese në fuqi ose ndaj sundimit të revizionistëve sovjetikë. Duke mos pasur një flamur kombëtar të caktuar dhe të maskuara prapa parullash demagogjike të «mbrojtjes së çështjes së socializmit», të «mbrojtjes së revolucionit socialist dhe të fitoreve socialiste» etj., ato janë thirrur të legalizojnë ndërhyrjen dhe agresionin e revizionistëve sovjetikë. Krijimi i tyre shënon në vetvete një nga aspektet praktike të vënies në jetë të teorisë famëkeqe brezhnjeviane të «sovranitetit të kufizuar» dhe të së drejtës që patriarkët revizionistë të Moskës kërkojnë t'i rezervojnë vetes për të caktuar se ku «revolucionin është në rrezik» dhe ata duhet të ndërhyjnë, se «kush tradhton socializmin» dhe ata duhet ta zhdukin.

Një objekt tjetër që revizionistët sovjetikë duan të arrijnë me krijimin e forcave ushtarake speciale, është ai që, me anën e tyre, ose nën emrin e tyre, të kamuflojnë qëndrimin e gjatë dhe të urrejtshëm të trupave të veta të pushtimit në vendet revizioniste. Ata shpresojnë se duke i veshur ato me uniformën e një ushtrie superkombëtare, që «është e të gjithëve», dhe që, për pasojë, duhet të dislokohet në të gjitha vendet, do të justifikojnë praninë e përhershme të xhandarmërisë së tyre ndërkombëtare, do të fitojnë «argumente» për të luftuar mungesën e popullaritetit dhe presionet e gjithanshme për tërheqjen e tyre dhe, më në fund, do t'i tregojnë botës se në vendet e Ev-

ropës Lindore nuk ka më trupa sovjetike, ato janë «të lira» etj.

Nuk mund të mos vihet re se krijimi i reparteve dhe i njësive speciale ndërkombëtare revizioniste është i lidhur jo vetëm me gjendjen e brendshme të Traktatit të Varshavës dhe me marrëdhëniet midis revizionistëve sovjetikë, nga njëra anë, dhe partnerëve të tyre, nga ana tjetër, por edhe me tërë politikën hegjemoniste dhe me planet e aventurave të reja agresive që hartojnë shtabet ushtarake në Kremlin. Në mënyrë të veçantë kjo masë e re ushtarake e konfirmon edhe më tepër qëllimin e revizionistëve sovjetikë për të ndërhyrë me forcë edhe në vende të tjera të Evropës, sidomos në Rumani, në Jugosllavi e në Shqipëri.

Këto synime nuk mund të maskohen, ashtu siç vepronjë krerët e Kremlinit, duke evokuar «miqësitë e vjetra», qofshin këto edhe tradicionale, as me parullat demagogjike «internacionaliste», prapa të cilave fshihen shovinizmi rusomadh, lidhjet e vjetra të carëve rusë me carët e vendeve të tjera. Pikërisht te shovinizmi i vjetër i carëve të vendeve të tjera mbështetet invazioni i mundshëm i revizionistëve sovjetikë. Prandaj ky shovinizëm duhet shpartalluar, sepse përbën një rrezik shumë të madh.

Ne shqiptarët i kemi kaluar periudhat e hipokrizisë e të pabesisë së revizionistëve sovjetikë, që na hiqeshin si miq e dashamirë, por që mbanin thikën të fshehur për të na nënshtruar ekonomikisht e politikisht dhe për të na shtypur ushtarakisht.

Populli ynë e kupton, gjithashtu, të drejtën e po-

pujve të Jugosllavisë për të mbrojtur atdheun e vet nga çdo kërcënim e sulm.

Rreziku i një agresioni të pabesë imperialist, qoftë ky nga ana e imperializmit amerikan apo sovjetik, nuk mund të injorohet. Në çdo vend të kërcënuar nga ky agresion ekzistojnë faktorët e një mobilizimi total të energjive të shëndosha të popullit për t'u bërë ballë armiqve. Por, që të arrihet sukcesi, përgatitjet për mbrojtjen e vendit duhen bërë me tërë seriozitetin e duhur, duke rritur vigjilencën si jashtë, ashtu edhe brenda, duke i lidhur rininë dhe gjithë masat punonjëse me fatet e lirisë e të popullit. Përpara rrezikut të agresionit të huaj është e nevojshme t'u pritët rruga agjenturave që kërkon të krijojë armiku dhe të dallohen mirë ata që janë me të vërtetë për mbrojtjen e pavarësisë e të sovranitetit kundër pushtuesit nga ata që përgatitin buqetat e luleve për të e që në mënyrë false cilësohen si informbyroistë ose neostalinistë. Këta s'janë të tillë, sepse padroni që i udhëheq, revizionizmi sovjetik, është antiinformbyroist dhe antistalinist i tërbuar.

Në shtypin e huaj janë botuar shpesh lajme, të cilat zhvillimi i ngjarjeve i ka vërtetuar, se një nga objektivat e shumtë të krerëve revizionistë sovjetikë në krijimin e njësave të posaçme ndërkombëtare ka qenë synimi për t'i përdorur ato si forca simbolike ose si fillim të angazhimit të atyre vendeve që do të vënë në dispozicion të tyre repartet ushtarake në ndonjë konflikt të ardhshëm. Natyrisht, po të fillojë një konflikt, këto forca do të shtohen.

Duket qartë se revizionistët sovjetikë, megjithëse

me fjalë thonë se marrin masa mbrojtëse kundër imperializmit, në të vërtetë forcat speciale duan t'i përdorin si ushtri kundërrevolucionare për të goditur shtetet socialiste dhe për të shtypur revolucionin në botë.

Në këtë rrugë ata ndjekin strategjinë e imperialistëve anglezë e francezë, të cilët, duke dërguar në Rusinë sovjetike repartet e famshme të ekspedicionit intervencionist, të përbëra nga anglezë, francezë, polakë, çekë, japonezë, amerikanë e të tjerë, së bashku me ushtritë bjellogardiste, u përpoqën të mbytnin Revolucionin e Tetorit dhe shtetin sovjetik. Tani revizionistët sovjetikë, duke krijuar brigadat ndërkombëtare mercenare, përpiqen të përsëritin historinë.

Revizionistët sovjetikë duan t'i shndërrojnë vendet e Traktatit të Varshavës në burime nga ku të nxjerrin mish për top për agresionet që ata planifikojnë. Kështu kanë vepruar agresorët e të gjitha kohëve. Për të mos u futur thellë në histori, mjafton të përmendim Hitlerin, i cili pati krijuar kudo nga vendet e pushtuara njësi të tilla mercenarësh, për të realizuar qëllimet e tij ekspansioniste. Se ç'fat pësuan këta mercenarë dhe vetë Hitleri, këtë e dinë të gjithë. Le ta kenë parasysh edhe krerët revizionistë sovjetikë, që kërkojnë tani të ndjekin gjurmët e tij.

Krijimi i legjioneve mercenare është hapi i parë për degjenerimin në tërësi të ushtrive kombëtare të Traktatit të Varshavës në ushtri mercenare të Bashkimit Sovjetik. Këtë objektiv krerët revizionistë sovjetikë kanë filluar ta zbatojnë në praktikë, duke degjeneruar, në radhë të parë, shtabet dhe komandat e tyre nga shkallët më të larta e deri në më të ulëta. Ata



përpiqen tani të kenë kudo njerëzit e vet, të zënë pozita kyç, për të mundur pastaj që të gjithë efektivat t'i vënë në shërbim të tyre.

I gjithë ky proces kundërrevolucionar antimarksisht e antileninist dëshmon për planet e errëta të revizionistëve sovjetikë, të cilët duan të likuidojnë përfundimisht edhe shenjën më të vogël të sovranitetit në vendet ku sundojnë. Ata dëshirojnë kthimin e këtyre në koloni të thjeshta të tipit të Çekoslovakisë, ku arbitrariteti i tyre nuk njihet kufi, ku nderi dhe dinjiteti i popullit merren nëpër këmbë dhe ku i vetmi zë që dëgjohet është ai i kuislingëve që mburrin pushtuesit dhe lavdërojnë tradhtinë.

Krijimi i këtyre forcave mercenare s'ka asnjë bazë parimore, asnjë fije internacionalizmi, asnjë frymë të solidaritetit ndërkombëtar, por është një shqelmime brutal i sovranitetit, i lirisë e i pavarësisë së vendeve të Traktatit të Varshavës. Revizionistët sovjetikë nisen jo nga barazia sovraane, por nga mosbesimi ndaj partnerëve dhe nga pabesia ndaj tyre.

Ushtria kombëtare e çdo vendi është një simbol i shquar i sovranitetit dhe i pavarësisë kombëtare. Kur mbaron së ekzistuari ajo, kanë marrë fund edhe sovraniteti e pavarësia.

Imperialistët e rinj sovjetikë i kanë lidhur vendet revizioniste të Evropës Lindore nga ana politike nëpërmjet Traktatit të Varshavës, nga ana ekonomike nëpërmjet KNER-it. Ushtria pushtuese sovjetike ndodhet në të gjitha këto vende. Tani po bëhet edhe integrimi i plotë ushtarak. Shtrohet pyetja: Ç'mbetet tjetër përveç integritit territorial të këtyre vendeve

me Bashkimin Sovjetik, gjë që, në analizë të fundit, është një akt formal?

Partia jonë me kohë, bile shumë më përpara ngjarjeve të Çekoslovakisë, ka paralajmëruar se Traktati i Varshavës është shndërruar në një mjet për skllavërimin e vendeve pjesëmarrëse në të dhe në një armë të rrezikshme të politikës imperialiste të revizionistëve sovjetikë kundër popujve dhe sigurimit ndërkombëtar. Krijimi i «forcave ushtarake speciale» tregon për degjenerimin e mëtejshëm dhe futjen e tij në një rrugë të mbushur me pasoja mjaft të rënda.

Ne nuk besojmë se popujt e vendeve të Traktatit të Varshavës dhe, bashkë me ta, edhe popujt sovjetikë do ta lejojnë veten të bëhen rajá të klikës renegate Brezhnjev-Kosigin dhe të përdoren si vegla të bindura të politikës së saj skllavëruese e imperialiste. Idealit e pavarësisë e të lirisë, të revolucionit e të socializmit nuk mund të shuhet në zemrat e tyre. Dhe ne jemi të bindur se ata do ta kuptojnë drejt situatën e rëndë në të cilën i kanë futur klikat revizioniste dhe do të bashkohen me popujt revolucionarë, me të gjithë ata që luftojnë me vendosmëri dhe pa kompromis kundër planeve të rrezikshme të imperializmit të ri sovjetik. Kjo do t'u shërbente jo vetëm interesave të tyre të lartë kombëtarë, por edhe çështjes së përgjithshme të lirisë e të pavarësisë së popujve, kjo do t'i shërbente çështjes së madhe të komunizmit, për të cilën ata kanë bërë aq shumë sakrifica dhe kanë derdhur aq shumë gjak.

Për sa i përket popullit tonë, ai nuk u trembet as ushtrive mercenare që po organizojnë revizionistët so-

vjetikë, as edhe forcave të tjera të Traktatit të Varshavës. Populli shqiptar dhe ushtria e tij e lavdishme, nën udhëheqjen e Partisë së tyre heroike, janë si një trup i vetëm, të përgatitur për të përballuar çdo agresion, ngado që të vijë, dhe të dalin fitimtarë mbi të. Popullin tonë armiqtë nuk do ta gjejnë kurrë në gjumë dhe as e gënjejnë dot si format e organizimit të agresorëve, ashtu edhe parullat demagogjike që shoqërojnë të tilla organizime, si ato që po bëjnë tani revizionistët sovjetikë.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 55 (6719), 6 mars 1970*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 557*

**QË TË MARRIM PRODHIME TË BOLLSHME  
DUHET TË DIMË DHE QË TË DIMË  
DUHET TË MËSOJMË**

*Fjala në takimin me një grup kuadrosh drejtues të kooperativës së Luzit të Vogël dhe të kooperativave fqinje*

**11 mars 1970**

*I shoqëruar nga drejtuesit e kooperativës të Luzit të Vogël, shoku Enver Hoxha vizitoi disa objekte socialkulturore, u takua e bisedoi përzhemërsisht me punonjësit. Në takimin që bëri me një grup kuadrosh, shoku Enver Hoxha tha:*

Orientimi i Partisë që artizanati, për plotësimin e nevojave të popullit dhe të kërkesave për mjetet e punës, të kalojë në shkallë të gjerë nga qyteti në fshat, në kooperativat bujqësore, kurse në qytete të mbetet vetëm një artizanat i kualifikuar, sidomos për prodhimin e artikujve për eksport, ka qenë i drejtë. Ky konkluzion del nga fakti që ju kooperativistët dhe Partia në bazë, që nga rrethi e deri në fshat, e përqaftuat dhe e zbatuat konkretisht këtë orientim.

Ju tani keni punishte artizanati jo aq primitive

siç ishin disa vjet më parë në qytete, por punishte me motorë, që, natyrisht, të rinj nuk janë, por, sidoqoftë, janë në gjendje të funksionojnë dhe të plotësojnë një pjesë të nevojave të ngutshme të kooperativës suaj të madhe.

Këto që pashë këtu më pëlqyen shumë, por të mos mbeteni me kaq. Ju keni një bazë të mirë për të ecur më përpara, duke u nxitur edhe nga shembulli i disa kooperativave të tjera që, siç më kanë thënë, kanë krijuar një bazë akoma më të mirë e më të fuqishme. Kjo nuk e ul vlerën tuaj, por, siç thashë, ju nxit që të arrini më të përparuarit. Për të bërë përmirësime, veç përpjekjeve tuaja, duhet t'ju ndihmojnë edhe organet e Partisë e të pushtetit në rreth. Natyrisht, ju e keni parasysh se rrethi ka për të ndihmuar edhe shumë kooperativa të tjera që nuk kanë përparuar si ju; ai përpiqet t'i ngrejë të gjitha kooperativat bujqësore në nivelin tuaj, por rrethi nuk do të harrojë edhe për të përmirësuar bazën tuaj, sepse dollapët që prodhon zdrukthëtaria juaj për kooperativën dhe që duken të mirë, janë akoma të thjeshtë; gustot dhe dëshirat e shoqeve e të shokëve kooperativistë kanë filluar të rriten, ata duan prodhime më të mira, më të kualifikuara. Në qoftë se nesër do të derdheshit në qytet për të blerë mobilie, pse atje i bëjnë më të mira e më të bukura, ju nuk do t'i plotësonit dot nevojat tuaja edhe sikur të bënim tri ndërmarrje të tjera si ajo «Misto Mame», prandaj nuk duhet të mendoni që zdrukthëtaria juaj të prodhojë si kjo ndërmarrje, por që ta bëni tri dhe katër herë më të modernizuar se kjo që keni

tash, me qëllim që mobilitet si në cilësi, edhe në sasi, të jenë tri dhe katër herë më të mira. Kështu të mos vijë në qytet për të blerë mobilie, ta zëmë dhjetë familje në muaj, por dy, kurse të tjerave t'ua plotësojë nevojat zdrukthëtaria juaj, mbasi mobilitet e saj do të kushtojnë edhe më lirë.

Kjo perspektivë nuk duhet parë në kuptimin që në fshat të ngremë ndërmarrje industriale, por të synojmë që këtu të ngremë ato reparte artizanati të nevojshme që i duhen kooperativës. Nevojat e kooperativistëve janë rritur në një shkallë më të lartë, atëherë në përputhje me këto nevoja edhe ne duhet të ngremë cilësinë e mallrave, si të atyre që vijnë nga qyteti, ashtu dhe të këtyre që bëhen këtu, dhe të përpiqemi që të prodhohen më lirë e më shpejt. Kjo gjë kërkon medoemos të ekonomizojmë edhe forcat e punës. Problemi, pra, zgjidhet jo duke zgjeruar zdrukthëtarinë në dëm të tokave arë, por duke punuar në mënyrë të studiuar, që edhe kur është e domosdoshme të zgjerohet, duhet njëkohësisht të mekanizojmë dhe të organizojmë më mirë punën në të gjithë sektorët e ekonomisë kooperativiste.

Duhet ta kuptojmë, shokë, se pa një organizim të fortë nuk ka ekonomi të fortë. Organizimin që kemi tashti nuk e kemi aq të përsosur, ndaj po bëjmë përpjekje për ta forcuar që nga vendosja e drejtë e normave të punës, nga disiplina në punë, nga vlerësimi dhe nga matja e kohës së punës, nga shfrytëzimi në maksimum i makinerive etj., sepse këtu ka rezerva të mëdha. Që të arrihen këto, duhet bërë punë politike, që kooperativistët të jenë të ndërgjegjshëm dhe

të kuptojnë mirë se punojnë për veten e tyre. Këtu duhet t'i biem çekanit akoma.

Ne kemi arritur suksese të mëdha, por kur shtrohet problemi përse nuk merren rendimentet e planifikuara, atëherë del në pah se disiplina shkencore, disiplina teknike dhe disiplina proletare në punë nuk janë në nivelin e duhur. Ka njerëz te të cilët akoma nuk janë rrënjësor fort pikëpamjet e drejta për punën e përbashkët, për pronën e përbashkët. Kur është çështja për punën në pronën personale, ka kooperativistë që janë më shumë organizatorë, ndërsa për punën në kooperativë, në pronën e përbashkët, ata nuk janë organizatorë në atë shkallë që kërkohet. Kjo tregon se këta nuk e kanë kuptuar mirë që pasuria e të gjithëve shërben si bazë edhe për mirëqenien personale. Gjithë kjo pasuri kaq e madhe nuk mund të drejtohet po s'u organizua mirë puna dhe, për të dalë me sukses, duhen kuptuar mirë e duhen zbatuar me ndërgjegje e me disiplinë të plotë detyrat që përmenda.

Për të marrë prodhime të bollshme duhet të dimë dhe që të dimë duhet të mësojmë, pra, t'i kushtojmë rëndësi përhapjes së kulturës në masat e kooperativistëve. Kurrë njeriu nuk duhet të thotë se është i ditur. Vërtet ne dimë më shumë se dje, po duhet të mendojmë se dimë më pak nga sa do të dimë nesër. Ne kemi punuar dhe kemi mësuar, prandaj arritëm në këtë shkallë të zhvillimit, por na duhet të punojmë e të mësojmë akoma që të arrijmë atje ku duam. Sivjet ju nuk e realizuat planin e pambukut. Përse ndodhi kjo? Duhet t'u futemi thellë shkaqeve, sepse këtu keni agronomë dhe kryeagronom, që nuk janë pa dijeni, por

këto duhen thelluar. Si për njerëzit, edhe për bimët ka ligje biologjike, të cilat njeriu nuk i ndryshon dot, por ai mund dhe duhet t'i njohë, që të dijë t'i përdorë në interesin e tij. Po s'i mësuan këto ligje jo vetëm agronomët, por të gjithë kooperativistët, është e zorshme të marrim gjithë atë prodhim që kërkohet.

Më parë nuk u flisja kështu fshatarëve, pse si unë, edhe ata dinin më pak se sot, por tani edhe unë mësova, edhe fshatarët mësuan, të gjithë na mësoi Partia. Më parë kishte fanatizëm, njerëzit nuk i njihnin ligjet e natyrës, kurse tani kohët kanë ndryshuar dhe shumë gjëra duhet t'i kuptojnë. Duke njohur disa ligje dhe fenomene të natyrës së botës organike, njeriu i studion më thellë dhe i përdor në dobi të jetës së tij, të kafshëve dhe të bimëve.

Ju keni 550 krerë lopë dhe e dini se edhe lopa, sikurse njeriu, preket nga sëmundja e tuberkulozit. Dihet se qumështi i lopës, aq i ushqyeshëm dhe i dobishëm për shëndetin e njeriut, përmban, midis shumë lëndësh, edhe fosfat, kripëra të tjera dhe kalcium, që është pjesë përbërëse e gëlqeres. Kalcium kanë edhe kockat e njeriut, të cilit, kur është duke u sëmurur nga tuberkulozi, i këshillohet përdorimi i kësaj lënde të përzier me ujë dhe sheqer, që pihet pasi bëhet si shkumë gëlqereje. Përdorimi i kalciumit është i dobishëm edhe për sëmundjet e dhëmbëve, të kockave etj. Është vërtetuar shkencërisht se, që të zhvillohet lopa normalisht, që të ketë një jetë më të gjatë, që të lindë viça të mirë dhe të na japë qumësht në cilësinë dhe në sasinë e duhur, duhet t'i jepen ushqime të tilla që të përmbajnë fosfat, kripëra të tjera, kalcium etj.



Në rast se këto ushqime nuk i sigurohen, trupi i saj, për të prodhuar qumështin, konsumon lëndët që përmenda, sepse lopa për çdo litër qumësht harxhon 7-8 gramë lëndë të tilla, dhe sëmuret nga tuberkulozi.

Le të marrim problemin e pambukut. Në këtë bimë nuk u arritën rezultatet e duhura. Duke arsyetuar për shkaqet, disa thonë që s'ishte fara e mirë. Fara mund të mos ishte e mirë, sepse, pasi është blerë, nuk është vlerësuar ana biologjike si kusht me rëndësi për të ardhmen e prodhimit dhe, për pasojë, nuk është trajtuar si duhet. Nga fara e prishur nuk merr dot pambuk të mirë. Por një shkak kryesor ka qenë edhe mbjellja me vonesë e kësaj bime. Edhe po ta kesh të mirë farën ose po ta mbjellësh me kohë pambukun, duhet t'ia bësh të gjitha shërbimet, të jetë e shëndoshë fusha, së cilës t'i përgatiten të gjitha kushtet. Pambukut duhet t'i bëhen të gjitha shërbimet e nevojshme për rritjen dhe për zhvillimin e mirë, sepse edhe ai ka jetën e vet, kushtet dhe normat e zhvillimit, sëmundjet e tij. Në qoftë se i zbatojmë detyrat dhe ndjekim këmba-këmbës zhvillimin e kësaj bime, do të marrim rendimente të larta. Vërtet janë mësuar disa gjëra kryesore për numrin e prashitjeve etj., por vetëm ato që janë mësuar në kurse nuk mjaftojnë, në qoftë se njerëzit nuk do të thellohen më shumë pse duhet prashitur kaq herë pambuku, sa centimetra thellë hidhet fara e grurit në tokë, sa lloje rrënjësh ka gruri, i cili, që kur mbin, lëshon disa rrënjë më thellë dhe të tjerat anash etj.

Kështu, pra, secila bimë ose kafshë ka kërkesat e saj. Të ka qëlluar ndonjëherë të shikosh që, kur

vete mjelësja për ta mjelë, lopës nuk i del qumështi<sup>1</sup>? Pse ngjet kjo? Unë s'jam specialist për blegtorinë, po këtë e kam mësuar duke lexuar dhe duke pyetur njerëzit e ditur. Kjo ngjet se lopa është një kafshë shumë e ndjeshme, do qetësi dhe, po t'i shkojë mjelësja duke bërë zhurmë me kovë, asaj i tkurren nervat dhe instinktivisht qumështi nuk i vjen. Kjo është një gjë e thjeshtë, por duhet ditur. Sikur mjelësja të vazhdojë ta mjelë lopën kur kjo është në gjendje nervoze, në vend të qumështit do të marrë një lloj lëngu që është njëfarë acidi.

Lopa nuk e jep qumështin edhe për arsye të tjera. Kështu, në rast se milet vetëm tri herë, siç bëkeni ju, presioni i qumështit bëhet sa një e treta e presionit të gjakut dhe atëherë qumështi nuk del, sepse janë ligje biologjike këto. Po kështu, më thoshte një ditë një specialist, kur viçi pi qumësht, hunda e tij nuk duhet të jetë shumë e ftohtë ose shumë e ngrohtë, se në këtë gjendje lopa nuk ia jep qumështin. Ka rëndësi të dihet edhe koha kur i futet viçi lopës për të pirë, domethënë, para apo pas mjeljes, se gjalpin e ka jo qumështi që merret në fillim të mjeljes, po në fund, prandaj duhet t'i mësoni mjelëset që t'i mjelin lopët deri në fund. Në qoftë se duam që viçi të rritet shumë dhe të mos kemi gjalpë, atëherë e lejojmë të pijë në fund, në qoftë se duam të marrim më shumë gjalpë nga qumështi i lopës, duhet ta lëmë viçin të pijë para mjeljes.

I thashë të tëra këto për të treguar sa rëndësi ka

---

1 I drejtohet një kooperativisti.

të mësojmë e të dimë punët e bujqësisë e të blegtorisë. Ne duhet të arrijmë rendimente të larta edhe në grurë, në misër, në blegtori etj., etj. Siç ju ka thënë edhe shoku Rita [Marko]<sup>1</sup>, në këta pesë vjet Partia na ka vënë detyra të mëdha në industri dhe në bujqësi, për arsye se tashti janë krijuar kushtet që të mos kënaqemi me rendimentet që kemi marrë. Ne duhet të marrim 40 e 50 quintalë misër për hektar, 25-30 quintalë grurë për hektar, domethënë të marrim mesatarisht 23 quintalë drithë për hektar. A kemi mundësi t'i arrijmë këto rendimente? Po, dhe duhet t'i arrijmë medoemos, jo vetëm se kemi bërë investime, është përgatitur fusha për këtë qëllim, janë rritur e do të shtohen mekanizimet, ujërat, plehrat etj., por ajo që ka rëndësi shumë të madhe është çështja që ju fshatarët nuk jeni si më parë, po keni ndryshuar shumë. Shikoni gratë e vajzat tuaja në Luz, ato, me tërë kuptimin e fjalës, janë eflatune<sup>2</sup>, nuk kanë ndonjë ndryshim nga gratë dhe vajzat e qytetit. Ky është një sukses shumë i madh i Partisë. Prandaj me këto forca dhe mundësi që kemi duhet t'i futemi problemit në thellësi dhe t'i zgjidhim vetë detyrat tona. Punës, organizimit të saj, diturisë e çdo gjëje të re që mësojmë duhet «t'u nxjerrim vaj», t'i çojmë deri në fund. Në këtë mënyrë do t'i arrijmë të gjitha synimet tona.

Ju e shikoni se ç'po bëhet në të katër anët e vendit me metodën e aksioneve masive. Vetë i keni bërë

---

1 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit.

2 Të shkathëta, të zonjat.

këto kanale brenda ditës. Kujt ia merrte mendja më parë se do të hapeshin kaq shpejt gjithë këto toka? Shumë shpejt u bënë 100 hektarë me blloqe pemësh. Janë bërë ndryshime kolosale me anën e aksioneve me goditje të përqendruar dhe një punë e tillë do të sjellë ndryshime akoma më të mëdha në të ardhmen. Puna e Partisë duhet të vazhdohet e të perfeksionohet, pse me gjithë sukseset që kemi arritur, ka akoma mbeturina në ndërgjegjen e njerëzve. Shfaqja e këtyre mbeturinave nuk duhet të na dëshpërojë, por të na bëjë të organizojmë më mirë punën për t'u vënë fshe-sën, se janë forma të shfaqjes së kontradiktave në gjirin e popullit. Këto mbeturina, si dhe të tjera që do të nxjerrin krye, në sajë të luftës që do të bëjmë do të zhduken.

Ju e keni përmirësuar racën e lopëve dhe merrni nga 1 200 litra qumësht prej tyre. Këtu, natyrisht, luan rol raca, po për zhvillimin e lopës e të prodhimeve të saj kryesore ndikon edhe klima bregdetare, pse këtu janë vende të ngrohta dhe ka gjelbërime. Lopa ka nevojë për ushqime të gjelbra, të njoma dhe të lëngshme, për konvejerin e gjelbër. Ajo do ushqime të zgjedhura e të përgatitura. Ushqimet e njoma përmbajnë ujë, prandaj, ku ka lagështirë, ka edhe gjelbërime.

Më parë lopës i jepnin ç'të mundnin, e ushqenin me kashtë e me fletë të thata, i jepnin cukunidha<sup>1</sup> e barëra me erë. Lopës nuk duhet t'i jepen ushqime me erë, si presh, pse ato dëmtojnë organizmin e saj dhe lopa nuk i honeps. Nga lloji i ushqimeve që ha varet

---

1 Hithra.

edhe lloji i gjalpët që del nga qumështi i lopës, për shembull, gjalpë i butë ose i fortë, gjalpë i bardhë ose i verdhë etj. Në qoftë se qumështi do të bëhet djathë, të kihet parasysh se çfarë ushqimi i duhet dhënë lopës për të marrë atë qumësht prej të cilit djathi do të dalë me sasi dhe me cilësi të mirë. Ka rëndësi të madhe mënyra e të ushqyerit të lopës, prandaj të gjitha këto duhen ditur dhe të luftohet për një ushqim sa më të përshtatshëm të lopëve. Mendoj se duhet pasur kujdes që, sipas qëllimit që keni për përdorimin e qumështit, të zgjidhni edhe ushqimin e lopëve e jo t'i ushqeni ato kurdoherë njëlloj.

Ne duhet të luftojmë që të kemi qumësht e gjalpë me bollëk jo vetëm për popullin tonë, por edhe për të eksportuar, që të marrim valutë. Borgjezia që do të na blejë djathin ose gjalpin, meqenëse rron dhe është majmur në kurriz të popujve që shfrytëzon, është mësuar dhe do të vazhdojë të ushqehet me gjëra të zgjedhura, derisa një ditë t'ia shtypë kokën proletariati, prandaj ajo nuk e blen gjalpin po qe se nuk është bërë me qumështin më të përshtatshëm.

Për këto arsye që përmenda, qoftë për farën e grurit, të misrit ose të pambukut, qoftë për viçat dhe për lopët, specialistët, drejtuesit dhe të gjithë kooperativistët duhet të përpiqen të mësojnë, se janë gjëra që mësohen pa shumë vështirësi. Çështja ishte që të arrinin në këtë nivel zhvillimi të masave të popullit, saqë të mund të kuptohet, si me thënë, fillimi i bazave të shkencës, pastaj, më vonë, në sajë të një përparimi më të madh, edhe rrethi i dijenive do të zgjerohet shumë.

Do të vijë puna që ju shokë të bëni skartimin e deleve e të dhive. Nuk e di nëse keni dhi që kullotin në ato kodrat lart, por tashti, me këta hektarët e sipërfaqeve të tokave që po hapni e me këto pemët që po mbillni, për dhinë nuk mbeti më vend këtu. Ato le të mbahen në zona të tjera. Kur ju po zhvilloni lopën në një shkallë kaq të gjerë dhe i siguron asaj ushqime sipas kriterëve shkencore për të ngritur shumë rendimentin e qumështit, të gjalpët etj., vetvetiu vjen puna që këto dele që keni tani të skartohen. Ju duhet të mbani dele prej të cilave të mund të merrni 6-8 kilogramë lesh e shumë mish, kurse qumështi të synohet jo aq nga delja sa nga lopa. Pra, të kihet parasysht që të merret nga delja mish dhe sidomos lesh, sepse leshin nuk e jep lopa, ndërsa mishin e siguron edhe lopa, edhe delja, por, natyrisht, jo një dele sa një kec, po një dele e mirë që të ushqehet për mish.

Interesi i secilit prej jush vetvetiu dikton nevojën që të mbahen vetëm ato dele prej të cilave mund të merren 8 kilogramë lesh e jo një kile e gjysmë. Në Korçë, në Elbasan dhe në Cërrik kemi dele, por nga 600 kokë, fjala vjen, vetëm në 100 merren nga 6-8 kilogramë lesh. Në raste të tilla secili mendon dhe thotë: «Po këto delet, që japin vetëm nga një kile e gjysmë lesh, ç'i mbajmë, kur na duhen 140 hektarë toka buke për t'i kullotur?». Prandaj, sidomos në fusha, tani çështja shtrohet që të marrim sa më shumë qumësht, po kjo nuk do të thotë të kemi maninë për të mbajtur një numër të madh krerësh. Numrin e krerëve duhet ta llogaritim duke pasur parasysht sasinë e ushqimeve që duhen. Për këtë qëllim të planifikojmë që në fusha,

brenda kaq vjetëve, të përqendrojmë maksimumin e mundshëm të lopëve, gjë që kërkon medoemos rritjen e rendimenteve të misrit, të grurit, të foragjereve, të jonxhës. Pra, të llogaritim që nga kjo sipërfaqe toke të sigurojmë kaq drithëra, kaq foragjere dhe nga ky numër maksimal i lopëve të arrijmë të marrim maksimumin e qumështit dhe të viçave, duke ruajtur edhe proporcionet midis numrit të meshkujve dhe të femrave.

Të gjitha këto duhet t'i mendojmë e t'i gjykojmë me llogari, pse lopën për qumësht mund ta mbash me leverdi 10 vjet, ta ushqesh më tepër nuk është ekonomike. Por, po të gjykojmë me mentalitetin e babës e të gjyshit, që tërë jetën kishin vetëm një lopë, lopa nuk duhet therur. Në qoftë se ju keni tani 500 e ca krerë lopë dhe për 10 vjet do të merrni prej secilës nga 10 mëshqerra, do t'ju bëhen mbi 5 000 krerë. Lopët e fillimit, natyrisht, do të theren për të plotësuar nevojat për mish. Tashti shumica e fshatarëve mendojnë që lopa na duhet vetëm për qumësht, po të mos harrojmë se lopa na duhet edhe për mish. Krahas saj ne do t'i shtojmë edhe derrat, edhe pulat, edhe qetë, duke bërë llogari. Çështja është që në përlllogaritjet dhe në parashikimet t'i kemi sytë hapur që të mësojmë, të punojmë në mënyrë të organizuar dhe, siç thashë, t'u vemi mësimit e punës deri në fund. Po vepruam kështu, do t'i realizojmë me sukses detyrat që na ka vënë Partia.

Sa të bukur e keni bërë ju Luzin! Kjo do të thotë që Partia këtu në Durrës punon mirë. Rrethi i Durrësit ka përparime në bujqësi e në industri, ai është

një nga qendrat më të rëndësishme industriale dhe bujqësore të atdheut, është një nga rrethet më kryesore, ku kooperativistët punojnë shumë mirë dhe kanë rezultate. Me prodhimet bujqësore, veç pambukut, keni dalë shumë mirë, për orizin ju jeni shembull në gjithë vendin. Të tërë duhet të luftojnë në këtë drejtim e sidomos Saranda, që ka kushte shumë më të mira nga ju dhe ka marrë sa gjysma e prodhimit tuaj, ose rrethi i Elbasanit që tërë jetën ka prodhuar oriz dhe ju ia kaluat. Për këtë ju lumtë!

Farën e misrit, sikurse e dini, tashti po e përtërijmë, ajo duhet të përdoret mirë, me të të bëjmë eksperimente e kryqëzime. Edhe ne duhet të bëjmë e të shesim kryqëzimin shqiptar, pse nga kjo gjë, që është jashtëzakonisht e leverdishme, realizohen të ardhura të mira, mbasi merret trefishi i prodhimit. Brenda dy vjetëve në të gjithë vendin do të mbjellim farë të kryqëzuar, por ajo dy-tre vjet shkon mirë, pastaj duhet zëvendësuar me tjetër. Ju nuk e keni trajtuar mirë farën, e cila kërkon kujdes dhe kushte të mira. Triorët që keni marrë, standard janë? Kjo gjë duhet parë një çikë më mirë, pse edhe sikur të jetë e zgjedhur fara, prapë ajo ka përzierje. Ka farë të rrumbullakët, të gjatë, ka edhe farë, fuqia mbirëse e së cilës është e dobët. Prandaj triorët duhet të bëhen në një mënyrë të atillë që të seleksionojnë mirë farën dhe të mbetet ajo e zgjedhura. Po vetëm madhësia dhe forma e farës nuk mjaftojnë pa peshën e saj hektolitrike, sepse fara mund ta ketë formën dhe madhësinë e duhur, megjithatë pesha e saj hektolitrike mund të jetë 65 kilogramë në vend të 75. Ka farë me shumë hime e me



pak hime, me shumë amidon e me pak amidon, me shumë gluten ose me pak gluten. Që të bëhet buka e bardhë dhe e ardhur, fara duhet të ketë shumë gluten, sepse gluteni pi ujë më shumë dhe e bën bukën «llastikë».

Të gjitha këto që përmenda varen nga fara. Në goftë se mendohet shkurt: «Oburra, të mbjellim sot, pa të marrim ç'të marrim nesër», populli do të thotë: «More shoku kryetar, ç'janë këto makarona të zeza kështu, kur janë bërë me këtë grurë kaq të mirë që kemi prodhuar?». Sigurisht, përpara kësaj kërkesë të popullit kryetari do të vrasë mendjen: «Ç'duhet të ketë kjo farë që të bëhen makaronat të bardha? Po ky gruri që është mbjellë këtu, duhet të jetë i butë apo i fortë për t'u bërë petët të mira?». Kur provohet se duhet të jetë i fortë, atëherë, megjithëse mund të të japë më pak rendiment, mbjell nja tre-katër hektarë me grurë të fortë që të kënaqet populli. Prandaj del nevoja të dimë shumë gjëra për farën, se ndryshe nuk i realizojmë dot detyrat.

Ne planin e pesëvjeçarit që vjen akoma nuk e kemi bërë, po jemi në fazën e studimit të projekteve. Përpara se të hartohet plani do t'ju vijë edhe juve këtu. Planin mos e bëni vetëm ju shokët e kryesisë, në diskutimin e tij të marrin pjesë të tërë, organiza-ta-bazë e Partisë, të gjitha brigadat. Si bazë të merret shembulli i brigadës që ka arritur rezultatet më të mira. Kur ka kundërshtime në një brigadë, atje të shkojë e tërë brigada që ka marrë më shumë oriz, për shembull, dhe të diskutojë shtruar në brigadën tjetër që e kundërshton, së cilës t'i thuhet: «Pse ju nuk doni

të merrni prodhim sikundër kemi marrë ne? Çfarë kushtesh kemi ne më të mira nga ju, kur toka, ujitja etj. janë të njëllojta me ato që keni ju?». Këtu vihen në dukje organizimi i mirë i punës në njërën brigadë dhe dobësitë e punës së brigadës tjetër dhe pastaj, pasi binden kooperativistët, marrin angazhime që të punojnë e të prodhojnë të tërë në shembullin e brigadës më të mirë. Në diskutimin dhe në hartimin e planit lufta të jetë për rendimente reale, por të larta. Prandaj masat e gjera të popullit të futen në lëvizje jo «sa për t'i pyetur», se kështu na tha Partia, por për t'i pyetur mirë, për të marrë mendimin dhe për të vendosur tok me to. Po nuk vepruam kështu, të gjitha sukseset do të jenë të sipërfaqshme dhe të paqëndrueshme. Diskutimi i planit në mënyrë formale është i rrezikshëm. Çdo gjë, të mirën dhe të ligën, ta shtrojmë me popullin, pse kështu kurrë nuk do të gabohe mi; po të veprojmë ndryshe, do të gabojmë, sepse një ose dy mendime nuk mund të jenë kurdoherë të drejta e sidomos po s'i aprovoi e gjithë masa në liri e në demokraci të plotë. Kur planin e aprovojnë masat, atëherë edhe mobilizimi është total.

Gjatë përdorimit të plehrave kimike a i keni provuar dozimet, domethënë ruajtjen e proporcioneve? Ka rëndësi kjo, se ndodh që nga tamahu për t'i hedhur shumë pleh, dëmtohet bima. Duhet të keni kujdes në përdorimin e nitratit në këtë grurë, sepse, me sa di unë, kallmi i tij duhet të vijë sa më shpejt e të mos qëndrojë shumë kohë i gjelbër, kurse po t'i hidhet shumë nitrat, ai e mban gjelbërimin dhe njomësinë, por nuk piqet.

Mendoj se ju duhet t'u organizoni ndonjë kurs të veçantë kooperativistëve që punojnë në brigadat e pemëtarisë, të blegtorisë etj., për thellimin e dijenive të tyre nga ana teorike, për të mësuar veçoritë biologjike të bimës, të tokës, kushtet atmosferike e kombinimin e këtyre faktorëve, me qëllim që njerëzve t'u hapet horizonti. Kur t'i mësojnë mirë disa njohuri të domosdoshme, kooperativistët nuk do t'i zërë gjumi dhe do të ngrihen vetë që të marrin masat e duhura për mënjanimin e rreziqeve. Këto janë dobitë që sjell mësimi i shkencës.

A është përmirësuar mënyra e jetesës nëpër shtëpitë tuaja? Duhet bërë investime të nevojshme për të lehtësuar punën e njerëzve. Nuk e kam fjalën këtu për shpenzime për luks, po për shpenzime të nevojshme dhe për zgjerimin e kapacitetit të çerdheve, ku të mbahen shumë më tepër kalamanë sesa sot.

Tashti çështja është të bëjmë përpjekje që të realizojmë planet tona, të cilat në të ardhmen do të jenë më të guximshme, më mobilizuese dhe, natyrisht, do të na krijojnë mundësi reale për të ngritur nivelin e jetesës së popullit. Edhe juve do t'ju krijohen fonde që të investoni në shumë drejtime të tjera, po duhet të investoni edhe për ngritjen e nivelit të jetesës. Ne, në bazë të planeve, nuk do të importojmë më një sasi mallrash e sidomos ushqimore, siç kemi bërë gjer tani, të cilat mund dhe duhet t'i prodhojmë në vend. Kjo do të na japë një forcë të tillë ekonomike që të përballojmë akoma më mirë nevojat e tregut me sende të konsumit të gjerë, më të mira e më të lira. Për të prodhuar vetë këtu në vend, në bazë të planit për

zhvillimin e industrisë, do të zgjerojmë e do të përmirësojmë fabrikat ekzistuese dhe do të sjellim fabrika të reja. Ne do të ngremë jo vetëm fabrika të mëdha, si për metalurgjinë etj., po edhe fabrika tekstili, fabrika për fije sintetike, plastike etj., etj. Duke mos importuar më pambuk, vaj, sheqer e shumë mallra të tjera, krijojmë mundësi më të mëdha për të sjellë nga jashtë materiale të tjera të konsumit. Ne duhet të rritim eksportin edhe për disa prodhime bujqësore, si domatet, që bëhen shpejt në fusha, ose fasulet «pllaqi», që bëhen në malësi dhe nga të cilat merren 45 kuintalë për hektar. Këto fasule kanë leverdi të madhe, pse një kuintal në tregun e jashtëm kushton mbi 33 herë më tepër se nafta. Në qoftë se ne që tashti zëmë tregjet me domate, që kërkohen shumë, kemi leverdi, pse në periudhën mars-prill ato i blejnë me trefishin e çmimit të mëvonshëm. Duhet të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë e të vëmë në lëvizje të gjitha forcat për të realizuar fitime në tregun ndërkombëtar.

Ne importojmë tanin, për të regjur lëkurën e këpucëve, sepse nuk i mbledhim valanidhin dhe shqemen, me të cilët janë të mbushura pyjet. Kjo ndodh pasi nuk tregohet kujdes në kohën e pjekjes, që me forca të përqendruara të mblidhet gjithë valanidhi për të mos shpenzuar dollarë për blerjen e taninit. Ky qëndrim s'duhet lejuar në të ardhmen.

Kalamanët tuaj duhet të organizohen për të mbledhur kërmij e bretkosa që sjellin të ardhura të mëdha, me të cilët ne mund të importojmë fabrika nga jashtë për të bërë vetë lëndët plastike, jo si ato që blejmë çdo vit, po për të prodhuar plastikë si xham, që të

rrijë me vite nëpër serra, dhe për të bërë pllaka xhami që nuk thyhen. Siç e shikoni, duhet ta organizojmë kaq me mend punën, sa «të nxjerrim dhjamë nga pleshti», si i thonë fjalës. Në këtë drejtim ka shumë rëndësi të vëmë në jetë të gjitha iniciativat dhe të përkrahim të gjitha lëvizjet e njerëzve tanë krijues.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## SOCIALIZMI ÇDO VIT SJELL TË MIRA. KËTO I REALIZON POPULLI

*Fjala në mitingun e Luzit të Vogël<sup>1</sup>*

11 mars 1970

Jam shumë i gëzuar që erdha për të vizituar kooperativën tuaj, për t'u njohur me rezultatet e punës suaj të palodhur. Këtu pashë gjëra shumë të mira. Por mbi të gjitha në kooperativën tuaj pashë njerëzit, ju anëtarët e kooperativës, që keni bërë kaq shumë përparime në të gjitha drejtimet, sidomos nga ana politike, ideologjike, ekonomike dhe kulturore. Te burrat, gratë e sidomos te të rinjtë e të rejtat e kooperativës suaj përparimet duken sheshit.

Ndryshimet që kanë ndodhur në jetën tuaj pas Çlirimit, pasqyrohen në fytyrat tuaja të çelura e të gëzuara. Kjo ndodh për arsye se organizata-bazë e

---

<sup>1</sup> Duke u larguar nga kooperativa e Luzit të Vogël, shoku Enver Hoxha u përshëndet nxehtësisht nga qindra kooperativistë dhe nxënës të shkollave, që kishin dalë në rrugë për ta përcjellë. Midis duartrokitjeve dhe brohoritjeve të tyre të zjarrita në këtë miting spontan, shoku Enver Hoxha mbajti këtë fjalë.

Partisë në kooperativën tuaj ju ka frymëzuar vazhdimisht të punoni e të mësoni që ta gëzoni jetën të lirë e të lumtur.

Për të arritur këto suksese të mëdha ishte e domosdoshme të zhdukeshin shtypja dhe skllavërimi nga armiqtë, të cilët e mbanin popullin tonë nën zgjedhë dhe në errësirë. Partia dhe populli gjatë Luftës Nacionalçlirimtare u ngritën në këmbë e me armë në dorë çliruan vendin dhe rrëzuan shfrytëzuesit. Populli erdhi në fuqi, punëtori mori në duart e tij fabrikat, fshatari tokën. Populli mësoi të punojë, të ndërtojë, të rrojë i lirë. Sot ai, me Partinë e tij në krye, ecën përpara, siç ka ecur edhe kooperativa e zmadhuar e Luzit të Vogël. Kështu si ju ka përparuar gjithë Shqipëria. Ju e dini më mirë nga unë si ishte Luzi më parë. Sot e shohim të gjithë që Luzi juaj, Luzi ynë ka ndryshuar si nata me ditën. Këto toka që tash lulëzojnë të mbjella me grurë, me pambuk e me misër, ku kullotin me qindra lopë të racës, këto kodra që ju, gra dhe burra, me aq zotësi i hapët, i punuat e i bëtë tarraca me pemë frutore, këto shtëpi të bukura që keni ndërtuar në vend të kasolleve të dikurshme, janë një dëshmi e gjallë e ndryshimeve të mëdha që ka bërë pas Çlirimit ky popull heroik.

Kudo në Shqipëri janë çelur shkolla, ku marrin dituri e hapin sytë të rinj e të reja tok, vajza e djem si vëllezër e si motra. Ata mësojnë që ta bëjnë akoma më pjellore këtë tokë, që ta bëjnë edhe më të bukura jetën, që t'i bëjnë akoma më të bukura shtëpitë, që të shtohet bollëku në ushqime, që të mos ketë sëmurdje etj. Të gjitha këto janë rezultat i kujdesit dhe i

mësimeve të pavdekshme të Partisë, që populli i kupton dhe i zbaton me ndërgjegje të lartë.

Këtu te ju pashë gjëra të bukura që keni bërë dhe që duhet të vlejnë si shembull për të tjerët. Pashë të gjitha veprat që keni realizuar ju, që nga banjat deri te floktorja. Këto tregojnë se në jetën e fshatit tonë erdhi përparimi aq i nevojshëm e i domosdoshëm për ju, por këto që janë bërë, siç e kuptoni vetë, nuk janë të mjaftueshme. Më gëzoi shumë ngritja këtu e furrës së bukës, pse kjo lehtëson punën e nënave, të grave dhe të motrave tuaja; më gëzuan shumë edhe ndërtimet e çerdheve e të kopshteve, që gjithashtu ndihmojnë për lehtësimin e punës së gruas dhe për rritjen e mirë të kalamanëve. Armiqtë propagandonin se Partia jonë i ndërton çerdhet dhe kopshtet gjoja që të rrëmbejë kalamanët. Partia dhe Qeveria, mëma dhe motra, i hapën ato që ju t'i gëzoni më mirë kalamanët tuaj, që ata të rriten, të ushqehen e të edukohen më mirë se ç'mund t'i rriste, t'i ushqente e t'i edukonte ndonjë plakë e moçme në shtëpi. Në çerdhe dhe në kopshte fëmijëve nuk u ngjet asnjë rrezik që mund t'u ngjiste po të liheshin vetëm në shtëpi dhe, veç kësaj, ju jeni më të lira në punën që bëni për veten tuaj, për kalamanët tuaj. Duke qenë të sigurt për fëmijët që i lini në duart e kujdestareve dhe të edukatoreve, burra e gra do të shkoni të gëzuar në punë. Unë i pashë çarçafët e bardhë, me të cilët ishin pajisur çerdhet, dhe jam i bindur që ata nuk i kishin vënë se do të vija unë, pse nuk mund të bëhen në një ditë. Më pëlqeu shumë pastërtia në çerdhet, më pëlqyen shumë kalamanët, djemtë dhe çupat



tuaja, që ishin të pastër, të bukur, të qeshur sa s'ka ku të vejë më mirë. Të gjitha ato që pashë, më pëlqyen shumë. Nesër këto që keni bërë sot nuk do të jenë të mjaftueshme, nevojat tuaja do të jenë më të mëdha dhe ju patjetër do t'i shtoni të mirat. Këtë vit do t'ë punoni me forca e me vullnet akoma më të madh dhe s'ka dyshim që do të merrni prodhime të bollshme nga bujqësia dhe nga blegtoria.

Ju, me përjashtim të pambukut, në të gjitha prodhimet e tjera dolët mirë. Nga orizi morët rendimente shumë të mira, që ishin nga më të lartat në vend. Nga gruri dhe nga misri, gjithashtu, morët rendimente të kënaqshme, pse punuat shumë mirë e me mend. Edhe lopët i keni të mira. Në pambuk patët humbje, se nuk menduat e nuk punuat më mirë e me kohë edhe për këtë bimë. Unë kam parë edhe fshatra që kanë marrë nga 17-18 kuintalë pambuk për hektar. Edhe atje ka rënë shi, edhe atje koha ka qenë po kaq e keqe sa te ju, edhe atje është përdorur po kjo farë, por e kanë marrë prodhimin se bënë punën. Pësimet bëhen mësim për të ardhmen dhe unë jam i bindur në sigurimet që më dhanë shokët e kryesisë dhe të Partisë se këtë vit që po kalojmë kooperativistët e kooperativistet do ta prodhojnë pambukun në sasinë dhe me cilësinë e duhur.

Vëllezër dhe motra, ekonomia ka rëndësi të madhe për përparimin e një vendi. Sivjet do të merrni misër hibrid për 100 hektarë. Këtë lloj misri e kemi sjellë nga jashtë, sepse jep 110-120 kuintalë për hektar. Brenda një deri dy vjetëve në të gjithë vendin do të mbjellim nga ky misër, prej të cilit duhet të arrijmë

të marrim në të gjithë sipërfaqen nga 60 kuintalë për hektar.

Ne fukarallëkun e kemi zbuar dhe socializmi çdo vit sjell të mira për atdheun. Këto të mira i realizon populli i udhëhequr nga idetë e komunizmit. Prandaj, me ju, njerëz besnikë të Partisë, të fortë e të çeliktë, njerëz të zgjuar e të punës, do të bëjmë që nga këto toka dhe në këto kushte të marrim prodhime të bollshme. Kështu ekonomia jonë do të ngrihet akoma më lart. Por, vëllezër dhe motra, që të shkoni akoma më përpara duhet ta konsideroni tuajën me shpirt ekonominë e përbashkët, kooperativën, ta konsideroni punën në kooperativë si qëllimin tuaj kryesor dhe të tendosni të gjitha forcat për ta organizuar punën shumë mirë, të mos humbisni minutën që të mund të krijoni bollëkun për veten tuaj dhe për atdheun. Ka nga ju që, para disa vjetëve, merrnin 5-6 kuintalë grurë për hektar, kurse tash merrni 19. Disa shokë kooperativistë thonë: «Me kaq jemi të kënaqur, ku të vemi më shumë?». Partia na mëson se ky mendim nuk është i drejtë, prandaj mos u kënaqni me kaq, se ka mundësi për të marrë më shumë, jo 19, po 35 e më shumë kuintalë grurë për hektar, jo 50, po 80 e 90 kuintalë misër për hektar. Ja përse nuk duhet të jemi të kënaqur me kaq sa kemi arritur. Rendimentet e larta do t'i arrijnë me punë të palodhur dhe të kujdesshme kooperativistët, që mendojnë si revolucionarë dhe i kanë duart të florinjta. Me parullën revolucionare «Një për të gjithë e të gjithë për një», duhet të bëjmë që me prodhimet të jenë të kënaqur jo vetëm kooperativistët, po i gjithë populli, e gjithë Shqipëria.

Ne luftojmë për bollëkun, të cilin do ta krijojmë kur të bëjmë më shumë grurë, pambuk e stofa, kur të shtojmë lopët etj., etj. Atëherë do të kemi bukën, mishin, qumështin, gjalpin, djathin, stofat, këpucët etj., etj. më me shumicë e më të lirë. Po t'i kuptojë si duhet këto gjëra tërë populli ynë, sigurisht, do të jetë në gjendje të lulëzojë malet dhe t'i bëjë ato pjellore si fushat, siç po i bën. A mund ta merrje me mend më parë ti xhaxho<sup>1</sup> që do të bëheshin këto gjëra? Jo, kurrrë nuk mund ta merrje me mend, por ja që u bënë dhe tashti ti je në gjendje të thuash me siguri se të tëra do t'i bëjmë.

Qëllimi i Partisë është që populli të rrojë i lumtur e i gëzuar në atdheun e tij socialist, që askush të mos guxojë t'i prekë kufijtë e atdheut, se ndryshe gjen vdekjen.

Mëmat dhe baballarët tuaj, të dashur pionierë dhe pioniere, në të kaluarën kanë vuajtur të zitë e ullirit; jeta e tyre, si dhe ajo e gjyshërve dhe e stërgjyshërve tuaj, ka qenë një jetë vuajtjesh, plot me luftëra kundër bejlerëve, kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë. Prandaj, mëma, babai, gjyshi dhe gjyshja, me Partinë në krye, luftojnë që ju të mos shikoni ditë të këqija, të mos kenë mjerime dhe vuajtje, po të rriteni si punëtorë, si njerëz të ndershëm, besnikë të popullit, të atdheut dhe të Partisë, që të doni shoqi-shoqin me gjithë shpirt, të doni e të respektoni prindërit dhe mësuesit tuaj. Kur të mbaroni shkollën, mos harroni se ajo është një armë që jua dhanë populli dhe Partia

---

1 I drejtohet një të moshuari të pranishëm në miting.

për t'u vënë të gjithë në shërbim të popullit, si shërbëtorë të tij, e jo si fodullë. Të mos keni turp nga balta, se ajo dhe toka jonë janë të shtrenjta. Kush djersin, kush nxihet nga vajrat, kush bëhet pis nga balta në punë e sipër, ai është njeriu më i nderuar. Është me të vërtetë i mësuar ai njeri që është i lidhur me baltën e arave, me fabrikën, me punëtorin e me fshatarin.

Populli dhe Partia ju mësojnë si të rroni me të vërtetë të lumtur, si ta gjeni gëzimin në punë dhe si të jeni kurdoherë gati, me barutin të thatë, si ushtarë të stërvitur për mbrojtjen e atdheut. Derisa të mos jenë zhdukur imperializmi dhe revizionizmi nga faqja e dheut, pushka duhet mbajtur afër. Çdo ushtar, na mëson Lenini, të jetë qytetar, çdo qytetar duhet të jetë ushtar. Ushtria duhet të jetë e lidhur ngushtë me popullin. Në qoftë se bëhet kështu, thoshte Lenini, s'ka forcë në botë që ta mundë Rusinë e bolshevikëve. Edhe Partia jonë thotë: Në rast se ushtria shkrihet me popullin dhe çdo qytetar është një ushtar e çdo ushtar është një qytetar, s'ka forcë në botë që ta prekë e ta mundë Shqipërinë socialiste.

Këto kisha për t'ju thënë shkurtimisht. Më falni, se ju mbajta në diell.

Jam shumë i gëzuar dhe s'më iket nga ju, por duhet të vemi një çikë edhe në Luzin e Madh. Koope-rativistët e Luzit të Madh, meqenëse e kanë mbiemrin «i madh», do të thonë: «Po pse vajtët tek «i vogli» më parë?». Unë do t'u them atyre se Partia më mëson që të shkoj më parë te të vegjlit, pastaj te të mëdhenjtë. Do t'u them edhe shokëve në Tiranë që isha

këtu e çfarë pashë. Ato që pashë e ndjeva pranë jush do t'ia them edhe babë Myslimit, i cili do të gëzohet shumë, pse ju do dhe ju kujton përherë. Babën e kemi një nga shokët tanë më të lavdishëm e më të mirë, që, me gjithë moshën e kaluar, ka luftuar e lufton pa u lodhur. Ai bën ç'bën e mendjen këtej e ka, zemra e Myslimit është këtu te ju. Kur unë dua të marr vesh se ç'bëhet këtej, si shkon gruri, si punohet për misrin, si u bë pambuku, si janë ullinjtë etj., thërres Myslimin e i them: «Hë, Babë, ke shkuar gjë andej nga Syneji ose nga Luzi i Vogël?». «Po», thotë ai e më tregon si janë ullinjtë dhe prodhimet e tjera. Tashti është për pushime në Vlorë, kur të vete atje do ta pjek e do të bëjmë ca muhabet së bashku. Do t'i vijë shumë mirë që kësaj here do t'i tregoj unë atij se ç'bëhet këtu në Luz. Ai mbahet shumë mirë nga shëndeti.

Tashti lamtumirë dhe mbetshi me shëndet!

*Etohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## PËR FORCIMIN E ORGANIZIMIT TË PUNËS NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË ZMADHUARA

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 mars 1970

Jam dakord me sa thanë shokët se orientimi për zmadhimin e kooperativave bujqësore është i drejtë, prandaj në këtë çështje ne jemi në rrugë të mirë. Unë desha vetëm të përmend disa çështje që, sipas mendimit tim, Partia dhe pushteti në rrethe dhe në kooperativat bujqësore duhet t'i kenë parasysh, me qëllim që këto ekonomi të mëdha të drejtohen më mirë.

Me gjithë sukseset që kemi arritur në këtë fushë, të mos mendojmë se organizimi i punës është kudo në nivelin që kërkohet. Prandaj, na vihet detyrë që drejtimin e kooperativave të zmadhuara, duke u udhëhequr nga mësimet e Leninit, ta bëjmë gjithnjë e më të përsosur.

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve të paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Durrës dhe Krujë «Mbi përvojën e grumbulluar nga kooperativat bujqësore të zmadhuara dhe masat për forcimin e mëtejshëm të tyre».

Në kooperativat bujqësore, në këto organizata prodhuese të krijuara nga ish-ekonomitë e vjetra fshatare me karakter prodhimi të vogël individual mikroborgjez, duhet t'u vëmë rëndësi organizimit socialist të punës, organizimit të prodhimit dhe propagandës së prodhimit. Të gjitha këto duhet të zhvillohen me një punë politike të madhe dhe të organizuar drejt.

Partia dhe pushteti duhet t'i kenë parasysh vazhdimisht këto tri çështje esenciale dhe asnjëherë të mos mendojnë se i kanë plotësuar, i kanë perfeksionuar ose u kanë gjetur zgjidhje të plotë. Formave që praktikohen aktualisht ne duhet t'u bëjmë përmirësime. Në këtë mënyrë do ta mësojmë fshatarin që ky ta ndihmojë ekonominë kooperativiste të hyjë në rrugën e një ekonomie të vërtetë socialiste. Po të arrijmë t'i organizojmë mirë punën, prodhimin dhe propagandën e prodhimit dhe të ngremë çdo ditë e më lart nivelin ideologjik dhe politik të kooperativistëve për kuptimin e drejtë të detyrave, atëherë do të korrin suksese të mëdha. Prandaj dëshiroj të theksoj se të kënaqurit vetëm me atë që është arritur nuk është inkurajues, bile ai mund të bëhet frenues dhe ta pengojë ecjen tonë përpara.

**1. Mbi organizimin socialist të punës.** Desha të theksoj që në fillim se, siç dihet, si kudo, edhe në fshat është puna ajo që krijon të mirat materiale dhe farkëton karakterin e vërtetë të njeriut të rendit tonë shoqëror socialist. Puna formon e kalit, pra, edhe ndërjegjen e lartë të fshatarit, ajo ndihmon për të kuptuar drejt politikën, për të përvetësuar diturinë e teknikën dhe për të plotësuar detyrat. Në rast se nuk ma-

rrim masa për organizimin e mirë të punës, fshatari ynë kooperativist nuk do t'i kuptojë si duhet të gjithë komponentët që e përbëjnë punën dhe që i sjellin rezultate të mëdha ekonomisë. Duke ditur se shumë nga këta komponentë të punës, si: disiplina, koha, normat etj., fshatarësia, nga vetë natyra dhe prejardhja e saj klasore, nuk i ka të qarta, duhet zhvilluar një veprimtari e madhe edukuese me të, me qëllim që ajo të ecë me bindje të plotë në format e përshtatshme dhe moderne të punës. Vetëm kështu do të bëhet i mundur realizimi i detyrave të mëdha që kanë përpara kooperativistët. Ndryshe planet që hartojmë nuk do të realizohen në shkallën që kërkojmë.

Konstatojmë se format e punës që kemi eksperimentuar dhe që, në përgjithësi, janë të drejta, nuk zbatohen si duhet, ose zbatohen jo me ndërgjegjen e plotë, siç bëjnë njerëzit e edukuar dhe të ngritur politikisht që i kuptojnë drejt këto forma, brendinë dhe dobinë që sjellin ato. Aplikimi i drejtë i formave dhe kuptimi i lartë politik për dobinë që sjellin ato, kanë shumë rëndësi. Fshatarësia jonë nuk është akoma në gjendje t'i kuptojë dhe t'i zbatojë në shkallën që kërkohet të gjitha këto forma, ku hyjnë çështje si ato të brigadës, të normave, të ditës së punës etj., si dhe proceset e organizimit të punës. Kjo kërkon ngritjen më tej të kulturës së fshatarit tonë kooperativist, që i zbaton format e punës, po akoma jo me një kuptim të lartë politik, siç duam ne.

Format organizative të punës, si çdo gjë tjetër, ndjekin procesin e tyre të zhvillimit, ecin drejt përmirësimit. Nuk është e thënë që këto forma organizative



pune që ne kemi vënë dhe kemi zbatuar në jetë, nuk do të ndryshojnë pozitivisht e nuk do të zhvillohen më tej. Me kohë do të gjenden patjetër forma të reja organizative pune më të përparuara që do t'i nxjerrë vetë jeta, në rast se Partia dhe pushteti në bazë, duke u frymëzuar drejt nga direktivat e udhëheqjes, do të kenë iniciativa të gjera për të bërë eksperimente, përmirësime e ndryshime të mëtejshme me to. Format organizative të përparuaranuk duhen kuptuar në mënyrë aq të thjeshtë, siç mund të mendojë ndonjë që, me t'u ardhur diçka në mendje disa kooperativistëve, mund të vendosen e të zbatohen menjëherë. Një mendim i tillë do të ishte shumë simplist. Neve, gjithashtu, nuk na lejohet të presim hovin e kujtdo qoftë në rrugën e përparimit dhe të ngulim këmbë për të qëndruar në vend me disa forma që vërtet kanë dalë nga eksperiencia e masave, por që me kohë ato e humbasin vlerën, pse jeta imponon gjetjen dhe vendosjen e formave të tjera të reja më të efektshme. Prandaj kemi detyrë që, ashtu siç nuk duhet të shpejtohem me ndryshimin e formave ekzistuese, kur këto japin akoma rezultate, duhet të ngjallim iniciativën e njerëzve tanë për gjetje formash të reja pune ose për t'i bërë më të përsosura format ekzistuese në të gjithë sektorët, kur këtë e kërkon nevoja e zhvillimit të prodhimit. Kjo do të thotë se njerëzit tanë nuk duhet të jenë automatë, duke u nisur nga mendimi se kështu na është thënë, prandaj kështu duhet të veprojmë. Kur veprojmë së pari, duhet të jemi të bindur se kjo ose ajo formë pune është e drejtë dhe do të na japë rezultate, prandaj edhe të punojmë në kuadrin e asaj for-

me. Në të njëjtën kohë, gjatë punës secili duhet të vërejë me kujdesin më të madh për të gjetur ndonjë formë tjetër më të përshtatshme nga ajo që është caktuar.

Në zbulimin e formave të reja të organizimit të punës, kooperativisti nuk duhet të udhëhiqet vetëm nga interesi i rritjes së të ardhurave të tij nga dita e punës, por në radhë të parë nga interesi i përgjithshëm. Gjithë çështja qëndron në atë që ndërgjegjja socialiste e fshatarit tonë të arrijë një shkallë të atillë, sa ai të mendojë kështu: «Unë tani s'jam më ai që drejtoja një familje me katër-pesë veta, por jam pjesëtar i një familjeje të madhe dhe njëkohësisht përgjegjës për mbarëvajtjen e kësaj ekonomie të përbashkët».

Fshatarin duhet ta bëjmë të gjykojë se e ka për detyrë që, në mbledhje të zakonshme e të jashtëzakonshme të kooperativës, t'i shprehë mendimet e tij, të diskutojë për to dhe të mos lejojë që fjalët t'i marrë era. Nuk duhet t'i lejohet askujt dhe në asnjë mënyrë t'ia presë iniciativën kooperativistit, duke i thënë se «Ti, more shok, propozon kot për ndryshimin e normave», apo «Kjo ose ajo formë organizimi pune në brigadë me kaq veta, siç mendon ti, nuk mund të pranohet, mbasi Statuti atë e parashikon ndryshe», ose «Këshilli i Ministrave apo Komiteti Qendror i Partisë kanë dhënë të tjera rekomandime për këtë apo atë çështje, prandaj asgjë s'mund të bëhet». Në qoftë se i vëmë të gjitha çështjet kështu, të paracaktuara e të pandryshueshme njëherë e përgjithmonë, atëherë zbatuesi i tyre shndërrohet në një automat, humbet çdo iniciativë dhe ecën si kali i arabasë. Prandaj Par-

tia na mëson që mendimet e njerëzve të dëgjohen me vëmendje e të shqyrtohen me kujdes dhe mbi këtë bazë të përmirësojmë edhe format e punës. Format ekzistuese organizative të punës nuk duhet t'i marrim si medalje apo merita tonat, po si merita të masave. Merita e udhëheqjes konsiston në faktin se ajo ka ditur të bëjë përgjithësimin e eksperiencës së masave, gjë që e ka për detyrë, përndryshe s'ka vend të rrijë në drejtim të punëve. Përse të mos nxitet kooperativisti që të sjellë me mendimet e tij përmirësime në procesin e madh të zhvillimit të kooperativës? Të mendohet e të veprohet ndryshe nuk është marksiste, prandaj çështja e organizimit dhe e përmirësimit të vazhdueshëm të punës në kooperativa, në të gjitha drejtimet ka një rëndësi të jashtëzakonshme.

Edhe kur kooperativat kanë qenë të vogla, prapë organizimi i punës ka pasur rëndësi të madhe, por tashti që ato janë zmadhuar, kjo rëndësi është akoma më e madhe. Në këtë organizatë shoqërore ekonomike të madhe që ka udhëheqjen e të ardhurat e saj, organizatën-bazë të Partisë etj., etj., në radhë të parë duhet të kuptohet thellë dhe qartë nevoja e organizimit të punës, ndryshe këto ekonomi kaq të mëdha nuk do të na ecin si duhet.

Lidhur me këtë dëshiroj të flas pak edhe për rëndësinë e «sektorit» të kooperativës së bashkuar. Ky nuk është organizuar mbi baza hozrashoti, siç ndodh në ndërmarrjet shtetërore të bujqësisë, por varet nga asambleja e përgjithshme e kooperativës së bashkuar dhe nga kryesia. Sektori njëkohësisht duhet të japë llogari për punën edhe përpara popullit të fshatit që

e përbën, domethënë përpara brigadave ose njërive të tjera që merren direkt me prodhimin apo me aktivitetet e tjera.

Përfaqësuesit e sektorit, në mbledhjet e rregullta që bën kryesia e gjithë kooperativës së bashkuar, duhet të paraqesin aktivitetin e sektorit, kësaj njësie që punon në formë demokratike. Por në mbledhjet e kryesisë nuk venë 8-9 veta sa mund të jenë përfaqësuesit e sektorit, por sipas çështjeve dhe rëndësisë së tyre mund të venë 2-3 ose edhe 4, ndërsa për një problem që gjykohet si shumë i rëndësishëm, kur diskutimet ndizen dhe çështjet acarohen, mund të vendoset që të venë të gjithë. Kështu duhet kuptuar kjo çështje, se nganjëherë mendohet sikur sektori duhet të merret vetëm me dyqanin ose me disa çështje thjesht administrative. Sektori në radhë të parë merret me problemet ekonomike.

**2. Mbi organizimin e prodhimit në kooperativat bujqësore.** Organizimi i prodhimit ka rëndësi të dorës së parë. «Të mobilizohemi me të gjitha forcat që të prodhojmë sa më shumë, sa më mirë dhe sa më lirë» është parulla e Partisë. Kooperativistët duhet ta organizojnë e ta ngrenë gjithnjë e më lart prodhimin, pse kanë tokën e përbashkët, mjetet e punës dhe forcat e punës të përbashkëta dhe udhëhiqen me aftësi nga një pushtet demokratik me forma nga më demokratiket.

Për organizimin e prodhimit, megjithëse ky është një tjetër problem i madh, nuk do të zgjatem, por dëshiroj të them se, megjithëqë e kemi shtruar dhe deri diku po e aplikojmë parimin që planin e bën koopera-

tiva, përsëri atë e bëjmë më shumë ne, këtu lart. Prandaj duhet të mendojmë dhe të përpiqemi për të gjetur forma akoma më moderne, më demokratike e më të përshtatshme që planet ekonomike të hartohen në mënyrë të atillë që kooperativistët të thonë fjalën e vet për administrimin e zhvillimin sa më të mirë të ekonomisë së tyre të përbashkët, në kuptimin që prodhimi i ekonomisë së tyre të madhe kolektive të koordinohet e t'u përshtatet nevojave të të gjithë popullit dhe republikës.

Që të kuptohet drejt kjo çështje duhet që organizimin e prodhimit kooperativistët të mos e kuptojnë si një çështje private, siç e shikonin përpara, kur kishin ekonomitë e tyre familjare me ato dy-tre hektarë që kishin në pronësi individuale, sepse tashmë në vendin tonë është bërë një ndryshim i madh në llojin e pronësisë, kjo është shndërruar përfundimisht në një ekonomi të bashkuar socialiste. Në qoftë se sot kooperativistët marrin 20 kuintalë grurë për hektar në kooperativën e tyre, nga 7-8 ose 10 kuintalë që merrnin përpara dhe janë të kënaqur se me kaq ata i sigurojnë interesat e pronës së grupit dhe nuk përpiqen të marrin prodhim më të lartë, një qëndrim i tillë është në kundërshtim me interesat e shoqërisë socialiste. Një qëndrim i tillë tregon se ky grup kooperativistësh nuk rron me frymën e rendit tonë socialist, por tek ai mbizotërojnë akoma të forta pikëpamjet e vjetra mikroborgjeze të pronës së ngushtë private, natyrisht, në këtë rast në një masë më të zgjeruar, në masën e grupit.

Prodhimi i kooperativës, si një pjesë përbërëse e

gjithë prodhimin të bujqësisë sonë të madhe socialiste, duhet të ecë me ritmin e zhvillimit të të gjithë ekonomisë sonë shtetërore, sepse bujqësia, si një nga degët më kryesore të ekonomisë, për të cilën interesohet në mënyrë jetike mbarë populli, është e lidhur ngushtë me industrinë, me gjithë ekonominë tonë socialiste. Shteti ynë socialist nuk mund të lejojë që kooperativat bujqësore, qofshin këto të vogla ose të mëdha, të prodhojnë sipas qejfit, pra, nuk lejon decentralizimin e planifikimit, pse një gjë e tillë s'pajtohet me rrugën tonë socialiste. Shteti ynë bën bilancet, studion mundësitë reale që ekzistojnë në bujqësi dhe, në bazë të tyre, jep orientimet sa qindra mijë tonë grurë duhen për nevojat e republikës, sa pambuk, panxhar, qumësht e prodhime të tjera me radhë, dhe kooperativat bujqësore pastaj bëjnë llogari se me tokat, me mjetet e bashkuara dhe me forcat e punës që kanë etj. janë plotësisht në gjendje ta japin këtë prodhim, bile ato duhet të bëjnë përpjekje që këto shifra t'i tejkalojnë.

Kooperativistët, duke diskutuar për problemet e prodhimin, mund të thonë jo një, po shumë e shumë fjalë e mendime të vlefshme që synojnë të rritin prodhimin. Dhe pikërisht këtu, sipas mendimit tim, hyn çështja e organizimit të prodhimin. Kooperativistët gjykojnë se shteti, në bazë të tokës që disponohet, të kapacitetit ujitës, të shkallës së mekanizimit të arritur dhe të diturisë e eksperiencës së masave etj., kërkon nga kooperativa e tyre një sasi të caktuar drithi, bimësh industriale, prodhimesh blegtorale etj. Atëherë ata le t'i bëjnë vetë llogaritë për t'i plotësuar këto

kërkesa dhe e kanë për detyrë të dalin jo me një plan, po me shumë plane.

Le të marrim, për shembull, kooperativën bujqësore të Luzit të Vogël në rrethin e Durrësit. Kooperativistët aty llogaritin se, në bazë të sipërfaqes së tokës që kanë dhe të të gjitha kushteve të tjera, mund të prodhojnë drithë për të plotësuar nevojat e tyre dhe detyrën që u ka caktuar shteti në një sipërfaqe më të vogël nga sa u është caktuar dhe, tepëricën e sipërfaqes, u intereson, bie fjala, ta mbjellin me oriz, i cili në fushën e tyre jep prodhime më të mira. Me këtë ata plotësojnë kështu më mirë detyrën për t'i dhënë ekonomisë popullore drithë e oriz, realizojnë edhe të ardhura më shumë për kooperativën. Ata mund të llogaritin, gjithashtu, se u leverdis të mbjellin edhe këtë ose atë bimë, kur nuk kanë aspak interes të mbjellin një tjetër që, megjithëse u rekomandohet, nuk u bëhet mirë në tokat e tyre. Pra, vetë kooperativa, që njeh kushtet konkrete të tokës, të klimës etj., duhet të llogaritet që po ta mbjellë tokën me një bimë të caktuar, do të marrë të ardhura më shumë sesa po ta mbjellë atë me një tjetër, natyrisht, duke mbajtur kurdoherë parasysh plotësimin e detyrës ndaj shtetit. Duke vepëruar kështu, kooperativa do të arrijë të marrë maksimalen e prodhimit dhe të të ardhurave nga e njëjta sipërfaqe.

Ashtu si kooperativa e Luzit të Vogël që mora si shembull, të bëjnë të gjitha kooperativat. Kur përfundohen planifikimet në çdo kooperativë, atëherë shokët e rrethit krahasojnë këto plane me kuotat e planit që ka caktuar shteti për rrethin dhe kur rezulton se kër-

kesa e shtetit, për shembull për drithin, sipas planit që kanë bërë vetë kooperativat, plotësohet, kjo shifër vihet në plan ashtu siç e kanë bërë ato. Në rast se llogaria nuk del, atëherë fillojnë diskutimet, këmbehen mendime se ç'masa duhet të merren që rrethi të plotësojë doemos në radhë të parë kërkesat e shtetit. të mbarë republikës, dhe mbi këtë bazë t'i bëhet çdo kooperative korrigjimi i planit.

Çështja, pra, shtrohet që kooperativat dhe çdo rreth të mos mendojnë më parë për vete, por për tërë republikën. Puna këtu është që të harmonizojmë planet e kooperativave me planin e madh të shtetit. Kështu, gjatë diskutimeve dhe rrahjes së mendimeve, një kooperativë merr përsipër ta rritë prodhimin e një bime, një tjetër të një bime të dytë e kështu me radhë derisa të arrihet në plotësimin e detyrës që i ka vënë shteti rrethit.

Ne flasim shumë që planin e prodhimit duhet ta bëjë kooperativa, por në praktikë nuk ndodh pikërisht kështu, sepse kur kooperativave u dërgojmë planin, atyre u përcaktojmë jo vetëm llojet dhe sasinë e prodhimeve, por deri edhe hektarët që do të mbjellin me këtë ose atë bimë. Kështu, para se plani të dërgohet në bazë, çdo gjë është përcaktuar, zihen të tëra sipërfaqet, pa lënë asnjë arallëk që kooperativistët të kenë mundësi të thonë mendimin, të diskutojnë dhe të propozojnë. Është e drejtë një gjë e tillë? Jo, nuk është aspak e drejtë. Ne nga ana jonë justifikohemi me këtë që bëjmë, duke thënë se ka nevoja shteti. Po, shteti vërtet ka nevoja dhe të gjitha këto masa ne i marrim pikërisht që të plotësohen në radhë të parë



nevojat e shtetit, të kooperativistëve dhe nevojat e punëtorëve, por kurdoherë duhet të ndjekim rrugën më të drejtë, të mos veprojmë në mënyrë burokratike.

Që të bëhet një planifikim i drejtë në bazë, thuhet se duhen specialistë. Po i kemi ne këta njerëz? Unë mendoj se i kemi dhe në këtë drejtim insistoj shumë që vlerësimi i njerëzve tanë duhet të bëhet jo vetëm në bazë të titujve shkollorë që kanë marrë, por sidomos edhe të mendimeve krijuese që ata japin në luftën për ndërtimin e socializmit, në kooperativa, në fabrika e kudo. Vetëm se këtë nuk e bëjmë si duhet. Në qoftë se ne do ta organizojmë mirë punën me njerëzit që kemi, këta do të na japin rezultatet që dëshirojmë, pse në punë e sipër shumë njerëz do të shquhen, do të japin mendime, do të flasin me argumente përse duhet mbjellë kjo bimë e nuk duhet mbjellë ajo tjetra, e cila, megjithëse janë bërë të gjitha përpjekjet, nuk na ka dhënë frytet e duhura etj., etj.

Njerëzit që kemi në kooperativa, me shkollë, me kurse ose me eksperiencë, domethënë me një nivel përgatitjeje të diferencuar të lartë, mesatar ose të ulët, ne nuk i përdorim si duhet sipas aftësive që kanë për organizimin e prodhimit, duke filluar që nga studimet për planifikim. Në përgatitjen e planeve duhet të marrin pjesë jo vetëm kuadrot drejtues, po gjithë masa e kooperativistëve, të gjithë të njohin anët biologjike dhe agroteknike të bimëve, nevojat që kanë ato për punën që duhet bërë, për djersën që duhet derdhur, nevojat që kanë për mekanizma, për ujitje, për plehërim etj., të njohin njëkohësisht edhe leverdinë e tyre ekonomike. Të gjitha këto probleme ne nuk i kemi

shumë parasysh dhe mendojmë sikur do të na i zgjidhë vetëm një planovik, një llogaritar ose një agronom i lartë.

Në kooperativat e mëdha neve na duhet jo një planovik, po mundet edhe dy, njëri nga të cilët me arsim të mesëm, na duhen veç specialistëve të tjerë edhe dy apo tre llogaritarë, një me arsim të lartë e dy me të mesëm etj. Po ku do t'i gjejmë ne gjithë këta njerëz? Këta do t'i përgatitim në shkolla, por unë mendoj, siç propozuan disa shokë, që ne kemi plot për të qethur edhe në shumë nga ndërmarrjet tona ekonomike shtetërore të industrisë, të ndërtimit, të tregtisë etj. Nuk ka asnjë nga këto ndërmarrje, qofshin edhe të vogla, që të mos ketë dy a më shumë llogaritarë, megjithëse disa nga ato mund të bëjnë fare mirë edhe me më pak të tillë. Kështu që nga këto ndërmarrje ne duhet të tërheqim mjaft kuadro ekonomistë e llogaritarë dhe t'i caktojmë me punë në kooperativat bujqësore. Ndërsa vendet bosh që do të mbeten nëpër ndërmarrjet shtetërore, pas largimit të tyre, le të plotësohen më pas, kur të dalë herë pas here kuadri që përgatitin shkollat. Nuk është e drejtë, më duket mua, të presim derisa të përgatitim njerëzit nëpër shkolla, pastaj të plotësojmë nevojat e kooperativave bujqësore me kuadro ekonomistë, në një kohë kur janë mundësitë të sigurojmë një numër të mirë kuadros në rrugën që u tha më lart.

Nga ana tjetër, të mos harrojmë se ne kemi tani një mori njerëzish në kooperativat bujqësore që kanë jo vetëm një eksperiencë të madhe teknike dhe në punë, po edhe një kulturë më të madhe se para kolek-

tivizimit, sepse kanë bërë në masë nga 7 e 8 vjet shkollë. Midis këtyre mund të zgjidhen disa nga më të aftët që të bëjnë një kurs njëvjeçar për llogari, këshu që, në qoftë se sot në një kooperativë kemi vetëm një llogaritar, brenda 7-8 muajve mund të përgatiten aq sa na duhen atje për një organizim më të shëndoshë të veprimeve kontabël. Ne nuk duhet ta nënvleftësojmë në asnjë mënyrë gjithë këtë mori kuadrosh që punon dhe rritet në fusha, po ta ndihmojmë e ta inkurajojmë edhe për të mësuar. Partia duhet të punojë që t'u futë në shpirt gjithë kooperativistëve dëshirën për punë e për mësim dhe, që të arrihet kjo, të tërë duhet të vihen në lëvizje, ndryshe nuk mund të arrihet organizimi i mirë i prodhimit.

**3. Çështja tjetër për të cilën doja të flisja është propaganda e prodhimit.** Unë jam dakord se botimi i librave, leksionet, puna edukuese e Partisë etj., që u përmendën këtu, nuk kanë shkuar kot dhe, në fakt, kuadrot tanë edhe në fshat kanë ndryshuar shumë nga e kaluara, ata tani dinë shumë më tepër se përpara. Kur vajta javën e kaluar në kooperativën bujqësore të Luzit të Madh në rrethin e Durrësit, bisedova me një zooteknik me arsim të mesëm, një djalë mjaft i zgjuar dhe i zoti. Bazuar në një libër special që kisha kënduar para disa kohësh, i drejtova atij disa pyetje, të cilave iu përgjigj të tërave mirë, prandaj më bëri përshtypje të mirë ai djalë. Por sa ka si ai që kanë dalë nga shkollat tona! Mirëpo ua japim ne atyre atë autoritet dhe ato mundësi për të punuar dhe për të mësuar, apo tërë punën e varim te një zooteknik me arsim të lartë?

Ne mund ta organizojmë propagandën e prodhimit shumë më mirë se gjer tani, por kjo propagandë, mendoj unë, duhet aplikuar jo vetëm në bujqësi, por edhe në industri e kudo, në çdo sektor tjetër. Veç duhet bërë një propagandë konkrete figurative e me mend për të mobilizuar e për të mësuar njerëzit konkretisht, të cilëve t'u ngulim fort disa gjëra në kokë. Me anë të propagandës ne të shfrytëzojmë kapacitetet e tyre në dobi të prodhimit, pra t'i udhëheqim drejt e si duhet. Nuk është e mjaftueshme të përdoren vetëm disa parulla të thata e slogane, por të aplikohen sipas rastit parulla të nxjerra nga librat e gazetatat që lexohen, nga seminarët që bëhen, nga eksperiencat e punës së madhe dhe nga përparimet që arrihen në fusha etj. Por edhe këto nuk duhet të qëndrojnë për një kohë të gjatë, po të lëvizin, pasi t'i kenë shërbyer qëllimit për të cilin vendosen, dhe në vend të tyre të vendosen të reja, të kohës. Kjo gjë, më duket mua, nuk bëhet, megjithëse ka rëndësi shumë të madhe.

Ne flasim shumë, për shembull, për çështjen e rendimentit, të rregullit të brendshëm, të disiplinës dhe të organizimit të vogël etj. A zërthehen këto çështje në ndërmarrjet shtetërore apo në kooperativat? Mund të thuhet që po, por zërthimi në shumë raste bëhet vetëm me fjalë e në përgjithësi. Përse ndodh kështu? Sepse punëtori ose kooperativisti, edhe pas punimit të një direktive, vazhdon si dhe më parë në të tijën. Bëhet herë pas here nga një konferencë, por në praktikë pas mbledhjes jo kurdoherë shikon të merrret ndonjë masë, të bëhet ndonjë ndryshim i dukshëm, në vend që njerëzit, të gjithë pa përjashtim,

të nxiten e të drejtohen që të mendojnë për ato që dëgjuan, të marrin masa që mbi atë bazë të organizojnë më mirë punën për rritjen e prodhimit. Duhet t'u hyjë në kokë mirë njerëzve ajo që dëshiron dhe thotë Partia dhe ata të veprojnë vetë, të kenë iniciativë që t'i vënë në jetë mësimet e saj. E theksoj këtë, shokë, se, kur vizitova pikën e shëndetësisë dhe banjën e kooperativës bujqësore të Luzit të Vogël, atje nuk pashë ndonjë parullë si, për shembull, «Të lahesh në banjë, do të thotë të ruash shëndetin» etj. Ka mjaft çështje që e preokupojnë qendrën sanitare të një kooperative, atëherë pikërisht për këto duhen shkruar atje 1, 2, 3 e 5 parulla, që t'u bien në sy kooperativistëve dhe organizata-bazë të punojë e të udhëheqë njerëzit që t'i zbatojnë ato në jetë. Të njëjtën gjendje kam konsultuar kur kam vizituar disa kooperative në rrethe të tjera, klubet atje i sheh kudo të mbushura plot me pllakata të qëndisura për këtë ose për atë çështje, të cilat qëndrojnë të palëvizura motmot e dy vjet me radhë dhe kanë humbur forcën e tyre mobilizuese dhe edukuese. Propaganda, shokë, nuk bëhet kështu, prandaj këto të meta t'i zhdukim sa më parë.

Ne kujtojmë se, me të mbajtur një leksion, u vunë të gjithë në dijeni për temën që trajton ai, ose, duke botuar një libër, të tërë e lexuan dhe çështjet u kuptuan. Nuk është ashtu. Leksionet, së pari, nuk i dëgjojnë të tërë, edhe librat nuk i lexojnë të gjithë njerëzit. Ka pastaj nga ata që s'dinë si të punojnë me librin, ose shkojnë me mendimin se gjërat që thuhën në të, dihen. E dimë, — thonë disa të tjerë, — që organizimi i punës ka rëndësi të madhe, po i largohen

kësaj pune, me arsyetimin «s'kemi kohë tashti» etj. Mirë, mundet që në atë moment ata s'kanë kohë, po koha duhet gjetur që të lexohet edhe libri, të lexohen edhe materialet e tjera që botohen, të dëgjohet edhe një konferencë etj. dhe të mendohet pastaj ç'duhet bërë për ato që u lexuan ose që u dëgjuan dhe të merren masat e duhura për të shpënë përpara prodhimin. Unë përmenda disa nga format, po ka dhe shumë e shumë të tjera për ta bërë si duhet propagandën e prodhimit.

Në qoftë se shtrohet çështja që të drejta janë këto që thuhet, po për t'i vënë në jetë duhen letër, karton, bojë, duhet kështu apo ashtu, që ne nuk i kemi, sigurisht, asgjë nuk mund të bëhet. Mua më duket se të gjitha këto punë duhet t'i bëjë rrethi, t'i bëjë Partia, t'i bëjë organizata-bazë e Partisë në kooperativë që është udhëheqja më e rëndësishme e kësaj ekonomie të madhe. Ministria e Bujqësisë mund të ketë vullnet të mirë, por s'mund të futet në çdo problem, se po të veprojë kështu, do t'i mbeten pa bërë punët e tjera të rëndësishme, me të cilat duhet të merret dhe t'i zgjidhë ajo vetë.

Rrethi, mendoj unë, duhet të organizojë edhe ekspozita bujqësore, pse këto janë forma të efektshme të propagandës. Shumë e bukur është bërë ekspozita industriale në qytetin e Durrësit, ku venë me shumicë njerëz të të gjitha kategorive që e shikojnë. Edhe mua më pëlqeu ajo. Po përse nuk kanë bërë edhe një ekspozitë për bujqësinë shokët e Durrësit? Shijaku e ka bërë një të vetën e mendoj se edhe Luzi mund dhe duhet ta bëjë një si ajo, kështu duhet të bëjnë Rro-

gozhina e kooperativat e tjera dhe vetë rrethi. Bile edhe ne në qendër mund të hapim një ekspozitë bujqësore. Për një ekspozitë, rrethi që është më afër prodhimit është vetë kompetent. Ekspozita bujqësore duhet bërë dhe duhet konsideruar, si me thënë, si pjesë e propagandës konkrete bujqësore, ku njerëzit i shohin me sy realizimet e arritura, kërkojnë shpjegime dhe mësojnë si të punojnë më mirë në ekonominë e tyre kooperativiste ose shtetërore. Atje duhet të ngarkohen njerëz kompetentë që t'u japin vizitorëve shpjegime, ta zëmë, për llojin e grurit, të misrit hibrid, për mënyrat e mbjelljes etj., etj. Një punë e tillë, përveç të tjerave, duhet të bëhet sidomos në kooperativat e bashkuara.

Për të gjitha këto njerëzit dhe organizatat e Partisë në bazë, në kooperativë, duhet të mendojnë dhe të mendojnë me kokë, të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm se drejtojnë fatin e qindra familjeve dhe jo vetëm kaq, por ata e kanë për detyrë të japin kontributin e tyre edhe për gjithë Shqipërinë. Të tëra sa përmenda, pra, shokët duhet t'i zbatojnë brenda rrethit të vet, po të mendojnë e të krijojnë mundësi për t'i zbatuar kudo, edhe atje ku akoma nuk është bërë gjë; të mos kënaqen me ato forma që kanë përdorur gjer tani, por t'i përpunojnë më tej ato, t'i bëjnë më të përsosura.

Puna e propagandës bujqësore, më duket mua, nuk është e plotë. Ato që bëhen janë të mira, por duhet menduar që të plotësohen më tej me shumë forma të tjera që janë jo vetëm më praktike, por edhe më të efektshme e nxitëse. Po të shikojë kooperativisti

që brigada e tij ka mbetur më pas nga brigada tjetër që ka pranë, e cila ka përdorur disa forma pune më të mira, ku spikatin forca krijuese dhe zotësia në punë e kooperativistëve, sigurisht do të mendojë të përdorë edhe ai ato forma pune që ka aplikuar brigada fqinjë që ka arritur përfundime aq të mira.

Ne kemi theksuar se planin e kooperativës duhet ta bazojmë në rezultatet e brigadave më të përparuara. Mirëpo kjo kërkon që të njihen mirë rezultatet e këtyre brigadave, të flitet e të propagandohet për to dhe ato të ekspozohen në vende të dukshme. Sukseset e të tilla brigadave nuk i sheh kudo të afishuara, bile shpesh as në vetë kooperativën ku punon një brigadë e tillë, pa lëre pastaj në rreth. Duhet të ekspozohen, shokë, dhe me portrete, me fotografi e me grafikë të mëdhenj në qendër të kooperativës e të rrethit, rezultatet pozitive të brigadave më të mira. Kështu, për shembull, me t'u përhapur lajmi në rrethin e Durrësit se një nga brigadat e Luzit të Vogël ka marrë rreth 70 quintalë oriz për hektar, fotografia dhe rezultatet e saj duhet të ekspozohen sa një penxhere në qendër të kooperativës dhe të rrethit, gjë që do të vlejë patjetër si një mjet nxitës për të gjitha brigadat e tjera që merren me kultivimin e kësaj bime. Kjo është një propagandë konkrete, po s'e bëjmë. Mos vallë humbim gjë po ta bëjmë? Asgjë, përkundrazi do të fitojmë shumë.

Ne themi që planet tona duhet të bëhen në shembullin e më të mirëve dhe kjo është shumë e drejtë, vetëm duhet të gjejmë format më të përshtatshme të propagandës së prodhimit, që rezultatet e të përparuarve të njihen nga të gjithë. Në këtë drejtim ka



shumë forma, të cilat duhen shfrytëzuar, po forma pastaj lind formën, rezultati na jep rezultatin dhe na nxit për mendime të reja më të përparuara. Prandaj thashë që në fillim se çdo gjë bën evolucionin e vet dhe e reja zëvendëson kudo dhe kurdoherë të vjetrën.

Këto kisha për të thënë për sa u përket organizimit të punës, organizimit të prodhimit dhe propagandës së prodhimit.

Dua të shtoj dhe diçka për disa gjëra që u thanë këtu.

Ne duhet t'u japim zgjidhje të drejtë dhe gjer në fund problemeve, prandaj, kur i futemi, për shembull, kullimit të një fushe, ta bëjmë këtë punë plotësisht, të mos kthehemi më, t'i themi mbetsh me shëndet dhe ta punojmë që të na japë grurë, misër etj., pastaj t'i futemi tjetrës dhe këtë, gjithashtu, derisa ta përfundojmë e jo të veprojmë siç po shohim.

Mendimi im është që fusha të tilla, si ajo e Krujës, nuk duhet të lihen pa kulluar deri në fund të vitit 1975, por të zgjidhet çështja e shtesës së kapacitetit të hidrovorit, me qëllim që këto toka të mos na përmbysten. Tokat e fushës së Krujës dhe të Lezhës sidomos, ku kemi bërë investime të mëdha, duhet të kishim marrë të gjitha masat që të kulloheshin, përpara se të vendosnim hidrovoret në tokat e Hoxharës e gjetkë. Ne kemi thënë se i kemi kulluar tokat e këtyre dy rrethëve, ndërsa ato janë mbytur në ujë, prandaj për to duhet të bëjmë akoma punime. Zvarritja në këtë drejtim nuk është ekonomike, prandaj të procedojmë më seriozisht për këto çështje.

Për sa u përket çështjeve të tjera që u ngritën gjatë diskutimeve, ministri i Bujqësisë dhe shokët e tjerë anëtarë të Qeverisë mendoj se duhet të shkarrohen nga shumë gjëra, të cilat, ndonëse janë probleme të bujqësisë, nuk u përkasin atyre t'i zgjidhin, por rretheve. Në qoftë se ju, shokë ministra, do të futeni kudo e do të përpiqeni të merreni me gjithçka, nuk do t'ia dilni dot punës, përkundrazi, do të detyroheni të lini pas dore problemet kyç, për të cilat ju kërkohet juve t'i zgjidhni. Prandaj komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve le të merren më mirë me punët që u takojnë. Kështu, për shembull, për prodhimin e qerreve dhe të karrocave, që bëjnë fjalë, duhet të kujdesen ato. Ne kemi theksuar vazhdimisht që duhet të prodhohet mjete të tilla, mbasi jemi në deficit të madh në fushën e transportit, mirëpo shohim se nuk po bëhet gjë. Të themi, për shembull, që nuk kemi izotope, e kuptoj, por që s'kemi rathë, s'kemi hekur, nuk kemi këtë ose atë material për një nevojë si kjo, nuk është aspak e drejtë. Ne jemi shtet dhe i kemi të gjitha mundësitë për ta plotësuar këtë nevojë, vetëm këto duhet t'i parashikojmë mirë. Ministria e Bujqësisë në këtë rast do të marrë nga secili rreth nevojat që ai ka, fjala vjen, për hekurin që duhet për prodhimin e këtyre mjeteve dhe të kërkojë në Qeveri që ky të planifikohet e të sigurohet. Por në qoftë se Qeveria nuk ka mundësi dhe siguron, ta zëmë, vetëm gjysmën e nevojave që paraqiten në fakt, atëherë ajo duhet ta bëjë drejt shpërndarjen e sasisë që do të vijë për çdo rreth, në përpjesëtim me kërkesën e paraqitur nga secili. Për pjesën e kërkesave

që nuk ka mundësi të plotësohet, ministria duhet t'i njoftojë rrethet, në mënyrë që këta të bëjnë vetë përpjekje për t'i siguruar me aq sa do të munden. Kur kërkesa e planifikuar nuk i plotësohet rrethit nga Ministria e Tregtisë, secili rreth si porosites të interesohe, gjithashtu, vetë pranë këtij dikasteri dhe jo Ministria e Bujqësisë. Ka shumë gjëra të tilla që ju pengojnë ju, shokë ministra, të merreni me problemet më të rëndësishme, prandaj studiojeni dhe rregullojeni më mirë metodën e punës suaj. Mendoj se nuk është e drejtë praktika që shpesh ministrat kritikohen e u kërkohet llogari personalisht atyre për gjëra të vogla të sektorëve të tyre, për të cilat duhet të përgjigjen të tjerë shokë brenda dikastereve ose organeve përkatëse në rrethe e në bazë. Duhet t'u lëmë më tepër kohë kuadrove kryesorë të merrin me studimin dhe me kontrollin e problemeve të mëdha sesa me verifikimin edhe të gjërave më të vogla, për të cilat ministrat e organet qendrore të Partisë e të shtetit duhet të vënë në lëvizje më shumë e më mirë njerëzit e bazës. Duke vepruar në këtë mënyrë, do të ngrihet dhe më mirë përgjegjësia, si edhe shkalla e organizimit të punës në bazë. Këto çështje ne i kemi thënë ngahera, puna është që të veprohet drejt e si duhet në praktikë dhe sa më parë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 284. Tiranë, 1970*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# TI SHFRYTËZOJMË MË MIRË MUNDËSITË PËR EDUKIMIN E PUNONJËSVE TË KRIJIMTARISË LETRARO-ARTISTIKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 mars 1970

Jam dakord me vërejtjet dhe me diskutimet e shokëve Ramiz Alia, Manush Myftiu, Rita Marko e Dhimitër Shuteriqi, por, për sa i përket raportit, kam disa vërejtje, se më duket se ai është ca i njëanshëm dhe i shkruar në një mënyrë të atillë që të arsyetojë kërkesat. Ato që janë diskutuar në komision, unë nuk i di, pse nuk figurojnë në raport, prandaj për çka do të flas bazohem në ato që përmban raporti.

Më duket se në raport lihet të kuptohet sikur edukimi i përgjithshëm ideologjik dhe politik i kuadrove të krijimtarisë letraro-artistike e të masave që

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga sektori i edukimit i KQ të PPSH «Mbi disa probleme e masa për edukimin marksist-leninist dhe përgatitjen profesionale të kuadrove të krijimtarisë, si dhe mbi punën me talentet e reja».

merren me këtë lloj veprimtarie është pa efekt të madh për edukimin e tyre estetik-tekniko-profesional. Ky vlerësim, sipas mendimit tim, është i shtrembër dhe joreal. Nuk është ashtu as ajo që kërkohet të arsyetohet në raport ku thuhet: «...edukimi estetik dhe tekniko-profesional masiv dhe i pandërprerë pothuajse i është nënshtruar spontaneitetit».

E para, në këtë krijimtari kaq të frytshme, të gjerë dhe të mirë, unë mund të them se nuk ka ekzistuar spontaneiteti. Do të jetë gabim që iniciativën dhe rritjen me hov revolucionar të krijimtarisë, që janë vërtetuar te ne në jetë, në sajë të një pune të gjatë dhe të frytshme, t'i quajmë spontaneitet, domeñhënë të paorientuar, të padrejtuar, të pafrymëzuar nga vija dhe nga politika e Partisë. Dhe kur them nga vija e nga politika e Partisë, kam parasysh të gjitha diskutimet që bëhen, të gjitha mjetet që janë vënë në dispozicion. Edhe në këtë rast kam parasysh, po ashtu, në radhë të parë, njerëzit e shumtë që merren me krijimtari. Zotësitë e tyre nuk duhen nënvleftësuar dhe as të neglizhohen.

Shokët që kanë formuluar raportin shprehin dëshirën që të thellohet edukimi estetik e tekniko-profesional i punonjësve të krijimtarisë. Për këtë jam dakord edhe unë. Por në këtë drejtim nuk qëndrohet duarlidhur, mbasi për edukimin tekniko-profesional dhe etik marksist-leninist të punonjësve të krijimtarisë është duke u punuar vazhdimisht. Veçse mua më duket se shokët që kanë bërë raportin tregohen ca si shumë «estetë», në kuptimin jo të shëndoshë të fjalës. Ata nuk janë të kënaqur nga gjithë ky zhvillim i

vrullshëm dhe i drejtë, për të cilin po punohet konkretisht. Veç kësaj, për ngritjen profesionale, teknike dhe estetike të punonjësve të krijimtarisë po hapen kurse, zhvillohen seminare dhe zbatohen shumë forma të tjera pune, prandaj unë nuk mund të jem plotësisht i një mendimi me ta në këtë çështje, ne nuk duhet të kërkojmë «estetë» në një kuptim jo të drejtë.

Mund të më thonë se i kam keqkuptuar, mbasi ata nuk mendojnë që në veprimtarinë krijuese të punonjësve tanë të artit, të letërsisë etj. mungon estetika tekniko-profesionale marksiste-leniniste. Ashtu qoftë, që ta kem kuptuar gabim unë, por mendoj, dhe këtë e them me plot bindje, se krijimtaria jonë ecën drejt në rrugën marksiste-leniniste dhe në çdo drejtim të kësaj krijimtarie ka gjëra shumë të bukura.

Ne edukojmë të rinj me frymën e estetikës marksiste-leniniste, në universitet kemi një fakultet ku studiohet për letërsi, kemi Institutin e Lartë të Arteve ku përgatitim kuadro për teatrin, për muzikën etj. A nuk mësohet këtu për estetikën marksiste-leniniste? Pastaj punonjësit tanë të krijimtarisë kanë mësuar në shkolla, po ata kanë mësuar edhe jashtë shkollës. Vetë zhvillimi i vrullshëm i krijimtarisë së tyre ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Ky zhvillim ka çënë dhe është një shkollë e madhe për ta. Prandaj as lëvizja as ngjitja, as kalitja e estetikës marksiste-leniniste dhe as përparimi tekniko-profesional i punonjësve të krijimtarisë nuk duhen parë vetëm me syrin e një «intelektuali estet» apo vetëm në rrugën shkollareske.

Ne do të gabohe mi në rast se mendojmë që literatura dhe artet e huaja borgjeze e revizioniste, me

ideologjinë e tyre reaksionare, me estetikën e tyre dekadente, me qëllimet e tyre shkatërruese të vlerave më të mira dhe më të pastra të shoqërisë, nuk influencojnë edhe te punonjësit tanë të krijimtarisë jo të kalitur si duhet ideologjikisht dhe politikisht. Letërsia dhe artet janë një terren shumë i ndjeshëm e i prekshëm, prandaj lufta e klasave kundër mendimeve reaksionare, si në brendi, ashtu edhe në formë, si kudo, ca më shumë është e domosdoshme të zhvillohet edhe këtu, bile me vigjilencë të madhe. Por ta bësh këtë luftë klasash duke krijuar klasifikime që nuk janë të justifikuara, nuk është reale, për arsye se ideologjia e Partisë dhe lufta e saj revolucionare i kanë transformuar gjërat, kanë transformuar në radhë të parë njerëzit dhe kanë krijuar kështu botëkuptime të reja edhe te «njerëz me shkolla të ndryshme, por edhe me përvojë të madhe», siç përcaktohen në raport. Çdo gjë duhet t'i përgjigjet gjendjes, realitetit objektiv, mbi të cilin duhet të punohet për të sjellë përmirësime të mëtejshme cilësore.

Asnjë pesimizëm nuk duhet lejuar te njerëzit e Partisë, as te të vjetrit, as te të rinjtë. Karakteri i njerëzve farkëtohet dhe dituria fitohet. Natyrisht, kjo nuk arrihet as në një ditë, as në një vit. Punonjësit e krijimtarisë, si gjithë të tjerët, mund të bëjnë edhe gabi-me, ata mund të nxjerrin edhe vepra të dobëta nga ana estetike, bile nganjëherë edhe nga ana politike. Po vallë duhet të na dëshpërojë një gjë e tillë? Jo, aspak! Duhet të na bëjë kjo që të dalim me konkluzionin se niveli i estetikës marksiste-leniniste te ne është përtokë? Jo, aspak! Duhet të na bëjë kjo që të

themi se shokët tanë të krijimtarisë s'kanë haber nga ana tekniko-profesionale? Jo, aspak! Ne këto të meta e gabime duhet t'i korrigjojmë.

Përse i them këto? I them se intelektualët tanë të organizuar në Parti e kanë ca prirjen e intelektualizmit dhe, për t'u treguar të rreptë, deri diku i nxijnë çështjet. Një gjë e tillë nuk ngjet me punëtorët. Këta nuk e nënvleftësojnë punën e punëtorit të ri. Më ka qëlluar në shumë raste që kam pyetur punëtorë me një stazh të vjetër pune se si punon ky ose ai punëtor i ri që kanë pranë tyre dhe më janë përgjigjur se ai punon mirë, mëson, do të përparojë etj. Punëtori me përvojë të madhe vlerëson drejt dhe realisht se punëtorit të ri, që të arrijë perfeksionin, do t'i duhen akoma shumë e shumë vjet pune, do t'i duhet të kryejë njëkohësisht edhe kurse e shkolla, ndërsa kjo nuk ndodh kështu me intelektualët. Në rast se një prozë apo një poezi nuk është e nivelit letraro-artistik të Dhimitër Shuteriqit, të Ismail Kadaresë ose të Nonda Bulkës, përnjëherësh intelektual i thotë se kjo nuk është gjë; ai harron kështu se ajo që tani është diçka, nesër do të jetë më e mirë dhe pasnesër mund të jetë njëlloj si e shkrimtarëve me përvojë të madhe. Pra, si në çdo fushë, edhe në atë të krijimtarisë e të talenteve përparimi është çështje kohe dhe eksperience.

Në raportin që na paraqitet ka një sërë çështjesh, shumë prej të cilave janë të njohura e për to janë marrë edhe vendime që duhen zbatuar. Përse të mos ndiqet shembulli i rrethit të Shkodrës dhe i atij të Durrësit për krijimin e kurseve të shkurtra tre dhe gjashtëmuajore për studimin e estetikës marksiste-lenin-



niste pa shkëputje nga puna? Derisa shihet që këto kurse ndihmojnë, dhe në fakt ndihmojnë për ngritjen e elementit të ri të krijimtarisë, përse nuk krijohen të tilla edhe në rrethe të tjera?

Mbase gabohem, por ka raste që ndonjëri mund të kryejë edhe një shkollë speciale për të dalë estet, kritik apo shkrimtar e megjithatë mund të mos bëhet i tillë. Edhe e kundërta mund të ngjasë, që mund të jesh shkrimtar, aktor, muzikant, mund të jesh filozof marksist-leninist etj. me shkollë, por mund të kesh prirje e talent dhe nesër të bëhesh një kritik i mirë dhe i talentuar në gjinitë përkatëse, pa pasur shkollën speciale. Të kuptohemi, unë nuk jam kundër shkollës për këto specialitete, por nuk jam i mendimit të themi që nuk kemi njerëz, specialistë të ngritur për të orientuar dhe për të ndihmuar përgatitjen e kuadrove të zotë për sektorët e krijimtarisë artistike. Është e vërtetë se e kemi ca vështirë në këtë fushë, sidomos në fushën e kritikës letrare, muzikore etj., por kjo gjë të vlerësohet si një detyrë që duhet plotësuar. Mendoj se ka shumë njerëz të zotë që mund të bëhen kritikë të tillë, por kritikën nuk e kuptojnë politikisht si duhet dhe sa e nevojshme është. Kritika duhet parë e duhet bërë si një punë konstruktive që edukon, ndreq e perfeksionon dhe jo si një punë «destruktive, pse prish qejfin e njërit dhe të tjetrit».

Në një nga pikat e raportit flitet se akoma «nuk kemi ndonjë studim për tiparet e realizmit socialist te ne, për fizionominë kombëtare të artit tonë» etj. Mua më duket se ky afirmim nuk është plotësisht i drejtë. Sigurisht, ndonjë studim të plotë mund të mos

ketë, siç mendojnë shokët që e kanë shkruar, të cilët kanë patjetër edhe planin, edhe tezat se si duhen trajtuar këto çështje. Atëherë ç'pritni, shokë? Ne ju rekomandojmë ta bëni këtë studim, prandaj merreni përsipër dhe me afate të caktuara nxirreni, se kjo nuk shoh të figurojë gjëkund si detyrë për ta kryer. Është e lehtë të thuash se nuk kemi, por është më e vështirë të thuash do ta bëjmë. Kush do t'i bëjë këto gjëra? Unë nuk jam dakord me sa thoni ju se nuk ekzistojnë studime të tilla te ne, pse për realizmin socialist etj., etj. ka vite që po shkruhet. Në qoftë se e shtroni problemin për ndonjë manual të thelluar që nuk ekziston, atëherë dakord, bëjeni!

Gjithashtu nuk jam shumë dakord të shkëputen shumë njerëz nga puna, sidomos intelektualët, kurse jam dakord që për përgatitjen e njerëzve të këtij sektori të organizohen kurse tre ose gjashtëmujore pa shkëputje nga puna dhe kjo duhet të bëhet.

Po të jetë nevoja, unë nuk kam kundërshtim as për të dërguar qoftë edhe 10 veta me shkëputje nga puna në shkollën e Partisë «V. I. Lenin» për të mësuar estetikën marksiste-leniniste, po që të mbledhim e të dërgojmë 40-50 veta me shkëputje nga puna për një vit, mendoj se nuk duhet ta marrim këtë masë. Mund të vendosim që Shkollën e Partisë ta ndjekin pa shkëputje nga puna shumë shokë të lëmit të krijimtarisë letraro-artistike, por pasi të përgatitet mirë programi, ndryshe mund të venë atje dhe të mos mësojnë atë lëndë për të cilën ne i dërgojmë.

Mendoj, gjithashtu, se përderisa në universitet mësohet për letërsinë dhe për filozofinë marksiste-

-leniniste, ç'është nevoja të çelet edhe një kurs specializimi 1-2-vjeçar me lëndë të veçanta, sikundër propozohet në raport? Nuk mund të shtohet atje edhe ajo lëndë që mungon?

Ideja ime është se ka një ton ca pesimist në paraqitjen e nevojave, për zgjidhjen e të cilave nuk propozohen rrugët më praktike e më të efektshme. Sot kemi shumë më tepër kuadro e mundësi nga ç'kishim dje. T'i organizojmë e t'i ndihmojmë më mirë këta kuadro, t'i shfrytëzojmë më mirë të gjitha mundësitë që kemi, të aktivizojmë të gjitha institucionet kulturo-artistike për një punë më të thellë e të organizuar për edukimin ideoestetik e tekniko-profesional të punonjësve të krijimtarisë letraro-estetike.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# PROPAGANDA E PARTISË I BËN TË NDËRGJEGJSHËM, I NXIT DHE I MOBILIZON NJERËZIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 mars 1970

Për realizimin e detyrave që kemi përpara është e domosdoshme të bëhet edhe propagandë prodhimi. Po si bëhet konkretisht kjo propagandë, në se konsiston dhe si është organizuar? Kam përshtypjen që në këtë drejtim vetëm thuhet fjalë, se në të vërtetë një propagandë e gjithanshme, për shembull, për pambukun, nuk ekziston dhe shokët drejtues të rretheve nuk kanë menduar që të organizojnë mirë propagandën për ekonominë. Ata, me sa duket, e quajnë të panevoj-

---

1 Në këtë mbledhje u mor në shqyrtim raporti i paraqitur nga Ministria e Bujqësisë «Mbi punën e organeve të pushtetit e të Partisë për sigurimin dhe plotësimin e detyrave në lëmin e drithërave të bukës dhe të bimëve industriale për vitin 1970» dhe u dëgjuan sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve Shkodër, Krujë, Elbasan, Fier dhe Lushnjë, që raportuan për këtë problem.

shme marrjen e masave në këtë drejtim, sepse i konsiderojnë të njohura nga të gjithë njerëzit problemet ekonomike. Si nuk qenka e nevojshme një gjë e tillë? Kemi vite me radhë që po flasim për propagandën e prodhimit dhe shokët e rretheve nuk bëjnë përpjekje për ta organizuar më mirë këtë punë për drithin, për pambukun, për perimet etj. Nuk them që ata s'bëjnë përpjekje dhe nuk marrin masa për realizimin e detyrave në bujqësi, por këto nuk i shoqërojnë edhe me propagandën e nevojshme.

Në rreth e në bazë, para çdo procesi pune në prodhim, para çdo veprimi duhet të fillohet me shpjegimin e çështjes, domethënë të bëhet propagandë dhe propagandë intensive. Kjo është e domosdoshme për të armatosur njerëzit me direktivat e reja që nxjerr Partia, që këta pastaj të venë në punë të armatosur për të vepruar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe plotësisht të qartë për atë që duhet të bëjnë. Prandaj, porsa fillon procesi i një pune, duhet të fillojë njëkohësisht edhe propaganda për të, bile kjo duhet të prijë në çdo punë. Për të marrë, për shembull, prodhime të mbara në pambuk, është e nevojshme të bëhet propaganda përkatëse, duke filluar nga propaganda për kullimin e tokave që do të mbillen me pambuk, që njerëzit ta kuptojnë përse duhet kulluar ajo dhe të mobilizohen për kryerjen me cilësi të lartë të këtij procesi pune. Kështu, gjithë masa e punonjësve që caktohet të merret me këtë punë, mobilizohet dhe shkon në luftë, si me thënë, me krehurin plot fishekë. Pra, kur t'i bëhet e qartë kooperativistit domosdoshmëria e kullimit të tokës, ai do të dijë si ta kryejë

këtë punë. Pas kësaj vijnë procese të tjera pune, ta zëmë, ai i lëvrimit të tokës dhe i mbjelljes së farës së pambukut. Edhe këto procese duhet t'i shoqërojë propaganda përkatëse me forma nga më të ndryshmet, me qëllim që kooperativistit t'i hyjë si gozhdë në kokë domosdoshmëria për t'i kryer ato si duhet dhe në kohën optimale, ndryshe nuk do të kemi prodhim të mbarë. Veprimtaria propagandistike e Partisë është një zinxhir i tërë, që i bën të ndërgegjshëm, i nxit e i mobilizon njerëzit, është, pra, një punë e rëndësishme edukative.

Mirëpo si bëhet propaganda për problemet ekonomike në praktikë? Shokët e bazës, kur kanë kohë të lirë, edhe pse puna për mbjelljen e pambukut do akoma, ta zëmë, 4-5 muaj që të fillojë, i mbledhin kooperativistët për t'u bërë nga një konferencë për këtë bimë, në një kohë që ata mendjen e kanë në probleme të tjera. Edhe një njeriu me nivel më të ngritur kulturor nuk do të mund t'ia tërheqësh vëmendjen për një problem, për të cilin duhet mobilizuar pas një kohe të gjatë. Mund të thuhet se kooperativa e organizon këtë punë kur ka kohë, mirëpo kur kooperativisti s'e ka mendjen te pambuku, se ka grurin përpara, fjalët do t'i hyjnë nga një vesh dhe do t'i dalin nga tjetri. Duke vepruar në këtë mënyrë, propaganda nuk ka efekt dhe punët nuk bëhen si duhet.

Propaganda në prodhim nuk është diçka në erë. Ajo duhet organizuar në kohën e duhur dhe të përputhet me ngritjen e nivelit kulturor të njerëzve tanë, që këta të mos e kuptojnë atë si një parullë të thjeshtë, po si një detyrë me shumë përgjegjësi. Kur

mendohet, për shembull, të hapet një kurs për pam-bukun, kjo punë të shkallëzohet në disa momente apo data të caktuara, që t'u përshtaten proceseve të kësaj bime. Një gjë e tillë është e domosdoshme të mbahet parasysh në kushtet e ngritjes intelektuale të fshata-rësisë sonë kooperativiste, e cila ka nevojë ta ketë të freskët atë mësim që do të marrë në kurs, për shem-bull, për ujitjen, që, kur të vejë në fushë, ta lidhë me praktikën.

Arsyetimi se në dimër shokët janë më të lirë të merren me propagandën e prodhimit e ka burimin te mungesa e planifikimit dhe e harmonizimit të drejtë të punëve gjatë gjithë vitit, te mosnxjerrja e detyrave për çdo veprim për t'i lidhur si duhet propagandën me praktikën, fjalët me veprat. Po të mendojmë me kohë për detyrat dhe të veprojmë kështu, atëherë njerëzit në kooperativat bujqësore do të jenë të ngarkuar një-lloj dhe në mënyrë normale si në dimër, edhe në behar, si në pranverë, edhe në vjeshtë e s'do të ketë arsye të bëhen shumë konferenca dhe vetëm në dimër. Pastaj, duhet pasur parasysh se, po t'i thërresësh nje-rëzit vazhdimisht në konferenca, do t'u bëhet koka dauille. Kooperativistin duhet ta mësojmë si në shko-llë, ku nxënësi nuk detyrohet të mësojë ditë e natë, për tre muaj rresht, vetëm histori apo gjeografi. Një veprim i tillë është antipedagogjik, pra jo i rekoman-dueshëm.

Ju shokë të rretheve mund të keni më shumë eksperiencë në praktikën e këtyre punëve, po mendimi im është që ne e kemi për detyrë të mendojmë më thellë për këto çështje, të bëjmë një punë me cilësi

më të lartë, të kualifikojmë njerëzit sistematikisht në teori dhe në praktikë. Në rast se kooperativistit do t'i flitet, për shembull, për rëndësinë e prashitjes së grurit ose të rrallimit të misrit, të ncsërmen, ose e shumta të pasnesërmen, ai duhet të shkojë në arë që të prashitë apo të rrallojë, se atëherë e ka kokën plot, di përse e bën atë punë, kurse po t'i thuhën këto gjëra gjashtë muaj para se të vejë të punojë konkretisht në terren, do t'i ketë harruar, asgjë nuk do t'i ketë mbetur në mendje nga ato që i janë thënë, pra një propagandë e tillë nuk e bën efektin e duhur. Çdo lloj bime ka një shkencë të sajën, e cila u duhet bërë e njohur në kohë punonjësve përkatës, para se të fillohet nga puna.

Në rrethe organizohen seminare dhe aktivitete të tjera, format dhe mënyrat e organizimit të të cilave pak a shumë i dimë. Por a bëhen mbledhje specialishtësh kompetentë dhe punonjësish të dalluar për të rrahur probleme të tilla kyç të bujqësisë, siç janë, për shembull, natyra e tokës, e rrethit, ndryshimet që janë bërë në secilin rreth në strukturën e tokave, efektet e punimit, të kullimit, të punës etj.? Nuk e kam fjalën për mbledhjet që bëhen në formë të zakonshme dhe rutinë, ku mbahet një referat nga ndonjëri dhe të tjerët vetëm dëgjojnë, por mbledhje shkencore, ku njëri nga specialistët shtron, fjala vjen, problemin e transformimit të strukturës së tokave në rreth, tregon se në ç'gjendje janë këto toka dhe ç'do të bëhet më tej me to për të përmirësuar strukturën e tyre etj. Specialisti jep vetëm mendimin e tij për këtë çështje, mirëpo, duke qenë shumë i madh problemi i tokave,



fjala e referuesit nxit të tjerët, prandaj fillojnë debate dhe arrihet në disa konkluzione të përshtatshme, del pasqyra e vërtetë e gjendjes së tokave, përcaktohet se në cilën prej tyre duhet mbjellë shpejt e në cilën më vonë, kur duhet punuar toka e një zone dhe kur ajo e tjetrës, qysh duhet kryer ky ose ai proces pune etj. Mbledhje të tilla mbase bëhen në rrethe, por këtë eksperiencë ne duhet ta përgjithësojmë dhe ta ligjësojmë për një periudhë dhe jo për tërë jetën.

Më vonë mund të bëhet një mbledhje tjetër lidhur me tokat që u studiuan, për të cilat u dhanë mendime dhe u arrit në disa konkluzione, ku të diskutohet për llojet e bimëve që duhen mbjellë në to. Llojet e bimëve të planifikuara për t'u mbjellë, ta zëmë, në këto ose në ato toka të rrethit të Lushnjës, nuk janë plotësisht e tërësisht të arsyeshme në këtë gjerësi, sepse, në bazë të studimeve të bëra më parë nga specialistët e rrethit lidhur me terrenin, me sasinë e plehut, me forcat e punës e me faktorë të tjerë, dhe nga rezultatet e arriatura, del që kjo çështje ekonomikisht nuk është e leverdishme dhe duhen bërë disa ndryshime. A organizohen në rrethe të tilla mbledhje për përgjithësimin e eksperiencës, nga të cilat të dilet pastaj me disa konkluzione? E përsëris, nuk e kam fjalën për mbledhjet që bëhen në format e zakonshme, por për mbledhje ku specialistët të diskutojnë dhe të dalin me disa konkluzione për llojet e bimëve të planifikuara, nëse është ekonomike mbjellja e tyre apo jo. Sesionet shkencore që organizohen nëpër rrethe, fjala vjen, për pambukun, për duhanin etj., janë tjetër dhe nuk e japin një gjë të tillë, kurse në këto mbledhje mund të diskutohet, për

shembull, çfarë spostimesh duhen bërë në këtë apo atë lloj bime, me qëllim që rrethi jo vetëm ta realizojë planin, po edhe ta tejkalojë, bile në kushte shumë më të favorshme dhe jo vetëm në një lloj bime, por në disa, për arsye se e kemi studiuar këtë në bazë.

Dihet se shteti ka nevojë për një sasi të caktuar pambuku dhe orizi, që ne e importojmë. Në qoftë se rrethi i Lushnjës, për shembull, mendon se ka më tepër leverdi të mbjellë oriz në një pjesë të sipërfaqes së caktuar për pambukun, dhe nga bilanci që bën kur i dërgohet plani del që me sasinë e prodhuar në këto toka mund të importohet një sasi më e madhe pambuku, atëherë të shikohet mundësia e uljes së planit të pambukut për këtë rreth. Rrethi të lejohet t'i bëjë këto llogari pa e futur në çështjen e çmimeve që mund të kenë në tregun ndërkombëtar orizi e pambuku, se po e futëm në to, duke i thënë se nuk lëvizim nga ky plan, atëherë nuk ecim në rrugë të drejtë dhe janë vetëm llafe ato që themi se kooperativa bujqësore mund të mbjellë sipas dëshirës. Si mund të pretendojmë për një gjë të tillë kur asaj i thuhet nga qendra ç'sasi pambuku, misri, orizi etj. duhet të mbjellë dhe porositet që të mos lëvizë prej tyre? Të mbjellësh sipas dëshirës nuk do të thotë të bësh sipas kokës, por të udhëhiqesh nga dëshira për ta plotësuar më mirë planin e shtetit, bile për ta tejkaluar.

Ne duhet t'i mësojmë kooperativistët dhe veten që të mendojmë e të punojmë. Çështja është të mësohen kooperativat të punojnë për interesat e përgjithshëm të shtetit mbi bazën e centralizmit të planifikimit, veçse jo të një centralizmi të diktuar nga dëshirat

e qendrës, por të diktuar nga interesat e shtetit. Të mbjellim çfarë prodhon toka më shumë dhe mundësitë e prodhimit më të mirë të tokës i di baza, kurse kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit nuk e lejon rrethin e Lushnjës ta pakësojë sipërfaqen e pambukut, sepse ky s'bëhet në rrethe të tjera. Kjo që thotë Abdyl [Këllezi] s'është arsye, se unë s'e kam fjalën thjesht për pambukun, por për të gjitha llojet e bimëve. Ne e dimë që luledielli bëhet edhe në Tiranë, atëherë pse nuk e mbjellim? Dimë që soja bëhet fare mirë në tokat tona, atëherë pse nuk e mbjellim? Dimë, gjithashtu, fare mirë që shumë lloje makinash mund të bëhen në vend, atëherë përse nuk i bëjmë? Kjo është serioze, prandaj të mos vëmë pyetjen: Po të mbjellim oriz, ku ta gjejmë pambukun? Unë nuk diskutoj për ekstreme, që do të prodhojmë ose jo pambuk, siç thotë Abdyl Këllezi. Pambuk do të prodhojmë, por çështja nuk shtrohet kështu. Në rast se duam të prodhojmë pambuk dhe bimë të tjera, të cilat na leverdisin, atëherë t'i vihemi punës.

Këtu nuk është fjala të bëhen propozime për ndryshimin e planit, siç tha Pirro Dodbiba, i cili e kuptoi keq mendimin tim. Ajo që tha ai është një problem, por çështja e bukës ka në vetvete shumë probleme. Për prodhimin e bukës në vend interesohet gjithë populli, gjithë kooperativistët dhe specialistët. Ministria e Bujqësisë paska bërë konsulta me specialistë e me njerëz të tjerë që merren me prodhimin, por problemet kyç që kanë dalë prej tyre dhe që na interesojnë, nuk ia ka shtruar Byrosë Politike, që të shohim qartë ku e kemi mirë punën dhe ku nuk e kemi, në ç'drej-

tim duhet të marrim masa për ta zgjidhur më mirë problemin e drithërave të bukës etj. Shtrimi i këtyre çështjeve na duhet dhe na vlen më tepër se një informacion i thjeshtë, fjala vjen, për të na informuar për parashikimin e kohës. Informacione të tilla na kanë ardhur vazhdimisht dhe të dhënat e paraqitura në to i njohim, prandaj në mbledhjen e Byrosë Politike duhet të na bëhen propozime, të na thuhet çfarë mendojnë punonjësit e kualifikuar për zgjidhjen e disa problemeve konkrete që lidhen me drithërat e bukës dhe të mos na flitet në përgjithësi për çështje të planit.

Pak më parë, për shembull, këtu u tha që erdhi dhe u shpërnda fara hibride. Jo vetëm problemi i farës hibride, që importuam, por edhe ai i farës në përgjithësi është një problem i madh. Për këtë faktor vendimtar të prodhimit të drithërave të bukës ministri i Bujqësisë mund të na flasë posaçërisht në një mbledhje të Byrosë Politike, ku të na shpjegojë çfarëra gruri kemi, ç'rezultate na kanë dhënë etj. Kur vjen këtu ministri i Bujqësisë, më parë të na flasë për drithërat e bukës, pastaj për lulediellin, për shiun etj. Çështja e drithërave është e koklavitur, por ai mund të diskutojë vetëm për dy-tri gjëra që janë vendimtare.

Për farën e pambukut dhe për shkaqet e mosrealizimit të prodhimit kam dëgjuar se ka shumë mendime. Ministria e Bujqësisë, siç na kanë thënë, për këto çështje ka bërë analiza, konferenca, aktive e sesione shkencore, kurse ministri i Bujqësisë sot në mbledhjen e Byrosë Politike s'e zuri fare në gojë farën e pambukut. A nuk do të ishte mirë që problemet e ngritura në mbledhjet e organizuara për pambukun të na shtro-

heshin edhe neve? Propozoj që jo vetëm në Byronë Politike, por edhe në Qeveri informacionin e thjeshtë dhe gjërat e vogla t'i lëmë mënjanë e të kapemi pas problemeve kyç që na interesojnë. Ka shumë rëndësi kur shtrohet dhe analizohet thellësisht çështja, pse atëherë bëhen debate dhe konkludohet drejt. Kur unë ngrita këtu disa çështje të planit, shpërthyen diskutimet, prandaj është më mirë të ngrihen çështjet kështu sesa në mënyrë rutinë. Ne, shokë, në mbledhjet që bëjmë duhet të diskutojmë e të rrahim mendimet tona.

Për shembull, do të na interesonte të dinim nëse bëhen studime në lidhje me farërat e grurit që kemi në përdorim. A studiohet ç'duhet të bëhet që fara e grurit të arrijë me të vërtetë peshën e nevojshme, të ketë përqindjen e duhur të amidonit, të glutenit, të himeve dhe të gjitha karakteristikat e farës origjinale? Këto dhe disa çështje të tjera teoriko-praktike duhet t'ua mësojmë njerëzve, se nuk është e mjaftueshme vetëm t'u themi: «Oburra hidheni farën kështu ose ashtu!». Kur më ka takuar të pyes fshatarë pse ia hedhin nitratin grurit, ata më kanë thënë se këtë e bëjnë që të mos zverdhët bima. Mirëpo mund të ndodhë që, kur hedh shumë nitrat, të mos piqet kalliri, domethënë bima e grurit të mos formojë e të mos e plotësojë kokrrën, por të japë më shumë kashtë. A shikohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin e rritjes së mirë të grurit? Them i se gruri duhet të korret në fazën e dyllit dhe kjo parullë është e përhapur, por unë nuk di sa e drejtë është. Nuk jam specialist, por di se amidoni formohet dhe fara e fiton peshën hektolitrike duke u ngrohur në diell. Këto probleme shken-

core janë të lidhura. Po të kërkojmë që gruri të korret në fazën e dyllit, duhet të kemi parasysh se vërtet evitojmë humbjet, por humbasim peshën hektolitrike. Pra, duhet të dimë shkencërisht dhe të jemi të ndërgjegjshëm se çka fitojmë dhe çka humbasim me parullën «Të korrim në fazën e dyllit» dhe pastaj, duke i njohur këto probleme, vendosim ç'duhet të bëjmë.

Një çështje tjetër që lidhet me grurin është triorimi i tij. Si bëhet kjo punë? Kur janë prodhuar triorët, për të cilët ka pasur rezistencë të madhe, në ç'baza janë bërë vrimat e tyre, domethënë çfarë gruri duhet të mbetet për farë të kalibruar? Ç'formë kanë shoshat e triorëve, nga janë marrë dhe për ç'lloje gruri janë të përshtatshme? Ne, me sa di unë, kemi grurë të llojit «Senator kapeli» etj. Për këtë lloj gruri ose të misrit hibrid që kemi importuar duhet të kemi shosha të posaçme dhe të përshtatshme për triorimin ose për kalibrin e farës, që kokrrat të jenë standard, ku të mos luajë as një e dhjeta e milimetrit. Po kush i kontrollon triorimin e farërave, formën, madhësinë, peshën hektolitrike dhe cilësitë e tjera që kërkohen nga gruri për farë?

Kujdes kërkohet edhe për ruajtjen e kësaj fare, e cila duhet të jetë e ambalazhuar në thasë të vulosur me dyllë dhe jo e hedhur pa kujdes nëpër depo, siç ndodh sidomos në kooperativat bujqësore. Kjo s'duhet lënë në dëshirën e kooperativistëve, se nuk është punë ndërgjegjeje, por çështje shkencore, disipline teknike. Derisa e bëjmë këtë proces, rezultati varet shumë nga fara, prandaj farën e kalibruar duhet ta futim në thes, t'i vëmë dyllin dhe ta ruajmë mirë që të mos përzihen

llojet e ndryshme. Në këtë punë nuk ka një disiplinë të fortë shkencore, prandaj ky është një problem që duhet parë mirë.

Edhe kontrollin e farës, natyrisht, pa mohuar kontrollin e saj në rrugë shtetërore, kooperativa bujqësore mund ta bëjë vetë.

Për çështjen e parabimëve ne nuk kemi ndonjë studim shkencor në bazë të eksperiencës së deritanishme, prandaj vazhdojmë të ndjekim rrugën që kemi përcaktuar dikur. Nuk them se kjo rrugë s'është shkencore, por mendoj se i kemi eliminuar disa parabimë, të cilat mund të jenë më të favorshme për disa lloje bimësh. Kështu, për shembull, për grurin është misri, por është edhe panxhari i sheqerit, bile ky i fundit është më i mirë. Kjo çështje mund të merret në studim, sepse ka rëndësi të madhe për bujqësinë moderne. Gjëra të tilla duhet të parashikohen dhe të balancohen me ekonominë.

Bujqësinë duhet ta ngremë më mirë mbi baza shkencore. Të formojmë bindjen se ngritja mbi baza shkencore e bujqësisë nuk do të na lërë vetëm me këto prodhime që marrim sot, por do të na i shtojë. Nuk duhet të mendojmë se, duke u caktuar llojeve të bimëve që do të mbillen një sasi hektarësh, do të arrijmë rezultatet që dëshirojmë. Në qoftë se e ngremë bujqësinë dhe i trajtojmë llojet e bimëve mbi baza me të vërtetë shkencore, këto medocmos do të na japin rezultate të larta.

Për sa i përket mungesës së mekanizimit të punimeve për pambukun, arsyeja që dha ministri i Bujqësisë mua nuk më kënaq. Prodhimi i makinave për

rrallimin dhe për prashitjen e kësaj bime është një problem me rëndësi të madhe ekonomike, se në këto procese angazhohen me dhjetëra mijë forca pune në momente kruciale, ndërsa ministri na thotë që kanë kërkuar katalogët etj., etj. Një mjet i tillë duhet siguruar brenda muajit dhe komisioni i inxhinierëve të mblidhet e të vendosë menjëherë se kur duhet filluar puna për prodhimin e tij. Kam dëgjuar se disa makina bujqësore, megjithëse janë prodhuar në vend, vazhdojnë përsëri të sillen nga jashtë. Prandaj ju shokë të Qeverisë t'i shikoni mirë këto gjëra se kanë rëndësi të madhe. Më parë se të kërkojmë diçka nga jashtë, duhet të veprojmë vetë dhe shpejt në këtë drejtim. Këto probleme kërkojnë shkathtësi për t'i zgjidhur, se synojmë të kemi një bujqësi intensive, të cilën do ta bëjmë me këto forca pune që kemi. Nevoja për intensifikimin e bujqësisë nuk pret, ndërsa rruga që ndiqet për zgjidhjen e problemeve që dalin, më duket se është burokratike.

Mund të flasin edhe shokët, por mendimi im është që organizata e Partisë e rrethit të Tiranës dhe ajo e rrethit të Durrësit kanë ndërmarrë iniciativa me rëndësi për zhvillimin e ekonomisë. Këto duhen vazhduar, dhe, në vend që t'i drejtohem importit për makina të gatshme, të kërkojmë prej tij lëndë të parë dhe shumë gjëra t'i bëjmë në vend. Në këtë drejtim, më duket mua, ka shumë gjëra për të bërë, prandaj ato nuk duhen lënë pas dore.

Këtu u tha që tani kemi sjellë nga jashtë një impiant për prodhimin e gurkalit. Po përse të mos e sillnin pesë vjet më parë këtë impiant, përse për prodhi-



min e sqfurit në vend të pritnim sa të mbaronte Azotiku dhe të mos hapnim në Peshkopi minierat e sqfurit, të cilat u hapën njëherë dhe pastaj u mbyllën? Si këto ka edhe gjëra të tjera që mund të prodhohen në vend dhe që nuk bëhen, për arsye se dikasteret e gjejnë më të lehtë t'i drejtohen importit për sigurimin e tyre.

Ministri i Bujqësisë, kur ka nevojë për 800 tonë sqfur, nuk shkon të kontrakttojë me Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave, e cila ka në varësi industrinë që e prodhon këtë artikull, por i drejtohet Komisionit të Planit të Shtetit, dhe ky, në vend që ta kthejë mbrapsht, mbush listën me kërkesa të tilla që i drejtohen nga dikasteret. Po t'ua presë rrugën këtyre kërkesave, kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit do të vërë në pozita të drejta, fjala vjen, Ministrinë e Industrisë, që ta prodhojë sqfurin, ndryshe do të mbetemi me pikëpamjen që sqfurin nuk mund ta prodhojmë vetë. Prandaj çdo kërkesë për materiale që ka mundësi të prodhohen në vend, duhet kthyer mbrapsht nga Komisioni i Planit të Shtetit dhe i interesuari le të shkojë vetë të kontrakttojë me prodhuesin, i cili duhet të marrë masa me kohë ta plotësojë porosinë. Sigurisht, kur diçka nuk kemi mundësi ta prodhojmë, do ta marrim nga jashtë, se në tra nuk mund të hidhemi, por përpjekjet për ta prodhuar vetë atë duhen bërë si duhet.

Këtu u ngrit edhe çështja e hapjes dhe e pastrimit të kanaleve të para, të dyta e të treta. Po ku jemi bazuar ne që kanalet e dyta dhe të treta i kemi lënë t'i bëjë vetë fshatarësia? Pra, dua të di, sa dhe si janë forcat e fshatarësisë, sa janë këto kanale të dyta dhe

të treta dhe a mund t'i bëjë fshatarësia? Në qoftë se mund t'i bëjë, atëherë t'i themi që t'i bëjë në çdo kohë, ta sqarojmë që, sipas llogarisë, kanalet e para do t'i bëjë shteti me makineri, të dytat e të tretat do t'i bëjë vetë ajo. Këtë gjë e kemi thënë me kohë, që kur filluam bonifikimet. Ne e dimë si punonte fshatari atëherë, por tani ai nuk rri duarlidhur dhe nuk punon më si në ato kohë, puna e tij ka ndryshuar, është bërë më frytdhënëse. Fshatari ynë tani ka çarë male, prandaj më duket se ky problem duhet ristudiuar. Duhet të shikojmë ç'volum pune kanë kanalet e dyta e të treta dhe ç'forca ka konkretisht fshatarësia. Mund të na dalë që malësia të ketë shumë forca pune, por, meqenëse ajo nuk ka kanale si të Lushnjës, të Lezhës etj., për këto të fundit duhet të gjejmë edhe rrugëdalje, të sjellim një numër makinerish dhe të mendojmë se ku duhet t'i dërgojmë. Mua më duket se kështu zgjidhet ky problem. Mund të mendohet që këto punë t'i bëjë fshatarësia, por duhet të shikojmë konkretisht edhe mundësitë e saj.

Është e vërtetë se dikur e kemi parë këtë çështje, po tani kushtet kanë ndryshuar. Atëherë nuk kishim caktuar, për shembull, që Durrësi t'i bëjë tarraca e t'i mbjellë me pemë frutore të gjitha kodrat, që fshatarësia e këtij rrethi të krasitë pemët, të hapë toka të reja etj. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Lushnjën e për Fierin, që kanë filluar të mbjellin ullinj, në territore të mëdha dhe nuk arrijnë t'u bëjnë vetulloret. Kur kemi vendosur që kanalet e dyta e të treta t'i bëjë vetë fshatarësia nuk ekzistonin këto kushte. Sot problemi i forcave të punës të fshatarësisë ka evo-

luar, dikur në fshat forcat e punës gjendeshin më lehtë, kurse tani shumë prej tyre janë tërhequr nga industria, nga blegtoria etj. Prandaj, përpara se të themi të bëhet kështu ose ashtu, duhet t'i studiojmë shkencërisht të gjithë këta faktorë të rinj, të studiojmë se ku do t'i gjejmë e nga do t'i heqim mjetet e makineritë.

Në bazë të konkluzioneve që u nxorën këtu, të gjithë shokët në sektorët e ndryshëm ku drejtojnë, duhet të marrin masat e nevojshme, të veprojnë, t'i studiojnë problemet që dalin dhe të vendosin sa më parë për të aktivizuar prodhimin dhe për t'i zgjidhur çështjet në mënyrë objektive dhe pozitive.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**PËR DISA ÇËSHITJE TË RAPORTIT MIDIS  
KUADROVE ME ARSIM TË LARTË  
DHE KLASËS PUNËTORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 mars 1970**

Nevoja e rishikimit të shpërndarjes dhe e përdorimit drejt të kuadrove me arsim të lartë dhe të mesëm pranohet nga të gjithë shokët, por unë, megjithëse shkurtimisht, dëshiroj të trajtoj pak disa anë teorike të këtij problemi me qëllim që ta kuptojmë më thellë rëndësinë e madhe të tij.

Ne jemi shtet i diktaturës së proletariatit dhe luftojmë për ndërtimin e socializmit, për zhdukjen e klasave dhe për të shkuar në komunizëm, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë së Punës. Karl Marksi, në veprën e tij të madhe historike «Kapitali», për-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga aparati i KQ të PPSH «Mbi disa probleme të shpërndarjes dhe të përdorimit të kuadrove me arsim të lartë e të mesëm».

cakton rolin vendimtar kryesor të klasës punëtore dhe jep atje përkufizimin përkatës të proletariatit. Proletariati, thotë afërsisht Marksi, është ai që prodhon mbivlerën, krijon kapitalin, kurse inxhinierët dhe teknikët e mesëm, që merren me drejtimin dhe me organizimin e punës ndihmojnë prodhimin, por nuk janë prodhues direkt. Pra, punëtorët janë prodhuesit e drejtpërdrejtë të të mirave materiale për shoqërinë. Këtë është e domosdoshme ta kemi të qartë në parim dhe ta kuptojmë mirë, ndryshe, qoftë në parim, qoftë në praktikë, mund të gabojmë, mund t'u japim rëndësi më shumë kuadrove me arsim të lartë e teknikëve të mesëm dhe klasën punëtore ta harrojmë, ta nënvleftësojmë si klasë udhëheqëse.

Dëshiroj ta theksoj këtë çështje, mbasi sot këtu u fol gjerësisht për kuadrot me arsim të lartë, u fol shumë, gjithashtu, për zotësinë e kuadrove me arsim të mesëm, por sikur u harrua të përmendet çështja që të mirat materiale për shoqërinë i prodhon drejtpërdrejt klasa punëtore, pa ekzistencën e së cilës asgjë nuk mund të prodhohet, asgjë nuk mund të udhëhiqet drejt dhe të bëhet mirë. Këtë na e ka mësuar Marksi, këtë na e provon përditë vetë jeta. Duke pasur të qartë këtë mësim të madh, ne, pa nënvleftësuar rëndësinë që kanë përgatitja dhe edukimi i kuadrove me arsim të lartë dhe të mesëm, asnjëherë nuk do të gabojmë që t'i vëmë këta mbi klasën punëtore dhe mbi rolin e saj.

Duhet të kemi parasysh se direktivat për problemin e kuadrit Partia i ka lëshuar duke i thelluar mirë. Këto direktiva, me të cilat punojmë ne, duhet t'i lidhim mirë me njëra-tjetrën, se janë hallka të një të

tëre, janë hallka të bazuara në teorinë e Marksit, të marksizëm-leninizmit, dhe drejtohen në një objektiv, në çuarjen përpara të revolucionit, në ecjen tonë të pandalshme drejt socializmit dhe komunizmit.

Ne nuk synojmë që nëpër shkollat e mesme ose të larta njerëzit tanë vetëm të mësojnë, por, qysh kur janë në shkollë dhe më vonë, si dalin në jetë, i edukojmë ata të lidhen me prodhimin, të punojnë bashkë me punëtorët dhe fshatarët, që të prodhojnë të mira materiale për shoqërinë. Një gjë e tillë nuk bëhet as në vendet kapitaliste, as në vendet ku sundojnë revizionistët modernë. Si për çdo problem, edhe në këtë çështje ne jemi katërcipërisht kundër teorive borgjeze kapitaliste dhe atyre revizioniste.

Përgatitja e kuadrove lidhur ngushtë me prodhimin te ne ka filluar të vihet në jetë, është, si me thënë, në pragun e portës dhe Partia punon për të farkëtuar në këtë drejtim një koncept të ri te njerëzit tanë. Kuadrot, qofshin këta me arsim të lartë ose të mesëm, Partia i përpunon, në radhë të parë, ideologjikisht dhe politikisht, që të kuptojnë se ata janë ndihmësit direkt dhe indirekt të klasës punëtore dhe jo drejtuesit e saj. Kjo çështje me rëndësi të madhe parimore duhet të kuptohet mirë nga kushdo, nga komunistët, në radhë të parë, pse, siç do ta zhvilloj më pas, në rast se këta nuk mbajnë një qëndrim të vendosur në këtë çështje, gjendja mund të bëhet shumë e rrezikshme, ashtu siç po ngjet në vendet revizioniste.

Edhe bota kapitaliste mëson e përgatit kuadro, bile në një numër më të madh se ne, po kjo punë, nga pikëpamja cilësore dhe klasore, nuk mund të kra-

hasohet kurrë me punën që bëjmë ne për këtë çështje.

Borgjezia kapitaliste i përgatit kuadrot e vet me tendenca të caktuara politiko-ideologjike, me qëllim që me anën e tyre ajo të sundojë mbi klasën punëtore, ta drejtojë e ta shfrytëzojë atë dhe ta gënjejë me demagogji për të përjetësuar kështu sundimin e vet. Kuadrot që përgatit borgjezia kapitaliste përbëjnë shtresën e teknokratëve, ata janë njerëzit e saj më të besuar, të zgjedhur kryesisht nga klasa e vet, por edhe kur elementë të dalë nga radhët e klasës punëtore fitojnë mundësinë për të marrë arsim të mesëm ose të lartë, këta vazhdimisht përpunohen ideologjikisht dhe materialisht në mënyrë që ta tradhtojnë klasën e vet. Këta përgjithësisht bëhen aristokracia e klasës punëtore dhe i shërbejnë me besnikëri rendit borgjez kapitalist për të mbajtur nën fre proletariatin. Bijtë dhe bijat e punëtorëve dhe të masave të tjera të popullit në rendin kapitalist, si rregull i përgjithshëm, lejohen t'i ndjekin shkollat vetëm deri në njëfarë shkalle dhe pikërisht atë sa i intereson borgjezisë. Për të marrë arsim të mëtejshëm atje bëhet një proces seleksionimi. Kështu, për klasën punëtore, për fshatarësinë e varfër e të mesme, vihen gjithfarë masash kufizuese e pengesash të ndryshme, saqë fëmijët e tyre nuk fitojnë dot lehtë të drejtën për të ndjekur shkollat, ndërsa ata që fitojnë në shkolla në shumicën e madhe janë bijtë e klasave të pasura. Për këto arsye ata që mësojnë në universitetet e vendeve kapitaliste nga familjet e punëtorëve nuk përbëjnë ndonjë shumicë.

Ne, në vendin tonë, ecim në një rrugë krejt të ndryshme. S'ka dyshim që edhe ne përgatitjen dhe

edukimin e kuadrove me arsim të lartë apo të teknikëve të mesëm në shkolla e bëjmë, gjithashtu, me tendencë. Kjo për ne është e qartë dhe e natyrshme dhe duhet me doemos të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë. Ndryshimi në mes nesh si një vend socialist dhe vende kapitaliste qëndron në atë që te ne përgatitja dhe edukimi i kuadrove të të gjitha niveleve ka karakter masiv. Shkollat e mesme dhe të larta te ne janë për masat e gjera të popullit dhe në radhë të parë për klasën punëtore e për fshatarësinë kooperativiste. Klasa punëtore, ashtu si fshatarësia kooperativiste dhe të gjitha masat punonjëse në vendin tonë, marrin tani arsim në masë. Djemtë dhe vajzat te ne ndjekin qind për qind arsimin tetëvjeçar, në shkallë të gjerë ata ndjekin si asnjëherë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe shkollat profesionale dhe janë me qindra e mijëra elementët e këtyre klasave që ndjekin edhe shkollat e larta. Te ne punëtorët jo vetëm ndjekin dhe mbarojnë universitetin, por, gjithashtu, ndjekin kurse kualifikimi e shkolla me dhe pa shkëputje nga puna e pasi i mbarojnë studimet kthehen përsëri në punë, me një nivel përgatitjeje më të lartë. Rruga që ndjekim ne për përgatitjen e kuadrit është në antipod me atë që ndiqet në vendet kapitaliste; kjo është rruga që na mëson marksizëm-leninizmi, është rruga e përgatitjes, në radhë të parë, të elementit të dalë nga gjiri i klasës punëtore.

Sigurisht, sot ne nuk nisemi nga synimi që të gjithë punëtorëve t'u japim arsim të lartë, gjë që do të arrihet plotësisht më vonë, në shoqërinë komuniste, po luftojmë për të krijuar një industri moderne dhe buj-



qësi të përparuar, luftojmë për të shkuar gradualisht drejt një shoqërie pa klasa, luftojmë që mekanizimi, automatizimi etj., të zhvillohen pa ndërprerje dhe kultura e klasës punëtore dhe e gjithë masave punonjëse të ngrihet vazhdimisht në një nivel edhe më të lartë. Por në rrugën për ndërtimin e socializmit dhe për në komunizëm ne mbështetemi te klasa punëtore si forca vendimtare e zhvillimit të shoqërisë. Prandaj nuk mendojmë, siç ndodh nganjëherë me disa, që thonë se pa inxhinierë, pa agronomë, pa këta ose pa ata specialistë me arsim të lartë nuk mund të ecet përpara, nuk bëhet puna. Ne e çmojmë rolin që luajnë këta për zhvillimin e prodhimit, po nuk duhet harruar kurrë se veglat e mjetet e punës dhe mallrat industriale i prodhon drejtpërdrejt punëtori, se grurin e bën kooperativisti, se ata janë faktori vendimtar për prodhimin e të mirave materiale. Pikërisht pa këta nuk mund të ketë prodhim. Çështjen e kam që të kuptohet mirë se baza e prodhimit për shoqërinë është klasa punëtore, janë kooperativistët. Këtë të mos e harrojmë asnjëherë, ndryshe, shokë, padashur krijojmë mendimin e gabuar se këto i krijojnë vetëm inteligjencia, një «klasë e re», siç po ndodh në Bashkimin Sovjetik dhe në të gjitha vendet e tjera ku ligjin e bëjnë revizionistët.

Në fakt, këto vende kanë rrëshqitur në pozita krejt të gabuara. Në vendet revizioniste, megjithëse inxhinierët dhe të gjithë kuadrot e tjerë me arsim të lartë, çinovnikët apo nëpunësit kanë dalë nga klasa punëtore, atje zuri vend gradualisht koncepti teknokratik intelektualist se pa këta kuadro specialistë nuk mund të bëhet dhe, në fakt, në mënyrë të ndërgjegjshme këta

mendojnë se pa ekzistencën e tyre nuk prodhohet. Kështu në këto vende u krijua një shtresë e gjerë kuadrosh, një inteligjencie me tendenca dhe prirje të rrezikshme, një shtresë me tipare borgjeze, e dalë nga klasa punëtore dhe nga fshatarësia kooperativiste, që edukatën e ka marrë në regjimin socialist, është përgatitur në shkollat dhe në universitetet socialiste, por që është burokratizuar, është degjeneruar, për arsye se i është dhënë rëndësi e jashtëzakonshme në atë masë, sa që arriti dhe u bë zot, mori fuqinë në dorë dhe tashmë nuk pyet as për klasën punëtore, as për fshatarësinë kolkoziane, as për marksizëm-leninizmin, të cilin e bastardon në teori dhe në praktikë.

Natyrisht, ne nuk ecim në këtë rrugë. Po nuk është e mjaftë që Partia vetëm të thotë se nuk ecim në këtë rrugë. Për të ecur në rrugën e drejtë marksiste-leniniste Partia ka marrë një sërë masash për të mbyllur një herë e mirë shtigjet që çojnë në revizionizëm, që të mos shkohet në rrugën e rrezikshme të kthimit prapa për në kapitalizëm. Kur ne morëm vendimin për shkurtimin e organikave, patëm kurdoherë parasysh faktin që lufta për prodhim bëhet poshtë, në bazë, në fabrika dhe në ara. Për këtë arsye e gjykuam plotësisht të drejtë në të gjitha drejtimet se nuk duhet të lejojmë të na mbushen organikat me kuadro; duke qëndruar këta vazhdimisht në aparatet administrative, ka rrezik të burokratizohen dhe të pengojnë zhvillimin e drejtë të ndërtimit socialist të vendit, ka rrezik të burokratizohen shteti dhe Partia.

Për t'i prerë rrugën këtij rreziku, Partia mori vendimin tjetër, që dimë, atë të qarkullimit të kuadrove.

Këtë vendim, gjithashtu, e morëm në bazë të orientimeve të Marksit dhe të Leninit që për ne kanë qenë kurdoherë të qarta, me qëllim që në vendin tonë të mos krijohen në asnjë moment kushte për një katastrofë si ajo që ngjau në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste.

Vendimet për ngushtimin e organikave, për qarkullimin e kuadrove dhe për punën e tyre drejtpërdrejt në prodhim ne i morëm pikërisht që kuadrot, duke shkuar në bazë, në prodhim, ose sa më afër prodhimit, të fitojnë kuptimin e drejtë dhe objektiv të punës, që ata të mos jenë vetëm njerëz të zyrave, po edhe të punës prodhuese. Por, me gjithë përpjekjet e mëdha që ka bërë Partia në këtë drejtim, prapë ka akoma kuadro që nuk e kanë kuptuar si duhet këtë orientim jetik, nuk kanë kuptimin e vërtetë për punën në prodhim, prandaj ndodh që disa prej tyre punën në prodhim, që është, në radhë të parë, një çështje me rëndësi të madhe ideologjike, e bëjnë si angari.

Partisë i duhet të punojë akoma shumë që ta kuptojnë thellë të gjithë kuadrot këtë problem, të kuptojnë që këto vendime të rëndësishme ajo i ka marrë për të përgatitur qysh tash premisat që kur të arrihet në shoqërinë pa klasa, për të cilën po punojmë, atëherë inxhinieri, mjeku, agronomi, llogaritari e të tjerë, me një fjalë tërë intelektualët, të mos jenë më si tani, në rolin e ndihmësit të prodhimit, por, duke qenë të zotë në fushën e diturisë, të jenë njëkohësisht po aq të aftë edhe për punë drejtpërdrejt prodhuese. Po kështu edhe punëtori, në këtë fazë të lartë të zhvillimit të shoqërisë, jo vetëm të jetë i zoti për punë pro-

dhuese, po të jetë aq i zoti, aq i mençur dhe i ditur sa edhe intelektual i edhe për punë mendore. Kjo do të thotë që në shoqërinë komuniste makinat e fabrikat e modernizuara dhe automatike të jetë në gjendje t'i përdorë dhe t'i shfrytëzojë çdo njeri në interesin e përgjithshëm të shoqërisë pa klasa, pra të punojë në prodhim, njëkohësisht të tërë të jenë në gjendje të studiojnë, të mendojnë, të krijojnë e të drejtojnë.

Për të arritur në këtë fazë të lartë të zhvillimit, shoqërisë do t'i duhet të bëjë akoma një rrugë të gjatë. Derisa të shkohet atje Partia parashikon disa shkallë që duhen ngjitur me radhë njëra pas tjetrës. Këto duhet të kuptohen drejt nga të gjithë që të mund të ecet përpara. Por kjo ecje përpjetë nuk mund të bëhet në rast se çështja nuk kuptohet thellë ideologjikisht.

Nga materiali që na është paraqitur për shqyrtim, duket qartë se në çështjen e shpërndarjes së kuadrove ne kemi mjaft anomali. Këtu nuk është çështja se ka ndonjë shmangie ideologjike, për faktin se në Laç, për shembull, janë grumbulluar 29 specialistë me arsim të lartë, por, po të mos marrim masa që t'i zgjidhim në rrugë të drejtë të tilla anomali si kjo, më vonë do të kemi pasoja të rënda. Prandaj, duke i kuptuar drejt çështjet dhe në perspektivën ku duhet të vemi, anomalitë mund dhe duhet të ndreqen pa vështirësi.

Kemi ne sot kudo në numër të mjaftueshëm inxhinierë mekanikë dhe kuadro të tjerë me arsim të lartë të profileve të ndryshme? Sigurisht, nuk mund të themi se kemi sa duhet, përkundrazi, kemi nevoja të mëdha kudo për shumë e shumë kuadro me arsim të lartë, prandaj, krahas përgatitjes së kuadrove me

arsim të mesëm e të lartë me anë të shkollave, duhet të rregullojmë njëkohësisht edhe anomalitë që ekzistojnë në shpërndarjen e kuadrove, që në kushtet e sotme këta të shpërndahen në mënyrë proporcionale me nevojat reale dhe me kushtet konkrete të çdo sektori e ndërmarrjeje ekonomike.

Krahas kësaj, duhet të rishikojmë, gjithashtu, edhe planifikimin e kontingjenteve të studentëve që pranojmë çdo vit në degët e ndryshme të universitetit. Këtu na dalin shumë probleme, zgjidhjen e të cilave do ta bëjmë me periudha të caktuara, katër ose pesëvjeçare.

Në qoftë se tashti mendojmë të bëjmë pak a shumë një rregullim, një ndreqje të anomalive që ekzistojnë, në radhë të parë duhet të vlerësojmë drejt në rrugën e zhvillimit të saj dialektik ngritjen e klasës-punëtore. Në uzinën «Enver», ku kemi një klasë punëtore me një stazh pune dhe eksperiencë mesatare, ta zëmë, të paktën 6-vjeçare, po të shohim se ajo nxjerr prodhime me një cilësi të mirë, të jemi të bindur se atje ka mundësi të gjejmë shumë punëtorë në nivelin e teknikut të mesëm, të cilët mund dhe duhet pa hezitim t'i ngremë të drejtojnë. Prandaj, në qoftë se, duke vepruar me mendjen e vjetër, kemi dërguar më parë në këtë uzinë, për shembull, një numër inxhinierësh, tani që kemi këtë nivel punëtorësh që punojnë mirë, atje mund të shkurtohej numri i tyre pa i sjellë ndonjë pengesë punës, për arsye se vlerësojmë drejt tërë këtë ushtri punëtorësh që punon dhe lufton në këtë ndërmarrje.

Partia u ka vënë një rëndësi të veçantë edhe by-

rove teknike që disave u duket sikur e hanë bukën kot. Këto mund ta hanë bukën kot, në rast se planifikimi vazhdon të bëhet cep më cep, siç bëhet sot. Por në qoftë se në planifikim dhe në duart e Qeverisë lëmë si rezervë fonde materiale e financiare për t'u dhënë forcë mendimit krijues të masave dhe zhvillimit tekniko-shkencor, atëherë byrotë teknike do të marrin një rëndësi të jashtëzakonshme, do të bëhen me të vërtetë, siç thotë Marks, prodhues indirekt e ndihmësit e klasës punëtore, e cila përnjëherësh merr diturinë e atyre që bëjnë pjesë në këto byro, e diferencon atë dhe e vë në linjë. Po të mos veprohet kështu, atëherë mund të themi se këto byro e hanë bukën kot.

Situatën ta kuptojmë realisht, siç është. Organizata e Partisë në ndërmarrje, drejtori ose kryeinxhinieri mund dhe duhet ta gjykojnë me mendjen e tyre nëse gjithë këta inxhinierë që kanë në dispozicion në ndërmarrjen e tyre janë vallë të tërë të nevojshëm të mbahen? Në mënyrë proletare ata duhet të ndjekin vazhdimisht ngritjen e punëtorëve në përgjegjësi. Tani punëtorët dhe teknikët e mesëm i kanë rritur aftësitë dhe eksperiencën e tyre, shumë punë ata mund t'i kryejnë vetë, por ndërmarrjet i tërheq e vjetra prapa dhe i bën të arsyetojnë jo drejt. Inxhinierët që ata e shohin se i kanë të tepërt nuk i lëshojnë dhe, për të justifikuar mbajtjen e tyre në ndërmarrje, njërin e ngarkojnë të mbledhë vjeturinat, një tjetër të merret me furnizimin apo me diçka tjetër të vogël e kështu me radhë për të gjithë sa kanë. Të gjithë shokëve drejtues që mendojnë në këtë mënyrë Partia duhet t'ua bëjë të qartë të mos veprojnë si deri tani, prandaj, kur

shohin se kanë kuadro të tepërt dhe mund të bëjnë pa ta, t'i lëshojnë dhe këta të dërgohen të punojnë në sektorë të tjerë ku ka nevoja të mëdha.

Ne duhet të largohemi nga disa norma të vëna me kohë, në bazë të të cilave përcaktohej sa kuadro me arsim të lartë dhe të mesëm duhen për një numër punëtorësh. Proporcione dhe norma të tilla jo vetëm mund të mos ishin të drejta, por nuk mund të jenë as të dhëna një herë e përgjithnjë, ato varen nga ngritja e klasës punëtore të një vendi apo të një ndërmarrjeje të veçantë e nga shumë faktorë të tjerë. Në qoftë se në një ndërmarrje klasën punëtore e kemi me një stazh mesatar pune, ta zëmë, prej 10 vjetësh, domethënë se atje kemi mjeshtra të talentuar, atëherë s'është nevoja të mbajmë sipas normave të vjetra atë numër inxhinierësh, pse shumë nga këta punëtorë me një stazh kaq të gjatë pune i kanë rritur aftësitë në nivelin e teknikëve të mesëm, bile edhe më lart dhe janë në gjendje të kryejnë punën, pa qenë nevoja që në ndërmarrjen e tyre të mbahen shumë inxhinierë. Atje, pra, s'ka arsye të mbahen proporcionet e vendosura shumë vjet më parë midis kuadrove me arsim të lartë, të mesëm dhe punëtorëve. Po t'u përmbahemi këtyre proporcioneve të vjetra dhe të arsyetojmë se «industria është baza kryesore e ndërtimit të socializmit», pse «pa të nuk mund të ecet përpara», «pa kuadro me arsim të lartë nuk zhvillohet industria», atëherë nxirret konkluzioni se duhet të përgatitim sa më shumë inxhinierë mekanikë. Mirëpo kontingjentet e nxënësve të shkollave të mesme janë të kufizuara, kurse prodhimi ka shumë nevojë edhe për kuadro me

arsim të mesëm, pra bujqësia dhe sektorët e tjerë do të na mbeteshin zbuluar, pa numrin e nevojshëm të kuadrove. Një kriter i tillë është i gabuar.

Atëherë si do të bëjmë ne për të plotësuar nevojat e ekonomisë me kuadro brenda një pesëvjeçari? Për këtë qëllim duhet t'u jepet një orientim më i qartë Komisionit të Planit të Shtetit e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës që çdo vit ta kenë parasysh këtë disbalancim të kuadrove në sektorë të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës. Pra, sipas situatës dhe nevojave që na paraqiten, brenda pesëvjeçarit ne mund të përgatitim një plan, me anën e të cilit disbalancimin që ekziston midis sektorëve ta zbutim gradualisht sa të jetë e mundur më shumë, në mënyrë të studiuar shkencore dhe duke marrë parasysh të gjithë faktorët, bilancin e fuqisë punëtore, stazhin e tyre në punë, kurset e kualifikimit që kanë kryer ata etj., etj., derisa të arrijmë ta normalizojmë gjendjen dhe të mos presim t'i caktojmë me afate më të gjata. Në qoftë se brenda pesë vjetëve Uzina për Prodhimin e Pjesëve të Këmbimit për Traktorë, për shembull, ka organizuar një numër kursesh kualifikimi, pas përfundimit të të cilave janë ngritur në kategori me qindra punëtorë, dhe në qoftë se atje kanë qenë caktuar në fillim, fjala vjen, një numër inxhinierësh për një numër të caktuar punëtorësh, pas punës së bërë gjatë gjithë kësaj kohe për ngritjen dhe kualifikimin e punëtorëve, ne duhet t'i lëmë kësaj ndërmarrjeje më pak inxhinierë. Kjo është një çështje që duhet parë në mënyrë dinamike. Të gjitha masat që kemi marrë ne për revolucionarizimin e ndërgjegjes së njerëzve, të shkollave, për



luftën kundër burokratizmit, për punën në prodhim të kuadrove etj., janë një dhe duhet t'i shërbejnë këtij qëllimi.

Mua më duket se ecet në rrugë të gabuar, po qe se në praktikë vazhdohet të mbahen të pandryshuara, siç i kemi sot, raportet midis kuadrove me arsim të lartë e teknikëve të mesëm, apo raportet midis tyre dhe numrit të punëtorëve. Këto raporte duhen rishikuar në dinamikë.

Pikëpamja tjetër që ekziston se drejtori i fabrikës duhet të jetë «medoemos» inxhinier, nuk është kurdoherë e drejtë dhe mund të krijojë te ne rrezikun e teknokratizmit. E ç'të keqe ka Miniera e Manzës, ku drejtori nuk është inxhinier? Ne po shohim se ajo ecën shumë bukur me atë drejtor. Atëherë përse kërkohet për të gjitha rastet që në këtë ose në atë ndërmarrje ekonomike të drejttojë «medoemos» një inxhinier? Po të nevojitet që drejtori në ndonjë vend duhet të jetë medoemos inxhinier, atëherë le ta vëmë të tillë, por ka ndërmarrje ku kjo s'është aspak e nevojshme, prandaj çështja nuk duhet të përgjithësohet e të na ngrihet në parim.

Në sektorin e shpimit në naftë, për shembull, ku na kanë ndodhur gjithë ato që dimë, unë jam dakord që u vu në drejtim një inxhinier, por nuk do të ishte e paarsyeshme edhe në qoftë se drejtori nuk do të qe specialist për naftë, por një kuadër organizator i vërtetë, i fortë dhe më i zoti në këtë pikëpamje sesa një inxhinier naftë. Kur drejtorit t'i lindë nevoja për zgjidhjen e problemeve teknike, jo vetëm që do të më-

sojë vetë, por ai ka atje rreth vetes me dhjetëra inxhinierë e teknikë, që do ta ndihmojnë. Në shpim neve sot nuk na mungojnë punëtorët e kualifikuar, teknikët, inxhinierët, po na mungojnë disiplina proletare e teknike në punë dhe drejtues që të dinë t'ua ndajnë mirë detyrat vartësve, të dinë t'i drejtojnë, t'i ndihmojnë, t'i nxitin e t'i kontrollojnë në kohë si po i zbatojnë këto detyra. Edhe pa qenë inxhinier, drejtor në naftë, duke u mbështetur fuqimisht te naftëtarët dhe duke pasur cilësi të mira organizuese, mendoj se do të jetë në gjendje të mësojë atje çdo gjë, deri procesin e punës, kështu që gjatë kohës së kryerjes së detyrës ai do të bëhet specialist i mirë edhe inxhinier. Këtë çështje unë e shtroj në parim se si duhet të jetë te ne. Ndërsa industria në rendin borgjez udhëhiqet nga një parim tjetër krejt i kundërt nga ky yni. Atje kërkohet që teknikët të zënë kyçet e ndërmarrjeve kapitaliste. Prandaj ka ardhur koha që ne ta shikojmë me më shumë kujdes gjendjen e kuadrit dhe të shpërndarjes së tij.

E kemi theksuar se duhet të ruhemi shumë nga tendenca e fryrjes së organikave, pse kjo me dashje ose pa dashje të çon në krijimin e një shtrese burokratësh e teknokratësh, që vetvetiu krijojnë pikëpamjen se pa ta nuk mund të ecet përpara, se këta janë «komandantët e prodhimit». Jo, ne nuk duhet ta lejojmë në asnjë mënyrë të krijohet kjo situatë në vendin tonë. Kuadrot me arsim të lartë dhe teknikët e mesëm me një vlerë të madhe për Partinë, për ekonominë, për shtetin janë ndihmës të punëtorëve, kë-

shilltarë të tyre, ata ndihmojnë ekonominë dhe prodhimin. Por Partia na mëson që këtë shtresë punonjë-sish të mos e lëmë vetëm që të japë mësim dhe të këshillojë, por klasa punëto-re, kudo që janë këta, të bashkëpunojë ngushtë me ta, t'i dëgjojë me kujdes, të mësojë prej tyre, por edhe t'i marrë e t'i futë në punë, t'i vërë të punojnë edhe në torno, edhe në ndërtime e kudo ku punohet për prodhimin e të mirave materiale për popullin, t'i edukojë drejt, t'i kalitë e t'i ndreqë, për të arritur në atë që thotë Marksi, që së bashku, punëtorë dhe kuadro, të venë në komunizëm, njëlloj të tërë, me veti proletari me kuptimin e plotë të fjalës.

Klasa punëto-re e vendit tonë e lejon që kuadri me arsim të lartë ose të mesëm të marrë sot një rrogë pak më të madhe se punëtori, sepse kështu e kërkojnë ligjet e zhvillimit ekonomiko-shoqëror në socializëm, ku secili merr sipas punës që bën. Mirëpo këtë rrogë që marrin, ata duhet t'ia shpërblejnë plotësisht klasës punëto-re me punë dhe jo t'i shesin mend. Mendje klasa punëto-re dëshiron dhe ka nevojë të marrë, por në rrugën e vërtetë proletare.

Disa kuadro me arsim të lartë të profilit teknik edhe në të ardhmen do t'i mbajmë edhe nëpër organet qendro-re, si ndihmësit kryesorë të udhëheqjes së dikastereve, por këtu shokët kryesorë që e kanë të qartë vijën e Partisë, kur ta ngarkojnë një kuadër të tillë për të kryer një detyrë, ta porositin dhe ta edukojnë këtë që të vejë për ta studiuar problemin me punëto-rët, të konsultohet e të marrë mendimin e tyre, ta bëjë

atë të ndërgjegjshëm se klasa punëtore është baza, ndryshe ai që nuk e vlerëson klasën punëtore, siç na mëson Partia, s'ka ç'na duhet në këto vende. Një kujdes i tillë i vazhdueshëm i ndihmon këta të edukohen dhe të mos u rritet mendja.

Megjithëse përsëri do të kemi mungesa, ne duhet të bëjmë, gjithashtu, kujdes për një shpërndarje më të drejtë të kuadrove me arsim të lartë, prandaj të mos e lëmë pas dore ndjekjen e shkollave, as problemin e kualifikimit, po të përpiqemi që këtë çështje ta zgjidhim kurdoherë drejt dhe në bazë të zhvillimit dinamik të vendit. Prandaj kudo që konstatojmë njëfarë anomalie, diku tepricë kuadri, në disa vende të tjera mungesa, të marrim masa dhe në rrugë të drejtë, në mënyrë të studiuar e sipas kritereve që thamë, të bëjmë korrigjimet e nevojshme. Të kemi, gjithashtu, parasysh që edhe kuadrot e mesëm teknikë, që janë larguar nga profesioni i tyre bazë, me përjashtime të rralla dhe vetëm kur është e domosdoshme, t'i lejojmë të ndërrojnë profilin dhe të qëndrojnë atje ku kanë shkuar, të tjerët ta ruajnë profilin, të kthehen në punët që kanë pasur. Kështu duhet të veprohet në përgjithësi edhe me kuadrot me arsim të lartë të profilit teknik, këta sidomos të mos qëndrojnë në punë administrative, veçse në raste me të vërtetë të domosdoshme.

Të gjithë ne këto i kemi të qarta, shokë, dhe unë nuk thashë ndonjë gjë të re, rëndësi ka çështja që ato të kuptohen drejt, në prizmin që përmenda. Tani të kemi parasysh që, kur të hyjmë në detaje të këtyre problemeve, të mos shkojmë në ekstrem dhe të mos

përmbysim krejt normat e raportet. Atje ku paraqitet nevoja për të korrigjuar, të korrigjojmë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 308. Tiranë, 1970*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 308. Tiranë, 1970*

## RËNDËSIA E LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE NË HISTORINË E POPUJVE TË JUGOSLLAVISË

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**5 prill 1970**

U mbushën 29 vjet nga ai 6 prill i vitit 1941, kur Gjermania hitleriane dhe Italia fashiste shpërthyen agresionin e tyre barbar për pushtimin e Jugosllavisë. Ashtu si dhe 7 prilli i vitit 1939 për Shqipërinë, kjo datë u kujton popujve të Jugosllavisë fillimin e ditëve të rënda të robërisë fashiste, që u sollën atyre vuajtje e sakrifica të pallogaritshme. Njëkohësisht, ajo u kujton edhe fillimin e rezistencës popullore antifashiste të organizuar e të drejtuar nga komunistët dhe që arriti kulmin me epopenë e luftës nacionalçlirimtare, që është periudha më e lavdishme gjatë gjithë historisë së tyre të lashtë.

Me gjithë sabotimet e tradhtinë e klasave sunduese, popujt e Jugosllavisë i pritën pushtuesit me pushkë dhe luftuan me guxim e me vendosmëri kundër lëshimeve e kapitullimit të regjimit të vjetër monarkist. Kur qeveria e Cvetkoviçit e futi Jugosllavinë në «Paktin tripalësh» të Gjermanisë hitleriane, ishte shpër-

thimi i urrejtjes dhe i revoltës popullore që e përmbysi atë dhe bëri të mos pranohej marrëveshja.

E kalbur dhe e shitur, komanda e ushtrisë së vjetër mbretërore e sabotoi dhe e tradhtoi rezistencën e armatosur që jugosllavët patriotë i bënë sulmit të egër hitlerian. Por, ndërsa kapitulluan Nediçi e shokët e tij, popujt e Jugosllavisë u ngritën në këmbë dhe i mbushën malet me luftëtarët e rinj, me bijtë e tyre trima, që ishin të vendosur, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, të luftonin derisa t'i dëbonin nga vendi i tyre të gjithë pushtuesit dhe të gjithë tradhtarët.

Popujt e Jugosllavisë janë popuj trima, që me shekuj kanë luftuar për lirinë e për pavarësinë e tyre kundër hordhive të pushtuesve të huaj.

Lufta nacionalçlirimtare antifashiste i tregoi përsëri, por në një shkallë dhe forcë shumë më të madhe, këto veti të shquara. Gjaku i derdhur, sakrificat dhe privacionet e rënda, guximi dhe trimëria e treguar në dhjetëra e qindra beteja nga partizanet e partizanët jugosllavë, nga të gjitha kombësitë që formonin Jugosllavinë, nga gjithë populli, janë një shembull i lartë e i pashlyeshëm i vendosmërisë për të fituar pavarësinë, sovranitetin, dinjitetin e vet kombëtar dhe të drejtat demokratike të çdo kombësie që shtypej barbarisht nga carët e Serbisë dhe nga pushtuesit. Lufta nacionalçlirimtare e popujve të Jugosllavisë kundër pushtuesve fashistë gjermanë e italianë që e lidhur ngushtë me përpjekjet e me dëshirat për të realizuar jo vetëm çlirimin kombëtar, por edhe atë shoqëror, për të ndaluar restaurimin e regjimit të vjetër monarkist-

-diktatorial dhe për të krijuar bazat e përparimit në rrugën e demokracisë e të socializmit.

Në ditët më vendimtare, jo vetëm për fatet e tyre, por edhe për fatet e Evropës e të gjithë botës, në një kohë kur murtaja fashiste kishte vënë nën çizmen e saj gjithë kontinentin tonë dhe Hitleri kishte filluar sulmin e tij të përbindshëm kundër Bashkimit Sovjetik, popujt e Jugosllavisë filluan kryengritjen e armatosur, e cila vazhdoi e ashpër dhe pa ndërprerje deri në çlirimin e plotë të vendit. Nën udhëheqjen e komunistëve, ata u përlëshën me besim në forcat e veta dhe në fitoren përfundimtare në një luftë të pabarabartë me një armik të egër e të armatosur gjer në dhëmbë, që priste e digjte ngado që shkonte, që terrorin e masakrën i kishte të vetmin ligj të sundimit të tij. Meritë e luftës nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë është fakti se ajo nuk ishte një rezistencë e thjeshtë ndaj pushtuesve, as një vetëmbrojtje pasive ndaj veprimtarisë shkatërrimtare të armiqve. Që në fillim ajo nisi si një aksion aktiv në përpjesëtime të mëdha për t'i gozhduar në vend forcat e pushtuesit dhe për t'i asgjësuar.

Pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e brendshëm, që u bënë vegla të tyre, me qëllim që të shkatërronin ushtrinë nacionalçlirimtare dhe të shtypnin rezistencën e armatosur të popullit, ndërморën njërën pas tjetrës ofensiva të mëdha ndëshkimore, në të cilat vunë në përdorim forca të shumta ushtarake. Ata i shkakton vendit dëme jashtëzakonisht të mëdha e të rënda. Përveç atyre materiale, që janë të pallogaritshme, në luftën kundër pushtuesve dhe veglave të tyre popujt e



Jugosllavisë patën mbi një milion e shtatëqind mijë të vrarë. Por me gjithë krimet e barbarizmat e tyre armiqte e shumtë e të egër nuk i thyen dot luftëtarët trima jugosllavë, të cilët u qëndruan me guxim rrebesheve të pushtesve gjermanë e italianë, të çetnikëve e të ustashëve, të hortistëve hungarezë e të fashistëve bullgarë dhe dolën fitimtarë mbi ta.

Lufta nacionalçlirimtare e popujve të Jugosllavisë përbën një kontribut të çmuar në fitoren e përbashkët të popujve mbi fashizmin. Ky është një fakt historik i padiskutueshëm që nuk mund të mohohet nga askush. Për të do të flitet kurdoherë me respekt e me nderim, pavarësisht nga politika që ka ndjekur e ndjek Jugosllavia e sotme dhe nga fati që pësuan aspiratat e popujve të saj për të fituar, bashkë me çlirimin kombëtar, edhe socializmin.

Kohëve të fundit një fushatë e urryer ka shpërthyer, sidomos në shtypin revizionist bullgar, për të nënvleftësuar, bile për të mohuar luftën nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë. Paturpësia shkon deri atje sa revizionistët bullgarë, me mburrje, duan të provojnë se «bullgarët paskan çliruar territore të mëdha të Jugosllavisë». Të dalësh tani e të mburresh me forcat e fashistëve bullgarë që kishin pushtuar Jugosllavinë e që luftonin kundër partizanëve jugosllavë, ashtu siç luftuan edhe kundër partizanëve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, dhe t'i quash ata çlirimtarë pse pas orës 12 ndërruan xhaketë, kjo jo vetëm është revoltuese, por edhe një fyerje për të gjithë luftëtarët antifashistë. Është e qartë se falsifikatorët revizionistë bullgarë nuk nisen nga qëllimi për të ven-

dosur «të vërtetën» historike. Klika e Zhivkovit e bën këtë në kuadrin e synimeve hegjemoniste e agresive të carëve të Kremlinit ndaj Jugosllavisë. Kjo është në kundërshtim me ndjenjat e larta internacionaliste dhe burrërore të popullit vëlla bullgar.

Populli shqiptar ka ushqyer vazhdimisht një miqësi të singertë dhe vëllazërore për popujt e Jugosllavisë. Si popuj fqinjë që jetojnë pranë njëri-tjetrit, atyre u ka ndodhur shpesh të kenë të njëjtat fate, të ndodhen në të njëjtat fronte në luftë kundër të njëjtëve armiq. Populli shqiptar e filloi luftën e tij çlirimtare kundër pushtuesit fashist italian që në prillin e 1939-s dhe e vazhdoi kundër gjermanëve deri në fitore. Gjatë Luftës së Dytë Botërore populli ynë dhe popujt e Jugosllavisë ishin së bashku në kampin antifashist dhe luftuan për të njëjtat ideale. Ata bashkëpunuan dhe ndihmuan njëri-tjetrin kundër armiqve të jashtëm dhe tradhtarëve të vendit për të fituar të drejtën të rronin të lirë, të pavarur e sovranë në vendin e vet.

Kur Italia fashiste filloi pushtimin e Shqipërisë më 1939, studentët e Beogradit, pa marrë parasysh shtypjen e qarqeve sunduese reaksionare, demonstuan kundër agresionit dhe shprehën me forcë përkrahjen dhe simpatinë e tyre për popullin tonë. Manifestime të tilla solidariteti e përkrahjeje nga ana e popujve të Jugosllavisë për luftën çlirimtare të popullit shqiptar nuk kanë qenë të pakta.

Në frymën më të lartë internacionaliste dhe me ndjenjën e dashurisë, të miqësisë dhe të solidaritetit, partizanët shqiptarë shkuan në ndihmë të popujve vëllazër të Jugosllavisë dhe morën pjesë aktive, së bash-

ku me partizanët jugosllavë, në luftimet e ashpra në tokat e Kosovës, të Malit të Zi, të Bosnjës etj. Partizanët shqiptarë e jugosllavë luftuan së bashku në të njëjtat llogore për ideale të mëdha, të cilat janë të përjetshme dhe të pashuara. Gjaku i heronjve të rënë në këto luftime forcoi miqësinë.

Popujt e Jugosllavisë e dinë mirë se, pavarësisht nga divergjencat e papajtueshme ideologjike që na ndajnë me udhëheqjen jugosllave, në popullin shqiptar, ashtu si në të kaluarën, ata kanë edhe sot një mik që u dëshiron kurdoherë të mirën, që do të jetë kurdoherë përkrah tyre në rast se imperialistët e ndryshëm grabitqarë, armiqtë tanë të përbashkët, do të kërcënojnë atdheun e tyre, lirinë e pavarësinë kombëtare, që ata e kanë fituar me shumë gjak e me shumë sakrifica. Revisionistët imperialistë rusomëdhenj, në aleancë të fshehtë me agjentët e tyre, me shovinistët serbomëdhenj, gabojnë rëndë kur mendojnë se do t'i gjejnë në gjumë popujt e Jugosllavisë, të të gjitha nacionaliteteve, që janë të bashkuar përpara rrezikut që mund t'i kërcënojë. Popujt e Jugosllavisë do t'ua bëjnë varrin të gjithëve atyre që do të tentojnë t'u shkelin lirinë dhe indipendencën.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 81 (6745), 5 prill 1970*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 81 (6745), 5 prill 1970*

## TA MBAJME GJITHNJË LART FLAMURIN E LENINIT

*Fjala e hapjes në mbledhjen solemne me rastin  
e 100-vjetorit të lindjes së V.I.Leninit*

**21 prill 1970**

Të dashur shokë e shoqe,

Jemi mbledhur sot të festojmë 100-vjetorin e lindjes së Vladimir Iliç Leninit, të mendimtarit gjenial dhe revolucionarit të madh, strategut të lavdishëm të Revolucionit Socialist të Tetorit, mësuesit dhe udhëheqësit të urtë të proletariatit botëror.

Jeta e Leninit, idetë e tij, veprimtaria e tij janë të lidhura pazgjidhshmërisht me tërë historinë e madhe të epokës sonë, me kthesat rrënjësore që kanë ndodhur gjatë këtyre njëqind vjetëve në fatet e proletariatit dhe të popujve të botës. Shekulli ynë i njëzetë është shekulli i leninizmit.

Marksit dhe Engelsit kishin parashikuar shkencërisht përmbysjen e kapitalizmit dhe ndërtimin e shoqërisë socialiste. Idetë e tyre, mësimet e tyre Lenini i zhvilloi më tej dhe i realizoi në praktikë. Revolucionari

socialist në Rusi, i konceptuar dhe i udhëhequr drejt-përdrejt nga Lenini, shënoi fillimin e epokës së re të njerëzimit.

Historia ka njohur shumë udhëheqës të shquar dhe revolucionarë të mëdhenj, por janë të paktë ata, idetë dhe vepra e të cilëve të ruajnë atë vitalitet dhe aktualitet të pashuar, siç janë idetë dhe vepra e Leninit. Ato kanë përfaqësuar e do të përfaqësojnë edhe në të ardhmen fanarin ndriçues të rrugës revolucionare të proletariatit, busullën e pagabueshme, burimin e pashtershëm të frymëzimit për ta çuar gjithnjë përpara, nga fitorja në fitore, kauzën e madhe të komunizmit.

Duke festuar 100-vjetorin e lindjes së Leninit, ne nuk nderojmë dhe madhërojmë vetëm njeriun, i cili ka dhënë një kontribut që s'ka të krahasuar në krijimin e teorisë dhe të praktikës së socializmit shkencor. Me Leninin e leninizmin janë të lidhur edhe historia e Partisë sonë, çlirimi i popullit shqiptar nga prangat e robërisë fashiste dhe të feudoborgjezisë vendëse, fitorja e revolucionit dhe ndërtimi i socializmit në Shqipëri. Partia jonë lindi leniniste, luftoi e fitoi me flamurin e Leninit e të nxënësit të tij besnik, Stalinit, marshon ngadhënjimtare në rrugën leniniste.

Lenini e leninizmi për komunistët e popullin shqiptar nuk kanë qenë kurrë simbole dhe dogma të thata, as edhe një eksperiencë që i përket vetëm së kaluarës. Qëndrimin tonë ndaj tyre ne e kemi kuptuar dhe e kuptojmë si një detyrë dhe obligim për t'u qëndruar besnikë frymës dhe esencës revolucionare të leninizmit, për të luftuar me vendosmëri e pa pushim për ruajtjen e pastërtisë së tij nga sulmet e të gjithë

armiqve, për ta zhvilluar në mënyrë të pandërprerë e deri në fund revolucionin në vendin tonë, për të forcuar internacionalizmin proletar dhe unitetin e vërtetë marksist-leninist të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, pse vetëm kështu Shqipëria do të rrojë në shekuj e lirë, e pavarur, e fortë, socialiste dhe komuniste.

Askush si Lenini nuk ka zhvilluar një luftë të ashpër, konsekuente e parimore kundër ideologjisë borgjeze e oportuniste, si jashtë, ashtu edhe brenda radhëve të klasës punëtore, askush si Lenini nuk ka goditur me aq forcë antikomunistët e hapët, si dhe ata që antikomunizmin e tyre mundoheshin ta vishnin me frazeologji marksiste ose ta lyenin me bojë socialiste. Tradhtia e përbindshme e revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye, e sidomos degjenerimi i Bashkimit Sovjetik në një shtet borgjez imperialist, e theksojnë edhe më shumë aktualitetin e kësaj lufte. Mësimet dhe qëndrimet e Leninit ndaj oportunizmit marrin një rëndësi të dorës së parë për çdo revolucionar, për çdo parti të vërtetë komuniste.

Imperialistët, borgjezia e madhe dhe reaksioni ndërkombëtar tani u bien daulleve me sa fuqi kanë dhe përpiqen që degjenerimin revizionist ta kalojnë si leninizëm, t'ia atribuojnë leninizmit, gjoja «paaftësisë» së tij për të transformuar botën e vjetër dhe për të ndërtuar një shoqëri të re. Revizionistët e të gjitha ngjyrave, me ata sovjetikë në krye, nga ana tjetër, për të mbuluar tradhtinë e oportunizmin e tyre, mundohen ta zhveshin Leninin e leninizmin nga fryma e tyre revolucionare, t'i shtrembërojnë e t'i mistifikojnë ata. Të dyja palët dalin në një rrugë dhe punojnë për një

qëllim: të minojnë revolucionin, të shkatërrojnë socializmin dhe të skllavërojnë përjetë klasën punëtore.

Por leninizmin, trashëgiminë revolucionare të Leninit, flamurin që ngriti ai, nuk mund t'i mposhtë asgjë, asnjë dhunë, asnjë tradhti, asnjë demagogji. Lenini e leninizmi jetojnë dhe triumfojnë kudo, në Shqipëri ku ndërtohet me sukses socializmi, në valët e revolucioneve e të luftërave çlirimtare që kanë përfshirë kontinentet e Azisë, Afrikës e Amerikës Latine, në hovin e ri revolucionar të klasës punëtore e të masave punonjëse të Evropës e të Amerikës kapitaliste. Idetë e Leninit e vepra e tij frymëzojnë dhe udhëheqin luftën e vendosur që marksistë-leninistët dhe gjithë revolucionarët zhvillojnë sot kundër revizionistëve modernë në të katër anët e botës. Ato qëndrojnë si një zjarr i ndezur, gati të shpërthejë në flakë, edhe në zemrat e klasës punëtore e të punonjësve të vendeve revizioniste, që vuajnë nën zgjedhën e uzurpatorëve e të renegatëve.

100-vjetori i Leninit është një frymëzim i ri, i madh për të mësuar te Lenini, për të luftuar si ai, për ta ngritur gjithnjë e më lart flamurin e tij. Në këtë shprehet para së gjithash e mbi të gjitha edhe besnikëria ndaj leninizmit.

Le të na shërbejë ky jubile i lavdishëm për të forcuar edhe më tepër Partinë e shtetin tonë proletar, për ta bërë edhe më të bukur e më të lulëzuar atdheun tonë socialist, për ta mbajtur gjithnjë lart, të pastër e krenar flamurin e Leninit e të komunizmit në Shqipëri!

Le të japim kontributin tonë në luftën e të gjithë

komunistëve dhe të popujve revolucionarë të botës që luftojnë kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik e shërbëtorëve të tyre!

Le të buçasë sot edhe më fort kushtrimi revolucionar i Leninit: «Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj e kombe të shtypur, bashkohuni!», le të rritet e të forcohet gjithnjë e më shumë lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit, për fitoren e revolucionit e të socializmit kudo në botë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 95 (6759), 22 prill 1970*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 325.  
Tiranë, 1970*



## **TË MBËSHTETEMI FUQIMISHT NË MENDIMIN KRIJUES TË MASAVE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËR RITJEN E PRODHIMIT**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 prill 1970

S'kam për të diskutuar gjatë, sepse shumë çështje, me të cilat jam dakord, u ngritën, vetëm dëshiroj të bëj disa vërejtje.

Shokët që folën thanë me të drejtë se për plotësimin dhe për tejkalimin e planit të prodhimit ekzistojnë mundësi shumë më të mëdha nga ato që njohim dhe shfrytëzojmë sot, se ekzistojnë, gjithashtu, edhe kapacitete prodhuese që lejojnë kthimin në realitet të këtyre mundësive. Por, me gjithë përparimet e pa-

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga Ministria e Tregtisë, nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe nga Ministria e Bujqësisë «Mbi gjendjen e bilancit të tregtisë së jashtme dhe masat për plotësimin dhe tejkalimin e planit të eksportit» dhe u dëgjuan sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve Fier, Vlorë, Peshkopi, Kukës e Mirditë që raportuan për këtë çështje.

mohueshme që kemi arritur, konstatojmë se ka edhe frenime e vetëkënaqësi, ka rutinë dhe burokratizëm. Këto që po them janë shfaqje kundër të cilave Partia jonë ka luftuar gjithnjë dhe lufton me këmbëngulje. Megjithatë, po t'i futemi thellë problemit, ashtu siç u diskutua këtu, do të shohim se shfaqjet e përmendura më sipër vazhdojnë të na pengojnë seriozisht dhe në mjaft raste.

Është e vërtetë se baza e pranon planin që i dërgon qendra dhe lufton për ta zbatuar. Mirëpo, në të njëjtën kohë, ne nuk shohim të bëhen të gjitha përpjekjet e duhura, me qëllim që punonjësit të japin mendimet e tyre të vlefshme e reale për shtimin e prodhimit dhe për përmirësimin e cilësisë së tij, që ata të shfrytëzojnë në këtë drejtim tërë ato mundësi dhe rezerva të mëdha që ekzistojnë.

Në bazë, mendoj unë, vihen re dy prirje. Njëra është kur ndërmarrja përpiqet që plani i saj të jetë më i vogël, për ta realizuar më lehtë, pa shumë telashe e pa tendosje të forcave, kur ajo i paraqet qendrës një plan më të vogël nga mundësitë e saj, dhe kërkon mjete materiale e financiare më shumë sesa i duhen në të vërtetë për realizimin e këtij plani. Në këtë rast qendra, zakonisht, i cakton ndërmarrjes detyra më të mëdha se ato që ka propozuar kjo, por prapëseprapë më të vogla nga mundësitë e vërteta të ndërmarrjes dhe kurdoherë shkurton kërkesat që bën baza për mjete financiare e materiale. Kjo prirje është një shfaqje e metodave dhe e praktikave burokratike të drejtimit të ekonomisë, pa pjesëmarrjen plotësisht të drejtpërdrejtë dhe aktive të punonjësve. Prirja tjetër është kur në

ndonjë ndërmarrje ose kooperativë bujqësore çështjet që kanë të bëjnë me planin dhe me shtimin e prodhimit shtrohen në frymë revolucionare, diskutohen gjerësisht me masat dhe atëherë nga punonjësit shpërthejnë iniciativa të shkëlqyera, bëhen propozime shumë të vlefshme për të rritur detyrat e caktuara në plan për prodhime të reja, për të shtuar asortimentet dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre, duke kërkuar fare pak ose thuajse aspak fonde.

Shpesh dëgjojmë të pyetet: Derisa s'kërkon fonde, përse atëherë baza nuk i vë në jetë vetë të gjitha propozimet ose iniciativat e punonjësve? Kjo është lehtë të thuhet, mendoj unë, mirëpo edhe në këtë rast baza prapë has në vështirësi, që i krijojnë metodat burokratike të drejtimit të çështjeve ekonomike. Rutina, centralizimi nganjëherë i tepruar dhe jo në çdo rast i nevojshëm, sipas të cilit çdo propozim ose iniciativë e bazës më parë duhet të vejë të studiohet në instancën më të lartë, të aprovohet nga komiteti ose nga dikasteri, ta shikojnë atje një ose dy inxhinierë, në një kohë që në ndërmarrje ka shumë inxhinierë, ja, këta janë një pengesë, një frenim që i bëhet zhvillimit me ritme më të shpejta të forcave prodhuese.

Në ndonjë rast tjetër propozimet dhe iniciativat e punonjësve pengohen, sepse, ngaqë nuk konsultohen më parë sa duhet dhe për të gjitha gjërat me masat, organet qendrore të ekonomisë ose drejtuesit e ndërmarrjeve paravendosin me kohë e me hollësi çfarë do të bëhet dhe sa do të bëhet. Kështu që kur masat propozojnë, fjala vjen, të ngrihet një linjë e re në një fabrikë, atyre u përgjigjen: «Kjo nuk është parashi-

kuar në plan, prandaj nuk mund të bëhet sivjet, po do ta kemi parasysh vitin tjetër», ose u thuhet shkurt: «Për këtë nuk janë parashikuar fonde». Edhe një qëndrim i tillë e frenon prodhimin, prandaj në këtë rast masa e punëtorëve, derisa sheh se ekzistojnë të gjitha mundësitë për të krijuar gjëra më të mëdha, ka të drejtë të mos kënaqet vetëm me ato që ka vendosur ministria ose administrata e ndërmarrjes.

Ne konstatojmë që në shumë ndërmarrje, si në Uzinën e Plehrave Fosfatike në Laç, në Ndërmarrjen e Prodhimeve Farmaceutike në Tiranë etj., etj., punëtorët dhe inxhinierët, të cilët janë njerëz që punojnë, kanë mendimet e tyre krijuese për ta zhvilluar dhe për ta shpënë përpara prodhimin. Mirëpo, krahas kësaj, vëmë re se në shumë raste ata frenohen nga administrata, ose propozimet e tyre, që janë të domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, sorollaten lart, në dikastere, shikohen me vonesë, derisa më në fund u jepet njëfarë fondi si për sadaka. Është e mundur të ecet kështu për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë socialiste?

Natyrisht, si administrata e ndërmarrjes, ashtu edhe qendra (dikasteri, Komisioni i Planit të Shtetit) e kanë për detyrë t'i studiojnë me kujdes tërë propozimet dhe iniciativat e punonjësve, t'i llogaritin e t'i matin mirë cilat prej tyre janë të mundshme e më të leverdishme të realizohen dhe cilat jo, cilat mund të vihen në jetë sot dhe cilat më vonë, për cilat ka nevojë më shumë e më parë ekonomia e kështu me radhë. Pra, gjithçka është e domosdoshme të studiohet me imtësi, të mos i lihet as arbitraritetit, as spontaneitetit,

të harmonizohet në kuadrin e gjithë ekonomisë. Njëkohësisht, drejtuesit e ndërmarrjes ose të dikasterit duhet të sqarojnë masat si në rastet kur propozimi ose iniciativa e tyre sot për sot nuk ka mundësi të vihet në jetë, ashtu edhe kur mund të vihet. Ata të kujdesen që të mos krijohen kontradikta që frenojnë zhvillimin, por këto, porsa të lindin, të zgjidhen drejt dhe sa më shpejt.

Mua më duket se puna me rëndësi shumë të madhe për tërheqjen e mendimit krijues të masave dhe për pjesëmarrjen e tyre sa më aktive e të drejtpërdrejtë në planifikimin e në drejtimin e ekonomisë sonë nuk organizohet sa duhet dhe si duhet. Rrethet, baza, klasa punëtore dhe kuadrot që Partia ka përgatitur e do të përgatitë sa vjen e më tepër, duhet të kontribuojnë më shumë se deri sot me mendime e me sugjerime për të gjitha çështjet e zhvillimit dhe të drejtimit të ekonomisë sonë, të mëdha ose të vogla qofshin ato.

Propozimet dhe iniciativat e punonjësve të qendrës e të rretheve duhet të përbëjnë subjektin e madh kryesor të planit tonë. Për hartimin e tij të merret medoemos mendimi i bazës, sepse ata që punojnë atje, punëtorët, teknikët, inxhinierët, drejtorët, punonjësit e administratës e të tjerë, janë, si të thuash, duart dhe mendja kryesore që çon përpara prodhimin, njohin e dinë më mirë se kushdo tjetër rezervat dhe mundësitë e brendshme të pashtershme. Këta ndihmojnë organet qendrore të Partisë e të shtetit të koordinojnë e të caktojnë drejtimet e përgjithshme të zhvillimit të ekonomisë, të harmonizojnë mendimin dhe punën e masave në shkallën e gjithë ekonomisë. Në qoftë se ne

do të kemi besim më shumë vetëm në ato që do të vendosë ministria këtu në qendër me 2-3 veta që ka ajo për zgjidhjen e një problemi dhe nuk do të marrim parasysh gjithë përpjekjet, mendimet dhe propozimet e klasës punëtore, atëherë do të gabojmë dhe punët nuk kanë për të na shkuar mirë.

Shpesh në dikastere lihen pa shqyrtuar ato që duhen zgjidhur më shpejt dhe shqyrtohen e vendosen më parë gjëra që presin e mund të bëhen më pa. Pse ndodh kështu? Sipas mendimit tim, kjo ndodh sepse shumë gjëra jemi mësuar t'i vendosim lart, në qendër, sepse për shumë çështje të dorës së dytë e të tretë të planifikimit dhe të drejtimit të ekonomisë sonë ka njëfarë centralizimi të tepruar që kufizon, ndrydh e ngushton kompetencat e ndërmarreve, të bazës. Kjo është një çështje edhe parimore, edhe organizative, prandaj duhet ta zbatojmë kurdoherë e më mirë parimin teoriko-politik dhe organizativ që ka vendosur Partia për planifikimin, i cili rregullon dhe siguron zhvillimin e shpejtë e të harmonishëm të ekonomisë sonë socialiste.

Centralizimi i tepruar, kur gjithçka shqyrtohet ose aprovohet nga lart, rutina, ngurrimet ose frenimet që pengojnë për t'u mbështetur fuqimisht te klasa punëtore, te teknikët, tek inxhinierët, te drejtorët, na çon në dobësimin e vijës së masave, në mospërfilljen e mendimit dhe të dëshirave të tyre. Në qoftë se lejojmë që këto gjëra të trashen, masat nuk do ta aprovonjë një metodë pune të tillë në kundërshtim me parimet e Partisë sonë. Masat punonjëse që prodhojnë e që drejtojnë, duhet të shohin realisht unitetin e plotë të

mendimeve dhe të propozimeve të tyre me ato të udhëheqjes ekonomike dhe politike. Prandaj të veprohet ndryshe është një e keqe e madhe, kundër së cilës duhet luftuar pa pushim, sepse shërben si shtrat i nxehtë që ushqen e gjallëron burokratizmin, vënien e aparatit shtetëror e të administratave të ndërmarrjeve mbi masat, përhap konceptin dhe praktikën e komandimit të qendrës ndaj bazës, të drejtuesve ndaj punonjësve. Krijimi i një gjendjeje të tillë do të ishte shumë i rrezikshëm për fatet e socializmit e të diktaturës së proletariatit, për shkak se masat do ta ndienin veten si të shkarkuara nga përgjegjësia moralo-politike për përpunimin e planeve të zhvillimit gjithmonë e më të madh të ekonomisë, duke menduar se për to vendoset vetëm në qendër.

Po ta shohim tani çështjen nga pikëpamja ekonomike, do të dalim patjetër në përfundimin se planifikimi dhe caktimi i detyrave vetëm nga lart do të na shkaktonte rrjedhime të dëmshme për zhvillimin e shpejtë e të harmonishëm të ekonomisë sonë socialiste. Duhet pasur parasysh se çdo objekt i ri ose detyrë që caktohet në planin e shtetit për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, prek degë të ndryshme të ekonomisë, paraqet një lidhje dhe varësi reciproke midis tyre. Në qoftë se këto objekte dhe detyra caktohen pa marrë mendimin e masave punonjëse, pa u konsultuar me to gjerësisht e imtësisht, ka më shumë mundësi të bëhen gabime, të krijohen disproporcione qysh në hartimin e planit, t'i jepet epërsi kësaj ose asaj dëshire subjektive, të caktohen gjëra të paargumentuara e të pastuduara deri në fund etj., etj.

Shumë herë kemi folur e flasim me të drejtë për disiplinën e planit. Megjithatë konstatojmë se edhe në punën për zbatimin e saj ka boshllëqe, ka aty-këtu kuptime të ngushta, të cekëta e burokratike që pengojnë bazën, iniciativat krijuese të punonjësve, zhvillimin e vrullshëm të ekonomisë sonë.

Pa dyshim, plani është ligj, prandaj ai duhet të zbatohet me rreptësi e me përpikëri. Mirëpo kjo duhet kuptuar drejt, në mënyrë dialektike dhe jo si diçka e ngurtë, që të mos vrasë as mendimin krijues të masave, as shkathtësinë e tyre.

Ka shokë që disiplinën e planit e quajnë diçka të vendosur nëpërmjet shifrave, të cilat janë «të palëvizshme, të paprekshme, të studiuara dhe të vendosura shumë mirë e pa gabime» për të gjithë periudhën që kërkohet për realizimin e tyre.

Sigurisht, lëvizje të kota e të panevojshme të planeve në asnjë mënyrë nuk duhen lejuar. Absolutisht nuk duhen lejuar, gjithashtu, lëvizje fondesh pa vendime që përcaktohen në ligje dhe në urdhëresa, nuk duhet lejuar dobësimi i disiplinës financiare dhe i asaj të punës, por duhen bërë përpjekje dhe të luftohet për harxhimin sa më me kursim e me efektin maksimal të lekut të popullit, për përdorimin e mirë e të plotë të kohës së punës dhe për ngritjen e rendimentit.

Por lufta, puna, zbatimi i përditshëm i detyrave të planit nga punëtorët na japin të dhëna të reja objektive, financiare, materiale e forma organizimi që nxjerrin në shesh ndonjë pasaktësi të planit të vendosur dhe, si konsekuencë, kërkojnë të bëhen korrigjime, të merren disa vendime të reja. Këto nuk mund të li-



hen pas dore ose të shikohen në fund të vitit. Këtu ndërhyjnë ajo që thashë më lart, shkathtësia e njerëzve, guximi e mprehtësia e tyre në mendime, në gjykime, në propozime, këmbëngulja revolucionare nga ana e masës së punëtorëve dhe të teknikëve. Këto cilësi të njerëzve tanë mund të pengohen nga burokratizmi i udhëheqjes së ndërmarrjes, nga plogështia e saj dhe e një pjese të punonjësve e të teknikëve që nuk qëndrojnë në pararojë, mund të pengohen nga përqendrimi i tepruar i të drejtave dhe i kompetencave të bazës nga ana e dikastereve dhe i atyre të dikastereve nga Komisioni i Planit të Shtetit, ashtu siç mund të pengohen, më në fund, nga kuptimi shumë i ngushtë i disiplinës së planit, që thashë më lart.

S'ka dyshim se në drejtimin e punës ka ndryshime me të kaluarën, janë bërë përparime. Ne i kemi dhënë kompetenca bazës, të cilat në praktikë janë pasqyruar edhe në çështjet që rregullojnë hartimin dhe zbatimin e planit. Por, zakonisht, plani është bërë cip më cip dhe është e zorshme të gjesh mundësinë të financosh lehtë një zhvillim që ta diktojë progresi në punë, kushtet e ndryshuara, iniciativat e reja. Disa lehtësime që kemi pasur në këtë drejtim i kemi suprimuar, i kemi përqendruar lart, duke u shtyrë nga disa gabime ose abuzime që kanë bërë njerëz të bazës në këto drejtime. Mirëpo kjo ka krijuar një situatë jo të rregullt, që edhe për ato gjëra që janë në kompetencën e bazës, pyetet qendra.

Në parim qendra e kupton se nuk është punë e saj të merret me një problem të vogël, por në praktikë e dëgjon, merret me të dhe jep udhëzime. Një

shembull tipik: Në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror, duke i kërkuar ministrit të Tregtisë, Kiço Ngjela, përse rëndohen jashtë orarit punonjësit e tregtisë, ai, midis të tjerash, tha: «E si të mos rëndohen, kur Ministria e Industrisë dhe e Minierave i shtet kopsat me kokrra dhe i ambalazhon në thasë, kështu që punonjësve tanë u duhet të numërojnë një nga një me miliona kopsa. Një gjë e tillë vetëm te ne ngjet, prandaj këtë çështje do ta shtroj në Qeveri». Unë me ironi i thashë: «Të drejtë ke, shtroje në Qeveri, shumë e ke vonuar». Ai nuk e kuptoi ironinë, pse një metodë pune e tillë u është bërë zakon, prandaj vazhdoi: «Patjetër, e kam në shënim». E ç'punë ka Qeveria me një problem të tillë kaq të vogël, kaq të thjeshtë, kaq praktik? Ku spikat këtu iniciativa? Asgjëkundi! Ku është këtu bashkëpunimi midis dy dikastereve, bile edhe për një çështje kaq të thjeshtë? Nuk ka! Atë, thuhet, duhet ta zgjidhë Qeveria, duhet ta zgjidhë Komisioni i Planit të Shtetit.

Pra, mund të flasim shumë kundër burokratizmit, për dhënien e kompetencave, por në praktikë, me dashje ose pa dashje, punojmë në një mënyrë të atillë që as bëhet si duhet lufta kundër burokratizmit, as jepen plotësisht dhe as zgjerohen kompetencat.

Me gjithë përmirësimet, metoda jonë e punës lë shumë për të dëshiruar. Kurdoherë i këshilloj shokët të kenë besim të plotë te baza, te masat e punëtorëve, të kooperativistëve, te kuadrot tanë, t'i lënë ata të punojnë, të marrin përgjegjësi, të matin forcat e tyre me detyrat që u vihen, me vështirësitë që u dalin dhe të kenë satisfaksionin e plotë të punës së tyre krijuese.

Detyra jonë si udhëheqës është t'i mësojmë masat, por njëkohësisht të mësojmë prej tyre, pse ka edhe nga ata që e harrojnë këtë të dytën. T'i kontrollojmë masat dhe kuadrot në punë, jo me qëllim që t'i zëmë në gabime, por për t'i ndihmuar. Nga ana tjetër, edhe këto duhet të na kontrollojnë ne, kur jeta vërteton se kemi të meta e gabime në punë, pse ka edhe përgjegjës që e harrojnë këtë domosdoshmëri objektive, që u rritet mendja dhe kujtojnë se prej tyre s'del kurrgjë e gabuar. Dhe kjo i bën mendjemëdhenj, arrogantë me vartësit e nevrinë ndaj kuadrove.

Metoda e punës e udhëheqjes qendrore, qoftë e asaj të Partisë, qoftë shtetërore, duhet të luftojë marrjen me çikërrima që i përkasin bazës. Syri i mprehtë të shohë çdo gjë, por në rast se e mësojmë gjithë masën me këtë parim të drejtë, dhe e vërteta është se kemi shumë rezultate të mira në këtë drejtim, ne nuk duhet të merremi me gjëra të vogla, të harxhojmë kohën me to dhe të harrojmë problemet e mëdha që duan studime të thella dhe zgjidhje të drejtë nga ana jonë. Shumë herë ka dezekuilibër dhe kjo thuhet me shprehjen «Na merr rutina e punës». Jo, nuk qëndron puna këtu. Këto «gjëra të vogla» janë shumë më të lehta për t'u zgjidhur nga kuadrot kryesorë, pse ata kanë një eksperiencë të gjatë dhe «zgjidhja» e tyre sjell «një kënaqësi» që mbush boshllëqe dhe krijon përshtypjen se udhëheqim. Por ky është një satisfaksion jo i drejtë. Neve, shokë, na duhet të zgjidhim probleme më të vështira, të cilat jo se na trembin, jo se nuk i përballojmë, por jo me atë lehtësi që veprojmë me «problemet e vogla», që fare mirë i zgjidh baza, sido-

mos tash kur ajo ka një ngritje të atillë që zgjidh jo vetëm këto probleme po aq mirë dhe shpejt sa edhe ne, por edhe probleme të mëdha e të koklavitura, zgjidhje që ndihmojnë fuqimisht punën krijuese të udhëheqjes qendrore.

Prandaj këto çështje lypset t'i ndreqim atje ku janë shtrembër, të edukojmë dhe të mobilizojmë njerëzit në punë e në studim, që ata të kuptojnë dhe të zbatojnë si duhet disiplinën e planit, disiplinën financiare, disiplinën në punë dhe vazhdimisht e vazhdimisht të përmirësojnë metodën e punës.

Të gjitha këto që thamë duhen zgjidhur drejt, sepse pengojnë ecjen e ekonomisë sonë përpara dhe ashpërsojnë kontradiktat që ekzistojnë dhe lindin në gjirin e ekonomisë e të shoqërisë sonë socialiste.

Dihet se edhe në socializëm marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore nuk përputhen absolutisht e automatikisht me forcat prodhuese. Midis anëve të veçanta të tyre lindin kohë pas kohe mospërputhje, kontradikta, që shkaktohen nga ecja përpara e forcave prodhuese ose nga prirja e tyre e pandalshme për të ecur përpara dhe nga pengesa që paraqesin anë të veçanta të vjetruara të marrëdhënieve ekonomike e shoqërore. Të tilla janë, për shembull, kontradiktat midis formave të vjetra të organizimit, të drejtimit të punës e të prodhimit shoqëror dhe kushteve të reja, kërkesave të reja të zhvillimit të forcave prodhuese, nivelit të ri ideopolitik, kulturor e tekniko-profesional të masave punonjëse, midis formave e metodave administrative të drejtimit të ekonomisë dhe pjesëmarrjes së gjerë e aktive të masave punonjëse në të, midis përpjekjeve të

punonjësve që luftojnë ta zhvillojnë prodhimin e të ecin përpara, dhe rutinës e praktikës burokratike, të cilat i pengojnë të realizojnë dëshirat, iniciativat e tyre në bazë të mundësive ekzistuese etj., etj.

Është e vërtetë se këto kontradikta nuk janë antagoniste, siç janë në shoqërinë borgjeze kontradiktat midis punëtorëve dhe kapitalistëve. Kontradiktat e shoqërisë sonë janë rrjedhim i zhvillimit të saj në vijë të përpjetë, ato mund e duhet të kapërcehen pa tronditje, pa konflikte shoqërore. Por askujt të mos i shkojë ndër mend se kapërcimi mund të bëhet vetiu. Jo, ai kërkon më parë që kontradiktat të njihen, të zbulohen dhe pastaj, mbi këtë bazë, të merren masa për t'i zgjidhur me kohë, në rrugë e me mjete të drejta, siç na mësojnë Lenini dhe Stalini. Në rast të kundërt, po qe se kontradiktat e shoqërisë sonë socialiste, ndonëse nuk janë antagoniste, lihen të trashen, nuk zgjidhen me kohë e me masat e duhura, atëherë vjen një situatë që nga forca që çojnë përpara zhvillimin tonë ekonomik-shoqëror, ato shndërrohen në forca që e pengojnë seriozisht atë, duke krijuar telashe e vështirësi me karakter ideopolitik, ekonomik, administrativ etj. Këto mësimet të filozofisë sonë materialiste për kontradiktat në shoqërinë socialiste t'i kemi kurdoherë parasysh dhe t'i zbatojmë drejt, me frymë e me metoda revolucionare, për të zgjidhur me shumë kujdes në kushtet tona sidomos kontradiktat që lindin nga rutina e nga metodat burokratike të drejtimit të ekonomisë, të cilat bien në kundërshtim me masat punonjëse, pengojnë Partinë dhe shtetin tonë për t'u mbështetur fuqimisht në to.

Për t'i zbatuar sa më mirë e më shpejt në jetë

çështjet që fola më lart, ne duhet t'i bëjmë më të gjalla e luftarake organizatat-bazë të Partisë, t'i nxjerrim në rrugën e gjerë të kuptimit të çështjeve të zhvillimit të ekonomisë socialiste, si të atyre të përgjithshme, edhe të veçanta, ndryshe ato do të jenë si ca organizma të fjetur, sa për të bërë nga një mbledhje të zakonshme, për të kritikuar njërin ose tjetrin, duke u kapur formalisht pas shprehjeve të tyre. Po të kuptohet kështu roli i organizatës-bazë të Partisë, ajo nuk mund të jetë në pararojë dhe të bëhet luftarake për të zgjidhur çështjet vendimtare të ekonomisë, të prodhimit, për të kuptuar drejt ligjet e zhvillimit shoqëror. Organizata-bazë do të jetë në lartësinë e detyrave kur vetë komunistët që militojnë në të do të bëhen shembull në çdo drejtim dhe do të luftojnë, njëkohësisht, të edukojnë edhe masat, që ato të jetojnë e të veprojnë në shembullin e tyre. Kështu, kur flitet për disiplinën teknike, duhet të jenë komunistët të parët që ta zbatojnë atë; kur shtrohet çështja për kursime në kuptimin marksist-leninist, komunistët duhet të jenë në pararojë të masave punonjëse në fabrika, në fusha, në institucione e kudo për të bërë sa më tepër kursime. Kur është nevoja të forcohet gjendja në një minierë, ata të jenë të parët që të futen nën tokë jo sa për formë apo për t'u dukur, po për të punuar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me të gjitha forcat për nxjerrjen e mineralit. Komunisti duhet ta kuptojë mirë e thellë ideologjikisht se e ka për detyrë të punojë në frontet më të vështira, atje ku është puna më e rëndë. Komunisti në një minierë duhet të mësohet të bëhet minator, të mësojë atje që të njohë mirë shtre-

sat e nëntokës, cilësitë e mineralit, komponentët e tij etj., etj. Në qoftë se nuk vepron kështu dhe pret të shkojë në organizatën-bazë sa për të folur, kjo është një punë krejt formale. Në një rast të tillë diskutimi i tij atje do të jetë krejt formal, ashtu sikundër do të jetë formale edhe disiplina e tij.

Mund të flasim shumë për ndërtimin e socializmit, por në qoftë se nuk punojmë si komunistë, nuk japim mendime, nuk jemi të sinqertë, në qoftë se miqësinë dhe shoqërinë me njëri-tjetrin e shikojmë në mënyrë idealiste, atëherë fjalët që themi s'kanë asnjë vlerë. Shoqëria dhe miqësia te ne duhet të kenë për bazë sinqeritetin. Në qoftë se e do me të vërtetë shokun apo mikun, gabimet, të metat dhe dobësitë duhet t'ia thuash haptazi ndër sy, pavarësisht se atij aty për aty mund t'i vijë keq. Gjithashtu është krejt e huaj për ne ajo miqësi, sipas së cilës duhet të mos e kritikojmë këtë ose atë shok, se është në një punë me përgjegjësi dhe dëmtojmë autoritetin e tij etj. Këto çështje ne duhet t'i kemi mirë parasysh dhe i përmenda pikërisht për rëndësinë e madhe që kanë lidhur me interesat e prodhimit e të zhvillimit gjithnjë me ritme të larta të ekonomisë sonë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 330. Tiranë, 1970*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQF*

## SHTYPI YNË T'I PËRGJIGJET NIVELIT TË LEXUESVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

29 prill 1970

Kisha disa vërejtje për problemet e shtypit. Mendimi im është se puna në këtë sektor, që ka një rëndësi të madhe, nuk është pasqyruar seriozisht as nga shokët e sektorit të propagandës të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, as nga raportet e rretheve. Siç duket, orientimet që u janë dhënë komiteteve të Partisë të rretheve për paraqitjen e këtij problemi në Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë kanë qenë të përcipta, prandaj shokët e rretheve, duke iu përmbajtur atyre, kanë ardhur me mendime të cekëta, domethënë janë mjaftuar me paraqitjen e një informacioni të thjeshtë rreth këtij problemi, na kanë dhënë disa shifra për numrin e gazetave që shpërndahen, si shpërndahen, cilat çështje u interesojnë më shumë etj.

---

<sup>1</sup> Komitetet e Partisë të rretheve Tropojë, Pogradec dhe Elbasan raportuan në këtë mbledhje për shpërndarjen dhe për shfrytëzimin e shtypit dhe të radios.



Mua më duket se puna me shtypin është një çështje shumë e gjerë dhe serioze. Shokët e rretheve nuk folën fare, kurse shokët e tjerë folën tërthorazi vetëm për shfrytëzimin e organeve më të rëndësishme të shtypit periodik, sepse të gjithë u përqendruan te puna që bëhet me gazetat e përditshme. Mirëpo shtypi ynë nuk përfaqësohet vetëm nga «Zëri i popullit», në të përfshihen të gjitha gazetat dhe revistat e ndryshme që botohen në qendër e në rrethe dhe që kanë një mision shumë të madh. Ne këtu në Sekretariatën e Komitetit Qendror duhet të dimë si e përmbush në tërësi detyrën e vet shtypi ynë në bazë të orientimeve të Partisë, ku janë sukseset e të metat dhe ku duhet të vëmë dorë për sa u përket brendisë, paraqitjes e kombinimit të metodave të punës. Çështja është tek orientimet dhe te përmbajtja e shtypit, prandaj është e domosdoshme të dimë si zërthehen konkretisht prej tij orientimet dhe direktivat që jep Partia dhe ç'përfitime kanë masat e popullit jo vetëm nga leximi i gazetës «Zëri i popullit», po nga i gjithë shtypi.

Nuk ka asnjë dyshim që masat e popullit përfitojnë nga shtypi dhe ky, në krahasim me të kaluarën, ka bërë përparime. Duke njohur meritat e njerëzve tanë, specialistë dhe redaktorë që punojnë në sektorin e gazetarisë, në zhvillimin e shtypit tonë kanë kontribuar me mendimet, me pikëpamjet e me kritikën që kanë paraqitur e paraqesin vazhdimisht me shkrim edhe shumë njerëz të tjerë nga masat e popullit. Por mendoj se në shtyp, si në gazetat e përditshme, ashtu dhe në gazetat e revistat periodike javore, mujore etj. të profileve të caktuara, të specializuara, ka njëfarë

kaosi, që vjen, më duket mua, për arsye se punonjësit e redaksive të gazetave nuk janë sa duhet në korent të punës së gazetave të tjera, nuk bëjnë shumë përpjekje për të orientuar opinionin publik për kuptimin dhe për zbatimin e direktivave të Partisë dhe të detyrave shtetërore, për të edukuar kuadrot dhe popullin, nuk lexojnë si duhet dhe me vëmendje një sërë artikujsh që i shërbejnë organit të tyre etj.

Kam përshtypjen se shokët drejtues të organeve të shtypit, duke filluar nga ata të «Zërit të popullit», për kryerjen e detyrave të ngarkuara mbështeten vetëm te kuadrot që kanë në redaksi dhe te korrespondentët e tyre. Kjo e ngushton shumë tematikën që trajtohet në këto organe. Eksperienca e Partisë nuk përhapet duke shkruar në shtyp për motmot me radhë artikuj për të njëjtën çështje, për shembull, «për metodën e mësimit të Historisë së Partisë e të Veprave të shokut Enver», ose siç po shkruhet shpesh për format e edukimit, ku pjesëmarrësit mësojnë individualisht e shkojnë mirë të përgatitur, propagandisti ua shpjegon kësh-tu ose ashtu temën, mbasandaj u bën atyre pyetje etj. Kjo është si puna e mullirit, bëhet ç'bëhet dhe e njëjta «këngë» dëgjohet gjithnjë. Unë mendoj se një problem që shtrohet një herë, mund të shtrohet edhe një herë ca më vonë, por jo të flitet tërë jetën për të, pse ka edhe shumë probleme të tjera që duhet të trajtojnë «Zëri i popullit» dhe organet e tjera të shtypit.

Eksperienca e Partisë është kudo, atë e gjejmë në çdo vend ku punohet e zërthehen direktivat e Partisë, në organizatat-bazë të fabrikave, të kooperativave bujqësore, të institucioneve të ndryshme, të spitaleve etj.,

etj. Direktivat e Partisë zërthehen në organizatat-bazë nga punëtorët, kooperativistët, mjekët, inxhinierët, agronomët e të tjerë, pra, nga të gjithë ata që punojnë dhe luftojnë për t'i vënë në jetë. Prandaj punonjësit tanë të shtypit duhet ta kenë mirë parasysh se nuk është e mjaftueshme që zërthimin e direktivave të Partisë në organet e shtypit ta pasqyrojnë vetëm korrespondentët apo bashkëpunëtorët e gazetave me tri apo me pesë fjalë, ose edhe me një artikull, qoftë ky në një kolonë të tërë. Në qoftë se gjykohet kështu, bëhet gabim. Kjo tregon se nuk është kuptuar karakteri që i duhet dhënë shtypit tonë dhe as roli i madh që luajnë për këtë qëllim bashkëpunëtorët dhe korrespondentët vullnetarë.

Korrespondenti vullnetar i gazetës të mos konsiderohet njeri i paaftë për sa i përket shfaqjes së mendimeve dhe të mos kërkohet nga ana e tij një korrespondencë e thatë, bie fjala, sa u realizua damkosja e druve në Steblevë e të tjera të dhëna të kësaj natyre. Ky është një kuriozitet joedukativ, që e ka burimin në mendimin «Oburra, të kërkojmë se mos ka gjë në gazetë për Steblevën, për Peshkopinë ose për Himarën»! dhe, po s'pati gjë për to, atëherë shko tutje! Kjo sjell kaosin në shtypin tonë. Ne duhet t'i edukojmë korrespondentët vullnetarë e bashkëpunëtorët e gazetave që të mos e katandisin direktivën e Partisë në një zërthim e raportim të thjeshtë të problemit, por të dërgojnë materiale, qoftë edhe një herë në muaj, ku të flitet si është punuar për zbatimin e direktivës për një çështje me karakter shoqëror, ekonomik, bujqësor, teknik ose organizativ. Kjo korrespondencë është

e nevojshme të ketë me të vërtetë mendime dhe ide. Që të mund t'i edukojmë korrespondentët vullnetarë për ta kryer si duhet detyrën e tyre, është mirë të dalim nga ajo mënyrë trajtimi dhe faqosjeje që vihet re në mjaft raste në gazetat e përditshme.

Organet tona të shtypit qendror duhet të shfrytëzojnë shumë edhe materialet e botuara në revistat e universitetit, të cilat kanë rëndësi të madhe, mbasi janë shkruar nga kuadro shkencorë dhe trajtojnë probleme të historisë, të gjuhës, të shkencave natyrore, të mjekësisë etj., etj. Pikërisht këto studime me vlerë nuk pasqyrohen në faqet e gazetave me pretekstin se në to trajtohen çështje «speciale», sikur «Zërit të popullit», «Bashkimit» ose «Punës» nuk u interesojnë. Bëhen gjithë këto sesione shkencore, mbahen në to me qindra kumtesa, në të cilat zbërthehen direktivat e Partisë për probleme politike, ideologjike, shkencore, letrare, artistike etj., kurse në «Zërin e popullit» botohet një përmbledhje e shkurtër e tyre dhe kënaqemi duke menduar se me kaq mbaroi gjithçka. Shpesh, duke botuar ndonjë material të thjeshtë e të pathelluar të ndonjë sekretari partie, mendohet, gjithashtu, se është kryer detyra.

Që shokët e sektorit të shtypit ta kryejnë si duhet detyrën e ngarkuar nga Partia, është me vend t'i njohin lexuesit edhe me punën e shkencëtarëve të universitetit dhe të punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror, si e kanë zbërthyer këta të fundit, për shembull, problemin e luftës së klasave etj. Për këtë qëllim punonjësit e shtypit duhet të bëhen miq të bibliotekave, t'i studiojnë me vëmendje shkrimet e ndryshme

dhe të nxjerrin prej andej material për përgatitje artikujsh të rëndësishëm, të dobishëm për masat, sepse revistat tekniko-shkencore nuk dalin vetëm për një numër të kufizuar njerëzish, por për të gjithë.

Është e vërtetë se revistat që botohen shkojnë edhe në rrethe, por ka raste që vetë sekretari i Partisë jo vetëm nuk i studion, por nganjëherë as bojën nuk ua di. Edhe sikur të mendojmë për ta shtuar tirazhin e tyre me 100 ose 200 kopje të tjera, me gjithë vështirësitë që ekzistojnë për letër, prapëseprapë problemi nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë, pse këto organe nuk mund të vihen në dorën e publikut në mijëra kopje, siç mund të vihen, për shembull, gazeta «Zëri i popullit», «Bashkimi», «Puna» etj. Prandaj ka rëndësi të madhe që në organet e shtypit qendror për probleme të ndryshme të shkruajnë njerëz kompetentë.

Punonjësit e redaksive të gazetave, si njerëz me kulturë, të mësohen për të përvetësuar mirë studimet e thelluara që bëhen për zberthimin e direktivave të Partisë në të gjitha drejtimet e aktivitetet shoqërore, ekonomike, politike etj., mbi bazën e të cilave të botohen artikuj të ndryshëm. Organet e shtypit të kenë një plan pune të studiuar me kujdes për materialet që del nevoja të botohen. Po të veprohet kështu, mendoj se do të ngrihet akoma më shumë niveli cilësor i shtypit tonë. Ky është një problem me rëndësi, prandaj, kur vjen koha e pambukut, për shembull, nuk duhet folur çdo ditë që nga koha e mbjelljes e deri në mbledhjen e prodhimit vetëm për të. S'është nevoja që gazetat të përsëritin një muaj e gjysmë me radhë të njëjtën gjë. Problemi që na preokupon mjafton të trajtohet

mirë e qartë një herë, ndryshe nuk mund të kryhet si duhet puna edukuese me shtypin. E përse të merremi shumë herë me gjëra që janë të qarta për rritjen e pambukut dhe të mos shkruajmë, fjala vjen, për sëmundjet e veçanta të farës së tij dhe këtë jo në një artikull me tri fjalë të shkruar nga ndonjë kuadër i bujqësisë, por me një shkrim, ku problemi të trajtohet thellë, që t'u vlejë Partisë dhe pushtetit në bazë për ta punuar me ditë të tëra me gjithë rritësit e pambukut.

Mund të gaboj, por gjërat e vogla, më duket, nuk është e nevojshme të botohen në gazetë. Shtypi ynë s'duhet të merret me vogëlsira, sepse, po të veprohet kështu, duke marrë parasysh morinë e madhe të problemeve që ka Partia, nuk mbetet vend për ato më të rëndësishmet. Ne duhet të kemi një raport të drejtë edhe në përdorimin e shembujve, pa qenë nevoja të mbushim shtypin me shembuj të mirë e të këqij. Po të vepronin kështu të tëra gazetatat, këto nuk do të mjaftonin për një punë të tillë. Unë mendoj se trajtimi si duhet një herë i një eksperience të mirë do t'u shërbejë njerëzve për një kohë të gjatë, kurse po të flitet çdo ditë për çështje të një natyre, nuk do të mbetet vend të flitet për çështje shoqërore, të historisë, të gjuhës, të artit e të muzikës, të dramës e të mjekësisë etj.

Gazetat duhet të kenë një plan pune të menduar mirë, me qëllim që nëpërmjet artikujve të futin në kokat e njerëzve, të kuadrove të Partisë e të shtetit dhe te masat e popullit idetë shkencore, disiplinën shkencore. Në qoftë se shkohet me mendimin që në shtyp të flitet nga pak e për të tëra gjërat dhe ç'thuhet

sot, të thuhet prapë nesër, punët në të nuk do të na shkojnë mbarë. Artikujt e ndryshëm duhen trajtuar në mënyra të ndryshme dhe jo me fjalë e fraza të tepërta. Meqenëse të tërë njerëzit nuk janë në një nivel dhe nuk kuptojnë dot plotësisht gjithçka shkruhet në revistat speciale që përmenda pak më parë, atëherë duhen bërë përpjekje që disa probleme kyç të thjeshtësohen, veç jo të vulgarizohen në mënyrë banale, që njerëzit të vrasin mendjen kur t'i lexojnë. Kurse tani, me këtë stil pune që po përdoret në shtypin tonë, më duket se nuk nxiten lexuesit ta vrasin shumë mendjen.

Në një nga raportet e paraqitura në këtë mbledhje thuhet se organet e shtypit qendror duhet të kujdesen për ta thjeshtësuar akoma përmbajtjen e shkrimeve. Unë nuk jam dakord me një gjë të tillë, përkundrazi, këtu, më duket, duhet pasur parasysh fakti që niveli ideopolitik e kulturor i masave tona punonjëse ngrihet vazhdimisht. Lexuesit kanë etje të mësojnë, jo që të ushqehen me çfarëdo kuriozitetesh e kuturu, por që të informohen për gjërat kryesore me një orientim të caktuar. Kjo do të thotë që shtypi ynë t'i përgjigjet nivelit të lexuesve, të ngrejë probleme interesante dhe të mos trajtojë, sikurse thashë, gjëra që dihen.

Ndryshe do të pritet nga masat e popullit një shkrim, në të cilin është zbërthyer në mënyrë serioze, shkencore dhe pa «ujë» një direktivë e Partisë. Në rast të tilla, lexuesit, duke ditur se është fjala për direktivën e Partisë, do të preokupohen për ta lexuar dhe për ta rilexuar artikullin, nga i cili do të kenë çfarë të mësojnë. Kjo do të thotë që edhe ne të kemi parasysh që të vëmë në lëvizje forcat mendore, të

zgjojmë natyrën e njeriut, i cili, pasi e lexon një artikull me vlerë ose e dëgjon atë me vërejtje në radio, do të mbajë shënime, do të vërë në zbatim idetë e shprehura e do t'i kthehet prapë librit për të zgjeruar më tej njohuritë e tij.

Më kanë thënë, por edhe vetë kam vënë re, se rrallë duket nëpër rrugë ndonjë njeri që lexon një gazetë ose një libër. Njerëzit tanë ulen për t'u çlodhur nëpër parqe, kopshte ose lulishte, por, ndërkohë, nuk lexojnë. Ç'do të thotë kjo? Pavarësisht nga numri i madh i librave, i gazetave e i revistave që botojmë, kjo nuk është shenjë e mirë. Në shumë vende të zhvilluara njerëzit janë mësuar që, kur ngrihen në mëngjes, blejnë gazetën dhe e lexojnë në tren ose edhe kur zbresin nga tramvaji ose nga autobusi gjatë ndonjë pushimi të shkurtër prej pesë minutash. Te ne nuk ndodh kështu, bile ka njerëz që rrinë me orë të tëra pa asnjë punë dhe nuk lexojnë ndonjë gazetë, roman ose libër që duhet ta kenë në xhep për kohën e lirë. Më duket se nuk po bëhet akoma sa duhet për të rritur më shumë etjen e njerëzve për lexim, që këta të mos mësohen dembelë në këtë drejtim.

Tani njerëzit tanë kanë mbaruar në masë shkollën 7-8-vjeçare, pra të gjithë dinë ta lexojnë fare mirë shtypin. Megjithatë vazhdohet kudo t'u bëhet nga 5 minuta informacion që «t'i informojnë», për shembull, se si në një fshat të Lushnjës kanë marrë 17-18 quintalë luledielli për hektar! Përse të mos e gjejë dhe ta lexojë vetë punëtori ose kooperativisti gazetën? Mirë u tha këtu që gazeta nuk lexohet dot as në 5, as në 10 minuta. Çdo njeri, gjatë 24 orëve, mund të gjejë



vetë kohë për ta lexuar atë. Informacioni i shkurtër ishte i nevojshëm të bëhej kur shumicën e njerëzve i kishim akoma analfabetë, kurse sot, në përshtatje me kushtet e krijuara, duhen gjetur forma të tjera për shfrytëzimin e shtypit. Unë nuk them të heqim dorë fare nga puna për informimin e lexuesve. Kjo gjë mund të bëhet kur është rasti për probleme të rëndësishme, ose për t'u komentuar njerëzve ato ngjarje që çmohet se u duhen zbërthyer, megjithatë duhet punuar që jo vetëm anëtarët dhe sekretarët e organizatave-bazë të Partisë, por të tërë punonjësit tanë të edukohen që leximi i shtypit t'u bëhet një nevojë e domosdoshme. Ata që nuk lexojnë gazetën, janë njerëz të prapambetur.

Ka ardhur koha që ne të bëjmë një hop të ri në format dhe në metodat e leximit të shtypit, që njerëzit të arrijnë t'i zgjedhin vetë shkrimet që duhet të lexojnë. Ata, në radhë të parë, do të shikojnë artikujt që kanë më tepër interes për punën e tyre, pse, natyrisht, të tëra sa shkruhen në gazeta njerëzit mund të mos kenë kohë t'i lexojnë. Kështu mund të veprojnë edhe sekretari i komitetit të Partisë, që ka shumë punë. Qëllon ndonjë ditë që edhe unë nuk i lexoj të gjitha gazetat, jo vetëm sepse më vijnë rregullisht informacionet për politikën e jashtme, që m'i dërgon Agjencia Telegrafike Shqiptare, por edhe pse ndonjë shkrim është i cekët dhe nuk më kënaq. Nuk përjashtoj që në gazetë trajtohen mirë dhe në mënyrë shumë interesante probleme që unë i lexoj me ëndë deri në fund.

Thashë në fillim se duhet të koordinohet më mirë puna e organeve të ndryshme të shtypit. Me këtë

nuk kam parasysh vetëm format, sepse, natyrisht, gazeta «Zëri i popullit» ka metodat dhe format e saj të paraqitjes, «Bashkimi» dhe «Puna» kanë të vetat etj., por çështjen e kam që këto janë organe qendrore të shtypit dhe, si të tilla, për forcimin e punës duhet të ndërtojnë një plan se çfarë duhet të botojnë e çfarë nuk duhet të botojnë çdo ditë për orientimin dhe për edukimin e lexuesve. Gazetat, në varësi nga detyrat që i janë ngarkuar secilës, kanë edhe specifika në punën e tyre. Kështu, për shembull, gazeta «Puna» duhet të merret me problemet e prodhimit, por këto nuk është e thënë që të mos trajtohen nga organet e tjera të shtypit, prandaj lind edhe nevoja e asaj që thashë, e bashkërendimit të mirë të punëve.

Duhet të kemi parasysh të koordinojmë edhe punën midis organeve qendrore të shtypit dhe atyre lokale, domethënë të parat të njohin problemet që do të trajtojnë gazetat e rretheve. Kështu, gazeta «Shkumbini» e Elbasanit, fjala vjen, nga mijëra shembuj pozitivë do të propagandojë shembujt më të mirë ose mund të trajtojë çështjen e kullimit të tokave, të normave kolektive në Kombinatin e Drurit etj., por ajo mund të marrë edhe nga shtypi qendror ndonjë material që i intereson, siç mund të marrë edhe ky ndonjë shkrim nga gazetat lokale.

Nuk mund të qahemi se s'kemi material dhe eksperiencë në këtë drejtim. Çështja është që punonjësit tanë të shtypit të propagandojnë sa më mirë vijën e Partisë dhe eksperiencën e punëtorëve, të fshatarëve, të mbarë popullit tonë. Të kapemi pas atyre formave që e përgjithësojnë më mirë eksperiencën e masave.

Kjo arrihet kur shfrytëzohen edhe artikujt e botuar nëpër revistat e ndryshme shkencore. Nga këto mund të zgjidhet një material i mirë, t'i bëhen disa shkurtime dhe t'i adoptohet kësaj apo asaj gazete. Në qoftë se revista «Bujqësia socialiste» që i vete një rrethi, për shembull, në 10 kopje, ka një artikull shumë interesant, atëherë përse rrethi të mos vërë në lëvizje shtypshkronjën e tij të vogël dhe ta shumëzojë atë për ta shfrytëzuar për qëllimet e veta? Rrethi duhet të mendojë dhe të bëjë të gjitha përpjekjet që materialet e vlefshme të organeve të qendrës, që i gjykon se shërbejnë për të mësuar njerëzit, punëtorët, kooperativistët dhe kuadrot, t'i shumëfishojë e t'i shpërndajë, sepse shteti nuk ka mundësi ta bëjë më gjerë këtë punë. Por vihet re që jo vetëm nuk ka iniciativë në këtë drejtim, po iniciativa mungon edhe në punën që duhet bërë në bazë për të nxitur njerëzit që të lexojnë të gjithë një material të tillë. Mjaft shokë të rretheve, bile edhe të qendrës, janë dhënë pas praktikës dhe, duke u mbështetur më shumë në eksperiencën që kanë, nuk u japin rëndësinë e duhur përhapjes së njohurive teorike dhe arsytimit shkencor.

Ju shokë<sup>1</sup> duhej të na tregonit në diskutimet tuaja nëse agronomët, mjekët, veterinerët e të tjerë i lexojnë apo jo revistat e specializuara të lidhura me profesionet e tyre, nëse baza ka ndonjë vërejtje në këtë drejtim, nëse janë të mirë ose jo artikujt që botohen dhe a ju ndihmojnë në punën praktike. Është detyrë me

---

1 U drejtohet sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve që morën pjesë në këtë mbledhje.

rëndësi e Partisë që të nxjerrë konkluzione nëse eksperiencia që japin njerëzit e mësuar, që shkruajnë në këto revista, përvetësohet. Nuk ka shumë vlerë për Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë informata që na jepet për numrin e revistave dhe të gazetave që shpërndahen. Të thuash se një gazetë shpërndahet në 110 mijë kopje, kurse tjetra në 50 mijë, është vetëm një informacion i thatë. Çështja është të dimë si shfrytëzohet, si shpërndahet, si ndikon shtypi ynë në stadin që kemi arritur dhe, pastaj, mbi këtë bazë të hedhim hapat. Në qoftë se kjo mënyrë shpërndarjeje dhe ky shfrytëzim i shtypit na sjellin përfitime të mëdha, atëherë duhet medoemos të çajmë përpara, të gjejmë mundësitë dhe letrën e nevojshme që na duhet për të shtuar numrin e atyre gazetave e revistave që na sjellin me të vërtetë rezultate.

Jam dakord me propozimin që u bë këtu për të shtuar numrin e kopjeve të revistës «Fatosi». Për sa i përket gazetës «Pionieri», duhet të përmirësohet si paraqitja, ashtu edhe brendia e saj dhe të botohet në më shumë kopje se deri tani. Këto gjëra mund të bëhen. Po do të gjejmë letër për këtë qëllim? Unë them që po, sepse kemi mundësi të ekonomizojmë letrat që teprojnë ose që mbeten si copa të vogla. Sidoqoftë, letra e nevojshme mendoj se mund të gjendet.

Po e përsëris edhe një herë që këto vërejtje e kritika i bëj në bazë të konstatimeve dhe të përshtypjeve që kam. Disa nga ato që përmenda mund të mos jenë plotësisht siç them unë, po në përgjithësi mendoj se duhet rishikuar pak çështja e shtypit, me gjithë sukseset që ka arritur ky, qoftë në paraqitje, qoftë në

brendi. Në radhë të parë, ka përparime «Zëri i popullit». Shkrimet e ekipeve të organizuara nga kjo gazetë janë mjaft interesante, por duhet të mendohet që të realizohen edhe disa gjëra të tjera, që «Zëri i popullit» të bëhet me të vërtetë organi që jep tonin, dhe rrethet ta shfrytëzojnë më mirë.

Emisionet e radios sonë për botën e jashtme shpesh i dëgjoj, sepse jam i interesuar të di si paraqiten problemet dhe arritjet tona për opinionin ndërkombëtar. Unë, sikurse ia kam thënë shokut Thanas Nano<sup>1</sup> edhe herë të tjera, po e përsëris edhe tani, them që ato janë shumë të mira. Është fakt se puna shumë e frytshme për propagandën që bëhet me anën e radios e ka ngritur autoritetin e Partisë, të Qeverisë dhe të vendit tonë në botën e jashtme. Tashti që kemi kuadro më shumë, s'ka dyshim që puna do të bëhet më mirë.

*Botuar për herë të parë në librin «PPSH për shtypin», f. 223. Tiranë, 1972*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

---

1 Në atë kohë drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit.

# T'U JEPEN KOMPETENCA TË PLOTA KËSHILLAVE POPULLORË TË TË GJITHA INSTANCAVE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor<sup>1</sup>*

4 maj 1970

Çështjet e mëdha për përsosjen e mëtejshme të organizimit dhe të funksionimit të organeve të zgjedhura të pushtetit, që Partia na i mëson vazhdimisht në shkolla, në kurse të Partisë, në organizata dhe në të gjitha format e tjera të edukimit marksist-leninist, në shumicën e rasteve duket sikur të tërë i kuptojnë, por në praktikë nuk zbatohen kurdoherë drejt.

Në qoftë se nuk zbatohen mirë në praktikë parimet e Partisë që kanë të bëjnë me pushtetin popullor, do të thotë se nuk kuptohen thellë këto parime, pavarësisht se mund të përsëriten çdo ditë me fjalë. Parimet kërkojnë doemos organizimin e nevojshëm të pu-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi metodën e punës të këshillave popullorë dhe të komiteteve të tyre ekzekutive në rrethin e Krujës».

nës për zbatimin e tyre. Po nuk u kuptuan rëndësia dhe roli i madh i organeve të pushtetit në bazë, atëherë nuk mund të kuptohet pushteti popullor në tërësi.

Ne duhet të udhëhiqemi nga parimi «nga populli dhe për popullin». Por ky parim kërkon zbatim në jetë. Kur populli jep votat për përfaqësuesit e vet të kihet parasysh se është ai që vendos të ngarkojë me funksione pushteti dhe jo organet e Partisë dhe të shtetit. Kur vjen puna për t'u dhënë më shumë kompetenca instancave më të ulëta të pushtetit dhe për t'i vënë më shumë në lëvizje këto organe, nuk duhet ngurruar, duke vepruar vetë ose nëpërmjet një rrethi të kufizuar njerëzish. Në rast se u merren kompetencat organeve që u jepen, kjo tregon mungesë besimi ndaj tyre dhe ndaj masës që i ka zgjedhur. Pikërisht masës i takojnë medaljet, sepse është ajo që i kryen të gjitha detyrat, që i bën të gjitha punët.

Si të gjithë ne, edhe shokët e pushtetit në rrethe, e kanë për detyrë të lidhen me masën, të punojnë dhe të mësojnë bashkë me të që të gëzojnë vlerësimin e drejtë të saj. Përderisa populli ndërton socializmin me një punë kolosale, është ai që na mëson ta udhëheqim, kurse drejtuesi nuk është gjë tjetër veçse një nga të gjithë njerëzit që mendojnë dhe punojnë sipas mësimëve të Partisë. Masat e popullit janë këshilltaret e urta që kanë përvojën e madhe të jetës dhe të punës, prandaj jo vetëm nuk duhet të nënvleftësohen, por të dëgjohen me respekt të madh.

Këto parime t'i zbatojmë me rigorozitet, sepse nga moszbatimi i tyre, përveç të këqijave të tjera, lind edhe mendjemadhësia e shprehur në nënvleftësimin e

të tjerëve dhe në mbivlerësimin e vetes, duke menduar: «Unë jam ai që drejtoj», «Unë jam i mençur», «Pa i vënë gishtin unë, kurr gjë nuk bëhet» etj. Një kryetar kooperative bujqësore, për shembull, sado aftësi të ketë, s'bën dot gjë po nuk pati përkrahjen dhe mbështetjen e kooperativistëve, të shokëve të Partisë dhe të pushtetit në fshat, të anëtarëve të kryesisë etj.

Prandaj, shokë, kini parasysh se akaparimi i funksioneve, i kompetencave nga disa grupe njerëzish vjen në kundërshtim me parimet e Partisë dhe të pushtetit tonë.

Ne konstatojmë që nuk kritikohen udhëheqësit kryesorë, po përse ndodh kjo gjë? Në radhë të parë kjo ndodh për respektin që kanë njerëzit ndaj tyre, por megjithëkëtë, nuk është e drejtë, se respekti ka vendin e vet dhe për hir të tij nuk duhet të krijohet idealizimi i udhëheqësve, duke menduar se «ata janë njerëz të zotë», pasi, midis shumë të mirave, edhe ata kanë të meta.

Pse ju, shokë të Krujës, nuk e keni organizuar pritjen e popullit nga shokët e pushtetit në bazë? Ju thoni se nuk keni pasur kohë. Atëherë unë pyes: A keni mundësi ta pritni dhe ta dëgjoni popullin e atij rrethi? A ju ka krijuar Partia mundësi të tilla që gjithë atij populli t'i zgjidhen drejt hallet? Unë them që po. Nuk është i justifikueshëm fakti që «Nuk keni mundësi dhe kohë për të pritur popullin». Zgjidhja e këtij problemi duhet të shikohet thellë, që hallet e popullit të mos zgjidhen vetëm nga lart, por atje në vend, në bazë. Për këtë qëllim duhet të vlerësohen më shumë dhe t'u jepen kompetenca të plota këshillave



popullorë të të gjitha instancave, nga fshati e gjer te rrethi. Po të veproni në këtë mënyrë, do të keni një mori njerëzish të zgjedhur në pushtet që do të zbatojnë si duhet vijën e Partisë dhe do të zgjidhin problemet e punëtorit, të fshatarit dhe të tërë popullit.

Kur nuk vlerësohen dhe nuk aktivizohen këshilltarët popullorë si persona të zgjedhur, është e natyrshme që njerëzit të grumbullohen për të qarë hallet në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, por të tërë këta ju nuk keni mundësi t'i pritni. Mosprijta e popullit është e palejueshme, sepse, veç të këqijave të tjera, nuk jeton me pulsën e masës dhe e largon edhe kritikën nga poshtë.

Çfarë kuptimi ka që t'u kërkohet llogari këshillave popullorë, kur atyre nuk u jepen kompetenca?! Prandaj duhet t'i jepen kompetenca bazës, sepse, duke pasur kompetenca, rritet autoriteti i saj, forcohen kritika dhe përgjegjësia e këshilltarëve në punët e pushtetit. Pasi ta bëni këtë, pastaj mund t'i thërritni këshilltarët që të shikoni si e kanë pritur popullin në fshat, si i kanë zgjidhur hallet e problemet që u dalin njerëzve etj. Në këtë drejtim, shokë, nxirrni konkluzione për punën tuaj, sepse format e punës që kritikova më lart lejojnë formimin e koncepteve jo të drejta.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË GJALLËROJMË MË TEPËR JETËN E ORGANIZATAVE TË RINISË NË SHKOLLA**

*Fjala në takimin me një grup aktivistësh  
të organizatave të rinisë dhe të Partisë,  
mësuesish dhe pedagogësh të shkollave  
të mesme e të larta*

**12 maj 1970**

Shokë dhe shoqe të rinisë,

Ju falënderojmë shumë për ardhjen në këtë takim, ku na gëzuat me praninë tuaj dhe me gjithë ato që thate. Ne i dëgjuam me vëmendje diskutimet që bënë këtu disa shoqe dhe shokë tuajt. Sigurisht, ju keni të gjithë plot mendime për të shprehur, por nuk na lejon koha që diskutimet t'i zgjatim shumë.

Ju të gjithë e dini se Partia ka ndjekur dhe ndjek me kujdesin më të madh gjithë veprimtarinë, punën dhe përpjekjet tuaja, të cilat janë të mëdha e të lavdërueshme. Edhe me këtë rast Komiteti Qendror më ngarkoi të bëj një bisedë me ju për një sërë çështjesh që besojmë se e interesojnë rininë. Njëherë menduam të mos e shqetësojmë rininë tonë shkollore, pse tani

ajo është në zjarrin e provimeve, por pastaj arritëm në konkluzion që këto probleme, siç e vërtetuan edhe diskutimet tuaja, e preokupojnë shumë rininë tonë. Megjithatë ato për të cilat do t'ju flas sot, nuk janë gjëra të reja, ato janë gjëra të njohura nga të gjithë ju, por, natyrisht, kërkojnë një thellim të mëtejshëm nga organizatat e Partisë dhe nga ato të rinisë në shkollë, kërkojnë një punë më të gjerë e më aktive për të revolucionarizuar akoma më mirë punën. Prandaj vendosëm t'ua themi shoqeve dhe shokëve të rinisë shkollorë e studenteske disa këshilla.

Studentët, pavarësisht nga origjina, a me prejardhje nga klasa punëtore, nga fshatarësia apo nga vetë shtresat e inteligjencies, me origjinë nëpunësi, qytetare etj., bëjnë pjesë në shtresën e inteligjencies popullore. Natyrisht, origjina luan një rol të madh në formimin sa më të shëndoshë të ndërgjegjes klasore të studentëve, e cila kalitet nga Partia nëpërmjet edukimit të tyre politiko-ideologjik, nëpërmjet punës dhe në përgjithësi, luftës revolucionare.

Studentët janë kuadrot e ardhshëm për sektorë të ndryshëm të aktiviteteve shoqërore, ekonomike, arsimore, kulturore etj.; ata do t'i shërbejnë ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Prandaj, sa më mirë të jenë edukuar këta me ideologjinë e Partisë dhe të klasës punëtore, sa më të ngritur të jenë politikisht në vijën e Partisë dhe sa më mirë të kenë përvetësuar diturinë dhe shkencën, aq më mirë do t'u shërbejnë popullit dhe ndërtimit të socializmit të ne.

Ecja drejt kësaj rruge është e lehtë të vihet në

teoremë, por ajo është më e zorshme dhe më e ndërlikuar për ta zberthyer në pjesët e saj përbërëse për rrënjosjen e tyre në kokën e studentëve dhe të kuadrove të ardhshëm, me qëllim që këto pjesë përbërëse t'u bëhen tipare në jetë, me anën e tyre ata të luftojnë mbeturinat e shprehive të vjetra mikroborgjeze dhe të zbatojnë në jetë botëkuptimin e ri marksist-leninist. Sistemi i ri shkollor që vendosëm, do të ndihmojë shumë në këtë rrugë, në rast se kuptohet mirë, zhvillohet mirë dhe zbatohet mirë. Burokratizmi dhe shabllonizmi në këtë proces pengojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Ne me sistemin e ri nuk synojmë të arrijmë disa rezultate formale në edukimin e rinisë sonë shkollore dhe universitare, por synojmë ndryshime rrënjësore, në radhë të parë, për formimin e karakterit të tyre, në formimin e botëkuptimit filozofik marksist-leninist, që do të thotë të çrrënjosim sistematikisht mbeturinat dhe ndikimin e filozofisë idealiste dhe mbeturinat mikroborgjeze, e në përvetësimin nga ana e tyre të diturisë dhe të shkencës moderne të pararojës, me qëllim që ata ta zbatojnë atë në mënyrë korrekte dhe kurdoherë krijuese në kushtet reale të vendit tonë.

Çështja e edukimit ideopolitik të rinisë dhe në veçanti të studentëve ka një rëndësi të jashtëzakonshme për formimin e ndërgjegjes proletare dhe të pikëpamjeve të tyre filozofike. Këtë punë, veçanërisht në moshën që kanë ata, nuk duhet ta bëjmë as të përciptë, as shkel e shko, të nisur nga pikëpamja se kemi kohë, ose për arsye se kemi një rini të mirë, të padjallëzuar, heroike, e cila nuk ka tjetër rrugë ku të ecë, përveçse në atë të socializmit, duke menduar se format e punës

dhe të edukimit i kemi dhe s'ka ç'na preokupon tjetër në këtë drejtim. Po të mendojmë kështu dhe të vep-rojmë me pakujdesi, ne do të gabojmë dhe do të kemi pasoja jo të mira. Një gjykim si ai që përmenda më lart, në përgjithësi, është i drejtë, ai pasqyron një realitet objektiv që kanë krijuar pushteti ynë popullor, ndërtimi i socializmit, edukata e Partisë.

Edukimi ideopolitik i rinisë shkollore e studentes-ke, ashtu si tërë edukimi i gjithanshëm komunist i saj, është një fushë e gjerë dhe e ndërlikuar veprim-tarie, e cila, nën drejtimin e Partisë, realizohet me forcat e përbashkëta të shkollës, të mësuesve e të pe-dagogëve, të organizatave të rinisë, të institucioneve të shumta edukative e kulturore, si dhe të mbarë shoqë-risë, nëpërmjet mësimit, veprimtarisë politiko-shoqë-rore, aksioneve ideologjike, punës prodhuese, edukimit fizik e ushtarak, duke kombinuar formimin teoriko-shkencor të bindjeve ideologjike me pjesëmarrjen aktive në praktikën shoqërore revolucionare socialiste. Por e shikoj të nevojshme të theksoj se i tërë progra-mi i Partisë për edukimin e gjithanshëm komunist të brezit të ri nuk mund të mishërohet në praktikën e përditshme të punës, pa drejtimin efektiv të kësaj veprimtarie nga organizatat-bazë të Partisë dhe sidomos pa gjallërimin e veprimtarisë së organizatave të rinisë në shkolla.

Vitet e fundit, nëpërmjet pjesëmarrjes së rinisë shkollore e studenteske në aksione të shumta ideolo-gjike, në debatet për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, në punën prodhuese dhe në kalitjen fiziko-ushtarake, është revolucionarizuar më tej edhe vetë

organizata e rinisë. Por kësaj fryme të përgjithshme revolucionare nuk i përgjigjet akoma mirë, as në vështrimin ideopolitik, as në atë organizativ, jeta e përditshme e organizatave të rinisë në shkolla, sidomos në ato të lartat, nuk i përgjigjen mbledhjet dhe aktivitetet që zhvillohen në organizatë.

Kjo e metë është e ndjeshme sidomos në rininë studenteske, në radhë të parë, për vetë ambientin në të cilin ajo jeton, për vetë natyrën e mësimit dhe të edukimit në shkollat e larta. Në shkollat e mesme nxënësit kanë qenë në kontakt më të afërt me mësuesit, me prindët, me të gjithë edukatorët. Në shkollë ata janë kontrolluar thuajse çdo ditë për kryerjen e detyrave mësimore. Mësuesit përgjithësisht i kanë njohur ata nga afër dhe individualisht, bile në shumë raste kanë njohur edhe prindët e tyre. Në këtë moshë edhe këta u qëndrojnë më afër të rinjve. Këtë kontakt dhe këtë afrim ata e ndiejnë edhe në organizatën e rinisë dhe në tërë ambientin shoqëror. Sigurisht, këtu është fjala për atë kontakt dhe afrim që realizohet në rrugë të drejtë dhe jo për atë kontroll me frymë tutele konservatore, që orvaten të ushtrojnë disa prindër, bile edhe mësues e edukatorë, pa lënë jashtë këtu edhe vetë organizatat-bazë të Partisë të shkollave.

Në shkollën e lartë gështja ndryshon. Shumica dërrmuese e të rinjve largohen nga familjet e tyre. Ata hyjnë në një ambient të ri, më të gjerë. Pedagogët nuk i kontrollojnë dhe nuk mund t'i kontrollojnë ditë për ditë për mësimet. Ata nuk qëndrojnë afër tyre, ashtu si mësuesit e shkollave të mesme. Sigurisht, pedagogët e shkollave të larta mund të qëndrojnë më

afër studentëve në çdo pikëpamje, por është e qartë që kjo nuk mund të bëhet si në shkollën e mesme. Edhe në organizatë dobësohet ajo frymë e afrimit dhe e solidaritetit që karakterizon rininë e shkollave të mesme. Në këto rrethana shumë studentë nuk orientojnë gjithmonë drejt, bile disa prej tyre fillojnë ta ndiejnë veten «të lirë» nga syri i opinionit shoqëror, i kontrollit të shoqërisë. Pikërisht kështu mund t'u lindë atyre ndjenja e individualizmit, e intelektualizmit, e indiferentizmit për veprimtarinë politiko-shoqërore, për vetë jetën e organizatës së rinisë, ndjenja e një epërsie të gënjeshtërt dhe e shikimit të gjërave me mendjehetësi, sëmundje këto që, po t'i hyjnë në gjak pak e nga pak, e bëjnë njeriun fodull dhe individualist, e shikëputin nga masat punonjëse, nga klasa punëtore. Këto veçori të jetës së rinisë studenteske, që në shikimin e parë janë të lidhura me probleme shoqërore, psikologjike dhe pedagogjike, po të nënvleftësohen, marrin një karakter të mprehtë ideopolitik.

Është e domosdoshme që me punën intensive drejtuese ideopolitike dhe organizative të organizatave të Partisë, si dhe me punën e gjallë e konkrete të përditshme të organizatave të rinisë, ta mënjanojmë patjetër këtë defekt. Pikërisht në këtë prizëm është e nevojshme të ndalemi në mënyrë të veçantë e të shikojmë me sy kritik veprimtarinë që zhvillojnë organizatat e Partisë e veçanërisht ato të rinisë, sidomos mbledhjet që bëjnë, problemet që shtrojnë, diskutimet që zhvillojnë, si dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre. Po t'u futemi këtyre çështjeve në veçanti, do të konstatojmë mjaft raste të një pune të përciptë, të mun-

gesës së ndërgjegjes e të disiplinës proletare në punë dhe formalizëm në edukimin ideopolitik të studentëve.

Duke u interesuar për veprimtarinë dhe mbledhjet e organizatave të rinisë dhe të Partisë, për mbledhjet e komiteteve të tyre përkatëse në shkollat e mesme dhe në fakultetet e ndryshme të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe të instituteve të tjera të larta, konstatoj se ka shumë neglixhencë e formalizëm, shpesh bëhen mbledhje të paorganizuara mirë, nuk përgatiten si duhet as rendet e ditës dhe as diskutimet. Kështu mjaft mbledhje bëhen sa për të kaluar radhën.

Shokët e Komisionit Qendror për Arsimin më kanë treguar se si u bë mbledhja e organizatave të rinisë në universitet për të diskutuar për Statutin dhe rregulloren e re të shkollave të larta. Këto dokumente u lexuan në organizatën e rinisë pa iu dhënë mundësia studentëve të njiheshin më përpara me to, pa diskutuar në mënyrë paraprake për problemet dhe shqetësimet që na dalin në këtë fushë. Siç dihet, në këto dokumente duhet të gjejnë shprehje zbatimi në mënyrë konsekuente i parimeve të demokracisë socialiste në shkollë, thellimi i vijës së masave, rritja efektive e vetëveprimit të rinisë, forcimi i frymës së disiplinës proletare në shkollë. Por organizimi i keq e formal i diskutimit dhe i mbledhjes nuk mund të jepte ndonjë rezultat. Studentëve ua lexuan rregulloret, vërejtje nuk u bënë dhe me kaq mbaroi puna, në një kohë kur në projektet që u paraqitën kishte boshllëqe serioze dhe nuk mishëroheshin parimet e lartpërmendura.

Jo rrallë ndodh që të zhvillohen mbledhje të tilla. Pas tyre ka shokë drejtues të organizatave-bazë të



Partisë e të rinisë që nuk janë çliruar nga metodat burokratike të punës. Ata qahen e ankohen se të rinjtë studentë janë indiferentë, nuk tregojnë interesim, nuk diskutojnë etj., etj. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Studentët diskutojnë shumë, bile në mënyrë të zjarrtë, por jo në mbledhje formale që bëhen sa për t'u regjistruar dhe për t'u konfirmuar. Ata diskutojnë pas mbledhjeve, në konvikte, në aktivitete të lira të përbashkëta dhe kudo. Kur u ngjallet interesimi, ata marrin pjesë aktivisht në debate, bile edhe me pedagogët, shkruajnë fletërrufe, kërkojnë të organizohen dispute të veçanta etj. Gjithë çështja është te ngjallja e interesimit për problemet që diskutohen dhe tek organizimi i mirë i këtyre diskutimeve.

Sigurisht, një gjendje e tillë e sendeve në shkollat tona të larta është mjaft serioze. Që në këtë moshë, dhe çfarë moshe, pikërisht kur i riu dhe e reja janë të etshëm të dinë dhe të mësojnë, nuk gjejnë sa duhet interesim. Ata nuk gjejnë disa herë interesimin e duhur në mbledhjen më të rëndësishme e më me vlerë që duhet ta konsiderojnë si të tillë, në mbledhjen e organizatës-bazë të rinisë dhe të Partisë. Është e natyrshme të vihet pyetja: Ku do të kaliten i riu dhe e reja ideologjikisht dhe politikisht, kur organizata-bazë nuk i vlerëson ata si duhet, kur nuk punohet dhe nuk organizohet puna në një mënyrë të atillë që studentëve t'u ngjallet një interesim i madh? Ku më mirë se kudo gjetkë do të diskutojnë ata për fenomenet pozitive dhe negative të jetës? Ku do të mësohen t'i kuptojnë politikisht thellë dhe drejt problemet e shumta që shtrën lufta për jetën dhe për socializmin? Ku do të zber-

thejnë ata më mirë direktivat e Partisë, në rast se hekuri nuk rrihet si duhet, sa është i kuq, në kudhrën e Partisë, në organizatën-bazë?

Ka rëndësi të madhe të gjenden shkaqet, përse bëhen shpesh formale mbledhjet e organizatave-bazë në shkolla? Për ç'arsye një orë mësimi e përgatitur mirë ngjall interesim të madh te nxënësit e studentët, bëhen pyetje të shumta, bëhen edhe referime nga nxënësit? Kjo ngjet kështu gjashtë orë në ditë (pa përjashtuar këtu rastet kur edhe orët e mësimit mund të bëhen jointerese), e megjithatë as nxënësit e studentët, as mësuesit e pedagogët nuk mërzhiten. Atëherë përse ndodh e kundërta disa herë në disa mbledhje partie ose rinie që bëhen jo 7 orë në ditë, por një herë në muaj dhe zgjatin pak orë? Ky është një fenomen që duhet shpjeguar dhe nuk ka shpjegim tjetër përveç atyre që përmenda më lart. Të marrësh pjesë gjallërisht në organizatën e Partisë, të ngresh atje probleme të rëndësishme, t'i diskutosh çështjet thellë, në dritën e teorisë dhe të praktikës revolucionare, të marrësh vendime për t'i zbatuar në jetë, kjo do të thotë se studenti dhe pedagogu anëtar partie ose studenti dhe nxënësi anëtar i organizatës së rinisë e kuptojnë qartë vendin e parë që zënë teoria dhe politika e Partisë, kuptojnë rolin vendimtar të Partisë si detashment i organizuar i klasës punëtore.

Të përvetësosh diturinë, shkencën është një detyrë e dorës së parë për nxënësin dhe studentin — kuadro dhe punonjës të ardhshëm të shtetit tonë socialist. Ata duhet të punojnë pa u lodhur në këtë drejtim, çdo gjë ta kuptojnë mirë, që më vonë, kur të mbarojnë stu-

dimet, të jenë të armatosur për të kryer me sukses dhe në mënyrë krijuese detyrat që do t'u ngarkohen.

Mirëpo do të jetë një gabim i rëndë dhe me pasoja të dëmshme të pallogaritshme në rast se krahas studimit për përvetësimin e diturisë, nuk farkëtohet te nxënësit e studentët edhe ndërgjegjja e tyre proletare, nuk ngrihet në një nivel të lartë ndërgjegjja politike, nuk shpjegohet e nuk kuptohet çdo gjë në dritën e teorisë marksiste-leniniste, në dritën e luftës së klasave. Ekzistojnë rreziqe në këto drejtime në lidhje me shtresën e intelektualëve, rreziqe që zvogëlohen, mënjanohehen dhe zhduken vetëm me një punë të madhe këmbëngulëse të Partisë për edukimin e tyre që në kohën e moshës së re.

Duke e shikuar në këtë dritë, sa rëndësi kolosale ka puna e Partisë, edukimi politiko-ideologjik nga ana e saj i studentëve, i pedagogëve, i nxënësve e i mësuesve, ç'rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë ose të rinisë, në mënyrë që puna që bën kjo të mos jetë formale, por të realizojë qëllimet e mëdha që i ka caktuar Partia vetes për të armatosur dhe për të kalitur me vijën e saj ideopolitike inteligjencien e re popullore.

Për të dhënë mendime sa më shumë të sakta duhet të nisemi kurdoherë nga të dhëna dhe nga realiteti ynë objektiv. Studentët, nxënësit, pedagogët dhe mësuesit në vendin tonë janë të lidhur ngushtësisht me Partinë, me popullin, me socializmin. Kjo do të thotë se rruga e lavdishme e Partisë i ka edukuar njerëzit, u ka kalitur atyre patriotizmin socialist, politikisht ata

janë të afirmuar. Studentët dhe gjithë inteligjencia jo vetëm rrojnë në një ambient revolucionar, por luftojnë intensivisht dhe janë pjesëtarë aktivë të këtij revolucioni, për ndërtimin e socializmit dhe për përgatitjen e shoqërisë së ardhshme komuniste në vendin tonë. Organizatat e Partisë dhe organizatat e rinisë në shkolla kanë bërë dhe bëjnë një punë shumë të frytshme për të edukuar këtë frymë të përgjithshme revolucionare të studentët e pedagogët. Mirëpo kjo pjesëmarrje dhe ky edukim i përgjithshëm dhe shumë i rëndësishëm që përfshin studentët dhe inteligjencien tonë nuk mund të jenë të plotë, në rast se brenda kësaj kalitjeje të përgjithshme nuk zhvillohet edhe edukimi i veçantë i tyre në rrugën dhe në format që ka përcaktuar Partia për ta, si për të gjitha shtresat dhe klasat në vendin tonë, duke pasur parasysh karakteristikat dhe specifikat e tyre. Prandaj studentët dhe inteligjencia edukimin dhe kalitjen e vet nuk duhet t'i shohin vetëm në përfshirjen e tyre në edukimin revolucionar të të gjithë vendit, por edhe në edukimin dhe në kalitjen e veçantë të tyre, si një detyrë të domosdoshme, si një imperativ jetësor, që fuqizon edukimin dhe kalitjen e përgjithshme revolucionare të të gjithë popullit.

Duke e kuptuar kështu këtë çështje, studentët dhe inteligjencia nuk duhet t'i vënë rëndësi vetëm për vetësimin të diturisë dhe të shkencës, por rëndësi të madhe duhet t'i vënë ata edhe edukimit e kalitjes së tyre ideopolitike. Bile kjo e dyta duhet të zërë vendin e parë. Po s'i shtriam, po nuk i kuptuam dhe po nuk vepruam kështu, ne nuk do t'i luftojmë si duhet dhe

në mënyrë rrënjësore mbeturinat mikroborgjeze që mund të rrezikojnë ndërgjegjen e këtyre shtresave të rinjsh me specifikat e tyre.

Studentët dhe inteligjencia jonë nuk duhet t'i konsiderojnë teorinë dhe politikën e Partisë si disa lëndë shkollore në kuptimin thjesht skolastik, sipas të cilit «më mjafton të studioj lëndën, të mësoj formulimet, të përdor citatet, të krijoj një klishe dhe mbaroi puna». Një studim i tillë është i cekët, formal, burokratik, dogmatik dhe jokrijues. Kështu zbehet roli vendimtar i shkencës së madhe revolucionare të pararojës. Pikërisht studentët dhe inteligjencia jonë duhet të kuptojnë thellë dhe të realizojnë se teoria dhe politika e Partisë, të sintetizuara në libra, janë rezultat i luftërave të mëdha të klasës punëtore, i revolucioneve, i goditjeve të përgjakshme me kapitalin, fryt i krijimtarisë së mrekullueshme të popullit, i eksperiencave të panumërta, i dështimeve dhe i fitoreve etj. Pra, si të tilla që janë teoria dhe politika e Partisë sonë, ashtu edhe duhen mësuar, po ashtu duhet të çohen përpara nëpërmjet përpjekjesh, luftërash, debatesh, diskutimesh të gjalla dhe jo të fjetura, jo nëpërmjet rutinës burokratike ose dogmatizmit skolare. Sa rëndësi merr, pra, mbledhja e organizatës-bazë, e organizatës së rinisë, sa rëndësi marrin diskutimet dhe debatet për thellimin dhe studimin e teorisë dhe të politikës së Partisë.

Nëpërmjet kalitjes ideopolitike me vijën e Partisë studentët dhe inteligjencia jonë popullore duhet të përvetësojnë tiparet më të mira revolucionare të klasës punëtore. Ata duhet të jenë punëtorë të mëdhenj dhe,

në punën e në gjithë krijimtarinë e tyre, të karakterizohen nga thjeshtësia proletare.

Kjo mund të duket e thjeshtë dhe e kuptueshme, por në jetë nuk është aq e thjeshtë dhe as aq e kuptueshme, pasi ka shumë pengesa që vetëm një edukim i thellë teorik dhe praktik i zhdok. Të marrim studentët, edukimin e të cilëve Partia e ka vënë në një rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Përveç mësimit e studimit, aksionet e mëdha e të vazhdueshme të rinisë janë një kalitje e madhe për të, janë kalitje e gjithanshme, jo vetëm fizike, jo vetëm në kuptimin trupor, të shëndetit, por në kuptimin e madh ideologjik; janë unitet i punës mendore me punën fizike. Puna në prodhim nuk është vetëm një kohë e programuar, pa një qëllim të madh ideopolitik, që nuk i shërben unitetit të teorisë me praktikën; ajo nuk ka vetëm një kuptim të thjeshtë akademik. Në të vërtetë pjesëmarrja direkt e studentëve në prodhim ka të bëjë me ndërtimin konkret të socializmit. Rinia vete me një entuziazëm të madh në aksione e në punën praktike, domethënë ajo e kupton drejt ideologjikisht këtë vijë kaq të drejtë marksiste-leniniste të Partisë.

Rinia jonë duhet ta kuptojë dhe ta zbatojë këtë edhe më thellë, t'i bëhet shprehi se pa punë nuk rrohet, nuk krijohet, nuk vlen të jetohet jeta, të cilën e zbukurojnë puna, krijimtaria. Partia e mëson rininë të kuptojë se për të mësuar duhet të punosh dhe, duke qenë i mësuar, prapë duhet të vazhdosh të mësosh, pse duke mësuar duhet të krijosh dhe, që të krijosh, duhet të ndjekësh shembullin e lavdishëm të klasës punëtore, të punosh vetë dhe në punë e sipër njëkohësisht të

mësosh dhe të krijosh. Puna është, pra, në bazë të çdo veprimtarie, puna është në bazë të krijimit, të diturisë dhe të përvetësimit të saj dhe jo vetëm puna mendore, por uniteti i punës mendore me punën fizike, uniteti i teorisë me praktikën në çdo fushë.

Pra, Partia nxënësve e studentëve, pedagogëve e mësuesve dhe gjithë inteligjencies veçanërisht këto probleme duhet t'ua zhvillojë teorikisht dhe pa ndërprerje gjithë jetën, të arrijë që në jetë, në praktikë ato t'u bëhen atyre shprehi. Përndryshe ka rreziqe.

Cilat janë këto rreziqe? Në rast se nuk ecim vendosmërisht në rrugën që na mëson Partia, studentët dhe nxënësit, që do të mbarojnë universitetin dhe shkollat e ndryshme, mund të na dalin njerëz të përgatitur në lëndë të ndryshme, por jo të kalitur që në bankat e shkollës me ideologjinë proletare. Ata do të bëhen kuadro, por që për veten e «zotësinë» e tyre do të kenë një mendim jomarksist ose të përciptë teorikisht. Ata do të jenë pretenciozë, do të mendojnë se janë më të zotë e më të diturit nga të gjithë, pra të përgatitur që të drejtojnë e të udhëheqin të tjerët. Njerëz të tillë do të kthehen në karrieristë, në burokratë, përçmues të klasës punëtore dhe të punës, do të kenë mendimin se pa ata asgjë s'bëhet, se pa ata jeta ndalet, bile edhe dielli mund të mos lindë dhe të mos perëndojë në horizont. Sigurisht, pa kalitjen ideopolitike, do të bëhej borgjezimi i tyre dhe «në vend që të kemi vënë vetulla, kemi nxjerrë sytë», siç thotë populli ynë. Kështu ngjau në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet revizioniste. Kjo te ne s'ngjan dhe s'ka për të ngjarë kurrë, në rast se Partia do të punojë me të

gjitha forcat, në të gjitha këto drejtime të rëndësishme.

Partia duhet të zhvillojë një punë intensive teorike me studentët, në radhë të parë, për të zhdukur pikëpamjet individualiste që shfaqen tek intelektualët, të cilëve ua krijon jeta e gjatë e studimeve. Sido që këto studime kryhen në gjirin e një kolektivi të gjerë, metoda e punës, mësimi në libra, përqindja dërrmuese e kohës që zë puna mendore dhe përpjekjet individuale të secilit, e bëjnë studentin të mendojë se marrja e diplomës është rezultat i zotësisë së tij, rezultat i individit të izoluar me vullnet të veçantë. Detyrën që kryen, përvetësimin e diturisë, studenti nuk e kupton ashtu siç e kupton punëtori që punon në fabrikë, që ndërton uzina apo hidrocentrale. Punëtori nuk e ndan punën e tij nga ajo e kolektivit, ndërsa inxhinieri, studenti i djeshëm, shumë herë ka prirje që, edhe firmën kur vë, të thotë se këtë vepër «e kam projektuar unë», «e kam bërë unë», ai shkon deri atje sa të injorojë ose të errësojë në fakt ndërtuesit e vërtetë të veprës, punëtorët. Me këtë nuk dua të them se duhet mohuar momenti i krijimit individual në punë, por ai nuk duhet çuar gjer në ekstrem dhe nuk duhet të shkëputet nga procesi krijues kolektiv. Punëtori nuk thotë kurrë «këtë vepër e kam ndërtuar unë», po «e kemi ndërtuar ne», «kemi punuar ne në të», «e kemi krijuar ne». Punëtori s'ndahet kurrë nga kolektivi, nga klasa, ai nuk është individualist, por në gjak ka të theksuar forcën e unitetit, forcën krijuese masovike të klasës. Punëtorët mburren me veprën që kanë ndërtuar së toku, ose për punën prodhuese që bëjnë së toku, në të gjitha repartet e fabrikës, atyre nuk u shkon kurrë në



mendje të nxjerrin nga kjo përfitim ose lavdi personale. Kurse nuk ngjet kurdoherë kështu me inxhinierët, shkrimtarët, mjekët, drejtorët, sidomos kur këta nuk janë të ngritur ideologjikisht.

Është, pra, me rëndësi të madhe teorike dhe Partia duhet të edukojë në mënyrë të thellë rininë, studentët dhe intelektualët se ç'do të thotë, ç'duhet të kuptojnë dhe si duhet të qëndrojnë ata në jetë përpara unitetit krijues kolektiv dhe ndjenjës mikroborgjeze individualiste.

E para, uniteti krijues kolektiv nuk e zvogëlon, nuk e shtyp forcën krijuese të individit, as personalitetin e tij. Në të kundërtën ajo i nxit atij tiparet më të mira, i kalit besimin në forcat krijuese, i hap mundësi kolosale të mendojë, të punojë dhe të krijojë, i kalit karakterin dhe virtytet më të mira njerëzore, e bën atë të respektueshëm nga të tjerët dhe e mëson të respektojë të tjerët, t'i dojë të tjerët dhe të lidhë ngushtësisht punën e tij me atë të të tjerëve.

Kurse e dyta, ndjenja mikroborgjeze individualiste e izolon individin nga masa, e detyron atë të mendojë që «kërraba t'i heqë nga vetja», të punojë që të mbizotërojë fjala e tij, të duket mbi çdo gjë puna e tij. Me këto pikëpamje, natyrisht, ai është një egocentrist, një shpirtvogël, por që ka mendim të madh për veten e tij. Një njeri i tillë, kur nuk i kundërshton dot forcës së madhe të kolektivit, konformohet, po nuk është i bindur, nuk bën përpjekje të bindet, pse pikëpamjet e tij individualiste mikroborgjeze e pengojnë të shohë rrugën e gjerë dhe të drejtë. Ai bëhet kryelartë, mburret,

bëhet arrogant, nuk ka kuptim të drejtë për demokracinë dhe unitetin.

Me mësimet e saj teorike dhe me luftën revolucionare të përditshme, Partia duhet t'u mësojë studentëve dhe intelektualëve, në teori dhe në praktikë, rolin historik të klasës punëtore dhe të Partisë së saj marksiste-leniniste. Nuk janë aspak të mjaftueshme formulimet teorike për këto çështje, por duhet historia e gjallë e luftërave dhe e përpjekjeve të tyre që janë në bazë të këtyre formulimeve. Vetëm kështu këto bëhen të kuptueshme, bëhen shprehje, bëhen rrugërrëfyese.

Partia duhet t'u mësojë studentëve rolin hegjemon të klasës punëtore në revolucion, t'u mësojë arsyet, psenë dhe të mos lejojë të bëhen leksione të përcipta. Studentët dhe cilido tjetër duhet të dinë fundin e sendeve e të fenomeneve.

Po ashtu Partia duhet t'u mësojë atyre, në teori dhe në praktikë, ç'është uniteti i klasës, uniteti i Partisë dhe uniteti rreth klasës dhe Partisë së saj. Ç'është thotë ky unitet, si u krijua dhe si u kalit ky unitet, kundër kujt u formua, për ç'qëllime, në ç'bazë e ç'forca armiqësore përballoi dhe po përballon, ç'fitore e ç'disfata ka pësuar, nga i turren rreziqet, në ç'forma i turren, si u duhet bërë ballë dhe si duhen mposhtur këto rreziqe të shumëllojta. Siç shihet, çështja e unitetit nuk është një formulë e thjeshtë. Këto parime filozofike duhen zërthyer në tërë gjerësinë dhe madhësinë e tyre revolucionare, që i riu dhe studenti i sotëm, nesër punonjës dhe ndërtues i socializmit, t'i

ketë të formuluar e të kristalizuara mirë në ndërgjegjen e tij këto çështje të mëdha jetike.

Po t'i ketë të kristalizuara mirë këto parime, atëherë inteligjencia jonë popullore do të shkojë në punë dhe në luftë për ndërtimin e socializmit jo me pikëpamjen që të komandojë klasën, po të udhëhiqet nga klasa, të njohë dhe të jetë e lumtur që punon nën hegjemoninë e saj, të lidhet ngushtë me klasën, shpirtërisht dhe materialisht, të lidhet ngushtë me kolektivin punonjës, të zhdukë nga vetja ndjenjat mikroborgjeze të kryelartësisë dhe të përçmimit të punës prodhuese. Afrim me klasën do të thotë ta ndihmosh atë, por edhe të punosh në prodhim si ajo, ta këshillosh atë, por në radhë të parë të marrësh këshillat e saj, të kesh respekt për diturinë e madhe të saj, për zotësinë e saj në krijim, në zbatim, në realizim, të jesh i disiplinuar si klasa. Ja përsëri një nga temat teorike me një rëndësi të madhe, që Partia duhet t'u zhvillojë pareshtur studentëve dhe inteligjencies, e kam fjalën për disiplinën e proletariatit. Disiplina e klasës nuk është diçka sempliste, siç e katandisin disa, si, për shembull, brendapërbrenda mureve të fabrikës. Kjo disiplinë e klasës është një grumbull i madh parimesh teorike, politike e praktike, që klasa i ka farkëtuar në luftëra e në përpjekje të përgjakshme, kundër një grumbulli tjetër të madh parimesh idealiste në shërbim të kapitalizmit dhe të borgjezisë. Ne vazhdojmë e do të vazhdojmë të luftojmë kundër këtyre mbeturinave mikroborgjeze, akoma të gjalla në ndërgjegjen e njerëzve.

Sa duhet të thellohet puna e Partisë, e organiza-

tës-bazë në të gjitha këto probleme kaq të mëdha? Kush është ai që mund të thotë se ora e historisë, e fizikës ose e letërsisë është më interesante se mbledhja e organizatës-bazë të Partisë, e organizatës së rinisë ose mbledhjet e kurseve të teorisë marksiste-leniniste, në rast se ne në këto mbledhje i shtrojmë kështu, i diskutojmë gjallërisht, i ilustruojmë në këtë mënyrë këto probleme jetike? Jo vetëm që mbledhje të tilla në universitet e në institute të larta, në shkolla, në qendrat e kulturës, të arsimit, të administratës e kudo do të bëhen nga më të gjallat, nga më luftaraket, por nuk kanë për të mjaftuar as një, as edhe dy mbledhje në muaj. Dhe për këto lloj mbledhjesh, për këto lloj mësimesh të mëdha të Partisë dhe të klasës, të përgatitura si duhet, të gjithë njerëzit do të gjejnë kohën, do të lënë mangut gjumin e tyre.

Detyra e Partisë në shkolla, në universitet dhe në institutet e larta është e madhe, e shumanshme, ajo duhet të plotësohet pikërisht në kompleksitetin e saj. Të mos kuptohen detyrat e Partisë, në radhë të parë të organizatave-bazë të Partisë e të rinisë dhe të komiteteve të tyre përkatëse, si diçka për të diskutuar dhe për të marrë disa vendime të çastit, për të korigjuar, ta zëmë, vetëm sjelljen jo të pëlqyer të ndonjë nxënësi, studenti apo pedagogu. Një kuptim i tillë i cekët i punës së Partisë dhe i detyrave të saj shkakton atë formalizëm dhe mungesë pjesëmarrjeje në debate në organizatat-bazë, ku është e nevojshme më tepër se kudo gjatë të ketë një frymë luftarake proletare, ku t'u bëhet luftë rutinës, burokracisë dhe sëmundjeve që e kanë burimin në to.

Thuhet se nuk përgatitet mirë programi i punës në organizata. Këtu është e keqja, që vjen se komunistët nuk janë të qartë për problemet dhe detyrat e të gjithë kolektivit si shkollë, se ata nuk e ndiejnë veten si një unitet i çeliktë proletar në udhëheqje të punëve, nuk ndiejnë përgjegjësinë kolektive që të veprojnë si repart i organizuar brenda repartit të madh të organizuar që është Partia. Këtë formulim ata mund ta kenë mësuar si nxënës e studentë, por nuk veprojnë si pjesëtarë të pararojës së organizuar të klasës. Studentët dhe pedagogët komunistë mund të kenë mësuar në teori ç'është kontrolli punëtor, kontrolli i klasës, por ata, duke qenë anëtarë partie, pavarësisht se nga gjendja nuk janë punëtorë, harrojnë që duhet të jenë vetë të parët që ta zbatojnë me disiplinë proletare atje ku punojnë dhe militojnë këtë parim të madh që është kontrolli punëtor, gjë që do të thotë klasa dhe Partia e saj në fuqi, në udhëheqje.

Partia duhet të rrënjosë te nxënësit e studentët, te pedagogët dhe te mësuesit komunistë kuptimin e drejtë për rolin e unitetit dhe të frymës së pararojës, se vetëm kështu do të edukohet pastaj masa, vetëm kështu çdo komunist i këtij sektori, i kësaj shtrese nuk do të veprojë në veçanti me një frymë individualiste, po do të luftojë që të zhdukë me sukses lëkundjet karakteristike të shtresës, do të luftojë shfaqjet e servilizmit, të oportunizmit dhe të respektit të inferiorëve ndaj hierarkisë administrative, të bazuara në parime jo të shëndosha.

Nxënësit, studentët, pedagogët e mësuesit komunistë, në radhë të parë, dhe, po të jenë këta në radhët

e para, të gjithë të rinjtë, pedagogët e mësuesit e pa-organizuar në Parti, do të zbatojnë e do të përvetësojnë me zell e përpikëri lëndët. Kjo lyp një punë të palodhur mendore e fizike, lyp metoda revolucionare kurdoherë në kërkim, lyp vullnet e disiplinë, lyp, në radhë të parë, kuptim të thellë politik mbi të gjithë këta komponentë, të cilët krijohen dhe kaliten jo rastësisht, por me një edukatë të vëmendshme.

Kush do ta bëjë këtë përveç Partisë? A mungojnë, pra, temat për një apo për një mijë rende dite të organizatës-bazë? Jo, s'mungojnë, ka aq shumë, sa që mund të mos gjesh kohë as të hash, as të flesh, pale të punosh. Por duhet të dish të zgjedhësh, të dish të shpërndash në format e ndryshme të punës së Partisë dhe të anës shtetërore dhe asnjërin të mos lësh mënjane, të mos e harrosh pa e kontrolluar politikisht, ideologjikisht, teknikisht dhe praktikisht.

Asnjë çështje, lëndë e praktikë mësimore nuk duhet t'i shpëtojë syrit vigjilent politiko-ideologjik të Partisë, asnjë shmangie nga një kontroll proletar, nga një ndihmë e korigjim nuk duhet të lejohet, por të luftohen pikërisht formalizmi dhe ndjenja e autoritetit të rremë e joproletar e atyre njerëzve me karakteristikat specifike të kryelartësisë së intelektualit të sëmurë.

Asnjë anë administrative shtetërore nuk duhet t'i shpëtojë kontrollit proletar politik të Partisë në shkolla dhe në universitet, pse këtu të këqijat mund të trashen dhe kjo të bëhet burimi i ndjenjave mikroborgjeze të burokracisë, të servilizmit, të karrierizmit e të arrogancës në të rinjtë tanë. Partia mbi çdo gjë dhe kudo

duhet ta ketë zgjuar syrin politik dhe të ndihmojë e të korrigojë njerëzit.

Aksionet e rinisë dhe puna në prodhim kanë një rëndësi të jashtëzakonshme. Atyre Partia, në shkolla dhe në universitet, duhet t'u vërë rëndësi të posaçme, të mos konsiderohen ato aspak si një shtojcë e fundit e programit vjetor mësimor, si njëfarë pushimi ose kohë e humbur. Në qoftë se konsiderohen kështu nga disa, qoftë edhe në mënyrë të heshtur, kjo do të thotë se këta nuk e kuptojnë aspak vlerën kolosale politike, ideologjike dhe pedagogjike të këtij problemi të madh edukativ për rininë dhe për këdo. Kushdo, por në mënyrë të veçantë rinia studenteske, që në bankat e shkollës duhet të mësohet të punojë fizikisht, të lodhet, të djersijë, të krijojë me mendjen dhe me duart e saj. Me punë dhe në punë të mësohet studenti në shkollën e klasës punëtore, atje të njohë ai forcën, zotësinë, disiplinën dhe vullnetin e saj të çeliktë. Me punë dhe në punë, përbri klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste, të mësojë i riu, punëtori ose kuadri i ardhshëm, ç'do të thotë thjeshtësi proletare, ç'do të thotë të fitosh jetën me djersë dhe jo duke udhëhequr e duke komanduar, atje të shohë se Shqipëria u çlirua me luftë, u ndërtua me luftë, u zbukurua me luftë.

Një veteran proletar, i cili që në vegjëli ka punuar si mekanik për të ushqyer veten, prindërit dhe më vonë fëmijët e tij, që ka vuajtur në regjimet e kaluara të zitë e ullirit, që ka njohur vuajtjet dhe mjerimet e punëtorisë nën regjimin e Zogut dhe shfrytëzimin e egër kapitalist në emigracion, që ka marrë pjesë në

rezistencën kundër pushtuesve dhe që është autori i vjershës që u këndon luftës dhe vrasjes së Qemal Stafës nga fashistët, më thoshte një ditë: «Shoku Enver, lavdi Partisë së klasës sonë punëtore që bëri gjithë këto mrekulli me luftë, me punë, me djersë. Të rinjtë që rriten në socializëm nuk duhet t'i harrojnë aspak vuajtjet e klasës, vuajtjet e popullit, luftërat e tij heroike. Fëmijët e një proletari si unë Partia i mësoi, njëri prej tyre tash është inxhinier, tjetri oficer, i treti punëtor i dalluar. Unë kam një pantallon në shtëpi, pantallon i them unë, pse ai është vetëm një leckë plot me arna, ku s'gjen vend të vësh një gjilpërë. Ky është i vetmi pantallon prej punëtori që kisha unë në kohën e Zogut. Këtë pantallon e kam varur në mur të odës, si një pjesë muzeu dhe u them fëmijëve: «Djemtë e mi, shikojeni këtë dhe kurrë mos harroni Partinë, mos harroni klasën, ndiqni Partinë, ndiqni klasën, të jeni kurdoherë të thjeshtë e punëtorë të palodhur, të jeni trima si populli, si Partia. Socializmi, krijimi i të mirave, të mos ua rritë mendjen, mos harroni vuajtjet e kaluara të popullit»».

Studentët dhe pedagogët duhet ta kuptojnë e ta marrin si duhet vetë në duart e tyre problemin e madh të punës dhe Partia vazhdimisht t'u bëjë të qartë se kjo çështje nuk është një pjesë vetëm e programit shkollor, por pjesë përbërëse e jetës së njeriut, është kuptimi i vërtetë dhe i bukur i jetës së tij. Klasa punëtore dhe fshatarësia në fabrika e në ara ta thithin rininë në punë, ta marrin në patronazh dhe të dërrmojnë pikëpamjet burokratike e thjesht ekonomiste të atyre drejtuesve që nuk e kuptojnë si duhet rëndësi-



në e edukimit të brezit të ri në punën fizike prodhuese.

Sa shumë tema për rende dite të mbledhjeve të organizatave-bazë të Partisë dhe të rinisë përmbajnë këto probleme jetike! Nuk ka veçse të zgjedhësh.

Ose të marrim çështjen e edukimit fiziko-ushtarak të studentëve dhe të rinisë. Sa çështje të shumta partie dalin për këtë problem kaq të rëndësishëm për nxënësit, për studentët dhe për ushtarakët. Unë nuk dëshiroj të zgjatem më tej në këtë problem, por nga Partia, nga rinia, nga studentët dhe ushtarakët duhet të kuptohet se ky edukim ka për qëllim zhvillimin e shëndetit të rinisë, edukimin progresiv të të rinjve për të mësuar artin ushtarak, për të qenë ushtarë të vendosur, trima, të përgatitur nga çdo anë për mbrojtjen në çdo rast të pavarësisë së atdheut, të lirisë së popullit, për mbrojtjen e socializmit dhe të Partisë nga çdo armik. Ky edukim është njëkohësisht ideopolitik dhe tekniko-ushtarak. Në këtë drejtim duhet të kuptohet mirë edhe çështja se çdo student, që në format e ndryshme mbaron shërbimin ushtarak, nuk del veçanërisht oficer dhe komandant, por në radhë të parë ai del një ushtar i republikës. Kjo çështje që po ngre ka rëndësi të veçantë ideologjike, që të mos krijohet mendimi se studentët që mbarojnë universitetin dhe shkollat e tjera të larta do të jenë vetëm kuadro drejtues ose oficerë komandues, qoftë në sektorët civilë, qoftë në ata ushtarakë.

Ka edhe probleme të tjera që duhet t'u tërheqin vëmendjen organizatave të Partisë dhe të rinisë në shkolla. Rinia jonë studentore ka një nivel të lartë zhvillimi dhe interesa të gjerë. Në përshtatje me të

është e domosdoshme që me studentët të diskutohen probleme jetësore të moralit, të artit, të shijes, të shkencës, të teknikës etj., duke i parë ato gjithmonë në një vështrim të mprehtë ideopolitik, në prizmin e botëkuptimit tonë marksist-leninist.

Pra, si konkluzion, i gjithë edukimi i rinisë shkollore e universitare është një problem i gjerë, kompleks, vendimtar. Vetëm udhëheqja si duhet nga Partia e gjithë këtij edukimi, në të gjitha veçoritë e tij, do të bëjë që të korrim rezultatet që kërkojmë. Prandaj rëndësi vendimtare marrin edhe aktivitetet e shumëllojshme dhe mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë në shkolla, në universitet dhe në institutet e larta, si edhe ato të organizatave-bazë të Bashkimit të Rinisë së Punës.

Unë kam besim të plotë se organizatat e Partisë e të rinisë në shkolla do të hidhen në luftë edhe më me vrull për të zbatuar detyrat dhe orientimet e Partisë për edukimin e gjithanshëm komunist të rinisë shkollore e studentore, sidomos për edukimin ideopolitik të saj, do të bëhen akoma më të gjalla e luftarake, do të revolucionarizojnë më tej gjithë jetën dhe veprimtarinë e tyre.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 344. Tiranë, 1970*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## REVIZIONISTËT SOVJETIKË NË LËMSHIN E KONTRADIKTAVE TË PAZGJIDHSHME

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

15 maj 1970

Një gjendje e rëndë, plot vështirësi e kriza, ka përfshirë të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë së Bashkimit Sovjetik. Ajo është bërë aq e mprehtë e aq e dukshme si në fushën ekonomike e shoqërore, ashtu edhe në atë të politikës së brendshme e të jashtme, sa nuk ka mënyrë si të fshihet më. Për të flitet poshtë e përperjetë; për të detyrohen të bëjnë fjalë edhe shtypi, edhe njerëzit e vetë klikës revizioniste sovjetike, e cila tani po korr atë që mbolli në rrugën e tradhtisë e të kundërrevolucionit. Ajo mbolli erën dhe po korr furtunën.

Pas vdekjes së Stalinit, klika revizioniste hrushoviane mori përsipër rolin e ndyrë të kthimit të Bashkimit Sovjetik nga një shtet socialist në një shtet kapitalist, natyrisht, duke u munduar të ruajë maskën e socializmit për të mashtruar popullin dhe për të evituar kundërshtime e përleshje të rrezikshme. Këtë kurs ajo e ndjek me këmbëngulje e zell të madh në të

gjitha fushat, por jo pa vështirësi e disfata serioze, që ia çoroditin planet, demaskojnë vijën e saj tradhtare e antimarksiste, thellojnë kontradiktat e saj me klasën punëtore dhe me masat punonjëse në Bashkimin Sovjetik dhe me popujt e forcat revolucionare të botës.

Në këtë rrugë theu qafën Hrushovi. Ai qe demaskuar në sytë e popujve si antimarksist i tërbuar dhe varrmihës i revolucionit e i socializmit. Ai shkallmoi Partinë Bolshevike dhe pushtetin e sovjetëve, të ngritur me aq sakrifica e heroizëm nga proletariati dhe nga fshatarësia kolkoziane sovjetike nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit. Ishte lufta parimore e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e gjithë forcave të shëndosha marksiste-leniniste, ishte demaskimi i pamëshirshëm që ajo u bëri politikës dhe veprimtarisë së tij kundër-revolucionare, si dhe rezistenca e vetë popullit sovjetik, që e bënë Hrushovin të përfundojë në koshin e plehrave të historisë.

Trojka hrushoviane që e zëvendësoi atë, ndoqi të njëjtën vijë me një zell akoma më të madh, duke ia kaluar vetë ustait si në politikën e brendshme, ashtu edhe në atë të jashtmen, ndonëse me forma më të stërholluara.

Në radhë të parë ajo vazhdoi vijën e Hrushovit për degjenerimin e mëtejshëm të partisë, e cila tani, veç emrit, nuk ka asgjë tjetër marksiste-leniniste dhe është kthyer në një parti oportuniste të tipit socialdemokrat, në një instrument mashtrimi e shtypjeje në duart e elementëve karrieristë e burokratë të borgjezisë së re sovjetike, të kësaj kaste të privilegjuar që u ka hipur në zverk klasës punëtore e popullit

punonjës. Diktatura e proletariatit ka pushuar së ekzistuari dhe prapa parullës antimarksiste të «shtetit të të gjithë popullit» është vendosur diktatura fashiste e klasës së re shtypëse e shfrytëzuese. Borgjezia ndërkombëtare nuk përmbahet nga gëzimi kur shikon se ideologjia e kultura e saj po zëvendësojnë ideologjinë dhe kulturën socialiste në Bashkimin Sovjetik, se normat dhe morali që sundojnë sot atje, nuk ndryshojnë në asgjë nga marrëdhëniet e degjeneruara borgjeze dhe nga ai produkt i neveritshëm i shoqërisë kapitaliste që quhet «mënyrë amerikane e jetesës».

Ekonomia sovjetike ka ndeshur në vështirësi të pakapërcyeshme dhe po shkon drejt falimentimit. Sistemi i ri ekonomik, reforma që u adaptua disa vjet më parë nga udhëheqja revizioniste sovjetike, kishte për detyrë të krijonte kushtet dhe t'i hapte rrugën veprimit të ligjeve kapitaliste në sferën e prodhimit. Heqja dorë nga plani unik e i përgjithshëm shtetëror, decentralizimi i prodhimit dhe vënia në komandë e fitimit si parimi bazë dhe forca themelore lëvizëse e të gjithë ekonomisë, shkallmuan strukturat e saj socialiste dhe u dhanë një shtytje të mëtejshme drejt degjenerimit kapitalist. Në qoftë se Hrushovi hodhi bazat dhe filloi restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, pasardhësit e tij e çuan atë përpara si në gjerësi, ashtu edhe në thellësi.

Tani revizionistët sovjetikë po shijojnë frytet e hidhura të punës së tyre. Rivendosja e kapitalizmit solli me vete edhe gjithë sëmundjet kronike të sistemit borgjez. Ndërmarrjet, të cilat u lejuan të prodhojnë çfarë të duan e si të duan, të shesin e të blejnë ku të

duan, të vendosin vetë për çmimet e prodhimit e të shitjes, të zgjerojnë ose të pakësojnë sipas interesit të tyre investimet, të shtojnë ose të pakësojnë vetë numrin e punëtorëve, hynë në luftë me njëra-tjetrën për lëndën e parë, për kreditë bankare, për tregjet, për teknikën etj. Rendja pas fitimit mbi bazën e konkurrencës, e cila u dha fund solidaritetit socialist dhe ndihmës reciproke midis kolektivave punonjës, lindi disproporcionet dhe anarkinë në prodhim. U legalizua dhe mori të drejtën qytetare parimi «i shenjtë» i borgjezisë se më i fuqishmi mbyl më të dobëtin. Kanë rënë ritmet e rritjes së prodhimit industrial, planet nuk realizohen, falimento i plani shtatëvjeçar «çudibërës» i Hrushovit, po falimenton edhe plani pesëvjeçar i Brezhnjevitet e i Kosiginit, që u mburrën se do të ndreqnin «dobësitë» e Hrushovit. Vendi i sovjetëve, me burime kolosale lëndësh të para, nuk siguron dot industrinë e vet me lëndë të tilla, në një kohë kur ato i eksporton me çmim të lirë në vendet kapitaliste. Në bujqësi prodhimi i drithit, i mishit dhe i produkteve të tjera blegtorale bie vazhdimisht, miliona hektarë tokë kanë mbetur djerrë pesë vjetët e fundit. Shpërdorimet kanë marrë dhenë në të gjithë sektorët. Burokracia revizioniste ecën me vrap në konsolidimin e pozitave të saj si klasë sunduese.

Të gjitha tronditjet e ekonomisë revizioniste, vërshtirësitë dhe krizat e saj ranë mbi kurrizin e punonjësve. Papunësia, kjo sëmundje e rëndë e sistemit kapitalist, kamxhiku i egër që u qëndron kurdoherë mbi krye punëtorëve dhe u helmon tërë jetën, është bërë një fenomen i zakonshëm në Bashkimin Sovjetik. Dë-

shira e borgjezisë së re për t'u pasuruar sa më shpejt ka çuar në rritjen e vazhdueshme të çmimeve të mjetëve kryesore të jetesës e, për pasojë, në zhvleftësimin e mëditjes së masës kryesore të punëtorëve e të fshatarëve. Janë rritur taksat e drejtpërdrejta nga popullsia, pakësohen fondet kulturore e sociale, shtohen shpenzimet e shërbimeve etj. Reforma kapitaliste e ekonomisë dhe e drejtimit të shtetit jo vetëm çon në zhvillimin e pabarabartë, në kurriz të njëri-tjetrit, të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, të rajoneve e të republikave, por flak në masë punëtorët në rrugë, shkakton konflikte shoqërore e nacionale, thellon ndarjen klasore, bën që të ashpërsohet më tej lufta klasore.

Vepra historike e Leninit dhe e Stalinit e zgjidhjes së çështjes nacionale mbi bazat e marksizëm-leninizmit, u shkallmua nga renegatët hrushovianë. Është gjallëruar dhe vepron me shpatë zhveshur borgjezia shoviniste rusomadhe, e cila nuk ngurron t'i kalojë edhe në mitraloz, si dikur cari në satër, masat popullore të Ruisë e të kombësive të tjera që guxojnë të kundërshtojnë politikën shtypëse e antisocialiste të klikës në fuqi. Në republikat e ndryshme sovjetike po ngre krye e hedh shtat fara e nacionalizmit, po lindin konflikte nacionale e tendenca separatiste, që janë rrjedhim i pashmangshëm i politikës revizioniste të rivedosjes së kapitalizmit.

Kjo gjendje nuk mund të mos shkaktojë pakënaqësi e zemërim në masat e gjera punonjëse dhe këto nuk mund të mos gjykojnë se kush janë fajtorët. Klika renegate që është në fuqi, duke e ndier veten pisk, kërkon të manovrojë. Me qëllim që të qetësojë e të

mashtrojë masat, ajo pranon faktin e vështirësive të ndryshme, por fajin ua hedh institucioneve e individëve të ndryshëm, të cilët gjoja nuk kanë zbatuar «si duhet» reformat dhe mbajnë kështu përgjegjësinë kryesore, siç ka deklaruar në disa raste kohët e fundit Brezhnjevi, duke premtuar njëkohësisht reforma të reja, që gjoja do t'i shërojnë të gjitha sëmundjet nga të cilat vuan tani ekonomia sovjetike. Pakënaqësia e masave punonjëse që janë ngopur me premtime boshe e me fjalime demagogjike, po merr përpjesëtime të mëdha.

Disfatat që pësoi ekipi i ri udhëheqës sovjetik në politikën e jashtme nuk janë më të vogla nga ato të Hrushovit. Sado mjegull e mashtrime të lëshojë e të bëjë ai në sytë e popullit sovjetik, ky nuk mund të mos shikojë kthesën prej 180 gradësh që ka bërë Bashkimi Sovjetik në fushën ndërkombëtare nën udhëheqjen e Brezhnjevi-Kosiginit, nuk mund të mos shikojë faktin se sot Bashkimi Sovjetik është vënë në konflikt me gjithë popujt revolucionarë e lirishtarë të botës, me miqtë më të ngushtë e më të afërt të popullit sovjetik dhe është bërë aleat me armiqtë e tij më të egër, me imperializmin amerikan, në radhë të parë, si dhe me militarizmin gjermanoperëndimor e me atë japonez, zhvillon një bashkëpunim të neveritshëm me regjimet më reaksionare në Azi e në Amerikën Latine. Agresioni i armatosur kundër Çekosllovakisë i demaskoi krerët revizionistë të Moskës si armiqtë të rrezikshëm të lirisë e të pavarësisë së popujve. Mbështetja ndërkombëtare për Bashkimin Sovjetik, autoriteti i tij si shtet socialist, përkrahja dhe dashuria e proletariatit dhe e popujve të botës ndaj tij nuk ekzistojnë më. Të gjitha këto



populli sovjetik nuk mund të mos i shohë e të mos nxjerrë konkluzionet përkatëse.

Politika imperialiste revizioniste që mbështetet në dhunën dhe në forcën e armëve, militarizimi gjithnjë e më shumë i ekonomisë, gara e armatimeve nuk mund të mos shtynin në planin e parë grupet ushtarake dhe të shtonin pretendimet e tyre për pjesëmarrje të drejt-përdrejtë në përcaktimin, në instancën e fundit, të politikës së jashtme e të brendshme. Nuk është e rastit që emrat e mareshalëve e të admiralëve si Greçko, Jakubovski, Gorshkov e të tjerë përmenden aq shpesh në Bashkimin Sovjetik, sikur vendi të ishte në luftë.

Tradhtia veç prish, nuk ndërton, por shkatërron, siç bëri tradhtia e revizionistëve hrushovianë, që uzurpuan pushtetin në Bashkimin Sovjetik. Ajo shkatërroi partinë, diktaturën e proletariatit, ekonominë sovjetike. Ajo u vuri minat kampit të socializmit, lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, luftës nacional-çlirimtare të vendeve të shtypura apo të varura nga imperializmi. Të gjitha këto i interesojnë së tepërmi borgjezisë ndërkombëtare, me imperializmin amerikan në krye, prandaj ajo e ka ndihmuar dhe e ndihmon klikën revizioniste sovjetike me të gjitha mënyrat që të ecë sa më përpara në rrugën e kapitalizmit e të kundërrevolucionit. Bashkimi Sovjetik pushoi së qeni qendër e revolucionit botëror dhe, nga mbështetje e frymëzim për popujt liridashës e revolucionarë që ishte dikur, është bërë një shtet imperialist e fashist, që i ka kthyer gjithë potencialin dhe bateritë e veta kundër socializmit, pavarësisë dhe zhvillimit sovran të popujve. Pikërisht në këtë rrugë e mbi këto baza, kur

imperializmi amerikan u bind se Bashkimi Sovjetik jo vetëm nuk përbënte më rrezik për sistemin kapitalist botëror, por mund të ishte një partner i rëndësishëm për shpëtimin e këtij sistemi dhe për të shuar valët e revolucionit proleçar në ngritje anembanë botës, u hodhën themelet e po zhvillohet aleanca e përbindshme midis Bashkimit Sovjetik e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleancë që sot përbën shtyllën e kundërrevolucionit botëror dhe rrezikun më të madh për lirinë e popujve dhe për sigurimin ndërkombëtar.

Imperializmi amerikan dhe kapitali botëror, duke ndihmuar revizionistët sovjetikë për rivendosjen e kapitalizmit, kanë qëllimet dhe përfitimet e tyre: së pari, një Bashkim Sovjetik kapitalist është më pak i rrezikshëm për ta se një Bashkim Sovjetik socialist, përveç faktit që edhe si shtet kapitalist ata duan ta dobësojnë dhe po e dobësojnë; së dyti, kjo u krijon mundësi të shpartallojnë perandorinë revizioniste sovjetike duke i shkëputur satelitët nga Bashkimi Sovjetik me mjete e me rrugë të ndryshme; së treti, duke koordinuar planet dhe ndihmën në fushën ndërkombëtare, ata duan ta ndërsejnë Bashkimin Sovjetik kundër lëvizjeve revolucionare e çlirimtare në vendet e ndryshme.

A kanë sukses në këto synime imperializmi amerikan dhe kapitali botëror? Kjo nuk mund të mohohet. Gjendja aktuale e Bashkimit Sovjetik në të gjitha fushat, siç u përmend më lart, tregon rezultatet e kursit të rivendosjes së kapitalizmit.

Amerika dhe vendet e tjera kapitaliste kanë hapur kasafortat e po i japin kredi të mëdha qeverisë sovje-

tike, miliarda dollarë, marka, sterlina, franga në kushte mjaft tërheqëse. Tradhtarët revizionistë tani po trokasin në të gjitha bankat e botës kapitaliste. Bashkimi Sovjetik sot është bërë grumbulluesi më i madh i kredive të huaja. Politika e «dyerve të hapura» për kreditë e huaja nuk mund të mos çonte në afrim me militaristët revanshistë të Gjermanisë Perëndimore dhe me militaristët japonezë, të cilët, «me rrugë paqësore», po realizojnë planet e tyre të vjetra imperialiste për të depërtuar në Bashkimin Sovjetik dhe sot janë bërë, pas imperialistëve amerikanë, miqtë më të ngushtë të sundimtarëve të Kremlinit. Po duken shenjat e para se trustet e mëdha perëndimore po hartojnë plane për të ndërtuar industrinë e vet në Bashkimin Sovjetik, e cila do të administrohet me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë dhe do të mbetet pronë e tyre. Mbreti i automobilëve të Amerikës, Fordi, foli mjaft qartë për këtë gjatë vizitës që bëri muajin e shkuar në Moskë. Është e qartë si drita e diellit se monopolet imperialiste nuk u çmendën që të ndihmojnë ndërtimin e socializmit e të komunizmit në Bashkimin Sovjetik, por kanë objektiv të qartë për ta shtyrë këtë vend sa më thellë në një rrugë tjetër të përcaktuar shumë mirë prej tyre. Kreditë e tyre jepen kryesisht për të zhvilluar sektorët e mallrave të konsumit e të luksit. Në këtë mënyrë borgjezia ndërkombëtare, nga njëra anë, nxit e kënaq kërkesat e borgjezisë së re sovjetike, e fut këtë më thellë në mënyrën e jetesës kapitaliste, nga ana tjetër, i jep mundësi klikës Brezhnjev-Kosigin dhe e nxit që mjetet e veta t'i investojë në sektorë të tjerë,

sidomos në sektorët ushtarakë, për ta shtyrë më tej në politikën agresive. Fuqitë imperialiste veprojnë tani me udhëheqjen sovjetike ashtu siç vepruan me Hitlerin para Luftës së Dytë Botërore, të cilin e nxitën drejt Lindjes kundër Bashkimit Sovjetik. Tjetër punë se hesapet u dolën të gabuara dhe Hitleri u kthye kundër tyre. Risku në gjithë këtë allishverish, me përpjesëtime të mëdha e qitje të largët, ekziston, por ai është i llogaritur, sigurisht aq sa mund të llogaritet në kuadrin kontradiktor të kapitalizmit.

Si rezultat i kursit antileninist të ndjekur për vite me radhë nga udhëheqja hrushoviane, Bashkimi Sovjetik është dobësuar në lëmin e prodhimit, në fusha të tjera ai mbetet prapa Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe distanca që i ndan jo vetëm nuk zvogëlohet, por bëhet gjithnjë më e madhe. Depërtimi i kapitalit botëror në formë kredie apo në një tjetër do ta thellojë këtë pabarazi dhe e dobëson gjithnjë e më shumë Bashkimin Sovjetik, gjë që nuk mund të mos shikohet me interes nga borgjezia perëndimore. Fakt është se në fushën e shkëmbimeve që zhvillon me vendet kapitaliste, Bashkimi Sovjetik kryesisht u shet lëndë të para, si: minerale, gaz, naftë, lëndë druri; me këtë shlyen edhe kreditë që merr. Kapitali botëror influencon drejtpërdrejt në vetë strukturën ekonomike të Bashkimit Sovjetik, gjë që patjetër çon në ndryshime rrënjësore në superstrukturë, veç influencave të drejtpërdrejta që Perëndimi ushtron, në të gjitha nivelet, në institucionet e superstrukturës sovjetike.

Politika e saj e jashtme antimarksiste e kundërrivolucionare, siç u theksua më lart, është burimi tje-

tër i madh i krizës së pazgjidhshme në të cilën është zhytur udhëheqja revizioniste sovjetike.

Imperialistët e rinj sovjetikë nuk i zgjedhin më mjetet kur është puna për të arritur objektivat e tyre ekspansionistë, qoftë ndaj aleatëve të vet revizionistë, qoftë ndaj vendeve të tjera. Në bashkëpunim me imperialistët amerikanë dhe njëkohësisht në garë e në kontradiktë me ta për tregje e zona influence, ata nuk mungojnë të praktikojnë edhe politikën e depërtimit imperialist politik e ekonomik. Njësitë e shumta të flotës ushtarako-detare sovjetike që si kuçedra po sillen rrotull në ujërat e Mesdheut, të Oqeanit Indian dhe të atij Paqësor, nuk janë dërguar në këto dete e oqeane për shëtitje, po për të hedhur kthetrat në ato zona, për presione, shantazhe e demonstrim force. Ekspansioni revizionist sovjetik synon tani hapësirat e gjera të Azisë, të Afrikës e të Amerikës Latine.

Politika e sotme e udhëheqësve sovjetikë është një politikë tipike kolonialiste e neokolonialiste. Është një fakt tanimë i njohur se, nën presionin e shtuar politik, ekonomik, ushtarak, vendet revizioniste të varura nga Moska po trajtohen prej saj si koloni të zakonshme, gjë që ka shkaktuar kontradikta të reja në frontin e vendeve revizioniste. Kështu, mosmarrëveshjet për çështjet politike, ekonomike e ushtarake jo vetëm që nuk pakësohen, por shtohen vazhdimisht. Mbi të vjetrat dalin të reja, akoma më të komplikuar, më të thella e më të mprehta. Një plagë e hapur dhe e pashërueshme ka mbetur problemi çekoslovak. Me gjithë masat e rënda që kanë marrë revizionistët sovjetikë për nënshkrimin e popullit çekoslovak, gjendja është akoma shu-

më larg «normalizimit». Rezistenca që po gjejnë pushtuesit revizionistë në Çekoslovakia është një goditje e vazhdueshme që u bëhet autoritetit dhe prestigjit ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik, një demaskim i përhershëm i parullave të tyre demagogjike e mashtruese. Përderisa tanket sovjetike qëndrojnë në Pragë dhe grykat e mitralozëve rrinë të ngrehura drejt popullit çekoslovak, cili është ai që mund t'u zërë besë qëllimeve «paqedashëse» të politikës së jashtme sovjetike për të cilat betohet Brezhnjevi? Dhe traktati i «miqësisë dhe i aleancës» nën çizmen sovjetike, që nënshkruan ditët e fundit Brezhnjev-Kosigini me vasalët e tyre në Pragë, duke ngritur në «parim universal» ndërhyrjen e armatosur sovjetike në çdo vend tjetër të «bashkësisë» revizioniste gjoja në emër të mbrojtjes së socializmit, ka ngjallur shqetësime të reja në mjaft nga këto vende.

Dilema midis zgjedhjes së rrugës së dhunës ose mjeteve paqësore për të siguruar sundimin mbi Çekoslovakinë dhe mbi vendet e tjera satelite, qëndron e pazbutur përpara udhëheqësve të Moskës, ashtu siç ishte edhe në prapun e 21 gushtit 1968. Brezhnjevi nxori teorinë e «sovrانيتetit të kufizuar», por me gjithë servilizmin e hipokrizinë ndaj padronit moskovit, asnjë nga klikat sunduese të vendeve revizioniste nuk është treguar entuziaste për këtë filozofi prej feudalesh mesjetarë. Fakt është se kjo teori ka shkaktuar kudo në vendet revizioniste pështjellim dhe pasojat e saj politike shpejt ose vonë do të dalin në shesh.

Në një rezistencë jo shumë të kamufluar po ndesh edhe synimi tjetër i krerëve të Kremlinit për t'i lidhur

automatikisht vendet satelite me planet e aventurave të tyre ushtarake. Vështirësitë që u kanë dalë shtabeve të Moskës për krijimin e «forcave speciale» të Traktatit të Varshavës, shprehin pikërisht këtë atmosferë.

Gjendjen e mungesës së unitetit, të fërkimeve e të mosbesimit midis klikave revizioniste e bën edhe më të nderë politika e «ndërtimit të urave», e afrimit dhe e bashkëpunimit që Shtetet e Bashkuara të Amerikës e vendet e tjera perëndimore ndjekin ndaj tyre. Krerët e Kremlinit i shikojnë me shumë shqetësim flirtet që vendet e tjera revizioniste bëjnë me botën perëndimore, por ata janë në pozitë të dobët për t'i ndaluar, kur vetë janë hedhur në prehrin e miqësisë së madhe me SHBA-në, Gjermaninë Perëndimore, Francën, Anglinë etj. Afrimi Moskë-Bon dhe marrëdhëniet e reja që po krijohen midis Gjermanisë Federale e vendeve të tjera revizioniste, krijojnë dilema të reja në Kremlin, zgjidhja e të cilave nuk është nga më të lehtat.

Kursi i saj antimarksist e kundërrevolucionar e ka bërë klikën udhëheqëse revizioniste të Moskës të ndeshet gjithnjë e më shumë me probleme të mëdha e të pazgjidhshme, të acarojë edhe më tepër kontraktat e brendshme e të jashtme, e ka vënë në një luftë të papajtueshme me popullin sovjetik dhe me popujt revolucionarë të botës.

Për t'i bërë ballë kësaj situatë, nga njëra anë, ajo shton demagogjinë duke shumëfishuar betimet e «besnikërisë» ndaj marksizëm-leninizmit e idealeve të Revolucionit të Tetorit, nga ana tjetër, shtrëngon vidhat,

përdor frikën dhe forcon diktaturën fashiste. Fushata e shfrenuar propagandistike dhe spekulimet e ulëta që ajo organizoi me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Leninit, janë një shembull tipik i artit të saj të demagogjisë pa skrupull. Leninin e leninizmin e kanë luftuar shumë antikomunistët e hapët e të fshehtë, oportunistët të të gjitha ngjyrave dhe reaksionarë të tërbuar. Por të gjithë këta të paktën e shpallnin veten si kundërshtarë dhe mbronin hapur klasën e tyre. Kurse revizionistët hrushovianë e luftojnë atë duke u hequr si leninistë. Çka është më monstruoze, ata përpiqen që shpirtin e tyre borgjez e imperialist t'ua atribuojnë Leninit e leninizmit. Fyerje e poshtërim më të madh nuk ka njohur historia.

Në këtë taktikë djallëzore bëjnë pjesë edhe fjalët që sundimtarët e Kremlinit pëshpëritin me gjysmë zëri se gjoja po kthehen në politikën e Stalinit, në idetë e në praktikën e tij të udhëheqjes, të cilat e kishin bërë Bashkimin Sovjetik një shtet të fuqishëm socialist, me një unitet të shëndoshë të brendshëm dhe me autoritet të madh ndërkombëtar, me një ekonomi të përparuar dhe një dinamizëm rritjeje të shpejtë. Ky është një tjetër sakrilegj dhe mistifikim skandaloz. Jo pa qëllim sot në Bashkimin Sovjetik lejohet aty-këtu të shkruhet ndonjë fjalë e mirë për Stalinin, të dalë fytyra e tij në ndonjë film dokumentar apo historik dhe të përmendet në ndonjë fjalim të rastit. Dhe jo vetëm në Moskë, në Pragë apo në Sofje përhapen me porosi parulla se gjoja klika brezhnjevine po rehabiliton gradualisht Stalinin e po kthehet në vijën dhe në me-



todën e tij, po praktikon «neostalinizmin». Kësaj borie i fryn edhe propaganda borgjeze në Perëndim, të gjithë ata që janë të interesuar të shpëtojnë hrushovizmin dhe kursin e rivendosjes së kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik nga revolta eventuale e popullit sovjetik, që, më në fund, do të shohë e do të veprojë. Kjo propagandë dinake bëhet për të mashtruar popullin sovjetik, për të mashtruar popujt e tjerë dhe revolucionarët, për të përhapur iluzione dhe mjegullën që mbulon krimin e tradhtinë. Edhe parulla e «neostalinizmit» është fyerje për Stalinin, për idetë dhe veprën e tij gjeniale. Orvatjet e paturpshme të revizionistëve sovjetikë për t'ia veshur Stalinit metodat e tyre policore fashiste, politikën e tyre antimarksiste e imperialiste, nuk mashtrojnë dot revolucionarët dhe popullin sovjetik, sepse Stalini nuk ka qenë i tillë, por një marksist e një internacionalist i madh, armik i betuar i oportunistëve e i renegatëve të çdo ngjyre, i fashizmit e i imperializmit.

Klika e Brezhnjev-Kosiginit përmend parullat e drejta të kohës së Stalinit, si nevoja e «forcimit të udhëheqjes së partisë», e «forcimit të disiplinës proletare», e «forcimit të centralizmit demokratik», jo në kuptimin e tyre të vërtetë marksist dhe me qëllim që të rivendosë normat e partisë leniniste, sepse një parti e tillë nuk ekziston më në Bashkimin Sovjetik, po për të justifikuar masat e saj shtypëse, për të forcuar pushtetin e saj fashist, për të mos i lejuar masat të gjykojnë për kushtet e rënda në të cilat janë katandisur dhe të dënojnë ata që, duke braktisur mësimet e

Leninit e të Stalinit, janë përgjegjës për këtë situatë. Sado përpjekje të bëjnë Brezhnjevët, Kosiginët dhe gjithë miqtë e tyre, qoftë duke i sharë ose «duke i mburrur» emrat e Leninit e të Stalinit, mësimet e idetë e tyre as i errësojnë as i përvetësojnë dot dhe ato do t'i çojnë në këmbë revolucionarët e vërtetë dhe proletariatin sovjetik që të përmbysin nga themeli këtë bandë tradhtarësh e armiqsh të betuar të socializmit e të leninizmit.

Gjendja e vështirë e Bashkimit Sovjetik është shtrirë në të gjitha fushat, edhe në ekonomi, edhe në politikë, edhe brenda, edhe jashtë. Ajo dëshmon se revizionizmi sovjetik tani ka hyrë në një fazë të re të krizës së tij, ka hyrë në krizën e tij të përgjithshme dhe fundi i tij i palavdishëm është i pashmangshëm. Nyjet e kontradiktave janë pleksur keq. Disfatat e njëpasnjëshme dhe frika e dhënies llogari për tradhtinë e krimet e tij kanë ngjallur grindje e mosmarrëveshje edhe në vetë grupin udhëheqës revizionist të Moskës. Tani plaga është bërë gangrenë që ka përfshirë gjithë trupin. Operacioni është i domosdoshëm. Brezhnjevi e kompani, sigurisht, do të dëshironin të bënin ndonjë operacion si ai që bënte kur hoqën Hrushovin, mbase këtë radhë mendojnë të heqin qafe më shumë se një e këtyre t'ua veshin të gjitha gjynahet e disfatat, me shpresë se kështu do të fitojnë edhe njëfarë kohe, gjatë së cilës do të përpiqen të konsolidojnë pushtetin e tyre fashist; t'u mbyllin gojën të pakënaqurve, të shtypin çdo rezistencë. «Rregullimet» që kërkojnë të bëjnë revizionistët e rëndojnë edhe më keq gjendjen, the-

llojnë më shumë kontradiktat dhe krizën që i ka mbërthyer.

Revizionistët dhe aleatët e tyre borgjezë mundohen të krijojnë bindjen se situata mund të përmirësohet me zëvendësimin e disa personave në sferat e udhëheqjes, ose me disa reforma e korrigjime: jo të mëdha në fushën e ekonomisë. Kjo është një orvatje e bërë me qëllim, për të fshehur shkaqet dhe burimet e vërteta, për të mos nxjerrë në shesh se ajo është një krizë politike, pasojë e pashmangshme e rivendosjes së regjimit kapitalist, e gjithë vijës dhe politikës anti-marksiste e borgjeze të Hrushovit dhe pasardhësve të tij që vazhduan hrushovizmin pa Hrushovin dhe sot mbajnë në duart e tyre pushtetin e uzurpuar.

Për këdo është e qartë se me këmbimin e disa personave në udhëheqje nuk do të ndërrojë gjendja në Bashkimin Sovjetik dhe aq më pak mund të mendohet se do të ndryshojë kursi i tanishëm i fashistizimit brenda dhe i sundimit e i ekspansionit imperialist jashtë. Në rast se krerët revizionistë të Bashkimit Sovjetik sot grinden midis tyre, këtë nuk e bëjnë për parime. Ata zihen se kush është më i zoti të mashtrojë e të tradhtojë më shumë popullin sovjetik e popujt e tjerë, kush është më i aftë të forcojë më tej sistemin e shtypjes e të agresionit. Ata që sundojnë sot në Kremlin janë të gjithë grupe hajdutësh të së njëjtës strofke. Që të ndryshojë efektivisht gjendja, duhet pastruar e gjithë strofka, duhet të zhduket e gjithë fara e tyre. Vetëm rivendosja përsëri e diktaturës së proletariatit, vetëm një revolucion i ri si ai i Tetorit të Madh, do ta rivendosë Bashkimin Sovjetik në rrugën

e mëparshme socialiste, vetëm ai do t'i kthejë atij emrin e lavdinë e dikurshme. Dhe kjo është detyrë e vetë popullit sovjetik.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 115 (6779), 15 maj 1970*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 582*

## TE PËRMIRËSOJMË VAZHDIMISHT PUNËN NË SHKOLLË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 maj 1970

Problemi për të cilin na raportohet nuk është i lehtë, megjithëkëtë në asnjë mënyrë s'duhet të jemi pesimistë, por njëkohësisht të mos mendojmë se brenda një viti i kemi zgjidhur të gjitha çështjet e koklavitura që kanë lidhje me të. Do të kalojë një kohë që direktivat e drejta të Komitetit Qendror të Partisë të gjejnë zgjidhjen më të plotë dhe problemet që do të na dalin përpara gjatë zbatimit të kësaj reforme të sqarohen më mirë.

Mendoj se për zbatimin e orientimeve të Partisë për shkollën është bërë një punë e mirë nga kadro të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, nga mësues, nga

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e orientimeve të Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të PPSH në planet e në programet e reja mësimore të shkollave, si dhe në tekstet e reja shkollore».

pedagogë dhe nga shokë që merren me këto probleme të mëdha e të rëndësishme. Direktivat e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë, në përgjithësi, siç po shohim, janë kuptuar drejt. Sigurisht, te mjaft mësues ka akoma ndikime të vjetra dhe shfaqje të konservatorizmit, por mund të themi se, në përgjithësi, ata i kanë kuptuar këto direktiva dhe bëjnë përpjekje të lavdërueshme që t'i vënë në jetë. Ky fakt është inkurajues, por ne nuk e flemë mendjen duke thënë se punët po ecin si në gjalpë.

Qysh tani kanë dalë në pah mjaft probleme që kërkojnë zgjidhje, siç janë ngarkesa e nxënësve dhe e mësuesve dhe përpjekjet që duhen bërë për normalizimin e mëtejshëm të saj; kuptimi i thellë dhe futja si duhet e boshtit ideologjik marksist-leninist në shkollë, që realizohet me anë të lëndëve të veçanta, por edhe nëpërmjet mishërimit të parimeve marksiste-leniniste në të gjitha lëndët e tjera; realizimi i këtij boshti në tekstet shkollore; çështja e metodave të mësimit e të edukimit, që duhen për realizimin e këtyre pikësnyimeve; kualifikimi i mësuesve e i pedagogëve etj. Të gjitha këto nuk janë gjëra që zgjidhen me një direktivë, as edhe brenda një viti.

Problem me të vërtetë i madh është zbatimi i këtyre kritereve në tekstet shkollore, për të cilat po punohet. Tekstet nuk mund të përgatiten brenda një kohe të shkurtër as si sasi, as si cilësi, por është e mirë dhe pozitive puna që po bëhet në këtë drejtim, që merren zotime dhe caktohen detyra. Njerëzit e ngarkuar me përgatitjen e teksteve shkollore janë shumë të interesuar që ato t'u përshtaten sa më mirë orientimeve të

Partisë, kushteve dhe kërkesave të socializmit në vendin tonë, nevojave në rritje të nxënësve e të studentëve etj.

Edhe pasi të hartohen e të botohen tekstet e reja, prapë nuk mund të themi se mbaroi puna me to. Vazhdimisht do të bëjmë tekste të reja dhe vazhdimisht do të dalë nevoja e përmirësimit të tyre<sup>1</sup>. Duke u ngritur niveli ynë i përgjithshëm, niveli i shkollës, i mësuesve dhe i nxënësve, do të ngrihet edhe niveli i teksteve. Shkenca e teknika do të ecin përpara dhe këto zhvillime do të gjejnë pasqyrimin e vet edhe në tekstet shkollore. Për të gjitha këto arsye, gjatë zbatimit të kritereve të lartpërmendura, është e nevojshme që Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, mësuesit e pedagogët në shkolla e kudo të ndjekin në mënyrë të vëmendshme çdo gjë. Ata jo vetëm duhet të kontrollojnë zbatimin e orientimeve të Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë, por edhe të nxjerrin konkluzione për të gjitha problemet që kanë dalë e do të na dalin.

Të mos ecim me sy mbyllur dhe të mos biem në vetëkënaqësi, por medoemos dhe vazhdimisht ta përmirësojmë gjendjen e tanishme të fillimit. Ky përmirësim nuk mund të bëhet me urdhër nga lart, atë duhet të na e imponojë praktika, që nga eksperiencia e mësuesit më të thjeshtë. Prandaj vetë mësuesit e pedagogët dhe të gjithë kuadrot drejtues të arsimit t'u kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre problemeve, t'i

---

1 Vetëm në vitin shkollor 1983-1984, nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor u përgatitën dhe u botuan 54 tekste të reja.

kenë parasysh në çdo moment, t'i vërejnë e t'i ndjekin vazhdimisht. Partia i ka ngarkuar çdo punonjësi të arsimit detyrën që të japë mendimin e vet për këto çështje dhe jo vetëm kur i kërkohet nga ministria ose nga Komisioni Qendror për Arsimin. Nuk është i drejtë përqendrimi në këto probleme vetëm një gjysmë ore para ndonjë mbledhjeje, ku ndonjëri lexon materialin e përgatitur më parë dhe të tjerët pastaj mundohen për të nxjerrë diçka mbi ato që thotë ai. Në mbledhje të tilla secili duhet të flasë hollësisht për eksperiencën e vet në dhënien e mësimit.

Në zbatimin praktik të direktivave të Plenumit të 8-të në jetën e shkollës, sikundër u tha kur i aprovuam ato, sidomos në zbatimin në unitet të trekëndëshit mësimit-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak, dalin edhe vështirësi, pasi jo të gjithë këta komponentë të edukimit komunist janë të koordinuar mirë. Kjo nuk do të thotë se duhet t'i rishikojmë ose t'i ndryshojmë që tani raportet që kemi vendosur midis tyre. Nuk ka kaluar as edhe një vit nga koha kur i vendosëm ato, prandaj do të ishte e nxituar po të dilnim me konkluzionin se mësimit, për shembull, i është dhënë pak kohë, kurse edukimit fizik dhe ushtarak ose punës prodhuese u është dhënë shumë. Raportet midis këtyre komponentëve duhen parë gjatë disa vjetëve që të mund t'i ndryshojmë, duke pasur parasysh që t'u qëndrohet sa më afër ndarjeve që ka bërë Komiteti Qendror i Partisë, sepse, në përgjithësi, ato janë të drejta, të domosdoshme, por nuk përjashtohet që gjatë zbatimit në praktikë të studiohen dhe të gjenden forma pune që të alternohen sa më drejt komponentët the-



melorë të edukimit komunist, të përdoret më racionalisht koha, të shikohet lehtësimi i ngarkesës mësimore etj. Këto nuk mund të bëhen në mënyrë automatike qysh tani, pa u mbushur akoma viti, por pas disa vjetësh, kur nevojat të dalin të arsyetuara dhe të argumentuara në punë e sipër. Për këtë duhet një cikël i tërë dhe jo vetëm për shkollat e larta, por edhe për shkollat e mesme, sepse nga këto vijnë studentët në shkollat e larta.

Problemi që ngriti shoku Manush [Myftiu] për punën në prodhim duhet menduar mirë. Tani do të kemi çdo vit një masë të madhe të rinjsh, të cilët, pasi të mbarojnë shkollën e mesme, do të bëjnë një vit punë<sup>1</sup>. Shteti dhe Partia kanë angazhim për këta, prandaj duhet medoemos t'u gjejmë punë. Natyrisht, këtyre të rinjve nuk mund t'u sigurojmë vende që kanë lidhje me profesionet e tyre të ardhshme, ata do t'i dërgojmë kudo ku kemi punë, në industri, në bujqësi, në malësi. Çështja është të mendohet që tani se ku do të venë të punojnë këta njerëz dhe të merren masa, sepse erdhi koha dhe kontingjenti që do të dalë nga shkollat e mesme dihet. Bujqësia do të tërheqë mjaft nga këta që do të mbarojnë shkollat e mesme, por nuk përjashtohet që industria dhe minierat të marrin më

---

1 Me vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Për ngritjen e mëtejshme të cilësisë së punës mësimore-edukative të shkollës», të datës 25.6.1982, stazhi njëvjeçar në punë pas mbarimit të shkollës së mesme dhe të universitetit u hoq. Koha për përgatitjen e diplomës dhe të provimeve të formimit në shkollat e larta u përfshi brenda periudhës së studimeve.

shumë. Këto probleme janë të lidhura zinxhir, prandaj duhet menduar që në të gjitha fabrikat, uzinat etj., ku punohet me një turn, me një turn e gjysmë ose me dy turne, t'i përgatitim njerëzit, sidomos ata me kategori të tretë e të katërt, që puna të organizohet menjëherë me tri turne dhe të rinjtë e shkollave të futen në to. Këto punë t'i bëjmë në kohë.

Mendoj se Byroja Politike ka arsye ta aprovojë një veprimtari të tillë të frytshme. Të gjithë shokët që janë ngarkuar të ndjekin problemet në fushën e arsimit-kulturës, ta vazhdojnë këtë punë.

Byrosë Politike, mendoj unë, herë pas here, por jo dendur, t'i raportohet nga shokët e arsimit për ndonjë problem të veçantë që çmohet i nevojshëm, për shembull, si janë trajtuar tekstet nga ana filozofike, nga ana ideologjike, ose ndonjë problem tjetër që ka lidhje me to dhe duhet të na paraqitet. Por ajo të mos ngarkohet me shumë çështje të hollësishme, teknike, sepse nuk është vendi të flitet këtu për të gjitha tekstet, për brenditë e tyre etj. Në shokët e Byrosë Politike nuk mund të japim gjykime me kompetencë për të tëra problemet në një shkallë kaq të gjerë, sepse nuk jemi specialistë për të gjitha çështjet e arsimit. Por, kur të jenë arritur disa konkluzione dhe shihet e nevojshme që Byroja Politike të japë një mendim, bie fjala, për shkurtimin e ndonjë afati ose për ndonjë gjë tjetër me rëndësi, këto mund të na vijnë. Mund të na paraqiten, gjithashtu, edhe konkluzione në disa momente kyç për realizimet me sukses të orientimeve të Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë në një drejtim ose në një tjetër. Për problemet e tjera të

arsimit Byroja Politike, Komiteti Qendror i Partisë kanë krijuar Komisionin Qendror të Arsimit, ku drejtuesit e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës mund të drejtohen edhe më shpesh për të zgjidhur probleme. Atje ka mjaft specialistë për këto punë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## NË TRAJTIMIN E ÇËSHTJEVE SHOQËRORE KËRKOHEN KUJDES, TAKT DHE NGROHTËSI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 maj 1970

Tani t'i japim fund shqyrtimit të këtij problemi, i cili, natyrisht, nuk mund të konsiderohet se është zgjidhur përfundimisht. Lufta kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare nuk mbaron as me një, as me dhjetë mbledhje, përkundrazi, është luftë e gjatë dhe duhet të zhvillohet vazhdimisht e pa ndërprerje. Partia të vazhdojë të punojë akoma më shumë në këtë drejtim të rëndësishëm edhe për të ardhmen. Nga eksperiencia e deritanishme të përfitojmë për të forcuar akoma punën e saj.

Në trajtimin e këtyre çështjeve, për të cilat na u dhanë disa shembuj këtu, e sidomos të atyre që kanë

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të përgatitur nga sektori i edukimit në aparatit e KQ të Partisë «Mbi përfundimin e diskutimit popullor për luftën kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare».

të bëjnë me marrëdhëniet në familje, me raportet midis pjesëtarëve të saj etj., duhet të tregohen kujdes e ngrohtësi dhe të evitohet sa më shumë vënia në kor-niza ose shprehja e tyre me formula. Konfliktet fa-miljare kërkohet të shpjegohen gjerësisht, me durim, pa alarm dhe të zgjidhen me takt e në frymë shoqëro-re, ndryshe nga ç'është vepruar në rastet që na u për-mendën si shembuj negativë. Ne duhet t'i kemi mirë parasysh këto gjëra. E kemi për detyrë që ta edukoj-më familjen, po nuk kemi të drejtë të futemi pa takt në brendi të marrëdhënieve intime të saj. Partia e ndalon krejtësisht një gjë të tillë. Kur një person shkon te sekretari i organizatës-bazë dhe i thotë hapur një problem të brendshëm të familjes së tij, ky në asnjë mënyrë nuk mund të shkojë si hetues në atë familje, po duhet të mendojë shumë që të përgatitë taktikën më të drejtë për të zgjidhur konfliktin, pa u futur në gjërat intime të familjes. Në këto raste të veprohet në mënyrë të tillë që, shumë herë pa i rënë në sy, ta bin-dim tjetrin të kuptojë se rruga e ndjekur prej tij nuk është e drejtë, pse vjen në kundërshtim me vijën e Partisë dhe me normat e moralit komunist.

Nuk është e lejueshme që, me t'u ankuar një vajzë se familjarët e ndalojnë të martohet me atë që dashuron, të nxitohemi dhe, pa bërë më parë një punë politike bindëse, të marrim gjithë familjen, me plakun, me plakën, me hallën, me gjyshen e të tjerë, dhe t'i çojmë në gjyq përpara popullit. Në këto gjëra lypset maturi dhe nuk lejohen teprime, sepse ndryshe ar-miqësohemi me ata pjesëtarë të shoqërisë sonë që e duan Partinë, por kanë mbeturina të moralit të vje-

tër. Vetëm në raste flagrante, kur shkelen rëndë normat e moralit komunist ose kryhen veprime që ligji i parashikon si krime, problemi mund të diskutohet në kolektiv ose t'i dërgohet gjyqit.

Shokët e Partisë dhe të organizatave të masave duhet të bëjnë kujdes të madh në këto çështje, që janë shumë delikate. Nuk mund ta bindim lehtë e menjëherë një brez burrash e grash në moshën 50 vjeç e lart të heqë dorë nga zakonet prapanike e nga besimet fetare. Këta njerëz, po të veprohet arbitrarisht, mund të bëjnë ashtu siç u thuhet, por nuk do të jenë të ndërgjegjshëm. Ne duhet të bëjmë që ata të jenë të ndërgjegjshëm, por, që të arrihet kjo, që ata të binden për kotësinë dhe për dëmin e këtyre zakoneve e besimeve, kërkohet një kohë e gjatë.

Natyrisht, ne do të përpiqemi të parandalojmë gjithçka që mund të shkelë normat e moralit komunist dhe ligjet tona, por skandale s'duhën lejuar. Atje ku ndonjë ka provokuar skandale, të bëjmë ç'është e mundur që t'i evitojmë dhe kështu cilindo ta vëmë në rrugë të drejtë, në frymën e edukatës së madhe që Partia ka formuar në popull.

Nuk duhet të arrihet deri atje sa shokë të bazës të venë në çdo shtëpi për të parë si e bëri apo si do ta bëjë ky apo ai fejesën, por të zhvillojmë punë sqaruese e bindëse me djalin e me vajzën, me plakun e me plakën, për të rrënjosur te njerëzit normat e moralit proletar lidhur me krijimin e familjes së re. Sigurisht, në goftë se organizata e rinisë dhe ajo e Partisë s'e kanë bërë si duhet punën me djalin e me vajzën dhe vajza rri e mbyllur në shtëpi si më parë, atëherë kjo do t'i

thotë babait: «Amin, më jep atë që mendon ti». Në të kundërtën babai do ta pyesë vajzën dhe, në qoftë se ajo nuk e njeh djalin, do t'i thotë ta shikojë. Zgjidhja e këtyre çështjeve varet nga organizimi i punës politike dhe ideologjike të Partisë, nga puna e organizatës së rinisë dhe e organizatave të tjera të masave për edukimin e njerëzve.

Si tha shoku Rita [Marko] dhe siç ka theksuar gjithnjë Partia, në luftën kundër ideologjisë së vjetër reaksionare duhet të mbështetemi më shumë sidomos te të rinjtë e të rejtat që marrin pjesë në prodhim, pse këta janë forcat më të gjalla, më të vendosura dhe më të interesuara për fitoren e së resë edhe në marrëdhëniet në shoqëri e në familje. Të jemi të vëmendshëm që ta ruajmë rininë nga ndikimi i keq i zakoneve prapanike dhe i ideologjisë fetare. Të njëjtën gjë ta bëjmë edhe për gratë dhe për të tërë ata që marrin pjesë në prodhim. Pjesëmarrja në prodhim revolucionarizon ndërgjegjen dhe ngre nivelin e jetesës të njerëzve.

Komunistët duhet të jenë në radhë të parë njerëz politikë dhe t'i kuptojnë çështjet ideologjike në frymën e Partisë. Kur një komunist pranon t'i japë rekomandim për t'u pranuar në Parti një vajze dhe pretendon që ajo të mos ketë të drejtë ta kritikojë, ose të kërkojë të tërheqë rekomandimin e dhënë kur vajza e kritikon, a mund ta quash atë komunist? Natyrisht, atë nuk do ta përjashtojmë nga Partia, por do ta edukojmë. Po kur bëhet një gjyq kundër ndonjërit që shet vajzën, si në rastin që u tregua këtu, dhe kur populli i fshatit ngrihet dhe i dënon ata që e kanë kryer këtë akt, ndërsa komunistët nuk flasin, ky është një qën-

drim i palejueshëm, prandaj instruktori i komitetit të Partisë që ishte dërguar atje, duhej t'i nxiste komunistët të diskutonin. Komunisti mund të bëjë edhe 400 ditë-punë në vit, po ai nuk e ka kryer detyrën në goftë se s'mbron këtë çështje të madhe, nuk është në pararojë për të zbatuar deri në fund vijën e Partisë edhe në probleme të karakterit shoqëror.

Ne kemi përparime në luftën kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare, prandaj nuk duhet të dëshpërohemi kur ngjet ndonjë gjë e shëmtuar, por as nuk duhet ta flemë mendjen dhe të kënaqemi me sukseset që kemi arritur. Të jemi të ndërgjegjshëm se përsëri do të ketë shfaqje të zakoneve prapanike, edhe pas 10-20 vjetëve. Rëndësi ka që këto të vijnë gjithnjë duke u pakësuar. Sukseset e reja në këtë drejtim do të arrihen, siç thashë, në sajë të punës së dendur politike që do të bëjë Partia, jo me fushata, por vazhdimisht dhe pa ndërprerje.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## T'I KUPTOJMË POLITIKISHT ÇËSHTJET DHE T'U VEMI PUNËVE GJER NË FUND

*Fjala në takimin me kuadro drejtues të rrethit  
të Kukësit*

27 maj 1970

*Në këtë takim, ku merrte pjesë edhe anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë, shoku Ramiz Alia, sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit foli për sukseset dhe për perspektivat që i hapen këtij rrethi. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha.*

Ne dëshirojmë të dëgjojmë vazhdimisht nga ju, shokët e bazës, propozime dhe vërejtje, të dimë si i gjykon baza direktivat e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të Partisë. Gjatë fjalës së vet shoku sekretar i parë i komitetit të Partisë të rrethit tuaj tha se direktivat e Partisë janë të drejta. Ato janë vërtet të drejta, por gjatë zbatimit të tyre, është e kuptueshme, hasen edhe vështirësi. Prandaj nuk përjashtohet që midis tyre të ketë çështje që duhen ndryshuar apo përmirësuar, mbasi nuk është e thënë që ndonjë nga direktivat të jetë pa asnjë të metë.

Baza tani ka fituar eksperiencë dhe ka kapacitet të madh, ajo zbaton, por njëkohësisht edhe krijon, prandaj udhëheqja pret vazhdimisht prej saj ndihmë dhe vërejtje konstruktive. Baza e Partisë ka mendime, bile shumë herë të thella, që ajo i gjen në popull, me të cilin është e duhet të jetë vazhdimisht në lidhje të ngushta. Në popull i ka gjetur kurdoherë Partia mendimet e saj të arta, edhe kur ai nuk ka qenë në atë nivel ideopolitik e kulturor siç është sot, pse urtësia dhe dituria e popullit janë të pashtershme. Merret me mend se mendimet e popullit tani janë më të thella, forcat e tij krijuese janë shumë më të mëdha se më parë. Këtë forcë të madhe gjykimi, këtë dituri të madhe populli i ka fituar dhe i ka shtuar gjatë zhvillimit ekonomik të vendit tonë në rrugën e socializmit, zhvillim që i ka hapur atij perspektiva dhe ia ka rritur forcat për hartimin dhe për realizimin e planeve. Por zhvillimi i ekonomisë e ka bërë vazhdimisht e më të përsosur edhe politikën e Partisë. Tani mbarë populli jo vetëm që e kupton mirë këtë politikë, por edhe nxjerr prej saj konkluzione të drejta, jep gjykime të sakta kur në një drejtim ajo është e mirë, por edhe kur në një drejtim tjetër është më pak e mirë, ai e këshillon Partinë që atë problem ta thellojë më tej, kurse kur një direktive i ka kaluar koha dhe nuk jep më rezultate, populli propozon që ajo të shikohet edhe një herë. Dhe tok me popullin e, natyrisht, në pararojë të tij, janë komunistët, marksistët, pra, jeni edhe ju, shokë.

Është një sukses i madh që në udhëheqje të organizatës së Partisë, të organeve të pushtetit dhe të or-

ganizatave të masave të rrethit tuaj kemi tani shokë jo vetëm të ngritur politikisht e besnikë gjer në fund ndaj vijës së Partisë, por edhe të përgatitur ideologjikisht në një nivel të kënaqshëm. Ka bile këtu mes jush shokë që kanë mbaruar ose vazhdojnë Shkollën e Partisë, që kanë kryer kurse të ndryshme partie etj., prandaj, duke i shtuar kësaj edhe eksperiencën tuaj, jam i bindur se ju keni mendime e propozime që duhet t'ia parashtroni në kohë Partisë.

Edhe mendimet e idetë që Komiteti Qendror i Partisë dhe Byroja e tij Politike shprehin në formën e udhëzimeve, të direktivave, të referateve, të raporteve, të fjalimeve etj., s'janë gjë tjetër veçse sinteza e eksperiencës së madhe të fituar gjatë luftës dhe punës së përditshme të gjithë Partisë. Mirëpo për atë eksperiencë pune që kemi fituar, Partia nuk lejon që as juve, as neve të na rritet mendja, por nuk duhet të hidhemi edhe në anën tjetër, domethënë të nënvleftësojmë kapacitetet tona, sepse Partia dhe populli na kanë ngarkuar detyrën me shumë përgjegjësi, ruajtjen e fitoreve të arritura dhe ndërtimin e socializmit në vendin tonë, prandaj ata kërkojnë nga ne që të vrasim mendjen, t'u vemi punëve gjer në fund dhe çështjet t'i kuptojmë thellë politikisht. Për zbatimin e detyrave ne duhet të bëjmë përpjekje që të gjejmë format më të drejta organizative, të cilat u përshtaten kohës, problemit, situatës politike, gjendjes morale dhe ngritjes ideologjike të banorëve të çdo rrethi në veçanti etj. Të gjitha këto që përmenda janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe shërbejnë për forcimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të mirëqenies së

popullit, të fuqisë mbrojtëse të atdheut, për revolucionarizimin e mendjes së njerëzve tanë, prandaj, e përsëris, populli dhe Partia kërkojnë shumë nga ne.

Ju shokë, që punoni ditë e natë për të zbatuar drejt vijën e Partisë, mos mendoni për asnjë çast se puna që bëni është thjesht praktike, sa për të shkuar, fjala vjen, në një qendër pune apo kooperativë bujqësore, për të organizuar atje një mbledhje, për të marrë disa masa etj. Jo, për mbarëvajtjen e punës kurdoherë janë të domosdoshme edhe njohuritë teorike. Të gjithë ne komunistët çdo punë që bëjmë duhet ta lidhim me teorinë tonë. Për këtë na vihet detyrë të bëjmë përpjekje të mëdha që çdo direktivë të Partisë ta vëmë në jetë jo në mënyrë dogmatike, por me një reflektim të thellë dhe kurdoherë duke u bazuar në studimet përkatëse dhe, kur është nevoja, t'u rikthehemi veprave të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, që kemi mësuar nëpër shkolla ose gjatë punës sonë të përditshme. Ju duhet të reflektoni për të gjetur ku e ka bazën teorike puna që kërkohet të bëjë secili për zbatimin e direktivave të Partisë e të Komitetit të saj Qendror. Po përse duhet vepruar kështu? Sepse ndërtimi i socializmit, në radhë të parë, kërkon njerëz me kulturë të thellë, me njohuri të gjera teorike. Ne tash jetojmë në një botë ku revizionistët, socialdemokratët e tradhtarët të tjerë të ngjyrave të ndryshme, si dhe kapitalistët e imperialistët zhvillojnë një luftë të gjithanshme ideologjike kundër teorisë sonë, marksizëm-leninizmit, kundër ndërtimit të socializmit e të komunizmit, kundër lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Armiqtë po e shtrembërojnë në mënyrë të përbindshme, po dhe shumë të

stërholluar, marksizëm-leninizmin, gjë që rrezikon njerëz të bien brenda në llumin e tyre, në rast se nuk e zotërojnë mirë teorinë marksiste-leniniste.

Në një revistë teorike të partisë revizioniste franceze lexoja një ditë shkrimin e një «filozofi» revizionist, i cili fliste për fazën e parë të ndërtimit të komunizmit në Bashkimin Sovjetik. Në atë shkrim ky i ashtuquajtur filozof përpiqet të hedhë poshtë tezën tonë, sipas së cilës në Bashkimin Sovjetik është krijuar një shtresë e re borgjeze, që ai e merr në mbrojtje. Sipas këtij «filozofi», nuk qenka e vërtetë se në Bashkimin Sovjetik është krijuar një shtresë e re borgjeze. Këtë ai e arsyeton gjoja me thëniet e Marksit dhe të Leninit, sipas të cilëve, që të ekzistojë një shtresë shfrytëzuesish për të shfrytëzuar një klasë tjetër duhet të ketë në dispozicion mjetet e prodhimit. Një gjë e tillë, arsyeton autori i artikullit, në Bashkimin Sovjetik nuk është vërtetuar dhe me këtë përpiqet të hedhë poshtë atë që themi ne se atje është krijuar një shtresë shfrytëzuesish. Fakti që në Bashkimin Sovjetik ka njerëz që rrojnë shumë më mirë nga masa e madhe e punonjësve, se kudo, deri edhe në kolkoze, ka drejtues që kanë nga një e nga dy bahçe, nga një e nga dy vila private, automobila personale etj., sipas këtij revizionisti nuk ka asnjë rëndësi! Ai nuk merr aspak parasysh se kjo shtresë njerëzish të privilegjuar mëkëmbet dhe po merr dita-ditës e më shumë tiparet e klasës borgjeze, po e shndërron dalngadalë socializmin në një kapitalizëm monopolist shtetëror. Këto tipare karakteristike të klikës burokratike të Bashkimit Sovjetik «filozofi» revizionist i redukton në asgjë, sikur s'pas-

kan asnjë rëndësi! Ai pranon që në kolkoze ka abuzime, që një kryetar kolkozi mund të ketë edhe vila e automobila personale në dispozicion e megjithatë këto shfaqje të shëmtuara përpiqet t'i qëndisë e t'i maskojë duke cituar Leninin.

Një tjetër «filozof», anëtar i partisë revizioniste belge, mohon Leninin «duke u bazuar» tek artikulli i tij «Katastrofa që na kanoset dhe si duhet luftuar kundër saj»<sup>1</sup>. Në këtë artikull vihet në dukje se si duhen bashkuar me një të vetme të tëra bankat e vendit, se si duhet zhdukur sekretit tregtar, nën të cilin fshihen të gjitha matrapazllëqet e kapitalizmit etj. Aty Lenini jep orientime si të ushtrohet kontrolli punëtor, si të përqendrohen industritë e së njëjtës degë etj., etj. Kur e lexon në fillim shkrimin e revizionistit belg, të krijohet përshtypja sikur ai është një deli burrë, një «leninist», por, kur i shkon gjer në fund leximit të artikullit të tij, merr vesh qëllimet e vërteta që synon të arrijë. Ai në fund të shkrimit përpiqet t'u mbushë mendjen lexuesve se tani situata në Belgjikë nuk është si në kohën e Revolucionit të Tetorit, pse sot ndikojnë faktorë të ndryshëm, dhe jep një mijë e një «arsye» për të revizionuar tezat e Leninit. Ky «deli burrë» përpiqet «të argumentojë» se sot qenka e pamundur të bësh ato që ka shkruar Lenini dikur, se mendimet e tij tani s'paskan vlerë etj.

I përmenda këta dy shembuj lidhur me atë çka thashë në fillim, se jetojmë në një kohë kur po bëhet një luftë e madhe ideologjike midis nesh dhe armiqve

---

<sup>1</sup> Shih: V. I. Lenin. Vepra të Zgjedhura, vëll. II, f. 545

tanë, prandaj anëtarët e Partisë edhe në këtë drejtim duhet të jenë të armatosur shumë mirë me marksizëm-leninizmin, ashtu siç tha edhe shoku sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit tuaj. Unë dëshiroj ta falënderoj atë për ekspozenë e mirë dhe të plotë që na bëri për gjendjen e rrethit tuaj. Shumë herë, si në mbledhjet e Byrosë Politike, ashtu edhe në ato të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë ne kemi pasur rastin t'i dëgjojmë shokun Izet Dyrmishi dhe, para tij, shokun Tahir Minxhozi, kur na kanë raportuar realisht dhe konkretisht për gjendjen në rrethin e Kukësit. Me këtë dua të them se udhëheqja e Partisë është në dijeni për punën dhe luftën tuaj, por shoku Izet sot na e sqaroi edhe një herë akoma më mirë situatën.

Komiteti Qendror i Partisë mendon se në rrethin tuaj punohet dhe ka suksese. Natyrisht, si në çdo rreth tjetër, edhe këtu, ku më shumë e ku më pak, ka edhe të meta. Por për Partinë ka rëndësi që të metat të zbulohen e të njihen me kohë, që të mund të bëhen gjithashtu me kohë përpjekje për të krijuar kushte të favorshme për plotësimin e detyrave. Në këtë drejtim ka edhe vështirësi, por, sikurse na mëson Partia ngahera, ato kurrë nuk mund të thyejnë Partinë tonë, si kudo gjatë, ashtu edhe në rrethin tuaj.

Një indeks shumë i mirë, që përbën bazën e të gjitha fitoreve tona, është fakti se popullin e kemi të mrekullueshëm, të thjeshtë, punëtor e besnik të Partisë. Mund të thuhet se të gjithë popujt janë të mirë, megjithatë duhet njohur se jo të tërë janë njëlloj. Populli shqiptar ka shumë cilësi të larta, gjë që përbën garancinë e madhe për ecjen e vendit tonë përpara

në rrugën e socializmit. Partia, që bazohet te ky popull me këto cilësi të larta, ka shumë të drejtë kur thotë se në gjirin e tij ekzistojnë mundësi të pallogaritshme për të bërë gjëra të mëdha.

Nuk dëshiroj të hyj këtu në hollësi të çështjeve, por desha të theksoj se e vjetra, ku më shumë e ku më pak, reziston duke u kapur fort pas shumë të këqijave, siç janë zakonet prapanike, feja, patriarkalizmi, shtypja e gruas etj. Por të gjitha këtyre duhet t'u bëjmë ballë dhe t'i mposhtim. Partia na mëson vazhdimisht se zhvillimi ekonomik sjell përparimin, se çdo revolucion ka në themel të tij bazën ekonomike. Gjithë ndryshimet e mëdha që janë bërë në karakterin e njerëzve, në pikëpamjet e në mentalitetin e tyre, e kanë bazën e vet pikërisht te ky zhvillim i madh ekonomik që ka bërë Partia në rrugën e socializmit, domethënë në zhdukjen e pronës private dhe në krijimin e pronës së përbashkët mbi mjetet e prodhimit, në ndërtimin e industrisë, të kooperativizmit dhe në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Mbi bazën e re ekonomike të krijuar është ndërtuar edhe superstruktura. Kështu, në luftë me ideologjinë borgjezo-idealiste, me besimet fetare etj., etj., në vendin tonë çdo ditë e më shumë ka zënë e po zë rrënjë ideologjia jonë marksiste-leniniste. Të mos harrojmë kurrë, shokë, se në ato rrethe ku janë të zhvilluara në një shkallë më të lartë ndjenja e punës, fryma e organizimit dhe e disiplinës proletare në punë, ku janë ngritur më shumë rendimentet e bimëve bujqësore, ku njerëzit punojnë më mirë në ara e në fabrika, atje mendohet shumë më pak për vezët e kuqe, për kreshmët,



për bajramin dhe për agjërimitin etj. Krejt ndryshe është gjendja atje ku nuk bëhen përpjekje për një punë intensive për zhvillimin e ekonomisë. Në raste të tilla njollat e errëta të shoqërisë së vjetër qëndrojnë më fort në mendjen dhe në zemrat e njerëzve e sidomos të atyre që janë të kaluar nga mosha.

Ne duhet t'i studiojmë e t'i gjejmë mirë metodat dhe format që lyksen për të zbatuar direktivat dhe vijën e Partisë në këto çështje, për të cilat, pa hequr dorë nga puna me burrat, duhet të mbështetemi në radhë të parë te të rinjtë e sidomos te të rejtat dhe gratë, pse këta janë forca e pararojës në këto probleme, pse mbi ta rëndon më fort pesha e zakoneve të vjetra e prapanike që i gozhdojnë në vend. Prapanikët dhe konservatorët kërkojnë të veprojnë me të rinjtë, me gratë, me motrat dhe me bijat tona ashtu siç kanë vepruar prindërit e tyre me ta; ata janë të predispozuar të bien lehtë viktimë e mentaliteteve të vjetra. Atëherë cila është detyra e Partisë në këtë situatë? Detyra e saj është që t'i çlirojë njerëzit tanë nga këto mentalitete, duke i hedhur në luftë kundër tyre.

Ne kemi kudo në vendin tonë të rinj e të reja të shëndetshëm, të dashur, të zgjuar, të vendosur, që në këto probleme të mëdha shoqërore dinë t'u marrin krahët prindërve të tyre dhe në këtë drejtim kemi sukses. Vërtet ndodh edhe ndonjë ngjarje e padëshirueshme, por kjo nuk duhet të na mërzhitë, sepse është e natyrshme që të tilla ka aty-këtu dhe përsëri do të ketë edhe në të ardhmen. Për mënjanimin sa më shumë të tyre ne kemi marrë mjaft masa e do të marrim edhe të tjera, që Partia do t'i gjykojë të nevojshme e të drejt-

ta. Ndaj atyre që ruajnë pikëpamje të vjetra e konservatore ne nuk përdorim dhunën, po marrim masa edukuese, deri te nxjerrja përpara popullit e personit që bën gabime. Kjo është një gjë e drejtë dhe shumë e mirë. Me këtë formë pune ne i themi popullit: «Ja ç'ka bërë ky njeri, gjykojeni vetë nëse ka vepruar mirë apo keq». Dhe masat e popullit shfaqin mendimin, dënojnë gabimin dhe tregojnë rrugën për korrigjimin e elementit prapanik. Kjo është një punë edukuese shumë e madhe, efikase e me rëndësi, që e udhëheq kudo Partia.

Si kudo gjetkë, edhe ju në Kukës keni për të bërë një luftë të madhe në këto drejtime dhe jemi të bindur se nuk do të hasni në kundërshtime të mëdha për problemet e rëndësishme që shtron aktualisht për zgjidhje Partia. Thonë se kundërshtime për përhapjen e së resë përparimtare hasen më shumë te pleqtë. Kjo mund të jetë deri diku e vërtetë, por më duket se nganjëherë këto nuk hasen vetëm te pleqtë, po edhe në njerëz të moshave 40-45 vjeç, që në pamje të parë të lënë përshtypjen sikur janë të përparuar, po në ndërgjegjen e tyre ruajnë mbeturina të theksuara, prandaj në këtë drejtim duhet të vazhdohet pandërprerë një luftë me pjekuri, me këmbëngulje, pa bërë lëshime, me durim të madh dhe pa i ofenduar njerëzit.

Kur konstatohet se një plak, apo edhe një 45-vjeçar, shkel vijën e Partisë lidhur me marrëdhëniet e reja në familje e në shoqëri, komunisti, kudo qoftë, duhet, së pari, të mendohet thellë që këtë çështje ta zgjidhë në mënyrë që të mos priset familja, e cila, në përgjithësi, në vendin tonë është e shëndoshë nga të

gjitha pikëpamjet, por ka edhe raste kur ndonjë plak, që nuk i kupton drejt çështjet, bëhet pengesë. Komunisti në asnjë mënyrë nuk duhet t'i lërë në harresë çështje të tilla që janë sa serioze, aq edhe delikate.

A kemi ne mundësi që një plak me pikëpamje konservatore e prapanike ta sjellim në rrugë të drejtë? Po, kemi. Partia ka sjellë në rrugë njerëz me qëndrime armiqësore e jo më një plak që do me gjithë shpirt Partinë, por që akoma e mundon e vjetra. Veç në këto raste duhet vepruar sa gjallërisht, aq edhe me takt. Mirëpo ka edhe disa komunistë që e bëjnë veshin të shurdhër. Një shok na tregonte një ditë në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror se si një baba e kishte martuar të bijën për para, me një fjalë e kishte shitur. Organizata-bazë e Partisë e zbuloi këtë akt të shëmtuar, e dënoi atë dhe vendosi që kjo vepër të demaskohej haptazi në popull dhe fajtorët të ndëshkohen nga organet e drejtësisë. Gjykata e rrethit e hapi në vend gjyqin për ta shqyrtuar çështjen publikisht para popullit të fshatit. Prokurori bëri aty demaskimin e veprës dhe të fajtorit dhe pas tij shumë njerëz nga populli u ngritën, diskutuan dhe e dënuan këtë ngjarje. Mirëpo komunistët, në kundërshtim me vendimin që patën marrë në mbledhje të organizatës-bazë, heshën! Instruktori i komitetit të Partisë ua bëri me she një disave prej tyre që të ngriheshin të flisnin, por, me gjithë nxitjen që u bëri ai, asnjë komunist nuk foli. «Ç'bëtë ju pastaj?», e pyeta shokun që na tregonte për këtë ngjarje. «Mblodhëm organizatën-bazë dhe i kritikua komunistët për qëndrimin negativ që mbajtën», u përgjigj ai. «S'keni bërë mirë, i thashë

unë, sepse qëndrimin e komunistëve të kësaj organizate-bazë partie ju duhej ta kishit dënuar menjëherë dhe atje në vend, mu para popullit». Në fund të procesit gjyqësor instruktori i komitetit të Partisë fare mirë mund të ishte ngritur e të thoshte: «Gjyqin tani e mbaruam, le të zgjidhim bashkë me të edhe një çështje tjetër. Asnjë nga komunistët e organizatës-bazë që janë të pranishëm këtu, të cilët Partia i ka mësuar të luftojnë kundër të tilla poshtërsive që bën ndonjëri ndaj vajzave, me gjithë vendimin që mori organizata, s'foli gjatë zhvillimit të gjyqit për këtë çështje. Kjo do të thotë se këta nuk e zbatuan një vendim të organizatës, kjo do të thotë ca më tepër se ata nuk janë luftëtarë për zbatimin me vendosmëri të vijës së Partisë, gjersa heshtin kur para syve të tyre shiten me para bijat dhe motrat tona, pra janë oportunistë, prandaj si të tillë ata e mbajnë kot taserën e Partisë. Atëherë çfarë duhet të bëjmë me ta?». Dhe populli të gjykonte bashkë me fajtorin edhe qëndrimin e gabuar të këtyre të quajtur komunistë.

E kam fjalën që këto shfaqje shumë negative ne duhet t'i luftojmë kudo që vërtetohen dhe në çdo rast. Për këtë qëllim të gjëjmë forma pune të shumta e të përshtatshme. Komunistët duhet të jenë shembull, si kurdoherë edhe për zgjidhjen e këtyre problemeve, se ka edhe nga ata, si në rastin që përmenda, që nuk e luajnë mirë rolin e tyre. Ata e duan Partinë dhe janë gati të hidhen në zjarr për të, por duke mos i kuptuar mirë teorikisht të tilla probleme, duke mos bërë edhe vetë përpjekje për t'u ngritur, i mbulojnë fryma dhe mentaliteti prapanik i fshatit. Këta komunistë nuk ka-

në guximin të dalin përpara popullit për të thënë mendimin e tyre për çka është ose s'është e drejtë, kurse komunisti duhet të ndiejë kënaqësi vetëm kur, duke qenë i drejtë dhe kurdoherë kokulur, me një punë këmbëngulëse, me durim e me shkathtësi lufton ta bindë masën për të zbatuar vijën e drejtë të Partisë në çdo çështje. Vetëm me një punë të tillë masa e ndjek me besim komunistin në çdo hap që ai do të bëjë.

Për problemet e ushtrisë, që shoku sekretar i përmendi me të drejtë qysh në fillim të fjalës së tij, duhet të bëhet një kujdes gjithnjë e më i madh. Lenini na mëson që çdo ushtar duhet të jetë një qytetar i mirë, ashtu sikundër çdo qytetar duhet të jetë njëkohësisht një ushtar i mirë. Në qoftë se arrijmë ta realizojmë në jetë këtë, vazhdon Lenini, atëherë nuk ka forcë në botë që ta mundë Rusinë e sovjetëve. Ne po luftojmë ta vëmë në jetë këtë mësim të madh të Leninit, po përpiqemi që ushtrinë ta lidhim sa më ngushtë me popullin, i cili bën pjesë i tëri në radhët e ushtrisë dhe tok me këtë lufton e do të luftojë gjer në fund për mbrojtjen e lirisë e të fitoreve të arritura, për atë liri që patën ëndërruar dhe luftuar aq shumë gjyshërit e prindërit, për të cilën edhe vetë ka derdhur gjak derisa e siguroi e sot vazhdon të derdhë djersë për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Në vendin tonë ushtri dhe popull janë një, prandaj, ashtu siç e mësojnë ushtarët artin ushtarak në kazermat, duhet ta mësojnë atë edhe gjithë nënshtetasit e republikës jashtë kazermave.

Lenini porositi, gjithashtu, të zhdukim kazermat dhe të krijojmë në vend të tyre shkollën e madhe të

ushtrisë së gjithë popullit. Partia jonë ecën në këtë rrugë. Ne sot kemi në vendin tonë ushtrinë e rregullt, që është bërë shkolla ku mësohet arti ushtarak, por kemi njëkohësisht detyrën e stërvitjes paraushtarake, gjatë së cilës përgatitim të rinjtë para se të shkojnë ushtarë, kemi rezervistët e më së fundi çetat vullnetare të vetëmbrojtjes, ku bëjnë pjesë të gjitha gratë, si dhe burrat e moshuar. Këto forca përbëjnë atë ushtri të madhe, ku merr pjesë pa përjashtim tërë populli ynë. Kjo ushtri, në bazë të tezave të lëshuara nga Këshilli i Mbrojtjes, çdo ditë e çdo muaj do të bëhet akoma e më shumë e përsosur. Do të vijë shpejt koha që çdo qytetar, kudo që banon, në fshat ose në qytet, do të jetë i organizuar në repartin e tij të përbërë prej një numri ushtarësh, me gjithë armatimin që i përket në dispozicion. Ky repart do të stërvitet njëloj siç veprohet edhe në ushtri. Kështu që taktikën dhe strategjinë e Ushtrisë sonë Popullore do ta mësojnë pa përjashtim të gjithë nënshtetasit. Ata që do të bëjnë pjesë në efektivin e repartit, do të kenë shumë besim te komandanti i tij, se ai do të jetë shoku i tyre më i afërt që do të jetojë e do të punojë me ta çdo ditë dhe do t'i përgatitë në nivelin që kërkon nevoja e mbrojtjes së vendit në çdo krahinë. Sikur të ndodhë, për shembull, që armiku të kërcënojë diku në një pikë të kufirit, atëherë, me t'u dhënë sinjali, reparti do të mblidhet dhe do të gjendet në vendin e caktuar qysh më parë, i gatshëm për ta mbrojtur gjer në fund atë pjesë kufiri që do t'i jetë caktuar për ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut.

Partia ka vënë detyrë që të gjitha udhëzimet e

dhëna nga Këshilli i Mbrojtjes për përgatitjen ushtarake të të gjithë shtetasve, t'ia bëjë të qarta tërë popullit. Prandaj komandantët dhe komisarët e reparteve e të nënreparteve dhe të njësive ushtarake që janë caktuar të punojnë në terren me paraushtarakët, me rezervistët dhe me forcat vullnetare, duhet ta marrin me seriozitetin më të madh këtë detyrë kaq të rëndësishme që u është ngarkuar ta kryejnë me përpikëri, sepse janë ata që do të udhëheqin luftën. Në qoftë se ndonjëri është caktuar komandant i një reparti në rezervë, është e domosdoshme ta ketë mirë të qartë se do të ketë në dorë fatin e stërvitjes së njerëzve të një reparti të tërë, mbrojtjen e pozitave që i janë caktuar këtij reparti, prandaj ai duhet të mendohet thellë që tashti, pa ardhur akoma rreziku, për të kryer më së miri detyrën e përgatitjes luftarake të efektivit të vet. Për këtë qëllim, komandantët në rezervë, të të gjitha niveleve, duhet t'i mësojnë vetë, në radhë të parë, dhe t'i kenë të qarta si duhet të gjitha njohuritë e nevojshme ushtarake për mbrojtjen e atdheut, që të jenë pastaj në gjendje t'ua mësojnë gjithë vartësve të tyre gjer tek ushtari i thjeshtë. Ata duhet të perfeksionohen vazhdimisht në përvetësimin e Artit Ushtarak të Luftës Popullore dhe të bëjnë përpjekje që të njohin me pëllëmbë gjithë vendin e caktuar për të mbrojtur, ku do të grumbullohen e do të bëjnë stërvitjen repartet që do t'u caktohen.

Një formë të tillë organizimi, që është shumë efikase, mund ta praktikojë vetëm një ushtri popullore, siç është kjo jona. Me një organizim të tillë të mbrojtjes, një nënshtetas që është nga Kukësi, nuk do të

jetë nevoja të shkojë deri në Gjirokastrë, por do të caktohet të stërvitet dhe të luftojë këtu në rrethin e vet, sepse pikërisht këtë vend ai e njeh më së miri dhe është në gjendje ta mbrojë e të mos lërë t'i kalojë as miza. Ne duam t'i mësojmë tërë ushtarët dhe oficerët e shërbimit aktiv, si dhe ata që janë në rezervë, ata të vetëmbrojtjes dhe paraushtarakët, që organizimi i tyre të bëhet sa më efektiv, që kuadrot ushtarakë të jenë sa më afër njerëzve të tyre etj.

Partia na porositi që barutin ta mbajmë kurdoherë të thatë. Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë janë agresorë. Qysh kur sulmuan Çekosllovakinë, revizionistët sovjetikë parashikonin të sulmonin edhe Rumaninë, Jugosllavinë dhe Shqipërinë. Këtë ata duan ta realizojnë, sepse dëshirojnë të dalin në Mesdhe, ku duan të kenë bazat e tyre ushtarake. Tash ata nxjerrin lot gjaku që ne u vumë drunë nga Vlora, i bien kokës me grushtë që humbën atë bazë aq të rëndësishme që s'e gjejnë dot. Ajo kohë kaloi një herë e mirë, qysh kur nga ana jonë u pa qartë tradhtia e tyre. Partia e Punës e Shqipërisë nuk e gëlltiti atë tradhti.

Siç e dini, flota sovjetike tash ka dalë në detin Mesdhe gjoja për të mbrojtur vendet arabe. Ky është fund e krye një mashtrim, për arsye se revizionistët sovjetikë nuk kanë aspak ndër mend të mbrojnë popujt arabë, përkundrazi, ata janë dhe luftojnë për skllavërimin e tyre. Revizionistët sovjetikë synojnë t'i kthejnë në koloni të tyre vendet arabe dhe, për t'ia arritur këtij qëllimi, shfrytëzojnë disfatën që pësuan këta popuj nga sulmi imperialisto-sionist i vitit 1967.



Nën maskën e ndihmës për t'i nxjerrë nga gjendja në të cilën janë këta popuj, revizionistët sovjetikë gjetën rastin që të dalin në Mesdhe, u futën mirë në Egjipt dhe po e shfrytëzojnë këtë gjer në palcë. Revizionistët sovjetikë u japin aeroplanë egjiptianëve, por në çdo avion ata kanë pilotët e tyre dhe këta nuk lejojnë daljen në luftime kundër izraelitëve. Revizionistët sovjetikë u japin egjiptianëve edhe armatime, por me kusht që politikën në Mesdhe ta bëjnë ata vetë, sovjetikët.

Sikurse dihet, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu sikundër revizionistët sovjetikë, kanë interesat e tyre në Mesdhe, por ndërsa të parët kanë këtu plot baza detare-ajrore e tokësore, sovjetikët nuk kanë, prandaj përpiqen të gjejnë ku të munden. Tash për tash një pjesë të flotës së tyre ata e kanë ancoruar në portin detar të Aleksandrisë që u ka lëshuar Naseri, po vërtiten të sigurojnë të tjera në Libi, në Qipro dhe në Algjeri, por, me sa duket, asnjë nuk u jep. Revizionistët sovjetikë i kanë kërkuar edhe Titos t'u lëshojë ndonjë bazë, por as ky, me sa duket, nuk i lejon. Natyrisht, ne shqiptarët është e ditur që nuk i lejojmë. Mirëpo flota e tyre, për të qëndruar e për të lëvrire në Mesdhe, duhet të ketë medoemos baza të qëndrueshme, ndryshe nuk mund të rrijë dot gjatë në det të hapët.

Në kohë relativisht paqeje, si këto të tanishmet, flota sovjetike është e detyruar të bëjë lëvizje të mëdha, me nga 40 e 50 anije të ndryshme luftarake që shkojnë e vijnë pa pushim për t'u riparuar në bazat sovjetike të Detit të Zi. Lëvizje të tilla në kohë lufte nuk është e mundur të bëhen, atyre u duhen medoe-

mos baza në Mesdhe, prandaj, për të plotësuar këtë nevojë e dëshirë të madhe të tyre, revizionistët sovjetikë, përderisa nuk gjejnë rrugë të tjera, dikë duhet të sulmojnë. Po të sulmojnë vendet e NATO-s, që janë aleate të imperialistëve amerikanë, do t'u duhej të prishnin aleancën e fshehtë që kanë me këta të fundit, gjë që nuk e dëshirojnë. Kështu që si objekte sulmi u mbeten vetëm Jugosllavia, Rumania dhe Shqipëria.

Përpara kërcënimit të një sulmi sovjetik regjimi titist reagoi, ai rezistoi dhe mori masa urgjente ushtarake, mobilizoi ushtrinë etj. Qëndrimi i Jugosllavisë është i qartë për sovjetikët, në rast se këta do ta sulmojnë, do të ketë luftë midis këtyre dy vendeve. Në këto rrethana bëmë edhe ne deklaratën, sipas së cilës, po të sulmohet Jugosllavia, Republika Popullore e Shqipërisë do të jetë përkrah popujve jugosllavë, do të shkojë në ndihmë të tyre. Deklarata jonë u erdhi mirë të gjithëve, po në mënyrë të veçantë u erdhi shumë mirë popujve të Jugosllavisë. Kjo na intereson shumë neve, por i intereson edhe Titos, u intereson edhe kapitalistëve, të cilët qëndrimin e Shqipërisë e interpretuan si një zbutje nga ana jonë të mosmarrëveshjeve që kemi në fushën ideologjike me revizionistët jugosllavë. Kur ata nuk kishin filluar akoma të thoshin që shqiptarët u zbutën, ne, me anë të një artikulli që botuam në shtypin tonë, u futëm të gjithëve një dackë fytyrës, për të pasur të qartë se s'është fjala aspak për zbutje ideologjike, por vetëm për një ndihmë në rast se Jugosllavia do të sulmohet nga ushtria e revizionistëve sovjetikë.

Rreziku i një sulmi kundër vendit tonë, ashtu si edhe më parë, vazhdon të ekzistojë, por ne nuk jemi qorra, Partia jonë nuk gënjehet, ajo i gjykon thellë koniunkturat, prandaj në asnjë mënyrë nuk lejon që të shuhet vigjilenca. Ne e dimë se në Bashkimin Sovjetik është në fuqi klika fashiste e mareshalëve aventurierë, të cilët mund edhe ta sulmojnë Jugosllavinë, megjithëse kjo do të jetë një ndërmarrje e zorshme për ta. Edhe Çekoslllovakinë revizionistët sovjetikë e sulmuan vetëm pasi u siguruan mirë se atje nuk do të hidhej asnjë pushkë, kur u bindën se udhëheqja revizioniste çekosllovake, klika e Dubčekut dhe e tradhtarëve të tjerë, ishte frikacake dhe do të kapitulloste, siç kapitulloi. Në rast se sovjetikët do të kishin të dhëna se në Çekosllovaki do të kërciste pushka, ata do të mendoheshin mirë para se të vepronin, sepse vërtet janë agresorë, po përpiqen edhe të maskohen.

Duke sulmuar Çekoslllovakinë, revizionistët sovjetikë i vunë Bashkimit Sovjetik një tjetër njollë të zezë të madhe që nuk është shlyer dhe as që do të shlyhet kurrë. Agresioni kundër Çekoslllovakisë, sikundër e dini, bëri bujë të madhe në mbarë botën, edhe pse atje nuk u hodh asnjë pushkë kundër agresorëve. Ndryshe do të ndodhë po të sulmohet Jugosllavia, popujt e këtij vendi do të luftojnë, ashtu sikundër bënë gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër pushtuesve nazifashistë. Në një rast të tillë revizionistëve sovjetikë, përveç rezistencës së vendosur të popujve jugosllavë, do t'u duhet të përballojnë edhe kundërveprimin e fuqishëm të opinionit publik botëror. Prandaj, duke e njohur këtë fakt, është e zorshme që ata të ndër-

marrin një aventurë të tillë. Por socialimperialistët, si imperialistë që janë, mund të bëjnë çdo gjë, prandaj ne, për çdo eventualitet, duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të gatshëm. Edhe Titoja, që është revizionist, po përgatitet për çdo të papritur. Kjo është arsyeja që ne i mbështetim në këtë çështje popujt jugosllavë. Për qëndrimet e tjera të udhëheqjes jugosllave ne e kemi theksuar qartë dhe si kurdoherë e themi haptazi se jemi në kundërshtim, s'pajtohemi kurrë me të, pse është revizioniste, është antimarksiste, tradhtarë e marksizëm-leninizmit.

Politika që ndjekim ne ndaj Jugosllavisë ndihmon njëkohësisht edhe shqiptarët e Kosovës, për arsye se Titoja «nga halli dhe jo nga malli» ka filluar tash t'u bëjë disa lëshime shqiptarëve. Kohët e fundit shqiptarët në Jugosllavi kanë fituar të drejtën të ngrenë flamurin shqiptar, shkollat të jenë më të lira për ta, u mëkëmb Universiteti i Prishtinës, i cili na ka kërkuar që t'i ndihmojmë me tekste, se kosovarët vetë s'kanë, na kanë bërë kërkesa për të shkuar pedagogë tanët atje për të mbajtur leksione për shqiptarët etj., etj. Kjo është një gjë shumë e mirë. Por Titoja ka filluar t'i bëjë këto lëshime në favor të shqiptarëve të Kosovës se e ka punën pisk, ka rënë ngushtë. Regjimi i tij kapitalist ka krijuar një situatë shumë të vështirë edhe për atë vetë. Në Jugosllavi janë krijuar grupe të shumta antagoniste që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, përpiqen kush e kush të marrë drejtimin dhe kanë ngjallur një nacionalizëm e shovinizëm të tërbuar. Të tillë janë grupi i serbomëdhenjve, i reaksionarëve maqedonas, grupi kroat etj. Titoja, për të zgjatur sa më

shumë sundimin e tij, mbështetet në një grupim kundër një grupimi tjetër. Sovjetikët me dallavere përpigën ta shfrytëzojnë këtë situatë, duke mbështetur grupin serbomadn të Rankoviçit. Për këto arsye Titoja është kundër revizionistëve sovjetikë.

Rankoviçi me Titon dhe me dijeninë e plotë të tij u ka bërë gjithë ato të zeza shqiptarëve të Kosovës. Mirëpo tani, meqenëse Rankoviçi u demaskua, Titoja tërë fajin ia hodhi atij dhe për demagogji e për të mos pasur kundërshtimin e tyre, u dha shqiptarëve të drejtën e ngritjes së flamurit, të hapjes së më shumë shkollave shqipe, të drejtën e zgjedhjes së shqiptarëve në disa organe të pushtetit etj. Me këto veprime ai përpigjet të tregojë sikur gjoja ka qenë kurdoherë në favor të shqiptarëve dhe këtë e bën që të shmangë telashtet në situatat e vështira ku ndodhet, pse e di që shqiptarët janë të gishtit.

Tani në Jugosllavi vërehen tendenca të tilla që kroatët që mbështetin Titon, mbështetin edhe shqiptarët. Në këto rrethana, Partia jonë, me politikën e saj të drejtë marksiste-leniniste, i ndjek me kujdes koniunkturat e krijuara dhe përpigjet të përfitojë prej tyre, po parimet ajo nuk i ndryshon kurrë, prandaj probleme të tilla si ushtria, çështja e kufijve, e ndërtimit të fortifikatave dhe të brezave të mbrojtjes duhet të ndiqen e të zgjidhen njëlloj si edhe më parë, pa menduar aspak t'i lëmë pas dore këto probleme. Asgjë s'ka ndryshuar nga politika jonë, prandaj çdo neglixhencë në këtë drejtim është e palejueshme.

Ju, shokë, në fushën ekonomike keni suksese, po keni akoma shumë për të bërë, sidomos për ngritjen e

rendimenteve të bimëve bujqësore dhe të blegtorisë. Sukseset duhet të jenë për ju një bazë shumë inkurajuese për të ecur edhe më përpara, prandaj mos u kënaqni me rezultatet e arritura. Prodhimi i grurit ka qenë shumë inkurajues për fshatarësinë e rrethit tuaj. Edhe prodhimi i misrit, i cili nga fshatarët tuaj njihej mirë edhe më parë, gjithashtu ka qenë inkurajues. Por, sikurse u vu në dukje këtu, për arritjen e rendimenteve që kërkohen nga Partia, rëndësi të dorës së parë kanë zbatimi i agroteknikës së përparuar, organizimi dhe disiplina në punë. Në qoftë se nuk punohet si duhet në këto drejtime, nuk mund të merren rendimentet që synojmë të arrijmë. Gjithashtu, në qoftë se u vihet rëndësi vetëm drithërave dhe nuk kombinohet mirë zhvillimi i bujqësisë me atë të blegtorisë, atëherë asnjëri nga këta dy sektorë të rëndësishëm nuk përparon. Duket sikur bujqësia me blegtorinë nuk merren të shkëputura, sikur kombinimi i tyre është kuptuar drejt nga të gjithë, por në të vërtetë nuk ndodh kurdoherë kështu dhe ja një fakt: Na thuhet kudo se po merren masa që të shtohen lopët, por nuk mendohet mirë që të sigurohen e të shtohen njëkohësisht edhe të gjitha llojet e sasi të ushqimeve që nevojiten për to. Kur parashikohet të shtohet një numër i caktuar lopësh, duhet llogaritur që atyre t'u përgatitet e t'u jepet edhe gjithë sasia e ushqimit të gjelbër që kanë nevojë për gjithë vitin, prandaj është e domosdoshme të mbillet patjetër gjithë sasia e panxharit, e jonxhës, e tërfilit, e sudangrasit etj., që ato duhet të hanë. Për këtë qëllim ne duhet të parashikojmë e të sigurojmë edhe sipërfaqet e tokës ku do t'i mbjellim gjithë këto

lloje foragjeresh. Në planifikimin e këtyre sipërfaqeve të kemi kurdoherë parasysh që të mos pakësojmë aspak prodhimin e drithërave, përkundrazi, ta tejkalojmë si me anën e hapjes së tokave të reja, ashtu edhe me ngritjen e rendimenteve.

Kur flasim për ngritjen e rendimenteve, del në plan të parë domosdoshmëria e forcimit të disiplinës në punë, e zbatimit të agroteknikës së përparuar, e ujitjes me brazda, e hedhjes së sasisë së nevojshme të plehut dhe e kryerjes së të gjitha shërbimeve të tjera. Nevoja e zbatimit me përpikëri të kodit agroteknik duhet t'i bëhet e qartë çdo kooperativisti e kooperativisteje. Atëherë do të bëhet më mirë edhe zhvillimi i harmonishëm i bujqësisë me blegtorinë. Po t'i sigurohen lopës të gjitha ushqimet që duhet të marrë dhe po t'i bëhen të gjitha shërbimet e tjera për të cilat ka nevojë, ajo me siguri do të rritet e mbarë dhe do të japë jo vetëm mijëra litra qumësht në vit, po edhe pleh me bollëk dhe të cilësisë shumë të mirë. Ja, pra, se si bujqësia e blegtoria lidhen zinxhir njëra me tjetrën. Është një llogari e tërë kjo që duhet bërë me shumë kujdes dhe të mos ecet në tym, pse këtej varet shumë zhvillimi shkencor i bujqësisë sonë. Ka ardhur koha tani që, me mundësitë e krijuara, të gjitha këto synime t'i bëjmë realitet. Përveç lopëve na duhen edhe gjedhët e tjerë, domethënë qetë e punës, po veç duhet llogaritur mirë sa qe na duhen. Pasi t'i keni bërë mirë këto llogari, ngulni këmbë, po të jetë nevoja, gjer në Komisionin e Planit të Shtetit ose në Komitetin Qendror të Partisë, që ajo shifër të realizohet, duke argumentuar se qetë ju duhen si për të punuar tokat atje ku

s'hyn traktori, ashtu edhe për transportin e brendshëm etj. Me këto dua të them se, sipas kushteve të rrethit, ju duhet të mendoni edhe për strukturën e blegtorisë dhe për përsosjen e saj të vazhdueshme.

Ju jeni të apasionuar pas deles «Rudë», së cilës populli i ka kushtuar një këngë të bukur. Unë nuk dua t'jua cenoj këtë dashuri të madhe që keni ju për të, por le të arsyetojmë pak, përse na duhen delet dhe përse duhet të rritim më tepër lopët? Kafshët shtëpiake ne i duam që të na japin prodhime për të ushqyer njerëzit. Dihet se lopa jep më tepër prodhim se delja, prandaj, pa i zhdukur aspak delet, të punojmë me kujdes për të shtuar lopët, ndryshe do të mbetemi në diell, pa lopë e pa dele. Por është e domosdoshme që lopëve që po blejmë t'u sigurojmë ushqime në sasinë që duhet dhe të mira nga ana e cilësisë, që të marrim rendimente të larta prej tyre. Pasi ta shtojmë numrin e tyre, ne do të shpërndajmë lopë race në të gjitha kooperativat bujqësore dhe atëherë në vendin tonë do të ketë qumësht me bollëk. Jo vetëm kaq, po edhe viçat grumbullimit nuk do t'ia dorëzojmë të kategorisë së tretë, por të kategorisë së parë dhe me peshë të lartë. Nga një gjë e tillë kooperativat do të nxjerrin të ardhura të mëdha, prandaj ato nuk do të kenë asnjë interes të mbajnë delet «Rudë» vetëm sa për të marrë një kile e gjysmë lesh. Për të përballuar nevojat për lesh ne duhet të mbajmë aq dele sa do të na i plotësojnë këto nevoja, por njëkohësisht do të bëjmë përpjekje që të përmirësohet nga viti në vit aftësia e deleve për të prodhuar lesh më shumë, po edhe të cilësisë më të mirë. Sa për qumësht dhe mish nevojat në të



ardhmen ne do t'i plotësojmë me lopët. Po edhe delja me rendiment të lartë nuk mund të zhvillohet, po nuk u lidh mirë me tokën e me ekonominë e kooperativës dhe po të mos jetë nën kujdesin e gjithë kooperativistëve. Sot ka ardhur koha që me delet nuk mund të ecet duke bredhur lart e poshtë, sikurse është vepruar gjer tash në disa rrethe. Një gjë e tillë, në kushtet e sotme të intensifikimit të bujqësisë, na dëmton shumë, prandaj nuk mund ta lejojmë më shtegtimin e deleve.

Problemi i planifikimit, sidomos tash, del në shesh me tërë forcën e vet. Planifikimi në bujqësi nuk mund të bëhet duke aprovuar gjithçka ka ardhur nga lart, duke u justifikuar se ashtu na kanë orientuar Komiteti Qendror dhe Qeveria. Partia dhe Qeveria japin shifrat dhe orientimet e përgjithshme, kryesore, të cilat duhet t'i marrë e t'i studiojë me kujdes çdo rreth e kooperativë bujqësore, kooperativa e Shishtavecit, për shembull, pasi i merr këto orientime që i kërkojnë çfarë duhet të prodhojë ajo, i diskuton me kooperativistët. Ne, thonë kooperativistët, do të mbjellim kaq hektarë me patate dhe do të luftojmë që të marrim kaq kuintalë për hektar. Ata, natyrisht, mund të mbajnë edhe ca rezerva; për t'i diskutuar me shokët e rrethit, të cilët kanë parasysh një varg më të gjerë detyrash në shkallë rrethi. Shokëve të rrethit shteti u përcakton sa prodhime duhet të sigurojnë për bukën, sa për bimët industriale, sa për mishin etj. Ata, natyrisht, duke njohur gjendjen e të gjitha kooperativave, mbasi jetojnë këtu së bashku me ju, i caktojnë çdo kooperative shifrat orientuese. Por në rast se Shishtavecit, ta zëmë, mund të prodhojë shumë më tepër patate

nga sa i caktohet, ose një kooperativë tjetër nuk është në gjendje ta prodhojë dot me leverdi një lloj bime, për arsye të kushteve të ndryshme të tokës, të klimës etj., rrethi duhet të ketë parasysh këto veçori të çdo kooperative e sugjerimet e kooperativistëve dhe planin ta koordinojë sipas mundësive e kërkesave të kooperativave, të cilat nga ana e tyre planifikojnë për të siguruar vetë ato prodhime që bëhen më shumë, por që ndihmojnë edhe për plotësimin e planit të shtetit. Në qoftë se një kooperative i është planifikuar të prodhojë duhan dhe ky në fushat e saj s'bëhet, ose bëhet fare pak, atëherë kjo duhet të njoftojë në mënyrë të argumentuar se duhanin nuk e siguron dot, që rrethi të marrë masa t'ua ngarkojë për ta prodhuar kooperativave të tjera. Në qoftë se del që kjo sasi nuk është e mundur të plotësohet në asnjë mënyrë as brenda rrethit, atëherë udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth duhet të njoftojë Komisionin e Planit të Shtetit se misrin, mishin, leshin, pataten etj. jo vetëm i plotësojnë, po edhe i tejkalojnë në këtë masë, kurse duhanin s'e prodhojnë dot. Dhe atëherë Komisioni i Planit këtë çështje duhet ta koordinojë me rrethet e tjera. Kështu hartohet një plan i drejtë që edhe kooperativat i mobilizon totalisht, pse ato vetë me dëshirën e tyre dhe me ndihmën e Partisë e bëjnë planin më real, mobilizues dhe me një perspektivë të qartë.

Ju duhet të kujdeseni ca më mirë se deri tash edhe për pemëtarinë. Merrni shembull nga rrethet e tjera, shokë, ta zëmë nga Peshkopia, që e ka vënë në rrugë të mbarë këtë sektor. Mund të thoni se nuk keni forca pune, as Peshkopia nuk ka shumë forca pune,

po veç dibranët kanë më shumë disiplinë në punë, gjë që shikohet në disa aksione që organizojnë, sidomos në ato me goditje të përqendruar.

Është e vërtetë se miniera e bakrit që keni në rrethin tuaj zbaton një teknologji të vjetër, prandaj do të na lindë nevoja të merren disa masa për të përmirësuar teknologjinë e prodhimit. Dhe në këtë punë nuk duhen lejuar zvarritje, siç po ndodh te ju me ngritjen e shtëpive të banimit për punëtorët. Kjo punë të shikohet mirë këtu, pa qenë nevoja të kërkojë llogari Byroja Politike.

Do të kemi rastin të bisedojmë për këto probleme edhe nesër e pasnesër, se kam ndër mend të qëndroj nja tri ditë këtu. Kështu, për sa i përket ndonjë informacioni për ngjarjet ndërkombëtare, për probleme që i interesojnë shumë Partisë etj., do të kemi rast të flasim në takimet e tjera. Unë fola shumë, prandaj, po të dëshironi tani ju mund të na bëni pyetje, se nuk mund t'i prekja të tëra problemet për të cilat ju keni nevojë t'ju flasim.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## TOK ME POPULLIN TË KRIJOJME ATË REALITET TË MADH QË SYNON PARTIA

*Fjala në mitingun e qytetit të Kukësit*

28 maj 1970

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër të rrethit të Kukësit,

Jam shumë i gëzuar që kam ardhur sot këtu në mes jush për t'u njohur me jetën dhe me sukseset tuaja, për të biseduar dhe për të shkëmbyer mendime së bashku, për të marrë masa të mëtejshme, me qëllim që jeta juaj në të ardhmen të zbukurohet akoma më shumë e të bëhet më e mirë me punë të frytshme e të palodhur. Ju falënderoj për gjithë këtë dashuri të madhe që ju tregoni për Partinë dhe për Qeverinë, të cilat nuk kanë kujdes tjetër përveç ndërtimit të jetës së lumtur për popullin. Prandaj në emër të tyre dhe në emrin tim, ju përshëndes nga zemra të gjithë ju që jeni sot në këtë miting dhe, nëpërmjet jush, gjithë popullin e rrethit tuaj.

Porsa mbërrita, bisedova për punët tuaja me përfaqësuesit e Partisë dhe të popullit në komitet. Por

gjatë kohës që do të qëndroj këtu, dëshiroj të marr kontakt direkt edhe me punëtorë e kooperativistë, të dëgjoj me vëmendje çdo gjë që do të më thonë, dhe jam i bindur se ata kanë shumë për të më thënë, me qëllim që punët tona të ecin më me vrull, që ekonomia dhe kultura në rrethin e Kukësit të bëjnë përparime akoma më të mëdha. Sigurisht, ata do të më këshillojnë e do të më sugjerojnë plot gjëra me vlerë, në mes të tjerash do të bëjnë edhe kritika për disa gjëra që duhen ndrequr.

E kam vizituar edhe herë të tjera Kukësin dhe ruaj kujtime nga më të mirat për ju, pasi jeni një popull patriot, punëtor, përparimtar dhe luftëtar i së resë, besnik i Partisë, ndërtues dhe mbrojtës i socializmit. Këtë radhë unë ndiej edhe një gëzim tjetër që i shtohet takimit me ju, pasi shoh që këtu, ku po bisedojmë së bashku, po ndërtohet Kukësi i ri, për të cilin ka vendosur Partia. Do të vijë dita që Kukësi i vjetër do të zhduket. Ky është ligj; qyteti i vjetër do të zhduket, por në vend të tij është duke u ngritur më i bukur qyteti i ri i socializmit. Historia do të flasë për Kukësin e vjetër, pasi prej tij populli ruan shumë kujtime të hidhura e të bukura, ajo do të flasë për mjerimet e së kaluarës, por edhe për sukseset e arritura nga ju gjer më sot. Qyteti i ri i socializmit këto kujtime të bukura të Kukësit të vjetër do t'i ruajë dhe do t'i zhvillojë më tej, pasi ju, banorët e këtij rrethi, të ndihmuar edhe nga punonjësit e gjithë Shqipërisë, me zotësinë dhe me duart tuaja, do ta ngrini e do ta çoni kurdoherë përpara Kukësin e ri.

Qyteti i vjetër, tokat ku shtrihet ai dhe bregoret

përreth do të përmythen nga uji e në vend të tyre do të krijohet një liqen i madh, që do të shërbejë për të vënë në lëvizje një tjetër hidrocentral madhështor. Ja se si po realizohen ëndrrat e popullit tonë përparimtar në rrugën që na mëson Lenini, sipas të cilit pushteti popullor plus elektrifikimi janë baras me socializmin dhe komunizmin. Pra, siç po e shohim, ne ecim vazhdimisht përpara pa u ndalur, pasi na udhëheq Partia jonë e dashur.

Si i gjithë populli shqiptar, edhe populli i rrethit tuaj ka luftuar vazhdimisht kundër të gjithë armiqve të jashtëm që i kanë shkelur vendin, kundër pushtesve osmanë, serbë, austriakë, italianë, gjermanë, si dhe kundër armiqve të brendshëm, feudalëve, bajraktarëve gjakpirës e të tjerëve. Ai ishte një popull përparimtar, që nuk mungoi të zgjidhte si deputet luftëtarin e flaktë për demokraci, Avni Rustemin. Këtu në këto male ka luftuar dhe është strehuar Bajram Curri, ky trim i mençur dhe mbrojtës i vegjëlisë, që luftoi kundër feudalizmit e shovinistëve serbë për lirinë dhe për unitetin e Shqipërisë.

Por mbarë popullit tonë i është dashur të kalojë vështirësi të mëdha, i është dashur të derdhë shumë gjak për të arritur gjer këtu ku jemi sot, pasi pa luftë dhe pa përpjekje as liria dhe as socializmi nuk mund të fitoheshin. Përpara se të fitonte revolucioni popullor në vendin tonë, masat punonjëse të ne nuk kishin bukë, nuk kishin dritë, ato i kishin pllakosur mjerimi dhe varfëria, vuajtjet dhe sëmundjet. Por me luftë dhe duke kapërcyer vështirësi të shumta, populli shqiptar i flaku tej të gjitha këto të këqija dhe doli në rrugën

e ndritur të socializmit. Populli, pra, nën udhëheqjen e Partisë, e bëri edhe një herë beli se nuk mund të rronte dot pa liri. Ai, si kurdoherë gjatë shekujve, edhe gjatë Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare diti dhe e përdori mirë pushkën, në male e në fusha, atij i shërbyen shumë traditat e lashta luftarake të gjyshërve e të stërgjyshërve tanë të trashëguara brez pas brezi. Malësorëve dhe fusharakëve shqiptarë, fshatarëve dhe punëtorëve tanë Partia ua kaliti më tej këto veti të mrekullueshme të popullit, i udhëhoqi ata në beteja kundër armiqve të jashtëm që na kishin shkelur vendin e atyre të brendshëm që ishin bërë aleatët e tyre, dhe i çoi në fitore.

Edhe populli i rrethit të Kukësit, si gjithë populli shqiptar, shkroi me gjakun e bijve dhe të bijave të tij më të mira epopenë e madhe të Luftës Nacionalçlirimtare. Disa vjet më parë unë kam qenë këtu me rastin e festës së Çetës së Lumës<sup>1</sup>, e cila na kujton të gjithëve luftën heroike dhe kontributin e vlefshëm që dha populli i rrethit tuaj jo vetëm brendapërbrenda rrethit, por edhe për çlirimin e krahinave të tjera të vendit, si Peshkopia e Tirana, bile njësi të tëra të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, në radhët e të cilave kishte edhe me qindra bij e bija kuksiane, kaluan kufijtë e atdheut dhe u shkuan në ndihmë popujve të Jugosllavisë. Prandaj, kur kalojmë këtyre maleve, kur hapim toka të reja, kur punojmë në ara e kudo në këto vise të dashura e të shtrenjta, si ne të moshuarit, ashtu edhe ju të rinj e të reja, nuk harrojmë për asnjë çast se çdo

---

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 294.

pëllëmbë e kësaj toke është skuqur me gjakun e djemve e të vajzave më të mira të popullit për të fituar atë liri që gëzojmë sot.

Historia e lavdishme e vendit dhe e popullit tonë ka një vlerë të madhe. Ne përpiqemi e nxjerrim mësimë të pavdekshme prej saj dhe jemi të lidhur si mi shi me thoin me këtë tokë, së cilës i jemi qepur për t'ia ndryshuar krejtësisht faqen, për ta bërë një kopsht të lulëzuar, dhe këtë nuk e bëjmë vetëm me fjalë, por, siç na mëson Partia, me vepra.

Ju kuksianët keni një fjalë të urtë që thotë: «Punët peshojnë, llafet hiç kandar nuk çojnë». Dje ne luftuam e derdhëm gjak, pasi ishte e domosdoshme që ai të derdhej, ndryshe nuk çlirohej Shqipëria, nuk kishte rrugë tjetër që të vendosej pushteti popullor. Ne jemi kurdoherë të gatshëm të derdhim përsëri gjakun, në rast se do të na preken kufijtë dhe do të na cenohen fitoret e popullit tonë. Por sot ne derdhim djersën e ballit mbi këtë tokë të lagur me gjakun e dëshmorëve, ku dita-ditës po lulëzon bujqësia, po ngrihen fabrika, kombinate, hidrocentrale etj., që jeta e popullit të bëhet gjithnjë e më e mirë. Kjo është vepra e revolucionit, vepra e Partisë.

Më kujtohen disa fraza të një raporti që Komiteti i Partisë i Rrethit të Kukësit i dërgonte Komitetit Qendror të Partisë në vitin 1944. Në mes të tjerash, në atë raport thuhej: «Kukësi është një qytet i vdekur, komunikacioni nga të dy Drinët është prerë, arsimi mungon thujse krejtësisht, funksionon vetëm shkolla në Bicaj. . .».

Tani, pas 25 vjetësh, shikoni si është bërë mbarë



Shqipëria, motra dhe vëllezër, një vend i lirë, me fusha të gjera e pjellore, me një industri të fuqishme, me një blegtori që po zhvillohet, ku edhe bjeshkët po ndërrojnë me shpejtësi faqen dhe po bëhen pjellore ashtu si fushat. Por më e rëndësishmja është se në këtë vend sundon populli, mbi këtë truall sundon njeriu i ri përparimtar, demokrat e revolucionar gjer në fund.

Shqipëria jonë ka hyrë tanimë në rrugën e një vendi nga më të përparuarit, pasi njerëzit e saj janë zotër të vendit, zotër të vetes së tyre, ata askush nuk i shfrytëzon dhe askush nuk guxon t'i shfrytëzojë e t'u prekë nderin dhe lirinë. Të gjithëve sot në Shqipëri u qesh buza dhe u këndon zemra.

Le të qëndrojmë këtu në Kukës dhe të shikojmë si po ecën rrethi juaj e si zhvillohet ai me shpejtësi përpara syve tanë. Për këtë flasim fakte të shumta. Prodhimi industrial i realizuar në rrethin tuaj vitin e kaluar është i barabartë me prodhimin industrial të realizuar në gjithë Shqipërinë në vitin 1938. Sot vetëm Kukësi prodhon mbi tri herë më shumë bakër blister nga sa prodhohej në gjithë vendin në vitin 1960. Në rrethin tuaj në këta gjashtë muajt e fundit janë hapur 1 653 hektarë tokë e re, që do të thotë më shumë se në të gjithë pesëvjeçarin e tretë, ose më shumë se në katër vjet të pesëvjeçarit të katërt të marrë së bashku. Krahina të tëra të rrethit tuaj, më parë me toka të thata e që vuanin për ujë, siç është ajo e Hasit, janë duke u shndërruar në fusha pjellore të ujtitshme, të cilat po kthehen në ndërmarrje bujqësore të begatshme, ose krahina, si ajo e Shishtavecit etj., po prodhojnë sasi të mëdha patatesh.

Ju kuksianët jeni nga blegtorët më të dalluar të vendit tonë, që keni një dashuri të madhe për delen. Por Partia tanimë ju ka hapur sytë dhe ju mëson çdo ditë e më mirë se ku qëndron interesi juaj i madh, i rrethit dhe i gjithë Shqipërisë. Dhe ju tani e kuptoni që, tok me gjithë këtë zhvillim të madh që merr e do të marrë gjithnjë e më shumë bujqësia në rrethin tuaj, është e domosdoshme të zhvillohet edhe blegtoria e të harmonizohet akoma më mirë dhe si duhet me bujqësinë. Ju tani e kuptoni, e më vonë do ta kuptoni edhe më mirë, se krahas deles, është e domosdoshme të zhvillohet edhe lopa në rrethin tuaj. Këtë nuk jua them që të lini pas dore rritjen e deleve, pasi ne kemi nevojë të madhe edhe për to, por veç kemi nevojë për dele me rendimente të larta mishi e leshi, që arrihen me punë dhe me dituri të mëtejshme, të cilat jua rekomandoj t'i fitoni. Mirëpo si në mjaft kraha të tjera të vendit, edhe te ju ekziston një traditë që duhet thyer, dashuria për çdo lloj deleje. Tani ka ardhur koha të realizojmë atë që thashë pak më parë, të harmonizojmë zhvillimin e deles dhe të lopës, pasi, në fund të fundit, njeriu, qoftë delet, ashtu edhe çfarëdo bagëti tjetër, i rrit për të marrë prej tyre sa më shumë prodhime. Partia na mëson të ecim me llogari, e cila na sqaron se lopa na jep prodhime shumë më të bollshme se delja. Pra, kur them se duhet thyer tradita, me këtë të kuptojmë përpjekjet që duhet të bëjmë për të thyer atë traditë sentimentaliste, siç është dashuria për delen, duke llogaritur konkretisht të ardhurat që na jep ajo në krahasim me lopën.

Partia dhe Qeveria punën tuaj me delen «Rudë»

e kanë përkrahur dhe do ta përkrahin, pasi kjo dele është lloj i një race të bukur, së cilës ne duhet t'i krijojmë kushte të përshtatshme që të rritet në vend, prandaj duhet të lihen mënjanë metodat e vjetra të kultures e të shtegtimit, të cilat nuk është e mundur të realizohen në një etapë zhvillimi të bujqësisë sonë si kjo e tanishmja, kur karakteri i saj ka ndryshuar në krahasim me bujqësinë e vjetër private me prona të ndara e të hallakatura, dhe është duke u transformuar në një bujqësi të bashkuar, të fuqishme, moderne dhe intensive.

Në këto drejtime të zhvillimit të bujqësisë sonë ne kemi shumë për të thënë dhe kemi shumë për të bërë këtu në Kukës, motra dhe vëllezër, pavarësisht nga gjithë ato realizime të mëdha që janë arritur gjer tani. Ne duhet të marrim masa të tjera për forcimin e mëtejshëm të ekonomive kooperativiste dhe për ngritjen e tyre në një nivel akoma më të lartë agroteknik, duhet të marrim masa të mëtejshme për shtimin e sipërfaqeve të ujitshme, për pyllëzimet e për pemëtarinë. Gjithashtu, duhet të dërgojmë të rinj e të reja në shkolla e në kurse për të mësuar bujqësinë e blegtorinë moderne, por jo një dhe dy veta, por me dhjetëra e me qindra, që, porsa të mbarojnë mësimet, të kthehen përsëri në gjirin e popullit dhe, tok me të, të krijojnë atë realitet të madh ekonomik që synon Partia në bujqësi. Partia na mëson që njerëzit që punojnë, që drejtojnë, që organizojnë në ara, duhet të jenë të ndërgjegjshëm se për t'ia arritur këtij qëllimi të madh është e domosdoshme të punohet dhe njëkohësisht të mësohet. Por duhet punuar dhe duhet mësuar në më-

nyrë të organizuar, sepse organizimi luan një rol të madh në arritjen e objektivave të dëshiruara.

Qëllimi i gjithë këtyre masave është që të shtojmë prodhimet bujqësore e blegtorale për të plotësuar me to nevojat e rrethit tuaj dhe të të gjithë Shqipërisë. Këtë detyrë i kanë vënë vetes Partia dhe Qeveria, pasi një nga detyrat e tyre kryesore është ngritja e mirëqenies së popullit, të cilit jo vetëm të mos i mungojë asgjë, po nga viti në vit t'i shtohen gjithnjë e më shumë prodhimet ushqimore për të cilat ka nevojë për jetesën e tij.

Kukësi nuk është vetëm një rreth bujqësor, pasi këtu kemi tani edhe një industri të bakrit. Si në çdo rreth të vendit tonë, industria ndërtohet e zhvillohet në bazë të pasurive që ka toka ose nëntoka. Për sa u përket pasurive të mëdha të tokës, aktualisht në Kukës mund të ketë disa punishte, por kjo nuk përjash-ton aspak që, si në të gjitha rrethet e tjera, me zhvillimin e madh të bujqësisë, të ndërtojmë edhe këtu fabrika, qoftë edhe të vogla, por moderne, për përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, siç mund të jenë, për shembull, djathërat, frutat, perimet etj.

Por rëndësi të madhe marrin në rrethin tuaj, sidomos, pasuritë e nëntokës, të cilat kanë hapur për gjithë vendin tonë një perspektivë të ndritur. Këtë perspektivë e çeli Partia dhe po e bëjnë realitet klasa jonë punëtore, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia popullore, mbarë populli ynë dhe askush tjetër. Kjo është një fitore e madhe që po korrin e do të korrin edhe më vonë.

Vendburimi i Gjegjanit këtu në Kukës, si nga pi-

këpamja e sasisë, ashtu edhe e cilësisë së mineralit të bakrit, është nga më të mirët e vendit tonë. Por ne jemi duke përgatitur, gjithashtu, vendburime të reja bakri dhe kromi në rrethin tuaj. Në Shishtavec (Kallabak), gjithashtu, ekzistojnë rezerva kuarci, të cilat jo shumë vonë do të shfrytëzohen nga fonderitë e uzinave tona të qelqit.

A ka, pra, të drejtë Partia, vëllezër dhe motra të Kukësit, kur thotë se sa e bukur do të jetë e ardhmja për popullin tonë, kur thotë se këto bjeshkë do të bëhen po aq pjellore sa edhe fushat, se në zemrën e këtyre maleve shekullore gjenden thesare të paçmueshme? Po të mos kishin luftuar Partia dhe populli, këto rezultate nuk mund të arriheshin, nuk do të zbuloheshin këto pasuri të mëdha, por edhe sikur të zbuloheshin, ato do të bëheshin pasuri e hajdutëve të huaj dhe e hajdutëve vendës si Muharrem Bajraktari e Mustafa Kruja me shokë, të cilët do t'ua shitnin copë-copë truallin e vendit tonë koncesionarëve të huaj imperialistë.

Ne gëzohemi shumë kur dëgjojmë se sa kujdeseni ju, populli bujar i Kukësit, për gjeologët tanë, sa kujdeseni për minierat që janë hapur. Shumë nga ju punojnë vetë atje, prodhojnë e kaliten. Ne gëzohemi, gjithashtu, kur populli i rrethit tuaj këshillon Partinë, këshillon kuadrot dhe gjithë punonjësit të kujdesen dhe të shfrytëzojnë me ekonomi gjithçka e gjer në fund në interes të popullit, të mos lënë asgjësendi të shkojë dëm, të kursejnë kohën, të forcojnë disiplinën në punë, të realizojnë planet dhe t'i tejkalojnë ato.

Njerëz të mësuar tani edhe në rrethin tuaj ka plot

e të tillë nesër do të ketë akoma më shumë. Çdo komunist dhe komuniste, si dhe çdo njeri të mësuar, Partia e këshillon vazhdimisht që diturinë dhe zotësinë që kanë fituar t'i vënë si duhet në shërbim të plotë të interesave të popullit dhe të socializmit, të mos tregohen kurrë fodullë për atë çka dinë e kanë mësuar dhe të mos nënvleftësojnë asnjëherë diturinë e madhe të popullit, përkundrazi, të mësojnë vazhdimisht nga ai, sepse dituria dhe zotësia e popullit janë të pakufishme. Populli është i zoti të bëjë çdo gjë, kurse një apo qofshin edhe dhjetë njerëz të mësuar nuk janë të zotë të bëjnë asgjë pa popullin. Ju, këtu në Kukës, mirë e thoni që «Kush asht i zoti, s'i shkon zi moti». Pra, vetëm kur njerëzit e mësuar dhe komunistët do të lidhen ngushtë me popullin, atëherë do të bëhen më të zotë, atëherë rezultatet e punës sonë do të jenë jashtëzakonisht të mëdha dhe direktivat e Partisë, të cilat u hapin sytë njerëzve, do të zbatohen më së miri në të gjitha fushat. Direktivat dhe këshillat e Partisë nuk janë disa gjëra të thata e të pakuptueshme, ato përmbajnë në vetvete dëshirat dhe kuptimet e gjera të popullit, i cili ka forca aq të shumta në gjirin e tij saqë është në gjendje t'i vërë këto direktiva në jetë me sukses për të realizuar punë të mëdha.

Sigurisht, për të korrur sukses të plotë, punët duhet të organizohen mirë, jo rrëmujë e shkel e shko, pasi kështu as bujqësia nuk jep gjë, as industria nuk prodhon, as lopa nuk jep qumësht, as delja nuk prodhon qumësht, mish apo lesh. Prandaj komunistët, kur shpjegojnë dhe zbatojnë direktivat e Partisë në çdo fushë, më parë duhet të reflektojnë vetë thellë për

format dhe metodat e organizimit të punës që duhen përdorur. Këto forma e metoda të mos dalin vetëm nga koka e tyre, por të jenë fryt i mendimit të përbashkët krijues të masave të popullit, pasi kështu do të jenë më të përsosura. Kjo është rruga jonë dhe kjo rrugë e ky qëllim synojnë që popullin ta bëjnë më të gëzuar dhe më të lumtur.

Si në të gjithë vendin, ashtu edhe në rrethin tuaj ne kemi një organizatë partie të fortë e të shëndetshme, me shokë e shoqe besnikë të çështjes së madhe të popullit dhe të socializmit. Komunistët e Kukësit janë në krye të detyrave dhe të lidhur ngushtë me popullin. Këtë unitet të ngushtë të Partisë me masat punonjëse qoftë populli, qoftë komunistët duhet ta kenë kurdoherë parasysh në çdo moment e përpara çdo gjëje, me qëllim që ta çelikosin vazhdimisht. Pa ekzistencën e këtij uniteti, punët nuk do të na shkojnë mbarë, kurse me ekzistencën e çelikosjen e vazhdueshme të tij Shqipëria socialiste nuk do të ketë mortje kurrë. Prandaj komunistët, në radhë të parë, duhet të zhvishen nga çdo mbeturinë mikroborgjeze, përndryshe ata nuk do të jenë në gjendje të luftojnë në masat e popullit ato mbeturina të dëmshme të së kaluarës që pengojnë ecjen tonë përpara.

U shemb përgjithmonë regjimi i sanxhaqeve e i bejlerëve, i dasive gegë e toskë, myslimanë, katolikë e ortodoksë, të krijuara apostafat nga armiqtë për të përçarë popullin tonë, me qëllim që të sundonin më mirë mbi të. Tani ka ardhur një kohë tjetër, kur populli është një dhe i pandarë, si një bllok i tërë i çeliktë,

prandaj sot nuk ka fuqi që ta thyejë këtë unitet, të lëkundë themelitë e tij të forta.

Të gjithë në vendin tonë janë shokë, miq e vëllezër me njëri-tjetrin. Ky unitet bazohet në transformimet e mëdha ekonomike në rrugën socialiste që ka krijuar prona e përbashkët mbi mjetet e prodhimit, mbi bazën tonë ideologjike, marksizëm-leninizmin, ideologjinë e klasës punëtore, që është bërë njëkohësisht ideologjia e fshatarësisë kooperativiste dhe e inteligjencies sonë popullore. Kjo ideologji na ndihmon të kaliten virtytet më të mira, më të pastra e më të kulluara të popullit tonë heroik dhe të hidhen tej të gjitha mbeturinat e veset e këqija që na ka lënë e kaluara, e cila i kishte themelet e saj në pronën private mbi mjetet e prodhimit, në besimet idealiste dhe fetare. Uniteti ynë sot forcohet e çelikoset dita-ditës në luftë.

Askush nuk ia do të keqen kësaj Shqipërie, që i kushtoi popullit kaq gjak e sakrifica, përveç armiqve. Prandaj cilido nga ne, kur mendon, kur vepron, kur punon dhe lufton, duhet të përpiqet të bëjë sa më pak gabime, që në punën dhe në luftën e tij të ketë sa më pak të meta e dobësi. Por fakt është se të gjitha këto nuk zhduken dot përnjëherësh. Prandaj është e domosdoshme që për të mirën e çdo njeriu dhe për të mirën e përbashkët të Shqipërisë sonë socialiste e të brezave që do të vijnë, t'i luftojmë me vendosmëri mendimet e këqija dhe të dëmshme, t'i luftojmë gjithë këto mbeturina të së kaluarës që pengojnë ecjen përpara të shoqërisë sonë, që dëmtojnë unitetin, dashurinë dhe harmoninë me njëri-tjetrin. Duke i parë çështjet



në këtë prizëm, cilido, përpara kritikës apo vërejtjes së shokut, të vëllait ose të motrës, kurdoherë duhet të reflektojë me gjakftohtësi e me kuptimin e një njeriu të ri dhe të gjejë rrugën e vërtetë për të vepruar. Dhe pikërisht këtë rrugë të vërtetë na mëson çdo ditë Partia.

Ka njerëz, midis të cilëve edhe komunistë, që nuk i kuptojnë gjithmonë si duhet mësimet e Partisë. Disa herë ata janë të pasjellshëm, ka raste që bëjnë hatëre, ndonjëherë përpiqen të shfrytëzojnë pozitën dhe sillen në mënyrë arrogante me njerëzit e popullit. Nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që këta njerëz, kudo që të jenë dhe sido që të paraqiten, të vazhdojnë në këtë rrugë. Pikërisht këtu duhet luftuar ajo ndjenjë e gabuar dhe e vjetër, siç janë hatëri dhe miqësia e rreme, shoqëria pa baza, që vë interesin personal përpara interesit të përgjithshëm. Shokun, mikun, vëllain duhet ta duam në mënyrë të sinqertë kur shohim se ai punon me ndershmeri për çështjen e popullit dhe të Partisë. Por, padashur, ai edhe mund të gabojë. Në këtë rast ne e kemi për detyrë ta ndreqim dhe t'ia falim gabimin. Por ai mund të gabojë edhe me dashje. Edhe në këtë rast ne duhet ta ndihmojmë, duke e këshilluar dhe duke e kritikuar që të korrigjohet e të ecë në rrugën e popullit dhe të Partisë, pasi ndryshe populli e dënon. Përse duhet t'i bëjmë këto dhe të veprojmë kështu? Sepse pikërisht vetëm në këtë rrugë do të ekzistojë ajo dashuri e madhe në mes njërit dhe tjetrit, që ne e quajmë unitet dhe që është garancia e të gjitha sukseseve tona.

O ju pleq të Kukësit! Shumë nga ju më kanë

shkruar disa herë letra, të cilat më kanë prekur, më kanë forcuar besimin në punë dhe më kanë dhënë të kuptoj se Partia jonë ecën në rrugë të drejtë. Me këtë rast që ndodhem pranë jush, dëshiroj t'ju falënderoj nga afër për atë ndihmë të vlefshme që na keni dhënë dhe për atë besim të madh që keni te Partia dhe te rinia. Unë jam interesuar vazhdimisht për punën tuaj dhe shokët drejtues të Partisë në rreth më kanë folur me admirim për të gjithë ju, burra e gra, që, sido me moshë të kaluar, prapë jeni në ballë të luftës dhe të punës. Ju jeni nga ata njerëz patriotë që edhe pushkën e mbani për gryke por edhe kazmën nuk e lëshoni nga dora. Ju edhe mund të thoshit se tani u plakëm, na u rritën djemtë, na u rritën cucat, atëherë përse të punojmë e të lodhemi akoma? Mirëpo nuk mendoni kështu, ju e keni thyer këtë mentalitet të vjetër ndaj punës. Ç'ju ka bërë që t'i thyeni mentalitetet e vjetra? Pikërisht e gjithë kjo punë e madhe revolucionare e Partisë që ju ka rinuar shpirtin dhe ju ka dhënë forcë. Ju jeni nga ata që keni mbajtur në kurrizin tuaj peshën e rëndë të robërisë së kaluar, prandaj tani, që dolët në dritë, mendoni dhe e çmoni drejt se duhet ta vazhdojmë pa ndërprerje punën dhe luftën, që kurrë të mos kthehen më ato ditë të zeza.

Dëshiroj tani t'ju them edhe nja dy fjalë të tjera. Kur ishim ne të rinj, qenë të tjera kohë dhe, natyrisht, sipas kohëve ishin edhe zakonet. Ne kishim edhe atëherë zakone shumë të mira, siç janë: bujaria, mikpritja, besa, nderi, dashuria për punën etj. Por bashkë me to kishim edhe do zakone të këqija. Zakonet e mira që kemi trashëguar nga e kaluara, ne i ruajmë dhe

Partia na këshillon vazhdimisht çdo ditë: «I ruani, i zhvilloni, jepuni brezave të ardhshëm gjithë këto zakone të mira, që ata të jenë, si kurdoherë, shqiptonja mali, kurse zakonet e këqija i luftoni, pasi ato janë të dëmshme».

Kohët e reja kërkojnë edhe zakone të reja. Këtë ju vëllezër dhe motra të Kukësit, në përgjithësi, e keni kuptuar, prandaj Partia ka gjetur një mbështetje të fortë te populli i rrethit tuaj, ashtu si te mbarë populli ynë, pa të cilin asgjë nuk mund të bëhet. Gjer sot ne kemi shkukur e kemi pastruar mjaft ferra që na pengonin fort këmbët, por po të themi se i kemi zhdukur të gjitha, do të bënim gabim. Gjithçka kemi bërë nuk është e mjaftueshme, pasi kemi akoma shumë e shumë për të bërë, pasi e vjetra nuk zhduket lehtë, bile nganjëherë zakonet e vjetra, për të mos u zhdukur, vishen me rroba të reja, por, në fakt, ato janë po aq të vjetra dhe të këqija siç kanë qenë edhe më parë.

Nuk do t'i përmend tani të gjitha këto zakone të këqija, pasi i dimë nga lufta e përditshme dhe e vazhdueshme që po bëjnë Partia dhe populli kundër tyre, por me këtë rast dëshiroj t'ju them që të luftojmë sidomos kundër atyre zakoneve prapanike që kanë të bëjnë me mënyrën e të jetuarit dhe me çlirimin e plotë të gruas, për t'u hapur rrugën rinisë, në përgjithësi, dhe cucave, në veçanti, që të jenë të lira, të ndershme, punëtoje, të kenë mundësi të mësojnë në kurse e shkolla, të mendojnë me kokën e tyre, të shkojnë në aksione, të ndërtojnë jetën e re, të ndërtojnë familjen e tyre në bazë të dashurisë plot ndershmëri.

Mos e merrni fjalën «dashuri» si diçka të turp-

shme, pasi dashuria është një domosdoshmëri në jetë. Ashtu sikurse babai dhe nëna i duan bijtë dhe bijat e tyre dhe këta i duan e i respektojnë prindërit, vjen koha që edhe vajza, kur rritet, do të krijojë marrëdhënie dhe do ta dojë djalin me të cilin ajo do të lidhë jetën dhe do të lindë fëmijët e saj të ardhshëm. Këto marrëdhënie kthehen në diçka të turpshme kur bëhen në forma të palejueshme që i dënon Partia, kurse të martohet i riu ose e reja me atë që ia do zemra, është një gjë sa e ndershme, aq edhe e domosdoshme në jetën e njeriut. Nuk ka prind, deri edhe tek ai më konservatori, që, po të mendohet thellë, të mos arrijë në këtë konkluzion, pasi ai i do vetëm të mirën vajzës ose djalit të vet. Edhe Partia dëshiron dhe përpiqet që familja të jetë një organizëm në unitet të plotë. Po si mund të jetë ajo në unitet të plotë, po të mos ekzistojë dashuria e sinqertë në mes çiftit? Kur çdo familje është në unitet të plotë dhe e gëzuar, atëherë fshati dhe qyteti janë të gëzuar, i gjithë atdheu është i lumtur e i gëzuar.

Përse po e ngre vazhdimisht këtë çështje? Sepse në këtë drejtim kemi akoma shumë për të bërë, për arsye se ndaj grave dhe vajzave mbahen akoma qëndrime jo të drejta dhe prapanike, kurse roli i tyre në shoqërinë tonë socialiste duhet kuptuar mirë nga të gjithë, pasi është nga më të rëndësishmit dhe, në mos më i rëndësishëm se ai i burrave, është njëlloj i barabartë me të.

Unë kam besim të plotë se populli i Kukësit i ka kuptuar drejt këto probleme dhe i zbaton gjithashtu drejt. Këtë ma vërtetojnë letrat që marr nga punonjës

të ndryshëm të rrethit tuaj, nga pleq dhe të rinj. Ju nuk e keni bërë kurrë dysh fjalën e Partisë, pasi e dini që ajo është vetëm për të mirën tuaj, prandaj jam i bindur se do ta thelloni akoma më shumë këtë revolucion ideologjik që udhëheq Partia, se ky revolucion do të bëjë që ne të korrim suksese akoma më të mëdha në të ardhmen.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Duke punuar e duke ndërtuar, të mos harrojmë për asnjë moment që edhe të vigjilohet, pasi, siç thotë populli, «Uji fle, hasmi s'fle». Në botë ka armiq të popujve dhe të socializmit që kurdisin komplete kundër lirisë dhe pavarësisë së popujve dhe zhvillojnë luftëra kundër tyre. Këta armiq janë kapitalistët, imperialistët dhe shërbëtorët e tyre reaksionarë, revizionistët dhe tradhtarë të tjerë të çdo ngjyre. Në krye të të gjithë këtyre armiqve qëndrojnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë. Ç'kërkojnë të bëjnë ata? Ata kërkojnë të sundojnë botën dhe t'i mbajnë popujt nën zgjedhë. Më konkretisht kjo do të thotë që, sikur t'u vijë për dore, të sjellin në fuqi në Shqipëri bejlerët, agallarët, fajdexhinjtë dhe gjithë plehrat e tjera që shpartalloi pa mëshirë revolucionin ynë popullor. Por ata nuk mund t'ia arrijnë kurrë këtij qëllimi, sepse janë më të dobët se popujt. Është pikërisht dobësia e tyre që i bën imperialistët dhe revizionistët të jenë më të egër kundër popujve, kundër komunizmit, kundër socializmit. Ata e shikojnë vdekjen me sy, por dëshira

e tyre është të rrojnë, ta zgjatin edhe ca jetën. Prandaj me hekur dhe me zjarr përpigën t'i shtypin popujt dhe revolucionet e tyre. Mirëpo popujt janë më të fortë se ata dhe shembullin më të madh që e vërteton këtë e ka dhënë populli shqiptar, një popull i vogël, që ka luftuar vazhdimisht gjatë shekujve kundër armiqve të shumtë e të mëdhenj, por as u mund e as u zhduk, përkundrazi, ishte ky që i mundi edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare pushtuesit, qofshin këta fashistët italianë, ashtu edhe nazistët gjermanë e bashkëpunëtorët e tyre. Është lehtë, pra, të bëhet një analogji e tillë me luftën çlirimtare që zhvillojnë edhe sot popujt kundër bishave imperialiste.

Imperializmi amerikan ka shumë vjet me radhë që ka filluar agresionin e tij në Vietnam, por populli heroik i këtij vendi e ka gozhduar në disa vrima që quhen kampe këtë fuqi të madhe imperialiste, duke i shkaktuar atij dëme kolosale. Ai nuk mund të fitonte dhe e sheh se nuk ka për të fituar në Vietnam. Prandaj përpara disfatës që i shkaktoi populli vietnamez, kohët e fundit imperializmi amerikan sulmoi një popull tjetër, popullin kamboxhian. Këtë ai e bëri nga halli, duke menduar se do t'i shpëtojë disfatës, por kësaj nuk do t'i shpëtojë, për arsye se jo vetëm që gjithë popujt e botës janë ngritur në këmbë dhe po e dënojnë me indinjatë të madhe këtë xhandar të egër ndërkombëtar, por konkretisht imperializmi amerikan ka tani përballë tre popuj: atë vietnamez, atë laosian dhe popullin e Kamboxhias, që, të bashkuar si një trup i vetëm në Gadishullin Indokinez, do t'ia bëjnë varrin shumë shpejt.

Imperializmi amerikan synon të futë nën zgjedhë popujt e Azisë, për t'i pasur si mish për top në këtë luftë që janë duke përgatitur, domethënë t'i vënë aziatikët të luftojnë kundër aziatikëve. Mirëpo këtij qëllimi barbar imperializmi amerikan nuk do t'ia arrijë dot kurrë, për arsye të forcës kolosale të popujve, për arsye se vetë aleatët e tij janë shumë të tronditur nga brenda, nga kundërshtimi i vetë popujve të tyre, ashtu edhe nga jashtë nga gjithë popujt e tjerë të botës.

Pikërisht në këto situata të një dobësie të përgjithshme të armiqve të lirisë së popujve dhe të socializmit, revizionistët sovjetikë, këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit, që e kanë shndërruar Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist, kanë hyrë në aleancë me imperializmin amerikan për të shtypur revolucionet kudo në botë dhe për të përgatitur luftën kundër Kinës. Kjo aleancë, natyrisht, i ka bazat mbi rërë, pasi drejtohet kundër popujve, pasi ajo është aleanca e një grushti kapitalistësh me qëllime shfrytëzimi ndaj popujve dhe për robërimin e tyre. Prandaj brenda në Bashkimin Sovjetik dhe në aleatët e tij revizionistë ekzistojnë jo vetëm kontradikta të mëdha, por edhe lëvizje kundërshtimi ndaj kësaj rruge imperialiste për të robëruar popujt, që tradhtarët e Kremlinit përpiqen ta maskojnë me emrin e Leninit, siç bënë me Çekoslovakinë dhe siç dëshirojnë të bëjnë me përgatitjet e tyre për agresion kundër Rumanisë, kundër Jugosllavisë; kundër Shqipërisë, kundër Kinës.

Tradhtia e revizionistëve në Bashkimin Sovjetik dhe në të gjitha vendet e tjera ku sundojnë këta tradhtarë, ka shkaktuar një rënie të madhe ekonomike dhe

një degjenerim politik e moral të paparë. Atje po vendoset rendi kapitalist me të gjitha të këqijat e tij, duke përfshirë edhe diktaturën e egër fashiste e militariste. Kjo diktaturë shtyp brenda popullin dhe përgatit agresionin kundër popujve të tjerë. Midis imperialistëve dhe revizionistëve ekzistojnë një sërë komplotesh dhe intrigash, marrëveshje të hapëta e të fshehta, të gjitha të bëra gjoja në emër të mbrojtjes së paqes, të sigurimit evropian e të mirëqenies së popujve. Por të gjitha këto hajde-eja, të gjitha këto kontakte e bisedime, të gjitha këto koluzione<sup>1</sup> nuk mund të fshehin acarimin e gjendjes në gjirin e imperialistëve dhe të revizionistëve modernë, kontradiktat e mëdha në mes tyre, grindjet që sa venë e po shtohen, dështimet në çdo fushë, demaskimin e qëllimeve të tyre të vërteta dhe ngritjen e revolucionit.

Imperialistët dhe revizionistët janë në krizë të madhe, në krizë politike, ekonomike dhe ushtarake. Në të katër anët ku sundojnë ata, punëtorët, studentët, fshatarët janë hedhur në greva, demonstrata e përleshje të përgjakshme. Kurse, nga ana tjetër, në Republikën Popullore të Shqipërisë po ndërtohet me sukses socializmi, populli është hedhur i tëri në luftë për ndërtimin e jetës së lumtur e të begatshme.

Politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë është e drejtë, marksiste-leniniste, revolucionare dhe e palëkundshme në asnjë rrethanë. Ne kemi luftuar dhe do të luftojmë gjer në fund për socializmin e vërtetë dhe

---

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja — marrëveshje sekrete midis dy palëve në dëm të një të treti.



për komunizmin, nën flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, kundër çfarëdo erërash e furtunash, të çdo fuqie që të jenë ato. Këto erëra e furtuna ne shqiptarët as na trembin, as na frikësojnë. Ne do t'i mbështetim dhe do t'i mbrojmë të gjithë popujt që luftojnë për lirinë dhe për pavarësinë e tyre.

Revizionistët sovjetikë prej kaq kohësh po i vijnë rrotull Rumanisë dhe me kërcënime e shantazhe të poshtra duan të nënshtrojnë popullin e saj. Nën maskën e Traktatit të Varshavës, ata bëjnë shantazhe ushtarake, duke kërkuar me këmbëngulje që të bëjnë manovra në Rumani, me fjalë të tjera, që të futin forcat e tyre të armatosura në territorin rumun dhe të mos i nxjerrin më, pra ta pushtojnë Rumaninë dhe të vendosin atje një qeveri kuislinge, siç bënë në Çekoslovakia. Krerët revizionistë të Kremlinit duan ta bëjnë Rumaninë një koloni të tyre dhe për këtë qëllim i bëjnë asaj presione të shumta ekonomike, duan ta integrojnë në ekonominë e tyre, t'u imponojnë rumunëve deri monedhën e tyre të falimentuar. Dikur Hrushovi, me planin e tij të krijimit të «kompleksit të prodhimit ndërshtetëror të Danubit të Poshtëm», ishte më «modest». Ai synonte të kolonizonte vetëm një pjesë të Rumanisë, rajonet danubiane të saj dhe zonën e Bukureshtit. Kurse klika e Brezhnjev-Kosiginit ka oreks më të madh, kjo kërkon të gllabërojë gjithë Rumaninë. Por populli rumun, partia dhe qeveria e tij po i qëndrojnë me vendosmëri dhe me guxim këtij presioni të turpshëm.

Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij janë dhe do të jenë kurdoherë në anën e popullit vëlla rumun,

do ta mbështetin e do ta përkrahin atë në luftën e tij të drejtë.

Socialimperialistët sovjetikë bëjnë të tilla presione dhe përgatitin plane agresive duke menduar se nuk i ndëshkon njeri, mjaft që të jenë në ujdi me imperialistët amerikanë.

Ne kemi mbështetur e do të mbështetim, gjithashtu, në të ardhmen, me të gjitha forcat tona, luftën e popullit vëlla vietnamez, të popullit vëlla laosian e të popullit vëlla kamboxhian. Ne gjithnjë kemi ndjekur me simpati të veçantë dhe e kemi përkrahur luftën e drejtë e këmbëngulëse të popujve vëllezër arabë për çlirimin e tokave të tyre të pushtuara nga agresorët izraelitë dhe për të mbrojtur të drejtat e veta kombëtare nga komplotet e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Ne e kemi përkrahur me vendosmëri edhe luftën heroike të patriotëve trima palestinezë kundër armiqve të egër imperialisto-izraelitë.

Populli shqiptar është miq besnik e i sinqertë i të gjithë popujve arabë dhe i popullit palestinez, prandaj ai ka qëndruar dhe edhe në të ardhmen do të qëndrojë përkrah luftës së tyre, duke qenë plotësisht i bindur se fitorja përfundimtare do të jetë në anën e popujve arabë.

Ne kemi mbështetur e do të mbështetim të gjithë popujt e tjerë të botës që luftojnë për liri, pavarësi, demokraci dhe socializëm. Ne do të luftojmë gjer në fund kundër tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, në radhë të parë kundër revizionistëve sovjetikë dhe të gjitha llojeve e ngjyrave të tjera të revizionizmit, si dhe kundër reaksionit në botë.

Ne punojmë e ndërtojmë, por njëkohësisht vazhdojmë të forcojmë gjithmonë e më shumë fuqinë mbrojtëse të atdheut tonë socialist, duke qenë secili prej nesh një ushtar i hekurt i Republikës sonë Popullore. Kufijtë tanë janë të paprekshëm. Të mos mendojnë armiqtë se jemi të vegjël e të pafuqishëm. Ne kemi miq të shumtë e të singertë në të katër anët e botës. Ne nuk sulmojmë njeri, por u themi, gjithashtu, imperialistëve dhe revizionistëve të kenë kujdes, se kush prek Shqipërinë, do të gjejë vdekjen, fitorja do të jetë jona.

Politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë kurdoherë ka qenë dhe është për marrëdhënie të mira me fqinjët. Ne kemi thënë dhe e theksojmë se dëshirojmë të jemi miq me popujt e shteteve kufitare. Ne u kemi dashur dhe kurdoherë u duam të mirën popujve fqinjë. Kurrë nuk u kemi bërë keq atyre; vetëm kur klikat fashiste reaksionare të tyre na kanë bërë keq, atëherë edhe ne u jemi përgjigjur dhe u kemi dhënë mësimin e merituar. Ne dëshirojmë të kemi me popujt fqinjë marrëdhënie të mira në rrugën shtetërore dhe mbi baza të interesit reciprok. Çdo shteti ia kemi bërë të njohura dëshirat dhe pikëpamjet tona, por ato nuk ia imponojmë kurrkujt. Edhe të tjerët e kanë parë dhe e kanë ndier, gjithashtu, kotësinë për të na frymëzuar ose për të na imponuar dëshirat dhe pikëpamjet e tyre të papëlqyeshme për ne.

Shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër të Kukësit,

Nën udhëheqjen e Partisë, mbarë populli ynë do ta çojë akoma më përpara dhe me hapa të sigurt këtë

përparim të madh të vrullshëm që po zhvillohet në vendin tonë drejt ndërtimit të plotë të socializmit. Partia dhe Qeveria jonë po studiojnë aktualisht planin e pestë pesëvjeçar plot me perspektiva të shkëlqyera. Ky plan do të bëhet objekt studimi i gjithë popullit. Partia dëshiron pjesëmarrjen sa më të gjerë në diskutime të thella nga ana e masave tona punonjëse që plani të dalë sa më i plotë dhe sa më real.

Me këtë rast dëshiroj t'u uroj nga zemra gjithë popullit të rrethit të Kukësit, klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies, ushtarëve të kufirit, grave trime dhe rinisë suaj suksese akoma më të mëdha në të ardhmen në punën për ndërtimin e socializmit dhe në luftën për mbrojtjen e fitoreve të arritura.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli trim e përparimtar i rrethit të Kukësit!

Lavdi Partisë heroike të Punës të Shqipërisë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 127 (6791), 29 maj 1970*

*Botohet, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 127 (6791), 29 maj 1970*

## MINATORËT DHE METALURGËT JANË PJESA MË E FORTË E KLASËS PUNËTORE

*Fjala në takimin me punëtorë e kuadro të Uzinës  
së Shkrirjes së Bakrit dhe të Minierës së Gjeggjanit  
të Kukësit*

28 maj 1970

*Në Uzinën e Shkrirjes së Bakrit shokut Enver Hoxha  
iu bë një pritje shumë e ngrohtë nga kolektivi i saj,  
si dhe nga ai i minierës. Udhëheqësin e Partisë e sho-  
qëruan në repartin e konverteve, ku u njoh me pro-  
ceset e punës dhe pa prodhimet e bakrit shqiptar. Pas  
kësaj, në klubin e kulturës të uzinës, punëtorët dëgjuan  
me vëmendje fjalën e shokut Enver Hoxha.*

Me rastin e vizitës në uzinën tuaj dëshiroj t'ju  
them nja dy fjalë. Do të qe më mirë që këtë takim  
ta bënim brenda në uzinë, ku të merrnin pjesë të gji-  
thë punëtorët, por kazanët atje bëjnë aq shumë zhur-  
më, sa do të ishte e zorshme të merreshim vesh me  
njëri-tjetrin.

Shokët e mi dhe unë jemi shumë të gëzuar që  
erdhëm këtu për t'ju takuar. Ne kemi dëgjuar vazhdi-  
misht për punën tuaj të vështirë, por të lavdërueshme.

Ajo që na gëzon më tepër është se kjo uzinë, dhe tok me të Miniera e Gjegjanit, ashtu sikurse shumë miniera, fabrika dhe uzina të ndërtuara në vendin tonë, janë ngritur nga njerëzit tanë të talentuar, në radhë të parë nga klasa jonë punëtore. Janë mendja, duart, dashuria e tyre e madhe për punën, për popullin dhe për Partinë që u japin atyre forca për të ndërtuar vepra të dobishme për ekonominë. Uzina ku punoni ju, është ndërtuar e tëra, nga kreu gjer në fund, nga ju, prandaj ne na gëzon aq shumë zemra kur dëgjojmë të flitet për ju.

Kjo uzinë aktualisht punon me një teknologji jo shumë të përparuar, prandaj, natyrisht, duhet të mendojmë që t'i bëjmë përmirësimet e nevojshme. Dhe këto përmirësimë prapë do t'ia bëni ju, pse jeni djem dhe vajza të zonjat. Me shkollat, me mësimet dhe me edukatën që ju ka dhënë e po ju jep vazhdimisht Partia, ju do të jeni çdo ditë e më mirë në gjendje jo vetëm të përmirësoni teknologjinë e kësaj uzine, por të ndërtoni edhe të tjera si kjo akoma më moderne. Do të vijë koha që edhe makineritë për uzina të kësaj natyre ne do t'i bëjmë të gjitha në vendin tonë. Më parë mendonim se kjo do të arrihej vonë, kurse në fazën e zhvillimit aktual të vendit nuk mund të mendojmë më kështu, se për këtë qëllim po punon me të gjitha forcat mbarë populli, në radhë të parë Partia, komunistët, klasa punëtore. Me këtë zell të madh për punën, me këtë edukatë dhe hov revolucionar që kanë njerëzit tanë, me këtë zhvillim të vrullshëm që vihet re kudo në vendin tonë, tani jemi në gjendje që parashikimet t'i realizojmë në periudha shumë më të shkur-

tra se më parë. Për këtë flasin provat e shumta dhe sukseset e pandërprera që i vërteton jeta çdo ditë.

Sikurse e theksova në fjalimin që mbajta sot në mëngjes në miting, ngritja e fabrikave, e uzinave dhe e minierave tona të reja, natyrisht, varet shumë nga ç'ka nën tokë. Përpara nëntoka jonë pothuajse nuk njihej fare. Edhe sot nuk ia njohim akoma të tëra të fshehtat e pasuritë e saj, por gjeologët tanë, që Partia i shtoftë (jo zoti, se ky kishte marrë më qafë gjyshërit e stërgjyshërit, nënat e baballarët tanë, prandaj i vumë drunë dhe brezin e ri e tërë njerëzit tanë i shpëtuan njëherë e mirë prej tij), kanë treguar zotësi të mëdha për zbulimin e mineraleve të dobishme. Me punën e tyre këmbëngulëse ata kanë vërtetuar se janë intelektualë patriotë, të edukuar me vijën e drejtë politike të Partisë. Kjo i ka ndihmuar të lidhen shumë më ngushtë me vendin, t'u qepen kodrave e maleve, ku, natyrisht, ka plot vështirësi. Shumë nga gjeologët tanë jetojnë nëpër çadra, megjithatë dhe pavarësisht nga vështirësitë e terrenit, të klimës etj., ata kanë punuar dhe kanë zbuluar vazhdimisht shumë minerale të çmueshme për ekonominë popullore, ndër të cilat bakër, hekur-nikel, hekur-silikat, nikel-silikat etj., që janë baza të rëndësishme për ngritjen e industrisë sonë të rëndë në të ardhmen. Më parë këto minerale nuk i kishim, vetëm i ëndërronim. Tani shumë prej tyre i dimë jo vetëm ku janë, por edhe sa janë dhe në të ardhmen do t'i dimë akoma më mirë madhësinë e gjerësinë e shtrirjes territoriale, si dhe sasinë e tyre.

Në pesëvjeçarin që vjen do të fillojmë të ndërtojmë uzinën tonë të parë të industrisë së rëndë. Varet

shumë nga përpjekjet tona të gjithanshme që ta ndërtojmë atë - sa më shpejt, sepse ajo do të nxjerrë nevojën për të ndërtuar uzina të tjera e puna do të shkojë kështu me radhë, zinxhir. Me përfundimin e kësaj vepre do të sigurohet shkrirja e qindra mijë tonë çeliku, që më vonë do të arrijnë edhe më shumë. Kur ta kemi shënuar këtë sukses brenda një perspektive të afërt, do të vijë koha që thashë, që ne të mund të prodhojmë edhe makineri në vendin tonë.

Ndërtimi i kësaj uzine kërkoi edhe ngritjen e fabrikave të përpunimit. Tani na duhet të ngremë fabrikën e pasurimit të bakrit. Mineralin që po përpunojmë tani, më pas do ta kalojmë në procese të tjera përpunimi, në fabrika të tjera. Kjo do të na japë mundësi që bakrin ta eksportojmë me një çmim më të lartë dhe, më vonë, duke e eksportuar të përpunuar, atë do ta shesim dhjetëfish më shumë. Nga kjo populli do të ketë fitime të mëdha. E shikoni, pra, se si, me zhvillimin e pandërprerë të vendit, ndërtimi i një vepre lind nevojën për ndërtimin e një dhe më shumë veprave të tjera të reja, të cilat sjellin rritjen e prodhimit e të të ardhurave të popullit tonë, fuqizimin e pandërprerë të ekonomisë sonë popullore.

Gjeologët që zbulojnë naftën, gazin dhe mineralet e çmueshme kanë një meritë të madhe përpara popullit. Tani ka ardhur koha që ata dhe specialistët e tjerë të bëjnë përpjekje që mineralet të përpunohen në vend, që asgjë të mos eksportohet jashtë shtetit e papërpunuar.

Kjo punë, të dashur shoqe dhe shokë punëtorë, do të ketë rëndësi të madhe për ndërtimin e plotë të so-



cializmit në vendin tonë. Rruga e zhvillimit të industrisë minerare në Shqipëri krijoi mundësi të ngrihej një industri e re që është çdo vit në rritje dhe, njëkohësisht me të, të krijohej edhe një klasë punëtore e fuqishme, e zgjuar dhe e zonja, të cilën Partia e edukoi dhe e kaliti vazhdimisht me mësimet e marksizëm-leninizmit, me një patriotizëm të lartë, e bëri të kuptojë drejt politikisht interesat e kolektivit, të mbarë popullit dhe të vendit tonë.

Ju punëtorët, në sajë të punës së pareshtur edukuese që bën Partia, interesin e kolektivit e vini në plan të parë, sepse e kuptoni qartë që brenda këtij interesi ruhet edhe interesi vetjak. Kjo është një fitore e madhe për Partinë dhe për popullin, pse pa ekzistencën e klasës punëtore, natyrisht, vendi ynë nuk mund të ecte përpara drejt socializmit me këto ritme të shpejta zhvillimi dhe me një siguri të madhe. Ju, pra, shokë dhe shoqe, minatorë e metalurgë, jeni bij të klasës punëtore, jeni pjesa më e fortë e kësaj klase, ju Partia ju konsideron si majën e shpatës së klasës punëtore. Këtë forcë punëtore të çeliktë, në radhët e së cilës bëni pjesë edhe ju, e kalitin, së pari, politika e drejtë e Partisë dhe ideologjia e saj, që ju futin në zemër e në shpirt dashurinë për punën, për popullin dhe për atdheun.

Ju, shokë minatorë e metalurgë, ju bëjnë të fortë fizikisht dhe shpirtërisht vështirësitë e punës. Për të përballuar detyrat e vështira që kryeni ju, njeriu duhet të jetë me një brumë të veçantë, të çeliktë, që Partia tashmë e ka përgatitur. Ju që punoni këtu, e dini se nuk keni lindur punëtorë, po jeni bij fshata-

rësh, bij kooperativistësh. Para se të vinit në minierë e në uzinë, natyrisht, ishit të përgatitur politikisht dhe të vendosur për të ecur në rrugën e Partisë, me të cilën jeni të lidhur si mishi me thoin; ishit për rrugën e kolektivizimit të bujqësisë në fshatrat ku keni lindur e jeni rritur. Por kur Partia ju bëri thirrje për të ardhur e për të punuar këtu, thirrjes së saj iu përgjigjët me një gatishmëri të madhe, megjithëse e dinit se ajri në minierë nuk do të ishte i pastër si në ara, nuk do të thithnit atë erë të këndshme të bimëve të fushave, të barit, të grurit apo të luleve të mollës, pse ajri i minierës kundërmon erë dheu, se këtu ka pluhura dhe gaze. Ju e dinit, gjithashtu, se në vend të freskisë së natyrës së qetë të fushave, do të punonit ku zien metali i lëngshëm në temperatura të larta. Pavarësisht nga këto kushte të vështira, ju nuk iu tutët punës, dëgjuat thirrjen e Partisë dhe thatë: «Atje do të shkojmë» dhe morët përsipër një punë të rëndë, por të lavdishme, për rezultatet e së cilës kanë aq shumë nevojë ekonomia jonë popullore, mbarë vendi. Këtu filloi edhe kalitja juaj si elementë të klasës punëtore.

Me një klasë punëtore të çeliktë si kjo jona, që qëndron në krye të masave punonjëse për ndërtimin e socializmit, Shqipëria do të shkojë në komunizëm, në atë shoqëri, ku s'do të ketë më ndarje të shoqërisë në klasa, ku, sikurse na mësojnë Marks, Engels, Lenini, Stalini dhe Partia jonë, s'do të ketë më nevojë as për parti, as për shtet. Derisa t'ia arrijë asaj kohe shoqëria jonë, natyrisht, duhet të derdhet akoma shumë djersë, do të duhet të derdhet edhe gjak, sepse

armiqtë na kanë halë në sy dhe duan të na shkatërronjë. Po nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit. Ata mund të ndezin edhe luftëra lokale ose të përgjithshme, por prapë ne do t'i mundim me siguri.

Për vendin tonë, ashtu si për të gjithë popujt e botës, shpëtimi qëndron tek ekzistenca e klasës punëtore dhe e partisë së saj, te rritja dhe te kalitja e pandërprerë revolucionare e kësaj klase me idealet e Partisë e të popullit dhe me mësimet e marksizëm-leninizmit. Ju që keni ardhur këtu nga fshati, keni hyrë tashmë në mengenenë e klasës punëtore, Partia ju ka kalitur dhe vazhdon t'ju kalitë çdo ditë, por kini parasysh kurdoherë se kalitja e njeriut nuk ka fund. Siç mund ta dini, inxhinierët, kur kalitin tani hekurin në uzinë, e kalojnë atë edhe në rontgen, për ta kontrolluar se mos ka të çara të padukshme, dhe me këtë provojnë nëse është bërë mirë shkrirja e tij etj. Po që se shkrirja nuk është bërë mirë, atëherë hekurin e kthejnë për ta ripunuar që të kalitet si duhet, ndryshe makineria që do të bëhet me të, topi, mitralozi ose raketa (se edhe raketa e të gjitha llojet e armëve duhet t'i ketë Shqipëria socialiste), që do të prodhohen, nuk do të dalin me cilësinë e dëshiruar.

Kështu kujdeset Partia edhe për kalitjen e njerëzve me cilësitë e moralit tonë socialist. Këtë punë bën ajo me punëtorët, me fshatarët, me intelektualët. Por çekani i Partisë për edukimin klasor revolucionar duhet të rrahë edhe mbi ju, punëtorët, ndërsa çekani juaj duhet të bjerë më shumë e më fort sidomos mbi ata që ruajnë mbeturina nga e kaluara, që të pastrohen vazhdimisht prej tyre, të ecin me çapin tuaj e të mos u

zihet fryma. Edhe fshatarësia, për shkak të natyrës së saj klasore, ka mbeturina të tilla. Kjo është e natyreshme, pse ajo ka qenë nën ndikimin e psikologjisë së pronës së vogël. Por fshatarësia patriotike e vendit tonë, pavarësisht nga disa mbeturina që ekzistojnë akoma në ndërgjegjen e saj, ka ndryshuar dhe është e vendosur të ecë përpara në rrugën që i tregon Partia. Në kushtet e ndërtimit socialist, fshatarësia jonë është sqaruar, ajo e ka kuptuar mirë ç'është Partia, ç'është klasa punëtore, ka kuptuar rëndësinë e madhe të aleancës së saj me këtë klasë, me të cilën është e lidhur si mishi me thoin, siç ka kuptuar dobinë shpëtimtare që ka për të kolektivizimi i bujqësisë.

Mbeturina të ideologjisë dhe të moralit të vjetër ekzistojnë, ku më shumë e ku më pak, jo vetëm te fshatarësia dhe tek intelektualët, por edhe te vetë klasa punëtore, domethënë te ju. Akoma nuk kemi arritur atë shkallë edukimi që kërkohet të ketë klasa punëtore. Ne do ta realizojmë medoemos qëllimin e lartë të Partisë që organizatat-bazë, komunistët e komunistet, në krye të klasës punëtore, të udhëheqin e të ndihmojnë me shembullin dhe me edukatën e tyre fshatarësinë kooperativiste, nëpunësit, mbarë inteligjencien popullore. Klasa jonë punëtore, me kontrollin e saj, me forcën e saj të bindjes dhe, kur duhet, edhe me grush-tin në tavolinë, do të bëhet farkëtuesja e vërtetë e shoqërisë sonë të ardhshme pa klasa.

Është e nevojshme ta kuptojnë të gjithë se organizata-bazë e Partisë duhet të jetë kurdoherë revolucionare. Për këtë arsye kërkohet të zhduken nga organizatat-bazë të Partisë format e vjetra të punës dhe

çdo gjë tjetër që pengon hovin e tyre revolucionar. Ato të jenë kurdoherë në sulm kundër rutinës, javashllëkut, mbeturinave borgjeze e mikroborgjeze në ndër-gjegjen e njerëzve, si dhe kundër fodullëkut, hatërit etj., etj. Kur një komunist e mban kokën përpjetë dhe hiqet sikur çaç është, atë kritikojeni fort. Në qoftë se për të bërë këtë ju pengon ndonjë «rregull», hidhëni poshtë një rregull të tillë, se ai na dëmton. Sikur t'i ngjasë gjë furrës së uzinës, çfarë do të bënit ju? Me siguri do të hidheshit në zjarr e në flakë për ta shuar zjarrin e për të shpëtuar nga dëmtimi pasurinë socialiste. Kështu duhet të veproni ju edhe po t'i ngjasë gjë organizatës së Partisë. Po të konstatoji, kudo që të jeni, ndonjë ngjarje të papëlqyer, ngrini fort zërin dhe në qoftë se ju pengon ndonjë «rregull» a «procedurë», prisheni atë. Klasa punëtore nuk duhet të rrijë pa thënë fjalën e saj. Ajo bën gjithçka, prandaj është faktori kryesor që duhet të diktojë vullnetin e vet kudo. Punëtorët, kur shohin se nuk zbatohet drejt vija e Partisë, të mos druhen të përplasnin grushtin në tavolinë, para cilitdo qoftë. Atij që gabon, punëtorët i thonë: «More vëlla, ne të duam shumë, bile, po të jesh në rrezik, edhe kokën japim për ty, por dashuria dhe miqësia jonë nuk janë të sëmura, ato janë të sigjerta e në rrugë partie. Kështu, kur shohim se puna që të është ngarkuar të kryesh nuk ecën mirë, gabimet t'i themi troç që të të shpëtojme, ne nuk dimë të të bëjmë lajka, prandaj ndiq rrugën e Partisë dhe ndreqe gabimin».

Në qoftë se ndonjë mundohet të frenojë vrullin revolucionar të klasës punëtore, kjo duhet ta këshillojë atë të heqë dorë ose ta neutralizojë dhe, po të jetë se

vazhdon në rrugën e tij dëmprurëse, t'i tregojë vendin.

Fshatarët, e sidomos intelektualët, i ruajnë më gjatë mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze, kurse ju punëtorët jo, sepse jeni më të kalitur. Të gjithë kanë luftuar për çlirimin e atdheut dhe punojnë tani për begatinë dhe për të rritur fuqinë mbrojtëse të tij, po, sidoqoftë, te furra ku derdhni djersë e kaliteni ju, nuk janë të tërë. Mësuesi bën vërtet një punë fisnike, po ai nuk thith pluhurat e uzinës, nuk ndeshet si ju me vështirësi të mëdha në punë. Me këtë dëshiroj të them se Partia kërkon nga të gjithë, edhe nga kooperativistët, edhe nga intelektualët, po në radhë të parë nga ju punëtorët, që organizata-bazë e Partisë të bëhet gjithnjë e më luftarake dhe normat e jetës e të veprimtarisë së saj të zbatohen pa pasur frikë nga kurrkush. Ata që nuk janë të sigurtë, mund ta pengojnë e ta gënjejnë për një kohë organizatën-bazë, po një gjendje e tillë nuk mund të vazhdojë gjatë. Aq më pak njerëzit e këqij është vështirë të gënjejnë e të gjejnë truall të favorshëm në organizatën-bazë të Partisë.

Për këtë qëllim organizata-bazë e Partisë duhet të luftojë që t'i kapë në kohë problemet dhe të metat, t'i zbulojë ato që në fillim, t'i vërë menjëherë gishtin sëmundjes për të shëruar plagën. Është pikërisht si me njeriun e sëmurë, që, kur mjekohet me kohë, shërohet shpejt dhe përfundimisht. Në qoftë se i sëmuri e nënvleftëson sëmundjen dhe shkon me mendimin e gabuar se është i shëndoshë, nuk kujdeset që të kontrollohet në kohën e duhur te mjeku, një mëngjes të mirë atij mund t'i konstatohet ndonjë sëmundje e rëndë që mjekohet me vështirësi. Kështu është çështja edhe me

punën e Partisë, me jetën e organizatës-bazë. Prandaj asnjë komunist të mos mendojë se është pa të meta në punë, se s'ka mbeturina etj., por vazhdimisht të mësojë në mënyrë revolucionare ideologjinë tonë, marksizëm-leninizmin, të punojë e të luftojë që të kalitet në kudhrën e Partisë dhe të veprimtarisë së përditshme revolucionare, pse vetëm kështu do të arrijmë të mënjanojmë shpejt gabimet në punë, dhe bashkë me veten do të kalitim edhe Partinë.

Klasa punëtore e ka për detyrë ta mësojë edhe ajo marksizëm-leninizmin jo si në shkollë, jo vetëm sa për të ditur diçka e për ta pasur si një stoli personale. Marksizëm-leninizmin, direktivat e Partisë punëtore duhet t'i mësojë me të njëjtin vullnet të çeliktë, ashtu sikurse punon në uzinë apo në fabrikë, të lexojë me etje dhe njëkohësisht të reflektojë mbi ato çka lexon, të gjykojë nëpërmjet studimit jo vetëm për punën në uzinën ose fabrikën ku punon, por edhe për problemet e familjes, të rrethit dhe të të gjithë Shqipërisë. Të bëjmë që çdo njeri, e në radhë të parë punëtore, të gjykojë kështu dhe të mos shkojë me mendimin se «Ka kush mendon për gjërat e mëdha». Një koncept i tillë i bën disa njerëz të shijnë dhe të korrin si të duan. Po të lejohen të veprojnë në këtë mënyrë, ata mund t'i hipin popullit kalakëç në qafë.

Një gjë e tillë mund të ngjasë në rast se humbet vigjilenca, ashtu siç ngjau në Bashkimin Sovjetik. Nuk i shkonte mendja njeriu se do të ndodhte ajo katastrofë e madhe në partinë e Leninit dhe të Stalinit, në atë parti që kishte bërë Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit që tronditi botën, që kishte vendosur diktatu-

rën e proletariatit në një të gjashtën e botës, nën udhëheqjen e së cilës u ngritën tërë ajo industri e madhe dhe bujqësi socialiste. Mirëpo tani e dimë të gjithë ku përfundoi Bashkimi Sovjetik. Kjo ndodhi se për një kohë, qysh para vdekjes së Stalinit, atje nuk ndiheshin më ajo frymë revolucionare dhe gjallëria e dikurshme në parti. Punën e partisë kishte filluar ta mbulonte rutina, mbledhjet bëheshin të mërzitshme e monotone, sa për të thënë që bëheshin, secili përpiquej të merrej vetëm me punët personale, me interesat e ngushtë të familjes, pa u preokupuar shumë për interesat e mëdha të mbarë shoqërisë, për punët e fabrikës, të uzinës, të kolkozit etj. Filloi të lulëzonte kështu koncepti i gabuar, sipas të cilit «Punët i dinë ata lart». «Centralnij Komitet znajet» thoshin njerëzit, domethënë çdo gjë e di Komiteti Qendror, udhëheqja e partisë. Pas vdekjes së Stalinit, udhëheqja e re që mori fuqinë në dorë, solli në krye të partisë dhe të shtetit sovjetik të gjitha plehrat e revizionizmit, dallkaukët, elementët anti-parti, megalomanët, njerëzit e qejfeve që luftojnë të rritin famën dhe pasurinë e tyre në kurriz të popullit. Ata, duke qenë të tillë, e degjeneruan akoma më shumë partinë, gjersa më në fund arritën të thoshin se tani ajo s'është më parti bolshevike, por «parti e të gjithë popullit», prandaj partia që ekziston tashmë atje nuk është parti e klasës punëtore. Revizionistëve, natyrisht, nuk u intereson ta pranojnë hapur këtë të vërtetë të hidhur, por «partinë e të gjithë popullit» ata e shpjegojnë me faktin se Bashkimi Sovjetik po shkon tani gjoja në komunizëm, me një fjalë, drejt zhdukjes së klasave. Kurse në të vërtetë atje po ngrihet klasa e



borgjezisë së re, klasa e burokratëve dhe e teknokratëve, e nëpunësve, e profesorëve, e mësuesve, e doktorëve dhe e inxhinierëve, të cilët shfrytëzojnë punën e klasës punëtore.

Për të justifikuar tradhtinë e tyre, revizionistët modernë kanë shpikur «teorinë», sipas së cilës, meqenëse kohët kanë ndryshuar, meqenëse shkenca tani ka marrë një hov të madh dhe zhvillimi i saj nuk njeh më kufi ndryshimesh në sistemet shoqërore, revolucioni tekniko-shkencor sjellka përparime të njëllajta si për socializmin, ashtu edhe për kapitalizmin. Kjo «teori» e kopjuar nga ideologët borgjezë do të thotë se, gjersa revolucioni tekniko-shkencor sjell përparimin, s'ka më nevojë për revolucion proletar. Pra, sipas kësaj «teorie», revolucioni tekniko-shkencor duhet të zëvendësojë revolucionin proletar me dhunë! Me këto «arsyetime» revizionistët dhe kapitalistët duan t'i thonë klasës punëtore se roli i saj tashmë paska mbaruar, pse këtë rol sot e kanë marrë inxhinierët, profesorët, njerëzit e mësuar. Këta janë tani, sipas tyre, në pararojë, sepse, gjersa këta udhëheqin revolucionin tekniko-shkencor, në socializëm do të shkohet pa revolucion, vetëm me reforma. Ja edhe një nga shtrembërimet e rënda që revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, i bëjnë marksizëm-leninizmit. Kjo i shtohet tradhtisë së tyre ndaj çështjes së madhe të socializmit dhe ndaj lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Teoritë që ata përhapin janë ato barëra të këqija që ushqen e kultivon kapitalizmi në ndërgjegjen e punonjësve për të zhdukur rolin udhëheqës të klasës punëtore në revolucion, të cilit ia ka frikën për vdekje, pse ky medoe-

mos do t'ua bëjë një ditë varrin si kapitalizmit ashtu edhe revizionizmit.

Roli i klasës punëtore në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit është vendimtar. Ajo është në gjendje të edukojë e të udhëheqë deri në fund masat e shtypura e të shfrytëzuara, derisa të zhduken krejtësisht klasat. Klasa punëtore ecën përpara e sigurt, e ushqyer me ideologjinë e partisë marksiste-leniniste, nën flamurin e kuq të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, kurse të gjitha klasat dhe shtresat e tjera të popullsisë duhet të ndjekin rrugën e saj, të jenë të bashkuara dhe në unitet të plotë me të.

Inxhinierët dhe teknikët tanë duhet të punojnë tok me klasën punëtore dhe të vihen nën drejtimin e saj. Rruga e Partisë sonë është e drejtë, marksiste-leniniste. Në kushtet aktuale, Partia jonë vlerëson lart rolin e rëndësishëm që luajnë inxhinierët e teknikët, por dituria dhe eksperiencia e tyre, ashtu si gjer tani, duhet të vihen në shërbim të klasës, në shërbim të popullit. Partia i mëson inxhinierët dhe teknikët tanë që ta ndihmojnë klasën punëtore, se ata janë ndihmësit dhe jo udhëheqësit e saj. Klasa punëtore është udhëheqësja edhe e inxhinierëve dhe e teknikëve, prandaj këtyre kurrë të mos u rritet mendja për atë dituri që kanë marrë, sado e madhe që të jetë, pse dituria e klasës është shumë më e madhe. Kjo është një e vërtetë e pamohueshme. Mund të jetë shumë i zoti një inxhinier, por ai do të mbetet me gisht në gojë, në qoftë se projekti i tij nuk do të ishte i zbatueshëm nga punëtorët, ky projekt s'do të vlente dhe do të hidhej në Drin. Në të kundërtën, kur projektin e merr në dorë

klasa punëtore, ajo e vë në zbatim, i jep jetë. Klasa punëtore në asnjë mënyrë nuk e zbaton atë automati-kisht, por në mënyrë krijuese, sepse edhe ajo ka dituri dhe eksperiencë.

Një poet i madh, kur i këndon klasës punëtore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, thotë se janë punëtorët ata që kanë ndërtuar atje gjithë ato kombinatë viganë të çelikut, të naftës, të industrisë së ndërtimit të makinave, grataçielat e Nju-Jorkut dhe çdo vepër tjetër të madhe, kurse për vete ata s'kanë asgjë, për arsye se ato që kanë ndërtuar me gjakun dhe me djersën e tyre, janë prona të gjakpirësve kapitalistë. Poeti me këto fjalë në asnjë mënyrë nuk mendon të hedhë poshtë rolin e inxhinierëve dhe të teknikëve, por ai vlerëson lart dhe realisht rolin vendimtar të punëtorëve.

Inxhinierët dhe teknikët tanë janë njerëz të Partisë dhe të popullit, të lidhur ngushtë me klasën punëtore, të cilën e duan me shpirt, pse Partia i ka mësuar të punojnë dhe të kaliten tok me klasën. Unë jam i bindur që ashtu si punëtorët, edhe inxhinierët tanë janë gati të hidhen në zjarr për punën e përbashkët që bëjnë. Bile, në vendin tonë, nëpër ndërmarrje është vështirë të dallosh cili është inxhinieri dhe cili punëtori, pse të dyja palët punojnë krahas në frontin e prodhimit. Rezultatet që ka arritur Partia në edukimin e njerëzve janë jashtëzakonisht të mëdha; ato në vendet kapitaliste e revizioniste nuk mund të arrihen kurrësesi. Inxhinieri në këto vende mendon vetëm për interesin e vet personal, ai arrin të ketë edhe një ose dy automobila. Edhe në Bashkimin Sovjetik inxhinie-

rët dhe deri kryetarët e kolkozeve kanë vila e automobila personalë, po populli veç pret në radhët pa mbarim për të marrë një kastravec në dyqan ose për të blerë një kalem në magazinë. Kush ka qenë atëherë në Bashkimin Sovjetik, i di mirë këto gjëra. Për popullin atje mungojnë prej kohësh shumë sende të domosdoshme, kurse për një grusht njerëzish të privilegjuar ka gjithçka. Një situatë e tillë ka ardhur për arsye të degjenerimit politik, ideologjik e moral në të cilin e kanë katandisur Bashkimin Sovjetik tradhtarët revizionistë. Ata i kanë vënë detyrë vetes të thithin djersën e punëtorëve dhe të kolkozianëve sovjetikë, të forcojnë kështu pozitat e tyre të privilegjuara.

Krejt ndryshe është situata te ne. Partia i mëson inxhinierët, teknikët, mësuesit, profesorët, gjithë inteligjencien të punojnë me klasën punëtore dhe me fshatarësinë, të shkrihen së bashku me to. Kur klasa punëtore shikon që drejtori, kryeinxhinieri, sekretari i organizatës-bazë të Partisë apo çdo drejtues tjetër nuk i kryejnë mirë detyrat, nuk lidhen ngushtë me masën, në fillim u tërheq vëmendjen, i këshillon të mos mbyllen shumë në zyra, por të punojnë e të jetojnë së bashku me punëtorët. Në qoftë se atyre u rritet mendja dhe nuk përfillin këshillat dhe porositë e punëtorëve, atëherë këta «u lajnë kokën» në organizatën-bazë të Partisë. Dhe kështu duhet të veprohet patjetër me cilindo, pa përjashtim. Dhe që të bëhet kështu, shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra, duhet kuptuar mirë teoria e Partisë.

Teoria e Partisë nuk është e vështirë për t'u kuptuar. Ajo, natyrisht, është një teori filozofike, por është

të filozofia e mendimit punëtor. Prandaj shokët që janë pak më të ngritur, edhe ata që kanë mbaruar shkolla, duhet t'ju shpjegojnë juve qartë e konkretisht çështjet teorike. Teoria jonë përfaqëson gjithë eksperiencën e klasës, eksperiencën tuaj. Juve ju duket sikur s'keni dhënë gjë me eksperiencën tuaj në çështjet teorike, por në të vërtetë nuk është kështu, për arsye se teoria jonë është një përgjithësim i praktikës dhe i eksperiencës suaj. Mësuesit tanë të mëdhenj kanë përgjithësuar shkencërisht eksperiencën dhe forcën e mendimit të klasës punëtoare. Për këtë arsye, gjersa teoria jonë është pjellë e mendjes dhe e forcës suaj, përse të jetë e pakuptueshme nga ju? Me përpjekje mësohet çdo gjë. Shokët tuaj kanë mësuar të zotërojnë shumë procese të ndërlikuara në punë e në prodhim; ata, me përpjekjet e tyre të palodhura, i kanë zhvilluar shumë dituritë e tyre, prandaj, ashtu si të gjitha fushat e tjera të shkencës e të diturisë, edhe teoria jonë marksiste-leniniste nuk mund të jetë dhe nuk është aspak e pakuptueshme për punëtorët dhe për masat e tjera punonjëse.

Çështja e dytë që ju, shokë punëtorë kërkohet ta kuptoni mirë, është që e gjithë veprimtaria e Partisë dhe mënyra revolucionare e punës dhe e jetës suaj të mos mbeten brenda katër mureve të uzinës ose brenda kuadrit të organizatës-bazë, por të rrezatohen përnjëherësh, në radhë të parë në kooperativat bujqësore ku keni familjet, si dhe në të gjithë rrethin. Pjesëtarët e familjeve tuaja, nëna ose baba, burri, gruaja, vëllai ose motra, fëmijët tuaj, që kanë këtu në uzinë ose në minierë njeriun e tyre, kur shkoni në kooperativë, du-

het të shikojnë te ju njerëz me mendime të dëlira e të qarta, me zemër të pastër si qelibari, që luftoni të zhdukni errësirën në radhë të parë në familje dhe prej këndeje në fshat. Nëpër familje, nëpër kooperativa e kudo që punoni dhe jetoni pas pune, ju duhet të jeni në pararojë për të luftuar të gjitha mbeturinat që ekzistojnë.

Partia na mëson t'i luftojmë çdo ditë mbeturinat e dëmshme. Por ato nuk zhduken aq kollaj, për arsye se janë bërë si shprehi e zakone në jetën e njerëzve, saqë shumë herë edhe padashur njeriu mund të zhytet në to. Ato mbështeten në forcën e zakoneve të këqija që pengojnë përparimin.

Për t'i thyer mbeturinat duhet të luftojnë, në radhë të parë, komunistët dhe klasa punëtore. Roli juaj këtu në Kukës, të dashur shokë dhe shoqe të Uzinës së Shkrirjes së Bakrit dhe të Minierës së Gjegjanit, është i madh. Prandaj mos mendoni dhe mos u preokuponi vetëm për punët që duhet të kryeni brenda çatisë së qendrës së punës, por mendoni edhe për problemet e rrethit dhe dijeni se kështu keni menduar dhe i keni shërbyer gjithë Shqipërisë.

Ju duhet të luftoni në mënyrë të organizuar dhe sistematike në radhë të parë, zakonet prapanike që shfaqen dhe ruhen nëpër familje. Kjo luftë, siç ka theksuar kurdoherë Partia, duhet bërë me mençuri, me durim dhe kurdoherë me gjakftohtësi. Punëtorin e dallojnë nga të tjerët gjakftohtësia dhe papërkulshmëria. Lufta kundër mbeturinave të moralit të huaj nuk bëhet duke e sharë tjetrin, por duke e vënë bartësin e mbeturinave në mengenenë e klasës, duke e edukuar

atë javash-javash, me durim e gjakftohtësi. Punëtori është i matur, se ai është i ndërgjegjshëm për epërsinë e fjalës e të mendimit të tij dhe e di se durimi, gjakftohtësia dhe arsyetimi i shëndoshë e bindin tjetrin. Punëtorët janë të thjeshtë, ata e ndiejnë veten të fortë në ideologjinë e në qëllimin e tyre, janë zemërbardhë dhe vlerësojnë drejt sa peshon një faj e si duhet ndrequr e korrigjuar fajtori, kurse disa intelektualë, ndryshe nga punëtorët, shesin mend, duke u përpjekur të vënë në dukje se, meqë kanë mësuar në shkollë, dinë çdo gjë, kurse të tjerët s'kanë ç'të thonë përpara tyre. Kur punëtorët me të drejtë u kundërshtojnë, ata e humbasin durimin dhe shprehen me nervozitet se këta njerëz s'marrin vesh, prandaj, sipas tyre, s'duhet humbur koha me ta, ata, bile, marrin edhe inat me njerëzit. Këta lloj intelektualësh mbajnë qëndrime të tilla se e konsiderojnë veten më eprorë nga të tjerët, janë, pra, ca fodullë e mendjemëdhenj. Pikërisht klasa punëtore duhet të punojë që t'ua zhdukë këto sëmundje.

Dua të theksoj edhe një herë se fjala juaj nëpër familje e nëpër fshatra për këto probleme, dhe në mënyrë të veçantë për çështjen e gruas, luan një rol të madh e vendimtar. Asnjë komunist, asnjë njeri përparimtar nuk e ka të errët çështjen e gruas, por ka disa që ngurrojnë të flasin e të hidhen me vendosmëri në mbrojtje të çështjes së saj të drejtë, pse nuk e gjejnë atë forcë për të kundërshtuar e për të thyer opinionin e prapanikëve, forcën e zakoneve në fshat, në rreth e kudo. Këta, në vend që të hidhen në sulm kundër opinionit prapanik, kundër zakoneve të këqija etj.,

preokupohen më shumë çfarë do të thotë fshati, qysh do të bëjnë për të futur të renë, për arsye se kemi këtë ose atë zakon që na pengon etj. Pikërisht këtu duhet të qëndrojnë trimërisht, si kurdoherë në ballë punëtorët, se ata janë krahu i pathyeshëm i Partisë. Ata duhet të dinë si t'u marrin anën e të bindin edhe plakun edhe plakën, edhe burrin 45 vjeç, edhe gruan 45-vjeçare, që të mos e pengojnë cucën e tyre për të vajtur, për shembull, në shkollë, në aksion apo të bëhet brigadiere etj., etj. Në qoftë se ndonjë shpif fjalë poshtëruese për një cucë ose grua që aktivizohet në punët jashtë familjes, të parët që duhet të ngrihen në këmbë për t'i mbrojtur ato duhet të jenë komunistët dhe njerëzit e klasës punëtore.

Në jetë ngjasin edhe gjëra të papëlqyera, mund të ndodhin aksidente në fushën e marrëdhënieve të miqësisë, të dashurisë, të familjes dhe të shoqërisë. Sigurisht, ngjarje të tilla nuk ka si përjashtohen krejtësisht, sado që çdo vit ato do të ndodhin gjithnjë e më rrallë. Mund të qëllojë, fjala vjen, që edhe një vajzë e martuar me dashuri, kundër vullnetit të prindërve të vet, nesër të ndahet nga burri që ajo pati zgjedhur dikur vetë, për arsye të rrethanave të ndryshme që krijohen ose për faj të ndonjërit prej tyre. Në këto raste nuk mund të mendohet se prindërit që e penguan vajzën të martohej me dashuri paskan pasur të drejtë! Në asnjë mënyrë kjo ngjarje e veçantë dhe e rastit nuk mund të përgjithësohet.

Në fushën e emancipimit të gruas, shokë dhe shoqe, janë bërë përparime të mëdha në vendin tonë. Sa motra nga Jugu kanë ardhur këtu në Veri dhe sa motra



të tjera nga Veriu kanë vajtur në Jug, janë njohur, janë miqësuar, kanë mësuar nga njëra-tjetra. Një gjë e tillë përpara as që mund të mendohej. Po të shikojmë statistikat për pjesëmarrjen e gruas në prodhim, në shëndetësi, në tregti e në shumë sektorë të tjerë, del se, ashtu si në tërë Shqipërinë, edhe këtu në Kukës shifrat janë të mëdha dhe gjithnjë në rritje. Pjesëmarrja e vajzave në shkolla është në një nivel shumë të kënaqshëm. Ne tash kemi kaluar nga faza e prapambetjes shekullore të femrës shqiptare. Megjithatë, ka akoma mbeturina të shumta që ngjallen e ngrenë kokën për të vepruar përsëri me forcë, në rast se kundër tyre nuk veprojnë me forcë puna e Partisë, ideologjia e klasës punëtore. Ne kemi një situatë shumë të përshtatshme për t'i luftuar dhe për t'i zhdukur mbeturinat e botës së vjetër. Por ato nuk mund të zhduken përnjëherësh, pse shfaqen përsëri e herë pas here jo vetëm te pleqtë, por edhe te komunistët, prandaj lufta kundër mbeturinave, sidomos nga punëtorët, nuk duhet të pushojë asnjëherë.

Ka momente që babës i hipën në kokë për ndonjë veprim apo qëndrim të vajzës së vet që aty për aty e revoltton. Më vonë, kur ai e gjykon qëndrimin e tij me gjakftohtësi, ashtu sikurse duhet të gjykojë komunisti, i thotë vetes: «Ku po më shpie mushka, përse e humba kot durimin me vajzën, e cila ka të drejtë në veprimin e vet» dhe i vjen keq për qëndrimin e nxituar që mbajti ndaj saj. Po përse u nxeh në këtë rast babai? Sepse nuk është thelluar mirë në ideologjinë e Partisë për marrëdhëniet e drejta që duhet të ekzistojnë në familje, sidomos lidhur me ato midis prindërve

e fëmijëve. Aq më tepër ne nuk duhet ta gjykojmë për të keq një fshatar, kur ai nuk sillet drejt ndaj gruas apo vajzës së vet, sipas normave të moralit tonë. Me një njeri të tillë të mos e humbasim durimin duke i bërtitur se qenka një prapanik, por të përpiqemi ta edukojmë. Të kemi mirë parasysh se nuk mund të jenë të përparuar të gjithë njerëzit në nivelin e komunistëve, të cilët edukohen vazhdimisht në organizatat-bazë të Partisë e, megjithatë, edhe midis tyre, ku më shumë e ku më pak, vërehen nivele të ndryshme zhvillimi dhe gjithfarë mbeturinash.

Kam për të thënë edhe një gjë tjetër. Klasa punëtore fiton e do të fitojë kurdoherë pozita të reja në luftën e vet kundër kapitalizmit vetëm në rast se do t'i mbajë radhët të shtrënguara si në bllok. Në kushte të tilla fuqisë së saj të bashkuar s'ka ç'i bën forca e kapitalizmit, e topave dhe e raketave të tij. Por ajo sot në shumicën e vendeve nuk është e bashkuar, për arsye se i mungon udhëheqja. Megjithatë, edhe pse lëvizja punëtore është e minuar nga brenda prej revisionistëve, socialdemokratëve, socialistëve, demokristianëve, fashistëve e një mijë e një reaksionarëve të tjerë, grevat nuk pushojnë në vendet kapitaliste, si në Itali, në Francë e gjetkë. Dhe kur bëhen greva në një qytet ose në shkallë kombëtare, në një vend kapitalist, gjithë jeta atje paralizohet, asgjë s'pipëtin, shtëpitë dhe rrugët qelben nga papastërtia, se s'ka kush heq plehrat, s'ka ujë, se s'punojnë ujësjellësit, s'ka trena dhe autobusë, se s'punojnë shoferët, s'ka dyqane, s'ka fabrika, s'ka elektrik. Merret me mend çfarë mund të bënte klasa punëtore me fuqinë e saj të pamposhtur

kolosale, po të qe e bashkuar, kompakte, e organizuar. Mjerisht, ajo s'ka akoma një udhëheqje me të vërtetë të klasës që ta prijë dhe ta organizojë. Vrullin dhe disiplinën e hekurt të klasës punëtore udhëheqjet e saj tradhtarë i manipulojnë në rrugë të shtrembër. Te ne klasa punëtore, që udhëhiqet nga Partia, nuk pranon çrregullime, vonesa, mungesë disipline dhe ndërgjegjeje në punë. Disiplina dhe ndërgjegjja në punë te ne, natyrisht, nuk janë akoma të përsosura në atë nivel që dëshiron Partia, sepse edhe në gjirin e klasës nuk janë të tërë njëlloj të disiplinuar e të ndërgjegjshëm, por ne duhet të luftojmë që t'i kalitim vazhdimisht këto cilësi të klasës, për t'i pasur çdo ditë e më shumë në një nivel sa më të lartë, pse kështu do t'i shërbehet më shumë çështjes së socializmit e të revolucionit.

Këtë disiplinë dhe ndërgjegjeje në punë, që Partia jonë duhet t'i forcojë akoma më shumë te punëtorët, njëkohësisht t'i rrënjosim edhe te kooperativistët. Organizimin sa më të përsosur në punë e në prodhim, që juve ju kërkohet dhe që luftoni ta zbatoni këtu në uzinë dhe në minierë, punoni që ta futni edhe në shpirtin e kooperativistëve, sepse ata janë gjaku ynë. Në fshat rrojnë njerëzit tanë të dashur. Qëllimi i secilit nga ju është që familja e tij në fshat të lulëzojë, qëllimi i çdo komunisti është që e gjithë kooperativa të lulëzojë, qëllimi i Partisë është që gjithë fshati dhe qyteti, mbarë vendi ynë të lulëzojë. Nuk mund të zhvillohet bujqësia jonë, në rast se nuk mendohet e nuk punohet që këto forma organizimi të punës dhe të teknikës që kemi sot, të përmirësohen vazhdimisht. Për këtë një-

rol të madh do të luani ju, shokë të klasës punëtore, e, në radhë të parë, komunistët.

Më kanë informuar se këtu te ju ka disa probleme serioze që nuk janë zgjidhur në kohë. Organizatat e Partisë të luftojnë që gjëra të tilla të mos ndodhin më. Edhe për ndërtimin e disa shtëpive për familjet e punëtorëve, një pjesë e të cilave tani ka përfunduar, ka pasur zvarritje. Megjithatë, për këtë problem nuk duhet fjetur mendja, pse ka akoma te ju rreth 300 punëtorë që jetojnë larg familjeve dhe gratë e fëmijët i shohin, si me thënë, një herë në hënë. Ka, pra, disa probleme, për zgjidhjen e të cilave duhet bërë më mirë studimi i tyre në kohë, të vihen shokët më mirë në lëvizje, se po të lihen gjërat në harresë, punët nuk bëhen. Natyrisht, në disa drejtime ne kemi edhe vështirësi që duhen kuptuar, po vështirësitë tona janë të rritjes, për arsye se ne po i shtojmë vazhdimisht detyrat për të përballuar gjithnjë e më mirë kërkesat dhe nevojat e mëdha të industrisë, të bujqësisë etj. Megjithatë, duhet të luftojmë më mirë për kapërcimin e vështirësive. Dhe pse Partia ka vepruar kështu, prandaj në çdo drejtim kemi dalë kurdoherë faqebardhë, planin po e realizojmë me sukses dhe në kongresin e ardhshëm të Partisë do të shkojmë me plan të realizuar.

Që të mund të sigurojmë realizimin e planit edhe në bujqësi, gjë që është ca më e zorshme, sivjet duhet të bëjmë përpjekje shumë më të mëdha, kurse për sa u përket gjithë sektorëve të tjerë, sidomos në industri, planin pesëvjeçar do ta tejkalojmë. Ky është një sukses i madh për të gjithë popullin dhe Partinë. Shumë gjëra

të tjera mund të realizoheshin akoma, po, siç e thashë, ka edhe sorollatje, ka rutinë, na pengon, sidomos, burokratizmi, prandaj të luftojmë me këmbëngulje kundër tyre e të mos e flemë kurrë mendjen se punët na shkojnë kurdoherë me tempin e duhur në të gjitha drejtimet. Veçse një gjë është e vërtetë, që Partia është në rrugë të drejtë, prandaj edhe vërtetohen gjithë këto suksese të mëdha që kemi arritur.

U kënaqa shumë te ju në Kukës, megjithëse nuk i kam mbaruar akoma vizitat. Të them të vërtetën, s'më iket prej këndeje. Nesër do të kemi rastin të takohemi me vëllezërit tanë kooperativistë të zonës së Hasit.

Në emër të Byrosë Politike dhe të Qeverisë ju uroj të gjithëve suksese gjithnjë e më të mëdha në punë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## NJERËZIT KALITEN NË PUNË E NË LUFTE

*Fjala në darkën e shtruar me rastin e përfundimit  
të vizitave në rrethin e Kukësit*

28 maj 1970

I dashur shoku sekretar i parë i komitetit të Partisë,

I dashur shoku kryetar i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor,

Të dashur shokë dhe shoqe të rrethit të Kukësit,

Së bashku me shokët që kemi ardhur këto ditë, jemi shumë të gëzuar që ndodhemi midis popullit të mrekullueshëm të Kukësit, nga i cili kemi marrë forca të reja. Këtu, mes këtyre bjeshkëve e pllajave, ka rrahur gjithmonë zemra e çeliktë e popullit për lirinë e Shqipërisë, për një jetë të lumtur e të lirë, për një shtet demokratik e sovran. Gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, anekënd Shqipërisë dhe matanë kufijve, ku jetojnë vëilezërit tanë, si ata të Kosovës e të tjerë, kanë luftuar e kanë derdhur gjak për të shpëtuar nga robëria e të huajve, për të jetuar në unitet të plotë, ashtu siç e meriton një komb si yni, që në shekuj ka

pësuar vërtet fatkeqësi të mëdha, por ato kurrë nuk e kanë mposhtur, përkundrazi, e kanë bërë gjithnjë më të fortë e më të çeliktë.

Me gjithë luftën e madhe me pushkë dhe me përnë, në sajë të së cilës arriti në ditën historike të shpalljes së pavarësisë kombëtare, populli shqiptar nuk mundi t'i realizonte dot plotësisht dëshirat dhe aspiratat e tij të ligjshme shekullore, për arsye se armiqtë imperialistë penguan bashkimin e gjithë tokës amtare dhe të tërë bashkatdhetarëve në një shtet të vetëm. Por gjaku i derdhur në shekuj për liri e për pavarësi bëri që vullneti i popullit të mos mposhtej as nga ushtritë e forcave ndërluftuese që e kishin kthyer atdheun tonë në fushë lufte, siç ishin hordhitë e Antantës, të Italisë, të Anglisë, të Amerikës e të Francës, të Greqisë e të Serbisë etj., si dhe ato të Austro-Hungarisë dhe të aleatëve të saj. Në mbarim të Luftës së Parë Botërore, megjithëse i varfër, pa përkrahje dhe i shkatërruar ekonomikisht nga lufta, populli ynë i dha një mësim të mirë imperializmit italian që donte të gjymtonte më tej tërësinë tokësore të atdheut. Ngjarjet historike të vitit 1920 provuan edhe një herë vendosmërinë e pa-tundur të popullit tonë për të jetuar i lirë dhe i pavarur.

Por për Shqipërinë erdhën përsëri kohë të vështira, pse populli ynë prapë filloi të shtypej e të merrej nëpër këmbë nga pasanikët vendës, agallarët, feudallët, bajraktarët, nga feja etj., të lidhur ngushtë me të huajt e të shitur tek ata. Megjithatë, populli ynë nuk u nënshtrua, rezistenca e tij për liri e për demokraci kurrë nuk u shua as nën sundimin e egër të satrapit

Ahmet Zogu e të këlyshëve të tij. Te masat e popullit punonjës, te punëtorët, te malësorët, te fshatarët, te të rinjtë e të rejtat, te djemtë e vajzat e shkollave, te mësuesit e profesorët ndihej e madhe urrejtja ndaj gjithë atyre që shtypnin popullin dhe shitnin te të huajt interesat e atdheut. Lëvizja popullore për liri e për demokraci, për tokë dhe për punë ecte përpara. Sado që ndër beteja binin trima të dëgjuar, si Bajram Curri, në rrugët e qyteteve të Evropës rropateshin patriotë, si Luigj Gurakuqi, nëpër burgje vriteshin e torturoheshin të rinj heroikë, si Qemal Stafa me shokë, revolucionin në Shqipëri nuk ndalej.

Këtë revolucion e udhëhiqnin idetë e mëdha të çlirimit, të shpëtimit përgjithmonë të popullit nga mjerimi e nga varfëria, e udhëhiqte eksperiencia e madhe e së kaluarës me disfatat dhe me fitoret e përkohshme, që i kishin kalitur shqiptarët brez pas brezi. Mësuan njerëzit tanë më të mirë nga eksperiencia e popullit, nga klasa punëtore dhe nga vuajtjet e saj; mësuan edhe nga eksperiencia e popujve të tjerë, nga lufta e proletariatit, e klasës punëtore ndërkombëtare. Fshatarësia jonë punonjëse patriote mësoi nga kryengritjet që kanë bërë të parët tanë kundër pushtesve dhe feudalëve; ajo mësoi e fitoi një eksperiencë të madhe edhe nga kryengritjet fshatare të popujve të tjerë.

Gjithë eksperiencia e madhe e njerëzimit është ngritur në një teori të ndritshme. Për të janë shkruar libra të tërë nga mendimtarë të mëdhenj, siç ishin Karl Marksi dhe shoku i tij i ngushtë, Frederik Engelsi, që i hapën sytë botës dhe i treguan ç'ishte kapitalizmi dhe si e shfrytëzonte ky aq egërsisht njeriun. Marksi



dhe Engelsi zbuluan të parët se si kapitalistët shfrytëzojnë masat e punëtorëve dhe demaskuan të gjithë ata që thoshin se pasurinë e kanë vënë «me djersën e ballit». E ç'djersë balli kanë derdhur kapitalistët për të realizuar fitimet e tyre? E kujt ishte kjo djersë që pretendonin ata bashkë me bejlerët, me agallarët e me fajdexhinjtë për pasuritë që kishin vënë? Karl Marksi e Frederik Engelsi, më parë, dhe pas tyre Lenini e, më vonë, Stalini ua bënë të qartë popujve se kjo ishte djersa e punëtorëve dhe e fshatarëve punonjës; treguan se kapitalizmi i detyron ata të punojnë si skllëvër, që me djersën e tyre të vërë kapitale të mëdha, t'i shumëzojë ato e të pasurohet çdo ditë e më shumë. Por, i shtyrë nga lakmia për fitime, me vënien e pasurive kolosale, me ndërtimin e fabrikave e të uzinave të shumta, kapitalizmi detyrohet të grumbullojë në të punëtorët që do t'ia bëjnë varrin. Milionat e punëtorëve, që kapitalizmi i shfrytëzon gjer në palcë, lidhen si vëllezër me njëri-tjetrin, mendojnë, revoltohen, ngrihen në demonstrata e në greva, rrokin edhe armët, pse s'kanë ç'humbasin veçse zinxhirët, për të përmbysur atë shoqëri të poshtër që u pi gjakun. Karl Marksi, me gjenialitetin e tij, luftërat e mëdha të klasës punëtore e të fshatarësisë, të zhvilluara para dhe gjatë kohës së tij kundër feudalizmit dhe kapitalizmit, i ka studiuar me imtësi, i ka sintetizuar dhe ka nxjerrë mësim.

Edhe populli ynë për qindra e qindra vjet me radhë ka luftuar kundër shfrytëzuesve. Natyrisht, ai nuk i dinte gjithë ato gjëra që tregon Marksi në librat që ka shkruar, kurse tash ne i dimë, se na i ka mësuar

Partia. Por populli shqiptar dinte mirë një gjë, që djer-sa që derdhte në punë i vente kot, pse me të maheshin pasanikët, feudalët, bajraktarët, tregtarët dhe të huajt, prandaj i kishte ardhur shpirti në majë të hundës. Fshatarët tanë luftonin, hidheshin në kryengritje të armatosura, që përhapeshin në të katër anët e Shqipërisë, kundër pushtuesve turq, grekë, serbë etj. Disa njerëz të mësuar nuk i kuptonin mirë këto kryengritje, i cilësonin si aksione të rastit, por, më vonë, u pa qartë nga të gjithë se ato nuk qenë të rastit. Do të duhej të dilnin nga gjiri i popullit njerëz të shquar të Rilindjes, si vëllezërit Frashëri, Vaso Pasha e të tjerë, që këto kryengritje të merrnin një rrugë me të vërtetë të organizuar. Kryengritjet e popullit shqiptar, pra, nuk kanë qenë të rastit, ato kanë pasur një bazë patriotike të thellë, kanë pasur, gjithashtu, edhe bazën e tyre ekonomike.

Kryengritjet, revolucionet, na mëson Lenini, kanë bazën e tyre ekonomike, ato synojnë përmbysjen e rendit ekonomik në fuqi, përmbysjen e kapitalistëve e të çifligarëve. Për këtë qëllim ngriheshin fshatarët tanë nga një krahinë në një tjetër, në veri e në jug të Shqipërisë, dhe kërkonin zhdukjen e xhelepeve, të tagrambledhësve e të xhandarëve, duke vrrarë e duke gjakosur herë pas here ata që dërgonte Turqia e sulltanëve për t'u thithur edhe pikën e fundit të gjakut. Mos vallë të gjitha këto ishin gjëra të rastit? Jo, motra dhe vëllezër, kjo përbënte luftën e popullit në të katër anët e Shqipërisë për mbrojtjen e interesave të vet ekonomike; ishte lufta për të mbrojtur tokën, për të mbrojtur atdheun nga të huajt dhe nga ata tradhtarë

shqiptarë që ishin vënë në shërbim të tyre dhe që pasuroheshin në kurriz të masave punonjëse.

Në krye të shumë prej këtyre kryengritjeve popullore ka pasur edhe njerëz të shtresave të larta. Kjo është e vërtetë, por ata ose kanë qenë elementë përparimtarë, dhe si të tillë duhen vlerësuar në ato situata, ose kanë qenë njerëz që hidheshin me popullin për të ruajtur thjesht interesat e tyre kundër grupeve të tjera që mbështetnin regjimin e pushtimit turk dhe që kishin përkrahjen e tij. Por të gjitha këto luftëra e kryengritje nuk u kurorëzuan me sukses për popullin.

Për të fituar një herë e përgjithmonë, shokë dhe shoqe, u desh të formohej Partia jonë heroike, e bazuar në mësimet e Marksit e të Leninit, e përbërë nga djemtë dhe vajzat tuaja heroike, që nuk kursyen as jetën për të organizuar dhe për të përgatitur atë revolucion që do ta bënte t'ia arrinte qëllimit të madh për të cilin populli ynë kishte luftuar në shekuj. Ne komunistët ishim pak në numër në fillim, por besimin në fitore e kishim të pakufishëm, pse ishim të bindur se do të vinte dita që populli ta kuptonte qëllimin e lartë të Partisë, që përfaqësonte dëshirat e tij të mëdha. Kështu u arrit në organizimin e Luftës Nacionalçlirimtare, në përmbysjen e pushtetit të feudo-borgjezisë, në vendosjen e pushtetit popullor dhe në fitoret e shumanshme që gëzojmë sot. Rezultatet e këtyre fitoreve tani i shohim dhe i ndiejmë që të gjithë.

Fitorja kryesore e popullit tonë, në radhë të parë, është marrja e pushtetit. Ardhja e popullit në fuqi ishte qëllimi kryesor i Partisë, sepse pushteti është një çështje bazë, na mëson Lenini. Pushtetin mund ta kenë

në dorë ose borgjezia, ose klasa punëtore. Kur atë e kanë në dorë kapitalistët, populli rron si skllav, në qoftë se e merr klasa punëtore, atëherë mbarë populli çlirohet. Marrja e pushtetit në vendin tonë u siguroi me luftë dhe kurdoherë në çdo vend ai do të merret vetëm me luftë. Ata që thonë të kundërtën, gënjejnë. Revizionistët sovjetikë, të cilët kanë tradhtuar mësimet e Leninit e të Stalinit, po predikojnë se populli dhe komunistët mund ta marrin pushtetin edhe pa derdhur gjak. Kjo as ka ngjarë dhe as do të ngjasë ndonjëherë, kapitalistët e feudalët nuk i japin kurrë vullnetarisht tokat dhe pasuritë që kanë grabitur. Imperialistët amerikanë, ta zëmë, gjithë atë ushtri e polici që kanë organizuar dhe kanë armatosur, asnjëherë nuk do ta çarmatosin dhe pastaj t'u drejtohen me dashamirësi punëtorëve për t'u dorëzuar pasuritë kolosale që u kanë grabitur. Një gjë të tillë nuk mund ta bëjë asnjë nga kapitalistët e botës. Prandaj këtyre u duhet vënë pushka prapa veshit që të detyrohen të ngrenë duart lart, ndryshe nuk mund të ketë fitore për popujt. Në rrugën e luftës së armatosur e morëm edhe ne këtë pushtet.

Pushteti ynë i diktaturës së proletariatit është pushteti i lirisë së vërtetë të masave punonjëse. Nën diktaturën e proletariatit ekzistojnë për popullin të gjitha liritë, ekziston demokracia e vërtetë për të folur e për të kritikuar kë të dojë dhe ashtu si mendon. Një demokraci të tillë ka vendosur Partia te ne. Në vendin tonë ekziston demokracia e shumicës.

Edhe kapitalistët thonë se në vendet ku sundojnë ata paska demokraci. Po cila është demokracia e tyre?

Ajo është demokraci e pakicës. Atje vetëm pasanikët kanë të drejtë të flasin e të gëzojnë, kurse populli shtypet e shfrytëzohet. Të drejtën në kapitalizëm e kanë njerëz të tillë, siç ishin te ne përpara Ahmet Zogu, Lalë Krosi e Muharrem Bajraktari me shokë, që shumë nga ju i kanë njohur. Ja, pra, e tillë është demokracia e tyre.

Demokracia që ka vendosur Partia jonë krijoi mundësi që të fitonte e të zhvillohej te ne revolucioni në të gjitha fushat, pa të cilin Shqipëria e re nuk mund të qëndronte në këmbë dhe kështu bejlerët e agallarët do të vinin përsëri në fuqi. Ju e mbani mend mirë ç'thoshin armiqtë e pushtetit popullor, kapitalistët, bejlerët, tregtarët, fajdexhinjtë, bajraktarët e gjithë besnikët e tyre, që përmbysi revolucioni popullor, kur populli mori fuqinë në dorë: «Komunistët s'kanë haber dhe do të falimentojnë», «Këta nuk dinë të rregullojnë ekonominë, nuk dinë të bëjnë tregti, nuk dinë të drejtojnë bujqësinë, pa lëre industrinë etj., kështu që do të detyrohen të na thërresin ne dhe atëherë dimë si t'ua rregullojmë qejfin». Mirëpo s'ishin ata, po ishim ne, djemtë dhe vajzat e popullit, të fshatarëve, të punëtorëve, të zanatçinjve, që ua rregulluam qejfin. Ata pak njerëz të ditur që morën anën e popullit dhe studentët e asaj kohe Partia i mobilizoi, i vuri në punë duke u dhënë përgjegjësi të mëdha. Kur njërit iu tha të bëhej drejtor i Bankës, ai u habit, se nuk e priste e as i shkonte në mendje një gjë e tillë, prandaj tha se nuk dinte si të punonte, por Partia e këshilloi të merrte menjëherë punën në dorë, se në punë e sipër do të mësohej. Një tjetri Partia i tha të

bëhej ministër i këtij apo i atij dikasteri etj., pavarësisht se nuk kishin shkollat përkatëse. Por pranë tyre u vunë njerëz të fortë, ish-partizanë të dalë nga lufta, të cilët, pasi zunë kyçet e punëve, u bënë thirrje specialistëve të vjetër të ktheheshin dhe të punonin mirë atje ku ishin më parë. Atyre u thanë: «Punoni nën diktaturën e proletariatit, tregoni gjithë forcën e diturisë e të zotësisë suaj për të mirën e popullit të udhëhequr nga Partia dhe për të mirën tuaj!». Dhe shumica e tyre punuan ndershmërisht. Shihni tani se si në një kohë kaq të shkurtër, prej jo më shumë se 25 apo 26 vjetësh, Shqipëria ndryshoi faqen.

Janë një shkollë e madhe gjithë këto luftëra e përpjekje që ka bërë populli pas Çlirimit, gjithë këto përmbysje të mëdha e situata të vështira që ka kaluar Shqipëria. Njerëzit tanë gjatë kësaj periudhe kanë fituar një eksperiencë kolosale që nuk mund ta fitonin dot edhe sikur të vazhdonin shkollën tërë jetën. Përpjekjet, vështirësitë e pengesat tani janë kapërcyer njëra pas tjetrës. Njerëzit mësojnë dhe kaliten në luftëra, në praktikë dhe në teori, e cila s'është gjë tjetër veçse praktika e shkruar. Kur Partia menjëherë pas Çlirimit u bëri thirrje atyre të ndërtonin ura, rrugë e shtëpi banimi, të hapnin kanale e të thanin kënetat, pavarësisht se nuk kishin mbaruar shkolla e universitete, pavarësisht nga mungesat e mëdha materiale, si të varfër, të djegur e të përvëlur nga lufta që ishin dhe me një ekonomi të shkatërruar, po me ndjenja të zjarrta në zemër, të gjithë gjykuan se duhej rindërtuar medoemos shpejt çdo gjë, prandaj u mobilizuan për të derdhur pa kursim gjithë diturinë dhe forcat e

tyre mendore e fizike dhe ia arritën qëllimit. Gjatë punës heroike të atyre kohëve, njerëzit tanë njëkohësisht edhe mësuuan. Ata mësuuan, së pari, nga puna praktike, po Partia i këshilloi t'i përvisheshin edhe mësimin në libra dhe në shkolla, ku do të gjenin teorinë që do t'u hapte horizonte të mëdha për punën, për zhvillimin e ekonomisë, për ndërtimin e socializmit. Në fakt u bë siç këshilloi Partia. Dhe ja tani si është mbushur vendi me shkolla, me mësues e pedagogë.

Mbarë populli ynë çështjen e shkollës e priti me një entuziazëm të papërshekruar. Kjo tregon dëshirën e tij të zjarrtë për shkollë, për mësim e përparim. Gjatë shekujve një popull trim e i zgjuar si yni pati vuajtur edhe për të mësuar; për ta mbajtur më lehtë të nënshtruar, pushtuesit dhe klasat shfrytëzuese e kishin lënë në errësirë, kurse me marrjen e pushtetit, ai shënoi suksese të mëdha edhe në këtë fushë. Kudo, së pari, u punua për zhdukjen e analfabetizmit deri në radhët e të moshuarve, kurse të rinjtë e të rejtat filluan në masë të mësonin, pse kështu do të ishin në gjendje të punonin më mirë për ndërtimin e socializmit. Partia i hapi sytë popullit, i tregoi rrugën e arsimit e të kulturës dhe tani ai, zot i fateve të veta, është në gjendje të rrëzojë edhe malet dhe në të vërtetë male po rrëzon. Me shumicë dolën e po dalin çdo vit nga shkollat njerëz të mësuar, që kanë ndërtuar e ndërtojnë vepra të reja. Fabrika ka sjellë fabrikën, miniera minierën, pusët e naftës u shtuan, bujqësia ndryshoi krejtësisht pamjen. Janë tharë e po thahen kënetat që i sillnin popullit sëmundje, varfëri e vdekje, u bënë kanalizime

nga të katër anët e vendit. Tani fushat tona janë bërë pjellore dhe kanë shpëtuar një herë e mirë nga rreziku i përmbytjeve.

E dini ju ç'po ngjet gjetskë, si në Itali, për shembull, në Rumani, në Hungari e në vende të tjera? Çdo vit ndodhin përmbytje të mëdha. Rumania sivjet ka pësuar një katastrofë të padëgjuar, atje qindra mijë hektarë tokë janë përmbytur, i shtoni pastaj edhe mijëra hektarë të tjerë që mund të përmbyten ditët e ardhshme, pse katastrofa po vazhdon. Mbaroi gruri në këto toka, mbaroi panxhari i sheqerit, janë prishur fabrika, sepse niveli i ujit të lumenjve, nga shirat e shumta dhe nga bora që po shkrin, është ngritur shumë lart, bile janë mbytur edhe njerëz. Një gjë e tillë s'ngjet te ne, sepse i kemi bonifikuar tokat, prandaj edhe kur bie shi i madh, rrëketë dalin me rrëmbim, po pas një dite toka teret kudo, uji kullon dhe largohet. Pse i kishim bërë me kohë vepra të tilla, fushat tona nuk u përmbytën nga reshjet e mëdha të këtij viti.

Ne vetëm në zonën e Shkodrës nuk kemi arritur të përfundojmë ato ndërtime që nevojiten për ta shpëtuar një herë e mirë edhe atë nga përmbytjet, për arsye se duhet bërë një punë jashtëzakonisht e madhe. Megjithatë gjysmën e punës e kemi kryer edhe atje, prandaj kur ka reshje të forta, as ajo nuk përmbytet në atë masë sa të shkaktohen dëme katastrofale në bimë, uji e mbulon grurin dy ditë, pastaj largohet. Me bonifikimet e mëdha që po bëhen, me ndërtimin e hidrocentralit të Vaut të Dejës, të Fierzës, më vonë të Komanit e më pas edhe të të tjerave (dhe nuk do të



shkojë shumë gjatë që të ndërtohen të gjitha këto), do të bonifikohet edhe fusha e Shkodrës.

Puna e madhe që është bërë te ne për bujqësinë i detyrohet udhëheqjes së drejtë të Partisë, i detyrohet fshatarësisë sonë patriote, që u fut një herë e përgjithmonë në rrugën e kolektivizimit, i detyrohet punës së palodhur të njerëzve të Shqipërisë së re, për të cilët flasin me respekt deri edhe kapitalistë. Me respekt kanë folur për vendin tonë vizitorë të ndryshëm që kanë ardhur këtu. Duke shëtitur nëpër Shqipëri, një vizitor italian tha se vepra të tilla janë ndërtuar edhe në Itali, por veç gjysma e saj është lënë në varfëri të madhe, masat rrojnë në vështirësi, pra, ndërsa një pakicë është pasuruar, populli vuan. Kur u kthye në atdhe ai shkroi për vendin tonë një artikull, ku u thoshte bashkatdhetarëve të mos mendojnë se Shqipëria është ajo e vitit 1939, kur u pushtua nga trupat e Musolinit. Jo, ajo sot ka ndryshuar krejtësisht, atje kudo nuk shikon përveçse fusha të bukura e të sistemuara, të kulluara e të ujitura, dhe vizitori përshkruan në mënyrë reale zhvillimin modern të bujqësisë sonë kooperativiste.

Këto gjëra të mëdha nuk mund të bëheshin në vendin tonë, shokë malësorë, pa kolektivizimin, pa bashkimin e fshatarëve në kooperativa. Kurrë nuk mund të arrihet që një fshatar, sado i zoti të jetë, të bëjë me forcat e tij të tilla mrekulli. Por, kur bashkohen forcat, mrekullitë bëhen realitet. Në rendin socialist, ku është në fuqi klasa punëtore, e udhëhequr nga Partia, fshatarësisë i vjen begatia me gjyma, siç thotë një fjalë popullore.

S'ka vend në botë si Shqipëria, ku njerëzit s'paguajnë taksa. Për këtë habiten të gjithë dhe kanë shkruar miq edhe armiq, kurse në vendet kapitaliste e revizioniste popullin e rrjepin me gjithfarë taksash.

Në Jugosllavinë gjitone ngrihen çdo ditë çmimet, që nga buka e deri te gjilpëra. Pastaj me atë çmim që e blen një mall në një dyqan, nuk e blen dot te tjetri. Çmimet ndryshojnë aq dendur nganjëherë, sa në mëngjes bukën mund ta blesh me më pak dinarë, kurse pasdreke me më shumë, lëri pastaj taksat që lulëzojnë nga të katër anët. Kjo ndodh se Titoja me shokët e tij janë revizionistë, ata kanë vendosur në vendin e tyre kapitalizmin, pikërisht për këtë arsye ne i luftojmë e do t'i luftojmë gjer në shkatërrimin e tyre të plotë...

Vija e drejtë e Partisë ka bërë që bujqësia jonë të përparojë, të ngrihen uzina e fabrika nga të katër anët e vendit. Ne tashmë kemi hedhur baza të shëndosha në ekonominë socialiste dhe po ecim me sukses drejt ndërtimit të plotë të socializmit. Rruga jonë është e drejtë dhe e sigurt, se në krye kemi Partinë tonë marksiste-leniniste, të lidhur ngushtë me popullin. Ajo është parti e klasës punëtore. Çdo direktivë e saj mbështetet në teorinë marksiste-leniniste dhe zbatohet në mënyrë krijuese në kushtet e vendit tonë. Partia jonë ka tashmë një eksperiencë të madhe e të gjatë të fituar me luftë, të cilën e vë në zbatim për të mirën e popullit. Në të ardhmen do të shohim se me këtë vijë të drejtë, me forcën e madhe të klasës punëtore, të fshatarësisë e të inteligjencies që po zgjerohet dita-ditës me bijtë e klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste, sukseset tona do të jenë edhe më të mëdha.

Reforma e madhe arsimore që ndërmori Partia kohët e fundit, ka për qëllim që i tërë populli të mësojë, të ngrihet nga ana kulturore e profesionale, të mbarojë shkolla, mundësisht, edhe shkollat e larta, që secili të bëhet mjeshtër i mbaruar në punën që i është ngarkuar, me qëllim që të zhvillohet më tej kjo vepër e madhe e Partisë. Në këtë mënyrë ne do të mund të ecim drejt shoqërisë komuniste, jo me fjalë, siç thonë revizionistët sovjetikë, që në fakt e kanë kthyer vendin e tyre prapa, drejt kapitalizmit. Ne po ecim me hapa të sigurt në rrugën marksiste-leniniste jo vetëm drejt bollëkut, por në atë mënyrë që ky bollëk të vijë duke u rritur vazhdimisht dhe kurrë të mos rrezikohet. Prandaj njëkohësisht po marrim masa që njerëzit tanë të spastrohen nga çdo mbeturinë e së kaluarës, të bëhen me të vërtetë bolshevikë.

Këtij qëllimi patjetër do t'i arrihet, por me punë, në radhë të parë. Minatorët dhe metalurgët e dinë më mirë se kushdo se çeliku nuk bie nga qielli, ai përpunohet, farkëtohet, skuqet në furrë e pastaj futet në ujë e kështu veprohet disa herë, gjersa bëhet i pafytyrës. Edhe njeriu kalitet me punë e me luftë. Por gjatë gjithë kësaj lufte e pune të madhe bëhen edhe gabime, për të cilat Partia merr masa dhe i ndreq, bëhen prapë gabime, prapë i ndreq. Ndonjëherë ndodh që hiqemi pak prapa, po pastaj hidhemi përpara më me forcë. Kështu është, në luftë e në punë kalitet njeriu, fiton eksperiencë dhe pastaj bën më pak gabime. S'ka dyshim se brezi i ri do të bëjë më pak gabime se ne, kurse brezat që do të vijnë më vonë do të bëjnë më pak e kurdoherë më pak gabime, sepse Partia

mëson të mbahen parasysht eksperiencia e brezave të kaluar, sukseset dhe gabimet e tyre, me qëllim që këto të fundit të mos përsëriten. Kurrë të mos harrojmë Shqipërinë, atdheun tonë, djersën dhe vuajtjet e popullit. Asnjëri nuk lejon Partia t'i rritet hunda, të bëhet fodull dhe mendjen ta ketë te rehatia. Rehatia gjendet në punë, në përpjekjet e sakrificat që bën njeriu për popullin. S'ka rehati e lumturi më të madhe sesa kur i ke shërbyer popullit. Vetëm atëherë njeriu e ndien veten të qetë, e zë gjumi menjëherë.

E bukur, shoqe dhe shokë, është perspektiva e zhvillimit të atdheut dhe këtë e garantojnë Partia dhe puna e palodhur e popullit. Situatat janë shumë optimiste, prandaj, me besim të patundur te Partia, te vija e saj e drejtë, te puna e madhe e popullit, le të mobilizohemi totalisht në të gjitha drejtimet, në ekonomi, në kulturë, në arsim e në shkencë, për të kryer detyrat, për të tejkaluar planet, se vetëm kështu do të realizojmë ëndrrat më të mira të popullit tonë, do të krijojmë atë mirëqenie dhe begati që i dëshiron dhe i meriton populli ynë heroik. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se këto detyra të mëdha realizohen vetëm me punë, me përpjekje, me organizim të shëndoshë. Duhet të punojmë e të lodhemi akoma, por puna e lodhja japin fryte, lodhja sjell më pas edhe çlodhjen. Ai që punon nuk ndien lodhje, ndërsa dembelët e ndiejnë veten kurdoherë të lodhur, për arsye, se shpirti i tyre i dembelosur sjell një lodhje të madhe, kurse shpirti i gëzuar i jep fuqi organizmit, e gjallëron, edhe plakun e bën të ri. Dhe, në fakt, ne të moshuarit e ndiejmë veten të përtërirë, sikur jemi të rinj. «Mes

je lodhur?», më thonë mua shokët e Kukësit. More po si të lodhem unë këtu në mes të këtij populli kaq të mirë, kaq trim, që është i tëri zjarr e barut?

Duke ju uruar nga zemra juve, e nëpërmjet jush gjithë motrave e vëllezërve, shoqeve edhe shokëve të rrethit të Kukësit, shëndet të plotë dhe suksese të mëdha në punë, dëshiroj t'ju ftoj të ngremë një doli për mëmën tonë të lavdishme, Partinë e Punës, për pushtetin tonë të diktaturës së proletariatit, për klasën punëtore, për fshatarësinë kooperativiste dhe inteligjencien popullore. Në mënyrë të veçantë dëshiroj me këtë rast që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë, në emër të shokëve që kam këtu, si dhe në emrin tim personal, ta pimë këtë doli për shëndetin tuaj, për kuksianët e kuksianet heroike, bij dhe bija besnike të Partisë, flamurtarë të ideve të mëdha të marksizëm-leninizmit në këto bjeshkë e në këto fusha të bleruara e të lulëzuara.

**Të rrojë Partia!**

**Të rroni të gjithë ju, motra e vëllezër të Kukësit!**

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## USHTRINË DHE POPULLIN T'I EDUKOJMË MIRË POLITIKISHT E USHTARAKISHT

*Fjala në takimin me ushtarë e kuadro  
të repartit «N» të Kukësit*

**29 maj 1970**

Jam shumë i gëzuar që takohem sot me ju, shokë ushtarë dhe oficerë, komandantë dhe komisarë të forcave të armatosura dhe kufitare. Nuk do të ishte aspak e natyrshme që ne të vinim gjer në Kukës dhe të mos bënim një takim me ju, sado i shkurtër që të ishte ky, për arsye se shokët e komitetit të Partisë dhe të komitetit ekzekutiv të rrethit na e kanë ngarkuar ca si shumë programin. Nga sa po shoh, shoku sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit është vazhdimisht në lidhje me ushtrinë dhe me kuadrot e saj udhëheqës. Kjo është një gjë mjaft e mirë. Partia duhet të interesohet shumë dhe vazhdimisht për ushtrinë, mbasi kjo është pjesë e popullit tonë të armatosur, që stërvitet për të mbrojtur pushtetin e diktaturës së proletariatit dhe atdheun, derisa të zhduket krejtësisht për vendin tonë dhe për gjithë njerëzimin rreziku imperialist dhe revizionist.

Ju ushtarakët, sidomos, e dini ca më mirë që zhdukja e armiqve të egër të lirisë e të pavarësisë së popujve nuk do të jetë diçka e shpejtë. Me këtë dua të them se do të duhet të bëhen akoma edhe shumë punë e luftë në këtë drejtim. Për t'ia arritur këtij qëllimi është e domosdoshme që popullin ta edukojmë mirë politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht. Kjo punë te ne nuk ka karakterin e një edukate militariste agresive, siç ndodh në vendet kapitaliste ose në ato revizioniste. Edukimi i popullit tonë ka një karakter krejt të kundërt, ai ka për qëllim të ndihmojë e të forcojë mbrojtjen e pushtetit popullor, të fitoreve të arritura gjatë ndërtimit të socializmit.

Për të shkuar në komunizëm, ashtu siç duhen bërë përpjekje për të ecur përpara në ekonomi, në kulturë e në drejtimet e tjera, duhet punuar edhe për edukimin ushtarak të të gjithë qytetarëve pa përjashtim, burra dhe gra, për forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut. Kështu ne do të mund të vëmë në jetë formulën e famshme të Leninit, sipas së cilës çdo qytetar duhet të jetë edhe ushtar dhe çdo ushtar duhet të jetë njëkohësisht edhe qytetar. Pikërisht në rrugën që na tregon Lenini është e domosdoshme ta edukojmë popullin tonë, në mënyrë të atillë që ai të jetë në çdo moment i gatshëm ushtarakisht, që nga ana e përgatitjes tekniko-ushtarake të arrijë një përsosmëri të madhe.

Partia jonë ka theksuar vazhdimisht se vetëm duke ecur në këtë rrugë nuk do të ketë fuqi në botë që ta mposhtë Republikën Popullore të Shqipërisë. Për këtë arsye ajo i ka vënë një rëndësi jashtëzakonisht të madhe edukimit politik, ideologjik dhe ushtarak të

ushtrisë së rregullt e të të gjitha forcave të tjera të armatosura të vendit. Qëllimi ynë është të arrijmë të realizojmë formulën e Leninit që përmenda, e cila përfshin përgatitjen politike ushtarake si të forcave të rregullta, të rezervistëve, ashtu edhe të atyre vullnetare të vetëmbrojtjes etj., që duhet të jenë të gjitha në një nivel të lartë e të njëjlojtë tekniko-profesional dhe moralo-politik e ideologjik.

Për t'ia arritur kësaj është e domosdoshme që forcat e ushtrisë së rregullt që kemi aktualisht në kazermat ku stërviteni, rroni e studioni ju, në periudha të caktuara të bëhen shkolla edukimi jo vetëm për t'ju edukuar ju, por edhe të gjitha forcat e tjera jashtë kazermave. Këtu duhet të synojnë Partia jonë, Komanda dhe Shtabi i Përgjithshëm.

Të rinjtë dhe të rejat tona merren me stërvitje paraushtarake, ndërsa nxënësit e studentët bëjnë stërvitje të rregullta në shkollat e mesme e të larta. Më vonë nxënësit kryejnë shërbimin e rregullt ushtarak, kalojnë pastaj në rezervë bashkë me forcat vullnetare që Partia i ka organizuar tani kudo nëpër fshatra e qytete, në formë çetash e batalionesh, ku marrin pjesë gra, vajza dhe të kaluarit nga mosha. Me të gjithë këta duhet të zhvillohet sistematikisht një program stërvitjeje me një nivel të lartë nga çdo pikëpamje.

Në këtë drejtim një rol të madh kërkohet të luajë puna kombinuere e Partisë dhe juaja, dua të them e ushtrisë së rregullt, e kuadrove, e komandantëve dhe e komisarëve, e gjithë ju ushtarëve. Jam i bindur se ju, shokë ushtarë, jeni të ndërgjegjshëm për detyrën e lartë që kryeni këtu, për shërbimin ushtarak të



rregullt. Partia ju mëson dhe ju edukon ta kuptoni mirë këtë, me qëllim që çdo qytetar i republikës që kryen shërbimin e rregullt ushtarak të bëhet një kuadër, pse nesër, kur ta mbarojë këtë shërbim, ai e ka detyrë t'ua mësojë edhe qytetarëve të tjerë të gjitha ato çka mëson në ushtri. Pra, kur të mbaroni shërbimin ushtarak, nuk duhet ta konsideroni veten si ushtarë të thjeshtë, në kuptimin që mësuat ç'mësuat këtu për veten tuaj dhe të kënaqeni se u bëtë të aftë për të përdorur armët, se jeni të zotë të përballoni çdo armik. Ju duhet të jeni në gjendje të dilni në kohën e duhur për të zbatuar direktivat e Komandës e të Shtabit të Përgjithshëm, të komandantëve tuaj. Por kjo është njëra anë e punës suaj. Veç kësaj, ju duhet të mendoni se e keni për detyrë të ngrini në nivelin tuaj edhe gjithë masën tjetër të popullsisë që përfshihet në format e tjera të organizimit për mbrojtjen e atdheut dhe tok me të të punoni vazhdimisht që të ngriheni lart e më lart. Është e domosdoshme të keni parasysh që të arrihet i njëjti nivel përgatitjeje tekniko-profesionale ushtarake i gjithë masës, të tregohet kujdes i njëjlojtë, gjithashtu, edhe për ngritjen e ndërgjegjes moralo-politike të saj në të njëjtin nivel. Në këtë mënyrë do të mund të zgjidhen si duhet të gjitha ato probleme që ju preokupojnë, shokë kuadro, komandantë dhe komisarë.

Çështja e kuadrove, si kudo, edhe në ushtri është nga më të rëndësishmet. Shumë nga ju e shohin se numrin e kuadrove në reparte nuk e kanë të plotë, se ata që kanë efektivisht janë të ngarkuar shumë, mbasi organikat nuk i kanë të plotësuar. Realiteti kështu

është, po ta gjykojmë çështjen në mënyrë kaq të thjeshtë. Por nuk duhet menduar në asnjë mënyrë që kuadrot t'i përgatitim vetëm nëpërmjet shkollave. Shpesh harrohet se ata i kemi përgatitur edhe në rrugë të tjera. Me mijëra kuadro të fortë si çeliku janë përgatitur edhe jashtë sistemit të shkollave dhe janë ngritur në një nivel të kënaqshëm si nga ana tekniko-profesionale, ashtu edhe nga ajo moralo-politike dhe ideologjike. Për nevojat e ushtrisë, për shembull, janë përgatitur shumë kuadro rezervë nga ish-ushtarët gjatë stërvitjes së rregullt ushtarake, të cilët në çdo rast janë gati dhe në gjendje të kryejnë çdo detyrë që mund t'u ngarkohet. Po të rrimë të presim sa t'i nxjerrim nga shkollat kuadrot që na nevojiten për ushtrinë, do të na duhen vite, bile me dhjetëra vjet. Sigurisht, edhe nëpërmjet shkollave ne do të vazhdojmë të përgatitim si kurdoherë kuadro, po vetë ushtria ç'është? A nuk është një shkollë, ku përgatiten vazhdimisht gjatë dy-tre vjetëve të shërbimit të rregullt ushtarak me mijëra njerëz? Po të tjerët që janë stërvitur nga 15, 17 apo 20 vjet me radhë në ushtri, ç'janë? Nuk duhen quajtur edhe ata kuadro rezervë? Të gjithë këta që përmenda e kanë kokën plot me dituri, prandaj janë dhe duhen konsideruar kuadro të ushtrisë sonë, dhe jo të një ushtrie të kufizuar, po të një ushtrie që përfshin në gjirin e vet gjithë popullin e armatosur.

Nuk jemi ne që e provokojmë luftën kundër armiqve, atë duan të na e provokojnë armiqtë luftënxi-tës. Por ne rrimë zgjuar dhe kurdoherë vigjilentë, se nuk e dimë kur mund të na sulmojnë, në cilin vit apo në cilën ditë. Po të jetë se armiku na lë në qetësi, ne

mund të kemi kohë për t'i përgatitur kuadrot që do të na duhen edhe me anë të shkollave, po në qoftë se ai na sulmon një ditë, ku do t'i gjejmë gjithë ata kuadro me shkollë që do të na duhen për të drejtuar këtë ushtri të madhe popullore? Këta kuadro, shokë komandantë e komisarë, megjithatë, ne i kemi të përgatitur, ja, këtu në ushtri, nën drejtimin e Partisë, ata i keni përgatitur dhe jeni duke i përgatitur vetë ju çdo vit. Prandaj, përveç punës edukuese sistematike moralo-politike dhe tekniko-profesionale që duhet të bëni ju me dashuri me ushtarët aktivë, kujdes të madh t'u kushtoni edhe stërvitjeve me rezervistët. Këtë çështje ta kuptojë shumë mirë e shumë drejt e gjithë Partia.

Detyrat ekonomike që duhet të kryejmë në të gjithë sektorët e jetës së vendit janë të rëndësishme, edhe detyrat ushtarake janë po aq, bile më të rëndësishme. Prandaj stërvitjet me rezervistët, me forcat e tjera vullnetare dhe me paraushtarët, të udhëhequra të gjitha nga ju kuadrot e ushtrisë, duhet të bëhen me kujdesin më të madh dhe pa u lodhur. Në radhë të parë të tregoni kujdes që t'i përgatitni vetë ju, shokë oficerë aktivë. Ju, pa humbur kohë, duhet të punoni për një përgatitje shumë të kujdesshme, të bëni përpjekje për të ngritur pareshtur nivelin e mësimit, që, brenda kohës së caktuar t'u jepni ushtarëve maksimumin, në mënyrë sa më të kuptueshme, të kthjellët e jo rutinë. Mos mendoni ta kryeni këtë detyrë vetëm se duhet kryer, por të bëni një punë me nivel të lartë dhe vazhdimisht në rritje. Kjo do të thotë që në mësimet që u jepni shokëve komandantë e komisarë të rezervës dhe të gjitha forcave të tjera, në të cilat është

organizuar populli i armatosur, t'ua bëni sa më të qartë e të kuptueshme gjithçka që u duhet dhe t'u jepni gjatë çdo mësimi, kurdoherë, diçka të re që ata nuk e dinë. Këtë diçka të re t'ua bëni atyre shumë interesante, për ta përgatitur efektivin në mënyrë të atillë që armiku të mos i gjejë në befasi forcat tona të armatosura.

Siç e shihni, detyra të mëdha keni për të kryer ju, shokë komandantë dhe komisarë të ushtrisë aktive. Në radhë të parë duhet të punoni me këmbëngulje që të perfeksionoheni vetë, të mos kënaqeni kurrë duke thënë se i njihni mirë të gjitha problemet. Ju duhet të punoni vazhdimisht që të kuptoni si duhet Tezat e Këshillit të Mbrojtjes, t'i thelloni e t'i zbatoni, të bëni edhe vërejtje për to. Ato janë projektteza<sup>1</sup>, prandaj Këshilli i Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë, të dashur shokë komandantë dhe komisarë, edukues të zotë e me eksperiencë të madhe të Ushtrisë sonë Popullore, kërkojnë ndihmë nga ju, që ato të përsosën më tej me vërejtjet tuaja dhe ju vetë të bëheni me të vërtetë të denjë për një ushtri me këto qëllime

---

<sup>1</sup> Këto projektteza janë miratuar nga Këshilli i Mbrojtjes i Republikës Popullore të Shqipërisë më 25 nëntor 1967. Ato u bënë Teza me vendim të Këshillit të Mbrojtjes më 12 nëntor 1975. Kundër tyre, në shpinë të Partisë, qysh në vitin 1971, grupi puçist e komplotist i Beqir Ballukut përgatiti antitezat, që u quajtën «materiale të zeza», baza e të cilave ishte «teoria e rrëshqitjes», domethënë disfatizmi, kapitullimi para pushtuesve të huaj, lënia e qyteteve dhe e territoreve armiqve, tërheqja në malë etj. Siç u dokumentua më vonë, frymëzues i grupit puçist të Beqir Ballukut ishte poliagjenti Mehmet Shehu, që luante fijen e komplotit në prapaskenë.

kaq të larta, që udhëhoq Partia jonë marksiste-leniniste.

Krahas punës për të dhënë një kontribut më të madh në këtë drejtim, kini kujdes për ruajtjen e disa prej tezave që janë shumë sekrete. Por, natyrisht, duhet të punoni me kujdes që brendinë e tyre ta kuptojnë e ta zbatojnë të gjithë oficerët dhe ushtarët. Kjo është e domosdoshme, mbasi po s'i kuptoi mirë ato oficeri i togës, i kompanisë dhe i batalionit, e bashkë me të edhe ushtarët, nuk ka si të vihen në jetë. Në kohën e luftës mund të japim sa të duam urdhra në telefon nga komandat, por, po të mos punojmë që tani për vënien e tyre sa më mirë në jetë, urdhrat e komandës nuk do të zbatohen. I dimë ne këto çështje dhe duhet t'i dimë, por në radhë të parë ka rëndësi vendimtare t'i dinë ata që do t'i zbatojnë. Njohja dhe përvetësimi i Tezave të Këshillit të Mbrojtjes duhet t'i ndihmojnë shokët e ushtrisë për t'u mprehur gjykimin e shpejtë e të guximshëm, t'u rritin iniciativën dhe besimin në vetvete, si dhe aftësinë për t'u orientuar në çdo situatë e për të marrë vendime të pjekura. Këto veti ata do t'i fitojnë duke mësuar esencën e vërtetë të Tezave.

Lidhur me to dy gjëra kërkohen nga ju: e para, siç thashë, të bëni vërejtje për to, pa u nisur nga mendimi se kanë dalë nga Këshilli i Mbrojtjes, ose pse disa shpjegime e udhëzime për këto Teza i ka nxjerrë Shtabi i Përgjithshëm, prandaj janë të përsosura, të paprekshme, të pakorrigjueshme. Ne në ushtri stërvitemi me disiplinë ushtarake, por të kuptojmë mirë që

kjo është në radhë të parë një disiplinë proletare, marksiste-leniniste, e vetëdijshme. Partia na mëson që për çdo gjë, kur kemi vërejtje për të bërë, të mos druhemi të japim mendimin tonë konstruktiv. Prandaj si Këshilli i Mbrojtjes, ashtu edhe Shtabi i Përgjithshëm ju rekomandojnë të merrni pjesë aktivisht në thellimin e në përsosjen e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes dhe, kur shihni se ndonjë kërkon korrigjim, bëni propozimet përkatëse.

Dëshiroj t'ju flas edhe për një gjë tjetër. U bëni kritika komandantëve dhe komisarëve të njësive më të larta për të metat që mund të konstatojnë në punën e tyre. Ju, shokë oficerë, në mënyrë shoqërore u bëni kritika ushtarëve, kurse shokëve oficerë të njësive më të larta nuk u bëni sa duhet. Partia na lejon që kritika me frymë shoqërore t'u bëjmë të gjithëve, kur gabojnë. Kjo do të thotë se kritikë mund të bëhet duke filluar që nga njeriu më i thjeshtë dhe deri te Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, sepse përpara Partisë jemi të tërë njëjloj, jemi komunistë dhe qytetarë të një vendi socialist, prandaj ta kemi kurdoherë parasysh këtë porosi të Partisë. Funksionet i kemi të ndryshme, njëri është ushtar, tjetri sekretar partie ose komisar, dikush është komandant etj., po përpara detyrës të gjithë jemi njëjloj. Si ushtarë Partia ju ka mësuar t'i kuptoni drejt rolin dhe rëndësinë e funksionit të komisarit e të komandantit, prandaj i doni dhe i respektoni ata, për arsye se ju mësojnë, ju edukojnë, janë për ju si prindër, si vëllezër, pse me ta do të shkoni në luftë etj. Por ju dëshironi që ata të jenë sa më të përsosur si

njerëz, prandaj nganjëherë, kur keni ndonjë vërejtje për ta, duhet t'ua thoni hapur dhe të jeni të bindur se nuk kanë për t'ju marrë për keq. Edhe oficerët mund të kenë ndonjë vërejtje për ushtarët, prandaj kur ata ua vënë në dukje për të mirën tuaj, për të mirën e ushtrisë, për të mirën e popullit, përpiquni, në radhë të parë, t'i kuptoni, pastaj edhe t'i zbatoni këshillat e tyre të drejta. I duhet vënë kujdes më i madh edukimit jo vetëm të ushtarëve, por edhe të kuadrove të tillë, siç janë komandantët e togave, komandantët dhe komisarët e kompanive e të batalioneve, sepse konstatojmë që nuk ekziston kurdoherë për ta ai kujdes që porosit Partia.

Pa u zgjatur, dëshiroj t'ju them se Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave i kanë bërë një vlerësim të lartë Ushtrisë sonë Popullore, e cila, si kurdoherë, është e gatshme t'i përgjigjet çdo thirrjeje të Partisë dhe të përgatitet sa më mirë. Ka suksese në ushtri në çdo drejtim, po, si kudo, ka edhe te ju vështirësi e të meta, dhe kjo është dialektike, për arsye se në shoqërinë tonë ka akoma mjaft njolla, për spastrimin e të cilave duhet punuar vazhdimisht. Edhe në ushtri ka nga ata, bile edhe oficerë, që, duke mos qenë të ngritur sa duhet ideologjikisht dhe politikisht, mbajnë ndonjë qëndrim jo të pëlqyer, prandaj edukimi ideopolitik i të gjithë efektivit është një detyrë e dorës së parë e organizatave të Partisë në ushtri. Megjithatë ushtria jonë në përgjithësi është e fortë, proletare, besnike gjer në fund ndaj çështjes së Partisë dhe të popullit, e përgatitur mirë edhe nga ana tekni-

ko-ushtarake. Është shumë pozitive që nga pikëpamja teknike ushtria jonë ecën vazhdimisht përpara, me ritme të kënaqshme. Armatimet që ajo disponon tash u përshtaten kohëve. Në të ardhmën ne mund dhe do të disponojmë të tjera edhe më të mira, por Komiteti Qendror i Partisë rekomandon që armatimet që kemi aktualisht, dhe që nuk janë pak, ushtria duhet t'i mirëmbajë, të mësojë t'i përdorë më së miri dhe t'i ketë kurdoherë në gatishmëri të plotë, për të realizuar në çdo kohë detyrën e lartë që i është ngarkuar, mbrojtjen e atdheut.

Kjo është një çështje që ka të bëjë me kuptimin e drejtë politik të situatave...

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë synon që të rrojmë në miqësi me shtetet e tjera, sidomos me ato fqinje, por me kusht që këto të mos përzihen në punët tona të brendshme, ashtu sikundër nuk përzihemi ne në punët e tyre...

Në Jugosllavi aktualisht është krijuar një kaos i madh. Ka qenë Titoja ai që ka shtypur gjer tani shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi. Por politika që ka ndjekur nuk i ka dhënë asgjë të mirë, prandaj, duke marrë parasysh se tani në Jugosllavi janë krijuar kontradikta të thella midis kombësive e grupimeve më me influencë, Titoja u detyrua të ndryshojë qëndrimin ndaj shqiptarëve. Në vetë gjirin e udhëheqjes revizioniste jugosllave ka kundërshtime midis titistëve dhe të tjerëve, atje janë krijuar grupe nacionaliste që luftojnë kush e kush të zërë vendin kryesor.



Si oficerë dhe njerëz politikë që ju ka përgatitur Partia, ju kuptoni, gjithashtu, se revizionistët sovjetikë bëjnë çmos të dalin në Mesdhe. Vlorën ata e qajnë tani me lot gjaku, pse ne u thamë me kohë dhe u themi: «Hipni këtu, të shihni Stambollin». Për të realizuar synimet e tyre ekspansioniste, ata përgatitën dhe janë gati që të nënshtrojnë këdo që mund të gjejnë të dobët, dhe bile edhe ta sulmojnë. Por është fakt që Titoja i ka paralajmëruar se, po të sulmohet Jugosllavia, kjo do të hyjë në luftë kundër tyre. Pikërisht në këto momente Partia jonë tha fjalën e vet, bëri deklaratën që keni lexuar në shtyp, me të cilën del në mbrojtje të popujve të Jugosllavisë. Qëndrimi i Partisë sonë ka bërë një përshtypje shumë të madhe kudo, sidomos te popujt e Jugosllavisë, ndërsa udhëheqja jugosllave përpiqet ta shfrytëzojë për interesat e saj këtë qëndrim, duke u munduar t'u tregojë popujve të Jugosllavisë sikur tani ne u pajtuam me të. Po ne nuk gënjehemi nga qëndrimet dhe nga deklaratat e revizionistëve titistë, se i njohim mirë kush janë.

Koniunkturat duhen shfrytëzuar, po kur shohim që titistët me propagandën e tyre përpiqen ta shtrembërojnë vijën e drejtë dhe të palëkundur të Partisë sonë, atëherë japim sqarimet e duhura, me anën e botimit si përgjigje të ndonjë artikulli, kur është e nevojshme, siç e keni parë edhe vetë në «Zërin e popullit», duke vënë kështu mirë pikat mbi i.

Partia dhe shteti ynë, me politikën e tyre të drejtë, gëzojnë një respekt të madh në arenën ndërkom-bëtare. Këtë respekt ata e kanë fituar në sajë të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë, prandaj atë

duhet ta kuptojmë, në radhë të parë, ne vetë, pastaj ta zbatojmë me përpikëri në jetë. Një nga detyrat në zbatim të politikës së Partisë është edhe puna për t'i bërë organizatat-bazë të Partisë në ushtri detashmente të vërteta pararojë, zemra të çeliktat të çdo reparti. Për këtë qëllim është e domosdoshme që komunistët e reparteve të jenë shembull në çdo drejtim, të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur drejt çdo problem, për të korigjuar çdo gabim e të metë që mund të vërtetohet atje. Prandaj ata vetë të jenë të palodhur në punë, të afërt e të hapët me njerëzit, të çiltër e të lidhur ngushtë me ushtarët, dhe, për zgjidhjen e problemeve, të marrin mendimin e masës.

Ju duhet të përpiqeni për të gjetur metodat më të përshtatshme e frytdhënëse për stërvitjen e përdikimin ideopolitik e profesional të efektivit. Këtë mund ta bëni shumë mirë, se jeni njerëz të mësuar. Partia ju ka nga kuadrot më të vjetër dhe me eksperiencë të madhe, prandaj në punë duhet të jeni nga më metodikët, sidomos në drejtim të stërvitjes dhe të edukimit të efektivit. Ajo kërkon gjithashtu prej jush që në studimin e teorisë, të taktikës dhe të strategjisë luftarake, të sillni kudo përmirësime me propozimet dhe me mendimet tuaja krijuese.

Me kaq dëshiroj t'i japim fund këtij takimi dhe t'ju falënderojmë së tepërmi për vëmendjen që treguat. Ne donim të qëndronim akoma më shumë me ju, po nuk kemi mundësi. U gëzova shumë që, së bashku me ju, kanë ardhur në takim edhe ushtarë e kuadro të kufirit, prandaj ju lutem që nëpërmjet jush t'u çoni të falat tona më të përzemërta dhe urimet për suksese

në detyrë gjithë shokëve tuaj që jetojnë dhe vigjilojnë në postat kufitare e në repartet nga keni ardhur.

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## ME PUNË DHE ME MËSIM NE DO TË ECIM PËRPARA

*Fjala në takimin me punonjësit e Hasit dhe  
të kooperativës së bashkuar të Krumës*

29 maj 1970

Të dashur vëllezër dhe motra të Hasit e të kooperativës së bashkuar të Krumës,

Shumë të gëzuar jemi sot që ndodhemi këtu së toku në këtë qendër të rëndësishme të krahinës suaj me tradita të mëdha patriotike. Ju hasjanët, si gjithë populli ynë, keni luftuar, jeni përpjekur e keni dërdhur vazhdimisht gjak për lirinë e vendit.

Për të gjithë shqiptarët krahina e Hasit është veçanërisht e shtrenjtë, pse këtu në gjirin tuaj ka luftuar heroi i maleve Bajram Curri, ai patriot i madh me zemër të zjarrtë, që s'pati kurrë frikë nga vdekja dhe ia kushtoi tërë jetën çështjes së çlirimit të atdheut e të popullit. Këtu, pikërisht, në këtë krahinë, ai gjeti një mbështetje të fortë dhe tok me ju u hodh në luftë. Ju hasjanët s'patët frikë nga plumbat e xhelatit Ahmet Zogu, kur mbanit e ruanit në gjirin tuaj heroin e popullit fukara që luftonte për një ide të madhe, për atë

ide që populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës, përqafoi më vonë dhe doli në dritë.

Sa gëzim të madh ndiejmë ne komunistët dhe patriotët kur takohemi me pleq e plaka të Hasit, të cilët na tregojnë se si e kanë strehuar në odat e shtëpive të tyre të varfra bacë Bajramin. Me këtë ju hasjanët i keni bërë një shërbim të madh Shqipërisë. Por ju u treguat dhe qëndruat si burrat edhe përpara xhelatëve të Ahmet Zogut, kur ata, pas vrasjes së Bajram Currit, patën pyetur për frikësim se kush do ta merrte trupin e tij të gjakosur. «Bjereni këtu, se e marrim ne hasjanët», u thatë ju pa frikë atyre banditëve dhe trupin e heroit e morët dhe e varrosët këtu pranë, ku, pasi të mbarojmë bisedën, pavarësisht se eshtrat e bacë Bajramit tash prehen në Tropojë, në atë qytet që sot mban emrin e tij të lavdishëm, e kemi për nder dhe detyrë të vemi të përulemi përpara lapidarit të ngritur në kujtim të tij.

Të mos ju vijë keq ju hasjanëve që ato eshtra u vendosën në Tropojë. E kush nuk i donte t'i kishte pranë? Gjithë qytetet e Shqipërisë do të dëshironin t'i merrnin eshtrat e Bajram Currit e t'i kishin në gjirin e tyre, pse ai ishte biri i gjithë popullit shqiptar, ishte babai i vegjëlisë. Anëmbanë vendit tonë bacë Bajrami donte të ngrinte flamurin e lirisë, por mbasi Tropoja mori emrin e tij, atje u çuan eshtrat e heroit. Pavarësisht nga kjo, për ne dhe për ju, për të gjithë ato që thashë, Kruma dhe krahina e Hasit janë prapë të shtrenjta.

Kur vendosa për të bërë një vizitë në rrethin e

Kukësit dhe shokët më pyetën nëse do të vizitoja ndonjë kooperativë, u thashë se do të vete pikërisht në Krumë, në Has. Dhe ja sot e ndiej veten të gëzuar që gjendem në mes jush, në mes të këtij populli të mrekullueshëm e të lumtur, që çdo ditë e çdo vit do të jetë edhe më i lumtur e më i gëzuar. Këtë lumturi dhe këtë gëzim na i solli të gjithëve Partia, për të cilën ju me të drejtë po brohoritni tash, pse pa të nuk mund të krijohet kjo situatë për popullin punonjës.

Hasi juaj më parë quhej «Has i thatë», por këtej e tutje kjo fjalë do të fshihet nga fjalori, mbasi Partia dhe Qeveria kanë vendosur që krahinën tuaj ta kthejnë në një vend pjellor, ta bëjnë Myzeqenë e kësaj ane. Janë vallë kushtet për një gjë të tillë? Po, janë. Unë e kam shkelur anembanë Shqipërinë dhe dëshiroj t'ju them me këtë rast se është e vërtetë që ne kemi kudo fusha të bukura, të cilat, pas Çlirimit, janë zbukuruar e janë bërë edhe më pjellore, pse janë sistemuar, janë kanalizuar, ato tash ujiten, punohen me traktor etj. Ne kemi edhe vende kodrinore e malore që, megjithëse me terren të thyer, janë të bukura, por mund të them se, midis të gjitha vendeve që kam parë, edhe Hasi juaj është fort i bukur, me kodrina të buta të mbuluara me shkurre e me drurë pak të dobishëm, të cilët po presin të spastrohen nga njerëzit dhe nga makinat që ka sjellë e do të sjellë akoma në të ardhmen Partia. Prandaj, duhet punuar që, brenda një periudhe sa më të shkurtër, të gjitha këto kodra, të cilat arrijnë një sipërfaqe prej 6 000-7 000 e më shumë hektarë tokë, të shpyllëzohen, të sistemohen, të ujiten. Qëllimi i Partisë është që edhe në krahinën tuaj të

krijohet së shpejti një bujqësi e përparuar moderne në atë shkallë sa të harrohet njëherë e mirë ajo sasi e paktë misri, thekre ose gruri që keni marrë këtu nga kjo tokë kaq e bukur, por, mjerisht e thatë në të kaluarën. Populli këtu ishte punëtor, por mundësi, mjete e dituri nuk kishte, pse atëherë atij i rëndonin në zverk sundimi i egër i armiqve të tij shekullorë, bejlerë, agallarë, bajraktarë e të huaj, dhe pushteti i tyre antipopullor. Krejt ndryshe është tash gjendja për popullin, lëre pastaj si do të jetë e ardhmja e tij, për të cilën po punohet nga viti në vit.

Me bujqësi moderne ne kuptojmë një bujqësi të atillë, e cila të sigurojë rendimente të larta në të gjitha llojet e bimëve, për shembull, të arrijmë që të marrim jo 20, po 50 e më shumë kuintalë misër për hektar. Mund të arrihet në vendin tonë një rendiment i tillë? Po, pse përveç arsyeve të tjera, tani kemi sjellë edhe farëra të zgjedhura nga jashtë, prej të cilave mund të merren deri 120 kuintalë për hektar. Tani Qeveria këtë farë ka filluar ta shpërndajë më parë në disa ndërmarrje bujqësore për ta shumëzuar. Atje ku është mbjellë, po luftohet për t'i bërë asaj të gjitha shërbimet e nevojshme, prandaj mendojmë të marrim mesatarisht 75 deri 80 kuintalë misër për hektar. Brenda vitit tjetër ose dy vjetëve, do të mund ta shpërndajmë këtë lloj fare në gjithë vendin, me synimin që të marrim mesatarisht 50 dhe 60 kuintalë misër për hektar nga e gjithë sipërfaqja e mbjellë me të. Kështu që edhe në Hasin tuaj, dikur të thatë, pasi të spastrohen mirë tokat nga pyjet e shkurret e padobishme dhe të punohen nga «Stalinecët» (nga ato makina të fuqishme

që mbajnë emrin e Stalinit), duke mbjellë një farë të tillë misri, do të shikoni ç'ndryshime të mëdha do të bëhen në ekonominë tuaj.

Ekonomia është baza e rendit tonë socialist. Kudo bëhet luftë për ta ngritur atë vazhdimisht. Edhe te ne kështu ndodh. Mbi ekonominë mbështeten fuqimisht gjithë ideologjia dhe politika e Partisë sonë, e cila punon për të sqaruar njerëzit, për t'u hapur sytë, për t'i mësuar të mendojnë në radhë të parë politikisht, pse kjo është rruga më e drejtë për zgjidhjen e plotë të çdo problemi. Politikisht duhet të mendohet edhe për çështjen e grave e të cucave.

Si kudo në vendin tonë, djemtë e vajzat hasjanë duhen dërguar në shkollë, ku, sipas porosisë së Partisë, do të mësojnë si të punohet toka, si të trajtohen farërat, si të mbillet e të korret, si të ushqehen bagëtitë etj., etj. Të gjitha këto bëhen e do të bëhen për të zhvilluar sa më shpejt ekonominë, që të ngrihet mirëqenia e popullit. Për këtë qëllim edhe fushat e kodrat e bukura të Hasit, sipërfaqet e të cilave do t'i shtojmë çdo vit duke hapur toka të reja, do t'i mbjellim me bimët që parashikojmë në plan, sidomos me misër dhe me grurë. Por, vëllezër dhe motra të Hasit, për të rritur rendimentet e tyre duhet punuar, pse vetëm me punë merren prodhime të bollshme misri e gruri. Po nuk punuam në mënyrë të organizuar, nuk mund të marrim rendimente të larta, për të cilat luftojmë, edhe sikur farën ta kemi të mirë, edhe sikur të kemi shumë traktorë, edhe sikur lopët t'i kemi të racës. Në qoftë se çdo proces pune nuk kryhet mirë, as toka prodhon, as lopa e dhia nuk japin sa duhet.



Në bazë të çdo gjëje, na mëson Partia, qëndron puna. Si gjithë populli ynë, edhe ju hasjanët jeni punëtorë, megjithëse disa duan të thonë se nuk jeni të tillë. Unë nuk dua t'i besoj kësaj. Është e vërtetë se te disa nga njerëzit tuaj ekzistojnë koncepte të vjetra të dëmshme, të cilat duhet t'i luftojmë. Po përse thoshin kështu më parë për hasjanët? E ç'të bënte i ziu hasjan në këtë vend, ku toka thahej për një pikë ujë, pa kafshë dhe pa mjete? Me se të punonte? Në këto kushte kaq të vështira ai që i detyruar të vente në Gjakovë apo në Prizren për të blerë një thes misër, që toka e tij këtu, edhe pse e punonte, nuk ia prodhonte.

Por me krijimin e Partisë, në sajë të udhëheqjes së urtë e të mësimeve të saj, ndryshuan kushtet, ndryshuan edhe pikëpamjet e hasjanëve e të hasjaneve për punën. Ata janë bërë sot punëtorë si të gjithë shqiptarët. Ashtu si në tërë vendin tonë, edhe në Hasin tuaj ka shkolla 8-vjeçare, ku djemtë dhe vajzat mësojnë dhe dalin prej tyre po aq të zotë sa djemtë dhe vajzat e tjera të Shqipërisë. Jo vetëm kaq, po sot janë të shumtë ata të rinj e të reja nga Hasi juaj që kanë mbaruar shkolla të mesme e të larta. Në të ardhmen do të dalin akoma më shumë njerëz të mësuar, të ditur e të zotë, si: mjekë, mësues, inxhinierë, traktoristë, elektrikistë, të cilët do të punojnë jo vetëm në krahinën tuaj, por në gjithë Shqipërinë. Dhe kur në rrethet e tjera do t'i shohin që punojnë kaq mirë e do t'i pyesin nga janë, ata do t'u përgjigjen krenarë se janë këtej, nga Hasi, sepse këtu, në këtë tokë, kanë lindur, janë rritur, kanë mësuar e kanë punuar më parë. Kur

e pyesim sot shokun Xhafer Spahiu: «Ku e ke bërë shkollën fillore?», «Në Krumë, në konviktin «Kosova»», përgjigjet ai me krenari. E ka për nder sekretari i Komitetit Qendror të Partisë kur tregon se ka mësuar në Krumë.

Çështjen e kam, shoqe dhe shokë, që vetëm me punë dhe me mësim ne do të mund të ecim përpara. Le të marrim problemin e misrit dhe të grurit. Të dyja këto bimë, si çdo lloj tjetër, për t'u zhvilluar kanë shkencën e tyre, sipas së cilës duhen trajtuar, duke filluar që nga puna për të pastruar farën e derisa grumbullohet prodhimi i ri. Me këtë dua të them se duhet mësuar si të trajtohet e të ruhet fara e drithërave, kur duhet hedhur në arë, si të prashitet bima, kur dhe si të ujitet e të ruhet nga sëmundjet, si të korret e t'i bëhen të gjitha shërbimet e tjera me radhë, gjer te seleksionimi i farës. Pra, bashkë me mësimin, duhet edhe punë. Puna dhe mësimi janë të pandarë, si kudo, edhe në bujqësi.

Tokat tuaja prodhojnë jo vetëm misër e grurë, po edhe bimë të tjera, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet t'i neglizhojmë dhe të mos mjaftohemi vetëm me drithërat e bukës. Në të kaluarën popullit tonë të vuajtur i kishte ngelur në kokë fjala «bukë». Mirëpo gjendja sot ka ndryshuar kudo. Edhe në Hasin tuaj «të thatë», siç më thanë shokët dhe siç e dimë nga eksperiencia e shumë kooperativave që më parë prodhoin bukë vetëm për tre-katër muaj, kooperativa e bashkuar e Krumës me fshatrat afër, tash jo vetëm bën bukën e tërë vitit, po edhe shtetit i jep teprica. Ky është një sukses i madh, motra dhe vëllezër. Kështu

si te ju ka plot kooperativa të tjera në vendin tonë që kanë arritur në këtë nivel, megjithëse ka edhe nga ato që nuk e bëjnë bukën akoma, jo se nuk duan, po nuk janë krijuar kushtet për një gjë të tillë. Një pjesë e mirë e këtyre do ta sigurojnë vitin që vjen, kurse të tjerat do të punojnë me të gjitha forcat që ta prodhojnë në një të ardhme të afërt.

Ne duhet të luftojmë që në të tëra tokat që tash kemi hapur e kemi punuar, të ngremë rendimentet e drithërave. Por është e domosdoshme të zhvillojmë njëkohësisht edhe blegtorinë, si lopën, ashtu edhe bagëtitë e imëta.

Pyjet janë një pasuri e madhe e popullit, prandaj t'i ruajmë e t'i shtojmë. Në qoftë se prishim një pyll, i bëjmë një dëm të madh vetes sonë. Të mbajmë mirë parasysh që në disa zona ku kemi pyje të reja në rritje dhe me vlerë, dhia i dëmton. Po këtu ju keni kushte të përshtatshme edhe për zhvillimin e lopës. Për këtë qëllim më parë se çdo gjë duhet të marrim masa për sigurimin e bazës ushqimore. E gjithë puna aty është tek ushqimi. Njeriu, po të mos hajë, tretet, bëhet si gishti. Kështu ndodh edhe me kafshën, po të mos i japësh të hajë. Prandaj, në rast se i sigurojmë lopës gjithë sasinë e nevojshme të ushqimit, do ta kthejmë atë në një fabrikë që do të na japë qumësht dhe mish me bollëk. Po të bëjmë llogari kush na jep më shumë prodhime, do të na dalë se, po ta trajtojmë në baza shkencore, lopa ka më shumë leverdi, pse, përveç qumështit dhe mishit, ajo na jep edhe plehun aq të nevojshëm për rritjen e bimëve, të cilin e sigurojmë në

stalla. Të gjithë e kuptojmë se pa pleh nuk mund të merren prodhime të bollshme.

Në qoftë se duam të ngrihen rendimentet e dri-thërave, të patates etj., duhet të kemi pleh kimik. Për këtë qëllim shteti ka ndërtuar fabrika plehrash, të cilat do t'i shtojë në të ardhmen. Por duhet të shtojmë edhe «fabrika» të tjera për prodhimin e plehut organik, siç janë lopët, veçse jo çfarëdo lopësh, po nga ato më prodhimtaret.

Ne duhet të punojmë që lopët të na japin sa më shpejt një mijë, dy mijë e më shumë litra qumësht në vit. Në disa ndërmarrje bujqësore, si në ato të Tiranës, kemi lopë race që japin prodhime rekord. Natyrisht, nga këto nuk kemi shumë, po janë të tilla që japin gjashtë deri shtatë mijë litra qumësht në vit. Merreni me mend se si rrjedh qumështi nga gjiri i tyre, si uji nga çezma! Po ama ato i ushqejmë si duhet. Sigurisht, ne nuk mund të arrijmë që të tëra lopët të na japin nga gjashtë e shtatë mijë litra si këto, po në rast se punojmë që në të gjithë vendin të marrim mesatarisht nga një mijë litra qumësht në vit për çdo lopë vendi, nga më pak se 500 litra mesatarisht që marrim tani, do ta rritim në një nivel të konsiderueshëm sasinë e qumështit. Prandaj, për të realizuar këtë, është e domosdoshme t'i sigurojmë lopës ushqim.

Më informuan shokët se këtu në ndërmarrjen bujqësore të Hasit kemi edhe lopë të vendit, edhe disa të racës, veç atyre pak tokë u keni rezervuar për ushqim. Ky është një gabim i madh, shoqe dhe shokë. Partia na mëson që, po vendosëm të mbajmë lopë për qumësht, për mish e për pleh, dhe duhet medoemos

të mbajmë, është e domosdoshme të përcaktojmë më parë se çdo gjë sipërfaqen e tokës nga e cila do të sigurojmë ushqim për to, me qëllim që t'i japim secilës sasinë e rekomanduar të tërfilit, të misrit, të jonxhës etj., etj. Në qoftë se veprohet kështu, dhe kështu duhet vepruar, atëherë do të shikoni se si do të fillojnë të shtojnë qumështin lopët e vendit.

Krahas sigurimit të ushqimit, të marrim masa që lopët e vendit t'i kryqëzojmë me damazë të racave të mira, si, fjala vjen, «Xhersej», ose me raca të tjera që japin rendimente të larta.

Po ndërmarrjen bujqësore këtu, për ç'qëllime e kemi krijuar? Që ajo, krahas realizimit të planit që i është caktuar, të bëhet shembull në të gjitha drejtimet për mbarë krahinën e Hasit, t'u japë eksperiencë e ndihmë kooperativave përreth, t'ju tregojë ju hasjanëve si punohet për lopën, për grurin, për misrin, për pataten etj., etj. Kjo ndërmarrje bujqësore, me një fjalë, duhet të bëhet shkollë për ju. Inxhinierët, agronomët dhe kuadrot me arsim të lartë e të mesëm që punojnë në ndërmarrjen bujqësore, të ndihmojnë edhe kooperativat tuaja me këshillat dhe me eksperiencën e tyre, derisa të siguron vetë kuadrot e nevojshëm, specialistët, agronomët dhe veterinerët tuaj. Pra, kuadrot e ndërmarrjes bujqësore, ashtu si për të, e kanë për detyrë të interesohen edhe për kooperativat rreth e përqark, sepse qëllimi i Partisë dhe i Qeverisë është që kooperativat bujqësore të ngrihen në një nivel të lartë zhvillimi, të ngrihen më lart edhe në to rendimentet, çka do të thotë të rriten të ardhurat tuaja, që të mos merrni nga 8 lekë për ditë-punë, por çdo vit.

e më shumë, derisa të siguron mesatarisht nga 550 lekë të ardhura në muaj, siç marrin punëtorët e ndër-marrjes bujqësore. Për këtë lufton Partia.

Për t'ia arritur kësaj, shokë dhe shoqe, kërkohen punë dhe mësim, duhen bërë përpjekje për rritjen e nivelit agroteknik të kooperativistëve dhe të rendimenteve në bujqësi, por edhe në blegtori, duke siguruar për këtë qëllim, siç thashë, ushqim të bollshëm, stalla të ngrohta, shërbim të mirë e të gjithanshëm, pa lënë pas dore në asnjë mënyrë përmirësimin racor të bagëtive etj.

Kafshët prodhuese kërkojnë një trajtim të kujdesshëm dhe në këtë drejtim gratë e vajzat janë shumë më të dhëna se burrat. Ato që keni caktuar ju këtu, janë gra e vajza të zgjuara, të cilat duhet t'i edukojmë e t'i mësojmë vazhdimisht; ato janë shumë të afta për t'u marrë me lopët dhe do t'jua them arsyen. Lopa është një kafshë mjaft delikate. Shumë nga ju, që kanë një eksperiencë të gjatë, e dinë mirë se, po të goditet me shkop, siç bëjnë disa barinj, lopa s'të jep qumësht. Gjithashtu, në qoftë se kur shkon ta mjelësh, i bën zhurmë me kusi, ajo prapë nuk të jep qumësht. Do të duhet t'i bësh për një kohë masazh, ta qetësosh, pastaj të shohim nëse do të të japë. Lopa kërkon një shërbim të veçantë, sidomos në kohën e pjelljes. Po s'i bërë shërbimin e duhur në këtë periudhë, ajo mund të sëmuret njëlloj si njeriu. Pikërisht për këtë arsye Partia ka dërguar me shumicë në shkolla vajza e djem, që të mësojnë për mjekë, për mami, për infermierë etj. Kur qëllon të veni nëpër spitale e klinika, atje gjeni tani gra e vajza më shumë se përpara. Partia i

ka çuar atje, se janë më të kujdesshme e më të dhimb-sura se burrat me të sëmuret. I njëjti kujdes, na mëson shkenca, duhet treguar edhe për kafshët, të cilat kërkojnë, gjithashtu, interesim të vazhdueshëm, pse kanë sëmundjet dhe nevojat e tyre. Mirëpo kafshëve të sëmura, për t'i shëruar, më parë u duhet gjetur ç'sëmundje kanë, punë që vërtet e bën veterineri, por të mos harrojmë për asnjë çast se vajzat dhe gratë që caktohen të punojnë ditë e natë me to, e kuptojnë më mirë e më parë se kushdo kur një lopë është e sëmure. Atëherë ato vrasin mendjen dhe i bëjnë vetes pyetjen: «Gjersa është kështu, sigurisht diçka ka, ose është sëmure, ose nuk i janë dhënë ushqimet në sasinë e në llojin e duhur, nga mungesa e të cilave vuan organizmi i saj». Duhet ditur se, përveç të tjerave, ushqimet që u jepen kafshëve kanë edhe kripëra minerale etj., që janë shumë të nevojshme për organizmin; po të mos i marrë ato, ai vuan, prandaj ushqimet duhet të jenë të shumëllojshme. Të gjitha këto gjëra njerëzit i mësojnë në shkolla, në kurse, nëpërmjet librave, konferencave etj.

Unë fola deri edhe për kripërat që i duhen lopës nëpërmjet ushqimeve që merr. Kështu është edhe me njeriun, i cili, përveç bukës e mishit, ka nevojë edhe për ushqime të tjera. Organizmi nuk mbahet vetëm me një apo me dy lloje ushqimesh, edhe sikur t'i marrësh këto me bollëk, bile, kur i merr jashtë masës, ai përsëri dëmtohet. Për shembull, edhe mish po të marrësh shumë, të bën dëm, bile mjekësia ka vërtetuar shkencërisht që mishi ka disa lloje helmesh, prandaj kush e ha dendur dhe në sasi të mëdha, dëmton trupin.

Atëherë ç'duhet bërë? Duhet ngrënë edhe fruta, edhe zarzavate. Mirëpo shumë njerëz te ne sidomos zarzavatet nuk i vlerësojnë drejt, bile i përçmojnë. Ka ndonjë që thotë: «Po pse, nga këto do të ha unë, si kafshët?», ndërsa ato kanë një rëndësi shumë të madhe për shëndetin e njeriut. Prandaj të mësoheni të hani më shumë domate, patate, presh, qepë, hudhra, majdanoz, kungull e të gjitha llojet e zarzavateve të tjera, pse janë shumë të dobishme për trupin.

Për zhvillimin normal të kockave e të dhëmbëve njeriu ka nevojë deri edhe për gëlqere, lëndë që e njohim të gjithë, pse me të lyejmë shtëpitë. Ndonjë mund të çuditet, po kjo është e vërtetë. Atëherë si të bëjmë, ta marrim gëlqeren dhe ta hamë direkt, ashtu siç është? Jo, bile një gjë e tillë do të qe e rrezikshme, por gëlqerja merret nëpërmjet disa lloje zarzavatesh, prandaj njeriut që i ha rregullisht ato, nuk i bien dhëmbët shpejt, kur është fëmijë i forcohen kockat, saqë edhe në pleqëri nuk i ndien të rënda këmbët. E shikoni, pra, sa të vlefshme janë zarzavatet?

Po ku gjenden ato? Mos vallë bien nga qielli? Jo, prodhohen e duhet të prodhohen këtu, në tokë. Për këtë qëllim në kooperativat tuaja caktoni apostafat një pjesë të tokës për të prodhuar zarzavate, llogaritni sa hektarë duhet të mbillni me patate, ç'sipërfaqe nevojitet për tranguj, pastaj për kunguj e kështu me radhë për të gjitha të tjerat, së pari për të plotësuar nevojat tuaja me sasinë e zarzavateve që duhet të hajë çdo vit një njeri, pastaj edhe për të shitur në treg.

Gratë dhe vajzat tuaja që venë nga Hasi në Berat, në Vlorë, në Gjirokastrë e gjetiu në Jug apo në



Shqipërinë e Mesme, dhe ato që vijnë prej andej këtu te ju, e kanë për detyrë të mësojnë njëra-tjetrën si duhen gatuar gjellët me zarzavate, të shkëmbejnë eksperiencë ndërmjet tyre. Qëllimi është që jetën e njerëzve ta përmirësojmë, ta bëjmë gjithnjë e më të bukur. Kështu na mëson Partia, prandaj drithërave, produkteve blegtorale, frutave dhe zarzavateve t'u japim rëndësi të madhe. Për prodhimin e tyre me bollëk është e domosdoshme të punojnë e të mësojnë pa u lodhur të tërë, të mëdhenj e të rinj.

Sidomos të rinjtë e të rejat në asnjë mënyrë të mos i lëmë pa shkollë, të mos i heqim nga tetëvjeçarja, bile sa më shumë prej tyre të vazhdojnë mundësisht edhe shkollat e mesme, sidomos shkollat teknike e bujqësore, por edhe universitetin e institutet e larta.

Edhe ne të moshuarit duhet të mësojmë nga librat dhe nga njëri-tjetri, të mësojmë edhe nga të rinjtë. Kështu ka ardhur puna tash, të rinjtë e të rejat që kanë mbaruar shkolla të mesme e të larta e janë bërë teknikë, inxhinierë, agronomë etj., janë në gjendje të na mësojnë si ta punojmë tokën sa më mirë, si të rritim rendimentet, si të mirëmbajmë bagëtitë e të përmirësojmë racat e tyre etj., etj. Për të realizuar të gjitha këto detyra duhet, pra, të mësojmë të gjithë dhe vazhdimisht.

Por që të mësojmë sa më mirë, është e domosdoshme të zhdukim më parë nga koka disa mbeturina të vjetra që na pengojnë në punë, siç janë feja, kanuni, zakonet prapanike etj.

Njerëzit gjatë shekujve kanë besuar në fe të ndry-

shme, duke menduar se ka një perëndi, një zot. Po ç'është ky zot? Tërë jetën kanë thirrur të parët tanë «O zot, shpëtona!», megjithatë kurrë nuk panë një ditë të bardhë. Kush i çliroi më së fundi njerëzit në vendin tonë nga zgjedha e bejlerëve, e agallarëve, e kapitalistëve? Zoti vallë? Po ta kishim pritur shpëtimin nga zoti, ne do të vuanim tërë jetën, siç ka vuajtur para Çlirimit mbarë populli ynë. Por atë e shpëtoi vetëm Partia, e cila nuk beson te zoti, se në të vërtetë ai nuk ekziston. Krishti, Muhameti, Moisiu, «shenjtorët që bëjnë çudira» etj., janë kurdisur nga pasanikët, nga shtypësit e shfrytëzuesit shekuj më parë për të frikësuar njerëzit, për t'i mbajtur në errësi, për t'i bindur që të jenë të durueshëm në këtë jetë, «se vetëm kështu do të gjejnë xhenetin në jetën tjetër». E ç'i duhet xheneti njeriut, kur vuan? Kush ka vajtur në «botën tjetër» dhe është kthyer e ka treguar çfarë bëhet atje? Asnjëri gjer sot. Të gjitha këto janë përralla të kurdisura nga priftërinj e hoxhallarë, të cilat sot nuk i ha më njeri, bile as shumica e pleqve të moçëm.

Mejithatë, e kaluara te disa nga këta ka lënë një varg njollash të errëta dhe u duket si çudi, për shembull, të mos mbajnë ramazan. Po ç'e do njeriu ramazan zinë, ç'të mirë i ka sjellë ai në jetë? Përse një muaj të tërë të mos hajë bukë ditën, po vetëm natën? Të mos hash bukë ditën do të thotë të mos kesh forca, pra të mos jesh në gjendje të punosh. Pastaj natën nuk hahet, pse e natyrshme është që njeriu të hajë para se të vejë në punë, domethënë ditën. Të gjitha këto rregulla që ka vënë feja, kanë pasur qëllime të djallëzuara.

Po bajrami dhe pashkët ç'janë? Janë festa fetare të lidhura me disa gjëra që nuk janë të vërteta. «Po gëzojmë me rastin e tyre», thonë disa. Ne sot kemi festat kombëtare dhe ditët përkujtimore tonat, si festën e Çlirimit, përvjetorin e themelimit të Partisë, Ditën e Dëshmorëve, ditën e vrasjes së Bajram Currit, ditën e çlirimit të fshatit, të rrethit etj., që janë bërë ngjarje të shënuara historike frymëzuese për të gjithë punonjësit tanë, prandaj përse të festojmë festat e turqve, të arabëve ose të popujve të tjerë? Kur përkujtojmë, për shembull, ditën e vrasjes së Bajram Currit, rinia mëson për përpjekjet e këtij burri të madh që luftoi e ra për Shqipërinë. Këtë ngjarje e kthen në një ditë të shënuar dhe jo bajramin apo pashkën, që fundja nuk tregojnë asgjë.

Po Krishti kush është? Në të vërtetë s'ka pasur fare Krisht, as që ka rrojtur kurrë një njeri i tillë. Edhe atë e kanë kurdisur. Pastaj rreth fesë janë krijuar kanunet, zakonet, ligjet e vjetra, të shkruara e të pashkruara, zbatimi i të cilave linte përshtypjen sikur i lidhte, i forconte, i bënte shoqërinë dhe familjen më të bashkuara, po as kjo nuk është e vërtetë. Përkundrazi, këto ligje e kanune dobësonin unitetin në familje, ku lulëzonin shtypja dhe skllavëria. Skllavja kryesore, pa asnjë të drejtë, ishte gruaja, e cila mund edhe të vritej nga burri. Ishte e drejtë kjo? Në asnjë mënyrë, bile qe shumë barbare. Ja, pra, të tilla ishin kanunet, zakonet dhe ligjet e vjetra, prandaj Partia u vuri dërmën dhe i shkatërroi.

Megjithatë shumë mbeturina ekzistojnë akoma, të cilat shfaqen herë pas here. Prandaj ne të moshuarit,

sidomos, duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për t'i zhdukur, që të mos u transmetohen të rinjve. Partia dëshiron dhe punon që ata të rriten të lirë, të pastër e të ndërgjegjshëm. Ajo na mëson të bëjmë përpjekje t'i edukojmë, t'u japim atyre në çdo rast shembullin e mirë, që të shohin te ne njerëz me të vërtetë të dashur, të drejtë, të gatshëm për t'i ndihmuar ata, si dhe gratë e vajzat, të ecin përpara.

Po për ndershmërinë, është e vërtetë që burri ruan nderin e gruas? Partia dhe jeta na mësojnë se gruaja e ruan vetë nderin e saj. Bile mund të themi se gratë, në përgjithësi, janë më të ndershme se burrat. Këtë e vërtetojnë ngjarjet e jetës së përditshme. Te gruaja shqiptare ne shohim një ndershmëri shumë të madhe. Atëherë nga del se burri qenka më i ndershem se gruaja?

Të kaluarit nga mosha duhet t'i rregullojnë më me kujdes disa «dollapë» që kanë në kokë, t'i spastrojnë ata nga vjetërsirat. Këtë spastrim po e bën dhe do ta bëjë Partia, po veç është e domosdoshme që ata komunistë, të cilët ngarkohen për ta bërë këtë punë me të tjerët, të spastrojnë më parë veten e tyre, pse ndonjë nga ata mban taserën e Partisë në xhep, po në kokë ka «lakra», ka disa pikëpamje jo të drejta, sidomos për gratë, ose i rritet mendja, bëhet fodull, sillet keq me popullin etj. Kur një njeri i paorganizuar në Parti mban një qëndrim të shtrembër ose nuk ka të drejtë për një çështje dhe këto ia vë në dukje një komunist, ai do të mendojë, dhe, në qoftë se vetë komunisti është i ndershem, do t'i thotë këtij: «Mirë e ke, o shok», por në qoftë se edhe komunisti bën të tilla

gjëra, tjetri ka të drejtë t'i thotë të shikojë më parë veten. Pra, që t'i zërë vend fjala, është e domosdoshme që komunisti më parë të japë vetë shembullin kudo dhe në çdo drejtim.

Ju shokë të paorganizuar në Parti mos kini frikë nga ata që bëjnë pjesë në Parti. Mua, për shembull, si komunist, Partia dhe populli më kanë zgjedhur në udhëheqje, mirëpo kjo nuk do të thotë aspak që, po të gaboj, të mos më thotë kush hapur që kështu si po vepron për këtë punë, na duket se e ke gabim. Në rast se vetë ky njeri është në rrugë të drejtë dhe, po të kem një gabim, ma vë atë në dukje, ai patjetër do t'i bëjë shërbim Partisë.

Me këtë dua të them që kur një komunist në fshat bën gabim, ju të tjerët nuk duhet të heshtni aspak, duke u nisur nga pikëpamja jo e drejtë se ky është në Parti, ka fuqinë në dorë dhe mund të bëjë çdo gjë kundër të tjerëve që nuk janë anëtarë partie. Jo, komunistët nuk mund të vihen mbi popullin, përkundrazi, ata duhet të jenë në shërbim të tij. Edhe komunistët e tjerë që janë në pozita të drejta duhet t'i heqin veshin atij, «t'i lajnë kokën», si i themi ndryshe, duke e nxjerrë para popullit, të cilit t'i bëhet e ditur që filani ka bërë këtë ose atë gabim, dhe të kërkohet mendimi i tij. «Të mos e përsëritë më, do të thotë populli, ndryshe do ta dënojmë, bile rëndë», kurse po të punojë mirë, ai tregon me këtë se po ecën drejt. Kështu duhet të bëjmë, motra dhe vëllezër, sepse populli do që Partia të jetë kurdoherë e fortë dhe jo e krimbur për hatrin e njërit, të dy, pesë, dhjetë ose pesëmbëdhjetë vetave, ndryshe nuk kemi si i ruajmë fi-

toret e arritura. Mirëpo Partia dhe populli dëshirojnë dhe luftojnë që jo vetëm t'i ruajnë fitoret, po edhe t'i shtojnë vazhdimisht. Gjithë ai lumë i madh gjaku nuk u derdh që të shkojë kot, por që të lulëzojë atdheu, që populli të rrojë i lumtur përgjithmonë. Pse vepron kështu, pse këto gjëra i shikon drejt, prandaj Partia është e fortë si çeliku, ecën kurdoherë përpara dhe populli e do me gjithë shpirt. Kur ndonjë komunist bën gabim, ajo e këshillon ose e kritikon. Në rast se ai e përsërit gabimin, Partia e dënon dhe po të mos vërë mend e të vazhdojë në rrugën që ka nisur, e përjashton nga radhët e saj, pse një njeri i tillë nuk e meriton të jetë komunist, ka me qindra e me mijëra njerëz të tjerë të devotshëm, sidomos të rinj e të reja, që tregojnë zotësi e heroizëm të madh për çështjen e popullit. Njerëz të tillë duhet të kërkonin ju për në Parti, pse kështu kësaj i vjen gjak i ri.

Gjak i ri për Partinë janë edhe gratë, prandaj duhet të vijnë edhe këto në Parti, se kanë një zjarr të madh revolucionar në zemër. Dëgjomëni, motra dhe vëllezër, në qoftë se arrijmë që gratë dhe vajzat të jenë plotësisht të lira, të mësuarat e të guximshme për të thënë fjalën e tyre kudo, pa frikë, pa druajtje, si burrnesha, atë punë që do ta bënim për pesë ose për shtatë vjet, do ta bëjmë me siguri për dy-tre vjet, pse gratë dhe vajzat përbëjnë një forcë kolosale, janë gjysma e Shqipërisë. Kur një grua ose vajzë e zonja zgjidhet brigadiere dhe u bën thirrje shokëve e shoqëve që ka në brigadë: «Në sulm përpara, të spastrojmë arat, të bëjmë kanale, të prashitim misrin, të bëjmë këtë ose atë punë!», të shikoni sa mirë e me ç'shpejtë-

si do të kryhet çdo punë. «Ngrihuni, — do t'u thotë në të ardhmen vajza shoqeve të saj, — të vemi të mësojmë në shkollë, po të jetë nevoja edhe natën, se nga askush nuk kemi frikë. Ne jemi të zonjat të mbrohem vetë, po të na dalë ndonjë i lig përpara që ka qëllim të keq, jo veëm do të na mbrojnë gjithë të tjerët që i kemi vëllezër, por ne edhe vetë jemi në gjendje t'ia shtypim kokën». Ja, kështu do të bëhet. Partia po përgatit e po kalit çdo ditë e më mirë njerëz trima, të guximshëm, patriotë të zjarrtë, punëtorë të palodhur, me etje të madhe për mësim, por edhe të ndershëm.

Është e vërtetë se kur niset tani vajza për në hekurudhë apo në një aksion tjetër, ka prindër që u tronditet një çikë zemra dhe mendojnë kushedi si është atje ku po shkon ajo. Mirëpo prapë ata kanë besim te Partia dhe te vajza e tyre dhe kështu është e vërteta, nuk mund t'i ngjasë sot diçka e ligë një vajze, por veç merakun prindërit e kanë. Sidoqoftë ka rëndësi të madhe vajtja e vajzës në një aksion, si për shembull në hekurudhë, ku mund të punojë një muaj, një muaj e gjysmë etj. Ndonjëra mund të shkojë të luajë edhe me top me shoqe e me shokë, të merret me atletikë, të marrë pjesë në një kampionat etj. Ne kemi besim te vajzat e gratë tona, pse janë të zonjat dhe mund e duhet të venë kudo. Tani kanë ndryshuar kohët, kudo që venë ato, në aksion, në sport, në shkollë, në kurs etj., Partia kujdeset dhe i mbron, pastaj atje ato gjejnë shoqe të mira e të pjekura që i kanë nën kujdes dhe i edukojnë. Prandaj kthehen në familje më të edukuara, më të përgatitura e më të pjekura.

Po lidhur me martesën ç'ndodh tash? Partia këshillon që, para se të vendosin të martohen, djali dhe vajza të njihen. Edhe te ju kështu duhet të ndodhë. Ne nuk mund të veprojmë si në kohën e prindërve tanë, kur vajzën e martonin me anën e ndërmjetësve «si derri në thes», pa e parë kurrë shokun e ardhshëm të jetës. Prandaj çupa le ta gjejë vetë shokun e jetës, ashtu sikurse djali le ta gjejë vetë vajzën me të cilën do të martohet. Detyra jonë është t'i ndihmojmë dhe t'i edukojmë mirë më parë, që kur t'u vijë koha për fejesë, vajza apo djali të jenë në gjendje të gryojnë që bashkëshorti i ardhshëm që do të zgjedhin, të jetë njeri i ndershëm, punëtor, të mos ketë ndonjë pjesëtar të familjes tradhtar, të dojë Partinë dhe atdheun. Këto janë cilësitë kryesore që duhet të shohin ata te njëri-tjetri, pa është i bukur a s'është i bukur, i gjatë apo i shkurtër, kjo është puna e tyre. Ne dëshirojmë, dhe këtë ua këshillojmë gjithë të rinjve e të rejave, që të na pyesin edhe ne prindërit para se të vendosin, pse ne kurrë nuk ua duam të keqen. E rregullt është që çupa, fjala vjen, para se të vendosë të fejohej, t'i pyesë prindërit, t'i vërë në dijeni se ajo dëshiron të fejohej me një djalë dhe të kërkojë me këtë rast mendimin e tyre. Po qe djali i mirë, prindërit duhet të gëzohen e t'i thonë: «Merre, vajzë, qofsh shëndoshë dhe e lumtur e u trashëgoft me të!». Kjo është rrugë e drejtë e Partisë. Por ka edhe ndonjë të ri që ka qëllime të këqija. Njerëzve të tillë u duhet rënë në kokë. Partia këshillon që marrëdhëniet midis të rinjve e të rejave të jenë të nderhme e të sinqerta.

Më duket sikur ju mërzi (të gjithë thonë njëzëri:



«Jo, aspak, vazhdoni, shoku Enver!», prandaj, duke përfunduar, dëshiroj t'ju them se vizitat që po bëj këtu në Has dhe në rrethin e Kukësit (se dje, veç mitingut, shkova edhe në Uzinën e Shkrirjes së Bakrit, kurse sot, duke ardhur për këtu, u takova me ushtarët dhe me oficerët e një reparti ushtarak, vizita këto që na ndihmuan shumë mua dhe shokët e mi), na kanë gëzuar shumë. Ne pamë se kudo janë ndërtuar objekte të shumta, në çdo vend vërehen përparime.

Në radhë të parë ne pamë popullin të gëzuar dhe me një besim të madh te Partia. Si kudo, edhe te ju, çdo njeri, pasi i kupton direktivat e Partisë, bën përpjekje të mëdha që t'i zbatojë në jetë. Ne jemi shumë të gëzuar kur shohim që patriotizmi i masave popullore të rrethit të Kukësit është i madh. Kjo ka rëndësi vendimtare, pse me një patriotizëm kaq të zjarrtë do të realizohen me sukses të gjitha detyrat që na ka vënë përpara Partia. Kemi bindjen e plotë se populli i rrethit të Kukësit, si gjithë populli shqiptar, e do me kokë Partinë dhe e mbron, pse ajo është në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, revolucionare, në rrugën e popullit, prandaj ky i dëgjon me etje të madhe dhe i zbaton me vendosmëri mësimet e saj. Kështu ndodh edhe në Has, si në të gjithë rrethin tuaj. Për këtë arsye ne gëzohemi shumë kur dëgjojmë dhe mësojmë se si realizohen me sukses planet te ju.

Ju sigurojmë se vendimet që kanë marrë Partia dhe Qeveria për rrethin tuaj, dhe veçanërisht për krahinën e Hasit, do t'i zbatojmë, bile ato do t'i rishikojmë edhe një herë për të parë ç'mundësi të tjera më të mëdha mund të krijohen për ta ndihmuar Hasin në

mënyrë një çikë si të veçantë, që këtu të vëmë në shfrytëzim akoma më shumë toka nga sa kemi vendosur dhe brenda një kohe sa më të shkurtër.

Me këtë rast ju uroj të gjithëve shëndet dhe suksese në punë.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli heroik i Hasit!

Të rrojë rinia!

Dalshi faqebardhë në planet tuaja!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

# POLITIKA E DREJTË E PARTISË DHE PUNA E POPULLIT PO I TRANSFORMOJNË MALET DHE BJESHKËT TONA

*Fjala në mitingun e qytetit Bajram Curri*

**30 maj 1970**

Të dashur shokë dhe shoqe të rrethit të Tropojës,

Çdo njeri mahnitet sa del në Qafën e Luzhës dhe shikon së andejmi madhësitinë e këtyre bjeshkëve, të cilat duket sikur thonë: «Ja, i tillë si malet e Shkëlzenit ka qëndruar në shekuj populli shqiptar, madhështor, gjigant, i pamposhtur e ballëlart. Ai u ka bërë kurdoherë ballë stuhive, ka çarë furtunat e kohëve, duke mposhtur armiqtë që donin ta robëronin, dhe u ka dhënë atyre mësimin e madh se nuk është skllav». Pikërisht në këto bjeshkë të larta me pllaja të bukura e plot livadhe të gjelbëruara, që gjatë dimrit mbuloohen me borë, rron dhe lufton për socializmin një popull i mrekullueshëm, me njerëz të gjatë nga shtati, me zemër të fortë e me mendje të kthjellët.

Edhe unë, si gjithë të tjerët, kurdoherë që kam ardhur këtu, e kam ndier menjëherë forcën tërheqëse

mahnitëse të njerëzve të rrethit tuaj, prandaj i këshilloj të gjithë që ta vizitojnë Tropojën, këtë skaj të largët malor të atdheut, me bukuri kaq të rralla natyrore, ku jetojnë njerëz të nrekullueshëm si ju, ku po zhvillohen me sukses bujqësia e blegtoria dhe ku punonjësit e Shqipërisë së re, me mendjen e tyre të zgjuar, do të zbulojnë me siguri në të ardhmen thesaret e çmueshme të nëntokës.

Njeriu ka ndjenja dhe këto ka dëshirë t'ua shprehë të dashurve të zemrës. Edhe unë dëshiroj t'ju them juve sa shumë jam i gëzuar që ndodhem përsëri këtu, për të marrë takim me popullin e Tropojës, që ka ardhur sot nga të gjitha anët e rrethit, dhe t'ju sjell të gjithë juve përshëndetjet më të nxehta të Partisë, të Qeverisë dhe të miat, t'ju uroj nga zemra shëndet, energji dhe punë të mbarë e të frytshme për të mirën tuaj dhe të mbarë atdheut.

Kurdoherë që kam ardhur këtu, ashtu edhe kur kam pasur rast të piqem e të bisedoj me tropojas gjatë punës në Tiranë, kam parë në fytyrat e në sytë tuaj të ndritshëm, që pasqyrojnë ndjenjat e zjarrta të zemrës, njerëz të gëzuar e të guximshëm. Edhe sot unë po shoh sa i madh është gëzimi juaj, gjë që shpreh dashurinë e thellë dhe besnikërinë tuaj të patundur ndaj Partisë sonë, pse, si gjithë populli shqiptar, një Parti të tillë trimëreshë kishit ëndërruar edhe ju gjatë luftërave kundër robërisë, kundër shfrytëzimit dhe errësirës shekullore.

Liria e këtyre bjeshkëve, ku keni lindur e keni jetuar, ka sunduar kurdoherë në zemrat tuaja, prandaj ju u ngritët përsëri të gjithë në këmbë, kur Partia e

komunistëve shqiptarë lëshoi kushtrimin për luftë të armatosur kundër pushtuesve e tradhtarëve të popullit. Gjëmuan përsëri bjeshkët tuaja gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, po kësaj here gjëmimi i tyre u bashkua fort me gjëimin e madh të gjithë Shqipërisë që dërrmoi nazifashistët dhe bashkëpunëtorët e tyre, çliroi atdheun, i hapi rrugën socializmit dhe e bëri vendin tonë një kështjellë të paprekshme, që sot nderohet nga mbarë bota.

Ju e njihni mirë gjendjen e mjeruar në të cilën e kishin katandisur popullin tonë regjimi i borgjezisë, i feudalëve e i bajraktarëve dhe hordhitë e fashizmit. Kujtoni Tropojën e dikurshme, ku lindën dhe luftuan gjyshërit e baballarët, si dhe shumë nga ju që jeni sot këtu. Kujtoni mjerimet e atyre kohëve të zeza, kur njerëzve tanë u mungonte buka e gojës dhe natën nëpër shtëpi u verboheshin sytë nga tymi i pishës, flinin përtokë, duke pasur për jastëk një trung, dhe për të blerë një kilogram kripë apo një shinik me misër u duhej të shkonin larg, deri në Shkodër e në Shëngjin. Kujtoni se si atëherë armiqtë e popullit, pasanikët dhe bajraktarët mbillnin përçarjen dhe hakmarrjen, ndërsa klerikët reaksionarë mbështetnin dhe përhapnin ligjet e egra të kanunit, të shariatit e të ungjillit, që poshtëronin nënat, motrat e vajzat tona dhe mbanin në errësi fshatarët e malësorët trima të Shqipërisë. Këta armiq i thoshin popullit se, sa më shumë të vuan-te në këtë botë, aq më mirë do të jetonte në botën tjetër, që nuk ekziston.

Të gjitha këto të këqija duheshin varrosur njëherë e përgjithmonë nga populli, por ai nuk mund t'i zhduk-

te e t'i varroste përveçse me grykën e pushkës. Këtu qëndron merita e madhe e popullit shqiptar dhe e Partisë së Punës të Shqipërisë, e kësaj partie marksiste-leniniste, që e mësoi popullin se vetëm duke luftuar ai do të fitonte lirinë dhe pavarësinë, se vetëm me luftë e me revolucion do të vinte në fuqi, do të shtypte pa mëshirë klasat shfrytëzuese e të gjithë ata që i kishin marrë nëpër këmbë të drejtat dhe i kishin rrëmbyer lirinë.

Sot, në sajë të revolucionit që bëri populli, i udhëhequr nga Partia, në Shqipëri, që është një vend pa shfrytëzues e pa të shfrytëzuar, zot është populli dhe askush tjetër. Shqipëria është vendi i diktaturës së proletariatit, ku punëtorja dhe aleatja e saj besnike, fshatarësia, bëjnë ligjin, ligjin më të drejtë të njerëzimit.

Pushteti i diktaturës së proletariatit e ka bërë Shqipërinë një vend të bukur. Në radhë të parë, ky pushtet zbukuroi njeriun, e mësoi këtë ta dojë dhe ta transformojë natyrën rreth tij, ta mbushë vendin me uzina, me fabrika e me hidrocentrale, që u kanë vënë fre lumenjve, dhe me sa e sa vepra të tjera që janë të gjitha, fund e krye, pronë e përbashkët e popullit. Gjatë viteve të këtij pushteti moçalet malarike të vendit tonë u kthyen në fusha pjellore e të lulëzuara, ku punojnë traktorët; janë hapur kudo kanale kulluese e ujitëse, tarraca e rezervuarë të panumërt; fshatrat u kolektivizuan, njerëzit kudo rrojnë dhe punojnë në unitet si në një familje të madhe dhe për një qëllim të madh të përbashkët. Pushteti ynë popullor, krahas zhvillimit me sukses të një industrie të fuqishme moderne dhe bujqësisë e blegtorisë së përparuar, që nga

viti në vit ecin më përpara, ka ngritur në të katër anët e vendit edhe mijëra shkolla fillore, tetëvjeçare e të mesme, Universitetin e Tiranës dhe institute të tjera të larta, spitale e maternitete, vatra e shtëpi kulture, ka ngritur vazhdimisht mirëqenien e punonjësve dhe, për mbrojtjen e fitoreve të popullit, ka organizuar një ushtri të çeliktë, të pajisur me mjetet më moderne, një ushtri me karakter popullor dhe të gatshme në çdo kohë për të mbrojtur atdheun socialist, ku çdo ushtar i republikës është edhe qytetar dhe çdo qytetar është njëkohësisht edhe ushtar.

Tropoja është një rreth malor, por Partia na solli kohë të tilla që ajo sot e siguron vetë bukën. Në rrethin tuaj punojnë tash shumë traktorë, aq sa nuk kishite e gjithë Shqipëria në vitin 1938. Këtu te ju është trefishuar fondi i tokës së punueshme. Në të kaluarën ju prodhoni vetëm misër, bile edhe atë me shumë vështirësi, kurse sot prodhoni edhe grurë, nga i cili merrni mesatarisht në shkallë rrethi 19,3 kuintalë për hektar<sup>1</sup>. Le të krahasohen me ju fushat nga më pjelloret të vendeve revizioniste, ku bujqësia ka zënë të tatëpjetën, ndërsa kooperativizmi është shkatërruar, le të shikojnë revizionistët se si deri këtu, në shpatet e Shkëlzenit, po ndërtohet socializmi i vërtetë nga ky popull trim që udhëhiqet nga Partia, sipas mësimeve të Leninit dhe të Stalinit.

Sigurisht, këto rezultate janë arritur me punën dhe me djersën tuaj. Ju keni ndërtuar këtu kanale, siç

---

1 Në vitin 1983 në rrethin e Tropojës rendimenti i grurit arriti 23 kuintalë për hektar.

është ai i Krasniqes, i Begajt etj., që kanë vënë nën ujë mbi 75 për qind të tokës arë. Rrethi juaj malor është i lidhur tejandanë me rrugë automobilistike. Tash në Tropojë, që nga Dragobia, në Pac e Lekbibaj, në çdo vatër familjare, ndriçon drita elektrike. Nuk ka fshat te ju që sot të mos ketë radio. Në vend të 11 shkollave fillore, me 575 nxënës e 13 mësues që kishte para Çlirimit, sot rrethi ka 85 shkolla, nga të cilat 4 të mesme, me 6 200 nxënës dhe 260 mësues, pa llogaritur afër 800 kuadro me arsim të lartë e të mesëm që po përgatiten në rrethet e tjera<sup>1</sup>. Përparime të mëdha janë bërë në rrethin tuaj. Revolucioni ecën përpara pa u ndalur edhe këtu te ju, si kudo në Shqipëri.

Një nga fitoret më të shquara në mbarë vendin tonë është çlirimi i gruas nga prangat mesjetare të së kaluarës, rritja e personalitetit të saj në familje dhe në punët shoqërore. As që mund të mendohej më parë që gruaja tropojase të zgjidhej deputete, kryetare kooperative, anëtare e këshillit popullor, apo të bëhej arsimtare, mjeke, mami etj. Nuk ndodhte më parë që me mijëra gra e të reja të niseshin në aksione apo për të ndjekur kurse, ose që grupe të tëra vajzash e grash të shkonin e të miqësoheshin me motrat e me vëllezërit e tyre në Jug e pastaj të ktheheshin që andej më të zonja e më të gëzuara, duke u bërë kështu iniciatore të zjarrit për përparimin e fshatrave të tyre. Sa e sa paragjykime e zakone prapanike janë përmbysur në

---

<sup>1</sup> Vetëm gjatë vitit shkollor 1983-1984 nga rrethi i Tropojës studiojnë në shkolla të mesme e të larta 2 094 nxënës e studentë.



familje e në jetë këtu te ju! Kudo po zënë vend çdo ditë e më shumë mendimet e reja, po futet kultura socialiste. Njeriu i ri i socializmit po kalitet me norma të reja të moralit komunist, si në gjithë rrethet e tjera, edhe këtu në Tropojë.

Të gjitha këto suksese të mëdha ju i keni arritur nën udhëheqjen e Partisë, e cila diti të kuptojë, të vërë në lëvizje e të ngrejë në një shkallë më të lartë virtytet e çmuara që ju keni trashëguar nga e kaluara, t'i gërshetojë këto si duhet me të sotmen e me të ardhmen. Partia ka brumosur brezin e ri me trimërinë, me burrërinë, me shpirtin e pastër dhe me mikpritjen tradicionale të malësorëve, kurse me mençurinë e tyre të mprehtë ajo diti të zhvillojë më tej te të rinjtë e të rejat tona diturinë dhe vullnetin e hekurt, që çojnë çdo gjë përpara.

Meqë jemi mbledhur sot këtu në këtë vend të lashtë plot me ngjarje historike, nuk mund të mos na shkojë mendja tek ai burrë i shquar, emrin e të cilit mban ky qytet krejt i ri i socializmit, te shqiponja e maleve, patrioti dhe revolucionari, Heroi i Popullit Bajram Curri. Bacë Bajrami e ka dashur dhe e ka shkelur këtë vend pëllëmbë më pëllëmbë. Qysh 60-70 vjet më parë, në krye të malësorëve trima, ai luftoi si dragua për lirinë dhe për pavarësinë e Shqipërisë kundër pushtuesve osmanë, kundër serbomëdhenjve, kundër dallavereve e intrigave të fuqive imperialiste që synonin skllavërimin dhe copëtimin e atdheut tonë. Bajram Curri që nga të parët në Shqipëri që çmoi veprën e madhe të Leninit e të bolshevikëve në Rusi dhe përsëndeti fitoren e Revolucionit të Tetorit, i cili hapi

një epokë të re në historinë e njerëzimit, epokën e revolucioneve proletare dhe të fitores së socializmit. Ai u kacafyt e u përlesh me forcat kundërrevolucionare të satrapit Ahmet Zogu, derisa dha edhe gjakun e jetën e tij midis këtyre maleve kreshnike, për të ardhmen e ndritur të Shqipërisë.

Të tjerë patriotë, si Ninan Sula, Sali Mani, Haxhi Zogu, Gjelosh Rama e të tjerë ndoqën rrugën e tij, luftuan me trimëri kundër armiqve të vendit. Gjaku dhe përpjekjet e Bajram Currit e të bijve të tjerë të Tropojës nuk shkuan kot. Në Luftën Nacionalçlirimtare Partia ngriti në këmbë tërë popullin. Thirrjes së saj, ashtu si mbarë populli shqiptar, iu përgjigjën edhe fshatarët malësorë të Tropojës, të cilët, më 28 gusht 1943, organizuan mbledhjen historike — Kuvendin e Malësisë së Gjakovës — tek ura e Kolgecajt, ku dhanë besën e vendosën njëzëri të hidheshin të gjithë në luftë kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit gjer në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Atdheu nuk do t'i harrojë kurrë trimëritë e partizanëve të rrethit të Tropojës, të cilët, të inkuadruar në çetën «Emin Duraku», në batalionin «Bajram Curri», në Batalionin e Rinisë e më vonë në Brigadën XXV Sulmuese, e cila u formua në rrethin tuaj, luftuan heroikisht bashkë me partizanët e tjerë për çlirimin e gjithë krahinës, gjer në Gjakovë, në Pejë, në Prizren e thellë në Jugosllavi. Vëllezërit tanë kosovarë panë me sytë e tyre se si u shkuan në ndihmë për çlirimin nga pushtuesit nazifashistë bijat dhe bijtë e Bajram Currit e të Partisë Komuniste Shqiptare.

Atdheu nuk do të harrojë kurrë gjakun e derdhur

nga dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare, si Jaho Sali Mani, Murat Paci, Islam Fazlliu, Mushak Kadri Emini, Ukshin Rustemi, Haxhi Avdyli, Haxhi Paci e të tjerë, si edhe të dëshmorëve të pasçlirimit. Vepra dhe kujtimi i tyre do të rrojnë në zemrat tona përjetë dhe do të na frymëzojnë në betejat për fitore të reja.

Të dashur shokë dhe shoqe të Tropojës,

Rrethi juaj është malor, por duhet të zhduket krejtësisht nga mendimi i njerëzve pikëpamja se malësitë nuk kanë perspektivë zhvillimi ekonomik e kulturor. Kjo është një pikëpamje e gabuar, jomarksiste. Kështu mendojnë vetëm kapitalistët dhe revizionistët, të cilët i përqendrojnë të gjitha përpjekjet atje ku fitimet janë më të mëdha për veten e tyre dhe jo për popullin. Ata i kanë braktisur vendet malore. Zhvillimi i bujqësisë, i blegtorisë, i arsimit dhe i kulturës për interesat e popullit, është kujdesi i tyre më i fundit. Politika që ndjekin kapitalistët dhe revizionistët synon zbrazjen e zonave malore nga popullata, hedhjen e saj në papunësi ose kthimin e kësaj pjese të popullit në një rezervë grevëthyesish. Në një pjesë të madhe të popullsisë së shumë vendeve kapitaliste e revizioniste, që quhen të përparuara, mbretëron analfabetizmi, përdoret për ndriçim pisha ose llamba me vajguri, mungojnë shkollat, kurse meshkujt largohen me shumicë nga vendet e tyre që në moshë shumë të re. Kapitalistët dhe revizionistët i përdorin si mall tregu këta njerëz që emigrojnë, i shpërndajnë në të gjitha vendet e

tjera, ku i shfrytëzojnë si skllëvër. Dhe me këtë mburrën se po u rritet popullsia e qyteteve, se gjoja në vendet e tyre po rritet numri i punëtorëve të industrisë, ndërsa në fshatra, pra në bujqësi, popullsia zvogëlohet. Me të gjitha këto kapitalistët dhe revizionistët përpigën t'u krijojnë njerëzve përshtypjen e rreme sikur industria në vendet e tyre po zhvillohet në përpjesëtime të mëdha dhe, si rrjedhim, rritet edhe mekanizimi i bujqësisë. Por e vërteta qëndron ndryshe dhe pikërisht siç e përmenda pak më lart.

Politika e Partisë sonë është në kundërshtim të plotë me politikën ekonomike kapitaliste. Partia e ka shumë të qartë vijën e saj në lidhje me zonat malore: «T'i bëjmë malet po aq pjellore sa edhe fushat». Kjo nuk është një formulë e thjeshtë. Vetë jeta te ne ka treguar se socializmi, politika e drejtë e Partisë, puna e organizuar dhe mendja e popullit po i transformojnë malet dhe bjeshkët tona në toka pjellore. Për këtë çështje, siç e dini, Partia ka bërë shumë punë dhe ka marrë një sërë masash për të favorizuar në mënyrë të veçantë kooperativat e zonave malore. Që të zhvillohen edhe këto me ritme të shpejta, janë caktuar kredi të posaçme për bujqësinë e blegtorinë dhe për mekanizimin e tyre, për farëra të zgjedhura e për raca të mira bagëtish me prodhimtari të lartë. Këto masa favorizuese tashmë kanë filluar të zbatohen në shkallë të gjerë dhe çdo vit ato do të vijnë vazhdimisht duke u shtuar. Gjatë zbatimit të planit të ri pesëvjeçar, që është duke u përgatitur, do të shkojnë akoma më përpara këto përpjekje të mëdha që po bëjnë Partia

dhe populli për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë së zonave malore.

Partia na mëson se çdo sukses arrihet me punë, me dituri dhe me organizim. Në të tri këto drejtime po bëhet kudo një punë e madhe dhe po thyhen shumë koncepte të vjetruara të së kaluarës, pse nuk mund të qëndrohet në vend. Janë krijuar mundësitë të kalohen rekorde, të lihen mënjanë format e vjetra të punës dhe të zëvendësohen ato me forma të reja që japin rezultate më të mëdha.

Në çdo rreth malor, dhe veçanërisht këtu në Tropojë, janë bërë e do të vazhdojnë të bëhen studime për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë e të blegtorisë. Çdo vendim që zbatohet, çdo rezultat që arrihet, duhet të bëhet objekt i një sërë konkluzionesh për masa të mëtejshme organizimi e veprimi nga punonjësit dhe nga Partia. Kujtdo, siç thotë populli, duhet t'i pjellë dhe jo t'i flerë mendja, t'i lëvizin këmba e dora, çdo njeri duhet të udhëhiqet nga mendimi krijues. Është e domosdoshme t'i lihet fushë e gjerë iniciativës krijuese të masave, e cila nuk duhet penguar me barrikadat e kota të burokratizmit ose të mbeturinave tradicionale. E them këtë, sepse në rast se ne do të shkonim sipas traditës, sipas së cilës në Tropojë nuk bëhet gruri, atëherë nuk do të qe e mundur që në kooperativën bujqësore të Margegajt për dy vjet me radhë të merrshin nga 30 quintalë grurë për hektar, siç u morën. Po të gjykonim sipas traditës, në kullotat e këtyre bjeshtëve do të mbaheshin vetëm bagëti të imëta.

Për vendin tonë ka rëndësi që zonat malore të mos shpopullohen, pse janë të gjitha mundësitë që edhe

në to të bëhet një jetë e mirë dhe e begatshme. Por faktori vendimtar që krijon të mirat materiale për jetesën është njeriu, i cili i siguron ato me punën dhe me mendjen e tij, prandaj edukimit të njeriut t'i vëmë kujdes të veçantë. Duhet të bëjmë akoma shumë që te të rinjtë e të rejat të ngjallet dashuria e madhe për bujqësinë, për blegtorinë, për kooperativat dhe për punën në të gjithë këta sektorë kaq të rëndësishëm të ekonomisë. Ashtu si gjer tani, bile edhe ca më tepër, duhet të bëhen përpjekje që të përmirësohen çdo vit e më mirë të gjitha kushtet e jetesës, për një jetë të begatshme e të kulturuar për anëtarët e kooperativave tona malore, që ata ta ndiejnë veten të lumtur e të gëzuar me punën që bëjnë në kooperativë.

Ne po shohim me kënaqësi se kultura dhe arsimi në kooperativa kanë marrë kudo zhvillim të madh. Drita elektrike që tashmë ju ka ardhur në çdo fshat, në të ardhmen do ta zhvillojë më tej përparimin në fshatin tonë malor, për arsye se, përveç radios dhe televizorit, në jetën e përditshme të familjeve kooperativiste do të futen gradualisht, me zhvillimin e pandërprerë të industrisë, orendi e sende të tjera shtëpiake, që do ta bëjnë më të këndshme jetën e kooperativistëve. Pra, ashtu siç thotë Partia, ne jemi duke ecur drejt ngushtimit të dallimeve midis qytetit e fshatit dhe kështu kushtet e jetesës të fshatit tonë të ri kooperativist do të afrohen përherë e më shumë me ato të qytetit.

Për zhvillimin me hapa më të shpejtë të ekonomisë sonë është e domosdoshme që në çdo rreth të marrin pjesë në planifikimin ekonomik të gjitha masat

punonjëse, të cilat të studiojnë me vëmendje e me kujdes të madh mundësitë e shfrytëzimit maksimal të të gjitha burimeve ekzistuese, sidomos të tokave. Kur fola pak më parë për bimët tradicionale që është bërë zakon të mbillen te ne, pata parasysh se kjo është një eksperiencë e fituar, të cilën duhet ta zhvillojmë më tej dhe të shkojmë drejt specializimit. Por specializim, mendoj unë, nuk do të thotë vetëm të braktisësh një lloj bime dhe në vend të saj të mbjellësh një tjetër, por të harmonizosh mundësitë e pjellshmërisë së tokës, që kësaj duhet t'i krijohen për ato lloje që mbjellim, për të cilat duhen zgjedhur farëra nga më të mirat, që duhet t'u bëjmë shërbimin më të përsosur. Përveç kësaj, në planet tona të kemi parasysh të futen pa druajtje edhe lloje të tjera bimësh shumë të nevojshme për ushqimin e njerëzve, po kështu edhe për ushqimin e bagëtive, jo vetëm të rrethit, por edhe për nevojat e përgjithshme të republikës. Rrethi, gjatë punës për hartimin e planit të vet, duhet të ketë kurdoherë parasysh jo një zhvillim të fjetur, si me thënë, të ekonomisë së tij dhe të kënaqshëm për vetveten, por një zhvillim të madh me përpjesëtime të gjera të ekonomisë për plotësimin e nevojave të tij dhe të mbarë vendit.

Ju, për shembull, nuk duhet të kënaqeni që Trovoja tash e bën bukën. Natyrisht, ky është një sukses i madh kur mendojmë të kaluarën, por ju duhet të luftoni që jo vetëm ta realizoni, por edhe ta tejkaloni prodhimin e drithërave tej nevojave të rrethit. Kjo do të arrihet me punë të palodhur dhe me përpjekje, bile të synoni që këtë detyrë ta realizoni në një sipërfaqe

toke më të vogël me tejkalimin e vazhdueshëm të rendimenteve. Për ç'arsye duhet t'i bëjmë të tilla përpjekje? T'i bëjmë, pse duhet të mendojmë për zhvillimin në një shkallë akoma më të lartë edhe të blegtorisë, e cila, siç e dimë, jep prodhime të bollshme vetëm kur kafshëve u jep të gjitha ushqimet për të cilat kanë nevojë, prandaj për sigurimin e tyre të lëmë edhe një fond të caktuar toke. Duhet ta braktisim pikëpamjen e vjetër, sipas së cilës ne mbajmë vetëm bagëti të imëta, që verës, kur i çojmë në bjeshkë, dhe sidomos gjatë periudhës së dimrit, nuk u japim sasinë e nevojshme të ushqimit. Një pikëpamje e tillë nuk na lejon ta zhvillojmë blegtorinë, lëre si racë, po as si numër; ajo na pengon të sigurojmë prodhimet që dëshirojmë të marrim, për të cilat populli ka aq shumë nevojë.

Ne gjithashtu duhet të zhdukim pikëpamjen pa asnjë bazë se gjoja në rrethin malor të Tropojës lopët nuk rriten. Partia është e bindur se këto edhe këtu te ju mund të rriten, bile edhe ato të racave të njohura si më pjellore, pse në botë ka vende edhe më malore nga këto tuajat që rritin lopë me famë, të cilat japin rendimente të larta.

I kemi ne vallë mundësitë të ecim në këtë rrugë? Po, i kemi, bile çdo vit po na krijohen gjithnjë e më shumë mundësi. Pastaj vetë eksperiencia e rrethit tuaj vërteton se lopa mund të zhvillohet për bukuri këtu dhe jo vetëm për mish, por edhe për qumësht. Në Currajn e Epërm, për shembull, që është 800 metra mbi nivelin e detit, nga tufa e lopëve të përmirësuara kanë marrë, qysh në laktacionin e parë, 1 500 litra qu-



mësht për kokë. E njëjta gjë ndodh edhe në Bujan, ku u morën 1 320 litra qumësht për çdo lopë foragjere me regjim stallor. Te ju ka edhe shumë shembuj të tjerë të mirë si këta që përmenda.

Perspektiva, pra, është e tillë që edhe këtë objektiv ne ta realizojmë me punë, si këtu në Tropojë, ashtu edhe në të gjitha rrethet e tjera malore, ku duhet të krijojmë tufa lopësh prodhuese, nga të cilat të marrim mbi 2 000 litra qumësht për kokë. Kur të arrijmë këtë rezultat, bile në një perspektivë jo të largët, atëherë krijojmë mundësi që të ngremë edhe këtu, në mes këtyre maleve që kundërmojnë erë të këndshme barërash ushqyese, fabrika për prodhim djathi e gjalpi të llojeve të ndryshme, ashtu siç kanë ngritur edhe në vende të tjera të botës.

Për të krijuar një ekonomi të shëndoshë kooperativiste, është e domosdoshme që bujqësinë dhe blegtorinë t'i lidhim ngushtë me njëra-tjetrën, të mos i shikojmë si dy sektorë të shkëputur. Bujqësia pa blegtorinë as që mund të ecë përpara e të zhvillohet, por edhe blegtoria pa bujqësinë ngec në vend. Prandaj na vihet detyrë që kudo ku ka mundësi — dhe këto mundësi ne duhet t'i shfrytëzojmë gjer në fund — të hapen toka të reja, të punohen si duhet ato, të shfrytëzohen në maksimum të gjitha burimet ekzistuese për ujitje, të punohet për ngritjen në një nivel më të lartë të teknikës së ujitjes, të zhvillohen me kujdes të madh eksperimentet tekniko-shkencore në bujqësi e në blegtori, të zgjidhen farërat, duke bërë një punë shkencore serioze për përmirësimin e tyre etj. Ja, kjo është rruga që duhet të ndjekim për zhvillimin e shpejtë të

bujqësisë sonë socialiste, si në Tropojë, ashtu edhe në të gjitha rrethet e tjera malore.

Këto orientime të drejta që na ka dhënë Partia, natyrisht, duhet t'i kuptojmë thellë në përbërjen e vet, në radhë të parë, t'i zbërthejmë drejt dhe pastaj të organizojmë sa më mirë punën për vënien e tyre plotësisht dhe sa më shpejt në jetë. Por të gjitha këto që thashë nuk mund të arrihen pa punë, këtë duhet ta kemi mirë të qartë. Në rrethin tuaj ka shumë kooperativistë që punën e kanë në gjak dhe nuk përtojnë të dalin për të hapur toka të reja e kanale, për të grumbulluar pleh e për të ndërtuar rrugë, deri edhe në paicën e dimrit të egër të krahinës suaj malore, siç bënë, për shembull, kooperativistët e lokalitetit të Lekbibajt. Ka te ju kooperativistë që jo vetëm realizojnë normën e ditëve të punës, por edhe e tejkalojnë atë. Edhe Heroi i Punës Socialiste Shaban Rexhë Hajdarmataj në kooperativën bujqësore të Zogajt të rrethit tuaj, megjithëse i ka të dyja këmbët të prera, realizon mbi 300 ditë-punë në vit. Kuptimi i lartë revolucionar që ka për punën dhe për detyrat ndaj shoqërisë, e bënë të renë Mire Marku<sup>1</sup> të kryejë si duhet detyrën si zëvendëssekretare e organizatës-bazë të Partisë të zonës së Lekbibajt, të jetë brigadiere e dalluar në kooperativën e Shëngjergjit dhe njëkohësisht të studiojë, ose Ilez Isuf Seçin nga Bujani që të marrë rendimente rekord prej 168 kilogramë qumësht nga çdo dhi. Këta njerëz me një ndërgjegje të lartë në punë, për

---

<sup>1</sup> Kjo shoqe është zgjedhur sekretare e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tropojës.

të cilën janë për t'u lavdëruar, ndodhen këtu midis jush.

Por, motra dhe vëllezër të Tropojës, Partia u thotë njerëzve si të mirat, ashtu edhe të metat e tyre. Unë jam i bindur se ju nuk do të ma merrni për të keq që po ju them se realizimi i ditëve të punës në kooperativat tuaja nuk është në atë nivel që e kanë rrethet e tjera. Vallë nuk keni mundësi ju të ecni në shembullin e njerëzve të përparuar të rrethit, ose të arrini e bile të tejkaloni nivelin mesatar të ditëve të punës që realizohen në rrethet e tjera? Sigurisht që këto mundësi i keni. Ata që përmenda pak më parë, bijtë dhe bijat tuaja, vëllezërit e motrat tuaja, janë një shembull i madh frymëzimi për të gjithë. Prandaj që të gjithëve, burra e gra, të rinj e të reja, me patriotizmin e lartë socialist që ju karakterizon, Partia ju thotë: Ndiqni shembullin e më të mirëve, organizoni punën ashtu si ata, e kontrolloni atë punë që bëni dhe zbatoni deri në fund detyrat që ju ngarkohen!

Dëshiroja të shtoja me këtë rast edhe diçka. Përparimi i kooperativave të zonave malore, dhe i atyre të rrethit të Tropojës në mënyrë të veçantë, përveç zhvillimit të degëve kryesore të ekonomisë kooperativiste, për të cilat fola, ka mundësi të realizohet në perspektivë edhe në disa drejtime të tjera, siç janë frutat dhe perimet.

Në rrethin tuaj një perspektivë shumë të mirë ka sidomos zhvillimi i pemëtarisë. Kumbullat tuaja kanë një emër të mirë jo vetëm në të katër anët e Shqipërisë, por edhe jashtë saj. Kjo nuk duhet t'ju bëjë të kënaqeni me rezultatin që keni arritur me këtë lloj

frute, pse ky është akoma i vogël, kurse mundësitë janë të mëdha<sup>1</sup>. Pastaj ju duhet t'i vini shumë rëndësi jo vetëm kumbullës, por pemëtarisë në përgjithësi, prandaj mendoni për të mbjellë e për të rritur të gjitha ato pemë frutore që mund të bëhen në kushtet e tokës e të klimës suaj malore dhe, pa humbur kohë, të krijoni fidanishtet që janë parashikuar në plan për të realizuar kështu zhvillimin e mëtejshëm të pemëtarisë.

Ju këtu keni pyje të tëra me gështenja, për të cilat unë jam interesuar shumë herë, pse rrethi juaj është nga më kryesorët e vendit tonë për prodhimin e tyre<sup>2</sup>. Mundet që gabohe, por nga informatat që kam, rezulton se nuk ekziston interesimi i duhur për to. Në këto pyje gështenjash nuk është futur ndonjëherë dora e njeriut për t'i krasitur dhe për t'i pastruar, për t'i përmirësuar e për t'u bërë shërbimet e nevojshme këtyre pemëve që na japin fruta kaq të vlefshme. Do t'ju them një gjë. Çekoslovakët blinin gështenjat e Tropojës dhe i përpunonin në vendin e tyre, ku, pasi i kthenin në ëmbëlsira, i eksportonin në shtetet e Amerikës Latine e deri në Australi, duke i reklamuar si gështenja të vendit të tyre. Dhe shikoni sa fitonin: aq të holla sa na paguanin neve për një kuinal gështenja, ata i nxirrnin vetëm nga disa kuti me gështenja të përpunuara që eksportonin. Do të vazhdojmë t'i lëmë

---

1 Në rrethin e Tropojës deri në vitin 1983 gati ishte katërfishuar numri i rrënjëve të kumbullave.

2 Gjatë vitit 1983 u morën 3,7 herë më shumë gështenja se në vitin 1970.

këto fitime të na ikin nga duart? Jo! Ne duhet t'i përpunojmë vetë gështenjat tona. Në radhë të parë, të prodhojmë kokrra në sasi të mëdha dhe me cilësi të mirë, me pamje të bukur e të shëndetshme. Kjo do të arrihet në rast se ju do të interesoheni vazhdimisht për pyjet e gështenjave, do t'u bëni atyre të gjitha shërbimet që thashë dhe pastaj prodhimet e tyre t'i ruani me kujdes dhe, kur të keni sasi të mjaftueshme e të mirë nga ana cilësore, hapet perspektiva për ngritjen e një fabrike të re në rrethin tuaj.

Edhe gështjen e perimeve duhet të mos e lini në dorën e fundit, pse në rast se nuk tregoni kujdes për to, do të thotë se nuk keni ide të qarta për rëndësinë që kanë për shëndetin e njeriut, për zhvillimin e organizmit të tij. Ky nuk ka nevojë vetëm për bukë, po edhe për mish e për qumësht, ka po aq nevojë edhe për perime. Prandaj duhet të bëni përpjekje që të mbillni sa më shpejt ato lloje perimesh që mund të rriten e të zhvillohen në tokën e në klimën e rrethit tuaj dhe të mos prisni që domatet t'ju vijnë nga Lushnja ose patatet nga Kukësi etj., sepse ato mund të mbillen e të zhvillohen fare mirë te ju.

Zhvillimi i blegtorisë me rendimente të larta, i pemëtarisë dhe i perimeve do të bëjë që edhe në Tropojë të zhvillohet industria. E gjithë kjo punë në perspektivë do të rritë akoma më shumë mirëqenien e punonjësve të rrethit tuaj. Partia dhe Qeveria janë plotësisht të gatshme t'ju ndihmojnë në këto drejtime, vetëm se kërkohet që organet e Partisë dhe të pushtetit në rreth, tërë populli juaj t'i marrin në dorë të gjitha këto probleme, t'i studiojnë në zhvillim, të hartojnë

planet, siç e përmenda pak më parë, dhe pastaj t'i përvishen punës me forca të shumëfishuara për realizimin e tyre.

Të dashur shokë e shoqe,

Socializmi është një rend shoqëror jo vetëm me bazë ekonomike të përparuar, por edhe me superstrukturë të përparuar. Kjo do të thotë që ne duhet ta zhvillojmë revolucionin socialist pa ndërprerje, si në fushën e prodhimit, ashtu edhe në fushat politike, ideologjike, kulturore etj. Pikërisht për këtë arsye Kongresi i 5-të i Partisë, Komiteti Qendror dhe Qeveria kanë marrë shumë vendime të rëndësishme dhe kanë përcaktuar detyra e masa për ta çuar punën përpara në të gjitha frontet. Dhe masat e popullit u janë përgjigjur atyre me gatishmëri të madhe. Kështu shpjegohen forcimi i pareshtur i pushtetit popullor dhe i organeve të tij, lufta me sukses kundër shfaqjeve të burokratizmit, të konservatorizmit, të patriarkalizmit, mbeturinave të së kaluarës dhe ndikimeve të huaja të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Kështu shpjegohet puna e madhe e bërë për emancipimin e gruas, kundër zakoneve prapanike etj., etj.

Por a duhet ndalur këtu dhe a duhet kënaqur me kaq? Në asnjë mënyrë! Ne kemi akoma shumë e shumë për të bërë. Revolucionin ynë, sidomos në lëmin ideologjik e kulturor, duhet forcuar, duhet zgjeruar e duhet thelluar më tej. Duhet forcuar pushteti popullor, lufta kundër koncepteve dhe zvarritjeve burokratike të pu-

nëve, në mënyrë që çdo detyrë në industri, në bujqësi, në tregti, në arsim, në kulturë etj. të kryhet shpejt, mirë dhe në përputhje të plotë me interesat e popullit, të atdheut e të socializmit. Por duhet luftuar më tej edhe për ngritjen ideologjike e kulturore, për t'u pajisur me mendimet e me idetë revolucionare të Partisë, me botëkuptimin marksist-leninist, për të çrrënjësuar çdo paragjykim e mbeturinë të së kaluarës, çdo konservatorizëm e ndjenjë patriarkalizmi. Sidomos në drejtim të emancipimit të plotë të gruas është e nevojshme të punojmë të gjithë më shumë.

Gruaja, që përbën më shumë se gjysmën e popullsisë, është një forcë e tillë kolosale, pa të cilën nuk mund të ecet asnjë hap përpara drejt komunizmit. Ja pse ajo duhet të gëzojë të gjitha të drejtat, të shkruara e të pashkruara, në punë, në shoqëri e në familje. Ja pse burri duhet të luftojë dorë për dorë me të në punë, në shtëpi e jashtë saj, si i barabarti me të barabartën. Nuk mund të quhet e lirë gruaja vetëm pse punon dhe i siguron vetes të ardhurat, pse burri i bën ndonjë punë të vogël në shtëpi, pse ndonjë prej tyre mund të zgjidhet në kryesi, pse ndonjë vajzë merr pjesë në grupin artistik. Ato duhet të marrin pjesë në punë e kudo njëjloj si burrat e djemtë.

Po kështu është e nevojshme të luftohet për të përmirësuar gjithnjë e më shumë mënyrën e jetesës së kulturuar, për të futur kudo higjienën e pastërtinë, për të shfrytëzuar institucionet socialkulturore të ngritura në fshat, për të bërë kurat e mjekimet e nevojshme sipas këshillave të mjekëve, për të frekuentuar spitalet, ambulancat e maternitetet. Në të gjitha këto

drejtime një rol të madh duhet të luajnë vazhdimisht organizatat e Frontit, të gruas e të rinisë dhe arsimtarët tanë, të cilët janë përçues revolucionarë të vijës së Partisë në fshat. S'ka dyshim se, duke vepruar kështu, ne do të ecim gjithnjë e më përpara.

Të dashur shokë e shoqe,

Në sajë të punës e të kujdesit të vetë popullit dhe të Partisë, Shqipëria është bërë një shkëmb graniti i pamposhtur i socializmit në brigjet e Adriatikut. Ajo, nën udhëheqjen e Partisë, mban lart flamurin e luftës kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me tradhtarët sovjetikë në krye. Ne kemi shumë miq e shokë të fortë në botë. Me ne janë të gjithë popujt revolucionarë e forcat marksiste-leniniste, që rriten e forcohen nga dita në ditë në luftë kundër armiqve të përbashkët.

Në situatën ndërkombëtare revolucionare që ekziston në botë, imperialistët, revizionistët dhe reaksionarët po pësojnë disfata të mëdha, të brendshme e të jashtme, politike, ekonomike dhe ushtarake. Për të dalë nga kjo situatë ata thurin komplete e krijojnë vatra të reja agresioni, siç kanë bërë në Vietnam, në Laos, në Çekosllovakia e gjetkë, siç bënë tani së fundi imperialistët amerikanë në Kamboxhia. Kjo tregon jo forcën, por dobësinë e tyre, tregon se atyre po u vjen fundi. Gruashti i fuqishëm i popujve do t'i shpartallojë planet e tyre dhe do t'i dërrmojë ata pa u lënë nam e nishan. Në këtë situatë populli ynë po i përmbush me nder



detyrat e tij kombëtare dhe internacionaliste, duke përkrahur luftën e popujve për liri, pavarësi e socializëm. Ne zbatojmë me konsekuencë politikën e mbrojtjes së fitoreve tona socialiste, të lirisë e të pavarësisë së atdheut, prandaj të gjithë, i madh e i vogël, e mbajmë barutin të thatë, jemi ushtarë të revolucionit.

Vendi ynë ndjek politikën e fqinjësisë së mirë, të respektit, të sovranitetit e të mosndërhyrjes në punët e brendshme me të gjitha shtetet fqinje. Politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë është një politikë parimore, që mbështetet në mësimet e marksizëm-leninizmit. Mbi këtë bazë ne kemi vendosur e vendosim marrëdhëniet tona me vendet e tjera, mbi këtë bazë zhvillojmë edhe marrëdhëniet me fqinjen tonë Jugosllavinë.

Pikëpamjet tona për Jugosllavinë dihen dhe i themi botërisht. Ne nuk përzihemi në punët e brendshme të popujve jugosllavë, por nuk e fshehim se midis nesh e udhëheqjes jugosllave ekzistojnë kontradikta të thella e të papajtueshme ideologjike, që e kanë burimin te fakti se udhëheqja jugosllave nuk është marksist-leniniste, përkundrazi, ajo ndjek një vijë revizioniste. Ky është mendimi i Partisë sonë dhe, nëse ne ia lejojmë vetes të drejtën që të kemi dhe ta mbrojmë deri në fund këtë pikëpamje, nuk ia mohojmë askujt, gjithashtu, të drejtën që të ketë mendimin e vet për ne. Prandaj Partia jonë nuk do të heqë dorë kurrë nga polemika parimore ideologjike, por do të luftojë deri në fund kundër çdo pikëpamjeje antimarksiste e revizioniste, e çdo ngjyre qoftë.

Por me Republikën Popullore Federative të Jugo-

sllavisë ne zhvillojmë marrëdhënie shtetërore, si në tregti, ashtu edhe në të gjitha çështjet që kanë një interes reciprok. Ne kemi qenë dhe jemi për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të tilla dhe vullneti i mirë në këtë drejtim as ka munguar, as do të mungojë nga ana jonë edhe në të ardhmen, pse me popujt e Jugosllavisë, siç e kemi thënë dhe e themi vazhdimisht, jemi miq e vëllezër, prandaj dëshirojmë që këto ndjenja të miqësisë që janë kalitur në luftën e përbashkët kundër fashistëve, kur partizanët shqiptarë e ata jugosllavë luftuan së toku, i lidhën plagët shoku-shokut dhe fituan së toku, t'i zhvillojmë në rrugë të drejtë e në interesin reciprok.

Në të njëjtën kohë, ne kemi parasysh se ekzistojnë në imperialistët amerikanë dhe ata sovjetikë, të cilët e kanë halë në sy Republikën Popullore të Shqipërisë dhe komplotojnë vazhdimisht kundër saj. Por ata nuk do t'ua arrijnë kurrë qëllimeve të tyre kriminale, sepse populli ynë gjithnjë i ka sytë hapur dhe gishtin në këmbëz. Këto dy vitet e fundit agresorët revizionistë hrushovianë kërcënojnë Jugosllavinë dhe popujt e saj, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tyre. Popujt e të gjitha kombësive që banojnë në Jugosllavi, në luftën antifashiste kanë luftuar me trimëri dhe me siguri ata do të dinë të luftojnë përsëri e t'i japin përgjigjen e merituar çdo agresori që do të orvatet të cenojë lirinë e pavarësinë e tyre të fituar me gjak e me sakrifica. Populli shqiptar, në rast rreziku, do të jetë përkrah popujve jugosllavë, kundër cilitdo agresor që do të kërcënonte lirinë, sovranitetin dhe pavarësinë

kombëtare të popujve tanë. Dhe agresori duhet të jetë i bindur se jo vetëm nuk na çan e nuk na thyen dot, por në një aventurë të tillë ai do të gjejë vdekjen. Këtë e kemi thënë dhe e themi qartë, pa ekuivoqe dhe hapur. Ky qëndrim yni është parimor.

Siç dihet, në Jugosllavi ka një popullsi të madhe shqiptare. Atje punojnë e jetojnë vëllezërit tanë kosovarë. Do të ishte antimarksiste dhe një tradhti kombëtare në qoftë se ne do ta neglizhonim këtë fakt, në qoftë se nuk do të pyesnim për fatin e tyre. Edhe vetë organi qendror i udhëheqjes jugosllave, gazeta «Borba», pranonte si një të vërtetë të pamohueshme faktin që populli shqiptar «gjithmonë ka qenë në shenjë nga pushtuesit e huaj, por megjithatë, ai ka gjetur gjithmonë fuqi për të ruajtur identitetin e tij nacional; nuk është e rastit që shqiptarët janë grupi etnik më i vjetër që jeton në Evropë dhe që ka luftuar për pavarësinë e tij nacionale». Ne duam që vëllezërit tanë përtej kufirit të kenë të gjitha të drejtat e plota, si tërë popujt e tjerë të Jugosllavisë. Është fakt që ka pasur periudha kur këto të drejta jo vetëm u janë mohuar, por kosovarët dhe gjithë shqiptarët që banojnë në Jugosllavi kanë vuajtur shumë nga padrejtësitë e nga diskriminimet e ndryshme shoviniste. Populli dhe Partia jonë më se një herë kanë ngritur zërin e protestës dhe kanë mbrojtur të drejtat e vëllezërve të tyre të njëgjaku e të një gjuhe. Për këtë qëndrim tonin të drejtë, parimor e njerëzor udhëheqja jugosllave na ka akuzuar për shovinizëm. Por faktet tregojnë se nuk ishim dhe nuk jemi ne të tillë, por, në të kundërtën, sho-

vinistë ishin ata që u mohonin sistematikisht edhe të drejtat më elementare vëllezërve tanë shqiptarë. Ne e themi hapur: kurrë nuk kemi ndërhyrë, as kemi ndërmend të ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Ne nuk jemi nga ata që maqedonasit apo turqit t'i quajmë shqiptarë, por kosovarët, shqiptarët e Maqedonisë apo ata të Malit të Zi themi që janë shqiptarë, prandaj kemi plotësisht të drejtë të denoncojmë çdo veprim që u mohon vëllezërve tanë kosovarë e të tjerëve të drejtat që u jep kushtetuta jugosllave dhe çdo masë që synon shkombëtarizimin e tyre ose largimin nga tokat e të parëve. Ne nuk mund të heshitim kur ndodh që shqiptarët që banojnë në Jugosllavi ngarkohen me faje të ashtuquajtura politike, kur këta interesohen për zhvillimin e jetës së re në Shqipëri, për fitoret dhe sukseset tona në ndërtimin e socializmit. Do të ishte një politikë dritëshkurtër dhe pa sukses të tentohej që popullsinë shqiptare të Kosovës me ia kundërvënë, në çdo formë qoftë, Republikës Popullore të Shqipërisë. Mbrojtjen e vëllezërve tanë kosovarë e të të drejtave të tyre ne e kemi bërë dhe do ta bëjmë gjithnjë brenda normave ndërkombëtare e njerëzore, brenda normave të fqinjësisë së mirë midis dy shteteve tona.

Ne jemi të sigurt se popujt e Jugosllavisë, që i kemi miq, na kuptojnë drejt dhe e aprovojnë këtë qëndrim. Vetëm ata që janë jo vetëm kundër kosovarëve, por edhe kundër lirisë e pavarësisë së popujve të Jugosllavisë, do të na akuzojnë si shovinistë e sikur ne ndërhykemi në punët e brendshme të Jugosllavisë.

Është e qartë se asgjë e mirë nuk del për miqësinë midis dy vendeve tona, në rast se lejohen forcat shoviniste serbomëdha o të tjera në Jugosllavi që të shtypin ndjenjat kombëtare të shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë apo të Malit të Zi, që të mbytin manifestimet e ligjshme të këtyre ndjenjave, të bazuara në traditat e larta patriotike të tyre.

Populli i Shqipërisë gëzohet që vëllezërit e tij kosovarë po marrin pjesë në zhvillimin e ekonomisë dhe në qeverisjen e vendit, që populli, rinia dhe inteligjencia e Kosovës ndjekin shkollat shqipe dhe bëjnë përpjekje të mëdha për të forcuar e për të zhvilluar gjuhën, traditat, zakonet dhe kulturën shqiptare. Populli ynë dhe institucionet e ndryshme shkencore, arsimore e kulturore kanë qenë dhe janë kurdoherë të gatshëm t'i ndihmojnë vëllezërit kosovarë në rrugën e tyre fisnike. Ne jemi gati, veç marrëdhënieve tregtare, të zhvillojmë edhe marrëdhëniet kulturore. Këtë gjë mund ta bëjmë edhe me popujt e tjerë të Jugosllavisë, por me Kosovën e favorizojnë traditat, kulturën dhe gjuha e njëjtë. Fakultetet e ndryshme të universitetit tonë dhe institutet e tjera të larta janë gati të ndihmojnë vëllezërit kosovarë me tekstet e nevojshme të lëndëve të ndryshme. Shkollat tona të larta, gjithashtu, mund t'u japin edhe bursa të rinjve kosovarë për të përfunduar studimet e tyre në fakultetet që dëshirojnë, ashtu siç mund të pranojnë shumë të tjerë, apo edhe pedagogë kosovarë për praktikë a për specializim, ose për të shkëmbyer eksperiencën. Ne kemi bindje se edhe në këtë drejtim popujt vëllezër

të Jugosllavisë do të na kuptojnë e do të na përkrahin, pse jemi në rrugë internacionaliste.

Të dashur motra e vëllezër,

Një e ardhme e ndritur e pret popullin tonë. Ne po mbyllim me sukses planin e katërt pesëvjeçar dhe po përgatitemi të nisim me forca të reja luftën për planin e pestë pesëvjeçar, i cili do ta ngjitet vendin tonë në maja më të larta. Perspektiva të mëdha ka edhe rrethi i Tropojës. Këtu do të bëhen transformime e përpime të pandërprera në fushën e bujqësisë. Zhvillim të madh do të marrin minierat dhe kërkimet gjeologjike të mineraleve, të cilat premtojnë shumë. Do të zhvillohen ndërtimet, komunikacioni, tregtia, arsimi e kultura. Në Fierzë do të ngrihet gjiganti i madh energjetik, i pashembullt në vendin tonë dhe i rrallë në Ballkan e në Evropë, i cili do t'u japë energji të re elektrike industrisë, minierave, bujqësisë, blegtorisë, vatrave tona.

Le të hidhemi, pra, me forca të shumëfishuara në punë, të kryejmë më së miri punët e stinës në bujqësi, të shfrytëzojmë kohën, të rritim rendimentet, të përmirësojmë cilësinë, të kursejmë kudo, të shfrytëzojmë rezervat e brendshme, të përmirësojmë metodën dhe stilin në punë, të hidhemi në aksione masive zinxhir me goditje të përqendruar në çdo fushë, të korrим suksesë gjithnjë e më të mëdha!

Nën flamurin e marksizëm-leninizmit, nën udhë-

heqjen e Partisë, përpara dhe gjithnjë përpara drejt fitoreve të reja!

Rroftë populli trim e patriot i rrethit të Tropojës!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja dhe organizatorja e të gjitha fitoreve tona!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 129 (6793), 31 maj 1970*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 129 (6793), 31 maj 1970*

## MASAT KËRKOJNË SHEMBULLIN E MIRË TË KOMUNISTËVE E TË KUADROVE

*Fjala në takimin me anëtarët e byrosë  
së Komitetit të Partisë të Rrethit  
të Tropojës*

30 maj 1970

Dëshiroj t'ju them, së pari, se jam gëzuar shumë që po më jepet rasti të piqem me ju, shokë kryesorë të udhëheqjes së Partisë të rrethit të Tropojës. Në fjali-min që mbajta sot në miting me popullin e rrethit, parashtrova disa probleme. Në Byronë Politike menduam që, krahas vetive të larta që kanë njerëzit e rrethit tuaj, të vija në dukje edhe disa të meta e dobësi që ekzistojnë në organizatën e Partisë dhe të jepja disa këshilla për të forcuar më shumë punën e Partisë në rreth.

Rëndësi ka që populli i Tropojës është i fortë, me gjykim të thellë, me guxim e me zemër të hapët. Këto janë cilësi të larta, prandaj duhet të dalim me konkluzionin që ne, bijtë e këtij populli, ushtarët e kësaj partie, është e domosdoshme të rishikojmë punën tonë, t'i bëjmë vctes pyetjen: «E kemi bërë detyrën



tonë, jemi ngritur ne vetë në nivelin e vetive të larta të këtij populli?».

Në përgjithësi, ne kemi një mendim të mirë për organizatën e Partisë të rrethit të Tropojës. Ajo mund të kishte arritur rezultate më të mëdha, po të ishte bërë një punë më energjike, më këmbëngulëse, më e zgjuar e më me iniciativë nga komiteti i Partisë. i rrethit, në radhë të parë nga vetë sekretari i parë, shoku Ali Kruja...

Megjithatë unë po shikoj se ju e keni syrin pishë, pse jeni shokë të gjallë, luftarakë, jeni komunistë të mirë e të afirmuar, pra i keni të gjitha mundësitë dhe forcat që punën ta çoni përpara. Prandaj, siç na mëson kurdoherë Partia, paskëtaj duhet t'i hyni më mirë punës, me një temp më revolucionar, të keni kurdoherë parasysh që kujtdo që gabon, qoftë ky anëtar i byrosë, sekretar, sekretar i parë i komitetit të Partisë apo kryetar i komitetit ekzekutiv etj., t'ia thoni çdo gjë në sy, haptazi, pa druajtje. Qëllimi është që mbi të gjitha puna e Partisë dhe e popullit të shkojnë përpara, që të forcohet organizata e Partisë dhe uniteti i saj të shëndoshet gjithnjë e më shumë, pse kështu do të realizohen detyrat e mëdha që kemi përpara: zhvillimi ekonomik i vendit, mirëqenia e popullit, ngrija e pareshtur revolucionare e masave. Puna e Partisë synon të sqarojë, të edukojë e të mobilizojë mirë njerëzit për zbatimin e detyrave, duke dhënë vetë komunistët shembullin personal në punë, në shoqëri e kudo.

Prandaj të vëmë të gjitha forcat që mësimet që na jep Partia dita-ditës si ushqim nga eksperiencia e ma-

dhe e saj (dhe ju shokë të Tropojës keni dhënë kontributin tuaj në thesarin e madh të gjithë veprës së Partisë, pavarësisht se jeni modestë dhe atë nuk e zini në gojë, se komunistët në çështje të tilla kurdoherë modestë duhet të jenë), t'i zbatojmë në jetë. Por këtë eksperiencë të madhe, në radhë të parë, ne duhet ta përvetësojmë mirë dhe ta zbatojmë mirë.

Puna kryesore e Partisë është të edukojë e të ndreqë njerëzit, të cilët mund të bëjnë edhe gabime... Në këtë drejtim ne, si kudo, edhe në Tropojë, përpigemi t'i mësojmë kurdoherë komunistët që të përvetësojnë tiparet më të mira të malësorëve, sidomos thjeshtësinë dhe sinqeritetin. Nuk i duhet fshehur asgjë malësorit, ndryshe ai zemërohet; me të të flitet hapur, se ai i kupton lehtë dredhitë. Kështu duhet folur edhe me shokët e Partisë. Prandaj, kur je duke biseduar me një shok komunist, përse t'u vish anës punëve, në forma që nuk i lejojnë rregullat e Partisë? Në mbledhjet e Partisë, sidomos, duhet të flisni hapur, shokë, thujani tjetrit gabimin, ashtu siç e vlerësoni, pse ai që ka gabuar do të mendojë më mirë, do t'i njohë gabimet dhe, ajo që ka rëndësi, nuk do t'i përsëritë më.

Kur kritikohen njerëzit, siç e dini, ndreqen, dhe, kur ndreqen, puna, natyrisht, ecën përpara. Kështu do të ndodhë edhe me ju. Ne kemi bindjen se edhe organizata e Partisë e rrethit tuaj do të ecë përpara dhe do t'i korrigjojë pa vonesë gabimet e të metat e vërtetuar. Komiteti Qendror kohët e fundit ju ka dërguar këtu disa shokë, të cilët po përpigën me të gjitha forcat t'ju ndihmojnë të ecni përpara. Duhet thënë me keqardhje që për disa çështje ekzistonin të gjitha

mundësitë të merreshin masa me kohë për t'i zgjidhur vetë ju; ato nuk duhej të ishin lënë në gjendjen që ju gjetën shokët që erdhën nga qendra, sidomos disa që kanë të bëjnë me jetën e popullit, me furnizimin, pra me mirëqenien e masave...

Le të sqarojmë pak tashti punën e të bërtiturit. Ka raste që të bërtiturit, natyrisht, pa u bërë nervoz, është me vend. Komunistët s'duhet të bëhen kurrë nervozë, po të mbajnë në çdo rast gjakftohtësinë. Të mbash gjakftohtësinë, s'do të thotë aspak të jesh i butë. Këtu të kuptohemi mirë dhe të mos mendohet se, meqenëse jemi shokë, punën mund ta bëjmë kur të duam apo kur të na vijë për mbarë. Jo, marrëdhënie të tilla në punë nuk duhen lejuar. Kur ngarkohesh të kryesh diçka, atë është e domosdoshme ta bësh mirë, në kohën e duhur e pa justifikime. Kështu, kur ngarkohesh të kryesh këtë ose atë punë, ta zëmë brenda tri orëve, duhet të fillosh menjëherë nga detyra e ngarkuar, bile brenda afatit të caktuar të kthehesh e të japësh llogari, të tregosh që e ke kryer dhe si e ke kryer. Partia i porosit anëtarët e saj t'i kërkojnë llogari edhe shokut për punën që i është caktuar të kryejë, pasi ata t'u kenë dhënë llogari të tjerëve për ato që duhet të kenë kryer vetë, ndryshe nuk ecet. Kërkesa e llogarisë është personale dhe kolektive, përpara përgjegjësit, përpara komitetit të Partisë, përpara Partisë dhe përpara popullit.

Të gjithëve, sidomos ne komunistëve, s'duhet të na rritet kurrë mendja. Asnjeri të mos mendojë: «Jam unë këtu që jap urdhra, prandaj kryhet puna», asnjeriu nuk i lejohet që vetë të vërë duart në xhep, ndërsa

të tjerëve t'u kërkojë të punojnë. Jo, kështu s'duhet vepruar, vendimet të merren patjetër së toku, po për zbatimin e tyre gjithsecilit sipas aftësive e përgjegjë-sive duhet t'i ngarkohen detyra të caktuara dhe kështu të gjithë së bashku t'i përvishen punës për t'i zbatuar në jetë. Në qoftë se nuk veprojmë kështu, detyrat nuk realizohen. Dhe ju shokëve të rrethit të Tropojës ju dalin shumë detyra në këtë drejtim.

Edhe një herë dëshiroj të theksoj se populli i rrethit tuaj është i mrekullueshëm. Siç doli edhe këtu, pasi analizuat gjendjen e punëve dhe morët një sërë vendimesh, ju u bëtë thirrje masave. Populli e dëgjoi me kujdes atë thirrje, u mobilizua dhe u hodh në sulm si asnjëherë tjetër, sa qysh herët në mëngjes njerëzit dalin në punë. Tani një mijë e njëqind forca pune më shumë se zakonisht punojnë në rreth në të gjitha frontet, për arsye se, porsa doli komunikata, shembullin të parët e dhanë komunistët. Shihni, pra, si e ndjek Partinë ky popull i mrekullueshëm, trim e punëtor, kur sheh se ajo e luan me të vërtetë rolin e pararojës! Me ta punuar thirrjen, ai ka menduar se diçka duhet të ketë ngjarë në komitetin e Partisë të rrethit, ku, veç vendimeve që kanë marrë, u kanë bërë edhe ndonjë kritikë të mirë atyre që kanë gabuar.

Kritikat për gabimet e të metat të bëhen kurdoherë atje ku kërkohet dhe në masën e nevojshme. Por ju edhe popullin duhet ta informoni, t'i tregoni që bëtë autokritikë përpara Partisë, pse në disa drejtime punët nuk i kishit mirë. Ne nuk mund t'ia fshehim popullit gabimet dhe të metat tona. Atij duhet t'i thuhet ku nuk u shkonin mirë punët dhe masat që keni marrë që

ato të ecin si duhet, pastaj ta falënderoni që në këto kushte iu përgjigj me një hov kaq të madh thirrjes së komitetit të Partisë. Tashti u bie detyra juve, shokëve të komitetit të Partisë dhe gjithë komunistëve të rrethit, që të viheni në ballë të masave, të bëheni shembull e të shkriheni me to. Populli nuk kërkon nga ju punë të vogla, sepse shatën kooperativistët dinë ta përdorin shumë më mirë sesa ju. Nga udhëheqësit ata kërkojnë mënyrat, format e metodat më të mira të organizimit të punës, duan të shohin tek ata njerëzit e palodhur për të udhëhequr masat në punë, shembullin më të mirë. Ne themi vazhdimisht të organizohemi, të punojmë në këtë ose në atë mënyrë, duke shpjeguar me argumente se kjo na sjell përfitime etj., dhe përpara se të vëmë në zbatim këtë mënyrë të re pune, të këshillohemi me popullin. Atëherë të shohim ç'gjëra të mëdha mund të bëjnë masat.

Kujdes të dorës së parë t'u vini problemeve ekonomike. Tani kemi prova të shumta se atje ku punohet e zbatohen me këmbëngulje mësimet e Partisë dhe agroteknika e përparuar, atje ku kombinohen mirë bujqësia me blegtorinë, merren rendimente të larta; grurin, misrin etj. nuk i mbulon bari i egër; atje rriten bagëti të shëndetshme e me prodhimtari që shtohet çdo vit.

Në këto drejtime rol të madh luan edhe propaganda. Partia na mëson të mos bëjmë kudo një propagandë uniforme dhe të caktuar një herë e përgjithmonë. Në bujqësi duhet të mësohemi vetë, në radhë të parë, që, para çdo procesi pune (pse ka shumë procese gjatë gjithë ciklit të zhvillimit të një lloji bime), të

bëjmë një propagandë të zgjuar e të menduar mirë politiko-ideologjike dhe tekniko-profesionale, qëkur fillohet nga puna, ta zëmë, për pastrimin e farës e deri në fund sa korret e futet në hambar prodhimi i ri. Në cilindo proces është e domosdoshme që komunistët të bëjnë propagandën përkatëse, të menduar e të organizuar mirë.

Kështu, para se të mbillet një lloj bime, duhet treguar kujdes për farën. E gjithë propaganda të përqendrohet në këtë kohë në shpjegimin sa më mirë kooperativistëve të punës që duhet bërë për mirëmbajtjen e farës në depo, për ta ruajtur atë nga lagështira, për ta mbrojtur nga sëmundjet, për ta ajrosur në depo, për ta spërkatur etj.

Kur të vijë koha për punimin e tokave, atëherë propaganda duhet të përqendrohet në këtë proces të ri pune, duke kërkuar që, në radhë të parë, traktoristët, si elementë të klasës punëtore në fshat, të jenë në pararojë të punës, të kenë në gatishmëri me kohë gjithë mekanikën, të japin shembuj heroizmi e vetëmohimi në punë. Atyrë t'u shpjegohet se, po të mos e futin plugun thellë në tokë, sa e kërkon bima që do të mbillet, nuk mund të priten rendimentet e dëshiruara etj., etj. E tërë propaganda në këtë moment të synojë që të punohet frontalisht nga të gjithë. Kështu, njëkohësisht me punën që do të bëhet me traktoristët, të jepen udhëzime që edhe në zonat ku nuk futet traktori kooperativat t'i ushqejnë mirë qetë, duke u shpjeguar njerëzve rëndësinë e kësaj pune në periudhën e mbjelljeve. Atëherë duhet menduar e duhet vepruar si në luftë, duhet me qenë të përgatitur sa më mirë. Pra, që

të arrihet kudo fitorja në këtë fushatë të rëndësishme, kërkohet që edhe në zonat me terren të thyer qetë të jenë të fortë, të shëndoshë, pse duke pasur qe të tillë, mund të punohen sipërfaqe toke më të mëdha dhe kështu detyrat të realizohen kudo. Këto detyra t'u shpjegohen qartë të gjithëve, sidomos në ato kooperativa ku kanë pak qe dhe sipërfaqe toke të madhe për të mbjellë. Atje, pa pasur kafshë të shëndosha e rezistente, nuk do të jenë në gjendje t'i realizojnë normat e t'ua dalin mbanë punëve të shumta. Prandaj, porsa të fillojë propaganda e Partisë, duhet të nisët menjëherë puna konkrete, duke qenë komunistët në ballë dhe shembull në çdo drejtim.

Pas punimit të tokave vjen procesi i mbjelljes. Propaganda në këtë kohë duhet të shpjegojë si të mbillet gruri ose misri, sa farë duhet hedhur për hektar. Ajo të shpjegojë mirë se, po s'u hodh sasia e duhur e farës, bimët e grurit nuk do të dalin në numrin që duhet, kështu, në vend që të merren, ta zëmë, 18 ose 20 kuintalë grurë për hektar, do të merren vetëm 7 ose 8 kuintalë.

Duhet pastaj, pas mbjelljeve, të vazhdohet propaganda për plehërimin, për prashitjen, për ujitjen, për luftimin e sëmundjeve të bimëve e kështu me radhë për çdo shërbim, deri në përfundim të ciklit. Veç të kihat parasysh që propaganda të bëhet e organizuar dhe kurdoherë në kohën e duhur, që kur fillon e derisa të mbarojë një proces i caktuar pune. Po të veprojmë kështu, do të shikojmë si kanë për të na dalë prodhimet. Prandaj, më duket mua, nuk duhet të bëjmë një propagandë të përqendruar në një kohë për të gjitha

proceset, fjala vjen në dimër, duke menduar se atëherë na ka mbuluar bora dhe, mbasi s'bëjmë dot tjetër punë, të mblihdemi rrotull zjarrit për të pjekur gështenja dhe aty të ngarkojmë specialistët që t'u flasin kooperativistëve për të gjitha problemet.

Meqenëse ra fjala për gështenjat, siç thamë edhe sot në miting, tregoni kujdes dhe merrni menjëherë të gjitha masat për të zhdukur dobësitë e të metat që keni në këtë sektor kaq të rëndësishëm ekonomik për rrethin tuaj. Punën ju duhet të mos e lini gjersa të vijë pranvera e ardhshme, pse, me shkrirjen e borës, do ta harroni edhe këtë detyrë. Shpesh harrohen çështjet, prandaj atyre t'u qëndrojmë vazhdimisht mbi kokë, ndryshe nuk zgjidhen vetë. Edhe për gështenjat, që të japin prodhime të mira, kërkohet punë këmbëngulëse, por njëkohësisht duhet mësuar për to.

Është ca i lodhshëm mësimi, shokë, pse ai kërkon që, pas punës së ditës, të këndosh libra, natyrisht, me sistem, kur, sa dhe çfarë duhet. Në rast se nuk vëmë rregull e sistem në lexim, nuk mund t'ia arrijmë qëllimit. Nganjëherë koha shkon kot, por jeta rrjedh dhe grumbullohen aq shumë gjëra, sa pastaj njerëzit nuk dinë nga të kapin fillin, kurse ndonjë arrin më në fund t'i mbyllë librat, vete në punë pa lexuar fare dhe merret me gjëra të vogla pa rëndësi. Prandaj është e domosdoshme ta sistemojmë mirë punën e leximit, gjë që do të na ndihmojë ta bëjmë në një nivel të lartë çdo punë.

Kështu, për shembull, po të dalë nevoja të merrësh të nesërmen me një problem, duhet të llogaritësh që do të të nevojitet të lexosh të paktën një orë në



mbrëmje, prandaj në këtë rast duhet t'i lësh mënjanë punët e tjera. Po të të duhet të shkosh një ditë tjetër, ta zëmë, në çerdhe, përsëri lypset menduar çfarë do të bisedosh me personelin e saj. Në radhë të parë, është mirë të flitet diçka për sëmundjet nga të cilat vuajnë foshnjat, ose për dëmin që sjell mungesa e higjienës dhe e pastërtisë së kalamanëve. Ato për të cilat do të të duhet të flasësh, mund t'i kesh mësuar, por edhe sikur të mos i dish, si sekretar partie, ose si anëtar i byrosë së komitetit të Partisë, do t'i lutesh një mjeku të vijë në zyrë dhe të të flasë ndonjë orë për disa probleme shkencore, për disa këshilla që janë të dobishme t'ua thuash grave që shërbejnë në çerdhe ose nënave të fëmijëve. Në qoftë se dëshiron të zgjerohesh ca më shumë në këto çështje, mund t'i kërkosh mjekut edhe ndonjë libër ku trajtohen këto probleme dhe, për të fituar kohë, do t'i lutesh të të shënojë kapitujt ku flitet më tepër për ato që të interesojnë. Kështu me radhë mund të veprohet për të tëra çështjet, qofshin ato ideologjike, politike, ushtarake, të bujqësisë, të higjienës e për çdo problem tjetër që preokupon Partinë.

Sekretari i parë i komitetit të Partisë nuk mund ta flerë mendjen për çështjet e ideologjisë e të kulturës, për faktin se me to merret njëri nga sekretarët e komitetit, ose për ato të ushtrisë, që i ndjek anëtari i byrosë i ngarkuar me problemet ushtarake, apo për problemet e rinisë, me të cilat merret sekretari i rinisë etj. Me rininë vërtet merret sekretari i rinisë, po organizata e rinisë duhet të ushqehet dhe të drejtohet nga Partia, pse rinia është si një vullkan në veprim, që zien, prandaj për të duhet të interesohet vazhdimisht e tërë

udhëheqja e Partisë në rreth. As sekretarët e tjerë apo anëtarët e byrosë të mos e flenë mendjen se me këtë ose me atë sektor që ka në varësi merret ky ose ai instruktor.

Por njerëzit nuk mund të kenë në kokë të tëra dijenitë, këto fitohen me punë e me mësim të pandërprerë. Çështjen e kam këtu, që punën të mos e ndajmë asnjëherë nga mësimi, as mësimin nga puna. Dhe mësimin ne do ta gjejmë edhe në libra, në revista, në gazeta etj., të cilat punëtorët e Partisë duhet t'i kenë kurdoherë në dorë, sidomos «Zërin e popullit». Gazetat nuk këndohen brenda një ore, po edhe të tëra ç'shkruajnë ato nuk mund t'i lexoni, sepse kanë plot gjëra që, jo se janë të këqija, por edhe mund të mos ju duhen, kurse shkrimet për probleme kryesore duhet t'i këndonit medoemos, veçse me sy kritik. Ju në mëngjes mund të këndonit një artikull, ta zëmë, për jetën e Partisë, pastaj, si shkoni në punë, duhet të mendoni për problemin që trajtohet atje, si e keni zgjidhur ju këtu ku punoni këtë problem, si sillen njerëzit e organizatës suaj me punonjësit e kooperativës etj. Kështu mbi këtë çështje komunisti reflekton dhe deri në njëfarë pike i del se gjendjen e ka njëlloj, siç thuhet në gazetë, por ka edhe disa anë që nuk përngjajnë. Atëherë i bën pyetjen vetes: «Si duhet të veprojnë për të arritur në atë për të cilën flet artikulli?». Vret kështu mendjen dhe del me disa konkluzione. Të këndosh, pra, një artikull gazete do të thotë të përpunosh në mendje direktivën e Partisë, të zhvillosh trurin, të përpiqesh të gjesh arsyet e qëllimet e autorit dhe të reflektosh si mund t'i realizosh ato që kërkohen në kushtet e tua konkrete.

Përveç gazetës, punëtori i Partisë duhet të lexojë edhe shumë libra, si dhe të gjitha dokumentet e Partisë. Për ta realizuar këtë detyrë është mirë të praktikoni një metodë, një sistem pune, që Partia ua ka dhënë në bazë të eksperiencës së saj të përditshme. Megjithatë secili mund të gjejë e të zbatojë atë metodë studimi që i pëlqen dhe i jep rezultate më të mira. Unë vetë kam një metodë timen në të lexuar, e cila mund të mos jetë e mirë për të tjerët. Personalisht, kur lexoj një libër, përpiqem të përfitoj sa më shumë prej tij, mbaj parasysh çfarë të lë mënjanë, çfarë të nxjerr e të nënvizoj etj. Nuk i dilet punës pa pasur një metodë në të lexuar. Sigurisht, në radhë të parë, kanë rëndësi dashuria dhe pasioni për librin, sidomos për të lexuar në mënyrë sistematike materialet e Partisë dhe të mësuesve tanë të mëdhenj, të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit. Pastaj rëndësi ka edhe gjetja e formave dhe e metodave më të përshtatshme për të përfituar sa më shumë prej tyre siç janë mbajtja e shënimeve, nënvizimet, qoftë edhe të një fraze që mund të na duhet për punën etj., pse një frazë e Marksit ose e Leninit komunistit i hap një horizont të tërë. Një frazë të tyre që mua më duhet, e shkruaj më parë në letër, pastaj përpiqem ta bluaj në kokë idenë që përmban ajo, duke u mbështetur në eksperiencën e Partisë, në raportet dhe në dokumentet e tjera të saj. Mendimet dhe konkluzionet që nxjerr, përpiqem t'i hedh në kartë, dhe shokët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, nëpërmjet buletineve, jua dërgojnë herë pas here si «simitet e furrës». Pra, duke u bazuar te Marksi, tek Engelsi, te Lenini dhe te Stalini, për-

piqem të bëj sintezën e problemit, gjykoj dhe mundohem të nxjerr diçka, pastaj sa e mirë është dhe ç'të meta e dobësi ka ajo, atë e gjykon Partia kur e merr dhe e lexon.

Dua të vë në dukje me këtë rast se rrallë na vijnë vërejtje e kritika nga baza, që të mund të gjykojmë ku ka dalë mirë ky ose ai material dhe ku s'ka dalë si duhet, që të korrigohet. Është e domosdoshme ta ndjekin mirë të gjithë këtë çështje dhe të mos pritët çdo gjë vetëm nga ne të qendrës. Ky është një problem shumë serioz. Ka rëndësi të madhe për Partinë që ju shokë të Tropojës, që keni eksperiencë dhe njohuri të mëdha për jetën e rrethit tuaj, të na ngrini herë pas here jo probleme klishe, me fraza shabllone, por probleme shoqërore që ju preokupojnë, të na tregoni si mendon malësori për to, si i pret ai vendimet e Partisë, natyrisht, pa na bërë zbukurime, pa na thënë gjëra të përgjithshme. Këto, në përgjithësi, i dimë, po dimë, gjithashtu, se njerëzit kanë edhe mendime të gabuara, jo se nuk i presin mirë materialet e Partisë, por se në ndërgjegjen e tyre ekzistojnë edhe njolla, të cilat i quajmë mbeturina. Pikërisht këtë duam të dimë ne, kjo na intereson shumë, cilat janë konkretisht këto mbeturina, si shfaqen e si paraqiten etj. Që ekzistojnë mbeturina, këtë e dimë, po konkretisht ku konsistojnë këto për çdo rreth në veçanti, këtë ne të qendrës nuk e dimë kurdoherë, kurse ju shokë të bazës po. Në qoftë se do t'i sqaroni këto probleme, kjo do të thotë se ato iu sqaruan Komitetit Qendror. Kuptohet që eksperiencën tuaj ne do ta përpunojmë më tej. Mirëpo, në qoftë se ju nuk na jepni gjë, ne do të mbetemi si peshku

pa ujë. Në këtë çështje duhet t'i vini gishtin kokës. Nuk mund të ekzistojë Parti pa bazë, te baza qëndron forca e saj.

Mësova se në rrethin tuaj ka shumë fëmijë. Këtë ne duhet ta inkurajojmë, por inkurajimi më i mirë për rritjen e popullsisë është ngritja e ekonomisë, prandaj të bëjmë të gjitha përpjekjet për këtë, të punojmë siç duhet për forcimin ekonomik të kooperativave. E dyta, të bëjmë çmos që të përmirësojmë higjienën dhe pastërtinë në të gjitha fshatrat tona. Realizimi i këtyre detyrave varet, në radhë të parë, nga ngritja e ekonomisë. Në qoftë se arrijmë që kooperativistët të mos marrin nga 5 ose 8 lekë, po nga 16 deri dhe 18 lekë për ditë-punë, si punëtorët e ndërmarrjeve bujqësore, atëherë, kur t'u bëjmë propagandë për higjienën dhe t'u themi grave të kenë të paktën nga tri palë veshje të brendshme për kalamanët, ato, duke kuptuar rëndësinë e problemit dhe duke pasur edhe mundësitë materiale, do të jenë dakord dhe do të venë menjëherë t'i blejnë në treg.

Mirëpo tashti që marrin të ardhura të pakta, me se t'i blejnë? Ja, pra, ç'rëndësi të madhe ka ngritja e ekonomisë! Në qoftë se do t'i lëmë lopët pa ushqyer mirë si gjer sot, nuk do të marrim dot më shumë qumësht nga secila. Prandaj çështjet t'i shtrojmë drejt, se s'ka njerëz sot që të mos i kuptojnë mirë këto gjëra. Partia është në gjendje që, me propagandën e saj, t'ua nxitë akoma më tepër këto dëshira e qëllime, vetëm se të gjitha problemet duhen lidhur me ekonominë, ndryshe do të mbeten ëndrra. Po të kufizohemi vetëm në fjalë, në propagandë e në agjitacion, pa bërë për-

projekte për ngritjen gjithnjë e më lart të ekonomisë, nuk kemi si t'i bëjmë gjithë këto që na thuhet dhe kooperativistët do të na kritikojnë. Ne këto detyra mund t'i realizojmë, vetëm është e nevojshme ta organizojmë punën sa më mirë dhe masat t'i udhëheqim si duhet. Kur t'u bëjmë propagandë e t'u themi atyre se Partia na këshillon të shtohemi, se kalamanët duhet të ushqehen mirë që kur lindin, të ruhen nga sëmundjet etj., kur të mobilizojmë mjekët, mamitë, infermierët, organizatat e Partisë, të rinisë, të gruas dhe gjithë masat për këtë punë, kur kooperativistët t'i kemi ngritur edhe ekonomikisht më lart, vetë ata do të marrin të gjitha masat për të realizuar çdo detyrë që ka lidhje me përmirësimin e higjienës e të pastërtisë, lindjet do të shtohen, fëmijët do të ushqehen më mirë etj.

Tash në vendin tonë socialist Partia ka përgatitur një mori shkrimtarësh e poetësh të talentuar, që kanë shkruar dhe vazhdojnë të shkruajnë romane, poema, vjersha, drama etj., në të cilat pasqyrojnë në forma të ndryshme vijën e Partisë. Ne komunistët, në radhë të parë, duhet të lexojmë përveç literaturës teorike e politike edhe vepra artistike. Kjo na ndihmon shumë për të kuptuar në këtë ose në atë formë letrare direktivat e Partisë. Komunistët që lexojnë nuk janë të paktë. Por ka edhe nga ata që e lënë mënjanë leximin e të tilla materialeve, që i nënvleftësojnë. «E ç'të këndojmë ne nga këto? Ç'ta këndojmë këtë vjershë apo atë roman, ne kemi halle të tjera» thonë dhe lexojnë vetëm fjalimin e Enverit. Po pse nuk lexon me kujdes shoku komunist poemën e bukur të Dritëro Agollit «Baballarët» apo një roman të Shevqet Musarajt, të

Jakov Xoxës ose të Ismail Kadaresë? Duhet pasur parasysh se vija e Partisë pasqyrohet e konkretizohet edhe në këto materiale. Ato, në mënyrë të këndshme, me episode reale nga të jetës etj., do t'ju ndihmojnë shumë, shokë, ta kuptoni e ta zbatoni këtë vijë. Do t'ju ndihmojnë ju të kuptoni gjithashtu edhe ato që janë sintetizuar në formula. Prandaj mos i lini pas dore, mos t'ju duket sikur, duke lexuar ato, e kaloni kohën kot.

Kur ndonjë injorant, njeri që për vete nuk zë kurrë libër me dorë, të shohë kryetarin e kooperativës me një roman në dorë, patjetër do të lllomotitë, duke thënë: «Si paska kohë kryetari i kooperativës ose anëtar i byrosë së organizatës-bazë të Partisë, që janë kaq shumë të ngarkuar me punë e me detyra, të lexojnë edhe romane?». Ata duhet t'i përgjigjen këtij injoranti, t'i thonë se përpiqen të gjejnë kohë të këndojnë edhe vjersha e romane dhe në këtë drejtim ta këshillojnë të bëjë përpjekje e të lexojë edhe ai. Komunisti, na mëson Partia, duhet të këndojë e të mësojë vazhdimisht në kohën e lirë, pse në këtë lloj pune ai jo vetëm do të gjejë një kënaqësi shpirtërore, do të mësojë e do të edukohet, po me shembullin e tij do të nxitë edhe të tjerët të këndojnë dhe të mos merren me biseda të kota që nuk sjellin asnjë dobi. Po të veprojnë kështu të gjithë komunistët, atëherë do të ziejë klubi, do të ndizen diskutimet, do t'u bëhen komente e kritika romaneve, do të ngrihen njerëzit politikisht, ideologjikisht dhe nga ana kulturore, pse, kur të thuhet që filan autor s'e ka trajtuar mirë në roman këtë ose atë çështje, për arsye se s'ngjet kështu në jetë, prandaj ajo

s'është reale, se në fshatin tonë nuk mund të ngjasë, siç shkruhet atje, një gjë e tillë etj., atëherë mendja e njerëzve tanë që lexojnë pa u lodhur, do të bëhet më e mprehtë dhe problemet e detyrat që kanë përpara do t'i kryejnë më mirë e me lehtësi.

Lexova ditët e fundit veprën e re të Nasho Jorgaqit kushtuar jetës së Qemal Stafës dhe më pëlqeu shumë, se e ka shkruar bukur e saktë. Jetën e Qemalit ai e ka trajtuar në mënyrë reale në shoqërinë e atëherëshme, duke e paraqitur atë si gjithë të rinjtë e kohës, duke e ngritur pastaj deri në atë nivel që dimë, sa Qemal Stafa u bë hero. Autori nuk e ka paraqitur Qemalin me fraza bombastike, si një njeri me tipare të veçanta që kur ka qenë akoma foshnjë në djep, dhe mendoj se ka vepruar mirë. Nasho Jorgaqi përshkruan në vepër gjendjen e vendit tonë në kohën kur jetonte Qemali, flet për veprimtarinë e priftërinjve jezuitë e françeskanë, për intrigat e tyre. Ai Qemalin na e paraqit jo me fjalë të mëdha, por siç ka qenë në realitet, në mënyrë të natyrshme e në rritje, si një nxënës të zakonshëm në fillim, pastaj javash-javash e ngre si revolucionar. Ç'na tregon autori, përse luftonte Qemali kur ishte në gjimnaz? Në fillim ai nuk luftonte për komunizmin, se s'kishte dijeni për të, po kundër festes së zezë. Çështja ishte të mbahej apo të hiqej kjo feste. Kjo tani mund të duket si gjë e vogël, po kishte një kuptim me rëndësi në ato kohë, siç e dinë edhe shokët që kanë luftuar me Qemalin. Nasho Jorgaqi, pra, në këtë vepër nuk përdor fjalë pa vend, si disa të tjerë që na i bëjnë shokët tanë heronj që në djep, saqë lexuesi ka të drejtë të thotë që kjo s'hahet, nuk mund



të ketë hero të mitur. Me gjëra të tilla do të binden lexuesit? Ato s'bëjnë pesë para, shokë.

Situata e jashtme zhvillohet vazhdimisht në favorin tonë. Udhëheqja jugosllave, siç e shpjegova edhe në miting, është revizioniste, tradhtarë. Ne e kemi të qartë se Titoja me shokë s'do të ndërrojnë kurrë rrugë, ata e kanë kthyer Jugosllavinë në një vend kapitalist, prandaj atje janë krijuar vështirësi të mëdha për popullin. Pikërisht këto kanë bërë të lindin kontradikta të mëdha me karakter të theksuar nacionalist midis grupeve të veçanta që janë krijuar në Jugosllavi; kroatët nga një anë, sllovenët nga ana tjetër, maqedonasit ngrihen kundër serbomëdhenjve, këta kundër malazezve etj., të gjithë, pra, përpiqen kush e kush të marrë në dorë frenat e sundimit mbi popullin. Dhe Titoja qëndron mbi të gjithë, është, si të thuash, ai që i balanon të gjithë. Ai ka autoritet mbi gjithë të tjerët dhe, pavarësisht se është shkaktari i gjithë këtyre vështirësive, po të mos ishte ai, do të ngjisinin turbullira të mëdha në Jugosllavi. Titoja, si revizionist me damkë që është, e futi Jugosllavinë në rrugën e një sistemi kapitalist që e quajnë «vetadministrim». Ai është shkaktari kryesor për gjendjen katastrofike në Jugosllavi.

Grupi i serbomëdhenjve e kundërshton këtë gjoja vetadministrim, sepse pjesëtarët e tij synojnë të sundojnë absolutisht njëlloj si edhe më parë në kohën e kralëve. Mirëpo ata gjejnë kundërshtime të mëdha nga ana e kroatëve. Kontradikta kanë ekzistuar vazhdimisht në Jugosllavi midis kombësive që e përbëjnë

këtë vend. Këto kontradikta përpiqen t'i shfrytëzojnë tani revizionistët sovjetikë për të thurur intriga dhe për të kërcënuar unitetin e grupit sundues në Jugosllavi.

Por, siç e dimë, në gjithë këtë punë Titoja ka mbështetjen e imperializmit amerikan; ai është agjent i tij, gjë që duket qartë nga kreditë e mëdha që merr vazhdimisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe nga Gjermania Perëndimore Titoja ka filluar të marrë kredi. Këto i jepen sidomos sa herë që del shëtitje në vende të ndryshme të botës, ku bën atë që i diktojnë padronët. Prandaj, para se të nisët për një mision të tillë (tashmë jemi të sigurt dhe kështu ngjan kurdoherë, pse këto kredi jepen botërisht), ai merr çeqet, pikërisht se atje ku vete, nën maskën e politikanit të «forcës së tretë», të «shteteve të paangazhuara» etj., bën punën e imperialistëve. Ne i dimë mirë tani të gjitha këto gjëra. Por Jugosllavisë po i vijnë rrotull edhe revizionistët sovjetikë, të cilët dëshirojnë të kenë atje pozita të shëndosha të tyre, njëkohësisht të likuidojnë bashkë me këtë vend edhe Shqipërinë dhe Rumaninë.

Rumania është, gjithashtu, një vend revizionist, por që mbulohet me maskën e komunizmit. As atje nuk është e pastër situata, megjithatë është fakt se qeveria dhe partia e këtij vendi u kundërshtojnë revizionistëve sovjetikë, të cilët përpiqen ta kenë plotësisht të nënshtruar, siç arritën me Çekoslllovakinë. Për këtë arsye i bëjnë Rumanisë presione të mëdha. Por midis udhëheqjes revizioniste sovjetike dhe asaj rumune ekzistojnë kontradikta. Rumunët nuk duan të futen nën zgjedhën e sunduesve të Kremlinit.

Hrushovianët, kur sulmuan Çekosllovakinë, kishin parashikuar të sulmonin edhe Jugosllavinë e nëpërmjet saj të na sulmonin ne, të likuidonin njëkohësisht edhe Rumaninë, por ne i demaskuam, siç i kemi demaskuar edhe më parë. Pas agresionit në Çekosllovakë, ne u larguam nga Traktati i Varshavës, i dhamë një shu-plakë edhe Bullgarisë me paralajmërimin që i bëmë për përqendrimin e trupave sovjetike në këtë vend, bëmë pastaj deklaratën e njohur në favor të Jugosllavisë, me të cilën sqaruam se, po të sulmohet kjo, ne do të jemi përkrah popujve të Jugosllavisë. Vetë Titoja nuk e pranon zgjedhën sovjetike, nuk do që klika e Brezhnjev-Kosiginit të japë urdhra në Jugosllavi, ai do që Jugosllavia të jetë e pavarur nën regjimin e tij. Këtë zgjedhë s'e pranojnë ca më tepër popujt e Jugosllavisë me përjashtim të serbomëdhenjve të Rankoviçit e të një sërë agjentësh të tjerë kundërshtarë të Titos, të cilët Titoja tashmë i ka spastruar.

Rumania dhe Jugosllavia tani janë nën kërcënimin e rreptë të revizionistëve sovjetikë, por është e zorshme që këta ta sulmojnë Jugosllavinë, se dihet që, po krisi pushka, jugosllavët do të luftojnë. Mirëpo revizionistët sovjetikë i tremben shumë kësaj, pse sot nuk është më ushtari sovjetik me ato ideale të larta dhe me moral të shëndoshë të kohës së Stalinit. Në goftë se kërcet pushka, ushtari sovjetik nuk mund të mos mendojë se hapi i vendit të tij është i padrejtë.

S'duhet harruar, shoqe dhe shokë, se gjithë kjo punë që është bërë në kohën e Leninit dhe të Stalinit, nuk mund të shkojë kot. Një gjë e tillë u vërtetua edhe në Çekosllovakë, ku shumë ushtarë e oficerë sovjetikë

që s'dinin ku do të venin e pse do të venin, kanë qarë kur kuptuan çfarë ndodhi. Po ndonjë mund të thotë: «Shumë mirë, kur është kështu, atëherë ç'bëjnë njerëzit sovjetikë, përse nuk ngrihen kundër klikës që ka uzurpuar pushtetin?». Këto punë, shokë, nuk bëhen dot përnjëherësh, revolucioni do kohë që të përgatitet, në rrugën e tij nuk ecet dot aq lehtë, sidomos në këtë situatë kur armiqtë në Bashkimin Sovjetik ia kanë hedhur popullit ganxhat në grykë.

Pra, fjalën e kisha këtu, që, po krisi pushka në Jugosllavi do të krijohet një situatë e brendshme jashtëzakonisht e rëndë për revizionistët sovjetikë dhe pikërisht kësaj ata i tremben shumë. Por ata i tremben, gjithashtu, edhe opinionit ndërkombëtar, pse njerëzit do të bëjnë pyetjen: Përse Bashkimi Sovjetik po sulmon Jugosllavinë, përse po e sulmon Shqipërinë? (megjithëse kjo nuk sulmohet dot aq lehtë, pse ka edhe faktorë të tjerë që i bëjnë të mendohen mirë armiqtë tanë revizionistë. Prandaj këta janë në vështirësi.)

Një situatë e tillë është krijuar tani në Evropë, prandaj Titoja u detyrua të mendojë për shqiptarët e Kosovës, të cilët, gjer ca kohë përpara, vetë ky, së bashku me Rankoviçin, i kishte shkuar në thikë. Ne e dimë se nuk qe vetëm Rankoviçi ai që pati mbajtur qëndrime antimarksiste ndaj shqiptarëve në Jugosllavi. Pa aprovimin e Titos ai s'mund të bënte gjë, po Titoja bëri ç'bëri dhe ia hodhi Rankoviçit të gjitha krimet që kishin kryer bashkërisht kundër vëllezërve tanë të përtejkuferit.

Sidoqoftë, rëndësi tani ka çështja që Titoja u detyrua më së fundi t'i llogaritë shqiptarët e Kosovës, të

kuptojë se ata nuk janë një popull qojle. E shikon ai që, sa më tepër të acarosh marrëdhëniet me shqiptarët, aq më keq është për të. Shovinistët e mëdhenj serbo-kroatë tërë jetën u kanë bërë shumë të këqija shqiptarëve, por tani që në Jugosllavi gjendja është bërë mjaft e rëndë, Titoja, deshi s'deshi, për arsye politike, u detyrua t'u japë pak liri shqiptarëve, me qëllim që t'i ketë me vete. Kështu u dha atyre të drejtën të mbajnë flamurin shqiptar, të shtojnë shkollat, të ngrenë universitetin dhe radion e tyre në Prishtinë, të dërgojnë në Shqipëri turistë, disa kuadro kosovarë të marrin më shumë pjesë në pushtet etj. Këto masa ai s'i mori nga malli, po nga halli.

Në këto koniunktura Partia dhe Qeveria jonë mbajtën qëndrimin që dihet ndaj rrezikut të një agresioni sovjetik kundër Jugosllavisë. Ne i demaskuam sovjetikët, pse këta jo vetëm e kërcënojnë me sulm Jugosllavinë, po synojnë të pushtojnë edhe vendin tonë, të zënë portet tona, me qëllim që të dalin në Adriatik e në Mesdhe. Revizionistët sovjetikë përpiqen të sigurojnë baza në Mesdhe, se s'ka ku lëvrin e fut hundët flota e tyre. I qajnë ata Vlorën, Durrësin dhe Shëngjnin, e dinë vlerën e madhe të tyre, prandaj mendojnë që, po të sulmojnë Jugosllavinë, të vijnë medoemos edhe në Shqipëri. Për këtë arsye ne deklaruar që, në rast se sulmohen popujt e Jugosllavisë, ne do të jemi me ta. Deklarata jonë ka bërë efekt në Jugosllavi. Sidomos njerëzit e shtresave të mesme të popujve të ndryshëm të Jugosllavisë flasin me simpati për këtë deklaratë dhe shprehin besimin se populli shqiptar kur jep fjalën, e mban.

Natyrisht, në këto situata, udhëheqësve jugosllavë qëndrimi ynë u leverdis në dy drejtime. Ky qëndrim u leverdis, së pari, se ne u bëmë solidarë me popujt jugosllavë kundër një agresioni eventual, por u leverdis edhe për një arsye tjetër, se ata duan ta shfrytëzojnë këtë për t'i treguar botës që edhe «kështjella e fundit staliniste», Shqipëria, «u rregullua», «u zbut», «shqiptarët u futën në vathë». Me qëndrimet e qarta që mbajmë, ne nuk e lëmë anën tjetër të shpatës titiste të veprojtë, se ia ndryshkim. Prandaj, si i thonë, «në mes të dasmës», botuam një artikull që duhet ta keni lexuar. Sot në miting dhamë një sqarim tjetër për qëndrimin tonë. Kështu të tërë do të thonë se gjendja në Shqipëri s'qenka si propagandojnë jugosllavët, se qëndrimi i mbajtur nga shqiptarët kohët e fundit është një çështje krejt tjetër. Pra, ne i kemi të ndara hesapet me ta, kemi deklaruar se në luftën kundër një sulmi të revizionistëve sovjetikë do të jemi përkrah popujve të Jugosllavisë, kurse për çështjet ideologjike as kemi qenë, as jemi dhe as do të jemi kurrë dakord me titistët, kështu që polemikën do ta vazhdojmë. Ne nuk jemi shovinistë, po marksistë, prandaj me syrin si i shikojmë problemet, mendojmë se qëndrimin tonë do ta presin mirë vëllezërit kosovarë. Politika jonë është e drejtë. Nuk mund të bëhet një politikë tjetër në këto koniunktura.

Fjala e Partisë, qëndrimet e Qeverisë edhe mendimet e popullit tonë të shprehura në fjalimet e udhëheqjes, u forcojnë besimin shokëve e vëllezërve tanë kosovarë dhe u japin guxim të vazhdojnë punën për forcimin e pozitave, për rritjen e të drejtave të tyre të

ligjshme nacionale, siç janë e drejta e flamurit, e drejta për shtimin e shkollave, e drejta të marrin pjesë më shumë në pushtet etj. Revizionistët jugosllavë pretendojnë se në Jugosllavi është vendosur një pushtet demokratik, atëherë ne u themi: «Përse i ngatërroni ju atje lart, përse populli të mos zgjedhë ata që do në këtë pushtet?». Kosovarët kanë të drejtë të kërkojnë që të mos i marrin vetëm ushtarë të thjeshtë, se ata kanë dëshirë dhe aftësi të bëhen edhe oficerë, të komandojnë në ushtri edhe ata e jo vetëm serbi e malazezi. Mos vallë nuk kanë të drejtë shqiptarët kosovarë të komandojnë në ushtri, apo janë më pak të zotë se të tjerët? Kur të dalin oficerë, shumë nga ata do të kërkojnë me siguri që të mos i dërgojnë të komandojnë vetëm në Slloveni, po edhe në Kosovë, pse me vëllëzërit kosovarë që flasin të njëjtën gjuhë, do të merren vesh më mirë e s'do të lënë të merret Kosova nëpër këmbë. Kështu kërkesa do të lindë kërkesën.

Edhe flamurin, thonë tani kosovarët, ne do ta vëmë kur të duam, kur të duam mund të këndojmë edhe këngë shqiptare. Tirana po na fton të dërgojmë djem e vajza kosovarë në universitet, të shkojmë të marrim tekste shkollore dhe libra të ndryshëm shqip, atëherë përse ju udhëheqësit e Beogradit na ndaloni dhe vepëroni në kundërshtim me parimet?...

Ne duam që kosovarët të mësojnë sa më shumë e sa më shpejt, dhe e vërteta është se ata kanë etje të madhe për mësim dhe edukim.

Vështirësi të mëdha ushtarake, politike e financiare ka gjithashtu imperializmi amerikan, të shkaktuara këto, së pari, nga kriza e brendshme që ekziston në

vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga luftërat agresive që këto janë duke bërë në vende të ndryshme të botës, por edhe për arsye të krizave të mëdha, nga të cilat vuajnë aleatët e tyre, siç janë krizat ekonomike që po përshkojnë Francën, Italinë, Anglinë etj., që janë duke tronditur bazën e dollarit.

Kur presidenti i Francës Zhorzh Pompidu vajti për një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në një fjalim që mbajti atje, ai foli hapur dhe drejtpërdrejt ia tha edhe Niksonit, në darkën që ky shtroi për nder të «mikut», se, po të mos merren masa për forcimin e pozitave të dollarit brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të ketë perturbacione të mëdha e të thella në të gjitha vendet e tjera. Dhe ka ardhur koha, vazhdoi Pompiduja me mënyrën e tij, që në këto situata është e zorshme të pranohet dollari si etalon i përbashkët për të gjitha vendet kapitaliste. Me një fjalë, ka edhe shtete si Franca që u bëjnë presion Shteteve të Bashkuara të Amerikës, megjithëse detyrohen t'i lejojë këto të investojnë kapitale në vendet e tyre, sepse janë në krizë, kapitali amerikan ka bërë investime, si kudo në vendet e tjera kapitaliste, edhe në Francë. Po me ardhjen e Dë Golit në fuqi, atij iu pre rruga. Tashti Pompiduja shtegun ua hapi përsëri por, natyrisht, vetëm në disa degë të ekonomisë, me kusht që mbi këto investime të ushtrojë kontroll qeveria franceze dhe kapitali vendës të ketë disa të drejta mbi atë amerikan.

Më ndryshe është Italia, e cila ndodhet thujse nën zgjedhën e plotë të kapitalit amerikan. Mirëpo edhe aty ekzistojnë kriza të pandërprera. Ka dy vjet



të tërë që përditë bëhen greva punëtorësh. Me miliona janë ata që ngrihen. Por këto greva s'japin gjë, sepse në krye të tyre janë sindikatat e borgjezisë, si ajo e Saragatit, e demokristianëve dhe një sërë sindikatash të tjera, me ato të partisë revizioniste të Toliatit në krye, që janë në ujdi të plotë me kapitalin monopolist italian. Ato i bëjnë këtij presione, i marrin edhe disa koncesione të vogla ekonomike që i lejon vetë kapitali, siç është, për shembull, nganjëherë ngritja e vogël e rrogave, megjithëse pas një jave apo pas një muaji kapitali monopolist përsëri i ngre çmimet. Kështu klasa punëtore s'fiton gjë. Krejt ndryshe do të ishte situata në Itali, po të kishte një repart të organizuar mirë, një parti të vërtetë komuniste.

Forca e klasës punëtore në vendet kapitaliste është kolosale. Po të hidhej ajo në një lëvizje me të vërtetë revolucionare, do të paralizohej jeta atje. Le të marrim si shembull Italinë, ku gjatë grevave të mëdha të përgjithshme, shpesh ndalen trenat, s'punojnë telefonat, s'dalin gazetat, mbyllen dyqanet etj. Në raste të tilla kapitalistët atje mbeten me gisht në gojë, siç mbetën në Francë këto ditët e fundit. Në qoftë se keni ndjekur me vëmendje shtypin, nuk mund të mos keni vënë re se si studentët e Sorbonës u përleshën me policinë etj., etj. Qeveria franceze i akuzon ata si marksistë-leninistë, po nuk janë të tillë. Midis tyre ka lloj-lloj rrymash. Edhe marksistë-leninistët punojnë e përpiqen të ushtrojnë ndikimin e tyre në lëvizjen studenteske, por kjo në shumicën udhëhiqet nga lëvizje të tjera, të majta trockiste, socialiste dhe anarkiste. Secila nga këto lëvizje e grupe ka lloj-lloj programesh,

bën thirrje, si: «Bjerini pushtetit!», «Rrihuni me policinë!», ka bile të vrarë e shumë të plagosur nëpër rrugë, midis tyre edhe policë, prandaj forcat qeveritare kanë bllokuar universitetet, rrugëve janë hedhur bomba, janë arrestuar rreth 400 veta etj. Atje është bërë, me një fjalë, një krahurë e madhe. Këto ngjarje dhe sa e sa të tjera si këto që po përsëriten nga koha në kohë, flasin për një krizë të rëndë në vendet kapitaliste, për një situatë jo të qëndrueshme.

Natyrisht, në këto situata revizionizmi sovjetik dhe imperializmi amerikan përpiqen t'u shtrëngojnë vidhat satelitëve të tyre përkatës. Përfaqësuesit e NATO-s bëjnë mbledhje pas mbledhjesh, bëjnë manovra ushtarake njëra pas tjetrës, por edhe këta të vendeve revizioniste s'mbeten pas, pse s'janë të qetë, ata kanë kundërshtime të mëdha me njëri-tjetrin. Hungarezët kanë kontradikta me sovjetikët, po kështu edhe gjermanët, polakët e të tjerë, pa folur për rumunët, që kanë kontradikta të hapëta me klikën e Brezhnjev-Kosigin. Prandaj situata në vendet revizioniste është bërë si lesh arapi, themi ne, por ato i mban frika e lëvizjeve revolucionare brenda.

Sidoqoftë, kjo situatë nuk mund të vazhdojë shumë, ajo ndihmon e favorizon javash-javash zhvillimin e revolucionit brenda vendeve revizioniste. Ne nuk kemi dijeni ç'bëhet në këto vende, sidomos në Bashkimin Sovjetik, por mendoj se është vështirë që atje të mos ketë lëvizje. Se si, konkretisht s'dimë gjë, po fakti që detyrohen të nxjerrin Stalinin nëpër kinematë dhe populli sa e sheh ngrihet e duartroket në mënyrë frenetike për minuta të tëra, ose që Greçkoja në mble-

dhjen solemne të 9 majit, Ditës së Fitores mbi fashizmin, u detyrua të zërë në gojë në mënyrë demagogjike emrin e Stalinit, tregon se situata e revizionistëve sovjetikë brenda vendit nuk është e mirë. Në këto mbledhje, megjithëse njerëzit i zgjedhin një nga një, janë ngritur të tërë në këmbë për të duartrokitur me minuta sa herë zihej në gojë emri i Stalinit. Mareshalë të njohur, si Zhukovi e të tjerë, kanë filluar tani të shkruajnë kujtimet e tyre, nëpër të cilat, nga pak, po flasin mirë për Stalinin.

Ne e kuptojmë se këto qëndrime të revizionistëve sovjetikë janë demagogji, se të tërë ata që shkruajnë e flasin në këtë mënyrë janë antistalinistë të poshtër, trockistë e revizionistë të regjur, por këtë qëndrim të matur ndaj Stalinit e mbajnë nga e keqja, se e kanë situatën të vështirë, prandaj përpiqen t'i gënjejnë ca kundërshtarët, që ne mendojmë se nuk duhet t'i kenë të paktë. Njerëzit e ndershëm atje bëjnë pyetjen: «Ku po shkojnë revizionistët me rrugën që kanë nisur?»; ata vlerësojnë se koha e Stalinit ka qenë më e mira, se veprimet e tij kanë qenë plotësisht të drejta etj. Por qëndrimet në favor të Stalinit revizionistët sovjetikë i mbajnë me kujdes, pa u nxituar, ndryshe u dalin lakrat, për këtë arsye ata ecin me hapa të peshuar e të llogaritur me zigarenë e farmacistit. Mirëpo një gjë e tillë nuk mund të mos bëjë efektin e vet. Kjo duket qartë se, me të dalë Stalini në ekran, njerëzit duartrokasën, ose sa flitet një fjalë e mirë për të, të shumtë janë njerëzit që guxojnë të brohorasin «Rroftë Stalini!» dhe varrin ia mbushin plot me lule, pse në situatën e krijuar nuk i ndalon dot kurrkush, mbasi

vetë krerët revizionistë janë të detyruar të flasin. Mi-  
rëpo nëse revizionistët flasin një herë për Stalinin, po-  
pulli flet shumë herë.

Me këto dua të them se revizionistët modernë si-  
tuatën e kanë të turbullt. Sidoqoftë, me njëri-tjetrin  
ata janë të lidhur ngushtë e në unitet, si kundër rre-  
zikut të brendshëm, ashtu edhe kundër një rreziku të  
jashtëm. Revizionistët e tjerë përpiqen t'i bëjnë ballë  
rrezikut duke u përpjekur ta çajnë murin që u kanë  
ngritur revizionistët sovjetikë, pse këta i pengojnë të  
kenë lidhje tregtare me vendet kapitaliste e të marrin  
kredi prej tyre etj. Kështu bën Valter Ulbrihti, i cili  
ka marrë kredi të shumta nga Boni dhe, pavarësisht se  
me fjalë grin kundër Republikës Federale të Gjërma-  
nisë, me të ai mban lidhje dhe merr kredi, sikur të  
dyja Gjermanitë të ishin një shtet i vetëm.

Kredi ka marrë edhe Rumania nga të katër anët.  
Tashti po përpiqet të marrë edhe Bullgaria deri në  
Japoni, duke arsyetuar se «Gjersa revizionistët sovje-  
tikë u kanë dhënë vetë koncesione të mëdha japone-  
zëve, epo edhe ne bullgarët keq jemi, sovjetikët s'na  
japin gjë. prandaj të përpiqemi mos zhvatim gjësendi  
nga të tjerët». Revizionistëve të Moskës nuk u pëlqejnë  
të tilla qëndrime. Kjo do të thotë se ka kontradikta  
midis tyre, megjithëse bullgarët janë një, sidomos me  
sovjetikët, Zhivkovi e di fare mirë që pa ndihmën e  
krerëve të Kremlinit s'rri dot në fuqi në Bullgari, se  
populli nuk e do. Të gjitha klikat revizioniste në fuqi  
sulen kush e kush të përfitojë sa më shumë nga kre-  
ditë e vendeve kapitaliste, ndërsa revizionistët sovje-

tikë i pengojnë, duan t'i mbajnë nën fre, pse politikën me vendet përëndimore përpigën ta bëjnë vetë.

Të tërë revizionistët luftojnë të lidhen sa më ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për t'u hedhur në luftë kundër nesh, Kinës dhe lëvizjeve revolucionare e nacionalçlirimtare në botë. Mirëpo rrotat e historisë ecin përpara në kundërshtim me të gjitha dëshirat dhe planet e tyre.

Lidhur me të gjitha këto që thashë, neve na dalin tani detyra të mëdha. Në radhë të parë të mobilizohemi për të realizuar planin e ri pesëvjeçar që po përgatitim, i cili është mjaft i ngjeshur në të gjitha drejtimet. Për këtë do të na duhet të vëmë në zbatim forma të reja të organizimit të punës, të ngremë pa-ndërprerë nivelin tekniko-shkencor të njerëzve tanë, por sidomos nivelin e tyre ideologjik dhe politik. Ne komunistëve, në radhë të parë, na vihet detyrë të bëjmë përpjekje të mëdha që direktivat e Partisë t'i zhvillojmë më tej, t'i thellojmë e t'i zbatojmë sa më mirë. Ato më parë duhet t'ua shpjegojmë masave, që t'i bëjmë të ndërgjegjshme, t'i armatosim me mësimet e Partisë, t'u çelim horizont dhe, si kurdoherë, me Partinë në krye, t'i ngremë në këmbë që të zbatojmë çdo direktivë të saj.

Jam i bindur se detyrat që na dalin përpara do t'i realizojmë, se populli ynë ka energji të mëdha, vetëm ato duhen shfrytëzuar në maksimum. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë porositi në mënyrë të veçantë për zgjidhjen e disa problemeve kyç, siç është ngritja e rolit të gruas në punë, në jetë dhe në shoqëri, për arsye se, po ta ngremë gruan në një stad akoma

më të lartë, planin e ardhshëm pesëvjeçar do ta realizojmë patjetër jo në pesë vjet, po në një kohë më të shkurtër. Shihni, pra, ç'forcë kolosale është duke dalë tani në vendin tonë! Kjo forcë e pallogaritshme, megjithatë, akoma nuk ka dalë si duhet në pah, vëllëzër e motra, jo se nuk duan gratë, por për arsye se janë përkërisht ata «rripa», që nuk janë këputur akoma me të kaluarën, të cilët i pengojnë. Merreni me mend ç'forcë do të krijohet, kur forcës së burrave do t'i shtohet edhe ajo e grave në vendin tonë. Prandaj të përpiqemi që të gjitha detyrat që na vihen, në radhë të parë ato në fushën ideologjike, politike e me radhë gjithë të tjerat, t'i realizojmë dhe e kemi detyrë t'i realizojmë, pse jemi komunistë, kemi eksperiencë, populli ka besim të madh te ne. Është detyra jonë që atij me punë t'i vërtetojmë besimin e madh që na ka dhënë. Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë kanë bindjen e plotë se ju, shokë komunistë të rrethit të Tropojës, i kuptoni drejt direktivat e Partisë dhe luftoni e do të luftoni me të gjitha forcat edhe në të ardhmen për t'i zbatuar në jetë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në*  
AQP

## PARTIA SKALIT TE NJERËZIT VIRTYTET E LARTA TË POPULLIT

*Nga biseda me kooperativistët e Dragobisë*

31 maj 1970

*Shoku Enver Hoxha u prit me një dashuri të jash-tëzakonshme në Dragobi jo vetëm nga anëtarët e kësaj kooperative, por edhe nga shumë fshatarë të tjerë të ardhur nga Çeremi, Valbona e Rragami. Në një shesh të bukur, ku udhëheqësi u shtrua pranë njerëzve të thjeshtë të popullit, u zhvillua kjo bisedë e ngrohtë.*

Sa mirë na mëson dhe na edukon Partia të mbli-dhemi e të jemi kurdoherë kështu si sot, të bashkuar si një zemër e një trup i vetëm. Një gjë e tillë në të kaluarën ishte vetëm ëndërr për popullin shqiptar, po ja që sot u bë realitet. Për ditë si këto që po gëzojmë kanë luftuar qindra vjet me radhë burrat e gratë e Shqipërisë, pse ata e kuptonin mirë që bashkimi dhe uniteti i mbarë popullit do të bënin të mundur që ai kurrë të mos zhdukej, po të rronte i lirë në shekuj. Në fakt, luftëra dhe përpjekje ka bërë pareshtur populli ynë, po lirinë aq shumë të dëshiruar e fitoi vetëm me Luftën heroike Nacionalçlirimtare, të udhëhequr nga

mëma jonë e madhe, Partia, që u lidh ngushtë, si mishi me thoin, me popullin, që na mësoi se bashkimi bën fuqinë, garanton lirinë, sjell përparimin, lulëzimin, mirëqenien e njerëzve.

Të gjitha këto të mira, që ju i shikoni vetë, na erdhën nga Partia që solli popullin në fuqi. Që atëherë ka ndryshuar shumë faqja e vendit tonë, por në radhë të parë kanë ndryshuar njerëzit. Mund të ndryshojnë njerëzit vallë? Po, mund të ndryshojnë nga mendimet, nga gjykimet, nga arsyetimet. Kur i mëson drejt, ata fitojnë aftësi për të bërë mrekulli që s't'i merr mendja, deri edhe bjeshkët i transformojnë e i bëjnë pjellore si fushat. Ja, nga hiçi njerëzit e Shqipërisë së re ngri-tën uzina e fabrika të mëdha, hidrocentrale gjigante, porte e hekurudha dhe sa e sa vepra të tjera. Në vend të pishës që përdorej dikur për ndriçim, jo vetëm në të gjitha shtëpitë e malësorëve, të fshatarëve pa për-jashtim, por edhe të shumicës së qytetarëve, sot shkon kudo drita elektrike. Sa shumë kanë bërë edhe në fshat mendja dhe zotësia e njerëzve tanë të udhëhequr nga Partia gjatë këtyre 25-26 vjetëve! Moçalet i shndërruan në fusha e kopshte të lulëzuara, tufat e vogla me kafshë joprodhuese i kthyen në kope të mëdha jo vetëm me dele e dhi, po edhe me lopë, me derra e me miliona shpendë që prodhojnë më shumë. Kudo janë ndërtuar e vazhdimisht po ndërtohen rezervuarë jo vetëm për të ujitur tokat, po edhe për të rritur peshq, ushqim ky shumë i shëndetshëm për njerëzit etj., etj.

Kam pasur një mall të madh të vija një herë në Dragobinë tuaj, të dëgjuar aq shumë për trimëri, që t'ju shikoja, në radhë të parë, ju malësorët, prindër,



vëllezër, motra, djem e çupa të mia që jetoni në këtë skaj të largët të atdheut, ku të parët tanë dhe ju vetë keni luftuar e tani po punoni me vrull për jetën e re, për socializmin. Dëshiroja të vija një herë këtu për të parë këtë vend të mahnitshëm, nga më të bukurit e Shqipërisë, të shihja jo vetëm bukuritë e tij të mrekullueshme natyrore, por edhe madhështinë e tij të një kështjelle historike të pamposhtur.

Këtë dëshirë të madhe e kisha edhe për arsye se këtu ka luftuar burri i maleve, Heroi i Popullit Bajram Curri, i cili, që në kohën e vegjëlisë dhe derisa vdiq, tok me ju, nuk e la pushkën nga dora, barutin e mbajti kurdoherë të thatë dhe e përdori kundër armiqve, të jashtëm dhe të brendshëm, që përpiqeshin ta shkelnin e ta copëtonin Shqipërinë, ashtu siç edhe e copëtuan, duke lënë Kosovën e vëllezërit tanë të një gjaku e të një gjuhe përtej kufirit. Bajram Curri luftoi kundër feudalëve, agallarëve, pasanikëve që shtypnin fshatarët e malësorët, popullin fukara, që i pinin gjakun dhe i rripnin lëkurën. Prandaj i madh e i vogël në vendin tonë kanë një dashuri dhe respekt të pakufishëm për Bajram Currin; emri i tij është bërë simbol i trimërisë dhe i besnikërisë ndaj popullit. Kur flet për Dragobinë, nuk ke se si ta shkëputësh nga ajo emrin e Bajram Currit, Dragobi e Bajram Curri janë një, ashtu siç është një edhe Maja e Hekurave.

Kujtdo që vjen në Dragobi i shtohet jeta, jo vetëm pse ajri këtu është i pastër, po mbi të gjitha pse gjendet mes jush, njerëz trima, bujarë e me zemër të pastër, që Partinë e doni me gjithë shpirt.

Partia më porositi kohët e fundit të vija për një

vizitë këtej nga Veriu i largët për t'u pjekur me motrat e me vëllezërit nga Kukësi, nga Tropoja, nga Puka, si dhe me punëtorët e Hidrocentralit të Vaut të Dejës. Ajo më porositi t'ju them ju të gjithëve se ditë më të lumtura do të vijnë për popullin, të cilat do t'i sjellim vetë ne, me punë të palodhur, me mendjen dhe me dituritë tona.

Dituria dhe zotësia e popullit janë të pafund. Partia tani e ka vënë në lëvizje gjithë këtë dituri të madhe. Prandaj, ashtu si industria, edhe bujqësia me blegtorinë, si në fusha, edhe në male, gjatë pesë vjetëve të ardhshëm do të zhvillohen akoma më shumë dhe për këtë qëllim po merren kudo masa për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Lidhur me këtë çështje dëshiroj tash t'ju them disa fjalë.

Në radhë të parë, Partia dhe Qeveria kanë vendosur që gjatë planit të ri pesëvjeçar t'i jepen fshatarësisë kooperativiste të zonave malore shuma të mëdha në kredit, me qëllim që këto zona të zhvillohen më tej dhe me ritme më të shpejta se gjer tani. Po çfarë mund të bëhet atje? Sipas nevojave e mundësive, ku ka ujë për të shfrytëzuar, të ndërtojmë kanale për të ujitur tokat, ku ka pyje, të hapim rrugë të reja, të ngremë sharra e të krijojmë një industri akoma më të zhvilluar për prodhimin e lëndës së drurit. Që të furnizohen më mirë populli dhe fshatarësia e malësive, t'i krijojmë kësaj mundësinë për të zhvilluar bimët e arave, në radhë të parë, misrin dhe grurin, nga të cilat të mos marrë prodhime të vogla si në kohët e kaluara, por të korra të mbara dhe të sigurohet buka.

Qysh tash sasia e drithërave po rritet e do të rritet

vazhdimisht në të ardhmen me masat që do të merren, si duke sjellë më shumë vegla bujqësore e traktorë, farëra të zgjedhura, por edhe bagëti të racës, sidomos lopë të racave të njohura që jemi duke i importuar me shumicë, me qëllim që brenda pak vjetëve edhe ju këtu në livadhet e bukura të Dragobisë të keni lopë prodhuese të rendimenteve të larta, të shtoni sasinë e qumështit, të mishit e të plehut. Kjo do të na japë mundësi të bëhet misri me bollëk edhe në një vend malor si ky juaji.

Në rrethet e largëta, si, për shembull, në Kukës, do të zhvillojmë industrinë për përpunimin e prodhimeve bujqësore, të cilat në vitet e ardhshme do të jenë më të mëdha. Kështu do të ndodhë edhe në rrethin tuaj, ku do të shtohen sidomos pemët në atë shkallë sa të ngremë edhe këtu një numër fabrikash të vogla për përpunimin e frutave.

Industria që po zhvillohet në vendin tonë punon me energji elektrike. Për këtë qëllim janë ndërtuar e po ndërtohen kudo hidrocentrale të mëdha e të vogla. Afër jush, në Fierzë, do të ndërtohet një tjetër hidrocentral që do të jetë më i madhi në vendin tonë, bile një nga më të mëdhenjtë e Evropës. Ai do të na japë energji me të cilën do të punojnë kombinatet dhe fabrika të tjera të reja, që të prodhojnë më shumë mallra për nevojat e përdorimit në jetën e përditshme, makineri e orendi shtëpiake që do të lehtësojnë punën tuaj në ara, në fabrika, në shtëpi etj.

Veprat që ka ndërtuar dhe ndërton Partia i shërbejnë interesit të të gjithë njerëzve tanë dhe jo vetëm disave, si në të kaluarën. Populli këtë e sheh, prandaj

punon me të gjitha forcat, prandaj po bëhen e do të bëhen te ne gjëra të tjera më të mëdha. Por gjithë këto vepra nuk ngrihen vetëm me dëshirë e me hov revolucionar; bashkë me vullnetin e mirë dhe me vendosmërinë duhet edhe dituria. Për këtë qëllim Partia e këshillon popullin të dërgojë djemtë dhe cucat në shkolla që të mësojnë.

Në të ardhmen do t'i vihet rëndësi më shumë se gjer tani edhe shëndetit të popullit. Nevojat tona në këtë fushë nuk përballohen dot me kaq mjekë sa kemi tash, po me mijëra. Partia dëshiron të ketë mjek jo vetëm në çdo kooperativë, por edhe në çdo fshat, të ketë mami, infermierë, farmacistë e të tjerë, që njerëzit të gëzojnë shëndet të plotë. Neve na duhet dhe po luftojmë, gjithashtu, që në çdo kooperativë bujqësore të kemi patjetër agronomë, zooteknikë, veterinerë e ndihmës të tyre, dhe jo vetëm nga një, po aq sa e lypin nevojat.

Përse na duhet t'i kemi gjithë këta kuadro? Populli ka një eksperiencë të madhe. Ju fshatarët, për shembull, dini shumë gjëra për bujqësinë, se tërë jetën keni punuar e keni prodhuar në këtë sektor. Megjithatë, në shkollë mësohen gjëra të tjera të reja që ju nuk i dini. Prandaj, duke bashkuar atë që të rinjtë dhe të rejat marrin në shkolla, me diturinë e popullit, bujqësia jonë do të përparojë me siguri më shpejt, domethënë do të kemi me bollëk grurë, misër, gjalpë, djathë e çdo prodhim tjetër, që populli të rrojë i gëzuar dhe i lumtur. Për këtë punojnë e luftojnë Partia dhe Qeveria, prandaj, njëkohësisht, të përpiqemi të mësojmë, t'i dërgojmë djemtë edhe cucat në kurse, në shkolla, në aksione e

kudo dhe të mos kemi frikë nga asgjë, pse vetëm me punë dhe me mësim do të ecim kurdoherë përpara.

Shumë nga ju kanë vizituar vende të ndryshme të Shqipërisë, ku kanë vënë re përparimet e mëdha që janë bërë. Këtë e kanë parë edhe shumë nga cucat që keni dërguar në kurse e shkolla, në aksione etj. Së pari, dëshiroj t'ju falënderoj në emër të Partisë që i keni lejuar cucat të shkojnë të takohen e të punojnë me motrat e tyre në krahina të ndryshme të atdheut, ku janë miqësuar me vajzat atje, janë njohur me njëra-tjetrën e janë bërë si motra të pandara, kanë parë fabrikat, fushat, detin e gjerë të Shqipërisë dhe janë kthyer në familje po aq të pastra e të ndershme, por më të forta e më të çeliktë, ashtu siç është vetë populli i këtyre bjeshkëve, që nuk ka njohur kurrë as poshtërsinë, as tradhtinë, por kurdoherë ka mbrojtur lirinë, bujarinë, mikpritjen e ndershmërinë.

Partia i ka vënë rëndësi të dorës së parë moralit të lartë të popullit dhe e mbron me forcë atë. Njeriu, qoftë burrë, qoftë grua, duhet të jetë i ndershëm në punë, në jetë e kudo. Prandaj Partia punon dhe i këshillon njerëzit të jenë kudo e në të gjitha rastet të ndershëm në marrëdhëniet midis tyre, sepse vetëm kështu vendi do të bëhet i çeliktë. Në mënyrë të veçantë shembull ndershmërie duhet të bëhen të rinjtë e të rejtat, pse kështu do të fitojnë besimin e prindërve të mosshuar, që kanë edhe ata pikëpamjet e tyre për këtë çështje. Prindërit kanë shumë qeder për cucën, kur largohet nga familja për të punuar në aksion ose në një fabrikë, dhe unë mendoj se kanë plotësisht të drejtë, mbasi duan të mos i ngjasë asgjë e keqe. Mirëpo ky

shqetësim i tyre shuhet, pse jo vetëm janë të bindur që cucat shqiptare janë vetë trimëresha dhe nuk guxon kush t'i njollosë, por Partia që i mban kurdoherë sytë hapur, kudo ku venë ato, e ka organizuar punën në atë mënyrë që të gjejnë shoqe të tyre më të pjekura, prandaj sot e ka vështirë njeriu i lig t'u bëjë keq atyre. Ne e themi haptazi se tashmë ka kaluar koha që disa njerëz pa moral t'u vijnë rrotull cucave. Partia, që çështjen e nderit e mbron me gjithë shpirt, është në gjendje t'u përdredhë kokën disa vagabondëve. Pastaj, ajo punon vazhdimisht t'u hapë sytë vetë vajzave dhe grave, pse kështu ato do të bëhen më të zonjat për të mbrojtur nderin, të drejtat dhe interesat e tyre, të familjes, të rrethit dhe të gjithë Shqipërisë. Ashtu sikurse këshillon burrat të veprojnë kurdoherë në rrugën e popullit, sepse kjo është në interesin e secilit, në interes të familjes dhe të të gjithëve, po ashtu punon Partia me gratë e me vajzat që ato të edukohen drejt e të bëhen luftëtare të vendosura për zbatimin në jetë të mësimëve të saj, një nga të cilat është edhe ajo që gruaja të mbrojë veten për çdo gjë, ashtu sikurse edhe burri, dhe jo siç kujtonin më parë njerëzit me mendime të vjetra, që përçmonin forcat dhe mundësitë e mëdha të gruas. Tash njerëz me të tilla mendime kanë mbetur shumë pak, por edhe këta Partia po i fut në zdrukthin e saj, ajo përpiket t'i ndreqë të gjithë.

Fola më sipër për agronomë, për veterinerë e për mjekë, tashti do të them diçka edhe për mësuesit. Ne kemi e duhet të kemi edhe më shumë shkolla. Partia tash në çdo fshat ka ngritur shkollë fillore, po mësimi

që merret atje s'mjafton, prandaj na duhet që ato t'i bëjmë të gjitha tetëvjeçare, me qëllim që në një kohë të shkurtër të mos mbetet asnjë cucë dhe asnjë djalë pa arsim tetëvjeçar, bile sa të krijojmë mundësi, do të vijë koha që asnjë prej tyre të mos mbetet pa mbaruar edhe të mesmen. E merrni me mend ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që në të ardhmen Shqipëria të ecë përpara me vrull shumë më të madh se gjer tani. Sepse, midis të tjerave, janë marrë masa për t'u dhënë arsim njerëzve në vendin tonë, se punëtorët, fshatarët, tërë populli ka mësuar e po mëson nëpër shkolla, prandaj janë arritur gjithë këto përparime në industri e në bujqësi, në arsim e në kulturë, në shëndetësi e në rritjen e mirëqenies së masave punonjëse dhe njerëzit tanë janë bërë çdo vit e më shumë të aftë të kryejnë si duhet çdo detyrë që u ngarkohet.

Në fushën e arsimit dhe të kulturës ne sot jemi më përpara nga shumë popuj të tjerë në botë, po jemi shumë më përpara sidomos nga diçka tjetër, që s'e kanë të tjerët, nga shpirti revolucionar, nga ndjenjat e larta të humanizmit socialist, dhe në këtë drejtim nuk na arrin dot kush. Këto ndjenja e tipare Partia i rrit dhe i forcon dita-ditës te njerëzit tanë.

Një nga këto tipare është edhe dashuria që duhet të kemi për njëri-tjetrin. Dashuria për njeriun te ne është në një nivel të lartë. Kur ju vjen nga një krahinë e largët në fshat ndonjë cucë si mësuese, ju kujdeseni për të si për cucën tuaj. Po edhe vajzat tuaja shkojnë në aksione, si në hekurudhë, në hapjen e tarracave etj., ku gjejnë të njëjtin kujdes e pritje të ngrohtë, njëlloj sikur të ishin pranë familjeve e prindërve të tyre. Ja,

pra, ç'ka krijuar socializmi në vendin tonë, prandaj gjithnjë e më shumë ta duam shoku-shokun. Krejt ndryshe ndodh në vendet kapitaliste, ku njeriu për njeriun është ujë.

Një tipar tjetër i njeriut në vendin tonë është ndershmëria, e cila ka, gjithashtu, rëndësi të madhe në jetën e një populli. Të jemi të ndershëm në çdo punë, na mëson Partia. Kjo veti po forcohet çdo ditë e më shumë te njerëzit tanë, ndërsa në vendet kapitaliste përpiqen kush të jetë kusari më i madh, për të vjedhur dhe për të vrarë popullin. Krejt ndryshe është te ne. Partia i mëson njerëzit të mos rrejné, të mos grabitin, të mos i bëjnë keq askujt. Edhe kur ndonjë shkon në rrugë të gabuar, ajo e mbërthen nga supet, e shkund mirë dhe e këshillon të ecë në rrugë të drejtë, pastaj ndjek sa do të reflektojë ai dhe ç'ndryshim do të bëjë. Po të ecë në rrugë të drejtë, Partia do ta inkurajojë, por në qoftë se vazhdon në rrugën e vjetër, do ta thërrisë edhe një herë, do t'i shkulë veshin dhe, po të mos ndreqet, do të marrë masa. Kjo ka ndihmuar që veprimet e mbrapshta në vendin tonë sa venë e zhduken. Do të ishte gabim po të thoshim se ato janë zhdukur krejtësisht, pse ka edhe njerëz të ligj, po fakt është se me kalimin e kohës numri i tyre zvogëlohet. Tash, kur ndonjëri bën ndonjë gabim, nuk çohet në gjyq, si në kohën e Ahmet Zog tradhtarit, po nxirret përpara popullit, ku sekretari i Partisë ose gjyqtari tregon çfarë ka folur apo çfarë gabimi ka bërë, njerëzit tregojnë dhe diskutojnë nëse është e vërtetë apo jo akuza dhe, po të vërtetohet, të akuzuarit i kërkohet të pohojë fajin e në fund kundër tij merret masa që gjy-



kohet e arsyeshme. Po të vërtetohet nga populli se nuk është fajtor, se është njeri i ndershëm, se është akuzuar kot etj., ai merr pafajësinë. Siç e kuptoni, gjyqi bën më shumë efekt në mes të popullit, ai që gabon ndihet kështu i turpëruar përpara të tjerëve dhe me siguri do të bëjë përpjekje ta ndreqë gabimin, kurse atij që s'është fajtor, i vihet nderi në vend. Puna e vazhdueshme e Partisë ka bërë që njerëzit tanë të edukohen, t'u forcohet karakteri, duke zhdukur gradualisht mbeturinat që vazhdojnë t'u qëndrojnë në ndërgjegje.

Një tjetër veti që ka skalitur tashmë Partia te njerëzit tanë dhe që ka rëndësi të madhe është kuptimi i çdo problemi në radhë të parë politikisht. Në vendet kapitaliste njerëzit nuk mendojnë kështu, ata nuk gjykojnë nëse kjo ose ajo punë që bëjnë është e drejtë politikisht, nëse u shërben popullit, atdheut etj., po mendojnë së pari nëse i shërben interesit të tyre të ngushtë personal, pse atje askush nuk çan kokën për të tjerët. Krejt ndryshe ndodh tash te ne. Kur duhet ndërtuar, ta zëmë, një fabrikë, një urë apo të hapet një kanal në një vend, njerëzit tanë pyesin: «Përse po e bëjmë këtë shpenzim, i shërben ky objekt popullit të krahinës apo jo?». Në rast se gjykohet se objekti do t'i shërbejë popullit, atëherë vendoset të bëhet. Fabrika, kanale etj., ndërtohen edhe në vendet kapitaliste, veç jo për të mirën e popullit, por për ta rrjepur atë. Kur ndërtohet, ta zëmë, një kanal, sipërmarrësi para së gjithash mendon që ujin për të ujitur tokat ta shesë sa më shtrenjtë, kështu, kur vjen koha që fshatari të korrë misrin, atij nuk i mbetet gjëkafshë. Pra, në vendet kapitaliste njeriu mendon vetëm për xhepin e vet dhe

në dëm të të tjerëve, kurse ne Partia na këshillon të mendojmë për popullin, domethënë të mendojmë politikisht. Kjo tash është arritur në vendin tonë.

Të tilla virtyte të larta është duke ua skalitur Partia njerëzve tanë. Ajo lufton për ditë që ato të rrënjosen te të gjithë, pse kështu do të jemi të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, do të kemi unitet.

Uniteti ynë duhet të jetë i çeliktë, për të të punojmë e të luftojmë të gjithë, ndryshe nuk është e mundur t'i mbrojmë fitoret e arritura. Uniteti nuk forcohet duke ruajtur në ndërgjegje një tog mbeturinash të dëmshme të së kaluarës. Ka akoma ndonjë që, kur sheh se cuca e një punëtori ose fshatari të varfër caktohet brigadiere, komandante batalioni vullnetar etj., flet poshtë e lart me përbuzje: «Kur u bë edhe kjo të na komandojë ne». Ja, kjo është një mbeturinë e dëmshme në ndërgjegjen e ndonjë të prapambeturi. Partia duhet të përpiqet ta edukojë edhe atë, duke i bërë të ditur se plot cuca e gra të atilla kanë dalë dhe më parë në mbrojtje të atdheut, sidomos në Luftën Nacionalçlirimtare, të cilat kanë luftuar krah për krah burrave e vëllezërve të tyre, njëlloj si ata. Nuk ishte Shota e Azem Galicës një trimëreshë heroinë e popullit kosovar, që tok me Azem Galicën e me Bajram Currin luftonte kundër serbomëdhenjve për lirinë e Kosovës? Po ato qindra e mijëra gra e vajza shqiptare që u hodhën në radhët partizane gjatë Luftës Nacionalçlirimtare? Sa mijëra gra e vajza të vendit tonë janë hedhur në sulm sot në punën e madhe ndërtimtare për jetën e re për popullin dhe janë pajisur me zotësi për të drejtuar në të gjithë sektorët? Megjithatë edhe tash ka njerëz që

nuk mendojnë drejt dhe, kur shohin një cucë të shka-  
thët që u bën thirrje anëtarëve të brigadës të hidhen  
në sulm për të kapërcyer normat, që u thotë mëmave  
dhe motrave t'i hedhin poshtë zakonet e vjetra, të  
shkojnë në dispenseri të kurohen kur sëmuren nga të  
ftohtit, të shkojnë te mamia ose në maternitet kur u  
vjen koha e lindjes, të braktisin mënyrat e vjetra të  
rritjes së fëmijëve që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe  
të kalamanit, del nga qoshja ndonjë mendjendryshkur  
që flet keq kundër saj dhe thotë: «Ç'është kjo cucë,  
ç'na thotë ajo kështu?» dhe frenon me fjalë hovin e saj  
revolucionar. Jo, motra e vëllezër, nuk është ai, po  
cuca që ka të drejtë, pse ajo është e brumosur me  
mendime të reja. Përse na qenka turp të vejë gruaja  
për të lindur në maternitet? Shumë drejt na këshillon  
Partia t'i zhdukim të gjitha mbeturinat dhe, në fakt,  
dita-ditës, me luftë e me përpjekje, po i zhdukim, pran-  
daj gjithnjë e më shumë po fitojnë mendimet e reja.  
Populli i kupton këto gjëra shumë mirë dhe ka besim  
të madh te Partia.

Një veti tjetër shumë e mirë e njerëzve tanë është  
vigjilenca. T'i hapim sytë katër e të mos na zërë gjumi,  
motra dhe vëllezër, asnjëherë të mos e flemë mendjen  
duke kujtuar se tash askush s'ka ç'na bën. Barutin ne  
duhet ta mbajmë kurdoherë të thatë. Pushkën mbajeni  
pranë ditë e natë. Dhe kur vjen dita e stërvitjes, të tërë  
duhet të shkojnë si një trup te vendi i caktuar, asnjë  
të mos mungojë. Ne do ta organizojmë ushtrinë në një  
mënyrë të atillë që kudo, në çdo vend ku ka mundësi,  
të krijohet skuadra, toga, batalioni, brigada dhe të gji-  
thë me radhë të pajisen me armët e nevojshme.

Dëgjoni ju trima e trimëresha të Valbonës e të Dragobisë, njeriu ynë sot nuk mjafton të stërvitet vetëm për të qëlluar me pushkë. Një gjë të tillë e kanë bërë bukur gjyshërit e stërgjyshërit, e kemi bërë edhe ne. Po ta kërkojë nevoja e mbrojtjes së atdheut, këtë do ta bëjmë përsëri e, me siguri, do ta bëjnë edhe djemtë e nipërit tanë, por tash ne duhet të mësojmë edhe armët e tjera që kemi e, veç atyre, duhet përvetësuar taktika ushtarake që të mëson si ta futësh armikun në kurth, kur duhet sulmuar, kur duhet shkuar përpara, kur duhet kthyer prapa etj. Lenini na ka mësuar të ecim kurdoherë përpara, po ai na ka këshilluar se, ndonjëherë, kur lind nevoja, është e domosdoshme të bëhen një ose dy hapa prapa, për t'u hedhur më vonë me vrull përpara 20 hapa përnjëherësh. Kështu është puna e luftës. Dhe të gjitha këto mësohen në ushtri. Prandaj përpiquni t'i përvetësoni sa më mirë këto mësimet të vlefshme. Ato do t'ju mësojnë oficerët e ngarkuar me këtë detyrë, që janë bij besnikë tuajt dhe të Partisë, të cilët kanë mësuar për vete dhe tani janë ngarkuar t'ju mësojnë edhe juve këto gjëra. Prandaj u vini veshin mirë mësimëve që merrni atje, me qëllim që, në rast rreziku, të tërë, i madh e i vogël, të ngrihemi në këmbë si ushtarë. Nuk flas vetëm për të rinjtë e të rejtat, po edhe për njerëz të moshuar. Ju sigurojmë se edhe ne të moshuarit, me këto forca që kemi, edhe dy luftëra të tjera bëjmë. Por jo vetëm ne, po edhe babën që kemi këtu dhe që ka mbi 80 vjet, po të ngjasë ndonjë rrezik, do ta marrim pranë shtabit të kompanisë apo të batalionit që të na mësojë me eksperiencën e tij të madhe, të na tregojë ku t'i biem armi-

kut në këtë ose në atë qoshe, si ta futim në kurth, siç bënte baca Bajram Curri që përhapte lajmin nga do të shkonte, kurse ai merrte një drejtim tjetër, sepse kishte kurdoherë parasysh që armiku duhet gënjyer e futur në kurth, gjersa t'i presësh kokën. Prandaj të gjithë, burra e gra, të rinj e të reja, të stërvitemi e të bëhemi ushtarë të çeliktë të republikës.

Dëshiroj t'ju them edhe një gjë. Nuk ka vend si Shqipëria, ku gjithë populli ka armë. Asnjë qeveri në botë nuk i jep popullit armë si ne. Po pse e ka bërë këtë Partia? Sepse shteti ynë është i popullit, shtet popullor, që udhëhiqet nga Partia. Në vendin tonë çdo gjë është e popullit. Ky është në fuqi, punon, ndërton, qeveris, ka edhe armë për t'u mbrojtur. Ai ecën në rrugën që i tregon Partia dhe e sheh se s'ka rrugë më të drejtë se ajo e diktaturës së proletariatit.

Për këtë arsye ne po ecim me hapa të shpejtë drejt përparimit dhe jemi të sigurt se në të ardhmen do të bëjmë hapa edhe më të mëdhenj. Për këto që them bazohem në realitetin tonë, çdo gjë te ne e bën vetë populli dhe bëhet për popullin. E shikoni këtë cucë malësore këtu përpara? Kjo është e zonja të bëjë gjëra të mëdha. Por në të kaluarën të zezat gra e vajza mbylleshin në katër muret e shtëpisë ose i çonin për të ruajtur kecërit nëpër pyll, kurse tash që u janë hapur sytë nga Partia, ato janë në gjendje të komandojnë me mijëra veta dhe njerëzit të kenë besim të plotë në fitore nën komandën e tyre. Ja ç'bëri Partia, pa udhëheqjen e së cilës nuk mund të arriheshin këto gjëra.

Ju nuk mund ta merrni dot me mend, vëllezër dhe motra të Dragobisë, ç'forcë të madhe po marrim ne nga

ardhja sot këtu pranë jush, sa shumë na shtohet besimi kur marrim kontakt dhe ju shohim kaq të gëzuar, entuziastë, të gatshëm për punë e për mbrojtje. Ju i kuptoni drejt direktivat e Partisë dhe i zbatoni me këmbëngulje, duke kapërcyer çdo vështirësi që ju del dhe mund t'ju dalë përpara. Vështirësitë nuk ju trembin, ashtu siç nuk ju tremb bora e madhe që bie në këto bjeshkë të larta dhe për një kohë duket sikur ju izoloni, siç nuk ju trembin ortekët e mëdhenj e të përbindshëm që rrokullisen poshtë nëpër këto hone të thella. Me gjithë këto vështirësi të mëdha të natyrës së ashpër të bjeshkëve, ju nuk lëvizni këtej. E tillë është edhe Partia, e patundur në rrugën e saj. Shqipëria ka ndeshur dhe ndesh ortekë të mëdhenj rrugës së vet, por ata i kapërcen me sukses, pse populli ka tani Partinë që e udhëheq, forca e madhe e saj shkrin të tëra vështirësitë që na dalin, siç shkrin dielli borën.

Ju uroj nga zemra, vëllezër dhe motra, suksese sa më të mëdha në punë dhe në jetë.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli i Dragobisë!

*Botohet për herë të parë si-  
pas shënimeve të mbajtura në  
këtë takim që gjenden në AQP*

## EDHE NJËZET JETË PO TË KESH TË PUNOSH, POPULLIT NUK IA LAN DOT

*Nga biseda me patriotin Ali Shabani*

31 maj 1970

*Pas takimit me kooperativistët e Dragobisë dhe me malësorët e ardhur nga fshatrat e grykës së Valbonës, shoku Enver Hoxha shkoi dhe vendosi një kurorë te lapidari i ngritur në afërsi të vendit ku është vvarë, duke luftuar, nga mercenarët e Ahmet Zogut Heroi i Popullit Bajram Curri. Në livadhin e gjelbër buzë Valbonës u ul gju më gju me vendësit dhe zhvilloi një bisedë shumë të ngrohtë me plakun patriot Ali Shabani, bashkëluftëtar i Bajram Currit.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nga patriotë të tillë si ju ne jemi frymëzuar dhe kemi mësuar qysh në vegjëli si ta duam atdheun. Shembulli dhe veprimtaria juaj na kanë brumosur mendjen e zemrën dhe na kanë nxitur të ndjekim rrugën ku keni ecur ju përpara brezit tonë. Ju jeni nga ata atdhetarë që na keni mësuar rrugën e patriotizmit të gjyshërve e të stërgjyshërve, na keni ushqyer me traditat e mëdha luftarake që mbahen kurdoherë të gjalla nga brezat e rinj të popullit shqiptar,

tradita që nuk janë shuar kurrë, përkundrazi, brez pas brezi janë ruajtur e janë forcuar gjithnjë e më shumë, ndërsa tash Partia këto i ka ngritur në një shkallë shumë më të lartë.

Partia e ktheu edhe figurën e Bajram Currit në një dritë të madhe për gjithë Shqipërinë. Sot nuk ka njeri në vendin tonë që të mos njohë emrin e këtij patrioti të madh, të kësaj shqiptonje të maleve tona le gjendare. Përse e ngriti atë Partia? Sepse ai ka luftuar për popullin, për drejtësinë. Pas vrasjes së tij, në ato kohë shumë të këqija që erdhën për popullin, njerëzit që kishin luftuar për drejtësinë i pllakosi errësira, e cila u zhduk vetëm me ardhjen e Partisë, dhe figura të mëdha kombëtare, si ato të Bajram Currit, të Azem Galicës, të Avni Rustemit, të Çerçiz Topullit e të tjerë, u ngritën në vendin që meritonin për të edukuar e për të frymëzuar me veprën e tyre brezat e rinj të Shqipërisë.

Partia, siç e dini edhe ju, ka bërë shumë gjëra të mëdha.

*SHOKU ALI SHABANI:* Fati ynë asht Partia, je Ti. Rrnofsh që na i ke ba të gjitha, na e ke ba popullin të lumtun, e unë, kur të kam pa, s'kam mujt me i ndal lotët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të falemnderit shumë për këto që the. Ti po më jep kurajë të punoj edhe më tepër e me forca akoma më të mëdha, të jem kurdoherë besnik e shërbëtor i popullit, të mos më rritet kurrë mendja, të jem njeri i thjeshtë si populli, të punoj për të me të gjitha forcat, derisa të kem fuqi.

Edhe pse nga viti në vit po na ikën mosha, ndihe-



mi të fortë, pse Partia po na gjallëron e na bën dita-ditës më të freskët, prandaj na duket sikur jemi të rinj dhe me të vërtetë të rinj jemi nga zemra. Po ta dojë puna, edhe shpatin mund ta ngjitim, dhe shembull për këtë kemi Bajram Currin. Ai 64-65 vjeç ka qenë, por me ç'lehtësi i ka kaluar këto rrugë kaq të vështira, që, kur i shikon tash, njeriu çuditet.

*SHOKU ALI SHABANI:* Ka ardh në kamb prej atje der q'aty (*tregon me dorë vendin*). Asht një shpell që ktu. Aty ka ba dimnin me gjashtë vetë, Sali Manin, Avdi Bajramin, Ali Nimanin, e, kur i kanë rrethue, i kanë thanë: «Nisu, se ne po luftojmë». Dhe ata kanë luftue.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është. Ata luftonin, po ne nuk çuditemi, pse mendojmë që atyre u jepte krah dhe zemër çështja e madhe e popullit. Prandaj, duke dalë nga shpella, bacë Bajrami i kapërceu si flutur këto rrugë të vështira me Sali Manin dhe me Avdi Bajramin, gjersa u vra.

*SHOKU ALI SHABANI:* Bash prej atij thepit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Matanë, po, me Sali Manin, me Avdi Bajramin.

Avdiun e kam mik, tash ai është ca i sëmurë në spital dhe jam i bindur se i vjen keq që nuk u ndodh këto ditë në Tropojë. Kam dëgjuar se u bë më mirë, është duke u shëruar dhe kjo na gëzon.

Të jetosh këtu në bjeshkë është shumë mirë për shëndetin. Sa vend i mrekullueshëm ky juaji! Vetëm se njeriu duhet të ruhet nga era.

*Shoku Enver Hoxha vuri dorën në gjoksin e Ali Shabanit dhe, kur pa se ai kishte fanellë leshi, vazhdoi:*

Bën shumë mirë që mban fanellë. Fanellat e leshit nuk duhen hequr këtu, sidomos nga të moshuarit, sepse kur djersin, plaku ftohet më lehtë. Ndryshe është me të rinjtë, ata janë të fortë, megjithatë, në vende të tilla edhe ata duhen këshilluar e duhen mësuar që të ruhen nga gjoksi, se era këtej është mjaft e ftohtë, por, kur ruhesh, ajri i këtushëm të jep shëndet të madh. Ja, edhe Avdiu nga e ftohta u sëmur.

S'i iket njeriut nga ky vend, ore shoku Ali Shabani. Nuk bëjmë këtu një shtëpi ose një kasolle me dërrasa dhe rrimë të dy së bashku me gjeologët?

*SHOKU ALI SHABANI:* Ata janë të mirë e punëtorë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ku e ke shtëpinë zotrote?

*SHOKU ALI SHABANI:* Në Valbonë, në katund.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Zotrote më the se e ke shtëpinë në Valbonë. Unë mbrëmë u hëngra me shokët, u thosha të shkojmë edhe në Valbonë, po ata më përgjigjeshin: «Nuk shkon dot, se ka rënë një ortek». «Jo, kundërshtoja unë, më duket se po më gënjeni, pse mendoni që lodhem», po ata ngulnin këmbë që nuk më gënjenin. Më në fund u dorëzova, shumica më mundi. «Vetëm më morët në qafë, more shokë, ua përsërita, më vjen keq që Valbonën nuk e pashë dot».

*SHOKU ALI SHABANI:* Na boll t'pamë ty, t'u ngjat jeta!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Hysniu që ka ardhur në këto anë më ka folur shumë dhe më këshilloi që të vija ta shihja një herë këtë vend, se është shumë i bukur, prandaj kisha dëshirë kaq të madhe.

*SHOKU ALI SHABANI*: I bukur â.

*SHOKU ENVER HOXHA*: (*Duke i zgjatur pake-tën e cigareve shokut Ali Shabani*): Mos u ngre fare, hiç, rri në dhe.

*SHOKU ALI SHABANI*: Po marr dhe një.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Domethënë ka rënë or-tek? Pra nuk më kanë gënjyer. Atëherë jemi në rregull (*qeshin*).

*SHOKU ALI SHABANI*: Njëherë shyqyr që je shëndosh Ti e t'u ngjat ymri edhe dyfish ma shumë se e ke ba, një. E dyta, mbasi të kemi Ty, Shqipnia â ba ar, dukat, kurrnjisend mangut nuk na ke lan me Par-tinë. Ma në rregull në bot kush, për qe at popull, nuk â. Në saje tande dhe të Partisë jemi kshtu. Por na u ke dhimt që ke hjek keq. Maje njashtu qysh e ke, Enver Hoxha, e mos thuej kam dy milion, po thuej kam 200 milion. Kët fjalë maje siç e ke, burrçe.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Ashtu do të bëj, si po më thua.

*SHOKU ALI SHABANI*: Se popullin e ke mbarë prej veti, se na e ke zbardhun kët shpirt. Jemi kenë të shkelun, të humbun, shkel ai, mbyt ai, vra ai. Sot, në saje tande e të Partisë, jemi kshtu na. E pse të jesh keq, maje qashtu qysh e ke, mos u lig, se je 200 mi-lion e jo 2 milion.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Kurrë nuk do të ligem.

*SHOKU ALI SHABANI*: Nji pllamb tokë, një vorr në skaj.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Ashtu është, ashtu. Gji-thë këto fjalë që më the do të qëndrojnë tërë jetën të rrënjosura thellë në zemrën time dhe të shokëve që

janë me mua. Kështu na mëson vazhdimisht Partia. Më the që kam vuajtur, po vuajtjet e mia janë vuajtjet e gjithë popullit. Ne njerëzit e Partisë nuk duhet të lejojmë që populli të vuajë, kurse vuajtjet e një njeriu, siç jam edhe unë, s'janë gjë hiç, se janë të një personi dhe secili e ka për detyrë të shkrihet për interesat e popullit. Sa shumë ka bërë populli për Partinë, prandaj jeta ime s'vlen hiçgjë përpara jetës së popullit. Edhe njëzet jetë po të kesh të punosh e të vdesësh njëzet herë, prapë popullit nuk ia lan dot.

*SHOKU ALI SHABANI:* Ti ia ke la.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kurdoherë njeriu popullit i është borxh. Kështu na mëson Partia, baca Ali.

*SHOKU ALI SHABANI:* Po, po.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po kush është Partia? Ne, ti, unë, tjetri, bijat dhe bijtë e popullit. Shumë nga ne u futën në Parti, ajo na mësoi pikërisht me këto fjalët e tua, na mësoi të çmojmë mendimet e popullit, na mësoi të njohim dëshirat, forcën dhe qëndrueshmërinë e tij.

*SHOKU ALI SHABANI:* Q'ajo të mban.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Partia na porosit të ecim në rrugën që the ti dhe të njohim se për luftë s'jemi 2 milionë, po jemi sa për 200 milionë. Këtë shprehje e the ti plaku i Valbonës, po këtë e ka thënë edhe Partia. Kështu si the ti duhet ta ndiejë veten të fortë komunisti, të mos ligështohet, po ta konsiderojë veten 100 herë më të fortë se armiku. Këtë që na mëson Partia, ti e the me zemër.

*SHOKU ALI SHABANI:* Me zemër.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me gjuhën e malësorit

të këtyre bjeshkëve. I madhi ynë Karl Marksi këto fjalë të urta i ka thënë në librat e tij që ne mësojmë çdo ditë dhe kjo shprehje ka një kuptim të madh. Komunisti nuk duhet të ligështohet kurrë në luftëra, në betejë, në punë, në çfarëdo vështirësie, por t'i kapërcejë të gjitha me vullnet të hekurt, se vetëm kështu arrihet fitorja. Dhe ne po ecim në rrugën që na ka treguar Marksi, prandaj po fitojmë dhe kurdoherë do të fitojmë.

*SHOKU ALI SHABANI:* O ku je!

*NJË SHOK:* O Ali! Shpjegoi dy fjalë Enver Hoxhës si ka luftuar Mushak Haxhia.

*SHOKU ALI SHABANI:* Mushak Haxhia ka luftue në Cernagorë me Danarav Veshoviqin me shtatë bataliona. A hy e asht shkri me gjith shpi me mashkuj e me gjith e deri 700 petica<sup>1</sup> i kanë kthye në kual. . .

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po punojnë kohët për ne. Këtu keni sharra a ndonjë gjëkafshë?

*SHOKU ALI SHABANI:* Sharra është atje, këto janë shtëpija.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kështu me ekonomi mirë jeni?

*SHOKU ALI SHABANI:* Po, po, mirë, i kemi në rregull. Bukë kemi, ka Qeveria, na ka dhanë, për kurrëgjja s'jemi mangut.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po këto dyqanet erdhën në Valbonë?

*SHOKU ISUF SADIKU<sup>2</sup>:* Po, po, kemi dyqane, kemi klube.

1 Serbisht — monedhë pesëfrangëshe.

2 Në atë kohë drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike.

*SHOKU ALI SHABANI:* Krypën e kemi si në Durrës, si këtu. Në kohën e Zogut kam dhanë një dhi për dhjetë kile krypë. Atje bajke tre lek e ktu një dhi tash bajke 3 000 lekë<sup>1</sup>. Unë me 3 000 lek tan Valbonën e mbaj motmot tash me krypë (*të qeshura*). Në saje të Partisë e tanden i kemi të tana. (*Të gjithë: «Të lumtë goja!»*.) Dreqi Ahmet Zogu ndenji gati 20 vjet e asnjë shenjë s'na i la, veç na ropi. Mori arin e shkoi e hangri dreqi e kurrë mos u dëgjoftë emri i tij, as i sulltan Hamitit, i të dyve. Sulltan Hamiti as me m'çu në shkollë, sot unë 80 vjeç e pa shkollë mbeç si hu, ç'ka t'ma këndoj kush një letër.

*Pas bisedës shoku Enver Hoxha u përshëndet për-zemërsisht me patriotin Ali Shabani e me malësorët e tjerë dhe u largua.*

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## NE KËTO BJESHKË MADHËSHTORE NE MOREM NJË FRYMËZIM TË MADH

*Fjala në darkën e shtruar me rastin e përfundimit  
të vizitave në rrethin e Tropojës*

**31 maj 1970**

Të dashur shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra,

Në këtë darkë të ngrohtë, shoqërore e kaq vëllazërore më lejoni që, në emër të shokëve dhe timin, t'ju shpreh ndjenjat më të zjarrta të mirënjohjes së zemrave tona për pritjen madhështore dhe për dashurinë e pakufishme që ju shprehni për Partinë, për Qeverinë, për gjithë atdheun tonë socialist.

Shoku kryetar i komitetit ekzekutiv Mehmet Rama vuri në dukje këtu se fjalët që i drejtova dje popullit të rrethit të Tropojës do t'ju shërbejnë juve në punë e do t'ju frymëzojnë për realizimin e detyrave. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju falënderoj për këtë premtim dhe dëshiroj t'ju them me këtë rast se Komiteti Qendror është i bindur për fjalën që i jepni Partisë, pse ju, trima e trimëresha të Tropojës, keni qënë kurdoherë në ballë të luftës së armatosur për të fituar lirinë e atdheut dhe sot jeni në ballë të punës për

ndërtimin e shoqërisë së re socialiste. Kontributi juaj në këto çështje të mëdha jetike ka qenë i madh dhe shumë frymëzues.

Të gjithë ne, që erdhëm këto ditë në mes jush, dëshirojmë t'ju themi se jemi frymëzuar në kulm nga patriotizmi juaj i mrekullueshëm, nga forca e madhe e karakterit, nga trimëria e qëndrueshmëria për të kapërcyer çdo vështirësi, nga mendimet tuaja përparimtare dhe nga vendosmëria për të zbatuar direktivat e Partisë që na hapin horizonte të reja për përmirësimin e jetës së popullit, për forcimin e begatinë e atdheut tonë socialist. Kushdo që vjen këtu në skajin më të largët malor të atdheut, në këtë vend kaq të dashur për gjithë Shqipërinë, ku, siç tha një luftëtar i vjetër, është pëllëmbë e vorr, ndien atë forcë të mahnitshme të njerëzve të bjeshkëve, të cilët armiku s'i ka përkulur dot kurrë në beteja dhe që s'janë trembur kurrë nga vuajtjet, nga uria dhe nga vdekja, po kanë luftuar e kanë derdhur gjak për të mos e lënë këtë truall të shkelej nga shqau apo nga çdo armik tjetër. Këta njerëz të mrekullueshëm të këtyre bjeshkëve kanë preferuar t'u digjen kullat e shtëpitë, të japin edhe jetën, por vendin, shpellat, pyjet, tokën ku kanë lindur e janë rritur të mos i lëshojnë. Kjo qëndrueshmëri, kjo luftë e vendosur që ka bërë populli shqiptar dhe në mënyrë të veçantë populli malësor i këtyre krahinave, ka frymëzuar brez pas brezi njerëzit tanë. Ne të rinjtë (edhe veten time unë e fut në këtë kategori) jemi shumë të lumtur për këto tradita të mëdha trimërie të të parëve tanë, të cilat deri edhe plakut, pavarësisht nga mosha dhe nga trupi, i përtërijnë zemrën.



Kur vijmë në popull, si këtu në Tropojë, ashtu edhe në vise të tjera të Shqipërisë, ne jemi shumë të lumtur që takohemi me patriotë të vjetër, të cilët kanë luftuar në të kaluarën e rrojnë akoma (dhe u urojmë atyre të arrijnë të bëhen 100 e 120 vjeç, për ta parë Shqipërinë edhe më të bukur e më të lulëzuar). Të tilla takime me veteranë e patriotë të shquar, si ata të Drëgobisë e të Valbonës, që kanë shkuar krah për krah në luftë me heronj si Bajram Curri, ose kanë ndenjgurju më gju me patriotin e madh, Ismail Qemalin, në vitin 1912, siç shoh sonte këtu një delegat që mban shiritin e 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, përfaqësues i denjë që i ka jetuar ditët historike të ngritjes së flamurit në Vlorë, njeriut i përtërijnë jetën dhe e bëjnë t'i duket vetja 20 vjet më i ri. Ja, pra, përse sonte nuk e ndiej veten 60 vjeç, po më duket sikur jam 40.

Ç'kënaqësi është për ne t'u rrih afër njerëzve të tillë dhe t'i dëgjosh të flasin me aq thjeshtësi për luftën e tyre të madhe, sikur të flisnin për një ngjarje të zakonshme. Ata i paraqesin si diçka të zakonshme luftërat dhe përpjekjet e paprera që vetë dhe paraardhësit e tyre kanë bërë në kushte të vështira e të rrethuar nga të katër anët me armiq të shumtë, duke dalë kurdoherë fitimtarë mbi ta, pse edhe vetë janë të thjeshtë. Por ne i çmojmë jashtëzakonisht shumë vlerën dhe rëndësinë e veprës së tyre të madhe. Qëndresa dhe heroizmi i tyre janë mbujtur edhe në gjakun tonë. Kur ishim të rinj dhe akoma nëpër shkollë, dëgjonim të flitej për Bajram Currin, për Hasan Prishtinën, për Azem Galicën, për Çerçiz Topullin e për Mihal Gramenon; për Luigj Gurakuqin, për «Plakun» e Vlorës, apo për Selam

Musain dhe bëheshim me fletë nga veprat e tyre të shquara në shërbim të atdheut. Kështu kalitej ndërgjegjja e shqiptarëve që në vegjëli. Kur kujtojmë këta patriotë dhe ngjarjet e kohës së tyre, na forcohet dashuria e pafund për këtë popull që vuante nën robëri, që shitej te të huajt nga bejlerët dhe nga Zogu. Të edukuar me idetë e me patriotizmin e tyre të zjarrtë, ne rriteshim atëherë me besim, pavarësisht se atdheu gjendej nën zinxhirët e egër të sundimit feudo-borgjez; kishim besim se do të vinte një ditë që ne djemtë e popullit do të luftonim tok me të dhe do t'i mposhtnim armiqtë. Këto ishin shpresat dhe mendimet e brezit tonë në kohën e rinisë, te përpjekjet dhe lufta e baballarëve tanë gjenim këtë forcë e këto mendime.

Këtu në mes nesh kemi një poet nga më të shquarit e vendit tonë, Dritëro Agollin, që ka bërë një poemë të bukur për baballarët. Shumë prej jush e kanë lexuar atë, pse poeti e ka shprehur bukur fort sa shumë të shtrenjtë e të respektuar jeni për ne ju baballarët tanë, jo vetëm pse na keni bërë kokën, po, përveç kësaj, edhe sepse ju na keni edukuar si ta duam popullin e të bëhemi fli për të. Dhe këto ditë në këto bjeshkë kaq madhështore dhe hijerënda ne morëm edhe një herë një frymëzim të madh, që do të na shërbejë të punojmë akoma më shumë e me kokë të ulur për të mirën e popullit.

E mira, siç na mësojnë Partia dhe populli, nuk ka fund, prandaj duhet të punojmë pareshtur për të bërë sa më shumë vepra të dobishme për popullin e atdheun. Është e padiskutueshme, vëllezër dhe motra, se gjatë 25 vjetëve të pushtetit popullor kemi arritur suk-

sese të mëdha. Janë socializmi e më vonë komunizmi që do të bëjnë njeriun plotësisht të lumtur nga çdo pikëpamje. Në të ardhmen do të krijohet ajo shoqëri që kanë parashikuar Marksii me Leninin dhe që Partia jonë, në krye të popullit dhe tok me të, po vazhdojnë ta ndërtojnë me sukses në vendin tonë. Ajo që ka thënë Partia, se ne jemi duke ndërtuar socializmin, po bëhet realitet. Bazat ekonomike të socializmit janë hedhur me sukses. Vitin e ardhshëm do të bëjmë Kongresin e 6-të të Partisë, ku do të marrim vendime të rëndësishme për të mirën e popullit, për të ngritur vepra të reja madhështore që do të kenë bazën e tyre në fitoret që kemi korrur gjër sot. Kongresi do të përpunojë e do të aprovojë edhe planin e ardhshëm për të vazhduar ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Partia na mëson kurdoherë të mos dehem nga sukseset e arritura, po të shohim kurdoherë përpara, duke e pasur mendjen të kthjellët, si mendjen e malësorëve të bjeshkëve tuaja, të mprehur nga vija e drejtë e Partisë. Vijën e Partisë ta kuptojmë mirë, ta analizojmë dhe t'i përvishemi punës me të gjitha forcat për ta zbatuar, pse na presin detyra të shumta, plotësimi i të cilave do të na japë rezultate të rëndësishme në përsosjen e mëtejshme të shoqërisë sonë dhe në përmirësimin e jetës së njerëzve. Në të ardhmen do të ndërtohen fabrika e uzina të reja, hidrocentrale të tjera, do të përmirësohen akoma më shumë fushat, do të mekanizohet më tej bujqësia dhe, si pasojë, do të ngrihen rendimentet e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Shkolla jonë do të përsoset dhe do të revolucionarizohet më shumë. Ushtria do të bëhet më e

çeliktë dhe do të pajiset me armë moderne. Të gjitha këto punë do të bëhen të harmonizuara, në mënyrë të atillë që të shkojnë të tëra paralelisht krahas ngritjes së pandërprerë ideologjiko-politike dhe kulturoro-tek-nike të njerëzve tanë.

Neve tani na duken si gjëra të zakonshme punët e mëdha që po bëjmë. Kjo i dedikohet forcës drejtuese dhe edukuese të Partisë, e cila i ka mësuar masat punonjëse të vendit tonë si të punojnë, të djersinë e të bëjnë gjëra të mëdha, dhe jo vetëm të mos ndiejnë lodhje, po, përkundrazi, të ndiejnë kurdoherë gëzim, satisfaksion dhe kënaqësi të madhe. Kënaqësia e njerëzve tanë është edhe materiale, për arsye se materialisht jeta vazhdimisht po përmirësohet e do të përmirësohet edhe më shumë, por sidomos është morale. Kjo do të bëjë që njerëzit tanë të jenë më të gëzuar, më të shëndetshëm, kështu që dhe jeta e tyre, sigurisht, do të zgjatet më tepër.

Para Çlirimit të ne jeta mesatare e njerëzve mezi arrinte 38 vjeç, kurse sot, në Shqipërinë tonë socialiste, është arritur që ajo të jetë rreth 68 vjeç. Kjo ndodhi se masat punonjëse të vendit, të udhëhequra nga Partia, përmbysën me luftë pushtetin e vjetër dhe vendosën pushtetin popullor; ato u çliruan njëherë e përgjithmonë nga çdo lloj shfrytëzimi, janë të lira e të gëzuara, punojnë e jetojnë të lumtura në atdheun sovran e të pavarur. Por, me arritjen e këtyre fitoreve, populli ynë nuk ndenji duarlidhur, atë nuk e zuri gjumi, as u bë përtac, përkundrazi, u hodh vazhdimisht në sulm. Ç'doli nga e gjithë kjo punë? Dolën shumë gjëra të mira: trupi u kalit, njerëzit u bënë të gëzuar, kalamanët rri-

ten gjithashtu të gëzuar dhe, siç thashë, jeta u zgjat. Nga vëzhgimet shkencore del që, pas Çlirimit të Shqipërisë, të rinjtë e të rejtat, në krahasim me kohën e paraçlirimit, janë mesatarisht 10 centimetra më të lartë nga shtati, më të fuqishëm e më të shëndetshëm se paraardhësit e tyre.

Të gjitha këto, natyrisht, i sollën zhvillimi ekonomik i vendit, rruga e drejtë e Partisë dhe, siç e përmenda pak më parë, kënaqësia e madhe që ndien populli që mban pushtetin në dorë dhe merr pjesë gjallërisht në luftën për ndërtimin e jetës së tij. Me ndërtimin e jetës së re ne kuptojmë përmirësimin e kushteve jetësore jo vetëm në ushqim e veshmbathje, por edhe në strehim, në mbrojtjen e shëndetit të kalamanëve, të pleqve dhe të gjithë punonjësve, në rritjen e nivelit të kulturës së tyre etj.

Shëndeti, motra dhe vëllezër, ka rëndësi të jashtëzakonshme. Më falni që do të flas një çikë për këtë çështje, po e theksoj se ka shumë rëndësi. Partia i vë shumë kujdes shëndetit të njeriut që kur lind dhe gjatë gjithë jetës. Synimi i saj është që ai të rrojë sa më shumë. S'ka asgjë më të çmuar se njeriu, ka thënë Stalini, pse ai bën çdo gjë. Populli bën revolucionin, populli krijon dhe ndërton i udhëhequr nga idetë përparimtare të partisë së komunistëve, e cila, pasi i grumbullon, i studion dhe i përpunon këto ide në procesin e jetës, armatos popullin dhe ky i zbaton me ndërgjegje të lartë për të mirën e tij. Partia merr eksperiencën e vlefshme të masave dhe, pasi e studion dhe e përgjithëson, ia jep përsëri popullit me anë direktivash. Kështu vepron ajo vazhdimisht.

Një fëmijë që lind është një fitore jo vetëm për mëmën e për babën, por edhe për atdheun, prandaj si ndër qytete, edhe ndër fshatra duhet të tregohet nga të gjithë kujdesi më i madh sidomos për kalamanët. Veçanërisht, të dashura motra, kujdes për fëmijët duhet të tregohet në malësi, ku edhe klima është një çikë më e fortë dhe pakujdesia më e vogël i dëmton ata. Partia dhe shteti kanë marrë masa që të lehtësohen lindja dhe rritja e fëmijëve, por për t'ia arritur këtij qëllimi të madh duhet që edhe burrat të ndihmojnë në punët e shtëpisë, që gratë jo vetëm të lehtësohen, por dhe të mos pengohen që të shkojnë për të lindur nëpër institucionet e krijuara, të cilat duhet të frekuentohen nga gratë.

Rëndësi të madhe i jep Partia përgatitjes së mjekëve, të infermierëve e të mamive. I dëgjoni këshillat e punonjësve të shëndetësisë me kujdesin më të madh! Unë u rekomandoj atyre të shkrijnë të gjitha forcat e mendjes dhe të trupit për çështjen e madhe të shëndetit të popullit. Ata janë njerëz besnikë të Partisë dhe të ndërgjegjshëm për misionin e lartë që u është ngarkuar. Këtë e treguan edhe me rastin e epidemisë së gripit, kohët e fundit, kur të gjithë, duke punuar pa pushim, bënë një punë shumë të lavdërueshme. Kjo epidemi e rëndë na erdhi nga jashtë dhe patëm disa humbje, por me masat që morën Partia e Qeveria dhe me kujdesin e madh të mjekëve, të infermierëve, të mbarë punonjësve të shëndetësisë u arrit që humbjet të ishin mjaft të kufizuara.

Partia edhe në të ardhmen do t'i vërë rëndësi të madhe shëndetit të popullit. Për ta ruajtur atë, në ra-

dhë të parë, duhet kujdesur për të mos u sëmurur. Po vallë e kemi në dorë të mos sëmuremi? Po, e kemi në dorë. Dhe një nga faktorët kryesorë që të ruan nga sëmundja është pastërtia, e cila është armiku i mikro-beve dhe i çdo lloj sëmundjeje. Mikrobet qëndrojnë atje ku mungon pastërtia. Ka disa rregulla të thjeshta për ruajtjen e higjienës dhe të shëndetit, që vetë populli i di nga eksperiencia e tij, po edhe mjekët na i mësojnë. Këto rregulla t'i mbajmë parasysht për të mirën tonë dhe të familjeve tona. Secili nuk duhet të mendojë vetëm për shëndetin e vet ose të familjes së tij, por, siç na mëson Partia, të mendojmë e të punojmë për shëndetin e gjithë popullit, që të tërë të jenë të shëndetshëm. Partia përpiqet që njerëzit tanë të jenë të fortë, të çeliktë. Me politikën e saj shëndetësore dhe me masat që ka marrë, është arritur të zhduken epidemitë në vendin tonë. Ky është një sukses i madh, sado që kemi shumë për të bërë. Këto i thashë, vëllezër dhe motra, që të bëjmë shumë kujdes për njeriun dhe për të rinjtë, sidomos në periudhën e rritjes dhe të formimit të tyre fizik, domethënë gjersa të marrin kockë.

Në Valbonë, kur u poqa me Ali Shabanin<sup>1</sup>, mikun dhe shokun e vjetër të Bajram Currit, që na priti me aq dashuri, e pyeta si ishte nga shëndeti. Ai m'u përgjigj i kënaqur se ishte mirë. I futa dorën në kraharor dhe i thashë se bën mirë që mban fanellë leshi në trup për të mos u ftohur, sepse ai rron në bjeshkë dhe duke ecur djersin, prandaj e porosita të ruhet që të mos e

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim, f. 425.

godasë era. Armikut dhe erës duhet mos me ia kthye kurrë shpinën, sepse pas shpine armiku të vret, po edhe era të godet si plumbi e të sëmur. Shqiptari kurrë s'e ka zakon t'ia kthejë shpinën armikut, por atë as erës nuk duhet t'ia kthejmë. Prandaj duhet të merren disa masa për veshjen e njerëzve në bjeshkë, ku bën më shumë ftohtë.

Këto çështje Partia jua ka vënë kurdoherë në dukje, unë vetëm sa i përmenda pak. Ndonjë mund të thotë: «Po ç'ka të bëjë kjo çështje me këtë mbledhje kaq solemne?». Ne komunistët dhe populli nuk i quajmë solemne këto mbledhje, po i konsiderojmë takime në mes shokësh, vëllezërish, motrash, për të shkëmbyer mendime. Ne flasim që duhet të ngremë rendimentet, kjo është e drejtë dhe duhet punuar që t'i ngremë, po duhet të ruajmë, në radhë të parë, shëndetin, pse rendimente pa punë s'ka dhe punë pa shëndet s'ka.

Tashti dua të flas pak edhe për Tropojën, e cila ka një të ardhme të bukur. Tropojën, shoku Hero i Punës Socialiste<sup>1</sup>, së shpejti do ta shohim më të zbukuruar nga puna e njerëzve. Sidomos ndërtimi i Hidrocentralit të Fierzës do të jetë një shtytje përpara, një impuls i madh për qytetin dhe për rrethin tuaj. Ndërtesat e banimit të punëtorëve të hidrocentralit dhe vetë ndërtesat e kësaj veprë të madhe i shtojnë rrethit tuaj jo vetëm bukurinë, por, ajo që ka rëndësi, edhe frymën përparimtare e revolucionare të klasës punëtore. Këtu do të shtohet transporti dhe bujqësia në fshat do të

---

1 I drejtohet Heroit të Punës Socialiste Shaban Rexhë Hajdarmataj.



vihet në kushte të tjera. Nevojat e zhvillimit ekonomik do të kërkojnë që bujqësia të bëhet intensive edhe këtu te ju. Kjo do të thotë se Çernica nuk do të prodhojë më si tash. Por që të prodhojë më tepër, duhet të vijnë më shumë traktorë, farëra të zgjedhura, lopë etj. Duke pasur në duar gjithë këto pasuri të mëdha, njerëzit duhet të dinë t'i administrojnë, prandaj ata është e nevojshme të venë më parë në shkolla e në kurse që të mësojnë.

Tropojanët dhe mijëra njerëz që do të vijnë nga të katër anët e Shqipërisë, do të kenë nevojë për ushqime, për fruta etj. Sigurisht, vetëm Tropoja ata nuk do t'i mbajë dot me ushqime, për këtë qëllim do të vijnë ushqime edhe nga rrethe të tjera. Megjithatë, edhe rrethi juaj e ka për detyrë të bëjë një kthesë rrënjësore, si në çdo drejtim tjetër, edhe në bujqësi. Të gjitha këto masa do të çojnë në përparimin e madh të rrethit të Tropojës, përgjithësisht, dhe në zbukurimin e qytetit Bajram Curri, në mënyrë të veçantë.

Problemin e zbukurimit të qytetit merreni në dorë vetë ju shokë të komitetit të Partisë e të komitetit ekzekutiv. Për këtë qëllim tregoni kujdes që ndërtesat e reja të bëhen me plan, në vende të përshtatshme; i vini rëndësi edhe gjelbërimit, duke siguruar vende për parqe e për kopshte të bukura, për kinema e për institucione të tjera kulturore, që qyteti juaj malor të bëhet model.

Vëllezërit tanë kosovarë, matanë kufijve të Shqipërisë, gëzojnë me gjithë zemër për sukseset tona. Aq më tepër gëzohen ata kur vijnë e shikojnë si zbukurohet Shqipëria. Siç e thashë në fjalimin që mbajta para

popullit, ne dëshirojmë të kemi vajtje e ardhje me ta. Qeveria e Beogradit duhet t'u japë të gjitha të drejtat vëllezërve tanë të Kosovës, sepse shqiptarin askush, asnjë kral, sado i madh e i fortë që të jetë, nuk e mban dot në pranga dhe nuk mund ta mposhtë.

Ka rëndësi të madhe puna që bëjnë këtu gjeologët, mbasi në bjeshkët tuaja ka shenja të pranisë së disa mineraleve shumë të çmueshme, prandaj po vazhdojmë të kërkojmë dhe të punojmë me këmbëngulje të madhe. Kur Partia të shikojë se ekzistojnë me të vërtetë sasi të mjaftueshme mineralesh, atëherë edhe në Tropojë do të hapet perspektiva dhe do t'i krijohen mundësitë për ngritjen e industrisë së rëndë. Në qoftë se në bjeshkët e Dragobisë do të zbulojmë mineralet që parashikohen, këtu do të ngrihen fabrika të mëdha. Fabrika të tilla punojnë vetëm me energji elektrike, prandaj jemi duke ndërtuar Hidrocentralin e Vaut të Dejës, pastaj atë të Fierzës dhe më vonë të Komanit e kështu me radhë. Do të mbushet Drini me hidrocentrale që do të zbukurojnë Shqipërinë ashtu si gjerdanët që mbanin gratë motit për t'u zbukuruar. Që nga Kukësi e deri në Shkodër mund të ngrihen disa hidrocentrale. Nëntoka jonë, e ndoshta edhe bjeshkët tuaja, kanë minerale, të cilat do t'i nxjerrin në dritë populli me Partinë. Zbulimi dhe shfrytëzimi i mineraleve që fsheh toka jonë do të pasurojnë vendin dhe do të lulëzojnë jetën e popullit shqiptar. Njerëzit te ne do të rrojnë më mirë dhe në vendin tonë do të ndërtohet me sukses socializmi e më vonë komunizmi.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, që tash janë krijuar në shumë

vende të botës dhe luftojnë kundër kapitalizmit e gjithë tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, formojnë bërthamën e shëndoshë të unitetit marksist-leninist revolucionar botëror. Ne jemi të fortë. Po të mos ishim vërtet të fortë, nuk do të thoshim që jemi të tillë, po do të gjenim se ku i kishim dobësitë dhe do t'i ndreqnim. Pra, i tillë është realiteti.

Ne kemi qenë të fortë edhe në kohën e luftës, kur në vendin tonë ishin fashistët italianë dhe nazistët gjermanë të armatosur deri në dhëmbë, kur milicët e bashibozukët e tjerë, me qindra e me mijëra, ishin shpërndarë në të katër anët e atdheut. Atëherë ne thoshim që do t'i shkatërrojmë e do t'i mundim armiqtë, se jemi më të fortë, dhe vërtet i mundëm, pse me Partinë ishte populli. Edhe tash nuk na mundin dot armiqtë, se ne jemi më të fortë, pse jemi komunistë dhe idetë tona janë për të mirën e popullit e të atdheut. Për këtë arsye populli ynë është e do të jetë me Partinë, me marksizëm-leninizmin.

Me marksizëm-leninizmin janë edhe të gjithë popujt e botës që duan lirinë dhe jo kapitalizmin e fajdexhinjtë, mbretërit e të gjithë ata që u rrjepin lëkurën e u pijnë gjakun. Komunistët janë në luftë me gjakpërësit, ata janë mbrojtësit e popullit, prandaj populli është me komunistët, kurse ata që sundojnë tash në vende të ndryshme të botës, qofshin imperialistët amerikanë apo revizionistët sovjetikë dhe aleatët e tyre, qëndrojnë mbi rërë, ashtu siç qëndronte dikur në Shqipëri Ahmet Zogu me bajraktarët. Këta të fundit nuk sunduan dot gjatë, për arsye se popullin e kishin ku-

ndër. Edhe pushtuesit italianë e gjermanë që erdhën me bomba e me tajare, si dhe tradhtarët vendas që bashkëpunuan me ta, s'qëndruan dot gjatë, pse populli, që s'e kishin me vete, i përmbysi. Përmbysja për armiq të e popullit do të vijë edhe në vendet e tjera.

Lenini ka thënë që zinxhiri do të këputet më parë atje ku hallka e kapitalizmit është më e dobët, pikërisht atje populli do të ngrihet në këmbë dhe do ta këputë këtë hallkë. Dhe kështu do të ndodhë me radhë. Një hallkë e dobët në zinxhirin kapitalist botëror ka qenë edhe Shqipëria, ku populli u ngrit dhe, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, i përmbysi pushtuesit e tradhtarët dhe ua preu rrugën e kthimit përsëri Zogut, bejlerëve dhe agallarëve. Italianët populli i hodhi në det, gjermanët i mundi edhe doli në rrugën e socializmit.

Në e dimë sa u vlen lëkura armiqve. Ata përpiqen të frikësojnë popujt që janë të fortë, por për vete kanë frikë, pse e ndiejnë forcën që kanë komunistët. Në rrugën e luftës kundër imperializmit e revizionizmit ecin popujt e komunistët e botës.

Në këto rrethana perspektiva e revolucionit është shumë e mirë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë futur në rrugë pa krye dhe jetojnë në turbullirë, Bashkimi Sovjetik është, gjithashtu, në turbullirë të madhe. Kështu është gjendja e revizionistëve në Bullgari, në Republikën Demokratike Gjermane, në Çekoslovaki, në Poloni etj. Në turbullira të mëdha është Franca kapitaliste, ku studentët janë ngritur në Paris dhe po përleshën ç'prej dy ditësh me policinë, duke u gjako-

sur nëpër rrugë, sado që kapitalistët po bëjnë me qindra arrestime, «për të rregulluar gjendjen». Presidenti i Republikës Franceze, Pompidu, deklaroi se do të merren masa të rrepta kundër atyre që do të bëjnë sulme të armatosura. Vetëm studentët po e lëkundin mjaft regjimin kapitalist, po sikur të lëvizë klasa punëtore, ç'do të bëhet vallë? Atëherë do të paralizohej tërë jeta e vendit. Kapitalizmin e pret vdekja. Ai kudo po tronditet, kurse ne forcohemi, revolucioni ecën përpara.

Nesër, vëllezër dhe motra, do të largohemi me keqardhje nga ju. Ne dëshirojmë me gjithë zemër të rrimë akoma më gjatë, se s'na iket, por ç'të bëjmë, punë të tjera na presin, vëllezërit e motrat e Pukës na presin gjithashtu, siç na pritët ju, prandaj do të largohemi nga Tropoja e dashur, nga ju shokë e shoqe, vëllezër dhe motra, por do ta kemi kurdoherë të paharruar kujtimin e këtyre ditëve, do të ruajmë në zemër këtë dashuri të madhe që ju tregoni për Partinë dhe për ne. Fjalët tuaja, ndihma juaj, besimi juaj i patundur në fitoren dhe në vijën e drejtë të Partisë do të na ndihmojnë shumë. Këto do të jenë për ne një forcë e madhe. Kur të kthehemi në Tiranë, në mbledhjen e afërme të Byrosë Politike, një nga çështjet e rendit të ditës do të jetë raporti që do të japim ne për përshtypjet nga vizitat që bëmë në këto anë. Do t'u tregojmë shokëve çfarë pamë, do t'i njoftojmë ata për shkëmbimin e mendimeve dhe të eksperiencës me ju, për sukseset e të mirat, për hallet që qamë së bashku, për këshillat e vlefshme që na dhatë, si dhe për premtimet që i bëmë njëri-tjetrit. Ne do t'i mbajmë premti-

met tona, natyrisht edhe ju do t'i mbani premtimet tuaja. Kështu, të dyja palët së toku e dorë më dorë, do të ecim kurdoherë përpara, të bashkuar si një trup dhe si një zemër.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli trim, liridashës e besnik i Tropojës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura që gjenden në AQP*

## PASI TË HARTOHET PLANI, TË VËMË TË TËRA FORCAT PËR REALIZIMIN E TIJ

*Fjala në mbledhjen me kuadrot kryesorë  
të rrethit të Pukës*

**1 qershor 1970**

*Shoku Pali Miska, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Pukës, raportoi për situatën politike dhe ekonomike, për problemet shoqërore dhe për gjendjen e organizatës së Partisë në rrethin e Pukës. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Ju faleminderit shumë, shoku sekretar i parë, për informacionin e gjerë dhe të qartë që na bëtë për situatën e gjithanshme të zhvillimit ekonomiko-politik e shoqëror të rrethit të Pukës, si dhe për masat që keni marrë ju këtu për forcimin e organizatës së Partisë.

Në fjalën tuaj ngritët probleme që preokupojnë organizatën e rrethit. Neve na duket se ju preokupoheni shumë jo vetëm për njohjen e tyre, por edhe për t'i zgjidhur drejt, pavarësisht se mjaft nga ato nuk janë të lehta, pse, ashtu sikurse i parashtruat ju çështjet, ka me të vërtetë pengesa e vështirësi. Por me të njëjtat pengesa e vështirësi luftojnë të gjitha organi-

zatat e Partisë në vendin tonë, pse si problemet politiko-ideologjike e shoqërore, ashtu edhe ato ekonomike, natyrisht, sipas situatave e zhvillimit të secilit, pra me disa ndryshime të vogla, janë gati të njëlojta në të gjitha rrethet. Duhet njohur që ka rrethe më të përparuara nga ana ekonomike, ka të tjera më pak të përparuara. Atje ku zhvillimi i ekonomisë ka ecur me ritme më të shpejta, Partia ka pasur mundësi ta zhvillojë më me vrull luftën kundër mbeturinave mikroborgjeze.

Disa nga çështjet që ngritët ju, do t'i prek në fjalimin që do të mbaj nesër në miting. Aty do të vë në dukje, së pari, sukseset e arritura, të cilat nuk duhet t'i nënvleftësoni, as t'i neglizhoni. Sukseset tuaja, si në fushën shoqërore, ashtu edhe në atë ekonomike, janë të meritueshme dhe mjaft të mira, gjë që e ka bërë rrethin tuaj të njihet në të gjitha anët e atdheut. Sot s'ka krahinë në Shqipëri që të mos njohë pasuritë e mëdha pyjore të rrethit dhe punën e sharrëxhinjve tuaj të dëgjuar. Jeta e gjithë shtetasve dhe ndërtimi i socializmit në vendin tonë janë lidhur me ta, për shkak të lëndës së parë që shkon prej këtej në çdo skaj të vendit. Njerëzit tanë kudo presin t'u vejë lëndë ndërtimi nga Puka. Kur kjo vete, të gjithë gëzohen, kur nuk shkon, thonë me keqardhje: «Ja, s'na erdhi lënda nga Puka». Prandaj, ashtu si përshëndetjet e lavdërimit, edhe kritikën s'mungojnë në adresën tuaj, sidomos ndaj punëtorëve të sharrave.

Gjatë vizitës që bëmë sot në disa reparte të sharrave në Fushë-Arrëz, shokët atje më folën për disa nga arsyet e mosplotësisimit të të gjitha kërkesave që u



drejtohen nga ndërmarrjet e vendit për lëndë të dimensioneve të ndryshme. Ju thoni se dërrasat i prodhoni të trasha që të mos dalë shumë tallash, mbasi sa më shumë të holla t'i nxirrni, aq më tepër tallash prodhohet dhe kështu humbet mjaft lëndë. Mirëpo harroni se atë që fitohet nga tallashi ua futni mobilieve, orendive etj. dhe kështu harxhoni trefish dërrasë. Kjo do të thotë se kur prodhohet një bankë, në vend që ajo të përgatitet me dërrasë jo të trashë, përdoret dërrasë trefish e trashë, pse ashtu ua keni dërguar ju. Prandaj nga ky trefish harxhim lënde le të hajë njëfish tallashi, veç dërrasat i prodhoni me përmasat që kërkohen. Këtu, or vëllezër, është e qartë se halli nuk qëndron te kursimi i lëndës, po te synimi juaj për të realizuar planin në global, si metra kub, si nga ana e ju shokëve drejtues, ashtu edhe nga punëtorët. Prandaj duhet t'u bëhet e qartë mirë të gjithëve kjo çështje. Kryeinxhinieri, kur e diskutuam ashtu në këmbë këtë problem, dha një mendim që është më i rekomandueshëm. Sipas tij kjo punë mund të bëhet në zdrukhtëtari. Po përse të bëhet atje?

Mbaj mend që, para se të hidhesha në ilegalitet, pranë dyqanit të vogël «Flora» në Tiranë, ku, nën maskën e shitjes së cigareve, bënim punën e Partisë, ndodhej dyqani i një shkodrani, i cili shiste lëndë druri. Dërrasat ai nuk i shiste të një standardi, po të dimensioneve nga më të ndryshmet, sepse sipërmarrësve dhe klientëve të tjerë që venin të blinin tek ai lëndë druri për të bërë shtëpi, nuk u thoshte: «Blini këtë që po ju jap unë!». Klienti dërrasën për tavan ia kërkonte aq milimetra të trashë sa i duhej, për dollap e mobilie

të një dimensionit tjetër e kështu me radhë për penxhetet, dyert, për çati etj. Ky pronar i jepte kështu blerësit lëndën në ato dimensione që e donte. Tregtari privat vriste, pra, mendjen dhe luftonte që lënda të prodhohej në të gjitha dimensionet, ndryshe nuk mund ta shiste dhe të tërhiqte klientë. Po ne s'paskemi interes dhe mundësi t'i bëjmë këto gjëra? Sigurisht që kemi.

Keni vajtur ndonjëherë ju shokë të sharrave nëpër zdrukthëtaritë e vendit, për të parë se si i përgatitin mobiliet e orenditë për popullin? Ja, mund t'ju them unë se ato dalin shumë të rënda dhe të kushtueshme, megjithëse kemi theksuar kaq herë dhe vazhdimisht flasim që të kursejmë sa më shumë, sidomos dërrasën dhe përgjithësisht lëndën e drurit, që janë materiale deficitare. Ne e pranojmë atë që thonë shokët e sharrave, që sa të jetë e mundur të evitojmë tallashin etj., etj., po çështja nuk është vetëm te tallashi. Aty ka akoma shumë për të bërë. Me këtë nuk dua të them që shokët e sharrave s'punojnë mirë. Ata punojnë shumë mirë, i realizojnë planet dhe janë punëtorë të dalluar, po duhet të njohin edhe këtë që thashë, që ekziston tek ata prirja për të realizuar planin në sasi, si global, dhe këtë s'jani vetëm ju që e bëni, ka edhe të tjerë që ecin në këtë rrugë mjaft të dëmshme për ekonominë popullore. Partia ngul këmbë në këtë problem, sepse dërrasa është material me vlerë të madhe dhe duhet përdorur me kursim.

Na vjen shumë mirë që Pukën e kemi një qendër e burim të madh furnizimi me dërrasa për gjithë vendin, por njëkohësisht na vjen edhe keq kur, duke ka-

luar këtej, shohim që janë prerë pa kriter mjaft masive pyjore, për përtëritjen e të cilave nevojiten një kohë e gjatë e kujdes mjaft i madh. Këtë gjendje e kanë rënduar shumë ata që kanë prerë para nesh. Sigurisht, edhe ne kemi prerë, po kemi pasur më tepër kujdes nga paraardhësit, për arsye se pyjet tani janë pronë e gjithë popullit, prandaj, me gjithë gabimet që janë vërtetuar në këtë drejtim pas Çlirimit, ne kemi synuar kurdoherë që pyjet t'i vëmë në shërbim të popullit, kurse paraardhësit tanë në prerjen e lëndës janë nisur nga dëshira për t'u pasuruar, paçka se ishin duke i shfarosur gjithë këto masive. Kohët e fundit ne jemi duke punuar mirë për shfrytëzimin e pyjeve dhe kë-shtu duhet të vazhdojmë.

Një arsye që na ka detyruar t'i dëmtonim me ndër-gjegje disa zona pyjore ishte gjendja e vështirë që trashëguam pas Çlirimit, kur nuk kishim akoma mundësi të hapnim rrugë për t'u futur thellë nëpër masi-vet e pashfrytëzuara, siç janë Kurora e Dardhës etj., etj., pse nuk kishim automjete që të futeshim thellë në to. Në ato kushte lëndën detyroheshim ta pritnim në pyjet më të afërta, pikërisht atje ku ishin rrugët kryesore. Me atë transport të paktë e të çalë, me ato mjete primitive që kishim, ne e mëkëmbëm me mish e me shpirt ekonominë popullore dhe tashmë ajo fazë e vështirë u kapërcye, prandaj është e domosdoshme të mendojmë një çikë më mirë për ruajtjen e pyjeve, pavarësisht se nevojat për lëndë druri janë jashtëzakonisht të mëdha dhe vazhdimisht në rritje.

Shoku sekretar i parë, duke udhëtuar nga Lajthiza për në qytet, më thoshte që ne andej nga qendra të

kemi parasysh që, me hapjen e rrugëve nëpër masivet e reja pyjore, ta lehtësojmë ca Pukën. Unë mendoj se ai ka të drejtë. Ne duhet ta lehtësojmë medoemos rrethin tuaj, të mos tërheqim lëndë druri vetëm prej tij. Rrugën për në Malësinë e Madhe tani e kemi hapur dhe mendojmë të ndërtojmë rrugë të tjera edhe për shfrytëzimin e pyjeve të Kukësit, të Tropojës etj. Megjithatë ne do të kemi prapë deficite në lëndë druri. Pukën do ta lehtësojmë, po planin nuk e ulim dot. Kjo do të thotë se do të vazhdojmë të presim dru edhe në të ardhmen, bile çdo vit e më shumë, në bazë të nevojave që vijnë vazhdimisht duke u rritur. Atëherë ç'duhet bërë? E vetmja rrugë është të mbjellim më shumë drurë pyjorë se gjer tani. Si kudo, edhe këtu te ju ndodh që të priten dhjetë drurë dhe të mbillet vetëm një. Ç'përpjesëtim është ky? S'ka dyshim se është shumë i zhdrejtë. Mbjellja këtu në Pukë, nga sa jam në dijeni, bëhet diçka më mirë, po në rrethe ku nuk ka ndër marrje pyjore me një gjerësi e numër kaq të madh punëtorësh, me teknike të zhvilluar etj. si këtu te ju, nuk veprohet kështu, pyjeve atje po u futin sëpatën pa kriter.

Prandaj ju, në radhë të parë, të dashur shokë të Pukës, tregoni një kujdes më të madh për pyjet. Këtë detyrë do ta theksoj edhe në fjalimin që do të mbaj nesër. Me këtë ka lidhje edhe problemi që ngriti shoku sekretar i parë dhe që e ka ngritur vazhdimisht edhe Byroja Politike, shtimi i mekanizmave. Siç dëgjova nga raporti që na bëri shoku Pali, në rrethin tuaj janë marrë disa masa, janë futur ca mekanizma. Ne edhe herë të tjera kemi biseduar për këtë dhe në fakt janë

marrë disa masa, po mendoj se akoma duhet bërë, bile më shumë, megjithëse, siç dihet, kemi plot halle. Unë do të bisedoj edhe një herë me ministrin e Industrisë. Çështja e shtimit të mekanizmave që u ngrit këtu, ne duhet të na preokupojë, pse ato do të na i kursejnë forcat e punës, për të cilat kemi shumë nevojë. Kështu, e vetmja mënyrë për të përballuar mungesën e tyre është mekanizimi. Në këtë drejtim duhet të bëjnë shumë përpjekje edhe punëtorët, edhe uzinat tona. Këtë problem e kanë ngritur vazhdimisht e po e ngrenë edhe tani Byroja Politike e Qeveria dhe në fakt kemi rezultate, por nuk kemi arritur akoma atë që dëshirojmë.

Shumë nga mekanizmat që ju duhen si juve këtu, ashtu edhe ndërmarrjeve të tjera pyjore, ne tani mund t'i bëjmë në vend, vetëm do të na duhet të importojmë lëndën e parë, domethënë hekurin e çelikut, pastaj uzinat që kemi ngritur, ku punojnë njerëz që tashmë kanë fituar një eksperiencë të madhe, janë në gjendje t'i prodhojnë ato dhe shumë gjëra të tjera, sado të vështira qofshin, mjaft të kenë modelet përpara. Dhe, në fakt, gjer tani ato kanë bërë shumë, vetëm duhet luftuar pretendimi që njëri thotë: «Mua më duhen mekanizma të kësaj forme», tjetri i kërkon ndryshe, se «Kështu janë të përshtatshëm për pyllin» etj. Jo vetëm ekzistojnë pengesa të kësaj natyre, po as vetë Ministria e Industrisë nuk jep mekanizma dhe as material nuk porosin për të prodhuar me to, fjala vjen, jo traktorë, po një sërë mjetesh e pajisjesh të nevojshme mekanike për pyjet, kur ekzistojnë mjetet dhe mundësitë që të bëhen në vend. Këto nevoja, në fakt, ajo i lë për mot-

mot apo edhe më shumë në harresë. Do të ishte më mirë që ministria të mos sjellë disa materiale të tilla, por të sjellë mjete që do të na i prodhojnë këto materiale, pastaj vitin e dytë, kur të ketë krijuar një linjë të posaçme në këtë ose në atë uzinë, të fillojë t'i prodhojë në seri.

Për ta zgjidhur një problem si ky në shumë sektorë të tjerë të ekonomisë, ne kemi ndërtuar e do të ndërtojmë akoma në të ardhmen një sërë uzinash, po kemi edhe uzina që punojnë prej kohësh e nuk janë të ngarkuara sa duhet, pse punojnë me një turn apo me një turn e gjysmë. Ne duhet të përpiqemi që të gjitha uzinat e fabrikat të punojnë me tri turne. Për këtë do të na nevojiten tri herë më shumë punëtorë, që do t'i ekonomizojmë në sektorët e tjerë ku punohet në mënyrë artizanale dhe duke sjellë mekanizma do të ketë më pak sharrëxhinj me sharra dore. Kështu edhe te ju sharrat e dorës do të zëvendësohen me motosharra ose me sharra elektrike. Vënia në shfrytëzim e 20-30 sharrave të tilla do të na ekonomizojë shumë njerëzit aq të nevojshëm për sektorët e tjerë të ekonomisë.

Veç kësaj, si kudo, në Pukë forcat e punës janë të nevojshme sidomos në bujqësi. Prandaj ky problem të bëhet nga ju objekt i një studimi serioz, siç edhe e keni bërë, ose siç duhet ta bëni sa më shpejt, në rast se akoma nuk i keni hyrë kësaj pune. Te ju duhet të jetë karakteristike lidhja e ndërmarrjeve industriale me fshatin, me bujqësinë, pse kjo është një punë me interes të madh për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, por sidomos për futjen në fshat të frymës proletare, shoqërore, socialiste me një ritëm më të shpejtë, më të

sigurt. Natyrisht, forcat duhet të balancohen me kujdes, duke studiuar problemet dhe çdo nevojë në mënyrë të harmonishme.

Për problemet me karakter nacional, siç janë ato të pyjeve, të sharrave etj., planifikues i plotfuqishëm nuk duhet të jetë, siç mund të mendojë gabim ndonjë, vetëm qendra, ta zëmë zëvendësministri i Industrisë që merret me këta sektorë. Ka raste që ndonjë shok përgjegjës në qendër s'pyet fare nëse ekziston këtu në rreth komitet partie apo komitet ekzekutiv. Qendra nuk lejohet të japë urdhra për të prerë lëndë druri këtu ose atje, sipas dëshirës dhe jashtë kriterëve të vendosura, duke u justifikuar se është ajo që ka përgjegjësi për drejtimin e ndërmarrjeve nacionale. Se ç'pasoja mund të ketë një praktikë e tillë në bujqësi, ai në qendër as që mendon, as interesohet, «kjo i takon dikujt tjetër», të përgjigjet. Të tilla qëndrimeve pa përgjegjësi u duhet dhënë fund. Një ndërmarrje le të jetë nacionale, e lidhur drejtpërsëdrejti me ministrinë dhe e ngarkuar me detyrë të furnizojë me lëndë druri e me dërrasa gjithë republikën, për çdo gjë drejtuesit e saj duhet të këshillohen edhe me ju, që jeni të lidhur ngushtë me terrenin, dhe me të gjithë ata që punojnë atje. Nga ju kërkohen punëtorë që u nevojiten këtyre ndërmarrjeve, ju bëni edukimin e punonjësve të tyre dhe interesoheni për organizimin e tyre. Pra ju bie konkretisht detyra të kujdeseni edhe për ruajtjen e pyjeve, për mbjelljen e drurëve pyjorë, për mbarëvajtjen e të gjitha problemeve të bujqësisë në rreth, prandaj është e domosdoshme t'i harmonizoni të gjitha këto gjëra. Kështu jo vetëm nuk ka asnjë arsye që

punonjësit e ministrive të mos këshillohen me ju për çdo problem që ka të bëjë me rrethin tuaj, po një punë e tillë është e domosdoshme nga ana e tyre. Prandaj, kur bëhet plani, i kini parasysh të gjitha problemet, si atë të pyjeve, të sharrave, nevojat për punëtorë në këta sektorë, si dhe nevojat e bujqësisë. Në rast se kemi vendosur çfarë objektivash duhen arritur në bujqësi dhe gjykojmë se ata janë të drejtë e të domosdoshëm, atëherë duhen marrë patjetër një sërë masash që të realizohen. Mirëpo ka objektiva për realizimin e të cilëve pengon mungesa e forcave të punës, për shembull në drejtim të hapjes së tokave të reja, dhe për këtë qëllim duhen sjellë ca mekanizma; ka kooperative që për realizimin e detyrave duhet të përfitojnë kredi nga ana e shtetit etj.; etj. Pasi të studiohen e të kombinohen mirë të gjitha këto probleme, të pasqyrohen në plan e, pasi të hartohet ai, të vëmë të tëra forcat për realizimin e tij.

Ju jeni specialistë të misrit, gjë shumë e mirë kjo, prandaj zhvillojeni më tej eksperiencën që keni fituar për zhvillimin e tij. Kjo, mendoj unë, lyp një interesim më të madh nga ana juaj, sidomos për sa i përket zbatimit sa më të plotë të kodit agroteknik. Çdo kapitull i këtij kodi ju vë detyrën e madhe të mendoni për të gjetur rrugët si ta organizoni më mirë punën për të plotësuar kërkesat e tij dhe kjo nuk është një punë aq e lehtë. Ata punonjës të bujqësisë që janë më të dalluar e më të ngritur në këto drejtime, duhet të bëjnë edhe ndonjë kurs partie, pasi kurset agroteknike nuk janë të mjafta për ta, pse, që të zbatohet mirë agroteknika, çdo veprim duhet bërë në mënyrë sa më të ndërgjegjshme.



Kërkesat e kodit agroteknik duhet t'i dinë mirë në teori dhe në praktikë të gjithë kooperativistët, ashtu si taktikën e strategjinë ushtarake kërkohet t'i dinë, veç oficerëve, edhe të gjithë ushtarët, sepse lufta nuk bëhet me telefon nga vendkomanda. Mund t'u flasësh sa të duash ushtarëve t'i bien armikut andej ose këtej, kjo nuk sjell shumë dobi në rast se ushtarin nuk e ke mësuar me kohë si, ku dhe kur t'i bjerë armikut, si të marrë iniciativën, të interesohet të mësojë ç'forca ka armiku, ç'taktikë ndjek etj. Pa njohur, pra, strategjinë dhe taktikën e luftës, ai do të hutohet. Përkundrazi, kur ushtari është mësuar qysh më parë me të gjitha njohuritë e domosdoshme për luftë, porsa të japë një urdhër komanda, ai përnjëherësh e kupton situatën dhe vepron me iniciativë e në mënyrë krijuese. Kështu, pra, duhet të bëni edhe ju në bujqësi.

Çështjet ekonomike kanë rëndësi të madhe. Për zgjidhjen e tyre duhet bërë një luftë e kombinuar me kushtet e me fenomenet e natyrës, që zhvillohen në bazë të disa ligjeve objektive. Ne duhet t'i zbulojmë e t'i aplikojmë ato ligje, të njohim në ç'situatë klimatike zhvillohet kjo ose ajo bimë, ç'lloj toke kërkon etj. Për t'ia arritur kësaj duhet eksperimentuar më parë, por që kjo të mos bëhet më kot, është e domosdoshme të mësohet, fjala vjen, ç'elemente përmban toka ku do të rritet bima që do të mbillet etj. Është si puna e kalamanit deri sa vete 1 vjeç, për të cilin duhet ditur se ç'nevoja ka, ç'lloj ushqimi kërkon dhe pas një ose dy vjetësh dihet që duhet të hajë të tjera ushqime. Edhe për një bimë që do të mbillet në një tokë të caktuar duhet ditur se ka nevojë për një punim të caktuar,

kur duhet bërë ky punim dhe në ç'masë; për çfarë plehu ka nevojë e në ç'sasi i duhet hedhur, pse kjo varet nga bima, nga toka etj. Këto të gjitha na i mëson agroteknika. Prandaj përpiqet Partia që të tëra këto t'ua mësojë njerëzve tanë në kurse e në shkolla.

Duke ju folur për këtë problem, mos mendoni se i njoh si duhet këto gjëra. Jo, unë i njoh vetëm në vija të përgjithshme, duke marrë disa njohuri nga ndonjë libër që lexoj, disa të tjera i kam mësuar nga shokët specialistë, me të cilët kam rastin të takohem herë pas here etj. Vetë ju që punoni vazhdimisht në bujqësi jeni shumë më të zotë nga ne që këto njohuri i marrim nëpërmjet rrugësh të ndryshme, por nuk punojmë në terrenin konkret me to, ashtu si ju. Puna e madhe që bëni ju në fusha, në ara, me blegtorinë etj., zotimet tuaja për të marrë 30 kuintalë misër për hektar janë për t'u lavdëruar. Kam bindjen se ju do t'i realizoni me siguri këto zotime.

Lufta për ngritjen e rendimenteve në gjithë sektorët e prodhimit është një faktor bazë për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për mirëqenien e punonjësve tanë. Duke bërë përpjekje për ngritjen e mirëqenies së kooperativistëve në vijën e Partisë, çdo kooperativist, mbarë populli do të shohin se ato që thotë Partia realizohen, por, në rast se punojnë të gjithë, pse pa punë asgjë nuk bëhet, pa punë nuk ka si ngrihet mirëqenia.

Dëshiroj të flas pak edhe për luftën e përpjekjet që duhen bërë për realizimin e një sërë detyrash të tjera që përmenda e që janë jetike për njerëzit, si pas-tërtia, jeta e kulturuar në familje, lufta kundër zako-

neve prapanike etj. Përpjekjet tona në këto drejtime do të bëjnë efektin e duhur në rast se do të gjejnë mbështetje në popull. Pikërisht për t'ia arritur këtë qëllimi është e domosdoshme puna e madhe që duhet të bëjë Partia. Tashti zor se gjen njeri në vendin tonë që të thotë se nuk dëshiron të lahet e të rrijë i pastër. Është e vërtetë se dikur priftërinjtë thoshin që nuk duhet larë, se ikën nga trupi «uji i bekuar». Kur e pagëzonin fëmijën të krishterët, dhe i vinin emrin, e futnin në një kazan me «ujë të bekuar» dhe e lyejin me vaj, i cili, sipas fesë, nuk duhej larë, kurse myslimanëve nuk u hidhej as vaj, as uthull. Hoxhallarët u thoshin besimtarëve të mbanin ramazan, të mos hanin mish thiu e shumë gjëra të tjera. Edhe sot mund të ketë akoma ndonjë prapanik që mendon dhe përpiqet t'i praktikojë fshehurazi ritet fetare.

Lidhur me martesat në Jug ekzistonte një zakon i ndryshëm nga juaji. Ndërsa të rinjtë këtej nga ju nuk martohen brenda fshatit, andej jo vetëm martoheshin në fshat, por kishte raste edhe në të njëjtën gjini. 45 vjet më parë gruaja gjirokastrite nuk martohej jashtë qytetit, as burri nuk merrte grua nga larg, prandaj martesat bëheshin brendapërbrenda. Bile ka ndodhur që ndonjë djalë ka marrë për grua deri vajzën e xhaxhait ose të tezes dhe këtë e bënin vetëm për të ruajtur pasurinë. E shikoni gjer ku arrinte borgjezia për të mos ndarë pasurinë? Prandaj ka ndodhur në disa raste që, kur midis dy vëllezërve njëri kishte një çupë, tjetri një djalë, i ati i djalit, duke menduar se me ardhjen e një çupe tjetër në familje pasuria e vëllezërve do të pjesëtohej, preferonte të merrte vajzën e vëllait për

djalin. Natyrisht, një gjë e tillë bëhej nga njerëz të veçantë, megjithatë është fakt se feja myslimane i lejonte martesat brenda gjinisë, prandaj nga Gjirokastra s'dilnin as vajzat, as djemtë. Mirëpo tashti janë zhdukur krejtësisht të tilla zakone. E kundërta ndodhte te ju, njerëzit bridhnin sa andej-këtej me ditë të tëra larg fshatit, për të gjetur një burrë për cucën ose një grua për djalin.

Dëshiroj të flas një çikë edhe për çështjen e fisit. Së pari, duhet pasur parasysh që fisi të mos konfondohet me gjininë, pse fis e gjini janë dy gjëra krejt të ndryshme. Partia këshillon që familja të forcohet, po ama jo familja patriarkale me katër-pesë kurora nën një çati. Familja jonë e re zakonisht përbëhet nga gruaja me burrin e me kalamanët, po mund të ketë edhe nënën e babën e gruas apo të burrit, po jo edhe kunata e kunetër, domethënë që dy-tre vëllezër të martuar të rrojnë bashkë në një shtëpi, ku të sundojë plaku ose vëllai më i madh. Sot nuk mund të ecet me një familje të tillë. Nuk është e drejtë të punojë djali apo e reja dhe vëllai i madh e gruaja e tij të administrojnë të ardhurat sipas tekave e dëshirave të tyre, me një fjalë, të bëjnë si të duan në shtëpi, kurse të tjerët të mos kenë të drejtë as të flasin.

Duke shëtitur një ditë në ullishtet e Tiranës, më doli përpara një djalë i ri, nga i cili mësova nga ishte, çfarë pune bënte, ç'njerëz kishte në familje etj. Ai ishte elektrikist dhe, veç nënës e babës, në familje kishte edhe shumë të tjerë, bile bëheshin rreth 40 veta nën një çati. U çudita kur më tregoi se rrojnë të gjithë nën një strehë dhe veprojnë siç urdhëron gjyshi. «Shi-

ko, i thashë, kur të vesh në shtëpi, u thuaj se u poqa me shokun Enver dhe ai më porositi t'ju sjell të falat e tij e njëkohësisht t'ju jap porosinë e tij, në radhë të parë gjyshit, i cili fjalën e Partisë nuk e bën dy, që ai të lërë të lirë secilin nga djemtë e tij të hiqen veçan me familje». «Kështu do të bëj, shoku Enver», më dha fjalën djali. Kur e pyeta nëse ishte vërtet i bindur për ato që i thashë, pohoi me gëzim se ai në asnjë mënyrë nuk dëshiron të rrojë me 40 veta.

Rëndësi kryesore ka puna që duhet të bëjmë për të zhvilluar sa më mirë e më shpejt ekonominë. Këtë e theksova edhe në Tropojë e në të gjitha vendet që vizitova ditët e fundit. Edhe këto toka malore ne duhet t'i kthejmë në vende pjellore dhe për këtë ekzistojnë mundësi shumë të mëdha. Nga studimet që kemi bërë na del se edhe në vende si këto tuajat jo vetëm ekzistojnë mundësi për të hapur toka të reja, si dhe për të ngritur më tej rendimentet e bimëve në tokat e mbjella, për arsye se nga viti në vit këto po i trajtojmë më mirë, i lëvrojmë më thellë, i ujitim, i plehërojmë, përmirësojmë mekanizimin etj., por edhe sepse në këto vende po hapen perspektiva për gjetjen e mineraleve të dobishme. Dhe të zbulosh minerale do të thotë të hapësh miniera, të rritet kërkesa për fuqi punëtore, të rriten pasuria e begatia e atdheut dhe, njëkohësisht, edhe mirëqenia e masave punonjëse të këtyre zonave, në radhë të parë.

Një gjë e tillë e vë rrethin përpara detyrës për të shpejtuar hapat në drejtim të intensifikimit të bujqësisë, ndryshe nuk mund të përballohen punimet që do të kryhen për nxjerrjen e mineraleve dhe s'ka si të

krijohen kushte të mira për furnizimin e popullsisë së rrethit, dhe veçanërisht të punëtorëve në qendrat e reja të punës, me prodhime bujqësore e blegtorale. Po të jenë të mëdha minierat e fabrikat e reja që do të ngrihen, do të duhet të vijnë punëtorë edhe nga rrethe të tjera. Kjo do të thotë se do të shtohet popullsia e rrethit, prandaj aq më shumë punë do të kërkohet për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Situata e re që po krijohet na vë përpara detyrën për të dalë nga strukturat e vjetra të bujqësisë. Kjo nuk do të thotë që ta lëmë pas dore misrin, përkundrazi, do të luftojmë dhe po luftojmë për të gjetur farëra të atilla që të na sigurojnë rendimente të larta prej tij. Dhe ne do të kemi të tilla farëra, do të kenë prej tyre edhe ju këtu në Pukë. Ju mbillni në rrethin tuaj farën e misrit «Mati». Ajo na ka dhënë rezultate jo të vogla këtu, megjithatë ne duhet të sigurojmë kudo farë hibride me rendiment shumë të lartë. Po ta trajtosh si duhet, ajo, edhe në një vend malor si Puka, jep 120 kuintalë misër për hektar, nga 30 që merrni ju tani, domethënë katër herë më shumë.

Tokat ku po e mbillni misrin me duart tuaja të arta, i keni bërë me të vërtetë të lulëzojnë, i keni punuar më së miri dhe i keni ujitur. Çështja është të siguronit edhe ca pleh më shumë dhe atëherë, duke mbjellë farë hibride, do të shihni se si do të merrni me siguri nga 60 e 70 kuintalë misër për hektar. Nuk e di sa e keni rendimentin sivjet, po mendoj se një objektiv duhet ta keni medoemos. Mos lejoni të shkohet me mendimin që të na japë sa të na japë kjo tokë. Mua më duket se ju duhet t'i merrni tokës jo më pak nga 70

kuintalë për hektar, duke mbjellë farën hibride. Për zonat fushore janë vënë detyra më të larta. Tani na mbetet të sigurojmë farën hibride për tërë republikën, pastaj brenda dy-tre vjetëve do të shikoni si do të bëhet misri. Dhe rritja e prodhimit të tij do të na zgjidhë shumë probleme. Nuk do të flitet pastaj jo më për çështjen e bukës së njerëzve, por kjo do të na japë mundësi të plotësojmë në masën e duhur edhe nevojat për ushqimin e bagëtive, kryesisht të lopës.

Direktivat e Byrosë Politike dhe të Qeverisë vënë detyrën për ta zhvilluar kudo lopën, jo çfarëdo lope, po nga ato të racave më të mira që tani po i sjellim nga jashtë me shumicë. Megjithëkëtë, nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që me ardhjen e lopëve nga importi lopët e vendit t'i lëmë pas dore. Në asnjë mënyrë! Ne duhet të punojmë që, krahas importimit të lopëve të racës, të përmirësojmë tonat. Atje ku është punuar mirë në këtë drejtim, nga lopët e vendit kemi arritur të marrim 600, 700 e deri 800 litra qumësht në vit. Tani në kooperativat ju keni lopë vendi, nga të cilat nuk merrni më shumë se 300 litra në vit. Kjo është shumë pak, mundësitë janë për më shumë. Ka në rrethet e tjera lopë si tuajat, nga të cilat, duke i mbajtur në stalla e duke u siguruar një ushqim më të bollshëm, marrin jo sa ju, po nga 900 e deri 1 200 litra qumësht në vit. Prandaj kërkohen përpjekje që të përmirësohen edhe lopët e vendit.

Për të bërë përmirësim të lopëve të vendit, sidomos me racën «Xhersej», te ne ka filluar të punohet me kohë. Tani kemi sjellë lopë të tjera, të racave më të mira. Nga këto nuk u kemi dhënë akoma kooperati-

vave, po i përqendrojmë më parë nëpër ndërmarrje bujqësore, ku, duke i trajtuar si duhet, ato japin nga 3 000-4 000 litra qumësht në vit. Brenda dy-tre vjetëve, mbasi t'i shumëzojmë, do të fillojmë t'ua shpërndajmë edhe kooperativave. Po gjersa të vijë ajo kohë Partia na këshillon të punojmë për të përmirësuar lopët e vendit, duke i kryqëzuar me llojin «Xhersej» dhe me raca të tjera të mira nga ato që kemi sjellë gjer tani. Sidoqoftë, për përmirësimin e racës së vendit shkoni më mirë «Xhersej». Ja, pra, edhe për bagëtitë, e sidomos për lopët, perspektiva është e mirë.

Prandaj, kur të bëni planet e bujqësisë, të gjithë kooperativistët e rrethit tuaj të marrin pjesë aktivisht në diskutime, të japin mendime e të hartojnë plane të reja. Po në ç'mënyrë? Ta zëmë se vjet kanë mbjellë 100 hektarë me misër, nga të cilët kanë marrë 25 kuintalë për hektar. Sivjet duhet luftuar për të marrë 40 kuintalë për hektar. Atëherë mund të mbillen vetëm 80 hektarë me misër, kurse 20 hektarë tokë që do të mbetet nga të 100 hektarët, mund të mbillen pjesërisht me jonxhë, e cila korret 4-5 herë në vit, apo me bimë të tjera foragjere që rekomandohen nga zooteknikët e veterinerët. Të tëra këto duhen bërë me llogari për të nxjerrë sa do të japin. Njëkohësisht të llogaritet sa ushqim kërkon çdo lopë që të na japë gjithë sasinë e mundshme të qumështit. Kjo llogari do t'i kërkohej ta bëjë zooteknikut. Kështu, kur të vijë zootekniku në kooperativë, t'i thonë se janë duke përgatitur planin, po u ka ngecur çështja te lopët, prandaj të kërkojnë këshillat e tij dhe ai do t'u thotë sa ushqime duhet t'i japin secilës lopë, për të marrë më shumë qumësht.



Duke vepruar sipas kërkesave të shkencës zooteknike, kooperativistët do të shikojnë pastaj si do t'i shtojnë prodhimet lopët. Pa ecur në këtë rrugë, nuk shtohen bagëtitë, nuk rriten lopët dhe kafshët e tjera, nuk mund të merren mish e qumësht në sasi të që nevojiten.

Partia tani na mëson se përveç misrit na duhet edhe gruri, aq i nevojshëm për ushqimin e njeriut. Njerëzit, sidomos fëmijët, kanë nevojë të hanë edhe mish. Ai nuk bie nga qielli, prandaj edhe atë duhet ta prodhojmë vetë.

Nuk ju dëgjova këtu të na flisnit për thiun, kurse në rrethin e Pukës ai duhet të gjejë fushë të lirë zhvillimi. Mirëpo, që të rritet për mish, derri do ushqim. Ne duhet të bëjmë përpjekje për të arritur që çdo familje të rritë derra për t'i bërë pastërma ose proshuta të mira për dimër dhe me sallon e tyre të mbushin qypat. Kjo do të ishte një gjë shumë e mirë. Por që të japë mish të bollshëm, derri ka nevojë të ushqehet vetë.

Po mishi i vëçit dhe i lopës si është? Në botë atë e kanë nga më të mirët. Shumë njerëz te ne pëlqejnë mishin e qengjit, bile andej nga Labëria e hanë shumë këtë mish dhe rrallë e gatuajnë me zarzavate.

Prandaj edhe në këtë drejtim duhet të bëhet mirë e qartë politika e Partisë, të dinë të gjithë cilat kafshë duhen rritur për qumësht, cilat për mish, për lesh etj. Rëndësi, në radhë të parë, duhet t'i vihet lopës, derri në radhë të dytë, pastaj deles, po kësaj kryesisht për mish dhe për lesh, sepse qumështin do ta sigurojmë më shumë nga lopët. Dhe kur themi që delen ta rritim sidomos për lesh, të kemi parasysh që prej saj të ma-

rrim jo nga një kilogram, po nga katër-pesë kilogramë lesh për kokë. Veç këtyre, duhet treguar shumë kujdes edhe për shtimin e pulave, të cilat kanë një të mirë që rriten në shtëpi. Duke rritur më shumë pula, bëhet e mundur që njerëzit të hanë mish më shpesh. Të mos lihet pas dore edhe dhia për qumësht e për mish në ato vende ku ka kullota për të dhe ku nuk dëmton drurët pyjorë.

Që të hamë mish, siç thashë më lart, atë duhet ta prodhojmë. Në qoftë se do t'u jepet ushqim i mjaftueshëm bagëtive, do të prodhohet mish me bollëk. Shumë vende në botë, duke u kujdesur për zgjidhjen e këtij problemi, kanë arritur të sigurojnë mish e qumësht me bollëk, pse kanë zbatuar forma e metoda pune të reja në bujqësi e në blegtori, kanë ndryshuar strukturat e këtyre sektorëve. Edhe ne duhet ta studiojmë eksperiencën e përparuar botërore në këta sektorë, të shohim çfarë kanë bërë dhe po bëjnë vendet e tjera në këtë drejtim. Të marrim eksperiencën e përparuar, ashtu siç marrim prej tyre edhe makina. Makineritë ose bagëtitë prodhuese nuk i kanë bërë kapitalistët, po punëtorët e fshatarët punonjës, mendja e tyre e mprehtë. Kafshët ose makinat që ne u blejmë atyre nuk na sjellin asnjë dëm, kujdes duhet pasur nga ideologjia borgjeze, këtë ta luftojmë dhe do ta luftojmë gjersa të shkatërrohen plotësisht kapitalizmi dhe ideologjia e tij.

Që të shtojmë mishin e qumështin, ne duhet të shtojmë, në radhë të parë, prodhimet bujqësore, të cilat nuk rriten pa pleh. Këto çështje jua kanë thënë e jua kanë përsëritur shokët e Partisë e të pushtetit. Veç kësaj, ju i dini më mirë nga ne këto gjëra, prandaj

dëshiroj vetëm të theksoj edhe një herë se lopët janë ato kafshë që na japin edhe pleh të bollshëm, ndërsa kafshët e tjera nuk japin kaq shumë.

Unë mendoj se i keni mirë synimet për zhvillimin e bujqësisë në rrugën socialiste. Tani këto synime, duke gjetur format e metodat më të mira të planifikimit, përpiquni që çdo kooperativë t'i harmonizojë duke llogaritur mirë ç'lloje bimësh duhet të zhvillojë me mundësitë që ka jo vetëm për nevojat e veta, po edhe për ato të rrethit dhe të të gjithë vendit, duke u bazuar në kushtet ekzistuese. Për këtë qëllim është e domosdoshme të bëhen studime me kujdes, në bazë të të cilave të përcaktohet ku e në ç'etapë do të arrijmë gjatë pesëvjeçarit. Krahas masave për të shtuar e për të përmirësuar lopën, të mendohet edhe për mbarështimin e derrit, të deles. Dhitë do t'i pakësojmë, por, edhe pasi ta kemi zhvilluar mirë lopën kudo, deri edhe në malësi, ato s'duhet t'i heqim të tëra, pse ka e do të ketë edhe në të ardhmen disa zona ku do të mbajmë dhi.

Pra, kur të përgatitni planin e ri pesëvjeçar, kini parasysh dhe krijoni mundësitë që çdo njeri t'i thotë mendimet që ka për këto çështje, thoni edhe ju vetë mendimet tuaja, dhe të gjitha ato që do t'ju duken të drejta i mbronin në interes të përgjithshëm të kooperativës, të rrethit dhe të mbarë atdheut.

Natyrisht, shokët drejtues në rreth kanë parasysh të mos u imponojnë kërkesa të paarsyeshme kooperativave, e dëgjojnë me kujdes bazën, duke e sqaruar atë sa më drejt politikisht. Shokëve e shoqeve që drejtojnë në bazë si kryetarë, zëvendëskryetarë kooperativash, brigadierë etj., duhet t'u bëhet e qartë vija e

Partisë, t'u tregohet ç'kërkojnë Partia dhe Qeveria nga secila kooperativë, për shembull, sa drithë duhet t'i japin shtetit, pa e prodhojnë këtë sasi në njëqind hektarë apo në pesëdhjetë hektarë, kjo është puna e tyre. Sipërfaqet e tjera të tokës që do të ekonomizohen nga rritja e rendimenteve, kooperativa le t'i mbjellë me bimët që mendon vetë. Kjo kërkon që planin për këtë qëllim ajo ta përgatitë bashkë me gjithë anëtarët. Pas kësaj pune, përfaqësuesit e kooperativës thirren në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, ku së bashku me punonjësit me eksperiencë që shërbejnë aty, të cilët janë mirë në dijeni për udhëzimet e dërguara nga qendra, harmonizojnë planet me shokët e kooperativës. Kjo punë është e domosdoshme të bëhet, pse një palë mund të thonë një mendim, ata të një kooperative tjetër mund të kenë mendime të tjera e kështu me radhë. Mirëpo rrethi e di ç'sasi drithi, qumështi, mishi, vezësh etj. i kërkohet, prandaj është e domosdoshme që shokët e rrethit të këshillohen e të diskutojnë me ata të kooperativave për të harmonizuar nevojat e çdo kooperative me ato të rrethit dhe të gjithë republikës. Sidoqoftë, është e domosdoshme të dëgjohet me kujdes zëri i bazës dhe jo t'i imponohen asaj edhe gjërat më të vogla.

S'ka dyshim, shokë, se ashtu si gjithë Shqipëria, edhe rrethi juaj ka ecur përpara jo vetëm në sektorin ekonomik, por edhe në atë ideologjik e politik. Përpjekjet që janë bërë në këtë drejtim do të vazhdojnë për shumë kohë. Prandaj organizatat e Partisë duhet të mos i zërë gjumi duke menduar se me marrjen e disa masave lufta kundër fesë ose zakoneve prapanike

ka përfunduar. Partia e ka të qartë se do të duhet të bëhet akoma shumë punë kundër tyre. Por rëndësi ka që kemi hyrë në rrugë të drejtë. Tani duhet të punojmë për ta bërë gjithë popullin të interesohet për njohjen e për zbatimin e vijës së Partisë, pse kjo është një gjë me rëndësi të madhe. Do të ketë disa njerëz që mund të mos e kuptojnë këtë ose atë çështje, kështu që nuk do të mund të zbatojnë disa detyra, prandaj të mos mendojmë se çdo njeri e kupton menjëherë vijën për të gjitha çështjet. Por të kemi kujdes që me njerëz të tillë të punojmë me takt e t'i bindim për drejtësinë e vijës së Partisë, duke ua bërë këtë sa më të qartë.

Të bindesh nuk do të thotë të nënshtrohesh, po të ecësh në rrugën e Partisë. Në këtë drejtim ka edhe te ju plot shembuj të mirë, jehona e të cilëve është ndier në Komitetin Qendror të Partisë. Ka caça pukjane që janë komuniste të denja. Me qëndrimet e tyre ato kanë dhënë shembuj të vërtetë heroizmi dhe, njëkohësisht, kuptimi të lartë të vijës së Partisë. Një nga këto caça është edhe ajo që jua tha hapur në byro kur e thirrët dhe i treguat letrën që ju pati dërguar burri i saj, se këtu po e merrte vesh ajo që për t'u futur në Parti duheshin bërë dy lutje, një burrit e një tjetër komitetit, dhe theksoi se lutje do t'i bënte vetëm Partisë për të hyrë në radhët e saj. Ne e kënduam me emocion të madh informacionin që na u dha për qëndrimin shembullor, dinjitoz e me një kuptim të lartë politik dhe ideologjik të kësaj shoqeje. Me gjithë qëndrimin negativ të burrit, ajo nuk tha që ai është armik. Përkundrazi, vuri drejt në dukje se me qëndrimin e tij ai tregon se nuk e ka të qartë vijën e Partisë dhe

premtoi se do të bëjë të gjitha përpjekjet për ta sjellë në rrugë të drejtë, por kërkoi edhe ndihmën e Partisë që i shoqi ta kuptojë gabimin e, më së fundi, shprehu bindjen se edhe ai do të ndreqet. Dhe në fakt kështu ka ndodhur. Bashkëshorti i kësaj të reje, duke qenë njeri i mirë, e kuptoi shpejt se nuk kishte mbajtur qëndrim të drejtë ndaj shoqes së vet dhe u korrigjua. Por ka edhe njerëz që bëjnë veprime me qëllime të këqija. Këta duhen demaskuar në popull dhe, kur e teprojnë duke shkelur ligjet, pushteti të marrë masat përkatëse kundër tyre.

Në radhë të parë të bëhen përpjekje për t'i sqaruar njerëzit. Kjo nuk do të thotë t'u nënshtrohemi atyre që ngulin këmbë pa arsye në të tyren. Jo. Çështjen e kam më shumë me ju gratë, pse ato qëndrime që mbajnë disa burra me mendime prapanike rëndojnë mbi ju. Burri është akoma kokosh në familje, për arsye se shumë privilegje të dhëna nga fisi, nga kanuni, nga ligjet e regjimeve reaksionare ai i ka gëzuar me shekuj. Partia është me ju dhe i kritikon të tillë burra që përpiqen t'ju imponohen, t'ju pengojnë në liritë e të drejtat tuaja. Po flas pak më konkretisht. Në qoftë se prindi kundërshton që e bija të fejojë me një djalë të mirë e të ndershëm që dashuron, pse atë ai s'e paska qejf pa asnjë arsye, vajza, nga ana e vet, e ka për detyrë t'i flasë një herë, t'i flasë edhe një herë tjetër, por në rast se shikon që i ati nuk po bindet, t'i kërkojë të falur babait dhe të martohet me atë që do. Megjithatë, e bija t'i thotë se nuk zemërohet me të, se ajo prapë do të përpiqet ta bindë një herë, dy herë, tri herë, do t'i vejë edhe në shtëpi, po me djalin që dashuron

ajo do të marthohet. E tillë të jetë rruga që duhet ndjekur për të bindur prindërit dhe jo nënshtrimi ndaj qëndrimeve prapanike apo të paarsyeshme të ndonjërit.

Partia ju këshillon ju vajzat e gratë të veni në shkolla ose në kurse. Ju që po ndiqni këtu kursin e Partisë të rrethit, sigurisht, s'ju ka ndaluar kush, as burri, as babai, as vëllai, pse jeni anëtare partie, jeni gra e vajza të ngritura, i keni të qartë qëllimin dhe rëndësinë e mësimit, dini edhe si t'i bindni njerëzit e familjes edhe po të keni ndonjë që ju pengon kur ju vihet detyra ose kur vetë dëshironi të mësoni. Çështjen e kam te ndonjë vajzë që Partia e këshillon të vejë në shkollë. Kjo e ka për detyrë t'ia shpjegojë një herë, dy apo tri herë prindit, pastaj, po të mos bindet, t'i thotë: «Mbeç me shëndet, baba, unë do të vete në kurs». Por kini parasysh, shoqe dhe shokë, se edhe kur babai s'dëshiron t'i vejë vajza në kurs, të jeni të sigurt se këtë ai e bën nga frika se mos i ngjasë gjëkafshë së bijës. Po, kur vajza t'i thotë babës të mos ketë frikë për këtë çështje, se ajo vetë është në gjendje dhe di ta mbrojë nderin shumë më mirë se brenda katër mureve të shtëpisë ku e ka mbyllur i ati, mbasi tani ia ka hapur sytë Partia, të jeni të sigurt se ai, më së fundi, do të bindet, por, nëse reziston, kjo vjen për arsye të mbeturinave e të zakoneve prapanike që e mundojnë akoma. Pasojat e gjithë këtyre zakoneve e mbeturinave bien në radhë të parë mbi gratë e vajzat.

Partia dhe Komiteti i saj Qendror na këshillojnë ta mbrojmë me forcë çështjen e gruas, derisa kjo ta ndiejë veten plotësisht të barabartë me burrin kudo, në çdo drejtim. Po që t'i arrihet kësaj plotësisht, do

të duhet një kohë akoma e gjatë. Kjo varet shumë nga vetë gratë, nga ngritja e tyre ideologjike dhe politike, në radhë të parë, që ato të bëhen të zonjat për ta marrë vetë në dorë mbrojtjen e të drejtave të tyre, përderisa të arrihet që të jenë të barabarta me burrat. Të shikoni atëherë ç'dashuri e singertë dhe e pastër do të ekzistojë në familje, sepse do të jetë zhdukur fodullëku i burrit. Fodullëku është një e keqe që ka për objekt të shtypë dikë dhe në familje objekt shtypjeje është gruaja, pastaj fëmijët. Mirëpo kur të jetë ngritur nga çdo pikëpamje në një nivel me burrin, gruaja do të bëhet një luftëtare e ndërgjegjshme, siç mëson Partia, dhe burrit do t'i zhduken veset e këqija që ka trashëguar. Atëherë gjendja e familjes do të marrë një tjetër pamje, aty do të lulëzojnë harmonia e vërtetë, demokracia, barazia, do të bëhen biseda më të lira, do të diskutohet ngrohtësisht për zgjidhjen e problemeve dhe për jetën e brendshme të familjes etj. dhe në punë të gjithë pjesëtarët do të dalin më të gëzuar.

Partia i kushton një rëndësi të madhe forcimit të pozitive të gruas në familje, pse edhe këtu ajo luan një rol të madh, prandaj nuk duhet të jetë në asnjë mënyrë e përrulur. Po u arrit në familje niveli i duhur i gruas, të shikoni se si do të bëhet Shqipëria. Këtë nuk e them për t'ju bërë qejfin ju shoqeve, po kështu është.

Vendi ynë ka nevojë të madhe jo vetëm për forcën tuaj fizike, po edhe për atë mendore, për arsyetimin, për diturinë dhe për mençurinë tuaj, që kanë qenë nënvleftësuar. Prandaj vazhdoni të ndiqni me zell



shkollat e kurset, mësoni kurdoherë pa u lodhur, krahas punës së përditshme këndoni edhe libra e romane. Pastaj, pasi ta keni kënduar librin, reflektoni dhe nxirrni konkluzionet e nevojshme nga leximi. Edhe ju që jeni duke ndjekur këtu kursin e Partisë, mos i mësoni gjërat në mënyrë automatike, çdo tekst e leksion e lexoni me vëmendje dhe përpiquni të thelloheni e të kuptoni brendinë e tyre. Në mbrëmje, kur bini të pushoni, i lidhni ato që keni lexuar me jetën në kooperativë apo në familje, përpiquni kurdoherë të gjeni me mendjen tuaj se për çfarë do t'ju shërbejë mësimi që morët sot, si do t'ju shërbejë ai që u zhvillua dje etj. Ato që ju mësojnë këtu në kurs, kanë lidhje me punën, me jetën e përditshme, me eksperiencën e masave punonjëse, prandaj ju duhet ta bëni medoemos lidhjen e tyre, pavarësisht nëse jua bëjnë këtë apo jo mësuesit dhe pedagogët e kursit. Puna e tyre duhet të bashkohet me punën tuaj mendore për këto probleme.

Rëndësi ka, pra, që të punojë vazhdimisht koka e secilit. Kështu duhet të veproni edhe kur të ktheheni në punë, kur veni në konferenca apo kur shtrohet ndonjë çështje etj. Kurdoherë të mendoni si e trajton Partia një problem të gruas, një problem ekonomik apo shoqëror, një çështje të industrisë etj. Është e domosdoshme të thelloheni në konkluzionet teorike që ka nxjerrë Partia për atë problem dhe ta lidhni çështjen me ato që keni mësuar. Edhe kur ka çështje ca më të thjeshta, për shembull, kur njëri flet për diçka, dëgjojeni me vërejtje, reflektoni mirë mbi gjithçka ka thënë, janë vallë ato në interes të popullit apo mos ka ndonjë gjë të shtrembër midis tyre? Mos bëri ai ndo-

një kritikë pa vend? Në rast se nga ky arsjetim nuk del gjë e keqe, atëherë, kur të përfundojë fjalën, i thoni: «Shumë mirë fole, jemi dakord me diskutimin që bëre». Kjo do të thotë të bësh konkluzione të drejta. Por folësi mund të shprehë edhe mendime jo të drejta, prandaj duhet reflektuar kur nuk e ka drejt atë që thotë.

Përpara na dalin shumë probleme, të cilat do t'i zgjidhim patjetër. Partia ka zgjidhur gjer më sot sa e sa probleme, bile edhe shumë më të koklavitura. Megjithatë mbeten akoma plot gjëra të koklavitura që duhen zgjidhur, veçse tani gjendja nuk është si në periudhën pas Çlirimit. Sot Partia zotëron një forcë të madhe, e cila qëndron tek eksperiencia kolosale që ka fituar. Komunistët dhe komunistet, qysh në ditët e para kur u formua Partia e në gjithë këta vjet, së bashku me popullin, kanë luftuar dhe kanë krijuar kudo, në të gjithë sektorët, gjëra shumë të bukura e të dobishme. Njerëzit tanë kanë tani eksperiencë të madhe në luftën për ndërtimin e socializmit, ata janë kalitur nëpërmjet gjithfarë vështirësish, politikisht mendojnë drejt, ideologjikisht janë ngritur si asnjëherë, prandaj në përgjithësi mendojnë e veprojnë sipas mësimëve të Partisë. Kudo janë hapur kurse partie, si ky që është hapur në rrethin tuaj, kemi Shkollën e Lartë të Partisë në Tiranë, kemi format e edukimit komunist të punonjësve, pastaj në të gjitha shkollat e arsimit të përgjithshëm e profesional mësohet marksizëm-leninizmi. Njerëzit tanë, pra, komunistë dhe të paorganizuar në Parti, kudo që punojnë, njëkohësisht edhe mësojnë, pajisen me ideologjinë e klasës punëtore.

Përparime po bëhen te ne edhe nga ana tekniko-shkencore, prandaj vihet re një hov i madh në fushën e shkencës dhe të teknikës. Revolucioni tekniko-shkencor në vendin tonë po zhvillohet me sukses në të gjitha drejtimet. Me planet që po hartohen, vitet e ardhshme ky revolucion do të ecë akoma më përpara, në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Ne nuk kemi nevojë për një të ashtuquajtur revolucion tekniko-shkencor që nuk shkon në këtë rrugë. E them këtë, se edhe në vendet kapitaliste zhvillohet revolucioni tekniko-shkencor, por teknika dhe shkenca atje shfrytëzohen për shtypjen e masave punonjëse dhe për pasurimin e monopoleve kapitaliste, kurse te ne çdo gjë vihet në shërbim të popullit dhe në këtë drejtim janë bërë e do të bëhen edhe në të ardhmen përparime të mëdha.

Në përgjithësi planet tona realizohen në të gjithë sektorët. Plani ynë pesëvjeçar, me përjashtim të bujqësisë, jo vetëm do të realizohet, po edhe do të tejkalohet. Edhe në bujqësi, megjithëse varet ca edhe nga moti, do t'i afrohem realizimit. Ky është një sukses i madh dhe vërteton se direktivat e Kongresit të 5-të janë plotësisht të bazuara e të drejta. Partia dhe populli u mobilizuan me të gjitha forcat për realizimin e tyre, prandaj edhe po korrin fitore. Gjatë viteve të planit të ardhshëm pesëvjeçar ne do të ndërtojmë vepra të reja të mëdha industriale, po edhe bujqësinë do ta ngremë në një nivel më të përparuar, duke i vënë rëndësi, sidomos, rritjes së rendimenteve.

Andej nga kaluam, nga Kukësi dhe Tropoja, pamë një entuziazëm të madh, populli është shumë i gëzuar

dhe i lidhur ngushtë me Partinë, kështu si edhe te ju, dhe plotësisht i mobilizuar për realizimin e planeve. Një patriotizëm i lartë, një gatishmëri ushtarake, një mobilizim total vihen re kudo. Për problemet e mbrojtjes na treguan edhe pleqtë si kanë punuar. «Të punojmë në radhë të parë për mbrojtjen e atdheut, na thoshin njerëzit, pse çështja e mbrojtjes është kryesorja».

Prandaj asnjëherë të mos na zërë gjumi për këtë çështje, gjersa forcat imperialiste, sadoqë dobësohen vazhdimisht, vazhdojnë të përgatiten për luftë. Imperializmi amerikan është në krizë, ai po zhvillon luftëra të armatosura në shumë vende të botës, si në Vietnam, në Kamboxhia, në Laos etj.; ia ka hyrë kësaj pune dhe tani nuk po ia del dot. Edhe vendet e tjera kapitaliste janë në krizë. Revizionizmi sovjetik është, gjithashtu, në krizë të madhe.

Krejt ndryshe qëndron puna me Shqipërinë. Ne ecim përpara dhe ndërtojmë me sukses socializmin. Edhe ushtarakisht po forcohem çdo ditë e më shumë, prandaj morali i popullit tonë është i lartë. Megjithatë duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të përgatitur. Prandaj asnjëherë të mos lihen pas dore stërvitjet ushtarake dhe jo vetëm të rezervistëve. Të gjithë të jenë të inkuadruar nëpër batalione. Sidomos ju komunistët t'u kërkonti shumë në këtë drejtim oficerëve që ju stërvitin, të mos lejoni t'ju zhvillojnë çdo vit të njëjtat gjëra, po t'ju bëjnë gjëra të reja politike dhe taktike. Kërkonti t'ju mësojnë jo vetëm si të qëlloni me pushkë, po edhe me mortaja e me armë të tjera, me qëllim që

të jemi sa më mirë në gjendje ta mbrojmë atdheun në kohë rreziku. Mos mendoni se, duke bërë pjesë në çetën e fshatit, është mjaft të dini pak gjëra. Po të ngjasë ndonjë rrezik, edhe ju shoqe do të luftoni krah për krah me ne, ndonjëra mund të bëhet edhe komisare apo komandante batalioni apo brigade etj. Edhe sikur të jeni luftëtare të thjeshta, po të qëllojë që të vritet komandanti i batalionit, duke u përgatitur me kohë qysh tani, ndonjëra nga ju do të jetë në gjendje të marrë përnjëherësh komandën e të drejtojnë. Po kjo detyrë mund të kryhet mirë kur të gjithë të mësojnë si duhet me kohë Artin Ushtarak të Luftës Popullore. Kohën në dispozicion për stërvitjen tuaj ushtarake oficerët dhe instruktorët duhet ta shfrytëzojnë mirë, lëndën dhe çdo lloj stërvitjeje t'jua bëjnë të qarta, po edhe ju vetë duhet të jeni shumë kërkuese ndaj tyre, duke u bërë pyetje pse duhet vepruar kështu si thonë ata dhe jo ndryshe, përse duhet dalë në këtë rast te ky breg dhe jo tek ai tjetri, pse i duhet prerë rruga armikut më poshtë dhe jo më lart, përse duhet të vejë tërë kompania në atë kodër dhe jo vetëm dy veta për të ruajtur grykën etj. Me pyetje të tilla oficeri, në radhë të parë, do të vihet të mendojë më mirë, po bashkë me të duhet të mendojnë edhe gjithë të tjerët që stërviten prej tij. Ne duhet të arrijmë atë që na mëson Lenini, që të gjithë të jemi ushtarë të mirë e njëkohësisht edhe qytetarë të mirë.

Mos keni edhe ju ndonjë vërejtje, mendim, sugjerim apo propozim për të na bërë? Mbase dëshironi të na jepni edhe ndonjë këshillë apo të na bëni ndonjë kritikë për diçka që ndoshta nuk e kemi drejt e duhet.

të marrim masa. Atëherë, gjersa nuk keni ndonjë gjë, sonte po e mbyllim bisedën në këtë takim.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

**NDËRTIMET TE NE BËHEN ME LËNDËN  
QË NXJERRIN DUART TUAJA TË REGJURA  
SI LËVOZHGA SHEKULLORE E PISHËS**

*Fjala në mitingun e qytetit të Pukës*

**2 qershor 1970**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Motra dhe vëllezër pukjanë,

Është një gëzim i madh për mua që të takohem dhe të bisedoj shtruar sot me popullin trim të Pukës, me përfaqësuesit e klasës punëtore, me sharrëxhinjtë e dëgjuar pukjanë, me kooperativistët dhe me gjithë punonjësit e tjerë të rrethit tuaj. Me këtë rast ju sjell përshëndetjet më të ngrohta revolucionare të Partisë e të Qeverisë dhe ju përgëzoj nga zemra për sukseset që keni arritur në ndërtimin e jetës së re socialiste.

Këto ditë, shokë e shoqe, unë bëra shumë takime e biseda me popullin e Kukësit e të Tropojës. Atje pashë me sytë e mi përparimet që janë bërë dhe kudo biseduam si shokë e vëllezër për të ardhmen, për detyrat që na dalin. Në këtë drejtim dëgjova me vëmendje propozimet e punëtorëve e të fshatarëve dhe

i dhamë këshilla njëri-tjetrit, në mënyrë që punët tona të shkojnë edhe më përpara. Kontaktet e bisedat që pata me ta, si dhe ato që do të kem me ju, janë e do të jenë shumë të dobishme. Jam i bindur se ato na ndihmojnë të gjithëve për t'i kryer akoma më mirë detyrat e mëdha që ka shtruar Partia përpara nesh.

Por desha të përmend se gjatë këtyre takimeve disa herë na është dashur të kujtojmë të kaluarën e hidhur, për të vlerësuar luftën dhe punën e madhe që ka bërë populli ynë i mrekullueshëm, nën udhëheqjen e Partisë, për të arritur këtu ku jemi sot. Ngado që shkon, kudo që ndalesh, shikon ndryshimet që janë bërë, të cilat janë si dita me natën në krahasim me periudhën para Çlirimit.

Ja, në rrethin tuaj shikon Pukën, këtë qytet të vogël malor, por të pastër e të bukur, me shkolla, me shtëpi e me dyqane, dhe menjëherë të shkon mendja te Puka e vjetër me 4-5 baraka, që kishte më shumë xhandarë, tagrambledhës e nëpunës gjakpirës të Zogut e të fashizmit sesa popullsi; shikon sot Fushë-Arrëzin me stabilimentet e sharrave shpërndarë në të katër anët e rrethit, ku punojnë mijëra punëtorë, bij të këtyre malësive, që kanë shpënë jetën, gëzimin, lumturinë në çdo familje shqiptare, kur mendon se çdo ndërtim në vendin tonë është bërë me lëndën që ju heronj pukjanë keni sharruar në shi e në dëborë dhe ua keni dërguar vëllezërve tuaj në të katër anët e atdheut; çdo gjë, pra, te ne është ndërtuar me lëndën që kanë nxjerrë duart tuaja të regjura si lëvozhga shekullore e pishës. Minatori ynë, në çdo minierë qoftë, kur punon ndihet i sigurt, se armaturën në galeri ia ka dërguar vëllai i tij,



sharrëxhi nga Puka; treni është i sigurt mbi binarët e hekurudhës, pasi traversat mbi të cilat ecën i ka prerë sharrëxhiu i Pukës; në hidrocentralet që ndërtojmë punëtorët e ndërtimit hipin mbi skelat e drunjta të bëra me lëndë që keni nxjerrë ju nga pyjet; çdo punëtori, i cilëso kategorie e natyre qoftë, në të katër anët e Shqipërisë, kur shkon në punë ose kur prehet në familjen e vet, i është rrënjosur në mendje se fabrika apo shtëpia ku gëzon është ndërtuar me lëndë druri të nxjerrë nga këto pyje shekullore dhe me dërrasat e punuara nga duart tuaja, shokë punëtorë pukjanë.

Kur shikojmë, pra, gjithë veprat e bukura që kanë krijuar mençuria dhe duart e mbarë popullit tonë, nën udhëheqjen e Partisë, nuk mund të mos mendojmë për atë kontribut të madh që keni dhënë veçanërisht ju në ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste, nuk mund të mos na shkojë mendja tek ajo e kaluar e zezë e këtij populli që vuante edhe për bukën e gojës; kujtojmë legjendën e misrit, legjendën e trishtueshme të malësorëve të varfër, të cilët, siç thoshte Migjeni, ecnin të ngarkuar me nga një gjysmë thesi misër, duke mbartur mbi kurriz jetën e vet të rëndë.

Sot njeriu shikon kudo si po lulëzojnë kooperativat tona bujqësore, deri edhe në malësitë më të thella, shikon dritën elektrike që po hyn në çdo shtëpi malësori, shikon këtu në qytetin e Pukës shkollën e mesme të bukur, plot dritë e ajër, si dhe shumë shkolla të tjera në të gjitha fshatrat, ku tetëvjeçaren e kryejnë pa përjashtim tërë bijtë dhe bijat e rrethit, gjithsej gati 8 000 nxënës, ku japin mësim 280 arsimtarë; shikon

kudo në fshatra institucione sociale e kulturore etj. dhe nuk mund të mos sjellësh ndër mend Pukën e pishës e të bishtukut, që kishte vetëm 200 nxënës dhe 6 mësues, ku nuk kishte mjekë dhe populli vuante nga uria, nga skamja dhe nga sëmundjet.

Është e ditur se gjithë këto ndryshime nuk erdhën vetvetiu, nuk u arritën lehtë e lehtë. Përkundrazi, u desh një luftë e punë e madhe, u desh të luftohej me heroizëm kundër fashistëve e tradhtarëve për të çliruar vendin, për të shkatërruar pushtetin e tyre dhe për të ndërtuar mbi gërmadhat e tij pushtetin e popullit, diktaturën e proletariatit. U desh të luftohej, gjithashtu, me të njëjtin heroizëm e vetëmohim kundër gjithë armiqtë pas Çlirimit, kundër bejlerëve e agallarëve, borgjezëve e bajraktarëve, që donin të pengonin ndërtimin e socializmit, kundër kulakëve e klerit reaksionar, kundër bandave të diversantëve dhe gjithë armiqtë të tjerë që bënë çmos për të përmbysur pushtetin popullor në Shqipëri. Gjaku i bijve më të mirë të popullit të rrethit të Pukës, si Halil Tërbuni, Pjetër Prendi, Zoje Ismaili, Frrok Kola, Zef Faslliu, Zenel Çoba, Nikollë Vogli e të tjerë, u bashkua me gjakun e qindra e mijëra dëshmorëve të atdheut dhe çimentoi themelet e Republikës Popullore të Shqipërisë, të jetës së re socialiste që ne gëzojmë sot. Prandaj t'i ruajmë si sytë e ballit fitoret e arritura, shokë e shoqe, t'i shtojmë e t'i zhvillojmë ato gjithmonë e më shumë, duke punuar e duke vigjiluar, duke mbajtur kurdoherë fort në njërën dorë kazmën e në dorën tjetër pushkën.

Rrethi i Pukës është zhvilluar shumë gjatë këtyre viteve të pushtetit popullor. Këtu ka marrë hov e po

zhvillohet me vull industria socialiste. Puka njihet në të gjithë Shqipërinë për pasuritë e mëdha pyjore dhe për industrinë e drurit, por ajo u jep atdheut dhe ndërtimit socialist edhe mineral bakri, kaolinë e prodhime të tjera shumë të nevojshme. Si rrjedhim i krijimit të industrisë, është formuar këtu edhe klasa punëtore, e cila rritet e forcohet vazhdimisht, dhe, ashtu si gjithë klasa punëtore e vendit, e edukuar me mësimet e Partisë, qëndron në vijën e parë të luftës për ndërtimin e socializmit.

Mua më gëzon fakti që edhe te ju janë arritur suksese të rëndësishme në zhvillimin e bujqësisë. Në mënyrë të veçantë desha t'ju përgëzoj, të dashur shokë dhe shoqe kooperativiste, sidomos për rendimentet e larta që keni marrë në gjithë sipërfaqen e mbjellë me misër, si dhe për punën e madhe që keni bërë e për suksesin që keni arritur duke vënë nën ujë pjesën më të madhe të tokës arë të rrethit. Eksperienca juaj në këto drejtime është për t'u lavdëruar dhe duhet t'u shërbejë si shembull sidomos atyre rretheve malore të vendit tonë që janë më prapa dhe që kanë kushte të barabarta me ju.

Thashë se rrethi i Pukës njihet për masivet pyjore, për këtë pasuri shumë të madhe që kanë populli e atdheu ynë në këto anë. Desha të ndalesha dhe ta bisedoja pak me ju këtë çështje, shokë e shoqe pukjane. Ka vite që po shfrytëzohen pyjet e Pukës, të cilat janë bërë nga furnizueset kryesore të ekonomisë dhe të popullsisë së republikës me lëndë druri. Kjo është një gjë shumë e mirë, por nxjerr, njëkohësisht, dhe mjaft probleme serioze e na shtron edhe shumë detyra të.

mëdha. Pyjet prodhojnë vazhdimisht lëndë, por, që të mos shterojnë kurrë, ato duhet të shfrytëzohen sipas rregullave, të mos dëmtohen, të pastrohen vazhdimisht, të mbrohen dhe të përtërihen, duke mbjellë gjithmonë masive të reja. Por shpeshherë këto rregulla nuk i respektojmë, prandaj, duke prerë shumë më tepër lëndë nga ç'mbjellim dhe nga ç'është kapaciteti prodhues i pyjeve, vihemi para vështirësish serioze. Po të ecet vazhdimisht kështu, vjen një ditë që të mos kesh ç'të presësh. Prandaj së keqes duhet t'i dalim me kohë përpara.

Industria e lëndës së drurit, e zhvilluar gjerësisht në rrethin tuaj, ka një rëndësi shumë të madhe për gjithë ekonominë e vendit tonë për plotësimin e nevojave nga më të ndryshmet të popullsisë. E kush nuk ka nevojë për lëndë druri? Veç kombinateve të drurit dhe zdrukthëtarive që e kanë bazën e tyre të vetme, lëndë druri kërkojnë minierat, hekurudhat, ndërtimet tona që shtohen nga dita në ditë, lëndë druri kërkon elektrifikimi, kërkon bujqësia; lëndë druri për t'u ngrohur e për të ndërtuar kërkon çdo familje.

E kam thënë edhe herë tjetër se lënda e drurit është si buka për industrinë dhe për nevojat e tjera të popullsisë. Por, ndërsa për prodhimin e bukës kujdesim çdo vit të plehërojmë tokën, të mbjellim farën, ta prashitim e ta ujitim bimën, për pyjet harrojmë se kemi detyra. Bile herë-herë, duke u nisur nga interesat e ngushtë, për të realizuar planin sa më shpejt, për të mos shkuar thellë e larg në pyll etj., presim dhe e dëmtojmë pyllin atje ku s'bën. Dhe vetë punëtorët e pyjeve ngandonjëherë, për pakujdesi apo për mungesë

ndërgjegjeje, presin atje ku s'duhet apo si nuk duhet.

Ju, motra e vëllezër pukjanë, jeni rritur tok me pyjet e në këto pyje dhe e dini shumë mirë sa të dobishme janë ato. Pyjet janë jo vetëm një pasuri e madhe, pasi japin lëndën e parë për të gjithë sektorët e ekonomisë apo dru për t'u ngrohur, por kanë një rëndësi të pallogaritshme edhe për klimën e për shëndetin e njerëzve, për ruajtjen e tokave nga gërryerjet që bëjnë ujërat e rrëmbyeshme në faqet e zhveshura, për zhvillimin e bimësisë në përgjithësi. Pyjet janë foleja e kafshëve dhe e shpendëve të egër, që jo vetëm i zbuturojnë ato, por janë edhe një pasuri e madhe, burim me rëndësi të ardhurash, prandaj t'i ruajmë, t'i zhvillojmë e t'i shtojmë me kujdes, duke u shërbyer si duhet e jo duke i vrrarë për t'i shfarosur, siç bëjnë shumë gjahtarë të ne. Prandaj shoqe dhe shokë, të gjithë, organet shtetërore dhe ekonomike, ju shokë punëtorë të sharrave, ju rojtarë të pyjeve, çdo fshatar e qytetar, t'i vlerësojmë si duhet pyjet, t'i duam dhe t'i ruajmë si sytë e ballit. Të mos kërkojmë që ato t'i mbrojnë vetëm rojtari i pyjeve, po rojtarë të pyjeve tona të bëhemi të gjithë, sepse këto janë një pasuri e pazëvendësueshme e gjithë popullit. Të ndërmarrim, pra, akcione të vazhdueshme për pastrimin e pyjeve, për luftimin e sëmundjeve në to, të mbjellim vazhdimisht fidanë të rinj<sup>1</sup>, t'i përtërijmë pyjet dhe në çdo mënyrë e me çdo mjet ta kursejmë lëndën e drurit, që në prerjen e në sharrimin e drurëve e deri në përpunimin e

---

1 Që nga viti 1970 deri më 1983 në rrethin e Pukës sipërfaqja e pyjeve është shtuar me 5 377 hektarë.

në përdorimin e tyre në industri apo në ndërtime. Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeveria kanë dhënë shumë porosi dhe kanë marrë vendime të posaçme për pyjet. Mua më kanë thënë, dhe këtu shokët e Partisë ma përsëritën, se janë marrë disa masa për ta përmirësuar gjendjen, por duhet bërë akoma më shumë, duhet kuptuar akoma më thellë rëndësia e këtij problemi për të tashmen e për të ardhmen, duhet luftuar më me vendosmëri kundër çdo pakujdesie, kundër çdo shpërdorimi të pyjeve dhe mungese kujdesi për to. Kam besim se punëtorët e fshatarët e rrethit të Pukës do t'i kuptojnë mirë detyrat në këtë drejtim dhe do të punojnë me këmbëngulje për realizimin e tyre.

Shoqe e shokë,

Kolektivizimi i plotë i bujqësisë këto vitet e fundit në krejt rrethin tuaj solli edhe këtu, në fshatrat e thella e malore të Pukës, erën e socializmit, forcën dhe vrullin e punës kolektive. Në këtë aksion të rëndësishëm për ngritjen e kooperativave bujqësore u shprehën edhe një herë patriotizmi, vendosmëria dhe vullneti i fshatarësisë punonjëse të rrethit tuaj për të ecur përpara me guxim në rrugën e Partisë. Partia ka bërë këtu një punë sqaruese plot durim për të bindur edhe ata pak fshatarë që, nën presionin e së vjetrës, të ideologjisë së pronës private, lëkundeshin e ngurronin të futeshin në kooperativë. Ajo u dha mundësi masave të fshatarësisë pukjane që, nga përvoja praktike e zoneve të kolektivizuara, të bindeshin për epërsitë e

rendit kooperativist dhe të shihnin se ai dhe vetëm ai është në gjendje ta nxjerrë fshatarësinë punonjëse nga skamja e nga prapambetja dhe ta vërë në rrugën e përparimit e të mirëqenies, si në fushë, edhe në malësi.

Që nga krijimi i kooperativave bujqësore te ju, koha është relativisht e shkurtër për mëkëmbjen si duhet të ekonomive kooperativiste, megjithatë sukseset në mjaft kooperativa janë të dukshme. Jo vetëm që shumë prej tyre siguruan vetë bukën, por në to janë futur edhe lloje të reja bimësh bujqësore, si gruri e patatja, janë rritur rendimentet në prodhimet blegtorale etj. Vetëm gjatë katër muajve të këtij viti u hapën mbi 300 hektarë toka të reja<sup>1</sup>.

Për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë ju duhet të bëni përpjekje që nga çdo lloj bime të merrni rendimente të larta, për arsye të kushteve të mira që keni krijuar vetë, duke vënë nën ujë pjesën më të madhe të tokës dhe duke praktikuar një agroteknikë të mirë, sidomos për sa i përket misrit. Eksperiencën që keni fituar në këtë drejtim, përpiquni ta thelloni më tej, por zhvillimi i harmonishëm i ekonomive kooperativiste kërkon që, krahas bujqësisë, të mos lini pas dore blegtorinë, sidomos kafshë të tilla, siç janë lopët, derrat dhe shpendët.

Për zgjidhjen e këtij problemi kaq të rëndësishëm dëshiroj t'ju them se është e domosdoshme të mendoni një çikë më thellë e më drejt për çështjen e dhisë. Mos kujtoni se kjo kafshë është e lidhur ngushtë dhe

---

<sup>1</sup> Gjatë viteve 1970-1983 në rrethin e Pukës janë hapur 2 527 hektarë toka të reja.

përgjithmonë me natyrën e vendit dhe mos shkoni me pikëpamjen se Puka nuk bën dot pa dhi edhe në kushtet e zhvillimit të sotëm të bujqësisë. Përkundrazi, do të jetohet më mirë duke zhvilluar kafshët që përmenda më sipër. Pastaj dhia bën dëme të mëdha, sidomos në një vend pyjor dhe me një të ardhme të bukur për sa u përket pyjeve dhe pemëtarisë, siç është rrethi juaj. Unë mendoj se, po të punoni më me kujdes për zhvillimin e një blegtorie më të përparuar, do të dilni me siguri në rrugën që ju tregon Partia, që dhia gradualisht të kufizohet me shtimin e llojeve të tjera të bagëtive që sigurojnë prodhime dhe të ardhura më të mëdha për kooperativën, për rrethin dhe për mbarë vendin.

Duke ndjekur përvojën e mirë të rrethit të Dibrës për organizimin e aksioneve me goditje të përqendruar, rrethi juaj ka arritur rezultate të mira edhe në hapjen e rrugëve automobilistike të mjaft zonave malore dhe përfundoi kanalën ujitës të Gojanit. Së shpejti do të mbarojë edhe elektrifikimi i krejt rrethit. Kjo është një fitore madhështore dhe do të jetë një festë e madhe për gjithë banorët e këtyre krahinave, sepse, së bashku me dritën elektrike, në jetën e përditshme të familjes do t'ju vijë kultura, do t'ju vijë radioja, do t'ju vijë edhe televizori. Shikoni sa gëzime njëherësh! Këto ndryshime kaq të mëdha e në një kohë kaq të shkurtër mund t'i bëjë vetëm një popull që udhëhiqet me besnikëri në rrugën e transformimeve të mëdha revolucionare, nga një parti marksiste-leniniste, siç është Partia jonë e Punës.

Por, shokë e shoqe, dëshiroj të tërheq vëmendjen



tuaj për t'u ruajtur nga vetëkënaqësia. Kur njeriu e krahason të kaluarën me të sotmen, vërtet i bëhet zemra mal dhe i duket se s'ka më mirë, por Partia na mëson të mos matemi me atë si kemi qenë, por me atë si duhet të jemi, si duhet të punohet e të jetohet në socializëm. E kur e shikojmë punën kështu, atëherë del se nuk duhet të kënaqemi me atë që kemi arritur, se kemi akoma shumë për të bërë që të punojmë e të jetojmë të gjithë, ashtu, siç thotë e siç dëshiron Partia dhe zemra e popullit.

Në kooperativat tuaja, me gjithë përparimet, ndahen akoma pak të ardhura për ditë-punë. Përse vjen kjo? Nuk ka mundësi që edhe në kooperativat malore të rrethit të Pukës të ndahen mbi 10 lekë për ditë-punë, pa llogaritur bukën? Eksperienca e përparuar si në rrethin tuaj, ashtu edhe në kooperativat e tjera malore të vendit, në kushte të përafërta me tuajat, e ka vërtetuar këtë më së miri. Atëherë ç'duhet bërë? Të punohet më mirë, të forcohet më shumë disiplina në punë, të shfrytëzohen si duhet tërë mundësitë që ekzistojnë, që nga hapja e tokave të reja, te zhvillimi i blegtorisë, e veçanërisht i lopës, e deri te mbledhja e bimëve mjekësore etj.

Vlera të konsiderueshme gjenden mbi sipërfaqen e këtyre maleve, pyjeve e kodrave. Këtu te ju rriten dhjetëra lloje bimësh mjekësore e industriale që lihen të venë dëm, të thahen e të kalben. Rrëshira e pishës, lulëbliri, shqemja e deri lulëkuqja apo kokrrat e dëllinjës janë burime të rëndësishme të ardhurash për çdo kooperativë, në rast se do të organizohet si duhet grumbullimi i tyre. Siç na thonë shokët e tregtisë, një

kuintal lulekamomili apo lulëkuqeje i eksportuar është baras me importimin e afro 15 quintalëve sheqer. Shikoni ç'vlerë të madhe kanë këto bimë! Por e keqja është se propaganda e Partisë, puna e organeve përkatese të tregtisë për njohjen e këtyre vlerave, si dhe organizimi i punës nga kooperativat bujqësore në këtë fushë, çalojnë, prandaj ne s'e realizojmë gjithnjë planin e grumbullimit të këtyre bimëve dhe disa nga kooperativat tuaja nuk sigurojnë të gjitha të ardhurat për të cilat ekzistojnë mundësitë. Në kooperativat tuaja me pak tokë, me parcela të vogla tokash në afërsi të shtëpive, ku mund të aktivizohen edhe plakat e pleqtë, nxënësit e shkollave e të tjerë, disa nga këto bimë të dobishme që specialistët i quajnë eteroleoze, si borziloku, menta, kamomili e deri te trëndafili i egër, mund e duhet të mbillen e pastaj të industrializohen, pasi s'kërkojnë ndonjë punë shumë të madhe. Nga të tilla bimë është e mundshme të sigurohen të ardhura të mëdha në sipërfaqe të vogla, prandaj ju duhet të merrni seriozisht edhe me këto punë dhe të krijoni kështu kushte për të rritur vlerën e ditës së punës në kooperativat tuaja të malësisë, duke e afruar me atë të kooperativave të fushës.

Një burim tjetër i rëndësishëm të ardhurash për kooperativat e rrethit tuaj është edhe pemëtaria. Por këtu ju jeni shumë prapa, ndërsa toka dhe klima janë shumë të përshtatshme për rritjen e pemëve frutore nga më të ndryshmet, si kumbulla, arra, qershii etj. Prandaj pemëtarinë, këtë degë të rëndësishme të ekonomisë bujqësore, duhet ta zhvilloni sa më shumë, jo vetëm për arsye të kushteve të përshtatshme që keni,

por pasi edhe vetë ju që keni lindur dhe jeni rritur këtu, mes pyjesh madhështore, ushqeni një dashuri të madhe si për drurët e tjerë, aq më tepër për pemët frutore. Jam i bindur se ju kanë munguar vetëm organizimi dhe marrja e masave efektive për krijimin e fidanishteve, por jo dëshira dhe vullneti. Zgjidhja e këtij problemi me frymë revolucionare do t'ju lejojë të zhvilloni sa më shpejt dhe në përpjesëtimet e duhura një sektor si ky, me rëndësi kaq të madhe për ekonominë. Ia filloni, pra, seriozisht kësaj pune<sup>1</sup> dhe jo duke mbjellë pemë frutore sidokudo, por në mënyrë të studiuar dhe nga llojet më të mira, u bëni atyre të gjitha shërbimet, në mënyrë që të siguronit fruta të bollshme si për veten tuaj, ashtu edhe për përpunimin e tyre.

Në Pukë industria dhe bujqësia janë fare pranë njëra-tjetrës, ndërmarrja shtetërore e kooperativa bujqësore shtrihen në të njëjtin truall, klasa punëtore jeton tok me fshatarësinë. Në këto kushte mund dhe duhet të mësohet shumë nga vrulli e nga fryma revolucionare e klasës punëtore, nga organizimi i punës në ndërmarrjet shtetërore. Punëtorët t'i kuptojnë më mirë rolin dhe detyrën e tyre në këtë drejtim, sepse ata janë forca udhëheqëse në aleancën e pathyeshme të klasës punëtore me fshatarësinë tonë kooperativiste.

Në rrethin tuaj, siç e përmenda, ka akoma kooperativa të dobëta, të cilat çalojnë më shumë, jo ngaqë s'kanë, por ngaqë s'dinë, pra u mungon eksperiencia.

---

<sup>1</sup> Pas vitit 1970 deri më 1983 në rrethin e Pukës janë mbjellë 399 mijë rrënjë drurë frutorë.

Por ka edhe të meta të tjera. Shpesh puna në fshat fillon me një e me dy orë vonesë, sepse mungojnë organizimi dhe shprehite e punës së përbashkët e të prodhimit modern. Nuk i dalin vallë detyra edhe klasës punëtore në këto kushte? Pa dyshim se po. Klasa punëtore nuk mund të qëndrojë aspak indiferente në këtë drejtim. Përkundrazi, ajo duhet të çojë në kooperative frymën e vet të mobilizimit e të organizimit, të futë atje disiplinën proletare në punë, të dërgojë kuadrot e saj më me eksperiencë dhe të ndihmojë konkretisht në organizimin socialist të punës. Kjo është jo vetëm e domosdoshme, por edhe krejtësisht e mundshme, aq më tepër po të marrim parasysh se në rrethin tuaj rrallë gjen ekonomi që të mos ketë pjesëtarë të familjeve punëtorë ose në marrëdhënie pune me shtetin. Çdo punëtor duhet të bëhet një aktivist i shquar për shpjegimin dhe për zbatimin e mësimëve e të vijës së Partisë në fshat, në radhë të parë në familjen e tij, për t'i bindur njerëzit për vlerën e madhe të kohës, duke u treguar kooperativistëve se ç'luftë bëhet në ndërmarrje për të fituar edhe minutën, pa lëre ç'do të thotë pastaj të humbasësh një ditë apo qoftë edhe një orë pune. Kësaj i thonë të forcosh me vepra aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë.

Klasa punëtore, e edukuar me vetitë e larta të moralit komunist, tregon një kujdes të madh për ruajtjen e pasurisë e të pronës socialiste, ajo lufton që çdo gjë të jetë e normuar dhe e studiuar me plan, sepse kështu shmangen humbjet e shpërdorimet. Ju, të dashur shokë e shoqe, keni dëgjuar shpesh, dhe në shtypin tonë është shkruar vazhdimisht, për shembuj të

lartë të vetëmohimit nga punëtorët tanë trima, deri edhe në sakrifikimin e jetës, për shpëtimin e pasurisë së popullit. Klasa punëtorë duhet të luftojë që këtë qëndrim me të vërtetë revolucionar ndaj pronës socialiste ta zbatojë edhe vetë akoma më mirë, por ajo e ka për detyrë të ndihmojë për ta futur edhe në fshatin kooperativist, ku vihen re akoma mjaft koncepte e qëndrime të gabuara, që e kanë burimin në psikologjinë e pronës private për ta konsideruar pronën kolektive jo si pronën e çdo kooperativisti, por si «mall të huaj», gjë që çon në dëmtimin e saj, në shpërdorime të ndryshme. Kështu forcohet ekonomia kooperativiste, forcohen shpirti i kolektivizmit e rendi socialist në fshat dhe, bashkë me ta, forcohet e çelikoset më tej aleanca e klasës punëtorë me fshatarësinë.

Roli i klasës punëtorë, motra dhe vëllezër pukjanë, duhet të ndihet jo vetëm në fushën e prodhimit, por edhe në problemet shoqërore, për të çrrënjosur nga ndërgjegjja e njerëzve tanë çdo mbeturinë të së kaluarës, për të luftuar kundër zakoneve prapanike dhe për të futur edhe në fshat, në çdo familje, mënyrën socialiste të jetesës.

Në rrethin e Pukës, ashtu si në të gjithë vendin tonë, është bërë e po bëhet një punë e kënaqshme për çrrënjosjen e koncepteve të huaja, të zakoneve prapanike e të besimeve fetare. Krahas luftës për të mposhtur të vjetrën, përpjekje të mira po bëhen për të afirmuar të reën përparimtare, socialiste. Kjo do të jetë një luftë e gjatë, e vështirë e delikate, sepse në këtë fushë rezistenca e botës së vjetër është veçanërisht këmbëngulëse dhe rrënjët e saj janë të thella. Por kjo

nuk mund të na dekurajojë e nuk mund të na largojë nga qëllimi ynë që edhe në këtë front jetik të sigurojmë fitoren e plotë të socializmit. Para së gjithash është e nevojshme të njohim mirë cilat janë këto mbeturina e zakone të këqija, që pastaj t'i luftojmë si duhet. Në këtë drejtim te ju është bërë një punë e mirë, sidomos duke e drejtuar goditjen kundër mbeturinave fisnore, fesë, kanunit e zakoneve të vjetra që ndeshen në krahinën tuaj dhe që janë në kundërshtim me rrugën tonë socialiste, me botëkuptimin tonë marksist-leninist.

Veçanërisht me këmbëngulje duhet luftuar kundër patriarkalizmit, bajraktarizmit e mbeturinave fisnore që janë pengesë për frymën e kolektivizmit dhe për organizimin socialist të punës, sepse nxitin ndjenjat e egoizmit, të ndarjes, të mospërfilljes, të manisë për emër e për derë të parë. Këto mbeturina nganjëherë ndikojnë, kjo edhe për mungesë pjekurie politike të kuadrove në disa kooperativa, deri aty sa që skuadrat e brigadat e punës të organizohen mbi bazën e mbeturinave fisnore dhe të familjeve të mëdha.

Patriarkalizmi i kundërvihet sidomos emancipimit të gruas, e cila në shekuj ka qenë e shtypur dhe e sunduar. Këtu në malet tuaja kanuni dhe ligjet e egra, me të cilat ishte pleksur edhe feja, ia kishin bërë jetën gruas edhe më të padurueshme. Ajo rrihej, shitej dhe vritej, s'kishte të drejtë të gëzonte, të thoshte fjalën e saj, bile as të qeshte në sy të burrave. Vetëm një «të drejtë» i kishin lënë asaj ligjet e vjetra e të mykura, të nënshtrohej tërë jetën, që kur lindte e derisa të vdiste. Por Partia i fshiu njëherë e përgjithmonë këto padrejtësi nga toka shqiptare, i fshiu edhe këtu

në Pukë. Gruaja pukjane është bërë sot një forcë e madhe në transformimin socialist dhe për përparimin e krahinës. Disa shifra që më treguan shokët drejtues të rrethit tuaj më gëzuan mjaft. Gratë zënë mbi 65 për qind të forcave të punës në fshat, 50 për qind të kuadrove të kooperativave bujqësore janë shoqe, në shëndetësi ato përbëjnë 71 për qind të krejt personelit, në artizanat 76 për qind, në arsim 41 për qind etj. Këto rezultate janë të mira, por s'duhet të na dehin, sepse në rrugën tonë për emancipimin e plotë të gruas kemi akoma shumë e shumë për të bërë.

Tani Partia luftën për të drejtat e për liritë e të rejave dhe të grave e ka ngritur në një shkallë më të lartë, duke e shtrirë deri në familje. Prandaj puna jonë duhet të jetë më e gjallë dhe më e kualifikuar, sepse pikërisht në familje ruhen më shumë patriarkalizmi, kanuni e zakonet e vjetra, të cilat i ka nxitur edhe feja, që e ndrydhin gruan apo të renë, nuk i njohin asaj të drejtën për të thënë fjalën e vet, ashtu siç e ka fituar në punë.

«Ligjet» e pashkruara, por të trashëguara brez pas brezi, që rregullonin marrëdhëniet brenda fisit e midis fiseve, në kushtet e ekzistencës së pronës së vogël private, të shfrytëzimit e të hasmërive, përse duhet të kenë fuqi edhe sot në kohën e socializmit, kur është zhdukur prona private dhe sundon kudo prona shoqërore? Sot s'janë bashkësia e fisit dhe aleancat midis fiseve që na mbrojnë e na ruajnë nga rreziqet dhe nga fatkeqësitë, por janë Partia jonë, shteti ynë, bashkimi ynë, uniteti luftarak i gjithë popullit, që përbëjnë garancinë e të gjitha fitoreve, bazën e përparimit dhe të lumturisë

sonë. Të gjitha teoritë për fiset dhe për bajraçet janë ndërtuar mbi baza reaksionare. Nuk duhet konfunduar uniteti familjar, i bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit e në ato humanitare, me fisin e me bajrakun të ndërtuar mbi bazën e fesë e të kanunit. Çdo kohë, çdo shoqëri ka ligjet e saj, rregullat e saj. Kalon koha dhe shoqëritë e vjetra përmbysen, prandaj krahas me to duhet të përmbysen edhe ligjet, rregullat dhe zakonet e tyre të këqija. Kjo po ngjet sot te ne edhe me kanunin, me ligjet fisnore dhe me fenë.

Nën ndikimin e zakoneve fisnore që i ka përkrahur edhe feja, vajza pengohet të shoqërohet me shokët e vet, asaj i hiqet drejta të zgjidhte lirisht shokun e jetës. Kaq rrënjë të thella kanë lëshuar te ne patriarkalizmi e mbeturinat fisnore, sa akoma edhe sot gjenden njerëz që përpiqen të pengojnë martesat midis të rinjve e të rejave brenda fshatit, duke i detyruar ata ta gjejnë shokun e jetës në vende shumë larg, bile edhe jashtë rrethit, pa e njohur fare njëri-tjetrin. Por sot, si kudo në vendin tonë, djemtë dhe vajzat pukjane jetojnë të lirë e të lumtur në atdheun e vet. Shumë prej tyre, sidomos tani, kanë mundësi të njihen e të miqësohen me vajza ose me djem jo vetëm të fshatit apo të rrethit, por edhe të rretheve të tjera, kur shkojnë në aksione, në shkolla të ndryshme të vendit etj., dhe, kur ndonjëri ose ndonjëra dashurohet, janë të lirë të martohen me atë që duan. Ka e do të ketë raste që martesat mund të bëhet edhe në një fshat ose rreth të largët dhe këtu s'ka gjë të keqe, por në asnjë mënyrë kjo të mos u imponohet të rinjve në bazë dhe për hir të traditave fisnore, të kanunit apo të zakoneve fetare.



Kanuni, feja dhe zakonet prapanike fisnore në disa krahina të vendit nuk e kanë pasë lejuar djalin apo vajzën të martohet brenda fshatit, duke e mbuluar këtë me arsyen pa bazë se janë gjoja të një gjaku. Ky jo vetëm është një koncept reaksionar, por nuk është i vërtetë as nga pikëpamja e shkencës biologjike. Që nga koha kur është vendosur kanuni kanë kaluar shumë breza, kështu që njerëzit e të njëjtit fshat sot ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri nga pikëpamja e gjakut. Përveç kësaj, gjatë kohës kur praktikohet ky zakon, gjaku llogaritet vetëm nga ana e burrit, ai nuk kihej parasysh edhe nga ana e gruas. Mirëpo në familje gjaku nuk mund të mos ndryshonte vazhdimisht pas çdo martese të brezave të rinj me ardhjen në familje të vajzave nga një tjetër fis ose bajrak. Pra, as nga ana biologjike nuk mund të mendohet që njerëzit e të njëjtit fshat, pas kaq brezash që kanë kaluar, të jenë përsëri të një gjaku. Kështu që edhe në këtë drejtim nuk ekziston asnjë rrezik.

Nga ana biologjike është e drejtë, ashtu sikundër e parashikon ligji ynë, që djali dhe vajza të mos martohen kur janë kushërinj të parë, po ata mund të krijojnë familje kur nuk kanë lidhje të afërta gjaku midis tyre. Kështu na mëson Partia ta kuptojmë edhe këtë çështje dhe Partia, që punon e lufton vetëm për të mirën e popullit, thotë gjithmonë të drejtën, të vërtetën, ajo kurdoherë i ka hapur atij sytë, e ka bërë luftëtar dhe e ka udhëhequr me sukses në luftë kundër botës së vjetër mizore të shtypjes, të varfërisë e të paditërisë, në të cilën e kanë mbajtur klasat shfrytë-

zuese dhe ideologjia fetare, në luftë për një jetë të lirë, të lumtur e të begatshme.

Tani dëshiroj të shtoj edhe diçka shkurt për fenë dhe për zakonet fetare. Mbarë populli ynë u ngrit në këmbë dhe i mbylli njëherë e përgjithmonë kishat, xhamitë dhe gjithë institucionet e tjera fetare, pasi me punën e madhe që ka bërë vazhdimisht Partia për edukimin e njerëzve tanë me botëkuptimin shkencor materialist, ai e kuptoi kotësinë e besimeve fetare që gjatë shekujve kanë ndrydhur hovin revolucionar të masave, i kanë këshilluar ato të jenë kurdoherë të bindura e të nënshtruara ndaj klasave sunduese, i kanë bërë të jenë të plogëta në punë dhe pesimiste në jetë.

Ndikimin e saj reaksionar feja e ka rrënjosur kudo. Midis shumë të këqijave ajo ka kultivuar në kokën e njerëzve tanë edhe një të keqe tjetër, atë të pabarazisë në familje, të pozitës së ulët të gruas dhe të pozitës sunduese të burrit si kryetar i familjes, fjala e të cilit aty ishte ligj. Feja, pra, është përpjekur të shuajë çdo shenjë të demokracisë deri edhe në familje, ajo ka përkrahur patriarkalizmin, pushtetin e burrit, gjurmët e kësaj pabarazie duken akoma edhe sot në vatrat tona. A është e drejtë kjo, dhe ku se? Aty ku jetojnë njerëzit më të dashur e më të afërt. Sigurisht që jo. Por, me gjithë punën e madhe që është bërë kundër fesë e zakoneve fetare, ne nuk mund të themi se ato u zhdukën krejtësisht nga shoqëria jonë. Megjithëse vazhdimisht vijnë duke u dobësuar, ato prapë ekzistojnë dhe janë si rrodhet që ngjiten pas trupit. Edhe disa zakone fetare që na duket sikur janë zhdukur, nxjerrin

përsëri kokën në forma të reja, ku hapur e ku fshehtas. Të mos e gënjejë mendja ndonjërin e të thotë se «te ne s'ka më fe», pasi ky mendim e vë njeriun në gjumë dhe në këtë mënyrë fesë i krijohen kushtet të gjallërohet dhe të bëjë punën e saj reaksionare e frenuese në shoqërinë tonë. Prandaj secili të tregohet i zgjuar e vigjilent dhe Partia ta udhëheqë vazhdimisht me këmbëngulje luftën kundër fesë dhe mbeturinave fetare në çdo formë që ato të paraqiten, që shoqëria socialiste dhe mirëqenia e popullit të ecin kështu përpara.

Disave nga më të moshuarit u duket sikur po shkulin diçka nga vetja në përpjekjet që bën mbarë shoqëria jonë për të hequr dorë nga këto zakone e doke. Dhe në të vërtetë ata shkulin diçka, por diçka të keqe, diçka të sëmurë që ua kanë futur në trup e në tru regjimet e vjetra që donin t'i mbanin tërë jetën të shtypur e të shfrytëzuar. Duke shkukur nga ndërgjegjja këto mbeturina të së kaluarës, besimet e kota e zakonet prapanike, njerëzit tanë çlirohen përfundimisht nga prangat e fundit të padukshme, por njëlloj të rënda e të dëmshme se ato që i mbanin skilevër të beut, të bajraktarit, të kapitalistit.

Prandaj t'i flakim në zjarrin e revolucionit gjithë këto mbeturina të patriarkalizmit, të konservatorizmit, të besimeve fetare, ta çlirojmë veten prej tyre, t'i hapim rrugë rinisë të marshojë gjithnjë përpara pa u ndalur, t'i sigurojmë gruas barazinë e plotë e të vërtetë, jo vetëm në punë e në shkollë, por dhe në shoqëri e në familje. Kështu forcohet atdheu, kështu lulëzon e përparon Shqipëria socialiste.

Duke mohuar e duke flakur tej të vjetrën, patriarkalizmin, kanunin, zakonet e egra fisnore, fenë e çdo mbeturinë tjetër reaksionare, ne duhet të bëjmë njëkohësisht një luftë të palodhur për të përkrahur të renë me përmbajtje të shëndoshë socialiste, për të përgjithësuar e për të përhapur shembullin pozitiv në të gjitha fushat e jetës, në festimin e festave kombëtare e lokale, në organizimin e dasmave e të fejesave socialiste, në organizimin e punës, në mënyrën e jetesës etj., që në çdo familje të ketë kurdoherë gëzim e hare. Flamurin e kësaj lufte ta mbajë rinia revolucionare e aksioneve, shoqet e shokët që janë përfshirë e do të përfshihen në lëvizjet për shkëmbimin e përvojës midis fshatarëve të Veriut e të Jugut, pjesëmarrësit e shkollave e të kurseve e të tjerë. Dhe këta luftëtarë të së resë nuk janë pak. Vetëm vitin e kaluar ky numër arriti në afro 2 500 veta në rrethin tuaj. Por për të renë përparimtare e revolucionare është e domosdoshme të ngrihen në këmbë të gjithë, të rinj e të reja, burra e gra, punëtorë e kooperativistë, i gjithë populli i krahinës suaj, sepse kështu do të çojmë në vend më shpejt fjalën e Partisë.

Të mëdha, shokë e shoqe, janë sukseset e rrethit tuaj, por edhe më të shkëlqyera do të jenë ato në të ardhmen. Ju vetë do të jeni dëshmitarë të rritjes e të zgjerimit të industrisë së drurit, të shtimit të mineralit të bakrit, të kaolinës, të mekanizimit të bujqësisë, të rritjes së rendimenteve në bujqësi e në blegtori. Në të ardhmen këtu në qytetin tuaj mund të fillojë ndërtimi i uzinës së përpunimit të asbestit. Dhe nuk do të jetë

e largët dita kur në mes të këtyre maleve, atje në Va të Fierzës, do të montohen kullat e larta të sondave të fuqishme, do të gjëmojnë minat e do të gumëzhijnë buldozerët e makinat e rënda të transportit për ndërtimin e hidrocentralit të ri. Makineri moderne e mjete të tjera të fuqishme që nuk janë parë ndonjëherë këtej nga ju, do të vërshojnë në këto vende kaq të bukura. Atëherë shumë bij e bija të maleve tuaja do të bashkohen me mijëra punonjës të tjerë që do të vijnë këtu nga të katër anët e Shqipërisë për të ndërtuar hidrocentralin e Fierzës, gjigantin e industrisë sonë elektrike, i cili do të jetë një nga më të mëdhenjtë në vendin tonë dhe në Evropë. Ai do të ketë një fuqi të instaluar prej rreth 400 mijë kilovatësh.

Këto janë vetëm një pjesë e atyre që do të ndërtohen e do të prodhohen në vendin tonë vitet e ardhshme. Me planin e ri pesëvjeçar që janë duke përgatitur Partia dhe Qeveria, në të katër anët e atdheut do të ngrihen fabrika e uzina të reja, do të ndërtohen rrugë e hekurudha, kanale e rezervuare të tjera, shkolla e shtëpi banimi etj. Popullit do t'i jepen më shumë mallra për përdorim të përditshëm dhe më shumë arsim e kulturë.

Në këta 29 vjet me Partinë, populli nga eksperiencia e tij ka formuar bindjen se çka thotë Partia e bën dhe se nga viti në vit ka gjithnjë përparime, jeta përmirësohet pa u ndalur. Këto shprehin qartë atë që Partia jonë i qëndron besnike popullit të saj që e ka lindur dhe e ka rritur, se për të s'ka interesa më të lartë se ata të popullit, se vija e saj është plotësisht e drejtë.

Të dashur vëllezër dhe motra pukjane,

Vendi ynë po jeton në një situatë revolucionare që është gjithmonë në ngritje. Klasa jonë punëtore, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia popullore, mbarë punonjësit tanë janë mobilizuar me të gjitha forcat për të realizuar para afatit planin e katërt pesëvjeçar. Shqipëria jonë e dashur nuk ka qenë asnjëherë në historinë e saj kaq e fuqishme, kaq me autoritet dhe e begatshme sa sot. Këtë forcë të pathyeshme Republika jonë Popullore e gjen tek udhëheqja e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë, te populli ynë trim e lirisdashës, virtytet e të cilit janë të skalitura edhe te populli i mrekullueshëm i maleve të Pukës. Prandaj të mos kursejmë asgjë për t'i vënë në jetë deri në fund mësimet dhe porositë e Partisë, që u përgjigjen interesave jetikë dhe aspiratave më të thella të popullit tonë.

Duke i pasur të qarta perspektivat e ndritura që kemi përpara, le të mobilizohemi, pra, me të gjitha forcat për të arritur fitore të reja edhe më të mëdha, për t'i kthyer edhe zonat malore, si këto tuajat, në vende të begatshme, që atdheu ynë socialist të lulëzojë në shekuj.

Rroftë sa malet Partia jonë heroike!

Rroftë populli patriot i Pukës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 131 (6795), 3 qershor 1970*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 131 (6795), 3 qershor 1970*

## POPULLI E VLERËSON LART KONTRIBUTIN E PUKJANËVE NË LUFTË E NË NDËRTIMIN SOCIALIST

*Fjala në drekën e shtruar me rastin e përfundimit  
të vizitave në rrethin e Pukës*

**2 qershor 1970**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Dëshiroj t'ju falënderoj edhe një herë nga zemra ju këtu dhe gjithë popullin heroik të rrethit të Pukës për këtë pritje kaq të nxehtë, për dashurinë e për besnikërinë e madhe që shprehni për Partinë tonë të lavdishme. Edhe Partia, Komiteti i saj Qendror dhe Qeveria kanë respekt e dashuri të thellë për ju pukjanët. Siç e thashë edhe në miting, kjo dashuri dhe ky respekt e kanë bazën, në radhë të parë, te pjesëmarrja juaj aktive në luftën e madhe të çlirimit, gjatë së cilës edhe ju, si gjithë populli shqiptar, dhatë dëshmorët tuaj, që lagën me gjakun e tyre të pastër këtë tokë të zhuritur për liri e për pavarësi, për të arritur në ditët e sotme kaq të lumtura e të gëzuara. E kanë bazën, gjithashtu, edhe në heroizmin e bijve tuaj që luftuan

më vonë, pas Çlirimit, tok me bijtë e tjerë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe të armës së Sigurimit të Shtetit, për të zhdukur bandat e shumta të diversantëve, të organizuara e të nxitura nga të huajt, të cilat silleshin këtej rrotull për të penguar forcimin e pushtetit tonë të ri popullor e për ta përmbysur atë. Por kontributi i popullit të rrethit tuaj nuk kufizohet vetëm gjatë luftës për çlirimin e atdheut dhe, më vonë, në përpjekjet e sakrificat e tij për mbrojtjen nga armiqtë dhe për forcimin e pushtetit popullor; ky kontribut është i madh edhe gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të socializmit.

Ju bijat dhe bijtë e Pukës përqaftat që në fillim me entuziazëm të madh direktivat e Partisë për ndërtimin socialist të atdheut dhe, si i gjithë populli shqiptar, u përpoqët për t'i zbatuar ato me sukses në jetë, prandaj janë arritur këto rezultate të mëdha, për të cilat fola në miting. Këtu dëshiroj të vë edhe një herë në dukje kontributin tuaj të madh në ndërtimin e Shqipërisë socialiste, punën e lavdërueshme dhe sakrificat e mëdha që keni bërë e po vazhdoni të bëni ju, burra edhe gra pukjane. Ju jeni njerëz të thjeshtë dhe as ju shkon ndër mend të mburreni, bile shumë nga ju as që mendojnë për atë kontribut të madh që keni dhënë në ndërtimin socialist të vendit, për të cilin kanë respekt mbarë populli i Shqipërisë, Qeveria, Partia, Komiteti ynë Qendror.

Kur çliruam atdheun dhe populli erdhi në fuqi, duhej ndërtuar medoemos ky vend atëherë i shkatërruar dhe i varfër në kulm. Në radhë të parë ndërtimi kërkonte kudo lëndë druri, e cila u shpërnda këtej nga Puka me një mijë mundime e sakrifica në të katër



anët e Shqipërisë. Ju nuk u keni bërë kurrë bisht thirrjeve të Partisë, po keni dalë kurdoherë në punë, edhe në kohë shumë të vështira për familjet tuaja, sidomos nga ana ekonomike. Të tërë e mbajmë mend se në vitet e para pas Çlirimit, si i gjithë vendi ynë, ishte e djegur, e përvëluar, e zhuritur edhe Puka, e cila në të kaluarën ishte jashtëzakonisht e varfër nga rrjepja e pamëshirshme dhe nga shfrytëzimi i egër që i kishin bërë armiqtë feudalë e bajraktarë, prandaj populli, të cilit s'i kishin lënë gjë në vatër, jetonte në mjerim të madh.

Edhe në ato kohë të vështira të fillimit Partia i hapi popullit perspektivat e së ardhmes dhe ju pukjanët, si gjithë shqiptarët, i kuptuat shpejt direktivat e saj të drejta. Ju kuptuat gjithashtu drejt se lënda e drurit ishte një nga faktorët që do të ndihmonte mbarë vendin tonë në rrugën e rindërtimit të shpejtë ekonomik. Dhe duke vënë interesin e Shqipërisë mbi të gjitha, filluat nga puna me ato pak mjete që kishit, për të transportuar lëndë, ca me kafshë, ca me ata kamionë të paktë apo me qerre, dhe kështu, pak nga pak e çdo vit e më shumë, lënda e drurit që prodhohej, shpërndahej këtej nga Puka juaj në gjithë truallin e Shqipërisë.

Puka ishte e mbetet edhe sot qendra kryesore e vendit tonë për përpunimin e lëndës së drurit. Nuk ka ndërtime në Shqipëri ku të mos ketë shkuar lënda e prodhuar këtu, që të mos kenë vulën dhe djersën e sharrëxhinjve e të druvarëve të Pukës. Me dërrasat tuaja janë ndërtuar fabrikat dhe shtëpitë e para, janë ndërtuar e po ndërtohen edhe sot veprat e reja indus-

triale, hekurudhat, hidrocentralet, shtëpitë e banimit kudo, në Tiranë, në Elbasan, në Gjirokastrë, nga të katër anët e atdheut, ku strehohen punëtorët dhe pjesëtarët e familjeve të tyre, të cilët, pas pune, mbledhen të gëzuar në apartamentet e reja, urojnë Partinë dhe pushtetin e tyre që u siguruan banesa komode, por, njëkohësisht, nuk harrojnë se shtëpitë ku jetojnë janë ndërtuar me lëndë të dërguar këtej, nga Puka.

Shokë gazetarë që keni ardhur me këtë rast këtu, unë kurrë s'ju jam lutur, por sot dëshiroj dhe ju lutem që këto fjalë të mia për pukjanët t'i shkruani në gazeta, që i gjithë populli të dijë ta vlerësojë lart këtë kontribut të madh të tyre. Duhet bërë i ditur në shtyp gjithë ai kontribut juaji në ndërtimin socialist të vendit, që shpreh njëkohësisht solidaritetin e madh, dashurinë vëllazërore që tregoni ju pukjanët për mbarë popullin, atë dashuri e solidaritet socialist që Partia na mëson të kemi për shoku-shokun, që ndihmon të rritet e të bëhet e pathyeshme forca e atdheut. Të jeni të bindur, motra dhe vëllezër, se ashtu sikurse ju këtu në Pukë, kur blini në dyqanet stofat e kombinatit të tekstileve «Stalin» të Tiranës ose ato të Kombinatit të Tekstileve të Beratit etj. uroni endëset që i kanë prodhuar dhe thoni: «U lumtë cucave që punojnë në ato kombinat, pse ato me punën e tyre po na sigurojnë neve veshjen që na mban ngrohtë», të njëjtat urime ju drejtojnë juve punonjësit e mbarë Shqipërisë kur u shkon lënda e drurit. Edhe ata thonë në këtë rast: «U lumtë pukjanëve e pukjaneve që po na dërgojnë lëndën e parë të ndërtimit!». Kështu, pra, punëtorët, kudo që janë, çimentojnë me punën e tyre të palodhur

solidaritetin midis njëri-tjetrit dhe unitetin e mbarë popullit rreth klasës punëtore e pararojës së saj, Partisë së Punës të Shqipërisë.

Kontributi juaj në ndërtimin e atdheut ka ngjallur dashurinë e madhe dhe respektin e gjithë punonjësve të Shqipërisë së re për Pukën, për këtë vend të heronjve të ndërtimit të socializmit. Prandaj, kur caktohen të vijmë për të punuar këtu kuadro të ndryshëm nga rrethet e tjera, si mjekë, mësues, inxhinierë, agronomë e të tjerë, këta duhet ta kenë për nder, dhe kur t'i pyesin ku janë caktuar me punë, të përgjigjen me plot gojën me gëzim dhe me entuziazëm e jo me gjysmë zëri, siç bëjnë disa, se po vijmë këtu t'i shërbejmë këtij populli kaq punëtor e trim dhe jo vetëm këtu në qytetin e vogël të Pukës, por të shkojmë deri në kooperativën më të largët të rrethit, ku të rrojnë, të punojnë, të lidhen ngushtë me masat e t'u shërbejnë si shërbëtorë të devotshëm të tyre dhe sado shumë që t'u duket se u shërbejnë, ta kenë mirë të qartë se përsëri nuk ua shpërblejnë dot. E them këtë sepse ka edhe nga ata njerëz që, megjithëse Partia i këshillon vazhdimisht, nuk i kuptojnë këto gjëra, po kërkojnë rehatinë, përpiqen të rrinë në të ngrohtë. Ne u themi këtyre, që për fat të mirë janë të paktë, se edhe pukjanët, edhe gratë e kalamanët e tyre, duan të rrojnë në të ngrohtë e pranë njëri-tjetrit, por ata janë të ndërgjegjshëm për detyrat ndaj atdheut e popullit, prandaj vënë këto mbi interesat e vet, prandaj burrat pukjanë vënë punojnë pa hezitim nëpër sharra, nëpër stabilimente, nëpër pyje, në shi e në borë, kurse në familje kthehen nga një herë në javë për t'u parë me gratë, me kalamanët

dhe me prindërit e tyre. Ne u themi të tillë njerëzve që në këtë vend ku punohet me kaq heroizëm, bëjnë sakrifica burrat edhe gratë, mbarë familjet e tyre. Në shembullin e pukjanëve duhet të jetë i gatshëm të bëjë sakrifica, kur e kërkon nevoja e popullit dhe e atdheut, çdo njeri në Shqipëri dhe të ketë respekt të madh për të gjithë ata që punojnë ndershëmrisht, që djersinë jo vetëm për vete, por, në radhë të parë, për interesin e gjithë vendit, siç bëni ju pukjanët, që, si shumica e punonjësve të ndërgjegjshëm të vendit tonë, punoni e luftoni jo vetëm për interesin tuaj, po për interesin e përgjithshëm, në radhë të parë. Këtë çështje kisha dëshirë ta theksoja edhe një herë para jush, njerëzve të thjeshtë të Pukës heroike, që dashurinë e besnikërinë ndaj atdheut e Partisë e keni treguar dhe po e tregoni vazhdimisht me prova konkrete, me punë të palodhur, pa pasur asnjë pretendim për t'u vënë në dukje kontributi juaj i madh.

Na mahniti dhe na dha forca të mëdha mitingu i sotshëm, gjatë të cilit ne pamë një entuziazëm e gjallëri të madhe, pamë pjekurinë, vendosmërinë e guximin e pukjanëve. Dhe në goftë se fola atje për disa mbeturina të së kaluarës që ekzistojnë, si kudo, edhe këtu te ju, këtë e bëra, motra dhe vëllezër, se ato duhen përmendur e duhen luftuar edhe në rrethin tuaj, po nuk janë karakteristika vetëm të pukjanëve, po edhe të tiranasve, të gjirokastritëve, të korçarëve etj. Ku më shumë e ku më pak mbeturinat ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve tanë, kundër të cilave duhet të luftojmë vazhdimisht të tërë çdo ditë që të spastrohemi dhe t'i zhdukim.

Si kudo në Shqipëri, edhe në Pukë ne shohim një kuptim të drejtë dhe një dëshirë e vendosmëri të madhe nga ana e punonjësve për zbatimin e direktivave të Partisë. Ju e kuptoni mirë se çështjet që ju këshillojnë Partia janë në interesin tuaj. Por ka edhe njerëz që ato nuk i kuptojnë përnjëherësh. Partia na këshilloi që me ta të mos zemërohemi, por, në radhë të parë, ne komunistët të bëjmë përpjekje që t'i kuptojnë dhe në këtë drejtim të punojmë me durim e të mos tërhiqemi përpara njerëzve të tillë. Tërheqja është si në dëm të interesit të përgjithshëm, ashtu edhe në dëm të vetë atyre personave që nuk i kuptojnë këshillat e Partisë. Prandaj, pa u zemëruar, pa u nevrikosur, të përpiqemi t'i bindim dhe të kemi besim se, në mos sot, nesër ata do të vijnë në rrugë të drejtë. E tillë ka qenë vazhdimisht politika e Partisë, e cila ka bindjen se mësimet e saj edhe për këto probleme do të kuptohen drejt nga të gjithë.

Vija e Partisë, gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së saj, ka qenë e drejtë. Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare ne kemi pasur të bënim edhe me elementë armiq, shumë nga të cilët na kishin vënë pushkën. Por pas Çlirimit thamë: «Ç'duhet të bëjmë me këta njerëz, t'u vëmë edhe ne pushkën?». Jo, mendoj Partia, të mos ua vëmë pushkën, se ne jemi fitimtarët, kurse ata janë të mundur. Patjetër se ndaj atyre që e kanë mbushur kupën, duhet të jemi të pamëshirshëm dhe ashtu vepruam. Kishte ca të tjerë që hodhën ndonjë fjalë kundër Partisë, por këtë s'e bënë me ndërjegje, se ishin të gënjyer. Atëherë ç'duhej bërë me ta? Partia këshilloi të punohej me durim për t'i ndrequr. Kështu

shumë prej tyre u korrigjuan, saqë sot e ndiejnë thellë ç'gabim të madh kanë bërë në të kaluarën, përse ia vunë vetes atë njollë. Dhe Partia u dha atyre mundësi ta lanin njollën. Megjithatë, shumë nga ata e ndiejnë në ndërgjegje se nuk duhet të kishin vepruar ashtu si bënë dhe thonë se, po të vijë prapë ndonjë rrezik si atëherë për atdheun, do ta tregojnë me prova këtë, për t'ia shpërblyer Partisë të mirën që u bëri.

Pra, deri edhe me këta njerëz Partia ka bërë një politikë të drejtë bindëse e jo më pastaj me njerëzit tanë, dhe puna e saj e vazhdueshme e me durim nuk është pa efekt. Ajo gradualisht ndihmon për formimin e botëkuptimit të saj të drejtë. Edhe konceptet e pleqve ndryshojnë kur punohet vazhdimisht e me durim me njerëzit.

Një plak, fjala vjen, mund të ketë një mendim jo të drejtë për cucën, po në vend që të futemi në luftë me të, le të përpiqemi ta bindim, t'i shpjegojmë që nuk e ka drejt qëndrimin që mban, pse cuca duhet të jetë e lirë, të vejë në punë dhe, kur të rritet, të vendosë vetë për të zgjedhur shokun e jetës, me të cilin do të martohet. Sigurisht, ajo duhet të marrë edhe mendimin e prindërve të vet, të cilët, po të jetë i mirë djali, ta urojnë të bijën të trashëgohet me atë që zgjodhi vetë.

Kur cuca është në pragun e moshës që mund të fillojë të dashurojë, prindërit duhet të kujdesen që ta përgatitin për jetën, ta këshillojnë të jetë punëtoare, se tani që u rrit mund edhe të dashurojë, prandaj burrin të përpiqet ta zgjedhë të ndershëm, punëtor, të thjeshtë e kokulur, të dojë popullin dhe t'i shërbejë mirë atij, të dojë Partinë, gjithashtu ta dojë djalin që do të zgjedhë, pastaj të tjerat janë çështje të saj. Prindi, po

të punojë kështu me kohë me fëmijët, të ketë besim se ata do t'i kenë në mendje këshillat që u jepen. Kështu që, kur djali ose vajza të gjejë shokun e vet, do të vijë me siguri t'i thotë se kush është, atëherë edhe prindi do të interesohet të pyesë nëse i ka cilësitë e duhura dhe, po të jetë ashtu, do ta urojë të trashëgohen dhe bashkërisht të përgatitin dasmën.

Mësimet e Partisë njerëzit duhet t'i zbatojnë në jetë, po për përvetësimin e tyre ata më parë duhen bindur, duhen sqaruar, duhen luftuar zakonet e vjetra të këqija që mund të kenë zënë rrënjë në ndërgjegje. Por populli ynë ka pasur e ka edhe shumë zakone të mira. Këto ne duhet t'i ruajmë si sytë e ballit. Një nga këto është ndershmeria. Partia e vlerëson lart këtë, prandaj i këshillon vazhdimisht gjithë njerëzit të jenë të ndershëm e të pastër moralisht.

Një tjetër zakon i mirë i popullit tonë është bujaria. Partia na mëson, gjithashtu, me qenë bujarë. Kjo do të thotë të vësh interesin e përgjithshëm mbi atë personal, të jesh zemërgjerë ndaj të tjerëve. Po të jesh i pajisur me këtë cilësi, do të thotë të jesh bujar, do të thotë të kesh zemrën të çelur. Mbi çdo gjë, më parë se interesi personal ose i familjes, duhet vënë interesi i të gjithëve. Kështu na mëson Partia dhe populli ynë e ka bërë të vetën këtë veti të lartë.

Një virtyt i çmuar i popullit shqiptar është edhe besnikëria. Besnikëria e popullit tonë është legjendare, veçse Partia na mëson të dallojmë mirë ndaj kujt duhet me qenë besnik. Besnik duhet me qenë ndaj popullit, ndaj atyre që sakrifikojnë për atdheun, për një çështje të drejtë, ndaj atij që hidhet në zjarr për interesat e

përgjithshëm, dhe në asnjë rast ndaj armikut, ndaj keqbërësve, ndaj atyre që dëmtojnë interesat e popullit. Për interesat e lartë të popullit askujt të mos i dhimset jeta, na mëson Partia. Ai që vë interesin personal mbi të përgjithshmin, nuk është njeri i mirë dhe në vendin tonë, ku udhëheq Partia, nuk ka për të bërë kurrë përpara. Kush mendon të ecë në rrugën e popullit dhe të Partisë, nuk duhet të veprojë kurrë në dëm të të tjerëve. Populli nuk e lejon një gjë të tillë. Njeriu i mirë kurrë nuk ia do të ligën tjetrit. Bajraktarët shtypnin masat, prandaj bajraktarë e popull ishin në luftë me njëri-tjetrin, kurse Parti e popull që luftojnë e punojnë në unitet për një qëllim të lartë, janë sot një e të pandarë.

Udhëtimi që bëmë këto ditë në Kukës, në Tropojë dhe këtu në Pukë na ka gëzuar pa masë. Kur të vemi në Tiranë, do t'u tregojmë shokëve të udhëheqjes të gjitha këto që pamë dhe me siguri të gjithë do të gëzohen. Edhe një herë, të dashur vëllezër, motra, shokë dhe shoqe të Pukës, dëshiroj t'ju falënderoj nga zemra për pritjen kaq të nxehtë që na bëtë nevc përfaqësuesve të Partisë këtu në rrethin tuaj.

Mbështetuni kurdoherë te Partia, se ajo është juaja. Hapjani zemrën asaj dhe Partia t'ia hapë kurdoherë zemrën popullit, asgjë të fshehtë të mos ketë nga populli. Anëtarëve të vet Partia u rekomandon të jenë kurdoherë të thjeshtë, punëtorë të palodhur dhe të sakrificës. Në qoftë se ata nuk ecin në këtë rrugë, i kritikoni, bile i kritikoni fort në qoftë se bëjnë gabime të përsëritura, kurse ata që nuk bëjnë përpjekje të ndreqen, s'ka pse të jenë në Parti.



Ju këtu në Pukë keni një organizatë partie të mirë, të shëndoshë, me komunistë besnikë, të gjallë, punëtorë të palodhur e të lidhur ngushtë me masat. Tani ajo po bëhet edhe më e fuqishme, pse në radhët e saj po futen edhe gra e vajza sokolesha. Nuk e them për t'ju bërë qejfin ju pukjanëve, komunistët nuk i bëjnë qejfin kot ndokujt, ata, siç i mëson Partia, ua thonë njerëzve hapur edhe të metat, edhe të mirat, por dëshiroj të vë në dukje se vajza e gra pukjane, e ndonjëra mund të jetë sot edhe këtu, kur ka qëlluar që i kanë penguar burrat, baballarët apo farefisi të futen në Parti, nuk janë tutur, kanë kapërcyer pengesat dhe i kanë bindur ata. Njerëz jemi, motra dhe vëllezër, bëjmë edhe gabime, puna është të përpiqemi t'i ndreqim dhe të edukohemi drejt.

Edhe në çështjen e martesave shumë cuca pukjane janë treguar gjithashtu të pjekura, kanë ecur në rrugë të drejtë, pavarësisht se ndonjëra është penguar nga prindërit ose nga njerëz të tjerë të afërt me mendime konservatore. E duan ato vajza prindin, edhe pse ai i pengon? S'ka dyshim që e duan, bile me gjithë shpirt. Por jeta duhet gëzuar, motra dhe vëllezër. Veç ajo nuk gëzohet duke e martuar babai vajzën me atë që mendon ai vetë. Jo, kjo s'është e drejtë, vajza të martohet me atë që do ajo. Kaluan kohët e para, tashti rinia s'i pranon më zakonet e vjetra që ndrydhnin e shtypnin lirinë dhe të drejtat e vajzave e të grave.

Ashtu si kudo, Partia po forcohet e po kalitet edhe këtu në Pukë. Në radhët e organizatës së Partisë të rrethit tuaj po hyjnë elementë nga brezi i ri, djem të gjallë dhe gra e vajza të reja sokolesha, kooperativiste

dhe punëtore. Këtu në rrethin tuaj ka një klasë punëtore të fortë. Ju e dini se Partia jonë është parti e klasës punëtore, e cila punon në frontet më të vështira. Por dihet se kush punon në vështirësi dhe qëndron i patundur, kalitet si çeliku në zjarr dhe nuk e thyen dot më pastaj asnjë pengesë. Në shembullin e kësaj klase punëtore të kalitur, që na udhëheq të gjithë, ecin komunistët. Prandaj kini besim të madh te Partia, e cila duhet t'i ketë letrat kurdoherë të hapura me popullin, si kudo në vendin tonë, edhe këtu në Pukë.

Duke përfunduar, ju ftoj, të dashur shokë e shoqe, ta ngremë këtë doli për lavdinë e Partisë sonë dhe për ju, për popullin trim të Pukës!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**FORCËN E LUMENJVE JU E VINI NË SHËRBIM  
TË ÇËSHTJES SË REVOLUCIONIT  
DHE TË SOCIALIZMIT**

*Fjala në mitingun e Vaut të Dejës*

**3 qershor 1970**

Të dashur shokë punëtorë e specialistë, ndërtues të Hidrocentralit të Vaut të Dejës,

Kur kam qenë këtu herën e parë, punimet e hidrocentralit ndodheshin akoma në fazën fillestare, por që atëherë dhe vazhdimisht kam ndjekur me vëmendje të madhe punën tuaj heroike, sukseset dhe fitoret tuaja. Sot që po i shoh me sy rezultatet e arritura, ndiej një gëzim të veçantë për gjithçka keni bërë ju me duart tuaja të arta.

Gjatë vizitës nëpër kantier dhe nga bisedat që bëra me punëtorë, me specialistë e me drejtues të punimeve, më doli qartë para syve puna juaj kolosale, lufta që keni bërë për të kapërcyer me kurajë e me vetëmohim një numër të madh vështirësish e pengesash, të pashmangshme në një ndërtim të tillë kaq të madh e kompleks. Partia dhe mbarë populli çmojnë

lart punën e palodhur, heroizmin dhe shpirtin e sakrificës që keni treguar dhe tregoni ju, shokë ndërtues të hidrocentralit, ndërgjegjen e lartë dhe vullnetin tuaj të paepur për të plotësuar me çdo kusht detyrën, iniciativën dhe frymën e novatorizmit në zgjidhjen e problemeve të shumta teknike dhe organizative.

Përfitoj nga ky rast që, në emër të Partisë e të Qeverisë, t'ju përgëzoj për punën tuaj vetëmohuese në ndërtimin e kësaj vepre të madhe të socializmit dhe t'ju uroj nga zemra suksese të mëtejshme.

Hidrocentrali i Vaut të Dejës është vepra më e madhe e ndërtimit në këtë pesëvjeçar. Këtu do të bëhen gjithsej mbi 5 milionë metra kub gërmime, mbi 6 milionë metra kub mbushje, 600 mijë metra kub betonime; u krye devijimi i lumit Drin në tunel me ndihmën e një dige 41 metra të lartë, si dhe një varg punimesh të tjera, të lidhura të gjitha këto me zgjidhjen origjinale të shumë problemeve të vështira inxhiniero-teknike, ekonomike e organizative. Por ju shokë punëtorë e specialistë po ua dilni mbanë të gjitha detyrave. Ju lumtë! Këtu në punimet e hidrocentralit po përdoret një sasi e madhe mjetesh teknike. Kjo është vepra që po ndërtojmë me përdorimin e mekanizimit në shkallë të lartë. Dhe klasa jonë punëtoje jo vetëm ka përvetësuar mënyrën e përdorimit të këtyre mekanizmave të shumtë, shpesh të komplikuar, por po i shfrytëzon ata me rendiment gjithnjë e më të lartë.

Hidrocentrali mbi lumin Drin nuk është vetëm një vepër e madhe ndërtimi, ai është kthyer edhe në një shkollë masive edukimi, ku klasa jonë punëtoje përsos artin e ndërtimit socialist, ngre nivelin e saj ideo-

politik, arsimor, kulturor e tekniko-profesional, forcon ndërgjegjen socialiste, mëson të marrë pjesë gjithnjë e më efektivisht në drejtimin e ekonomisë, të punëve të shtetit e të tërë jetës së vendit. Mësova se shumë prej jush ndjekin këtu filialin e universitetit dhe shkollën e mesme profesionale pa shkëputje nga puna për degët e ndërtimit, mekanike e elektrike, si dhe një numër të madh kursesh pa shkëputje nga puna për përgatitjen e specialistëve të rinj dhe për kualifikimin e të tjerëve. Kjo është një punë shumë e dobishme, sepse, duke kombinuar punën dhe mësimin, lulëzojnë talente të panumërta dhe kaliten qindra e qindra drejtues e kuadro punëtorë për të gjitha fushat e ndërtimit socialist, të cilët luajnë një rol të madh jetik në revolucionarizimin e tërë jetës sonë shoqërore. Mendoni se ç'rëndësi të madhe ka kjo për ngritjen e rolit të klasës punëtore, për ndërtimet e ardhshme që na presin, sidomos për zhvillimin e rrethëve të tilla, si Shkodra, Puka, Kukësi e Tropoja, që përgatitin në këtë shkollë të madhe revolucionare bijtë dhe bijat e tyre, të cilët nesër do t'u kthehen kuadro me përvojë.

Shokë,

Nga ky ndërtim gjigant të gjithë na pushton një ndjenjë e ligjshme krenarie për ndryshimet e thella që ka pësuar atdheu ynë dhe për fitoret madhështore që ka arritur në vitet e pushtetit popullor, duke ecur në rrugën e socializmit. Për këto ndryshime e fitore është në gjendje të gjykojë qartë jo vetëm brezi i vjetër,

i cili ka jetuar periudhën e errët të regjimeve antipopullore, të shfrytëzimit e të paditurisë, por edhe brezat më të rinj, që kanë parë me sytë e tyre vështirësitë e mëdha që ka kaluar vendi ynë në vitet e para pas Çlirimit. Mendoni për një çast, shokë, a mundej, qoftë edhe vetëm të ëndërrohej, në Shqipërinë e vjetër një ndërtim i tillë kaq i madh e kompleks? A mund të merrej me mend në atë kohë, kur vetëm në disa qytete kryesore kishte ndonjë central të vogël që mezi mjaftonte për ndriçim, se në Shqipërinë tonë do të ndërtoheshin hidrocentrale të fuqishme si ky i Vaut të Dejës, i cili do të prodhojë çdo vit 1 miliard kilovat-orë energji elektrike? Një njeri që do të fliste për një gjë të tillë atëherë, do ta quanin me siguri të çmendur.

Sot ky është një realitet i gjallë, që tregon se Partia jonë po vë në jetë një aspiratë të madhe — elektrifikimin e ekonomisë dhe të të gjithë vendit. Ju e dini se pas Hidrocentralit të madh në Vaun e Dejës, të tjerë gjigantë të sistemit tonë energjetik, si ai i Fierzës, krahas një rrjeti të gjerë hidrocentralesh të mesëm, do t'u presin vrullin lumenjve tanë të rrëmbyer, për ta vënë forcën e tyre në shërbim të çështjes së madhe të revolucionit e të socializmit.

Partia jonë, duke e orientuar dhe duke e udhëhequr popullin në rrugën e ndërtimit të socializmit, ka ndjekur dhe do të ndjekë edhe në të ardhmen me konsekuencë politikën e elektrifikimit të ekonomisë e të krejt vendit. Në këtë çështje ajo ka kurdoherë parasysh mësimet e Leninit të madh se komunizmi është pushteti i këshillave plus elektrifikimi i tërë vendit. Që të kapërcejë plotësisht prapambetjen shekullore

të trashëguar nga e kaluara, të ndërtojë bazën e plotë materialo-teknike të socializmit, të forcojë pavarësinë ekonomike dhe të bëhet çdo ditë më i aftë të ecë me këmbët e veta, vendi ynë ka nevojë për një industri të madhe moderne, për një bujqësi intensive, për një bazë të fuqishme ndërtimesh dhe për transport të zhvilluar. Nga kjo varen, gjithashtu, rritja e mirëqenies së popullit tonë dhe forcimi i mbrojtjes së atdheut. Por të gjitha këto nuk janë të mundura pa një bazë të shëndoshë energjetike. Dhe këtë bazë, veçanërisht në kushtet e vendit tonë, mund ta sigurojë vetëm elektrifikimi i ekonomisë.

Krahas faktorëve të tjerë, elektrifikimi është një nga më kryesorët për t'i dhënë një impuls të fuqishëm e të pandërprerë zhvillimit të forcave prodhuese dhe marrëdhënieve në prodhim. Nga ai varen shfrytëzimi i kapaciteteve dhe i rezervave kolosale që fshihen në të gjitha fushat e ekonomisë, zhvillimi e përsosja e prodhimit të mjeteve të prodhimit, sigurimi i riprodhimit të zgjeruar socialist, rritja e mjeteve të konsumit. Me kanizimet, automatizimi, rritja e rendimenteve, përmirësimi i cilësisë, shtimi i asortimenteve, ulja e kostos etj., me një fjalë revolucionarizimi i prodhimit në përpjesëtimet që parashikon Partia, për të tanishmen dhe për perspektivën, nuk mund të merren me mend dhe nuk mund të realizohen pa futur gradualisht dhe progresivisht kudo energjinë elektrike. Të gjitha këto kanë të bëjnë me forcimin e bazës ekonomike, të strukturës së rendit tonë socialist, e cila përcakton zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë sonë në tërësi.

Por rëndësia e elektrifikimit nuk kufizohet vetëm

me këtë. Ai ushtron ndikim të madh e veprim të drejt-përdrejtë edhe në zhvillimin e tërë superstrukturës sonë socialiste, ka në mënyrë të pashmangshme pasoja të thella në mendimet e njerëzve, në zhvillimin e shkencave, të kulturës, të arsimit, të institucioneve të ndryshme dhe të gjithë jetës shoqërore. Shikoni, për shembull, ç'po ndodh që tani në fshatin tonë, ku drita elektrike po futet gjer në skajet më të thella të malësive, ku shtëpitë kanë qenë nxirë në shekuj nga tymi i pishës dhe nga errësira e padijes. Njerëzit janë kudo më të qeshur e më të gëzuar, punojnë në ekonominë e përbashkët akoma më me qejf, ngaqë, pas punës, kanë mundësi të çlodhen në mënyrë më aktive e të kulturuar. Drita elektrike në çdo familje fshatare është një gjë e madhe. Shumë shtete në botë, të ashtuquajtura të zhvilluara, nuk e kanë arritur një gjë të tillë. Prandaj fshatari ynë mendohet thellë dhe u është mirënjohës Partisë, pushtetit popullor, klasës punëtore, që ia sollën në vatër këtë të mirë, krahas të gjitha të mirave të tjera, të cilat tani i çmon edhe më shumë e nga të cilat sheh më qartë detyrat e tij ndaj shoqërisë. Energjia elektrike krijoi kushte që në shtëpitë fshatare të futet radioja, pra të vijnë më shpejt fjala e Partisë, edukata politike, kulturore, arsimit, arti, muzika, dituria. Ajo i jep akoma më shumë mundësi fshatarit, sidomos rinisë, të frekuentojë shtëpinë apo vatrën e kulturës, të marrë pjesë më gjallërisht në aktivitetet e saj, të njihet në çdo kohë me librin, me shtypin etj. Këto, krahas gjithë punës tjetër të Partisë dhe të levave të saj, nuk mund të mos ndikojnë në psikologjinë e fshatarit edhe për sa u përket marrëdhënies famil-



jare, zhdukjes së koncepteve konservatore e patriarkale, paragjykimeve fetare e zakoneve prapanike, përmirësimin të mënyrës së jetesës etj.

Elektrifikimi i fshatrave është, pra, një hap shumë i rëndësishëm dhe efektiv për përparimin e gjithë anshëm të fshatit tonë socialist, për ngushtimin gradual të dallimeve esenciale midis fshatit e qytetit, gjë që e kërkon në mënyrë të domosdoshme ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste e, më pas, i asaj komuniste. Tani në të katër anët e Shqipërisë po zihen aksioni i madh revolucionar për të përfunduar plotësisht elektrifikimin e fshatit. Vendimi i guximshëm i Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror për ta përfunduar elektrifikimin e të gjitha fshatrave gjer më 8 nëntor 1971, për nder të 30-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme, pra 14 vjet para afatit që parashikohej në planet e mëparshme, jo vetëm po realizohet me sukses të plotë, por ekzistojnë të gjitha mundësitë që të vihet plotësisht në jetë akoma më parë. Me realizimin e kësaj detyre madhështore, vendi ynë, i cili vetëm tri dekada më parë ishte vendi më i prapambetur në Evropë, bëhet një ndër vendet e para në botë me të gjitha fshatrat të elektrifikuara. Kjo është një fitore e madhe, e cila dëshmon se Partia jonë nuk i lëshon fjalët në erë, se populli ynë, me fjalën e Partisë, është i gatshëm e i aftë të bëjë çudi, se ndërtimi socialist në atdheun tonë, edhe pse në kushtet e rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste, ecën përpara në mënyrë të shkëlqyer.

Të gjitha këto tregojnë se ju shokë, që punoni

e luftoni në fushën e elektrifikimit të vendit, bëni një punë shumë të vlefshme, me rëndësi të madhe jetike për çështjen e ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë.

Shokë,

Imperialistët, me ata amerikanë në krye, dhe bashkëpunëtorët e tyre, renegatët revizionistë sovjetikë, nuk duan të pajtohen me disfatat që kanë pësuar. Ata vazhdojnë të kurdisin plane e komplete kundër popujve. Ka kohë që imperializmi amerikan po përpiqet me zjarr e me hekur ta nënshtrojë popullin heroik të Vietnamit, të shuajë flakët e luftës së tij për liri, të bëhet atje zot vendi. Por megjithëse ka vite të tëra që po lufton, duke derdhur në fushën e betejës ushtarë, mjete, armë e municion pa numërim, sharra i ka ngecur në gozhdë përballë qëndresës së pamposhtur, luftës së madhe çlirimtare të popullit heroik vietnamez. Imperializmi amerikan dhe gjithë shërbëtorët e tij morën në Vietnam një mësim të mirë. Nuk është madhësia e një shteti që përbën forcën e tij, nuk janë numri i ushtarëve dhe sasia e cilësia e mjeteve dhe e armatimeve që vendosin fatin e luftës, por është çështja për të cilën luftohet, është ndërgjegjja e atyre që luftojnë që vendos, në fund të fundit, për të.

Të trullosur nga disfatat e njëpasnjëshme që pësuan në Vietnam, imperialistët amerikanë u sulën si bisha të tërbuara dhe mbi Kamboxhian, duke organi-

zuar grushtin e shtetit të klikës reaksionare të Lon Nolit dhe agresionin e hapët kundër këtij vendi. Kjo i ngjet historisë që tregojnë për të mbyturin, i cili kërkonte të shpëtonte duke u kapur pas flokëve të vet. Duke luftuar vetëm me popullin vietnamez dhe e pati shumë pisk imperializmi amerikan. A nuk është e qartë se, duke ngritur kundër vetes edhe popullin kamboxhian, gjithë popujt e Indokinës, ai do ta ketë akoma më vështirë? Është fakt tashmë se këto veprime të imperializmit amerikan e ndezën të fuqishme luftën e popullit kamboxhian, të udhëhequr nga Fronti i Bashkuar Kombëtar; këto veprime agresive kanë ngritur në një shkallë edhe më të lartë luftën çlirimtare të tre popujve të Indokinës, gjë që bën më të shpejtë e më të sigurt disfatën e turpshme të imperializmit amerikan. Populli shqiptar dhe Qeveria e tij përkrahin me të gjitha forcat luftën e drejtë të popujve të Indokinës dhe shprehin bindjen e plotë se me luftën e tyre të vendosur ata do t'i mposhtin me siguri armiqtë dhe do të korrrin fitore.

Është e qartë se me luftën e vet në Vietnam, me zgjerimin e agresionit në Kamboxhia etj., imperializmi amerikan synon jo vetëm të mbytë luftën çlirimtare të popujve të tjerë liridashës të asaj zone, por edhe ta kthejë tërë Gadishullin Indokinez në një bazë lufte e agresioni kundër popujve. Por të gjitha planet kundër-revolucionare të imperialistëve amerikanë, të klikës renegate imperialiste sovjetike dhe të veglave të tyre janë të destinuara të pësojnë disfatë të plotë. Ato do të dështojnë përballë vigjilencës dhe luftës së paepur të të gjithë popujve revolucionarë të botës.

Shokë dhe shoqe,

Ndërtimi i Hidrocentralit të Vaut të Dejës është vepër e shquar e klasës sonë punëtore të lavdishme. Ju, shokë punëtorë, specialistë e kuadro, që punoni në këtë kantier të madh, keni grumbulluar një eksperiencë të gjithanshme, e cila është mjaft e dobishme. Përgjithësimi dhe përhapja e eksperiencës së përparuar të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë, të gjithë punonjësve, është me rëndësi shumë të madhe, po të kemi parasysh detyrat e mëdha e të ndërlikuara që qëndrojnë para nesh. Kjo eksperiencë përbën një ndër rezervat më të pasura të ndërtimit tonë socialist.

Tani punimet në hidrocentral kanë hyrë në një fazë mjaft të rëndësishme e delikate, gjë që kërkon pa dyshim një mobilizim akoma më të madh të të gjitha aftësive tuaja fizike e mendore. Partia ka besim, dhe unë jam i bindur, se ju do të ngrini akoma më lart frymën revolucionare, do ta kryeni punën me cilësi të lartë, ashtu siç e kërkojnë normat teknike në një vepër si kjo, se do t'i organizoni akoma më mirë emulacionin socialist dhe luftën për realizimin në kohë të të gjitha detyrave. Vazhdoni, shokë punëtorë, ashtu si deri tani, bile akoma më mirë, të punoni e të mësoni, të ngrini nivelin tuaj ideologjik e politik, teknik e profesional, sepse kjo është rruga që na mëson Partia, nëpërmjet së cilës klasa punëtore kalit cilësitë e saj revolucionare dhe bëhet çdo ditë më e aftë e më e denjë për të kryer me nder misionin e vet historik, si forca udhëheqëse e shoqërisë sonë socialiste.

Partia ka bindjen e patundur se zotimin e madh që keni marrë për të vënë në shfrytëzim hidrocentralin në vitin 1971, ju shokë punëtorë e specialistë do ta plotësoni me nder.

Ju e dini, të dashur shokë, se tani mbarë populli ynë ka mobilizuar të gjitha energjitë për të realizuar e për të tejkaluar detyrat e planit të vitit 1970 e të krejt pesëvjeçarit të katërt. Kudo sundon një atmosferë mobilizimi, pune krijuese, optimizmi e vrulli revolucionar. Aksionet masive me goditje të përqendruar, që ngjallin një frymë të lartë emulacioni socialist, që thyejnë me guxim normat, konceptet, shprehitë dhe zakonet e vjetra në prodhim e në jetën shoqërore, që futin elemente të një organizimi më racional e më të përsosur në punë, po përhapen kudo dhe po bëhen pjesë e pandarë e metodës së punës të njerëzve tanë dhe të organeve drejtuese.

Shumë kolektiva punonjës qysh tani kanë përfunduar me sukses detyrat e planit të katërt pesëvjeçar. Ekzistojnë të gjitha kushtet e mundësitë që këtë plan ta përfundojmë para afatit. Kjo do të jetë me të vërtetë një fitore e madhe.

Por revolucioni socialist kurrë nuk qëndron në vend dhe nuk kënaqet me atë që është arritur. Duke varrosur të kaluarën dhe duke ndërtuar të tanishmen, ai shikon kurdoherë përpara, përgatitet për të ardhmen. Ajo që gjer dje ishte një synim dhe që sot është një sukses, fillon të na duket e pamjaftueshme përballë detyrave e horizonteve të reja që hapen para nesh. Për frymën e gjallë të socializmit është e huaj çdo gjë e ngurosur dhe konservatore. Kjo ka të bëjë edhe me

planet tona ekonomike, të cilat nga viti në vit dhe nga pesëvjeçari në pesëvjeçar bëhen më madhështore, edhe me problemet e jetës ideopolitike e shoqërore, edhe me format e organizimit dhe me metodat tona të punës.

Sukseset e mëdha që ka arritur vendi ynë gjatë viteve të planit të katërt pesëvjeçar kanë krijuar mundësi akoma më të mëdha, kanë hapur horizonte të reja akoma më të gjera, kanë përcaktuar objektiva të rinj, të cilët duhet t'i arrijmë me përpjekje e me punë akoma më intensive.

Në mënyrë të veçantë detyrat e reja të zhvillimit tonë në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste kërkojnë forcimin e mëtejshëm të rolit udhëheqës dhe të kontrollit të klasës sonë punëtore e të pararojës së saj, Partisë së Punës, në tërë jetën e vendit. Kjo është e domosdoshme për të zgjidhur jo vetëm problemet dhe detyrat e mëdha në fushën e zhvillimit të prodhimit, por edhe detyrat themelore të etapës së tanishme të zhvillimit të revolucionit tonë socialist, kur rëndësi vendimtare merr lufta për çrrënjosjen e shumë mbeturinave të shoqërisë së vjetër, për të ruajtur rendin tonë socialist, diktaturën e proletariatit nga rreziku i degjenerimit borgjez e revizionist, për të përsosur më tej bazën e superstrukturës socialiste, për edukimin komunist të punonjësve.

Prandaj, krejt në të kundërtën e rrugës që ndjekin renegatët revizionistë sovjetikë dhe të tjerë, të cilët përpiqen ta shndërrojnë klasën punëtore të vendeve të tyre në një forcë thjesht prodhuese, Partia e bën klasën tonë punëtore të vetëdijshme për rolin para-

rojë që i përket në socializëm, e mëson dhe e ndihmon të marrë pjesë sa më aktivisht në drejtimin e ekonomisë dhe në tërë veprimtarinë shtetërore e shoqërore, të ushtrojë në çdo qelizë të jetës sonë kontrollin proletar të drejtpërdrejtë. Në këtë qëndron një garanci vendimtare se në vendin tonë nuk do të lëshojë kurrë rrënjë bari helmues i revizionizmit, se flamuri i kuq i revolucionit në atdheun tonë nuk do të përkulet asnjëherë, por do të marshojë i sigurt përpara, drejt majave të reja të socializmit e të komunizmit.

Partia ka bindjen e patundur se edhe në të ardhmen klasa jonë punëtore e lavdishme do të jetë plotësisht e denjë për misionin e saj të lartë historik në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në atdheun tonë.

Duke përfunduar, shokë ndërtues të Hidrocentralit të madh të Vaut të Dejës, ju uroj edhe një herë suksese të mëtejshme në punën tuaj të çmuar për t'u dhënë sa më parë atdheut, popullit, ekonomisë sonë socialiste energjinë e transformuar të Drinit plak.

Lavdi klasës punëtore heroike të vendit tonë dhe pararojës së saj revolucionare, Partisë sonë të lavdishme të Punës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 132 (6796), 4 qershor 1970*

*Botohet, me disa shkurtime, sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 132 (6796), 4 qershor 1970*

## PËR MATERIALE NDËRTIMI KEMI NEVOJA TË MËDHA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

15 qershor 1970

Ky studim është i mirë. Ai mund dhe duhet të na shërbejë për të ardhmen. Ministria e Ndërtimit ka bërë dhe po bën shumë gjëra në këtë drejtim, eksperimenton e bën kërkime të gjithanshme. Këtë punë ajo e ka për detyrë ta organizojë, bile në një shkallë akoma më të gjerë, për zgjidhjen e shumë problemeve të mëdha të ndërtimeve që do të bëhen sidomos gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, sepse kërkesat për material ndërtimi do të jenë shumë të mëdha dhe të shumëllojshme.

Studimi dhe mendimet që u shfaqën këtu, mendoj

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së material ndërtimit (pa drurin) si nga sektori shtetëror, dhe nga ai kooperativist».



se duhet të na shërbejnë si orientime, por asgjë, më duket mua, nuk duhet të jetë definitive. Problemet të diskutohen edhe më gjerësisht gjatë hartimit të planit pesëvjeçar dhe atëherë të vendoset më mirë për to.

Këtu u numëruan plot mundësi që kemi për shumëllojshmërinë dhe për rritjen e prodhimit të lëndëve të para për ndërtim. Por të mos ngelemi te fjala «mundet»! Ç'janë këto «mundet» që na thuhet këtu? Këto nuk janë shpjegime, më duket mua, dhe unë nuk jam dakord me këtë, se me «mundet» gjërat mbeten fakultative, problemet nuk marrin rrugën që dëshirojmë, nuk zgjidhen. Në qoftë se shqyrtojmë në Byronë Politike një studim, për të cilin do të marrim një vendim ose do të japim udhëzime, atëherë s'bën të flasim me «mundet». Po që se këto gjëra nuk janë të studiuara mirë, ne nuk kemi mundësi të vendosim. Këtu na thuhet se në studimin e mëparshëm parashikohej që në ndërtesat e banimit, shoqërore dhe industriale, 60 për qind e strukturave vertikale e betonarme të ishin të parapërgatitura e 40 për qind monolite, kurse tani na është paraqitur e kundërta. Këto duhen parë më me seriozitet, sepse kemi të bëjmë me çështje të mëdha. Asnjëri nuk dyshon për mundësitë e shumta që ekzistojnë, por derisa të vijë puna që të aprovojmë planin definitivisht, ato duhet të diskutohen e të sheshohen me specialistët dhe me punëtorët, të bëhen eksperimente e të vërtetohen dhe pastaj, pasi të krijohet bindja, të vendosim.

Për këto që u thanë këtu, si, për shembull, për traversat prej betoni që prodhon Shkodra, ose për

shumë mendime e propozime të tjera, ju<sup>1</sup> mos prisni të merrni nga ne aprovimin teknik, së ne nuk jemi specialistë për këto punë. Prandaj për vendimet lidhur me këto çështje jeni ju plotësisht përgjegjës.

Brenda mundësive materiale që ka vendi ynë, duke u bazuar në të dhënat e teknikës bashkëkohore, ne do t'i përdorim lëndët e ndërtimit duke pasur parasysh vetë objektet. Për ato me karakter të përherëshëm e që duhet të durojnë sa më gjatë, do të përdorim lëndë ndërtimi të forta, ndërsa për objekte provizore e që do të na duhen për pak kohë, do të përdorim lëndë më të dobëta. Domethënë, sipas llojit të objektit do të përdoren edhe materialet e ndërtimit. Përse të përdoret çimento e markave të larta në të gjitha ndërtimet?! Kjo nuk është e drejtë. E them këtë se edhe çimentoja e markave të ulëta duhet përdorur. Përse kërkojmë të bëjmë gjëra me kosto të lartë, kur mund të ekonomizojmë qindra mijë tonë çimento të markave të larta? A ju ka shkuar në mendje një gjë e tillë?

Lloji i materialeve të ndërtimit që do të përdoren varet edhe nga disa faktorë të tjerë, si nga kostoja e tyre dhe nga mundësitë tona materiale, të cilat duhet të harmonizohen. Dëshirat mund të jenë të mëdha, por mundësitë që kemi mund të mos lejojnë që t'i plotësojmë të gjitha sot. Dëshira kemi pasur edhe më përpara, por atëherë mundësitë i kishim më të pakta. Tani këto mundësi i kemi më të mëdha, por, siç thashë, duhet

---

1 U drejtohet ministrit të Ndërtimit dhe shokëve të tjerë që qenë ftuar në këtë mbledhje.

të dimë t'i shfrytëzojmë, se edhe tani mund të ketë pikëpamje frenuese. Këtu u tha, për shembull, që në rast se i lejojmë fshatarët të bëjnë vetë tulla, atëherë në ç'mënyrë do t'ua tërheqim paratë? Kjo nuk është e drejtë. Një mendim i tillë mund të na shpjerë gjer atje sa të themi: Si do t'ua tërheqim paratë fshatarëve në rast se ata marrin 40 kuintalë grurë për hektarose 60 kuintalë misër për hektar? Duke gjykuar kështu, ka rrezik të vihemi në një rrugë të gabuar. Çështjet, shokë, nuk duhet të shtrohen në këtë mënyrë, prandaj problemet t'i zgjidhim me një logjikë të fortë marksiste-leniniste dhe t'u japim më tepër iniciativë masave, bazës, rretheve. Nuk them se atyre nuk u është dhënë iniciativë, por e kam fjalën se nuk u është dhënë sa duhet.

Organet qendrore duhet të binden se rrethet, baza mund të bëjnë gjëra të mëdha me metodën e punës së aksionit me goditje të përqendruar, sidomos tani kur po bëhen gjithë këto shtëpi dhe të tjera gjëra, të cilat vërtetojnë se janë krijuar forca e mundësi të mëdha në bazë. Ndërtimeve që do të bëhen në rrethe, duhet t'u përgjigjemi me shtesën e kapacitetit të fabrikave të çimentos. Mirëpo që të arrihet kjo, duhet përcaktuar mirë, në kohë, që rrethet të dinë se çfarë do të marrin brenda gjashtë muajve e kështu me radhë. Prandaj, për të gjitha këto detyra, të bisedohet me komitetet e Partisë, me komitetet ekzekutive dhe me ndërmarrjet në rrethe. Atje të merren vendimet dhe të bëhen planet për realizimet që parashikohen, sipas mundësive e të ndara në periudha të caktuara kohe. Të jemi të bindur se ata do t'i bëjnë mirë. Në këtë frymë, më duket mua, duhet t'i shohim këto gjëra.

Ne nuk duhet të kënaqemi me pak e të përsëritim vazhdimisht se kemi prodhuar letrën katrama, fjala vjen, e kushedi se ç'bëmë! Letra katrama është një gjë e vogël në krahasim me këto që po bëjmë tani. Si ajo duhet të bëjmë me qindra artikuj të tjerë ndërtimi, sepse mjetet i disponojmë dhe mundësitë i kemi. Por që të bëhen këto, kërkojen organizim më i mirë dhe iniciativë më e madhe. Nuk duhet të kënaqemi me atë që kemi arritur, në një kohë kur vetë jeta na shtron përpara të tjera kërkesa. Në fakt shumë gjëra i kemi realizuar para kohe, por edhe më tepër mund të bëjmë.

Pra, ndërtimet, duke filluar që nga themelet e deri te çatia, që nga betonimi e deri te vendosja e dritareve, si dhe në shumë procese të tjera, kanë një sërë problemesh. Në qoftë se thuhet që kemi gjithë këto materiale ndërtimi, por nuk dihet se si dhe në ç'drejtime duhen përdorur ato, prandaj ndonjëherë ecet në tym e krijohet kaos, kjo gjë nuk duhet lejuar, sepse për materiale ndërtimi kemi nevoja të mëdha. Partia na porositi të ndërtojmë një numër më të madh banesash, fabrikash etj. dhe me një teknikë sa më të përparuar.

Këto kisha për të thënë. Jam dakord me ato që u thanë këtu, por këto probleme duhen specifikuar, duhen studiuar e duhen plotësuar mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**TREGUESIT**



## TREGUESI I LËNDES

### A

*Aksionet, iniciativat dhe lëvizjet revolucionare të masave* — 37-38, 133-135, 176, 185, 345, 502, 533

*Aleanca, kontradiktat sovjetto-amerikane* — 195-196, 199, 265

*Armatimi i gjithë popullit; kuptimi leninist i tij* — 1-6, 423

*Armiqtë e brendshëm dhe armiqtë e jashtëm; veprimtaria dhe lufta kundër tyre* — 263-264, 297-298, 303, 446, 484

*Arsimi në RPSH*

— politika dhe puna e Partisë në fushën e arsimit. Zhvillimi dhe masivizimi i arsimit. Roli i shkollës në përgatitjen e brezit të ri — 106, 305, 339, 414-415, 416-417

— sistemi i ri arsimor — trekëndëshi revolucionar mësim-punë prodhuese-educim fizik e ushtarak. Lidhja e mësimi

me punën e me prodhimin

— 104, 166, 176-177, 185-188, 207-208, 210-214, 309

— tekstet shkollorë; boshti marksist-leninist në to — 208-209

*Artizanati* — 30-32

### B

*Bashkimi Sovjetik. Revizionizmi sovjetik*

— degjenerimi i rendit socialist, likuidimi i Partisë, i diktaturës së proletariatit dhe restaurimi i kapitalizmit në BS. Kriza, disfatat e revizionistëve sovjetikë dhe lufta për pushtet midis tyre — 189-195, 204-205, 265-266, 281-283, 285-286, 370-371, 404-405

— lidhjet me imperializmin; depërtimi i kapiteleve të huaja në BS — 196-198, 201

— lufta e tij kundër marksizëm-leninizmit — 128-129, 201-205

- politika e luftës, e ekspansionit, demagogjike; përpjekjet për të ruajtur e për të forcuar hegjemoninë mbi vendet revizioniste dhe kontradiktat me to. Synimet e tyre ndaj Ballkanit dhe vendeve arabe — 17-18, 20-21, 22-24, 25-26, 27-28, 193-195, 199-204, 234-236, 237, 265-266, 267-268, 396-399
- ngritja në revolucion e klasës punëtore dhe e popullit sovjetik — rrugë e vetme për përmbyshjen e revizionizmit në BS — 28, 205-206, 404-405

### *Blegtoria*

- rritja e rendimenteve dhe e prodhimtarisë së bagëtive. Prodhimet blegtorale — 39-41, 334, 467-468
- lopa — përmirësimi racor, trajtimi shkencor dhe shtrirja e saj në zonat malore. Bagëtitë e imëta — 33-36, 38-39, 242-243, 252-253, 333-334, 335, 336-337, 362-363, 465-469, 489-490
- baza ushqimore (kullostat, foragjeret) — 38-39, 240-241, 243, 333-334, 335, 337

*Borgjezia. Borgjezia e re re-*

*vizioniste* — 192-193, 223-224, 299, 357-358

*Bujqësia; modernizimi dhe intensifikimi i saj* — 97-98, 241, 328-330, 361

- agronomia, agroteknika dhe shërbimet kulturore. Kodi agroteknik. Rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore — 33-34, 35, 37, 332, 458-460, 489
- studimet në fushën e bujqësisë. Zhvillimi i saj mbi baza shkencore — 90-92, 97-98, 459-560
- ujitja, kanalet ujitëse, bonifikimet. Plehrat, plehrimi — 44, 75, 99-101, 305-307, 333-334, 468-469
- drithërat; problemi i sigurimit të bukës në vend. Perimet — patatja. Pemëtaria. Farërat dhe trajtimi shkencor i tyre — 42-43, 51-52, 93-97, 329-330, 332-333, 338-339, 366-368, 464-465, 492-493
- pambuku, bimët mjekësore — 35, 491-492
- harmonizimi, bashkërendimi i bujqësisë me blegtorinë — 240-241, 363-364, 489

*Burokratizmi dhe lufta kun-*



dër shfaqjeve të tij — thjeshtimi i organeve shtetërore dhe i administratave — 103-109, 116-117, 133-134, 136-137, 138-142

## Ç

Çekosllovakia — agresioni ushtarak sovjetik kundër Çekosllovakisë dhe qëndresa e popullit çekoslovak ndaj këtij agresioni — 19-21, 199-200, 234, 237, 397-398

## D

Demokracia borgjeze — 302-303

Demokracia socialiste — 60-61, 161, 302, 303

Diktatura e proletariatit në Shqipëri — roli dhe detyrat e saj në ndërtimin socialist të vendit — 302, 352-353

Disiplina proletare në punë dhe disiplina e planit — 138-139, 181, 293, 493-494

## E

Edukimi komunist dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja. Bindja — 259, 277-278, 280, 309-310, 342-343, 355, 359-360, 410, 417-423, 470-472, 475-476, 511-512

Engels, Frederik — 126, 222,

267, 276, 284, 298-299, 389  
Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 54-55, 155, 246-247, 327-328, 347, 350, 389-390, 394, 410-412, 426-427, 429-430, 435, 451, 460, 462-463, 481-482, 508, 514

## F

Familja; martesë — krijimi i familjes së re socialiste — 215-217, 228-229, 261-263, 290, 346, 461-463, 472-475, 498-500, 512-513, 515

Feja, lufta kundër saj — 339-341, 461, 470-471, 500-501

Franca — gjendja e brendshme, marrëdhëniet dhe kontradiktat e saj me SHBA — 392, 402, 403-404, 446-447

Fshatarësia, fshatarësia kooperativiste; edukimi ideopolitik dhe profesional, roli i saj në zhvillimin e bujqësisë dhe në ndërtimin socialist të vendit — 45, 57-58, 60, 62-63, 64, 67-69, 99-101, 107, 253-254, 278, 522-523

Fshati socialist — politika e Partisë për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës në fshat — 410, 522-523  
Fuqia punëtore. Sigurimi dhe shpërndarja e saj — 99-101, 211-212, 456

## G

*Gruaja dhe vajza shqiptare — politika dhe kujdesi i Partisë për emancipimin e gruas; virtytet moral-politike të saj — 261-262, 289-292, 336-337, 338-339, 342, 344-345, 354-355, 369, 407-408, 415-416, 420-421, 423, 471-475, 496-497, 498*

## I

*Imperializmi — strategjia globale, kontradiktat dhe kriza në gjirin e tij — 128-129, 197-198, 266, 370-371*

*Industria e rëndë*

- industria mekanike; prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit dhe i makinave — 98-99, 272-273, 455-456
- industria elektrike — zhvillimi i saj. Elektrifikimi i vendit — 413-414, 444, 502-503, 520-524
- zhvillimi i industrisë minerare, të bakrit dhe i industrisë metalurgjike. Kërkimet gjeologjike, gjeologët — 273-275, 444
- industria e materialndërtimit dhe studimet në këtë fushë. Industria e drurit — 450-452, 454-

-455, 486, 507-508, 530-534

*Inteligjencia — politika e Partisë ndaj inteligjencies. Edukimi i saj — 174-176, 178-180, 181, 284-285, 286, 289*

*Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak — 60, 63, 66, 179-180, 419-420, 509-510, 513-514*

*Italia — krizat ekonomike, grevat e punëtorëve dhe të masave punonjëse — 402-403*

## J

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav*

- agresioni fashist gjerman dhe italian i 6 prillit 1941 kundër Jugosllavisë. Lufta nacionalçlirimtare e popujve të Jugosllavisë — 120-125
- gjendja ekonomike, konfliktet nacionale dhe lufta e grupeve revizioniste për pushtet — 238-239, 308, 322, 395-396
- agjenturë e imperializmit. Kreditë imperialiste për Jugosllavinë. Qëndrimi i titistëve ndaj revizionistëve sovjetikë — 396, 397

## K

*Kapitalizmi* — shfrytëzimi, varfërimi, dhe lënia pa punë e masave punonjëse — 298-299, 357-358, 419

*Këshillat popullorë, komitetet ekzekutive* — kompetencat, detyrat dhe lidhjet me masat.

*Këshilltari* — 76, 160-163, 470

*Këshilli i Mbrojtjes. Tezat e Këshillit të Mbrojtjes* — 232-233, 318-320

*Këshilli i Ministrave (Qeveria)* — 95, 243, 465

*Klasa punëtore në Shqipëri* — roli udhëheqës i Partisë ndaj saj. Vendi dhe roli udhëheqës i klasës punëtore në shoqërinë tonë socialiste. Cilësitë dhe virtytet moralopolitike të saj — 102-103, 106-107, 116-118, 178-179, 180, 275-278, 279-280, 284-285, 286, 288-290, 493-495, 528-529

— pozita dhe pjesëmarrja e saj në ndërtimin socialist të vendit. Edukimi ideopolitik dhe profesional i saj — 103, 107, 272-273, 275-278, 281, 286-289, 293-294, 494-495, 518-519

*Klasa punëtore (proletariati)* — gjendja e saj; domosdoshmëria e bashkimit dhe e or-

*ganizimit* — 102-103, 292, 299, 403

*Kolektivizimi socialist i bujqësisë. Kooperativat bujqësore* — politika e Partisë për forcimin e gjithanshëm të kooperativave bujqësore të zonave malore. Epërsia e kolektivizimit mbi ekonominë private — 307-308, 357, 358-360, 365, 391-392, 488-489, 491-492

— organizimi dhe drejtimi i punës dhe i prodhimit në kooperativat bujqësore — 32-33, 46-47, 52, 56-67, 493-494

— pjesëmarrja e kooperativistëve në punë, të ardhurat e kooperativistëve — 364-365, 491-493

— kuadrot, specialistët — 33-34, 39, 67-69, 336-337, 339, 414, 466-467

*Komunisti* — roli pararojë dhe shembulli personal i komunistit. Figura moralopolitike dhe lidhjet e tij me masat. Revolucionarizimi, edukimi dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 144-145, 217-218, 228-231, 256-257, 278-279, 280-281, 324, 342-344, 381-382, 386-390, 392-394, 407

*Komunizmi* — përgatitja e kushteve për ndërtimin e sho-

qërisë komuniste — 106-107, 109-110, 276-277, 309, 437, 523

Kontradiktat joantagoniste në shoqërinë tonë socialiste dhe rrugët për zgjidhjen e drejtë të tyre — 142-144

Kosova — politika shoviniste e demagogjike e titistëve. Gjendja e brendshme; lufta e popullit kosovar për të drejta kombëtare e përparim shoqëror e kulturor — 238, 239, 296-297, 356, 373-376, 398-399, 401, 443-444

Kritika dhe autokritika — 145, 320-321, 343-344

Kuadrot dhe specialistët në vendet kapitaliste e revizioniste — 104-105, 107-108, 285-286

Kuadrot, specialistët

— politika dhe puna e Partisë me kuadrin. Përgatitja, kualifikimi dhe vendosja e kuadrove; përgatitja dhe ngritja e tyre nga radhët e klasës punëtore — 68-69, 102-104, 105-106, 108-119, 303-305, 315-317, 414

— edukimi komunist i kuadrove. Roli dhe detyrat e tyre në edukimin e masave — 117-118, 284-285, 286, 509-510

— metoda dhe stili i punës

së tyre. Marrëdhëniet kuadër-masë. Qarkullimi dhe puna në prodhim e tyre — 108-110, 140-142, 221-223

Kukësi — zhvillimi politik, ekonomik-shoqëror dhe kulturor i tij — 220-222, 225-226, 228, 239-245, 246-248, 249-250, 251-263, 269-270, 291, 311, 312, 477-478, 481-482

## L

Lenin, Vladimir Iliç — 1-3, 5-7, 10, 12, 13, 15, 54, 56, 109, 126-130, 143, 190, 193, 202, 204, 222, 223, 224, 231-232, 248, 265, 267, 276, 281, 284, 299, 300, 301, 302, 313, 314, 353, 389, 397, 422, 437, 446, 479, 520

Letërsia e artet borgjezo-revizioniste dhe lufta kundër tyre — 80-81

Libri, puna me librin. Studimi — 71-72, 386-389, 475

Ligjet objektive të natyrës — njohja dhe zbatimi i ndër-gjegjshëm i tyre — 34, 459

## M

Marksizëm-leninizmi — studimi dhe zbatimi i tij në kushtet konkrete. Lufta e revizionistëve modernë dhe e

reaksionit kundër m-l — 126-  
-130, 222-225, 445, 476

Marks, Karl — 102-103, 104,  
109, 112, 117, 126, 222,  
223, 267, 276, 284, 298-299,  
301, 389, 431, 437

Mbrojtja e atdheut — përga-  
titja e ushtrisë, e popullit dhe  
e vendit për mbrojtje — 1-  
-16, 231-234, 239, 269, 313-  
-315, 421-423, 478-479

Mësuesit, pedagogët — 168-  
-169, 183-186, 207-208, 209-  
-210

Ministritë, metoda e punës  
dhe detyrat e tyre. Kuadrot  
— 76-77, 99, 134-136, 139-  
-142

— Komisioni i Planit të  
Shtetit — 99, 114, 134-  
-135, 139, 244

— Ministria e Arsimit dhe  
e Kulturës — 114, 207,  
209, 213

— Ministria e Bujqësisë —  
72, 76-77, 93-94, 99

— Ministria e Industrisë  
dhe e Minierave — 99,  
140, 455-456, 457

— Ministria e Ndërtimit —  
530-531

— Ministria e Tregtisë —  
77, 140

Mirëqenia materiale dhe ngri-  
tja e nivelit kulturor të ma-  
save — rrugët dhe treguesit  
e rritjes së mirëqenies — 45-

-47, 254, 337-339, 360, 438-  
-439, 483-484, 490

## N

Ndërtimi i socializmit — po-  
litika dhe masat e Partisë për  
ndërtimin socialist, për ta  
çuar atë deri në fund dhe  
për t'i prerë rrugën revizio-  
nizmit në Shqipëri — 108-  
-110, 177-178, 250-251, 274-  
-275, 308, 310, 368-369,  
436-439, 476, 484, 519-523,  
527-529

## O

Organizata-bazë e Partisë —  
gjallërimi dhe rritja e frymës  
luftarake, përmirësimi i me-  
todës dhe i formës së punës  
së saj — 72, 143-145, 169,  
170-171, 172-173, 174, 181-  
-185, 187-188, 229-230, 278-  
-279, 280-281, 324

## P

Partia e Punës e Shqipërisë  
— roli udhëheqës dhe orga-  
nizues i saj në Luftën  
Nacionalçlirimtare dhe në  
ndërtimin socialist të ve-  
ndit — 301, 351-352  
— vendimet, direktivat e  
Partisë — njohja, zbër-  
thimi, përsosja dhe pu-

- na për zbatimin e tyre — 148-151, 219, 222, 256-257, 471
- lidhjet e Partisë me masat — 220, 382-383
  - Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ të Partisë — 93-95, 147, 212-213, 221, 380-381, 465, 531
  - Plenumi i 4-t i KQ të PPSH (11-12 dhjetor 1967) — 523
  - Plenumi i 8-të i KQ të PPSH (26-28 qershor 1969) — 207-208, 209
- PPSH — organizatat dhe komitetet e Partisë në rrethe*
- komitetet e Partisë dhe sekretarët e tyre; metoda, stili në punë dhe detyrat e tyre — 387-390
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Durrësit — 48-49, 98
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Kukësit — 219-222, 225, 250-251, 257, 294, 312
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Pukës — 449-450, 514-516
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 98
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të
- Tropojës — 378-389, 390-392, 407-408
- Planifikimi i ekonomisë popullore dhe metodologjia e saj. Pjesëmarrja e masave dhe e bazës në planifikim* — 76-77, 92-93, 94, 131-134, 135-137, 138-139, 457-458
- planifikimi dhe zbatimi i planeve në bujqësi. Pjesëmarrja e masave në hartimin e planeve — 43-44, 62-67, 74-75, 92-93, 243-244, 360-361, 466-467, 469-470
  - plani i katërt dhe i pestë pesëvjeçar — 270, 273-274, 294-295, 376, 412, 469-470, 477, 503, 527-528
- Politika e jashtme e RPSH*
- parimet themelore mbi në politikën e jashtme. Solidariteti dhe përkrahja e lëvizjeve dhe e luftërave nacionalçlirimtare të popujve të botës — 124-125, 266-270, 370-371
  - marrëdhëniet me vendet dhe me popujt fqinjë. Përkrahja e popullit shqiptar për popujt e Jugosllavisë në rast të ndonjë agresioni ushtarak kundër tyre nga revizionistët sovjetikë — 24-25,

- 125, 236, 238, 269, 323, 371-373, 399-400
- qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj Kosovës dhe popullsisë shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 356, 373-376, 400-401, 443-444
  - kritikë pikëpamjeve të revizionistëve sovjetikë për revolucionin socialist dhe revolucionin tekniko-shkencor — 283-284, 302
- Politika në plan të parë — shikimi i problemeve me syrin politik — 330, 419-420*
- Populli shqiptar*
- virtytet, cilësitë moralopolitike, traditat patriotike revolucionare. Luftërat e tij për liri, pavarësi e përparim shoqëror — 225-226, 248-250, 260-261, 296-298, 299-301, 326-327, 341, 349, 351-352, 355, 415-422, 425-426, 434-436, 513-514
  - pjesëmarrja dhe roli i tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 49-50, 161, 248-250, 303-306, 350-351, 356-357, 446, 506-507, 508-509
- Praktika dhe teoria; uniteti dialektik i tyre — 222, 286-287, 475-476*
- Prona socialiste — qëndrimi socialist ndaj pronës — 33, 63, 494-495*
- Propaganda e prodhimit në bujqësi; propaganda e prodhimit — 69-75, 89-90, 383-386*
- Puka — zhvillimi politik, ekonomik-shoqëror dhe kulturor i saj — 449-480, 481-504, 505-516*
- Puna — qëndrimi socialist ndaj punës; roli i punës në edukimin dhe në zhvillimin e gjithanshëm të njeriut — 33, 176-177, 185-187, 310-311, 330-331, 359, 364-365*
- Pushteti merret nga klasa punëtore dhe nga popujt vetëm me luftë të armatosur — 301-302*
- Pyjet — mbrojtja, shfrytëzimi, përmirësimi dhe shtimi i tyre — 333, 452-454, 485-488*

## R

*Revolucioni shoqëror, revolucioni proletar, revolucioni popullor — 298, 300, 301, 303, 445-447, 527-528*

*Revolucioni tekniko-shkencor — 477*

*Rinia dhe BRPSH — politika dhe kujdesi i Partisë për edukimin dhe për zhvillimin e*

*gjithanshëm të rinisë. Gjallërimi dhe revolucionarizimi i organizatave të rinisë në shkolla* — 53-54, 164-165, 167-173, 174, 175, 176-177, 181-183, 187-188, 415-416

*Roli i njeriut dhe i armëve në luftë* — 524

*Rumania — gjendja e brendshme, kontradiktat me revizionistët sovjetikë* — 306, 396

## S

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 143, 189, 190, 193, 202-203, 204, 222, 267, 276, 281, 282, 284, 299, 302, 353, 389, 397, 404, 405-406, 439

*Strategjia dhe taktikat ushtarake. Studimi dhe zbatimi i tyre* — 422-423, 459, 479

*Studentët, nxënësit — edukimi ideopolitik, arsimor dhe kulturor i tyre* — 164-188

## SH

*Shëndetësia — politika dhe kujdesi i Partisë për shëndetin e popullit, për nënën dhe fëmijën* — 50-51, 369-370, 391-392, 414, 439-442, 460-461

*Shkolla e Lirë Ushtarake* — 1-16

*Shkrimtarët dhe artistët — politika e Partisë për edukimi*

*min ideoestetik e tekniko-profesional të tyre* — 78-85

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — strategjia globale, politika e luftës dhe e ekspansionit. Disfatat e tyre në Vietnam* — 196-197, 235, 263-265, 285, 401-402, 478, 524-525

*Shtypi në RPSH — përmbajtja, tematika, shfrytëzimi dhe përhapja e tij. Gazetarët, korrespondentët vullnetarë të shtypit* — 146-159, 388

## T

*Të huajt, miqtë për Shqipërinë* — 307

*Traktati i Varshavës — vegël në duart e socialimperialistëve sovjetikë; kontradiktat në gjirin e tij. Denoncimi i tij nga RPSH* — 17-29, 397

*Tregtia e jashtme — rritja e eksportit dhe pakësimi i importit* — 45-46, 98-99

*Tropoja — zhvillimi politik, ekonomiko-shoqëror dhe kulturor i saj* — 349-351, 353-357, 358-360, 361-368, 376, 382-383, 391-392, 413, 433-444, 447-448, 477-478, 481-482

## U

*Uniteti Parti-popull. Uniteti moralo-politik i popullit*



*shqiptar* — 180-181, 257-259,  
409-410, 420-421, 445, 503,  
504, 514

*Ushtria Popullore*

- politika dhe udhëheqja e Partisë në të. Roli dhe detyrat e saj për mbrojtjen e atdheut; forcimi dhe revolucionarizimi i saj, karakteri popullor — 1-16, 54, 231-234, 312-314, 322
- përgatitja, edukimi, stërvitja dhe gatishmëria luftarake — 14-15, 313-315, 317-318, 321-322, 324, 479
- komisarët, komandantët, ushtarët — 7-8, 14-15, 232, 233, 314-317, 318-321, 324
- rezervistët, paraushtarakët, forcat vullnetare dhe stërvitja e tyre ushtarake — 3, 12, 232, 314, 317-318, 478-479

**V**

*Vendet revizioniste — gjendja e brendshme, kontradiktat me revizionistët sovjetikë* — 18-21, 199-201, 404, 406-407, 446

*Vigjilenca revolucionare* — 24-25, 28-29, 237-238, 239, 263-264, 316-317, 421

**Z**

*Zakonet shoqërore. E drejta zakonore. Zakonet prapanike dhe lufta kundër tyre* — 214-218, 226-230, 261-263, 288-292, 341-342, 461-463, 470-473, 495-500, 501-502, 510-511, 512-513

*Zonat malore — zhvillimi i mëtejshëm ekonomik-shoqëror dhe kulturor i tyre* — 357, 358-364, 365, 412-415, 463-464, 491-492



## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alia, Ramiz — 78, 219  
Agolli, Dritëro — 392-393, 436  
Avdyli, Haxhi — 357

### B

- Bajrami, Avdi — 427, 428  
Bajraktari, Muharrem — 255,  
303  
Balluku, Beqir — 1, 318  
Brezhnjev, Leonid — 192, 194,  
200, 204, 267, 397  
Bulka, Nonda — 82

### C

- Curri, Bajram — 248, 298,  
326-327, 341, 355-356, 411,  
420, 423, 426, 427, 435-436,  
441  
Cvetkoviç, Dragisha — 120-  
-121

### Ç

- Çako, Hito — 1  
Çoba, Zenel — 484

### D

- Dë Gol, Sharl — 402  
Dodbiba, Pirro — 93, 94-95,  
97-98, 99  
Dubçek, Aleksandër — 237  
Dume, Petrit — 1  
Dyrmishi, Izet — 225

### E

- Emini, Mushak Kadri — 357

### F

- Fasliu, Zef — 484  
Fazliu, Islam — 357  
Ford — 197  
Frashëri (vëllezërit) — 300

### G

- Galica, Azem — 420, 426, 435-  
-436  
Galica, Shote — 420  
Gorshkov, S. A. — 195  
Grameno, Mihal — 435-436  
Greçko, Andrei — 17, 195, 404-  
-405  
Gurakuqi, Luigj — 298, 435-  
-436

**H**

- Hajdarmataj, Shaban Rexhë  
— 364, 442  
Hitler, Adolf — 26, 122, 198  
Hrushov, Nikita — 190, 191,  
192, 194, 204, 205

**I**

- Ismaili, Zoje — 484

**J**

- Jakubovski, Ivan — 195  
Jorgaqi, Nasho — 394-395

**K**

- Kapo, Hysni — 428  
Kadare, Ismail — 82, 393  
Këllezi, Abdyl — 93  
Kola, Frrok — 484  
Kosigin, Aleksei — 192, 194,  
200, 267, 397  
Krishti — 340, 341  
Krosi, Lalë — 303  
Kruja, Ali — 379  
Kruja, Mustafa — 255

**L**

- Lon Nol — 525

**M**

- Marko, Rita — 37, 78, 217  
Miska, Pali — 449, 454  
Myftiu, Manush — 78, 211

- Mani, Jaho Sali — 357  
Mani, Sali — 356, 427  
Marku, Mire — 364-365  
Migjeni (Millosh Gjergj Ni-  
kolla) — 483  
Minxhozi, Tahir — 225  
Moisiu — 340  
Muhameti — 340  
Musai, Selam — 435-436  
Musaraj, Shevqet — 392-393  
Musolini, Benito — 307

**N**

- Nano, Thanas — 159  
Naser, Gamal Abdel — 235  
Nediç, Milan S. — 121  
Ngjela, Kiço — 140  
Nikson, Riçard — 402

**P**

- Paci, Haxhi — 357  
Paci, Murat — 357  
Peza, Myslim (Babë Myslimi)  
— 55  
Pompidu, Zhorzh — 402, 447  
Prendi, Pjetër — 484  
Prishtina, Hasan — 435-436

**Q**

- Qemali, Ismail — 435-436

**R**

- Rama, Gjelosh — 356  
Rama, Mehmet — 433

Rankoviç, Aleksandër — 239,  
397, 398  
Rustemi, Avni — 248, 426  
Rustemi, Ukshin — 357

**S**

Spahiu, Xhafer — 332  
Sadiku, Isuf — 431  
Saragati, Xhuzepe — 403  
Seçi, Elez Isuf — 364  
Stafa, Qemal — 298, 394-395  
Syla, Niman — 356

**SH**

Shabani, Ali — 425-432, 441-  
-442  
Shehu, Mehmet — 318  
Shtemenko — 17  
Shuteriqi, Dhimitër — 78, 82

**T**

Tërbuni, Halil — 484  
Tito, Josif Broz — 235, 236,  
238-239, 308, 322, 323, 395,  
396, 397, 398-399

Toliati, Palmiro — 403  
Topulli, Çerçiz — 426, 435-  
-436

**U**

Ulbricht, Valter — 406

**V**

Vaso Pasha — 300  
Vogli, Nikollë — 484

**X**

Xoxe, Jakov — 393

**Z**

Zoga, Haxhi — 356  
Zogu, Ahmet — 298, 303, 325,  
327, 356, 418, 445

**ZH**

Zhivkov, Todor — 406  
Zhukov, Georgi — 405-406



## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Afrikë — 129, 199  
Agjencia Telegrafike Shqiptare — 155  
Aleksandri (Egjipt) — 235  
Amerika Latine — 129, 199, 366  
Angli — 201, 297, 402  
Azi — 18, 129, 199, 265

### B

- «Baballarët» (poema ~, Dritëro Agolli) — 392, 436  
Bajram Curri (qyteti ~) — 349, 443  
«Bashkimi» (gazeta ~) 150, 156  
Batalioni «Bajram Curri» — 356  
Batalioni i Rinisë — 356  
Belgjikë — 224  
Beograd — 124  
«Borba» (gazeta ~) — 373  
Bosnjë — 125

- Brigada XXV Sulmuese — 356  
Bujan (Tropojë) — 363, 364  
«Bujqësia socialiste» (revista ~) — 157  
Bukuresht — 267  
Bullgari — 123-124, 397, 406, 446

### C

- Curraj i Epërm (Tropojë) — 362-363

### Ç

- Çernicë (Tropojë) — 443  
Çeta e Lumës — 249  
Çeta «Emin Duraku» — 356

### D

- Deti Adriatik — 399  
Deti Mesdhe — 199, 234, 235, 236, 323, 399  
Dragobi (Tropojë) — 354, 409,

- 410-411, 413, 414-415, 422,  
423-424, 435, 444  
Durrës — 31, 41-42, 72-73,  
82-83, 100, 399
- E**
- Evropa Lindore — 20, 23-24,  
27-28  
Evropë — 18, 19, 24, 122, 129,  
298, 398  
Egjipt — 235  
Elbasan — 40, 42, 508
- F**
- «Fatosi» (revista) — 158  
Fier — 100  
Fusha e Hoxharës, e Krujës  
dhe ajo e Lezhës — 75  
Fushë-Arrëz (Pukë) — 450-  
-451, 452, 482
- GJ**
- Gjakovë (Jugosllavi) — 331,  
356  
Gjermania Perëndimore  
(RFGJ) — 20, 197, 201, 396,  
404, 406  
Gjirokastër — 461-462, 508
- H**
- Has (Kukës) — 251, 295, 326-  
-332, 335, 347-348  
Hidrocentrali i Fierzës — 306-  
-307, 376, 413, 442, 444, 503,  
520  
Hidrocentrali i Komanit —  
306-307, 444  
Hidrocentrali i Vaut të Dejës  
— 306-307, 412, 444, 517-520,  
526-527, 529  
Hungari — 306, 404
- I**
- Indokinë — 264, 525  
Instituti i Lartë i Arteve —  
80
- J**
- Japoni — 197, 406
- K**
- Kambohia — 264, 268, 370,  
478, 524-525  
Kanali i Begajt (Tropojë) —  
354  
Kanali i Krasniqes (Tropojë)  
— 354  
Kanali ujitës i Gojanit (Tro-  
pojë) — 490  
«Kapitali» (libri), K. Marks)  
— 102-103  
«Katastrofa që na kanoset  
dhe si duhet luftuar kundër  
saj» (artikulli), V. I. Lenin)  
— 224  
KNER — 27  
Komanda e Përgjithshme e  
UP — 315



Komisioni Qendror për Arsimin — 170, 210, 213

«Kompleksi i prodhimit ndërshtetëror i Danubit të Posh-tëm» — 267

Kooperativa bujqësore e bashkuar e Krumës (Kukës) — 332-333

Kooperativa bujqësore e Luzit të Madh (Durrës) — 54, 69

Kooperativa bujqësore e Luzit të Vogël (Durrës) — 30-47, 48-55, 65, 71, 74

Kooperativa bujqësore e Margegajt (Tropojë) — 359

Kooperativa bujqësore e Shëngjergjit (Tropojë) — 364

Kooperativa bujqësore e Zogajit (Tropojë) — 364

«Komunist» (revista) — 17

«Krasnaja Zvezda» (gazeta) — 17

Krujë — 162-163

Krumë (Kukës) — 327, 328

Kurora e Dardhës (Pukë) — 453

Kuvendi i Malësisë së Gjakovës (28 gusht 1943) — 356

## L

Laos — 264, 268, 370, 478

Lekbibaj (Tropojë) — 354, 364

Lezhë — 100

Lumi Drin — 444, 518

Lushnjë — 100

## M

Malet e Shkëlzenit — 349, 353

Mali i Zi — 125, 322, 374, 375

Maqedoni — 322, 374, 375

Miniera e Bakrit — Gjegjan (Kukës) — 245, 254-255, 271-272, 275-276, 287-289

Miniera e Manzës (Durrës) — 115

## N

NATO — 236, 404

Ndërmarrja bujqësore e Hasit (Kukës) — 334-336

Ndërmarrja e Prodhimeve Farmaceutike—Tiranë — 134

## O

Oqeani Indian — 199

Oqeani Paqësor — 199

## P

Pac (Tropojë) — 354

«Pakti tripalësh» (Gjermani-Itali-Japoni) — 120-121

Palestinë — 268

Partia revizioniste italiane — 403

Pejë — 356

Peshkopi — 99, 244, 249, 490

Petërburg — 5

«Pionieri» (gazeta) — 158

Poloni — 404, 446

Pragë — 200, 202-203  
 Prizren (Jugosllavi) — 331,  
 356  
 «Puna» (gazeta) — 150, 156

## Q

Qafa e Luzhës (Tropojë) —  
 349

## R

Radio Tirana — 159  
 Republika Demokratike Gjermane — 446  
 Revolucioni i Madh Socialist  
 i Tetorit — 26, 205-206, 281-  
 -282, 355-356

## RR

Rruga e Malësisë së Madhe  
 — 454

## S

Sarandë — 42  
 Sevastopol (BS) — 5  
 Statuti dhe rregullorja e re e  
 shkollave të larta — 170

## SH

Shëngjin (Lezhë) — 351, 399  
 Shijak (Durrës) — 72  
 Shishtavec (Kukës) — 251,  
 255

Shkodër — 82-83, 306, 551,  
 444, 519, 531-532  
 Shkolla e Partisë «V.I. Lenin»  
 — 84, 221, 476  
 «Shkumbini» (gazeta) —  
 156  
 Shqipëria e Jugut — 461-462  
 Shtabi i Përgjithshëm i UP  
 — 314, 315, 318, 320

## T

Tiranë — 249, 451-452, 462-  
 -463, 508  
 Traktati i «miqësisë dhe i a-  
 leancës» sovjeto-çekoslovak  
 — 200  
 Turqi — 300, 301

## U

Universiteti dhe radio e Pri-  
 shtinës — 238, 399  
 Universiteti i Sorbonës — 403  
 Universiteti Shtetëror i Tira-  
 nës — 80, 84-85, 150, 170,  
 353, 375  
 Ura e Kolgecajt (Tropojë) —  
 356  
 Uzina «Enver» — Tiranë —  
 111  
 Uzina e Plehrave Fosfatike-  
 -Laç — 134  
 Uzina e Shkrirjes së Bakrit-  
 -Gjegjan (Kukës) — 271-273,

275-276, 279, 287-289, 294, -422, 428-429, 431, 435, 441  
347

**V**

Valbonë (Tropojë) — 409, 421-

Vendet arabe — 234-235, 268

Vietnam — 264, 268, 370, 478

Vlorë — 234, 323, 399



## L È N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 43—TË ..... V—IX

1970

TEZA PËR SHKOLLËN E LIRË USHTARAKE (5 mars 1970) .....	1—16
NJË HAP TJETËR I REVIZIONISTËVE SOVJE- TIKË NË RRUGËN E AVENTURAVE USHTARAKE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (6 mars 1970) .....	17—29
QË TË MARRIM PRODHIME TË BOLLSHME DU- HET TË DIMË DHE QË TË DIMË DUHET TË MË- SOJMË — Fjala në takimin me një grup kuadrosh drejtues të kooperativës së Luzit të Vogël dhe të kooperativave fqinje (11 mars 1970) .....	30—47
SOCIALIZMI ÇDO VIT SJELL TË MIRA. KËTO I REALIZON POPULLI — Fjala në mitingun e Luzit të Vogël (11 mars 1970) .....	48—55
PËR FORCIMIN E ORGANIZIMIT TË PUNËS NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË ZMADHUARA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 mars 1970) .....	56—77

T'I SHFRYTËZUJME MË MIRË MUNDËSITË PËR EDUKIMIN E PUNONJËSVE TË KRIJIMTARISË LETRARO-ARTISTIKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 mars 1970) .....	78—85
PROPAGANDA E PARTISË I BËN TË NDER- GJEGJSHËM, I NXIT DHE I MOBILIZON NJERË- ZIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 mars 1970) .....	86—101
PËR DISA ÇËSHTJE TË RAPORTIT MIDIS KUA- DROVE ME ARSIM TË LARTË DHE KLASËS PU- NËTORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 mars 1970) .....	102—119
RËNDËSIA E LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE NË HISTORINË E POPUJVE TË JUGOSLLAVISË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (5 prill 1970) .....	120—125
TA MBAJME GJITHNJË LART FLAMURIN E LENINIT — Fjala e hapjes në mbledhjen solemne me rastin e 100-vjetorit të lindjes së V. I. Leninit (21 prill 1970) .....	126—130
TË MBËSHTETEMI FUQIMISHT NË MENDIMIN KRIJUES TË MASAVE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËR RRIJEN E PRODHIMIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 prill 1970) .....	131—145
SHTYPI YNË T'I PËRGJIGJET NIVELIT TË LE- XUESVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (29 prill 1970) .....	146—159
T'U JEPEN KOMPETENCA TË PLOTA KËSHI- LLAVE POPULLORË TË TË GJITHA INSTAN- CAVE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (4 maj 1970) .....	160—163

- TË GJALLËROJMË MË TEPËR JETËN E ORGANIZATAVE TË RINISË NË SHKOLLA — Fjala në takim in me një grup aktivistësh të organizatave të rinisë dhe të Partisë, mësuesish dhe pedagogësh të shkollave të mesme e të larta (12 maj 1970) ..... 164—188
- REVIZIONISTËT SOVJETIKË NË LËMESHINË E KONTRADIKTAVE TË PAZGJIDHSHME — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (15 maj 1970) ..... 189—206
- TË PËRMIRËSOJMË VAZHDIMISHT PUNËN NË SHKOLLË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 maj 1970) ..... 207—213
- NË TRAJTIMIN E ÇËSHTJEVE SHOQËRORE KËRKOHEN KUJDES, TAKT DHE NGROHTËSI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 maj 1970) ..... 214—218
- T'I KUPTOJMË POLITIKISHT ÇËSHTJET DHE T'U VEMI PUNËVE GJER NË FUND — Fjala në takim in me kuadro drejtues të rrethit të Kukësit (27 maj 1970) ..... 219—245
- TOK ME POPULLIN TË KRIJOJMË ATË REALITET TË MADH QË SYNON PARTIA — Fjala në mitingun e qytetit të Kukësit (28 maj 1970) ..... 246—270
- MINATORËT DHE METALURGËT JANË PJESA MË E FORTË E KLASËS PUNËTORE — Fjala në takim in me punëtorë e kuadro të Uzinës së Shkri-rjes së Bakrit dhe të Minierës së Gjegjanit të Kukësit (28 maj 1970) ..... 271—295
- NJERËZIT KALITEN NË PUNË E NË LUFTË — Fjala në darkën e shtruar me rastin e përfundimit të vizitave në rrethin e Kukësit (28 maj 1970) ..... 296—311

- USHTRINË DHE POPULLIN T'I EDUKOJMË MIRË  
POLITIKISHT E USHTARAKISHT — Fjala në ta-  
kimin me ushtarë e kuadro të repartit «N» të  
Kukësit (29 maj 1970) ..... 312—325
- ME PUNË DHE ME MËSIM NE DO TË ECIM  
PËRPARA — Fjala në takimin me punonjësit e  
Hasit dhe të kooperativës së bashkuar të Krumës  
(29 maj 1970) ..... 326—346
- POLITIKA E DREJTË E PARTISË DHE PUNA E  
POPULLIT PO I TRANSFORMOJNË MALET DHE  
BJESHKËT TONA — Fjala në mitingun e qytetit  
Bajram Curri (30 maj 1970) ..... 349—377
- MASAT KËRKOJNË SHEMBULLIN E MIRË TË  
KOMUNISTËVE E TË KUADROVE — Fjala në  
takimin me anëtarët e byrosë së Komitetit të Par-  
tisë të Rrethit të Tropojës (30 maj 1970) ..... 378—406
- PARTIA SKALIT TE NJERËZIT VIRTYTET E  
LARTA TË POPULLIT — Nga biseda me koope-  
rativistët e Dragobisë (31 maj 1970) ..... 409—424
- EDHE NJËZET JETË PO TË KESH TË PUNOSH,  
POPULLIT NUK IA LAN DOT — Nga biseda me  
patriotin Ali Shabani (31 maj 1970) ..... 425—432
- NË KËTO BJESHKË MADHËSHTORE NE MOREM  
NJË FRYMËZIM TË MADH — Fjala në darkën e  
shtruar me rastin e përfundimit të vizitave në rre-  
thin e Tropojës (31 maj 1970) ..... 433—446
- PASI TË HARTOHET PLANI, TË VËMË TË TËRA  
FORCAT PËR REALIZIMIN E TIJ — Fjala në  
mbledhjen me kuadrot kryesorë të rrethit të Pukës  
(1 qershor 1970) ..... 449—480



NDËRTIMET TE NE BËHEN ME LËNDËN QË NXJERRIN DUART TUAJA TË REGJURA SI LË- VOZHGA SHEKULLORE E PISHËS — Fjala në mitingun e qytetit të Pukës (2 qershor 1970) .....	481—504
POPULLI E VLERËSON LART KONTRIBUTIN E PUKJANËVE NË LUFTË E NË NDËRTIMIN SO- CIALIST — Fjala në drekën e shtruar me rastin e përfundimit të vizitave në rrethin e Pukës (2 qer- shor 1970) .....	505—516
FORCËN E LUMENJVE JU E VINI NË SHËRBIM TË ÇËSHTJES SË REVOLUCIONIT E TË SOCIA- LIZMIT — Fjala në mitingun e Vaut të Dejës (3 qershor 1970) .....	517—529
PËR MATERIALE NDËRTIMI KEMI NEVOJA TË MËDHA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Po- litike të KQ të PPSH (15 qershor 1970) .....	530—534
TREGUESI I LËNDËS .....	537
TREGUESI I EMRAVE .....	549
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA .....	553